Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm /Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar nenin 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare,Nr.7,01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullore (QRK) Nr. 04/2021 si dhe nenit 9 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nxjerrë:

V E N D I M

Për dhënien e pëlqimit për miratim të Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas verifikimit të përputhshmërisë së Projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033", me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, "Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+", dhe Udhëzimin Administrativ Nr. MMPH 08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, jep pëlqim për miratim të "Plani Zhvillimor i Komunës së Shtërpcës 2025-2033".

A r s y e t i m

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor - Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Komuna e Shtërpcës, me shkresë zyrtare, më datë 05.11.2025 me Nr. Protokolli 8116/25 ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës/ Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit pëlqim për miratim të Projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033" sipas procedurës ligjore, pas shqyrtimit publik të hapur më datën 29.05.2025 në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të Projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033" dhe dokumentacionit përcjellës Raportin nga Shqyrtimi Publik, konstaton se ky Projekt-dokument:

1. I plotëson kushtet ligjore mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të parapara me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ;
2. Është në harmoni me nenin 15 dhe 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
3. Është në përputhshmëri me "Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+"
4. Është në harmoni me Udhëzimin Administrativ MMPH–Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal;
5. Është në harmoni me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.
6. Është në harmoni me Udhëzimin Administrativ MMPH–NR.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor.

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor - Drejtoria për Planifikim, Rindërtim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Komuna e Shtërpcës brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit të dokumentit të planifikimit hapësinor nga Kuvendi i Komunës duhet të dorëzoj në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës "Planin Zhvillimor Komunal të Shtërpcës 2025-2033", me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe kompletimit të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave të planifikimit hapësinor, sipas neni 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor obligohet të respektoj Ligjin për Tokën bujqësore në fuqi gjatë zbatimit të zhvillimeve në Komunë duke përfshirë "Plani Zhvillimor i Komunës së Shtërpcës 2025-2033 ".

"Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033" duhet të dorëzohet në Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit për miratim të Planit Zhvillimor Komunal, në kuptim të nenit 81 të Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale.

"Plani Zhvillimor Komunal i Shtërpcës 2025-2033" duhet të përkthehet në gjuhën serbe ashtu si parashihet në nenin 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- **Në kuptim të neni 21. të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, me Planin Zhvillimor Komunal nuk mund të lëshohen Kushte Ndërtimore!**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Izedin Bytyqi

U.D.i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:
- Parashtruesit të kërkesës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.

1.3. INFORMATA PËR KORNIZËN STRATEGJIKE TË MARRË PARASYSH GJATË HARTIMIT TË PZHK-së

1.3.1. Strategjitë sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata në nivel lokal dhe qendror

Gjatë përgatitjes së kornizës strategjike, komuna është mbështetur në dokumentet vijuese strategjike të nivelit qendror:

- Raporti i Gjelbër, Prishtinë 2015, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme, Prishtinë 2020, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit,
- Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+, Prishtinë 2010, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës.
- Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Para universitar në Kosovë 2016-2020, Prishtinë 2013, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016- 2021 (SKZh), Prishtinë 2016, Qeveria e Republikës së Kosovës.
- Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 – 2020, Prishtinë 2010, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 – 2020, Prishtinë 2009; Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2016– 2017, Prishtinë mars 2017, Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011 – 2018, Prishtinë Gusht 2011; Ministria e Ekonomisë.
- Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publiko- Private për Republikën e Kosovës, Prishtinë 2014, Ministria e Financave.
- Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i Veprimit 5 vjeçar, Prishtinë Gusht 2015, Ministria e Infrastrukturës.
- Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, Prishtinë 2010; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2016- 2026, Prishtinë 2016, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017- 2021, Prishtinë 2016, Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Para universitar në Kosovë, Prishtinë 2016; Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013- 2018, Prishtinë 2013, Ministria e Diasporës.
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Prishtinë 2016, Ministria e Shëndetësisë.
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Prishtinë 2014, Ministria e Mirëqenies Sociale.
- Gjatë përgatitjes së kornizës strategjike, Komuna është mbështetur në dokumentet vijuese strategjike të nivelit lokal:
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013- 2018, Prishtinë 2013, Ministria e Diasporës.
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Prishtinë 2016, Ministria e Shëndetësisë.
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Prishtinë 2014, Ministria e Mirëqenies Sociale.

1.3.2. Strategjitë e nivelit qendror

1.3.2.1. Strategjia e Mjedisit

Kosova është duke kaluar nëpër një fazë të rëndësishme të zhvillimeve të një periudhe të pasluftës, ku ngjashëm me vendet e pasluftës të rajonit, megjithatë mjedisi fillimisht nuk ka qenë një ndër prioritetet.

Kosova nuk ka pasur ndonjë traditë të gjatë të trajtimit të problemeve mjedisore, nuk ka pasur institucion (ministri) përgjegjës për mjedisin e as legjislacion të duhur për ta realizuar këtë. Të gjitha këto fakte krijojnë pasqyrën e interesimit të administratave të kaluara në Kosovë për mjedisin. Ligji i parë për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë është miratuar në vitin 2003 dhe obligon Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për përgatitjen e propozimit të Strategjisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm. Mjedisi sot paraqet një problem global dhe është një nga problemet e përbashkëta, si atyre të zhvilluara ashtu edhe atyre në zhvillim. Në aspektin ndërkombëtar, sot objektivat kyçe afatgjata për mbrojtjen e mjedisit janë:

a. Përmirësimi i cilësisë së jetës së njerëzve - është e qartë se pa një zhvillim ekonomik nuk mund të ketë as përkujdesje të duhur për mjedisin, sepse mbrojtja e mjedisit kushton.

b. Përdorimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore – duke u orientuar në resurset ekzistuese të cilat janë në dispozicion dhe ato resurse që mund të ripërtërihen.

c. Ndikimet e dëmshme në mjedis të eliminohen - duke u orientuar në veprimtaritë ekonomike që kanë ndikim sa më të vogël në mjedis.

Libri i Gjelbër – Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë

Qëllimi i këtij Libri të Gjelbër është që të përcaktojë politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Drejtoratit të Çështjeve Rurale (DÇR) për të ardhmen e parashikueshme, së bashku me kornizat e tyre ligjore dhe organizative.

Strategjia synon përmirësim të sektorit bujqësor dhe rural në Kosovë. Ministria do të luajë një rol lehtësues në themelimin e kornizës juridike dhe institucionale, në mënyrë që të promovojë tranzicionin nga ish ekonomia e centralizuar në ekonomi të planifikuar të tregut të lirë përbrenda rolit rregullator të Administratës Publike. Duke marrë parasysh faktin se 60 për qind e popullsisë jeton në zona rurale dhe në të shumtën me nivel të ulët të punësimit, strategjia përkon me të dyja, me zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, duke synuar aktivitetet gjeneruese të të ardhurave dhe shumëfishimin e të mbjellave drejt produkteve me vlerë të shtuar me mundësi të mbulimit të pjesës më të madhe të kërkesës së konsumit vendor. Gjithashtu, strategjia adreson mundësitë e tregut rajonal dhe të BE-së dhe zhvillimin e zinxhirit të ushqimit prej fermës deri të produkti final i ushqimit.

Strategjia e Energjisë e Kosovës[61]

Strategjia e Energjisë e Kosovës është hartuar në përputhshmëri me Ligjin e Energjisë dhe Programin e Qeverisë së Kosovës dhe përbën kornizën themelore në bazë të të cilës pas aprovimit në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës i përcaktohen objektivat dhe prioritetet zhvillimore sipas sektorëve të energjisë. Për të realizuar objektivat e Strategjisë duhet të përcaktohen edhe politikat, projektet, dhe masat e nevojshme Ligjore, organizative, strukturore, edukative dhe politike. Obligimi për të hartuar Strategjinë del edhe nga marrëveshjet ndërkombëtare mbi krijimin e tregut të përbashkët rajonal dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Strategjia për zhvillimin e energjisë së Kosovës ka të bëjë me menaxhimin efektiv të burimeve ekzistuese energjetike dhe me zhvillimin e burimeve të reja. Ajo përcakton politikat dhe masat për të shfrytëzuar burimet energjetike në dobi të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale, duke siguruar ruajtjen e mjedisit sipas standardeve të pranuara ndërkombëtare.

Strategjia e arsimit të lartë të Kosovës

Strategjia 10-vjeçare e Zhvillimit të Arsimit të Lartë në Kosovë është dokumenti që reflekton konsensusin në mes të faktorëve politikë, komunitetit akademik dhe shkencor, studentëve, shoqërisë civile, grupeve të interesuara për arsimin dhe publikut të gjerë për një vizion të artikuluar qartë se çfarë arsimi të lartë dëshirojmë dhe skicon rrugën për t'i përmbushur objektivat tona strategjike.

Dokumenti i strategjisë është një propozim për transformimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë sipas një modelimi, planifikimi, administrimi dhe menaxhimi më të efektshëm.

Realiteti i ri politik, shoqëror dhe ekonomik në Kosovë është pika fillestare e ndryshimeve dhe e zhvillimeve të reja në fushën e arsimit të lartë. Izolimi dhe zhvillimet politike të periudhës së kaluar kanë rezultuar me një ngecje në zhvillim, e cila vazhdon të jetë evidente edhe në periudhën e pasluftës, me gjithë praninë e disa zhvillimeve pozitive në këtë hapësirë.

Transformimi i arsimit të lartë ndodh kur vendi po kalon periudhën e tranzicionit. Agjenda kombëtare ka përcaktuar si pika kryesore: përcaktimin e statusit final politik të Kosovës, zhvillimin ekonomik të vendit, politikat sociale për të krijuar mundësi të barabarta dhe për të vendosur drejtësi për të gjitha grupet etnike dhe të pafavorizuara, si dhe integrimin e vendit në Bashkësinë Evropiane.

Sistemi i arsimit të lartë nevojitet të zhvillohet në mënyrë të tillë që t'i shërbejë rendit të ri shoqëror, t'i përgjigjet nevojave kombëtare dhe t'i përgjigjet realiteteve dhe mundësive të reja.

Me gjithë problemet e shumta dhe vullnetin për të bërë ndryshime, është bërë e qartë se nuk ka zgjidhje të lehta dhe të shpejta për zhvillimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë.

Prandaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë është përcaktuar që ndryshimeve t'u qaset në mënyrë sistematike, duke përfshirë në këtë proces të gjithë faktorët relevantë në shoqëri. Duke u nisur nga ky përcaktim janë kërkuar zgjidhje të cilat do të bëjnë të mundur që vendi ynë të bëhet pjesë e pandashme e hapësirës evropiane të arsimit të lartë e përcaktuar me objektivat e Procesit të Bolonjës. Në këtë kontekst, duke ndërtuar një sistem cilësor e fleksibilitet të arsimit të lartë që u përgjigjet kërkesave të shoqërisë, do të krijohen parakushte që arsimi i lartë të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Strategjia e Shëndetësisë

Misioni i Ministrisë së shëndetësisë është që të zhvillojë sistem efektiv dhe efikas të shërbimeve shëndetësore të kualitetit të lartë për të plotësuar nevojat e tërë popullsisë së Kosovës, pa marrë parasysh origjinën etnike, religjionin ose gjininë, dhe të përmirësojë gjendjen e përgjithshme shëndetësore përmes:

- Zhvillimit të politikës dhe këshillës profesionale për shërbimet shëndetësore, për të siguruar politika dhe këshilla më të mira profesionale dhe standarde më të mira të shërbimeve shëndetësore përmes aktiviteteve parandaluese;
- Menaxhimit strategjik duke siguruar kornizë menaxhuese për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore të qëndrueshme dhe të cilat përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe duke i përkrahur ato përmes zhvillimit të potencialit njerëzor, koordinimit të investimeve menaxhimit të kualitetit, dhe sistemeve informative; dhe
- Menaxhimit operativ duke siguruar ofrimin e shërbimeve publike kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar, sekondar, terciar në të gjitha institucionet shëndetësore.

Në kuadër të Planin Hapësinor të Kosovës, strategjia e zhvillimit hapësinor 2010-2020, Qeveria ka përcaktuar prioritetet strategjike vijuese:

- Kosova vend i hapur dhe i integruar në rajon dhe më gjerë;
- Sigurimi i qasjes në infrastrukturë për të gjithë
- Arsimim cilësor dhe i vazhdueshëm për të gjithë;
- Shërbime mjekësore me cilësi të lartë dhe të decentralizuara;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Ngritja e prodhimtarisë bujqësore dhe industriale;
- Zhvillim hapësinor i balancuar;
- Krijimi i vendeve të mjaftueshme të punës.

1.3.3. Strategjitë nga Plani Hapësinor i Kosovës

Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2020+ përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë, dhe me analizën e PHK-së më poshtë janë integruar edhe strategjitë regjionale në procesin e hartimit të PZHK-së.

1.3.3.1. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga PHK

Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2020+ është dokument qendror i planifikimit hapësinor, me qëllim të sigurimit të zhvillimit të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, të gjitha komunat duhet të i përmbahen zhvillimeve të planifikuara në *Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2020+,* i cili mbështet vizionin vijues:

"Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio- ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinje, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të gjithëve".[1]

Strategjia Zhvillimore Hapësinore e PHK-së, bazohet në:

- Zhvillimin e fuqishëm të rrjetit urban për zhvillim ekonomik;
- Zhvillimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore; dhe
- Zhvillimin e lidhjeve strategjike.

Plani Hapësinor i Kosovës- Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010– 2020+, përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë.

[1]MEA, Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2021+, Prishtinë, 2010



Harta 1 Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2020+

Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, Prishtinë 2010; Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka përcaktuar regjionin e Gjilanit, ku përfshihen edhe Komuna e Kaçanikut, Artanës, Vitisë, Kamenicës dhe Shtërpcës, si pjesë përbërëse e zonës "Urat e Kosovës- Hapësirë e Verdhë" që kanë këto përparësi dhe mundësi të zhvillimit:

- Tradita dhe trendi aktual i fuqishëm për tregti;
- Tradicionalisht hapësirë ku bashkë jetojnë, punojnë, me shkallë të lartë të tolerancës, grupe të ndryshme etnike;
- Hapësirë e cila në nuk është afektuar shumë nga pasojat e luftës së fundit, krahasuar me viset tjera në Kosovë;
- Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit ende jo të lartë;
- Trendi i ndërtimeve (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investivo privat;
- Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore;
- Tokë kualitative, e përshtatshme për zhvillim të bujqësisë, industrisë përpunuese e shërbyese dhe agrobiznes;
- Prezenca e resurseve natyrore, rekreative, shëruese, të ujërave termal, mundësi për zhvillim të turizmit malor, rekreativ e shërues.

Për këtë zonë është paraparë zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike. Sipas PHK, "Urat e Kosovës - Hapësirë e Verdhë" kanë këto veçori:

- Tokë bujqësore të kualitetit të lartë;
- Resurse të ujërave minerale;
- Hapësira të lira të gjelbra; dhe
- Aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore.

DRAFT



Harta 2 Urat e Kosovës – Hapësira e verdhë, Plani Hapësinor i Kosovës -Strategjia për Zhvillim Hapësinor 2010 – 2020+

Vizion parasheh një rol të rëndësishëm për Urat e Kosovës – Hapësira e verdhë, një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje, me synimet kryesore vijuese:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në qytete të mëdha të Gjilanit, Kamenicës, si dhe nëpër fshatra të vogla;
- Mbështetja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal;
- Konkurrencë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm;
- Zhvillimi i infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjia e informimit dhe komunikimit TIK) për të krijuar lidhje të përshtatshme ndër-urbane me pjesë të tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

1.3.4. Strategjitë që përfshihen ne Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharr

Plani hapësinor i Parkut Kombëtar „Sharri" përmban strategjinë me të cilën duhet të arrihen synimet dhe objektivat për parkun të përcaktuar gjatë një procesi planifikues në të cilin kanë qenë të përfshirë të gjithë përfaqësuesit relevant duke filluar nga sektorët e ndryshëm të Qeverisë së Kosovës e deri tek qytetari i rëndomtë. Në vijim janë paraqitur strategjitë e planifikuara për Parkun Kombëtar Sharr:

1. **Strategjia e zhvillimit dhe menaxhimit mjedisor:**
    - Funksionimi i një trupi të vetëm ligjor dhe përgjegjës për menaxhimin e parkut;
    - Hartimi i planit menaxhues për territorin e Parkut Kombëtar "Sharri";
    - Administrimi efikas dhe shtrirja e autoritetit të parkut;
    - Vetëdijesimi dhe informimi për parkun;
    - Mbrojtje e pyjeve nga faktorët natyror dhe njerëzor (prerjet, sëmundjet, zjarret, ortekët dhe erozionet);
    - Mbrojtje dhe ruajtje e biodiversitetit të parkut;
    - Mbrojtje, monitorim dhe shfrytëzim racional të resurseve të parkut;
    - Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK;
    - Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK;
    - Vetëdijesimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore;
    - Bashkëpunimi ndërinstitucional i nivelit qendror dhe lokal; dhe
    - Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore.

2. **Strategjia për zhvillimin ekonomik:**
   - Zhvillimet e planifikuara dhe kontroll të zhvillimeve për zonat brenda dhe përreth parkut;
   - Bashkëpunimi ndërkomunal për zhvillim rural në mes të komunave në të cilat shtrihet parku;
   - Mbështetje vendbanimeve përreth parkut për të ofruar ofertë turistike; ofrimin e eko - prodhimeve tradicionale dhe marketingun e tyre;
   - Vetëdijesim për ruajtjen e kulturës tradicionale të komuniteteve që jetojnë në zonat përreth parkut, veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e ekoturizimit;
   - Partneriteti publiko-privat për ofrimin e kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative;
   - Ngritja e objekteve përcjellëse, kontrolluese dhe afariste në funksion të parkut;
   - Përfitime nga shfrytëzimi ekologjik i Parkut;
   - Plotësimi i plan-programeve arsimore për industrinë e turizmit;
   - Propagandimi i vlerave natyrore, peizazhore e turistike të parkut;
   - Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat;
   - Bashkëpunimi për PK "Sharri" në mes të Kosovës dhe shteteve fqinje si dhe me shtetet në rajon e më gjerë;
   - Konkurrimi për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr;
3. **Strategjia për zhvillimin e infrastrukturës fizike:**
   - Qasje e mirë përmes rrugëve dhe shtigjeve në të gjitha zonat e parkut që janë me interes të vizitohen;
   - Sigurimi i transportit publik dhe vendparkimeve të nevojshme;
   - Sigurimi i transportit të skiatorëve deri tek pikat nga të cilat e fillojnë lëshimin;
   - Sigurimi i furnizimit të rregullt të parkut kombëtar dhe të vendbanimeve rreth tij me energji elektrike;
   - Zhvillimi i sistemit publik të ujësjellësit dhe kanalizimit në park dhe në vendbanimet rreth tij;
   - Zhvillimi i postës dhe telekomunikacionit në parkun kombëtar dhe në vendbanimet rreth tij;
   - Menaxhimi efikas i mbeturinave;

1.3.5. Strategjitë prej planeve të mëparshme komunale

1.3.5.1. Strategjitë prej PZHK

Në këtë rast, plan komunal i mëparshëm i nivelit të njëjtë është Plani Komunal Zhvillimor (PZHK). Komuna e Shtërpcës ka miratuar PZHK- në e parë në vitin 2012 me periudhë kohore 2012- 2022+, në përputhshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor.

Vizioni i PZHK 2012- 2022+ mbështetej në mundësimin e zhvillimit të shpejtë dhe valorizimin e burimeve të përbëra nga zonat rezidenciale, industriale, zonat rekreative turistike dhe të gjitha rrjedhat duhet të projektohen dhe ndërtohen në një mënyrë që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe kombin - tani dhe në të ardhmen. Është e nevojshme për t'u siguruar që ngjarjet e tilla të mos bien në konflikt (me efekte negative) me interesat e tjera sociale, të tilla si ambienti, shëndeti dhe siguria e popullatës. Gjatë planifikimit të rrjedhave të reja duhet pasur kujdes për rrjedhat e mëparshme.

Vizioni i PZHK-së së mëparshme është:

"Komuna e Shtërpcës në rolin e një lideri rajonal me turizëm të zhvilluar, me të gjitha pasuritë natyrore, bujqësi të zhvilluar dhe me tendenca të traditës dhe rrjedhave moderne, me cilësi dhe mjedis të qëndrueshëm për të gjitha komunitetet."

Nga aspekti i pozicionimit hapësinor, PZHK-ja përcakton konceptin vijues të zhvillimit hapësinor përmes zhvillimit policentrik hapësinor me tri nën-qendra Sevca, Drajkoci dhe Brodi, sigurimin e kushteve për zhvillimin e zgjidhjes në të ardhmen në përputhje me konceptin e vendbanimeve kompakte, konceptin e zgjeruar, përmbajtjen, qëllimin dhe për të rritur cilësinë e infrastrukturës së arsimit në të gjitha nivelet, në përputhje me konceptin e zhvillimit policentrik të tri nën-qendrave-, sigurimi i objekteve shëndetësore në vendbanimet në bazë të funksionit të tyre, dhe hierarkinë, duke siguruar kushtet dhe lehtësirat për përdorimin, ruajtjen vazhdueshme të qëndrueshme të trashëgimisë kulturore, sigurimin e kushteve dhe përmbajtje të administratës efektive dhe institucioneve transparente publike, ofrimin e objekteve sportive dhe rekreative në vendbanimet sipas funksionit të tyre dhe hierarkisë, sigurimin e kushteve (mjeteve) për jetën e të rinjve, të papunësisë dhe reduktimin e varfërisë, sigurimin e qendrave komunitare brenda qendrave lokale, qendrave për të moshuarit, jetimët dhe të pastrehët dhe qasje për personat me aftësi të kufizuara, duke synuar:

1. Zhvillimin e ardhshëm të Shtërpcës, në përputhje me konceptin e zhvillimit policentrik hapësinor;

2. Zhvillimi i ardhshëm urban të jetë në përputhje me konceptin e vendbanimeve kompakte;

Sidoqoftë, prioritet strategjike të përcaktuara në PZHK 2012- 2022+ janë marrë për bazë në të gjitha fazat e hartimit të kësaj PZHK-je. Prioritete strategjike të cilat janë paraparë në PZHK 2012- 2022+ nuk janë realizuar dhe do të merren parasysh gjatë hartimit të PZHK 2025- 2033 janë:

Demografia dhe çështjet sociale

- Krijimi i kushteve për arsimin fillor dhe të mesëm varësisht nga konceptet e nën qendrave dhe standardeve evropiane;
- Krijimi i kushteve për arsimim të lartë;
- Krijimi i kushteve për aktivitete kulturore dhe sportive, posaçërisht shfrytëzimi i vlerave kulturore arkitektonike dhe atyre arkeologjike.

Zhvillimi ekonomik

- Zhvillimi i planifikuar i zonës industriale dhe zona për zhvillimin e industrisë;
- Zhvillimi hapësirave aktive rurale dhe i zonave për zhvillimin bujqësor;
- Zhvillimi i zonave rekreative dhe turistike në malin Sharr;
- Zhvillimi i turizmit rural;
- Mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve natyrore;
- Qasje të reja në korridoret rrugore, plotësimi dhe forcimi i linjave ekzistuese.

Rrethina dhe shfrytëzimi i tokave (planifikimi dhe menaxhimi i vendbanimeve)

- Punimi i planeve rregullative i të qytetit dhe vendbanimeve;
- Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc dhe degëve të tij;
- Mbrojtja e tokave bujqësore të cilat do të jenë të definuara me këtë plan;
- Mbrojtja e resurseve.

Infrastruktura

- Ndërtimi i infrastrukturës për akumulim dhe transportimi i ujit për pije;
- Infrastruktura e transportit për trajtim të përkohshëm, po ashtu edhe për trajtim të përhershëm të ujërave të zeza;
- Ndërtimi i infrastrukturës për energji alternative;
- Ndërtimi i infrastrukturës për deponi të përkohshme dhe të përhershme;
- Ndërtimi i rrjetit të ri rrugor dhe përmirësimi i rrjetit të tashëm rrugor me infrastrukturën përcjellëse në drejtim të Maqedonisë dhe Serbisë;
- Përkrahja me infrastrukturën teknike të zhvillimit policentrik dhe lehtësimi në qasjen ndaj nën-qendrave;
- Ndërtimi i infrastrukturës e cila do të ofrojë siguri dhe rregullimi i komunikacionit urban dhe ndër-urban;
- Krijimi dhe përmirësimi i kualitetit të sipërfaqeve publike në pjesët rurale dhe urbane të komunës (varrezat, stacioni i autobusëve , vendeve për parkingje, hapësirave të gjelbra, rehabilitimi i hapësirave tregtare).
- Përmirësimi dhe rindërtimi i infrastrukturës ekzistuese energjetike;
- Lidhja e re e rrjetit optik me infrastrukturën përcjellëse në territorin e Komunës së Shtërpcës.

1.3.5.2. Strategjitë prej PZHU

Paralelisht me PZHK- në, Komuna e Shtërpcës ka hartuar dhe miratuar dhe Planin Zhvillimor Urban (PZHU). Në aspektin e përcaktimeve hapësinore, PZHK dhe PZHU nuk dallojnë, përveç se PZHU është hartuar vetëm për pjesën urbane.

Bazuar edhe në vizionin e Planit Komunal Hapësinor të Shtërpcës, i cili rajonin në të ardhmen e sheh si: "Komuna e Shtërpcës lider rajonal me turizmin e zhvilluar dhe me të gjitha pasuritë natyrore, me bujqësi të zhvilluar të bazuar në traditë dhe rrjedhat moderne, mjedis cilësor dhe stabil për të gjitha bashkësi", PZhU ka përcaktuar vizionin vijues për zonën urbane të Shtërpcës:

"Qyteti i Shtërpcës qytet turistik me zhvillim kompakt do të paraqes urën lidhëse të Komunës me rajonin, me infrastrukturë të integruara, me funksione të fuqishme dhe përmbajtje, atraktiv për jetë dhe punë në të, si për qytetarët, ashtu edhe për vizitorët, me ekonomi të qëndrueshme, atraktiv për investime duke përmbushur kritere për mbrojtjen e mjedisit."

PZHU, përveç që integron konceptin e gjerë zhvillimor dhe prioritetet strategjike të PZHK-së, përcakton edhe prioritete strategjike, si:

Demografia dhe çështjet sociale

- Krijimi i kushteve për arsim fillor dhe të mesëm, varësisht prej standardeve evropiane;
- Sigurimi i kushteve për arsim të lartë;
- Krijimi i kushteve për aktivitetet kulturore dhe sportive, e veçanërisht shfrytëzimi i vlerave kulturore, arkitektonike dhe arkeologjike.

Zhvillimi ekonomik

- Zhvillimi i planifikuar i zonave industriale: „Taraia“ dhe „Breg“;
- Zhvillimi i zonave turistike dhe rekreative:„Livad-Livadhi“ dhe „Obe Reke-Të dy lumenj“;
- Investimi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- Qasja e re për zonën urbane të korridoreve të transportit, plotësimi dhe forcimi i lidhjeve ekzistuese.

Mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës

- Hartimi i planeve rregullative të qytetit
- Trajtimi i segmenteve më pak të zhvilluara të zonës urbane;
- Rregullimi i shtratit të lumit Milloshticë;
- Krijimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe mbrojtja e tyre.

Infrastruktura

- Ndërtimi i rrugës së re që lidh zonën urbane me qendrën e skijimit;
- Ndërtimi i anashkalimit të ri rreth zonës urbane;
- Vazhdimi i ndërtimit të rrugës e cila do ta lidh zonën urbane me kompleksin sportiv „Livad-Livadh“;
- Përmirësimi i rrjetit ekzistues rrugor në zonën urbane me infrastrukturë përcjellëse;
- Ndërtimi i infrastrukturës e cila do të ofrojë siguri dhe rregullimin e trafikut brenda zonës urbane;
- Krijimi dhe përmirësimi i cilësisë së sipërfaqeve publike (varrezave, stacionit të autobusëve, vendit për parkim etj.);
- Mbulimi i burimeve ekzistuese të pa-mbuluara;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën për banim kolektiv „Vakavska“ dhe kompleksin sportiv „Livad“;
- Ndërtimi i objektit për trajtim të vazhdueshëm të ujërave të zeza;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në zonën për banim kolektiv „Vakavska“ dhe kompleksin sportiv „Livad“;
- Ndërtimi i infrastrukturave për energjinë alternative, përmirësimi dhe avancimi i infrastrukturës ekzistuese energjetike;
- Lidhja e re e rrjetit optik me infrastrukturë përcjellëse;
- Restaurimi i sistemit hekurudhor.

1.3.5.3. Strategjitë rajonale ose strategjitë e komunave fqinje

Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë, dhe me analizën e PHK-së më poshtë janë integruar edhe strategjitë rajonale në procesin e hartimit të PZHK-së, kurse pasi janë marr parasysh të gjitha strategjitë sektoriale të nivelit kombëtar dhe lokal, të listuara në përmbledhjen më lartë, konsiderohet se të gjitha strategjitë e komunave fqinje janë integruar në procesin e hartimit të kësaj PZHK- je.

1.3.5.3.1. Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt

Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt ka përcaktuar strategjinë vijuese:

Vizioni

Ferizaj, vend i hapur, atraktiv, zhvillim dinamik dhe infrastrukturë moderne. Urë e komunikimeve ekonomike, tregtare dhe kulturore. Komunë integruese në mes kryeqytetesh. Portë për vargmalet, aty ku bifurkacioni fton për rekreacion. Vend ku promovohet potenciali investues i qytetarëve, ku jetohet denjësisht në mjedis të sigurt.



Harta 3 Koncepti zhvillimor i Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt

Prioritetet Strategjike

Zhvillimi ekonomik

- NVM-të e zhvilluara;
- Zhvillimi i zonave ekonomike;
- Zhvillimi i infrastrukturës së përgjithshme dhe specifike;
- Promovimi i investimeve PPP;
- Eksploatimi i pasurive nëntokësore;
- Ruajtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore;
- Zhvillimi i turizmit rekreacional dhe kulturor.

Infrastruktura teknike

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm;
- Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
- Montimi i ujëmatësve zonal për monitorim të humbjeve;
- Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit;
- Zgjerimi i rrjetit të drenazhës;
- Përmirësimi she zgjerimi i rrjetit ekzistues elektrik;
- Ndërtimi i rrjetit të ngrohjes qendrore termale;
- 100% mbulueshmëri me rrjet telekomunikues dhe përmirësimi i rrjetit kabllor;
- Përcaktimi i zonës për varrimin e shtazëve të ngordhura;
- Përcaktimi i zonës për deponinë për mbeturina të ngurta;
- Përcaktimi i zonës për qendrën për trajtimin e mbeturinave;

DRAFT

- Përcaktimi i zonës për deponimin e mbeturinave të ngurta.

Transporti dhe transporti publik

- Hapja e rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese;
- Krijimi i shtigjeve për çiklistë, këmbësorë dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Eliminimi i fatkeqësive në hekurudhe;
- Zgjerimi i rrugëve nacionale drejtë kyçjeve të autoudhës së re;
- Lidhja e fshatrave përmes rrugëve alternative unazore;
- Fuqizimi i transportit hekurudhor dhe transportit publik dhe ndërurban.

Infrastruktura publike dhe sociale

- Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për shërbime publike shëndetësore
- Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për shërbime publike arsimore
- Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për aktivitete rekreative
- Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për aktivitete kulturoro-artistike
- Përmirësimi i shërbimeve administrative për qytetarët.

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

- Mbrojtja e mjedisit
- Mbrojtja e ujit
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit dhe të sistemit të ujërave atmosferike përgjatë lumenjve;
- Rregullimi i sistemit të kullimit (drenazhimit) të sipërfaqeve afër lumenjve;
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë përgjatë brigjeve të lumenjve;
- Hartimi i programeve për ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e vegjetacionit dhe për trajtimin e lumit, si një vlerë natyrore;
- Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave (riciklimin, selektimi i mbeturinave);
- Trajtimi i ujërave të zeza (ndërtimi i impianteve).
- Ndërgjegjësimi i banorëve për mbrojtjen e pyjeve dhe natyrës në përgjithësi;
- Bashkëpunimi ndër-komunal për mbrojtjen e pyjeve në zonat ndër-komunale;
- Ngritja e kapaciteteve në menaxhimin e sektorit të pyjeve.
- Mbrojtja nga rreziqet natyrore
- Masat mbrojtëse nga përmbytjet
- Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.
- Rregullimi i sistemit të drenazhimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.
- Përmirësimi i shtratit të lumit për të dy degët e bifurkacionit
- Ndërtimi i sistemit të drenazhimit në zonën hapësirave të lira për rekreacion te Gjimnazi.
- Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit në segmentin te "Ura e Dudit" dhe më poshtë.
- Pastrimi, rregullimi dhe mbulimi i pjesshëm i kanalit (në zonën e tretë shih hartën)
- Zbatimi i dokumentit të VRMF si komponentë e PZHU-se gjatë hartimit të planeve rregulluese.
- Ndarja e buxhetit vjetor për mirëmbajtjen e lumenjve
- Në rastin e ndërtimit të objektit në zonat afër lumenjve (jashtë zonës së mbrojtur), duhet të prezantohet projekti detal i drenazhimit të objektit dhe hapësirës ku ndërtohet objekti.
- Kufizimi i zhvillimeve në zonat të cilat historikisht janë të prira për përmbytje.
- Përmirësimin e këtyre zonave dhe destinimi i tyre për sipërfaqe të gjelbra.
- Shenjëzimi në teren i zonës së mbrojtur nga ndërtimet (50 m gjerësi)
- Masat mbrojtëse nga tërmetet
- Organizimi i fushatave periodike (punëtori, simulime) për vetëdijesimin e popullatës për rreziqet (tërmetet).

DRAFT

- Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kontrollimin e zhvillimeve në aspekt të ndërtimit rezistues nga forcat sizmike. Kontrolli duhet të verifikoi nëse objekti i cili do të ndërtohet përmban masat elementare për rezistencë ndaj tërmeteve.
- Hartimi i hartave mikro sizmike për 8 zonat urbane.
- Vlerësimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës kritike (shkollat, spitalet, urat, mbikalimet, pendat, etj.) dhe objekteve tjera me rendësi ndaj ndikimeve sizmike
- Hartimi i projekteve specifike për përforcimin e strukturave ekzistuese aty ku justifikohet arsyeshmëria ekonomike dhe racionale,
- Përforcimi i objekteve të infrastrukturës kritike me qëllim shfrytëzimin e tyre si qendra për evakuim në raste e fatkeqësive.
- Masat mbrojtëse nga zjarri
- Ndërtimi i rrjetit të hidrantëve publik në zonën urbane
- Shpërndarja e udhëzimeve si të sillen në ndërtesë në rast fatkeqësie/zjarri
- Trajnime/ushtrime për banorët si t'i shfrytëzojnë udhëzimet, si të përdorin aparatet për shuarjen e zjarrit.
- Fletushka për ngritjen e vetëdijes si të parandalohen zjarret në zonat rurale.
- Masat mbrojtëse nga erozioni
- Ngritja e vetëdijes së komunitetit
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara
- Ndërmarrja e masave të nevojshme gjatë ndërtimit të rrugëve në zonat rurale

Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

- Definimi i zonës së mbrojtur të fenomenit të bifurkacionit, kompletimi me shtigje për këmbësor, çiklistë dhe përmbajtjeve tjera;
- Marrja e masave në sigurimin e stabilitetit te objekti i arkivit të qytetit
- Marrja e masave në sigurimin e stabilitetit te objekti i Bibliotekës së Qytetit
- Shpallja si objekt i mbrojtur shtëpia e Gjon Sereqit
- Shpallja si objekte të mbrojtura të gjithë mullinjtë e vjetër të Ferizajt (Mulliri i Kukës)
- Studimi dhe hulumtimi dhe gërmimi i zonave arkeologjike në Varosh
- Studimi dhe hulumtimi dhe gërmimi i zonave arkeologjike në Nikadin
- Studimi dhe hulumtimi dhe gërmimi i zonave arkeologjike në Neredime të P. dhe Jezerc
- Incizimi i Valles së kaçakëve
- Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Varosh
- Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Komogllavë
- Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Greme dhe Gaçkë dhe vende të tjera
- Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për lokacionet e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Shfrytëzimit i tokës

- Përcaktimi i zonave të Banimit
- Përcaktimi i zonave Ekonomike
- Përcaktimi i zonave për infrastrukturës sociale
- Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore
- Përcaktimi i zonave për bujqësi intensive
- Përcaktimi i zonave për irrigacion të tokave
- Përcaktimi i zonave për ripyllëzim në Jezerc, Burrnik dhe Rahavicë, Mirash, Mirosalë, etj.
- Përcaktimi i zonave për meliorim
- Përcaktimi i zonave për turizëm malor në Jezerc, Pleshinë, Burrnik, Rahavicë
- Përcaktimi i zonave për turizëm të gjuetisë (në konsultim me Shoqatën e Gjuetarëve)
- Përcaktimi i zonave mbrojtëse për rrjetin elektrik të tensionit të lartë

DRAFT

- Përcaktimi i zonave me interes të veçantë që duhet të trajtohen me Plane Rregulluese të Hollësishme
- Miratimi i Hartës Zonale të Komunës
- Miratimi planeve Rregulluese të Hollësishme

Vendbanimet

- Zhvillimi kompakt hapësinor dhe mbrojtja e tokës bujqësore përmes përcaktimit të kufijve ndërtimor për vendbanimeve rurale
- Përcaktimi i zonave mbrojtëse për tension të lartë
- Përcaktimi i kufijve ndërtimor për vendbanime rurale
- Përcaktimi i Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanime urbane dhe rurale
- Trajtimi i vendbanimeve joformale

1.3.5.3.2. Plani Zhvillimor Komunal i Suharekës

Plani Zhvillimor Komunal i Suharekës ka përcaktuar strategjinë vijuese:

Vizioni

Suhareka, qendër e agrikulturës moderne kosovare, me zhvillim të qëndrueshëm socio ekonomik, kulturor e turistik, me efiçiencë në shfrytëzimin e energjisë, ku vlerësohet dhe promovohet potenciali investues i qytetarëve, mjedis ekologjik, qytetarë të shëndetshëm, rini të edukuar dhe arsimuar.



Harta 4 Koncepti zhvillimor i Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës

Prioritetet Strategjike

Zhvillimi ekonomik

- Prodhimi i energjisë së ripërtëritshme përmes mullinjve të erës në Budakovë dhe Duhël;
- Ndërtimi i hidrocentralit pranë pendës së liqenit të Dragaçinës;
- Ndërtimi i sistemit të ujitjes për toka bujqësore në Studenqan, Mushtish, Vraniq;
- Ndërtimi e infrastrukturës rrugore fushore për toka bujqësore të Klasit 1 – 4;
- Hapja e puseve dhe ndërtimi i rrjetit të furnizim me ujë në Agro – Zonë;
- Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për Zonën Ekonomike në Duhël.

Infrastruktura teknike

- Ndërtimi i akumulacionit ujor në Dragaqinë me kapacitet të vëllimit ujor prej 6.8 milion m3;
- Ngritja e kapacitetit të rezervuarit shtesë në Studenqan, Papaz, Reqan dhe Grejkoc;
- Transferimi i kyçjeve dhe zgjerimi i rrjetit të burimit Pusit të Atit – Shirokë;
- Ndërtimi i ujësjellësit në Bllacë, Duhël, Javor, Sopi, Bukosh, Reqan, Maqitevë, Papaz;
- Shtrirja dhe ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferike nga kanalizimi ujërave të zeza në zonën urbane dhe rurale;

Transporti dhe transporti publik

- Hartimi i Planit të Mobilitetit dhe zbatimi i tij;
- Rindërtimi dhe zgjerimi i stacionit të regjional autobusëve;
- Ndërtimi 16/24 vend ndaljeve për autobusë lokal komunal;
- Ndërtimi i rrugës Zonë Industriale – Studenqan-Neperbisht-Samadrexhë;
- Ndërtimi i rrugës transit në pjesën perëndimore Zonë Industriale–kyqja në Autoudhë (Reshtan);
- Ndërtimi i rrugës se re Mushtisht (L. Bahqevc) – Sallgrazhde – Greikoc);
- Ndërtimi i rrugës se re Mushtisht-Savrovë;
- Ndërtimi i rrugës se re përreth Autostradës Reshtan-Peqan-Sllapuzhan;
- Ndërtimi i rrugës se re Greikoc – Korishë;
- Ndërtimi i rrugës Peqan – Reshtan;

Infrastruktura publike dhe sociale

- Ndërtimi i katër çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve, tri në zonën urbane dhe një vendbanim rural;
- Ndërtimi i katër shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në vendbanime rurale;
- Ndërtimi i gjashtë sallave sportive, dy në zonë urbane dhe katër vendbanime rurale;
- Ndërtimi i qendrës së re kryesore të mjekësisë familjare në zonën urbane të Suharekës dhe shndërrimin e QKMF ekzistuese në QMF;
- Ndërtimi i dy QMF-ve, një në Bllacë dhe një në Vraniq;
- Ndërtimi i pesë AMF-ve, në vendbanime rurale;
- Ndërtimi i qendrës për punë sociale;
- Ndërtimi i banesave në bazë të Programit të veçantë të banimit për rreth 100 familje;
- Përfundimi i ndërtimit të shtëpisë së pleqve dhe personave pa përkujdesje;
- Ndërtimi i objektit të Ndërtesës Komunale;
- Ndërtimi i objektit të Zjarrfikësve;
- Ndërtimi i poligonit sportiv në Popolan;
- Ndërtimi i stadiumit të futbollit në Mushtisht;
- Ndërtimi i Palestrës sportive në Samadrexhë;
- Ndërtimi i Palestrës sportive në Suharekë;
- Ndërtimi/Rregullimi i qendrës kulturore "Ukë Bytyqi" Suharekë;
- Ndërtimi i varrezave të besimit mysliman në Sallagrazhdë.

Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

- Ndërtimi i shtratit të lumit në Sopijë;

DRAFT

- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Bukosh;
- Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Nëprebishtë dhe i kolektorëve për shkarkimin e ujërave të zeza deri te impiantit;
- Trajtimi i deponive ilegale.

Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

- Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për lokacionet e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Shfrytëzimit i tokës

- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës;
- Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale të Komunës;
- Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Rregullues të Hollësishëm "Zona Qendër";
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Ekonomike për rrugës regjionale Suharekë –Prizren;
- Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Ekonomike për rrugës regjionale Suharekë –Prizren;

Vendbanimet

- Zhvillimi kompakt hapësinor dhe mbrojtja e tokës bujqësore përmes përcaktimit të kufijve ndërtimor për vendbanimeve rurale;
- Përcaktimi i zonave mbrojtëse për tension të lartë;
- Përcaktimi i kufijve ndërtimor për vendbanime rurale;
- Përcaktimi i Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanime urbane dhe rurale;
- Trajtimi i vendbanimeve joformale.

1.3.5.3.3. Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit

Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit ka përcaktuar strategjinë vijuese:

Vizioni

Të zhvillohet Prizreni si një qendër e qëndrueshme kulturore në Kosovë dhe Ballkan, duke promovuar potencialin e tij sa i përket aseteve historike, resurset natyrore dhe ambientale, diversitet social dhe vitalitet ekonomik.

DRAFT



Harta 5 Koncepti zhvillimor i Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit

Prioritetet Strategjike

- Zhvillimi dhe ruajtja e resurseve natyrore dhe kulturore
- Përmirësimi i kushteve jetësore me zhvillimin e shërbimeve publike
- Promovimi i zhvillimit të balancuar dhe të organizuar urban
- Zhvillimi i rrjetit të fortë urban të zhvillimit ekonomik
- Zhvillimi i linjave strategjike transportuese dhe të infrastrukturës

1.3.6. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti i gjerë i planifikimit, siç janë planifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK), Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+ është dokument qendror i planifikimit hapësinor, me qëllim të sigurimit të zhvillimit të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, të gjitha komunat duhet t'i përmbahen zhvillimeve të planifikuara në *PHK, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+*, i cili mbështet në vizionin vijues:

"Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinje, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të gjithëve".[2]

Strategjia Zhvillimore Hapësinore e PHK-së bazohet në:

- Zhvillimin e fuqishëm të rrjetit urban për zhvillim ekonomik;

[2] MMPH, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+, Prishtinë, 2010

- Zhvillimin dhe ruajtjen e burimeve natyrore; dhe
- Zhvillimin e lidhjeve strategjike.

PHK përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë.



Harta 6 Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+

PHK, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+ ka përcaktuar Komunën e Shtërpcës (përfshihen dhe Komuna e Kaçanikut, Artanës, Vitisë, Kamenicës dhe Shtërpcës) si pjesë përbërëse e zonës "Urat e Kosovës- Hapësirë e Verdhë" që kanë këto përparësi dhe mundësi të zhvillimit:

- Tradita dhe trendi aktual i fuqishëm për tregti;
- Tradicionalisht hapësirë ku bashkëjetojnë, punojnë, me shkallë të lartë të tolerancës, grupe të ndryshme etnike;
- Hapësirë e cila në nuk është afektuar shumë nga pasojat e luftës së fundit, krahasuar me viset tjera në Kosovë;
- Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit ende jo të lartë;
- Trendi i ndërtimeve (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investiv privat;
- Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore;
- Tokë kualitative, e përshtatshme për zhvillim të bujqësisë, industrisë përpunuese e shërbyese dhe agrobiznes;
- Prezenca e resurseve natyrore, rekreative, shëruese, të ujërave termal, mundësi për zhvillim të turizmit malor, rekreativ e shërues.

Për këtë zonë është paraparë zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike. Sipas PHK, "Urat e Kosovës - Hapësirë e Verdhë" kanë këto veçori:

- Tokë bujqësore e kualitetit të lartë; Resurse të ujërave minerale; Hapësira të lira të gjelbra; dhe Aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore.



Harta 7 Urat e Kosovës – Hapësira e verdhë, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+

Vizioni i *PHK-së, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+* parasheh një rol të rëndësishëm për Urat e Kosovës – Hapësira e verdhë, një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje, me synimet kryesore vijuese:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në zona të mëdha të Shtërpcës, si dhe nëpër fshatra të vogla;
- Mbështetja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal;
- Konkurrencë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm;
- Zhvillimi i infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjia e informimit dhe komunikimit TIK) për të krijuar lidhje të përshtatshme ndër-urbane me pjesë të tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

Sa përket Komunës së Shtërpcës, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Zhvillim Hapësinor, 2010 – 2020+ ka identifikuar Zonat e Veçanta të Mbrojtura vijuese:

1. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Shtërpcë;
2. Kisha e Teodorit të Shenjtë, Biti e Poshtme, Shtërpcë;
3. Kisha e Nikollës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpcë;
4. Kisha e Vigjëreshës së Shenjtë, Gotovushë, Shtërpcë; dhe
5. Kisha e Shën Gjergjit, Biti e Epërme, Shtërpcë.

Ky plan po ashtu ka identifikuar edhe një qendër të skijimit – Brezovicën, e cila shfrytëzohet nga turistët vendorë dhe ata ndërkombëtarë që ndodhen në Kosovë.

1.4. INFORMATA PËR PROCESIN E PLANIFIKIMIT

1.4.1. Prezantimet publike

Me qëllim të gjithë përfshirjes së qytetarëve dhe hisedarëve tjerë në proces të planifikimit hapësinor, Komuna ka zhvilluar 6 diskutime publike, ku është prezantuar draft-PZHK-ja pas përfundimit të përgatitjes së secilës fazë.

Data	Aktiviteti	Numri i pjesëmarrësve
14.03.2019	Diskutim publik njoftues	19
17.09.2019	Diskutim publik i Profilit	14
05.11.2019	Diskutim publik i Vlerësimit	39
09.09.2020-18.10.2020	Diskutim publik i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	36
17.12.2021	Diskutim i Planit të Veprimit	17
14.07.2023	Diskutim i draftit final	15

1.4.2. Kërkesat e qytetarëve

Gjatë diskutimeve publike, qytetarët kanë parashtruar shumë pyetje në lidhje draft-PZHK-ën dhe janë pranuar dy kërkesa për rrugë, mirëpo duke marrë parasysh që lokacionet e propozuara shtrihen në Parkun Kombëtar "Sharr", qytetarët janë udhëzuar që të i drejtohen MMPHI-s, pasi që ky institucion është përgjegjës për planifikim të Zonave të Veçanta.

1.4.3. Përmbledhja jo-teknike e PZHK-ës

Në vijim është paraqitur përmbledhja e shkurtër jo-teknike e PZHK-ës:

1.4.3.1. Vizioni

Komuna e Shtërpcës në rolin e një lideri rajonal me turizëm të zhvilluar, me të gjitha pasuritë natyrore, bujqësi të zhvilluar dhe me tendenca të traditës dhe rrjedhave moderne, me cilësi dhe mjedis të qëndrueshëm për të gjitha komunitetet.

1.4.3.2. Qëllimet dhe objektivat

1. ZHVILLIMI EKONOMIK

Qëllimi 1: Zhvillimi i zonave industriale, ekonomike të biznesit, korridoreve zhvillimore ekonomike.

Objektiva 1.1:

Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonës ekonomike te Shtërpcës dhe Gotovushës.

Objektiva 1.2:

Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonave ekonomike në korridorin e rrugës rajonale.

Qëllimi 2: Modernizimi i bujqësisë dhe procesimi i produkteve bujqësore

Objektiva 2.1:

Menaxhimi adekuat i tokave bujqësore dhe pyjeve përmes përcaktimit të kufijve të zonave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2025.

Objektiva 2.2:

Zhvillimi I blegtorisë, pemëtarisë dhe perimekulturave në etapat 2026-2031.

Objektiva 2.3:

Ngritja e kapaciteteve të prodhuesve për kultivimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, në veçanti grave në bujqësi, 2026-2031

Objektiva 2.4:

Sigurimi I infrastrukturës për grumbullimin, ruajtjes dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore, 2026-2031

Qëllimi 3: Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shtërpcë

Objektiva 3.1:

2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Qëllimi 1: Administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve

Objektiva 1.1:

Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të ujësjellësit të fshatrave deri në vitin 2030.

Objektiva 1.2:

Përmirësimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit në qytet – zvogëlimi i humbjeve deri në 100 % deri në vitin 2032.

Objektiva 1.3:

Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të kanalizimit të fshatrave deri në vitin 2028.

Objektiva 1.4:

DRAFT

Shkyçjet e lidhjeve ilegale në ujësjellës deri në vitin 2025.

Objektiva 1.5:

Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza 2026.

Objektiva 1.6:

Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të rrjetit ekzistues atmosferik në qytezë ndarja e ujërave të zeza dhe atmosferike deri në vitin 2028.

Qëllimi 2: Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne

Objektiva 2.1:

Shtrirja nëntokësore e rrjetit elektrik dhe të TI –së në 70% të zonave urbane deri në vitin 2025.

Objektiva 2.2:

Ndërrimi i pajisjeve të vjetra elektro-energjetike deri në vitin 2026.

Objektiva 2.3:

Përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe furnizimi cilësor me energji elektrike në gjithë territorin e komunës me theks të veçantë zonën turistike.

Objektiva 2.4:

Përmirësimi dhe rritja e efiçencës energjetike në objektet publike 90% deri në vitin 2025 dhe 70% deri në vitin 2030 ndërsa për objektet private 60% deri në vitin 2025.

Objektiva 2.5:

Hulumtimi i mundësive për ndërtimin e sistemit të ngrohjes të bazuar në energjinë solare deri në vitin 2026.

Qëllimi 3: Ofrimi i shërbimeve moderne të telekomunikimit

Objektiva 3.1:

Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit 4G dhe 5G LTE deri në vitin 2025.

Objektiva 3.2:

Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore deri në vitin 2025.

Objektiva 3.3:

Zhvillimi i një infrastrukturë për një rrejt të përbashkët për shërbime të telekomunikimit deri në vitin 2025.

Qëllimi 4: Krijimi i një mjedisi të pastër pa mbeturina

Objektiva 4.1:

Përfshirja e fshatrave/vendbanimeve të mbetura në sistemin e menaxhimit të mbeturinave deri në fund të 2025 (mbulimi 100% me shërbim).

Objektiva 4.2:

Ndërtimi i stacionit transfer të mbeturinave deri në 2025.

Objektiva 4.3:

Eliminimi i të gjitha deponive të egra 2025.

Objektiva 4.4:

Përcaktimi dhe funksionalizimi i hapësirës për menaxhimin e mbetjeve nga ndërtim/demolimi dhe atyre shtazore deri më 2026.

Objektiva 4.5:

Ndërtimi i deponisë dhe impiantit për dekompostim të mbeturinave të biomasës deri në vitin 2030.

3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

Qëllimi 1: Zhvillimi I infrastrukturës dhe transportit të qëndrueshëm

Objektiva 1.1:

Modernizimi i rrugëve ndërlidhëse deri në vitin 2025.

Objektiva 1.2:

Ndërtimi i rrugëve të qytetit për zonat e reja të banimit sipas PRRH-ve të cilat do të hartohen deri në vitin 2027.

Objektiva 1.3:

Optimalizimi i rrugëve unazore (tranzitore) ekzistuese deri në vitin 2025

Qëllimi 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe sigurimi i transportit publik

Objektiva 2.1:

Përmirësimi i transportit publik urbano- rural dhe sigurimi i transportit urban dhe deri në zonat turistike Brezovicë dhe qendrën e re te skijimit deri në vitin 2026.

Objektiva 2.2:

Zhvillimi dhe zgjerimi i rrjetit të transportit të rregullt publik për të gjitha vendbanimet me mbi 450 banorë deri në vitin 2025.

Objektiva 2.3:

Ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe sigurimi lokacioneve për venndalesa të autobusëve deri në vitin 2026.

Qëllimi 3: Promovimi i lëvizshmërisë rekreative

Objektiva 3.1:

Në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me nivelin qendror ndërtimi i teleferikut Përvall - Brezovicë deri në vitin 2025.

Objektiva 3.2:

Ndërlidhja e zonave turistike përmes shtigjeve për çiklistë dhe kalërim gjatë verës deri në vitin 2027.

4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Qëllimi 1: Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Objektiva 1.1:

Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja për shërbim social deri në vitin 2025.

Objektiva 1.2:

Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për 30% deri ne vitin 2026.

Objektiva 1.3:

Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja shëndetësore deri në vitin 2026.

Objektiva 1.4:

Përmbushja e kërkesave për banim social (në vazhdimësi)

Qëllimi 2: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor

Objektiva 2.1:

Ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve për disa vendbanimet rurale me mbi 2000 banorë deri në vitin 2025.

Qëllimi 3: Sigurimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve

Objektiva 3.1:

Rinovimi i ndërtesës komunale deri në vitin 2026.

Objektiva 3.2:

Ndërtimi i zyrave të gjendjes civile në nënqendrat e planifikuara deri në vitin 2025.

Qëllimi 4: Sigurimi i infrastrukturës sociale adekuate dhe mirëmbajtja e saj

Objektiva 4.2:

Krijimi i kushteve dhe sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës (në vazhdimësi).

Objektiva 4.3:

Përmirësimi i hapësirave ekzistuese dhe sigurimi i hapësirave të reja për sport dhe rekreacion nëpër shkolla deri në vitin 2026.

Objektiva 4.4:

Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës (në vazhdimësi).

Objektiva 4.5:

Sigurimi i hapësirës për zgjerim të varrezave sipas asaj që është paraparë në hartë deri në vitin 2025 dhe planifikimi/ lejimi i hapësirave për objekte të reja të religjionit (në vazhdimësi).

5. MBROJTJA E MJEDISIT DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

DRAFT

Qëllimi 1: Parandalimi i ndotjes së ujërave

Objektiva 1.1:

Ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferik në qytet në të gjitha vendbanimet me mbi 1500 banorë deri në vitin 2029.

Objektiva 1.2:

Hapja dhe rregullimin e shtretërve të Moravës, Mirushës, Stanishorkës deri në vitin 2028.

Objektiva 1.3:

Eliminimi i deponivë ilegale deri në vitin 2026.

Qëllimi 2: Parandalimi i ndotjes së ajrit

Objektiva 2.1:

Planifikimi i hapësirave të gjelbra të reja në qytet deri në vitin 2025 dhe zhvillimi i hapësirave të gjelbra (në vazhdimësi).

Objektiva 2.2:

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit të Cilësisë së Ajrit deri në vitin 2025.

Objektiva 2.3:

Kufizimi i emetimit të substancave ajrore të dëmshme ose toksike nga veprimtaritë industriale deri në vitin 2027.

Qëllimi 3: Parandalimi i rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera

Objektiva 3.1:

Ndërtimin e pendave për mbrojtje nga erozioni në shtretërit e përroskave dhe përrenjve dhe përmirësimin e argjinaturave mbrojtëse deri në vitin 2028

Objektiva 3.2:

Ripyllëzim të 140ha për sipërfaqet pyjore përgjatë zonave erozive dhe shpatijet e diellosura, mbjellja e drunjtëve shtatlartë gjethembajtëse përgjatë perimetrit të zonave industriale deri në vitin 2026.

Objektiva 3.3:

Pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe të kanalizimit atmosferik ekzistues deri në vitin 2026.

Objektiva 3.4:

Sigurim i qasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri të zonë banimi dhe vendosja e hidrantëve në qytet dhe vendbanime në komunë deri në vitin 2030.

6. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

Qëllimi 1: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore

Objektiva 1.1:

Restaurimi i tërësishëm i objekteve të trashëgimisë 2026 Objektiva 1.2:

Ndërtimi i një objektit të Muzeut të Qytetit deri në vitin 2025

Objektiva 1.5:

Hartimi i Planit 25-vjeçar të Konservimit të Trashëgimisë Arkitekturale deri në vitin 2026

Qëllimi 2: Zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore

Objektiva 2.1:

Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave turistik në trekëndëshin në Brezovicë.

Objektiva 2.2:

Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave për turizëm rural duke shfrytëzuar potencialet si kombinim i tokave pjellore rreth Lepencit dhe pjesëve kodrinore malore/ kombinim edhe me produktet blegtorale dhe përmbajtjet tjera deri në vitin 2025.

Objektiva 2.3:

Projekte për kampanja informuese deri në vitin 2025.

7. VENDBANIMET

Qëllimi 1: Zhvillimi i vendbanimeve kompakte, të balancuara dhe të qëndrueshme

Objektiva 1.1:

Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar të qytetit jashtë kufirit urban deri në vitin 2025.

Objektiva 1.2:

Promovimi i shfrytëzimeve në pajtueshmëri (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të rejat për të plotësuar nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2029.

Objektivi 1.3:

Promovimi i përdorimeve të përputhshme (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të reja për të përmbushur nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2025.

Qëllimi 2: Mbrojtja e karakterit rural hapësinor dhe planifikim për rritje të ekuilibruar të vendbanimeve rurale

Objektiva 2.1:

Promovimi i modelit kompakt të zhvillimit rural duke përcaktuar zonat për zgjerim për të gjithë vendbanimet rurale deri në vitin 2025.

Objektiva 2.2:

Parandalimi i fragmentimit të tokave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2025.

Objektiva 2.3:

Zvogëlimi i pabarazisë së shpërndarjes së infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndërmjet Qytetit dhe vendbanimeve rurale, si dhe në mes të vendbanimeve rurale deri në vitin 2026.

Qëllimi 3: Mbështetja për trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje

Objektiva 3.1:

Mbështetje procesit të legalizimi i të gjitha ndërtimeve pa leje dhe integrimi i tyre në zona të urbanizuara, në vazhdimësi, deri në 2029.

8. BANIMI

Qëllimi 1: Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e banorëve të tanishëm dhe të ardhshëm

Objektiva 1.1:

Rritja e fondit banesor dhe dendësimi i ndërtimit në zonën urbane dhe zonën rurale, deri në vitin 2029.

Objektiva 1.2:

Sigurimi i banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës, në vazhdimësi.

9. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Qëllimi 1: Shfrytëzim efikas i tokës dhe resurseve

Objektiva 1.1:

Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të Tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe institucioneve deri ne vitin 2032.

Objektiva 1.2:

Zhvillimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të Tokës deri në vitin 2030.

Qëllimi 2: Shfrytëzimi për banim të qëndrueshëm në komunën e Shtërpces

Objektiva 2.1:

Promovimi i ndërtesave efiçiente në sipërfaqet për banim, me shfrytëzim të energjisë së ripërtritshme deri në vitin 2030.

Objektiva 2.2:

Zhvillimi i banimit përmes ndërtesave të mençura deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.

Objektiva 2.3:

Zhvillimi i sipërfaqeve të infrastrukturës publike dhe sociale deri në vitn 2032.

Objektiva 2.4:

DRAFT

Zhvillimi i sipërfaqeve të planifikuara për infrastrukturë në shërbim të arsimit, shëndetësisë, institucioneve të mirëqenies sociale, institucione kulturore, administratë, institucione kulturore, hapësira sportive, ndërtesa fetare dhe varreza deri në vitin 2032 dhe në vazhdimësi.

Qëllimi 3: Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve të Tokës bujqësore

Objektiva 3.1:

Ruajtja dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore në vendbanimet si : Brod, Drajkoc, Gotovushe dhe Bitije e Poshtme, deri në vitin 2030.

Objektiva 3.2:

Promovimi dhe zhvillimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore për bujqësi dhe blegtori në fshatrat me lartësi të madhe mbidetare deri në vitin 2030.

DRAFT

2. PROFILI KOMUNAL

Profili i gjendjes në komunë është ndër pjesët më të rëndësishme të PZHK-së së Shtërpcës, ku identifikohen, mblidhen dhe strukturohen informatat bazë mbi fushat tematike.

"Profili Komunal" ka përmbledhur dhe shqyrtuar të dhënat lidhur me: Historinë e zhvillimit të komunës së Shtërpcës, gjendjen ekzistuese të komunës, si dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës.

Mbledhja e të dhënave për Profilin Komunal është bërë në pajtueshmëri me Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal. Gjatë përgatitjes së profilit është hasur në vështirësi për shkak të mungesës, mos koordinimit dhe burimeve të të dhënave, por pas një angazhimi shtesë janë siguruar shumica e të dhënave.

2.1. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS

2.1.1. Historia e zhvillimit

Hulumtimet paraprake arkeologjike tregojnë se në shekullin e VI të erës sonë, në rrugën që çon përmes luginës së Sirinikut, janë ndërtuar dy ose tri fortifikata të qytetit, "Zidovnica" mbi fshatin Gotovushë dhe "Gradishte" në tatëpjetën me emër të njëjtë në Brezovicë. Supozohet se lugina ishte e banuar edhe më herët, që nga kohët e lashta, ku emri i tanishëm i fshatrave Biti (e Epërme dhe e Poshtme) i referohet mendimit se në mes të banorëve të lashtë ishin edhe pjesëtarët e fisit trak Bitia.

Si luginë e veçantë, ky territor për herë të parë përmendet në epokën e shtetit mesjetar serb. Përgjatë maleve të shumta në ato kohë kanë ekzistuar rrugët e karvanëve mes Pollogut (Tetovë) në jug dhe në veri të Kosovës. Të gjitha vendbanimet e fshatrave (me përjashtim të Brezovicës) janë shumë të vjetra, ku secili fshat kishte të paktën një kishë ose një pronë të kishës, shumë prej të cilave janë ruajtur deri më sot. Një numër i madh i shënimeve, mbishkrimeve (në kisha dhe varreza), toponimeve, si dhe dëshmi gojore dhe të shkruara dëshmojnë për vazhdueshmërinë e jetës në territorin e qarkut në këtë kohë dhe ekzistencës së përhershme të vendbanimeve në lokacionet e njëjta dhe atë shpesh me të njëjtin emër sikurse sot.

Gjatë periudhës së sundimit turk, dhe më vonë, deri në fund të shekullit të XIX (nga viti 1880 deri 1890) vendbanimet dhe jeta ekonomike e luginës në përgjithësi kanë stagnuar. Orientimi themelor në blegtori dhe bujqësi nuk kishte një vlerë të rëndësishme të tregut. Gjatë kësaj periudhe, vetëm Shtërpca shndërrohet në një qendër lokale tregtare dhe industriale, derisa vendbanimet tjera kanë ruajtur karakterin rural.

Eksploatimi i organizuar i kromit në fillim të këtij shekulli, ka pasur efektin e transformimit të Brezovicës nga vendbanimi i blegtorisë sezonale në një vendbanim të minatorëve. Shfaqja e kolonive të minierave ka ndryshuar pamjen e qarkut dhe ka pas ndikim në zhvillimin e vendbanimeve tjera të luginës, kryesisht Vërbeshticës dhe Shtërpcës. Brezovica përfundimisht është themeluar si një vendbanim i specializuar i minierave (me pajisje adekuate dhe objekteve mbështetëse) në kohën e pushtimit gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore. Me mbylljen e punëve në miniera në vitet e gjashtëdhjeta të këtij shekulli vjen deri te një ngecje e caktuar në ekonominë e këtij rajoni, e cila është reflektuar në zhvillimin e vendbanimeve.

Zhvillimi i turizmit filloi në vitet e pesëdhjetat dhe vrullin e fiton me ndërtimin e objekteve të rëndësishme hoteliere në vitet e tetëdhjeta, që çon në një transformim të Brezovicës në një qendër turistike dhe rekreative me një zonë të vikendeve. Ky proces inkurajoi zhvillimin e vendbanimeve të shumta të qarkut, dhe së pari Shtërpcës si një qendër lokale.

Një rëndësi të veçantë, siç u përmend më parë, në zhvillimin e vendbanimit qendror të luginës (Shtërpcës) kishin ndryshimet administrative – territoriale në periudhën e pasluftës. Zhvendosja e qeverisë komunale në Ferizaj ka ngadalësuar ndjeshëm zhvillimin si të Shtërpcës, po ashtu edhe të vendbanimeve të tjera në luginë.

Prandaj, janë konstatuar fazat e zhvillimi të rrjetit të vendbanimit si në vijim:

- Deri te çlirimi nga turqit – faza e theksuar e dominimit të veprimtarive bujqësore në strukturën e ekonomisë pa qendra të rëndësishme;
- Zhvillimi i xehetarisë – faza e transformimit të vendbanimeve (veçanërisht Brezovica dhe Vërbeshtica) me formimin e qendrës lokale turistike (Shtërpca);
- Faza e zhvillimit intensiv të turizmit që përcillet me formimin e rrjetit të vendbanimeve.

2.1.2. Pozita gjeografike, karakteristikat natyrore

Komuna e Shtërpcës shtrihet në pjesën juglindore të Kosovës me rreth 72 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me komunën e Prizrenit, Therandës, Ferizajt, Kaçanikut dhe me Maqedoninë. Në territorin prej 247,36 km² shtrihen 16 vendbanime në të dyja anët e Lepencit, në lartësi mbidetare prej 600 deri 1.200 metra.

Kosova, e bashkë me të edhe Komuna e Shtërpcës, zënë pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik, shtrihet në udhëkryqin e rrugëve Lindje – Perëndim mbi detin e Zi dhe Adriatik, dhe në drejtimin Lindje – Jug mbi Evropën qendrore dhe detin Egje.



*Harta 8 Pozita gjeografike e komunës së Shtërpcës në hartën e Republikës së Kosovës**

2.1.3. Veçoritë mjedisore

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Shtërpcës është 24.762,2 ha. Në të, sipas të dhënave të grumbulluara nga ana e grupit punues, momentalisht jetojnë rreth 10,771 banor në 16 vendbanime.

Shfrytëzimi i hapësirës për vendbanime të përhershme të banorëve dhe për zhvillimin e veprimtarive dytësore dhe terciare (përveç, turizmit pjesërisht) realizohen, në pjesën më të madhe, brenda këtyre 16 vendbanimeve (duke përfshire vendbanimin/fshatin turistik Brezovica).

Viset malore janë tradicionalisht, para së gjithash, shfrytëzuar për prodhimtari blegtorale, dhe në masë më të vogël për prodhimtari bujqësore. Ky konstatim vlen edhe për komunën e Shtërpcës, duke pasur parasysh atë se territori i saj gjendet në lartësi prej rreth 640 deri 2.597 m, dhe që në të ka kullota dhe livadhe, sipërfaqe të frutave dhe kulturave, si dhe tokës së punueshme.

Në bazë të këtyre informatave mund të vihet në përfundim së në komunën e Shtërpcës ekzistojnë kushte të favorshme natyre për zhvillimin e bujqësisë. Deri në një masë të caktuar ky përfundim është logjik, dhe atë vetëm kur është fjala

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

për kushtet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore. Këtu po i referohem prodhimit me pjesëmarrjen, para së gjithash, të familjeve bujqësore rurale që merren me këto aktivitete me qëllim të përmbushjes së nevojave të veta, dhe eventualisht, me qëllim të prodhimit të tepricave bujqësore të destinuara për tregun lokal. Për këtë mënyrë të prodhimtarisë bujqësore, banorët kanë shfrytëzuar këto sipërfaqe:

- Për prodhim blegtoral janë shfrytëzuar 10.985,2 ha (45,8 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 44,4 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e kulturave janë shfrytëzuar 2.464,0 ha (10,3 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 10,0 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e frutave/pemëtari (dhe vreshta) janë shfrytëzuar203,5 ha (0,8 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht diçka më pakë se 0,8 % nga totali i sipërfaqes së komunës).

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është 13.652,7 ha, që paraqet 55,15% nga sipërfaqja e përgjithshme.



Grafiku 1 Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Shtërpcës

Kur është fjala për sipërfaqet e pyjeve, prodhimin e masës drunore, në aspektin biologjik, realizohet në sipërfaqe totale prej 10.574,4 ha, apo në 42,7 % të territorit të komunës së Shtërpcës. Nga ajo pjesa e vogël e sipërfaqeve pyjore është private (842,1 ha apo 7,96 %), ndërsa pjesa më e madhe është nën pronësi publike (9.732,3 ha, ose 92,04 %).



Grafiku 2 Sipërfaqja e pyjeve në komunën e Shtërpcës

Sipërfaqet e pyjeve pothuajse tërësisht në viset që nuk janë të përshtatshme për prodhimtari bimore dhe blegtorale, që nënkupton anët e luginave të pjerrëta, zakonisht të ekspozuara në veri dhe në bazën gjeologjike më pak të përshtatshme për formimin e tokës më kualitative. Pyjet shtrihen në lartësi prej 640 m në brigjet e Lepencit deri në rreth prej 2.200 m në Oshlak. Megjithatë, shumica e pyjeve të vendosura në lartësi prej 1.000 – 1.700 m në shpatat e Sharrit, Oshlakut dhe malit të Jezercit. Terreni mbi 2.000 (2.000 m) është pa mbulesë të pyjeve. Kohëve të fundit (në tridhjetë vitet e fundit) pyjet gradualisht janë duke u zgjeruar edhe në viset të cilat janë të përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore dhe atë se në rrethin e komunës së Shtërpcës këto sipërfaqe më pakë përdoren për bujqësi.

Sepse, gjithnjë e me pakë ka popullsi bujqësore në komunë dhe gjithnjë e më pakë ka kafshë (sidomos dele) në kullota që ndikon " pozitivisht" në "lirimin" e hapësirës për zgjerimin natyror të pyjeve.
Sa i përket në përgjithësi, e pikë së pari për aktivitete ndërtimore është renditja e vlerës së terrenit, si bazë për ndërtim. Përveç kësaj, stabiliteti i terrenit mundëson të gjitha format e ndërtimit, të cilat duhet edhe të shfrytëzohen. Shikuar në përgjithësi, 10,771 banor të komunës së Shtërpcës banon, vepron, zhvillon veprimtaritë sekondare dhe terciare brenda 16 vendbanimeve si dhe shfrytëzon rrjetin e rrugëve për komunikim dhe transport të mallrave në mes vete. Sipërfaqja e përgjithshme nën vendbanime, rrugë dhe infrastrukturë tjetër nuk është më e madhe se 423,0 ha. Kjo sipërfaqe e cila në total në sipërfaqen infertile të tokës merr pjesë prej 36,4%, ndërsa në komunën e Shtërpcës jo më shumë se 1,70%.

Në bazë të këtyre informatave mund të supozojmë:

- Që për nevojat e banimit dhe zhvillimit të veprimtarive sekondare dhe terciare, duke përfshirë dhe rrjetin e rrugëve është e angazhuar një sipërfaqe mjaft e vogël;
- Që përdorimi i sipërfaqes në komunën e Shtërpcës është më intensiv vetëm në 1/90 e sipërfaqes totale të komunës;
- Që dendësia e banorëve në sipërfaqet e cekura është 44 banor në një hektar.
  Këtu, do të mund të konstatojmë se në komunën e Shtërpcës ka mjaft sipërfaqe për zgjerimin e vendbanimeve, por me kusht që kjo të mos bëhet në tokën e vlefshëm të punueshme rreth vendbanimeve. Megjithatë, nëse lind nevoja për ndërtimin e numrit më të madh të objekteve banesore, infrastrukturore, ekonomike dhe objekte të standardeve shoqërore atëherë duhet llogaritur përfshirjen e rreth 2,5 ha në çdo 100 banor të rinj, që, duke marr parasysh dinamikën e ndryshimeve demografike, nuk mund të paraqet një ngarkesë të madhe për zhvillimin e vazhdueshëm dhe të shpejt të socio-ekonomisë në komunën e Shtërpcës.

Toka e territorit të komunës së Shtërpcës karakterizohet me kushte natyrale te vlefshme për zhvillimin e turizmit. Malet e Sharrit me lartësi deri 2.600 m dhe me shtigjet jashtëzakonisht të favorshme veriore për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror, është një vlerë që deri më sot është shfrytëzuar shumë pakë. Shtigjet e lehta dhe tërheqëse skijimore gjatë dimrit dhe shtigje të gjelbëruara për përshtatshme për rekreacion gjatë verës me vlera të mëdha turistike me dukuri gjeomorfologjike (majat e larta të Sharrit, seksionet e pjerrëta, luginat e origjinave glaciale/akullnajore etj.) dhe hidrologjike (burimet dhe përroje të numërta që janë aktiv gjatë verës) që hyjnë në radhët e lokaliteteve më të vlefshme të rajonit.
Sot për nevojat e turizmit në komunën e Shtërpcës shfrytëzohen pjesët e pakta të tokës: hotelet, "Narcis", "Breza" dhe "Molika", restorantet, vendpushimet dhe objektet tjera përcjellëse turistike, duke përfshirë dhjetëra kilometra të rrugës së asfaltuar nga Brezovica deri te "Molika" nuk zënë më shume së rreth 15 ha. Përveç këtyre, në mënyrë periodike për nevoja të rekreacionit në verë, e sidomos dimrit shfrytëzohen shtigjet për shëtitje dhe skijim në sipërfaqe totale prej rreth 97,0 ha. Sipërfaqja e përgjithshme e pjesës së komunës, pjesa e kësaj sipërfaqe lëviz vetëm rreth 0,45 %. Sipërfaqet e cekura, pra, në të ardhmen mund të zgjerohen edhe për 10 e më shumë (sepse këso lloje të terreneve ka mjaft) dhe atë pa rrezik të kompromentuar zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, duke përfshirë pyjet dhe bujqësinë (bagëti).

DRAFT



Grafiku 3 Shfrytëzimi i tokës në komunën e Shtërpcës

Karakteristika inxhinierike – gjeologjike

Karakteristika gjeologjike të terreni janë të paraqitura nga aspekti i raporteve të tërësishme gjeomorfologjike, që nënkupton së janë realizuar ndarjet sipas proceseve moderne ekzodinamike dhe teknogjene dhe shfaqjeve të kërcënuara. Përmes prezantimit të formave gjeomorfologjike që rezultojnë nga efektet e një ose më shumë proceseve gjeomorfologjike, janë vendosur në të njëjtën kohën, dhe në të njëjtën kohë caktohen edhe kushtet në të cilat do të zhvillohet procesi bashkëkohor dinamik i cili në përgjithësi është faktori më i madh i rrezikut të paqëndrueshmërisë së terrenit. I kemi ndarë katër njësi (zona) të paqëndrueshmërisë së terrenit: zonat e paqëndrueshme, zonat e qëndrueshme, zonat kushtimisht të qëndrueshme dhe zonat potencialisht të qëndrueshme.

Si zonat e paqëndrueshme (jostabile) janë zgjedhur fushat me shenjat e dukshme lëvizjeve së kohës së fundit (shkarjet, zvarriten dhe rrëshqitjet e tokës). Shkarjet e dheut dhe zvarritjet janë të ndara në pellgu Vërbesticë, Jazhincës dhe Susickës dhe lumenjtë e tij, ndërsa paraqiten në shpatet e luginës në anët e rrjedhës së ujit. Shkaqet e terrenit dërrmuese/rrëshqitës janë të lidhura me regjimin hidrologjik të ujërave nëntokësore në material shpatave.

Terrenet potencialisht të qëndrueshme janë të ndarë anën e djathtë të luginës së lumit të Murzhicës dhe Bollovanit, në fakt paraqesin shkarjet e vjetra dhe të moderuara të tokës.

Terrenet kushtimisht të qëndrueshme apo terrenet pa shenja të dukshme (të mëdha) të lëvizjes janë të ndara në shpatet jugperëndimore të Sharrit (bregu i djathtë i Lepecit) dhe shpati veriore e Oshlakut.

Terrenet stabile janë të ndarë në shpat me ekspozime juglindore (bregu i majtë i Lepencit), dhe paraqesin zonat ku erozioni nuk ka lejuar akumulimin e sasisë së madhe të materialeve në shpata.

Përcaktimi i klasës së bonitetit të tokës në komunën e Shtërpcës

Falë kushteve të ndryshme të zhvillimit të procesit pedogjenetik në strukturën e mbulesës pedologjike të Shtërpcës, janë formuar 16 lloje të tokave. Të cilat janë:

1. Litosol mbi gurët gëlqeror të njomë
2. Dheu i cekët kafe mbi gurët gëlqeror të njomë
3. Dheu i cekët kafe mbi shkëmbinjtë themelor (diabazë, bazalt, etj).
4. Litosol mbi shist (gnajsi, mikashisti, filiti, argiloshisti etj.)
5. Dheu i cekët kafe mbi shist (mikashisti, filiti etj).
6. Dheu mesëm i thellë mbi shist (mikashisti, filitit i dr).
7. Deloviumi floval
8. Tokë aluviale – diluviale ranore – pjellore
9. Rendzina tipike mbi gurët gëlqeror të njomë
10. Rendzima post-mjaltë mbi gurët gëlqeror të njomë
11. Rendzina tipike mbi serpentinë

DRAFT

12. Rendzima post-mjaltë mbi serpentinë
13. Ranker tipik mbi shist
14. Ranker post-mjaltë mbi shist (filit etj.)
15. Toka e kuqe post-mjaltë mbi gurët gëlqeror të njomë.

Të gjitha tokat e mësipërme janë të grupuara në katër zona.

Pjesa më të ulët e terrenit që zakonisht përbehen nga luginat e rrafshëta aluvijale të lumenjve karakterizohen me mundësi më të mira prodhuese (fluvison, toka aluviale – diluviale), por ka edhe ato që nuk janë të favorshme për prodhimtari intensive bujqësore (humoglej, hipogej).

Tarracat fluvioglaciale janë të zhvilluar në disa nevoje, ku janë krijuar tokat përpunuese të përshtatshme për kultura të caktuara. Ato janë toka pseudoglej dhe luvisol në tarracat e poshtme dhe kambisoli distrikt në tarracat e larta.

Zonat malore në mes 800 dhe 1.800 m, sipërfaqësisht është më e madhe, dhe në të është shumëllojshmëria e pedologjike e mbulesës së tokës. Kësaj i kontribuon, si substratet e ndryshme gjeologjike, si dhe kushtet e diferencuara klimatike në lartësi. Llojet e tokave më të zakonshme të pranishme aty janë: brinipodzol, rendzine dhe dheu gëlqeror.

Si pjesë e veçantë është rripi mbi kufirin e sipërm të pyjeve ku janë të përfaqësuara: rankerët e distriktit, lotosoli dhe rendzina.

Nga këto katër grupe më e pranishme është toka humusore silikate (tanker), lloj specifik i dheut në shkëmbinjtë acidik të silikatit me thellësi të vogël deri 10 cm. Pastaj pak më thellë toka mesatare e cekët kafe mbi shist.

Në të njëjtën kohë me vendosjen hapësinore vërehet edhe zoonimi vertikal i tokës, i shkaktuar nga ndryshimet klimatike, apo variacionet e shpeshta nën ndikimin e substrateve themelore, ku kemi 31 lloje të varieteteve të tokës.

Sipas karakterit dhe strukturës së prodhimit bujqësor mund të identifikohen 8 klasa të bonitetit brenda tokës së punueshme dhe të pa-punueshme. Me këtë është mbuluar një gamë e më të mirëve, që i përket rajonit të tokës prodhuese të kulturave në pjesët e poshtme të zonës, deri te zonat më të dobëtat që përfshijnë joproduktivet. Kategoritë e tokës së punueshme janë të përfshira në katër klasat e para të bonitetit, me të tokën e katërt kaluese e kushtëzuar me tokën e forcuar punuese.

Pedologjia e tokës është një nga burimet më të vlefshme natyrore në të cilat është e mundur mbështetja e zhvillimi të Shtërpcës. Prandaj, përdorimi i saj duhet të bëhet në mënyrë racionale me përgatitje maksimale të masave anti-degraduese, ku prej rëndësisë primare është mbrojtja kundër erozionit.

DRAFT



*Harta 9 Tipet e tokave në komunën e Shtërpcës-Pedologjia**

Boniteti i tokave

Në hartën pasardhëse është paraqitur shkalla e bonitetit të tokës në komunën e Shtërpcës, në sipërfaqe në hektar dhe në përqindje. Klasa (I) 154,9 ha (1%), klasa (II) 652,5 ha (2%), klasa (III), 490,01 ha (2%), klasa (IV) 3.264,77 ha (12%), klasa (V) 15.295,57 ha (58%), klasa (VI) 2.391,41 ha (9%), klasa (VII) 2.558,24 ha (10%) dhe klasa (VIII) 1.467,58 ha (6%).

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Klasa	Sipërfaqja *ha*	%
I	154,9	1
II	652,5	2
III	490,01	2
IV	3.264,77	12
V	15.295,57	58
VI	2.391,41	9
VII	2.558,24	10
VIII	1.467,58	6

Tabela 1 Klasat e tokës në komunën e Shtërpcës



Grafiku 4 Ndarja e tokës sipas bonitetit në hektar (ha) në komunën e Shtërpcës, në bazë të udhëzimeve të FAO (1976, 2007)



*Harta 10 Boniteti i tokave në komunën e Shtërpcës**

2.1.3.1. Gjeologjia

Terreni i komunës së Shtërpcës karakterizohet me strukturë shumë komplekse gjeologjike –ku janë të përfaqësuara formacionet e ndryshme gjeologjike, ndërsa aktiviteti intensiv magmatik dhe lëvizjet e forta tektonike, gjatë evolucionit gjeologjik të zonës, kanë çuar në krijimin e një përbërje mjaft të komplikuar tektonike. Shkëmbinjtë që

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

përbëjnë këtë zonë sipas vjetërsisë i përkasin kohës së paleozoikut, permian-triasik, triasikut të mesëm dhe të sipërm, jurasike, kretake të epërme, neogjenit dhe kuaternarit. Në mënyrë litologjike ato janë: metamorfitet e ndryshme, shkëmbinjtë klasik, sedimentarë dhe organogjen, si dhe shkëmbinjtë intruziv magmatik dhe vullkanik.

Paleozoik – Formacionet më të vjetra janë shkëmbinjtë regjional metamorfik të paleozoikut që përbëjnë kompleksin në trashësi prej 1000 metrave dhe të cilat janë gjithashtu të përhapura në këtë fushë. Janë të paraqitura Albite-chlorite-sericite shist argjilor, kuarci, mermeri dhe kalshisti dhe graniti gnajs. Këto formacione veçohen buzë maleve të Sharrit, prej Lubotenit deri tek Prevalla. Shfaqen edhe në veri të Lepencit, të ndarë nga masa kryesore e krijuar nga format permian–priassike, si dhe në zonën e Jezercit. Nëpërmjet tyre, në një varg normal të stratigrafikëve, shtrihen krijimet permian–priassic, triasikët – transgresivet e mesëm dhe të lartë.

Permotrijasike – Shtigjet veriperëndimore dhe jugperëndimore të Jezercit dhe pjesa më e madhe e Sharrit, formojnë krijjime permian–priassike, në përbërjen e të cilave hyn: sedimente të dobëta metamorfozike të pelit – psamit, konglomeratet, kuarci, gëlqerja e kristaltë dhe kuarci – porfiri. Kufiri drejt metamorfëve paleozoik më pjesën më të madhe është i paqartë për shkak të mungesës së dëshmive faunistike, dhe çrregullimeve tektonike të mbulimit të terrenit. Supozohet se metamortitet permotrijasi është zhvilluar nga shisti argjilor, megjithatë, në teren, kufiri në pjesën më të madhe është tektonik.

Trijasike – Gëlqeroret e mermerta që e ndërtojnë Oshlakun, Lubotenin, paraqiten si pjesë të izoluara në pjesën e Gotovushës, zonat e ngushta rreth Izhancës dhe si olistoli në melanzhin olistromik të Koxhës së Ballkanit. Gëlqeroret e ndara janë të klasifikuara në trijasën e mesme dhe të epërme të padiferencuar. Sipas formacioneve të vjetra gëlqeroret trijasat janë transgresive, edhe pse në terren me shistin argjilor janë në raport tektonik.

Jurasike – Si Formacione jurasike paraqiten shkëmbinjtë me melanzhin olistromik, ultramafitimet dhe shkëmbinjtë metamorfik në thellësi të ultramafitës. Mesazhi olistrostromik shfaqet në formë të rripit me gjerësi prej 6-8 km. në mes të malit të Oshlakut dhe Jezercit, duke krijuar një zonë malore të Koxhës së Ballkanit. Përbëhet nga malanzha e matriksit dhe nga olistoliti apo klastave të vendosura në matriks.

Kretake – Sedimentetet e gëlqeres që shtrihen mbi formacionet e tjera të vjetra, paraqiten me anë të konglomeratëve, shkëmbinjëve të rërës dhe shtresës gëlqerore si dhe pllakës. Në rripin e shtresave gëlqerore, nyjore nga Kurkulica deri të Brodi, janë konstatuar si të ruajtura mirë një numër i faunës nga hipuriti, radiolariti dhe korali.

Neogeni – Zhavorri – argjila nga rëra janë të ndara tek Bitia dhe në juglindje të Brodit, i përkasin neogjenit. Megjithatë, pasi që këto sedimente nuk janë të dëshmuar në mënyrë faunistike, vjetërsia e tyre duhet marr kushtimisht.

Kuaternari – formacionet kuaternare janë të paraqitura në lloje të ndryshme gjenetike nga të cilat më të rëndësishme janë ato fluviale, diluviale dhe aluviale – proluviale si formacione bashkëkohore dhe të trashëguara pjesërisht si dhe ai glacial apo akullnajor që nuk është më aktiv, por i cili është një nga më të rëndësishmit, për shkak të formave të shumta prezente në reliefin e sotëm. Në kuadër të kvartarit janë të ndara: materiali morenë, shkëmbinjtë fluviooglacial, tarracat e lumenjve, grupet e shkëmbinjve, rrëpirat me gurë të rrëzuar, proluvijumi dhe aluvijumi.

DRAFT



*Harta 11. Formacionet gjeologjike**

2.1.3.2. Karakteristikat hidrografike

Ujërat sipërfaqësor

Në ujërat sipërfaqësor bëjnë pjesë:

- Lumenjtë: Cerenci, Tisa, Lumi i Thatë, Blateshtica, Vërbeshtica, Murzhica, Miloshtica, Kalluxherka, Bollovanka, Sishica, lumi i Viçës, Izhanca dhe Lepenci
- Liqenet: Jazhincës dhe Livadicës si liqene të përhershme dhe të mëdha, si dhe shtatë liqene të vogla të përkohshme.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

- Prockat: e Durlovi, Savinit, Vitacit, Berevcës, Ropotës etj.

Ujërat sipërfaqësore në komunën e Shtërpcës arrin gjatësinë deri 110.800,00 m dhe sipërfaqe prej 587.240,00 m².

Lumenjtë

Në hartën e komunës së Shtërpcës (skica nr. 1) rrjetin sipërfaqësor hidrografike e përbëjnë Lepenci dhe degët e tij, ku sipas rëndësisë veçohen: Vërbeshtica, Lumi i Thatë, Blateshtica, Miloshtica, lumi Sushica. Dendësia e rrjetit hidrografik është mjaft i ndryshueshme prej 0,91 deri 2,53 km/km².

Si rezultat i reshjeve të rritura, energjisë së lartë të reliefit dhe sasisë së madhe të reshjeve, koeficientit mesatar të fryrjes së pellgut të sipërm të Lepencit është më i madh se 60 %, e që është shumë më e lartë se basenet e lumenjve më të madh në rajon. Shpërndarja e ngritjes së nivelit gjatë vitit në Lepenc dhe në degët e tij është e tillë që prej janarit e deri në majit në mënyrë të vazhdueshme rritet rrjedha e tyre dhe pastaj zvogëlohet gradualisht deri në shtator. Sipas karakteristikave themelore hidrologjike të tij regjimi lumor i Lepencit i takon regjimit maqedonas të versionit pluvionival.

Lumi Lepenc dhe degët e tij janë mjaft të pasura me ujë. Kështu, rrjedha mesatare e Lepencit te Brodi është 5,63 m³/sek, deri sa te degët ai ka këto vlera: lumi Sushica 0,69 m³/sek, Vërbeshtica 0,67 m³/sek, Miloshtica 0,63 m³/sek dhe lumi i Thatë 0,51 m³/sek.

Rritja e rrjedhës së Lepencit nga burimi deri te gryka gradualisht rritet, kështu që tek bashkimi i lumit Tisa dhe Cerenci arrin vlerën prej 0,527 m³/sek. ndërsa te Brodi 5,60 m³/sek. Variacionet e rrjedhës janë vogla, dhe koeficienti vjetor ka vlerë 0,22.

Shpërndarja hapësinore e ujit (fryrja) në luginën e Sirinukt është e pabarabartë, për shkak së pjesët më të larta dhe pellgjet e degëve të djathta janë më të pasura me ujë. Megjithatë, vlerësimi i përgjithshëm tregon për resurse të shumta të rrethit të komunës, dhe me këtë për mundësit e zgjidhjes së problemeve të shumta ujë.

Në të njëjtën kohë, paraqiten kufizime serioze në përdorimin e ujit sipërfaqësor, të shkaktuara së pari nga karakteri i regjimit të lumit të pjesës më të madhe të degëve të Lepencit. Kjo ndikon në shfaqjen e ujërave të shumtë që shkaktojnë përmbytje të shpeshta me përmasa të mëdha. Sidomos përmbytjet e mëdha dhe shkatërruese kanë qenë vërshimet në vitin 1897., 1950. dhe 1979, kur flukset kanë arritur pothuajse në nivelin e ujërave të mira vjetëve. Është e qartë që shkaqet e kësaj duhet kërkuar në procesin e zhvilluar të erozionit të tokës dhe mbrojtjen e dobët nga uji, d.m.th. zbatimi jo sistematik dhe sporadik i masave riparuese biologjike, bioteknike dhe të karakterit teknik.

Është e qartë se me shfrytëzimin e ujërave në të njëjtën kohë duhet të merren masa për mbrojtjen nga uji, që në komunën e Shtërpcës fshihet forca e madhe latente e shkatërrimit.

Fenomenet hidrologjike të veçantë paraqesin liqenet ciruse akullnajore: liqeni i Livadicës, Liqeni i Vogël i Jazhincës dhe i Vërbeshticës. Duke marr parasysh dimensionet, vlera themelore e tyre është e karakterit estetik. Në fakt, prania e tyre në rripin e maleve të larta të Sharrit e bënë këtë zonë turistike më atraktive dhe më të vlefshme.

Liqenet

Në mesin e bukurive natyrore të kësaj zone vend të posaçëm zënë liqenet malore, të njohur për popullin "sytë e malit". Ndër më të njohurit janë:

- *Liqeni i Livadicës ose liqeni i Shtërbacës në cirkun e lumit* Kalluxherka. Gjendet në lartësi mbidetare prej 2.173 m. Gjatësia e liqenit arrin 230 m, gjerësi 120 m dhe thellësia rreth 7m.
- *Liqeni i Jazhincës* në lartësi mbidetare prej 2.170 m, në cirkun e burimit të Lumit të Thatë, i cili në nivelin më të lartë të ujit arrin 11 m. Gjatësia e tij është rreth 120 m, ndërsa gjerësia rreth 80m.

Ndër liqenet më të vogla të njohur janë:

- *Liqeni i Vërbeshticës* në lartësi mbidetare prej 2.075 m, gjendet në cirkun e Blatështicës
- *Liqeni i vogël i Jazhincës* që gjendet në lartësinë më të madhe mbidetare prej 2.200 m, ndërsa gjendet në cirkun e burimit të Blateshticës dhe Lumit të Thatë. Te gjitha liqenet janë me origjinë akullnajore – akumuluese.

DRAFT



*Harta 12 Njësitë hidrogjeologjike**

Ujërat nëntokësorë

Ujërat nëntokësorë kryesisht paraqiten në formë të ujëmbajtësit freatik dhe të thyer, deri sa paraqitja e ujërave nëntokësor krasik është më pak e pranishme, ku falë rezervave të shumta të ujërave nëntokësor ata janë në mundësi të ushqejnë një numër të madh të burimeve. Më të shpeshta janë burimet e dobëta që japin prej 0,1 - 1 l/sek, dhe ka mjaft prej atyre qe japin 1 - 5 l/sek. Me të pasura më ujë janë burimet karsike (dy burime nën Lubotenin, luginën e Heshtur, Gurin e zi I dhe II etj,) që kanë rëndësi të madhe për menaxhimin e ujit.

Paraqitja e ujërave nëntokësor dhe liqeneve është shkaktuar nga kushtet e veçanta. Terrenet e komunës së Shtërpcës të ndërtuar nga shistat e gjelbra argjilore, filita, gurit të zi gëlqeror nga flishi, gurit gëlqeror dhe dolomitëve, serpentinit, formacioneve dia-bazë, rërës, zhavorrit dhe argjilës. Kjo zonë karakterizohet me shkëmbinj ujëmbajtës ku ekzistojnë thyerje të burimit me shkëmbinjtë që nuk përshkohen nga uji që kalon mbi to. Ky burim ushqen burime të

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

shumta që paraqiten në majat e shumta të kreshtës nga të cilat formohet një rrjet hidrografik i zhvilluar. Burimet kanë kapacitet të ulët prej 0,10 l/sek deri disa l/sek. Temperatura e ujit ndryshon nga 3-10º C. Burimet janë kryesisht të pambuluara dhe gjenden në lartësi të mëdha dhe në tërë hapësirën.

Shpërndarja e resurseve të ujërave nëntokësorë është shume e ndryshueshme. Sipas strukturës gjeologjike, shtresat e rëndësishme të ujëmbajtësit gjenden në luginën e Murzhicës dhe Miloshticës, po ka edhe në të gjitha luginat e lumenjve, me mundësi më të vogla të shtresave ujëmbajtëse. Trashësia e sedimenteve të Morenës varion nga 2 – 5 m ose më shumë në luginën e Murzhicës dhe Miloshticës. Edhe pse nuk janë kryer hetimet, mund të supozohet se ka sasi të konsiderueshme të ujit. Megjithatë, më të pafavorshme nga aspekti i përdorimi janë ujërat nëntokësor në Vikend zonë dhe të luginës së Shtërbacit për shkak të ndotjes së shkaktuar nga urbanizimi. Përdorimi i ujërave nëntokësore me anë të gërmimeve të puseve është dukuri shumë e rrallë, dhe kjo është e kuptueshme për shkak të paraqitjes së madhe të burimeve natyrore. Megjithatë, pothuajse në çdo fshat ka ndonjë pus. Sasia e rrjedhës së pusit sillet prej 1 dhe 3.l/sek, që na sjell deri te përfundimi që nën tokë ka sasi të konsiderueshme të ujit.

2.1.3.3. Pjerrtësia e shpatieve

Një nga karakteristikat morfometrike është edhe që territori i komunës së Shtërpcës ka karakter malor, ku karakteri malor mesatar përbën 72,77 % të sipërfaqes së përgjithshme, ndërsa malet u ulëta deri 1.000 metra, përfshinë 20,37 % dhe malet e larta mbi 2,000 metra përfshijnë 6,86 % të sipërfaqes.

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme morfometrike e pjerrtësisë, tregon që për reliefin është karakteristike pjerrtësia prej 25 %, kështu që sipërfaqet me këtë pjerrtësi janë 94,77 % të sipërfaqes së përgjithshme. Pjerrtësia prej 5 – 25% merr pjesë me 3,88 %, ndërsa pjerrtësia prej 5 % vetëm për 1,35 %. Pjerrtësia mesatare e sipërfaqes topografike është 47,4 %.

Karakteristika e tretë e vetive të rëndësishme morfometrike është ekspozimi i sipërfaqeve topografike, ku përfaqësim dominant kanë ekspozimi verior dhe jugor. Proceset e fundit ku rolin mbizotërues e ka erozioni i ujit janë të përfaqësuara në mënyre të pabarabartë. Më i fuqishmi është në pjesët e mesme dhe të poshtme të pjerrtësive mbi luginat e lumenjve, dhe është shumë më i dobët në pjesët më të larta dhe në vargmale. Erozioni është veçanërisht intensiv në ekspozimet jugore, juglindore dhe jugperëndimore. Karakteri malor dhe të gjitha veçoritë e rëndësishme ndikojnë në elementet tjera të komplekseve natyrore, vetitë e tyre, ndërlidhjet dhe dinamikën.

2.1.3.4. Ekspozicionet e terrenit

Njohja, evidentimi dhe ndërtimi i hartës së ekspozicionit të terrenit ka rëndësi teorike dhe praktike, sepse përmes vlerave të tij përcaktohet zgjatja e ndriçimit të diellit në një territor të caktuar gjeografik[3]. Përdorimi praktik dhe teorik i hartës se ekspozicionit përveç regjimit kalorik, lidhet ngushtë edhe me parametrat tjerë meteorologjik si: reshjet, lagështinë e ajrit, temperaturat, drejtimin e erërave etj.[4] Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në përcaktimin sasior dhe cilësor në proceset morfodinamike të relievit. Këto ndryshime fiziko-gjeografike vërehen kryesisht në terrenet e ekspozuara nga jugu që janë më tepër të ndriçuara. Efekti i procesit të shkatërrimit të shkëmbinjve nën ndikimin e temperaturave drejtpërdrejt varet nga ekspozicioni i relievit.

Pra, me ekspozicion nënkuptojmë vendndodhjen e një shpati në lidhje me këndin e rënies së diellit. Drejtimi i ekspozimit të relievit ndaj diellit mund të specifikohet në shkallë relative:

1. Ekspozicioni = 0 °- nënkupton pjerrtësinë relievore të kthyer kah veriu (shpat verior, shpesh i referuar si "anë e errët");
2. Ekspozicioni = 90 ° - tregon shpatin lindor, shpat me më shumë rreze dielli në mëngjes;
3. Ekspozicioni = 180 ° - anët e kthyera kah jugu – i quajtur edhe "ana diellore";
4. Ekspozicioni = 270 ° - shpat perëndimor, shpat me më shumë diell në mbrëmje[5].

Llogaritjet e këndit të rënies së diellit ndaj sipërfaqes së tokës janë bere duke u bazuar në modelin digjital relievor "EUDEM" i cili ka përmasat e rezolucionit hapësinor 25*25m.

Ekspozicioni, sidomos në shpatet e pjerrëta, ka ndikim të madh në klimën lokale dhe bimësi. Për këtë arsye, qysh në kohërat e lashta shpatet jugore janë përdorur për vendbanime dhe punimin e tokës, ndërsa shpatet veriore për pyllëzim. Gjithashtu, njohja e ekspozicionit luan rol edhe në mbrojtjen nga rreziku i rrëshqitjes së ortekëve. Ekspozimi

[3] Talani Rifat "Praktikumi i laboratorëve dhe detyrave të hartografisë-topografisë",Shkodër, 1997, fq. 85

[4] Talani Rifat "Veçoritë morfologjike të pellgjeve ujëmbledhëse në Alpet e Shqipërisë", Studime gjeografike nr. 4, Tiranë 1990, fq. 129

[5] Drago Perko, Analiza površja Slovenije stometrskim digitalnim modelom reliefa, Geografija Slovenije 3, Ljubljana 2001

i një shpati ndikon fuqishëm në mikroklimë, florë, faunë, rendimente bujqësore dhe pyjore. Ky është një faktor i rëndësishëm edhe për ekologjinë e peizazhit. Në kushtet e prodhimtarisë biologjike, një shpat në jug apo në jugperëndim mund të ndikojë në rritjen e produktivitetit, por gjithashtu mund të jetë më i prekshëm ndaj thatësirës. Po ashtu, edhe arkitektura mund të marrë parasysh këtë faktor (ekspozicionin), ku shihet si thelbësore për arkitekturën e quajtur "bioklimatike". Me arkitekturë bioklimatike nënkuptohet një filozofi ndërtimtarie që bazon modelin e saj mbi efektshmërinë e shkëmbimeve midis shtëpive dhe ambientit natyror që i rrethon, që ka për qëllim kufizimin e përdorimit të impianteve mekanikë tradicional, d.m.th kursimin energjetik.[6]



[6] http://environment.nationalgeographic.com/environment/global-warming/solar-power-profile

Harta 13. Ekspozicionet e terrenit*



Harta 14 Relievi dhe lartësitë mbidetare*

2.1.3.5. Kushtet klimatike

Në tërë komunën, klima nuk është e ashpër edhe pse kjo zonë është në lartësi relativisht të lartë mbidetare, por është e butë, deri sa vetëm disa qindra metra mbi fshatra mbizotëron një klimë e vërtet malore. Kjo mund të shpjegohet nga ndikimi i lumit Lepenc, i cili derdhet në lumin Vardar, e ky pastaj në Detin Egje dhe përmes të cilës ndjehen efektet e dobishme të klimës së ngrohte të Egjeut.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Rajoni i komunës së Shtërpcës në masë të madhe është paracaktuar me reliefin malor dhe me strukturën e tij hipsometrike. Nga aty çdo element i klimës ndërron vlerën e vet me ndryshimin e lartësisë mbidetare. Kështu që me diferencimin vertikal të klimës është e mundshme të dallohen katër zona të lartësisë dhe të klimës, të cilat janë:

- Zona I – *zona e klimës së butë,* e paraqitur deri 1.000 metra lartësi mbidetare;
- Zona II – *zona kalimtare* prej 1.000 deri 1.200 metra lartësi mbidetare;
- Zona III – *zona subalpike* prej 1.200 deri 1.700 metra lartësi mbidetare;
- Zona IV – *zona e klimës alpike*, në lartësi më të mëdha prej 1.700 metra lartësi mbidetare.

Secila nga këto zonave malore ka avantazhet dhe kufizimet e arkëtuara për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara ekonomike. Kështu zonën e klimës së butë, e karakterizojnë pjesët e mira bujqësore për prodhimtari bujqësore. Në zonën kalimtare zvogëlohen mundësitë e prodhimtarisë bujqësore, deri sa rriten predispozitat për blegtori dhe pylltari. Në zonën e tretë subalpike, kufiri i epërm i së cilës përputhet me zonën e epërme antropogjene të pyjeve, e bënë këtë zonë të shquar për pylltari dhe blegtori. Zonën e katërt e karakterizon klima e freskët alpike, e pasur me reshje të borës, të cilat mund të qëndrojnë deri në shtatë muaj. Gjatë periudhës së dimrit, mbuloja e borës, retë e pakta dhe ndriçimi i rëndësishëm me rreze të diellit paraqesin predispozitat klimatike ideale për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit dimëror – malor. Gjatë verës, kur mbulesa e borës shkrihet, këto terrene bëhen të favorshme për zhvillimin e kullotave blegtorale, të cilat kanë një traditë të pasur këtu, por për fat të keq, pothuajse tërësisht është në zhdukje e sipër, por që në të ardhmen sigurisht duhet t'i kthehemi.

Natyrisht, se disa pjesë të këtij territori, duke pasur parasysh lartësinë mbidetare, ekspozimin e shpateve, d.m.th. ekspozimin e tyre në diell dhe ndikimin e erërave dominuese dhe strehimeve prej tyre, si dhe për shkak të karakteristikave të tyre të ndryshme të substrakteve (fushat, pyjet, livadhet, terrenit shkëmbor) në mesin e tyre, nga aspekti klimatik, të cilat në mënyrë të konsiderueshme ndryshojnë.

Megjithatë, klima e komunës së Shtërpcës përveç diverzitetit të rëndësishëm, ka një vijë të theksuar të përbashkët. Ajo rrjedh nga karakteristikat morfologjike të komunës së Shtërpcës, dhe fakti se mbi të në pjesën më të madhe mbizotëron moti anticiklonik. Përkatësisht, koha kryesisht është stabile, pa stuhi të forta dhe fatkeqësi, dhe me vera relativisht të ngrohtë dhe dimra të ashpër që janë tipare thelbësore të klimës.

Në bazë të matjeve të rrezatimit të diellit në Brezovicë mund të konkludohet se komuna e Shtërpcës, me një kohëzgjatje mesatare të rrezatimit vjetor prej më shumë së 1.938 orë është jashtëzakonisht e rrezatuar me diell.

Regjimi i rrezatimit diellor në Brezovicë është matur për periudhën 5 vjeçare (vitet 1984-1988). Kohëzgjatja me e gjatë e rrezatimit diellor është në korrik (285,4) dhe gusht (269,6), ndërsa më e shkurta në janar (72,6) dhe dhjetor (77,1). Përfshirje më të gjatë prej 200 orë ka mesatarisht edhe në shtator (222,4) dhe qershor (210,1). Kështu, muajt e verës me ditën më të gjatë dhe muaji shtator me vranësira të pakta, janë më të ndriçuarat me diell. Derisa muajt e dimrit (janari dhe dhjetori), me vranësira më të shkurta dhe më të mëdha kanë kohëzgjatjen më të shkurtë të ndriçimit të diellit.

Regjimi i temperaturës

Në territorin e komunës së Shtërpcës deri në vitin 1984 nuk ka ekzistuar ndonjë stacion meteorologjik në të cilin do të mund të mateshin temperaturat e ajrit. Megjithatë, nga viti 1984 në Brezovicë funksionin stacioni i kompletuar meteorologjik në të cilin monitorohen dhe regjistrohen rregullisht të gjithë elementet meteorologjike. Stacioni gjendet në lartësi mbidetare prej 915m, gjerësisë gjeografike 42º 13' dhe gjatësinë gjeografike 21º 01'. Regjimi i temperaturës trajtohet në bazë të dhënave nga stacioni meteorologjik i Brezovicës.

Brezovica ka një dimër të gjatë, por jo edhe shumë të ashpër. Në fakt, në të tre muajt e dimrit (dhjetor, janar dhe shkurt) temperaturat mesatare janë negative. Janari nga -1,4º C ndërsa Dhjetori vetëm -0,3º C. Vera në Brezovicë, sipas temperaturave mesatare është e freskët dhe e këndshme. Temperatura e muajit më të ngrohtë janë ato të Korrikut, është 18.0 º C, Gushtit 17.2 º C, dhe Qershorit 15.3 º C.

Luhatjet e temperaturave mesatare të muajve të verës janë në mënyrë të konsiderueshme më të ulëta se në muajt e dimrit: Në Qershor vetëm, 1º C, Gusht 2,8º C në krahasim me 6,0º C në Janar dhe 5,8º C në Shkurt. Përndryshe, ndryshueshmërinë më të madhe në temperaturat mesatare mujore e ka muaji Nëntor (7,0º C).

Kur komuna e Shtërpcës është nën ndikim e masave ajrore perëndimore dhe jugperëndimore, atëherë temperaturat e muajve të dimrit janë më të larta, ndërsa kur në të depërton ajri i ftoftë kontinental nga lindja, atëherë temperaturat e muajve të dimrit janë dukshëm më të ulëta. Në disa ditë të caktuara në muajt e verës temperaturat e ajrit mund të jenë tepër të larta. Kjo tregon temperaturat maksimale të regjistruara në atë muaj.

Analiza mesatare e temperaturave mujore, temperaturave mujore maksimale dhe minimale, si dhe ditëve të ashtuquajtura të verës, tregojnë se temperaturat e ajrit në komunën e Shtërpcës janë subjekt i ndryshimeve të shumta. Përkatësisht, në situatat e motit anticiklonik në pjesët e larta të maleve të Sharrit moti është mjaft i kthjelltë, me diell

dhe i ngrohtë, derisa në lugina dhe fusha është me mjegull dhe i ftoftë. Në shkurt nga pjesa e poshtme e komunës së Shtërpcës deri në 1.700 m lartësi mbidetare vjen deri të ngritja graduale e temperaturës së ajrit, e cila është 0,2º C në 100 m, gjë që tregon inversionin e temperaturave në muajt e dimrit, e sidomos në shkurt.

Vranësirat – Në bazat të vranësirave mesatare vjetore, prej 5,2 në Brezovicë, mund të supozohet se komuna e Shtërpcës i përket pjesës së Kosovës me më së paku vranësira. Vranësirat mesatare në Prizren dhe Pejë janë 5,8, në Ferizaj 5,7, Gjakovë 5,4. Moti me vranësirat më të mëdha është në muajt e dimrit (Janar, Shkurt) dhe në muajin e parë të pranverës (Mars), ndërsa më së paku në muajin e vjeshtës (Shtator) dhe muajve të verës (Korrik dhe Gusht). Vranësirat më të mëdha në muajt e dimrit lehtësohen nga luhatjet ditore të temperaturës së ajrit, dhe thekson edhe kalimin e masave ajrore perëndimore detare, dhe në këtë mënyrë dimrat nuk janë edhe shumë të ashpër. Vranësirat minimale në shtator e zgjasin verën, ndërsa vranësirat e pakta në korrik dhe gusht e bëjnë verën më të gjatë dhe më të këndshme.

Reshjet – Sipas hartës meteorologjike shërbimi hidrometeorologjik, në territorin e komunës së Shtërpcës është mesatarisht në mes 900 mm të reshjeve (në luginën e Lepencit) dhe 1.250 mm (në pjesët më të larta të maleve të Sharrit). Prandaj, territori i studiuar është i pasur me reshje. Në këtë aludojnë edhe burimet e saja ujore: rrjedhat (lumenjtë) e shumtë dhe burimet e shpeshta me sasi të mëdha të ujit. Regjimi pluviometrik (me shi) është analizuar në bazë të dhënave të të reshurave dhe stacioneve për matjen e reshjeve në Jazhincë dhe Shtërpcë. Stacioni për matjen e reshjeve në Jazhincë shtrihet në një lartësi mbidetare prej 950 m. Ai gjendet në fshatin me emërtim të njëjtë te burimi i lumit Lepenc. Sasia mesatare e reshjeve vjetore (periudha e viteve 1931 – 1960) mbi të është 972 mm. Por, pasi që për periudhën e viteve 1959 – 1987, do të thotë për 35 vite me radhë, posedohen të dhënat e besueshme për lartësinë e reshjeve, të njëjtat janë shfrytëzuar për procedimin e regjimit pluviometrik. Sasia mesatare e reshjeve ne Jazhincë (periudha e viteve 1950-1984) është 1.013 mm. Kështu, periudha e cekur ishte pak më e lagësht (mesatarisht 41 mm apo 4.2%), në krahasim me periudhën e viteve 1931-1960. Stacioni për matjen e reshjeve në Shtërpcë shtrihet në lartësi mbidetare prej 860 m. Reshjet aty rregullisht maten që prej vitit 1960. Sasia mesatare e reshjeve për periudhën e viteve 1960-1984 është 921 mm. Që do të thotë, se në krahasim me Jazhincën, Shtërpca është më e varfër sa i përket reshjeve me një mesatare prej 92 mm apo 9%. Pasi që dallimi i lartësisë në mes të Shtërpcës dhe Jazhincës është 90mm, gradienti vertikal pluviometrik (rritja e reshjeve në 100 m lartësi), është 102,2 mm. Sasia vjetore e reshjeve sipas muajve dhe stinëve të vitit është e shpërndarë në mënyrë mjaft të barabartë. Mesatarisht muaji me më së shumti reshje është Maji që ka një sasi prej 1,7 herë më të madhe të reshjeve në krahasim me Gushtin që është muaji me më së paku reshje. Shpërndarja e barabartë e reshjeve veçanërisht vjen në një kuptim më të qartë kur të merren në konsideratë stinët e vitit, pranvera me sasinë më të madhe të reshjeve, ka vetëm 3,4% më shumë reshje nga vera, ku mesatarisht ka më së paku sasi të derdhura të reshjeve.

Shtresa e borës **-** Bora është një dukuri e rregullt dimërore në komunën e Shtërpcës. Numri i ditëve me reshje bore, gjatësia dhe trashësia e shtresës së borës rritet me rritjen e lartësisë mbidetare. Numri mesatar vjetor i ditëve me borë shkon për periudhën e viteve 1931-1960 prej 40 në luginën e Lepencit deri në 100 ditë në pjesët më të larta të maleve të Sharrit. Në Shtërpcë numri i ditëve të regjistruara me reshje bore, për periudhën e viteve 1960-1984 është mesatarisht 39, ndërsa në Jazhincë për periudhën e viteve 1959-1985 është 42 ditë. Me shtresën e borës, me të cilën nënkuptohet shtresa e borës me trashësi më së paku 1 cm, disa pjesë janë të mbuluara prej 60 deri në 210 ditë. Shtresa e borës, për shkak të temperaturave të ulëta të ajrit, përherë ka qëndrueshmëri më të gjatë në krahasim me ditët e reshjeve të borës, d.m.th, ditët kur bie borë. Sipas matjeve konkrete për periudhën e viteve 1960-1984 kohëzgjatja mesatare e shtresës së borës në Shtërpcë është 66,5 ditë, në Jazhincë 71,2 ditë. Prandaj, kohëzgjatja e shtresës së borës e shtrirë nga Shtërpca – Jazhincë rritet në 100 për 5 ditë. Në pjesët më të larta të maleve të Sharrit nën shtresën e borës janë pjesët prej 180 deri 210 ditë, që nënkupton 6 deri në 7 muaj. Përndryshe, trashësia mesatare maksimale e shtresës së borës në lartësi mbi 1.700 m, është duke filluar nga 150 deri 200 cm, derisa në rajonet më të ulët është 70 cm.

Erërat **-** Në komunën e Shtërpcës më të shpeshtat janë erërat lindore dhe perëndimore, dhe është e qartë që në drejtimin e erërave në mënyrë dominonte ndikojnë format e reliefit, që nënkupton drejtimi i luginës së Lepencit dhe malet përreth. Erërat perëndimore, në mesin e stinës së dimrit sjell reshje të shumta bore. Ai në muajt e verës, në orët e pasdites, zëvendësohet me erërat juglindore, të cilat depërtojnë në komunën e Shtërpcës nga gryka e Kaçanikut dhe mbi degëzimet më të ulëta të maleve të Sharrit, në lindje të Lubotenit. Megjithatë, në terrenet skijimore të Brezovicës gjatë dimrit, dominojnë erërat nga kuadrati verior. Ato fryjnë nga mali i Jezercit, janë të forta, të ftohta dhe sjellin stuhi dëbore dhe borë të imët. Por, ato ndjehen vetëm në pjesët e larta, mbi 1.200 m lartësi mbidetare, derisa nën të lajmërohen si erëra të dobëta. Kur analizojmë shpeshtësinë e erërave dhe qetësinë nëpër sitnit e vitit, qetësia më e madhe është gjatë vjeshtës dhe dimrit, deri sa frekuencat më të mëdha të reshjeve kanë pranvera dhe vera.

DRAFT

Në kohët e fundit në Brezovicë, që po bëhet një qendër skijimore mjaft perspektive dhe në shkallë evropiane, për të cilën janë të interesuar dashamirësit e vërtetë të sporteve ekstreme në Evropë dhe botë ka faqen e vet personale, ku me precizitet të lartë mund të merret parashikimi shumë cilësor dhe preciz i motit, si për shtatë ditë ashtu edhe për periudha më të gjata.

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
-1,4	-1,4	2,6	9,7	13,2	15,3	18,0	17,2	13,9	8,4	2,7	-0,3	8,1

Tabela 2 Temperaturat mesatare mujore të ajrit në Brezovicë, periudha 1984-1988

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Vlerat maksimale												
111,1	104,4	116,2	219,9	211,8	248,8	338,6	317,1	247,8	171,5	132,2	115,6	2047,2
1988.	1987.	1988.	1986.	1986.	1987.	1988.	1986.	1987.	1986.	1986.	1985.	1985.
Vlerat minimale												
53,6	48,3	94,1	131,3	153,3	157,0	219,8	187,3	186,5	119,1	67,6	46,5	1916,4
1987.	1986.	1986.	1988.	1988.	1988.	1986.	1984.	1988.	1987.	1985.	1987.	1988.
Dallimi												
57,5	56,1	22,1	86,6	58,5	81,8	118,8	129,8	61,3	52,4	64,6	69,1	130,8
Vlerat mesatare												
72,6	89,8	107	167,7	189,7	210,1	285,4	269,6	222,4	148,0	99,0	77,1	1938,4

Tabela 3 Shuma e kohëzgjatjes së rrezeve të diellit në orë

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Maksimale												
1,3	0,7	3,9	10,3	14,3	16,1	20,2	18,2	16,4	10,2	4,8	3,4	8,4
1988	1988	1986	1986	1985	1987	1988	1988	1987	1984	1987	1985	1987.
Minimale												
-4,7	-5,1	0,5	7,1	11,5	15,0	15,9	15,4	12,8	17,5	-2,2	-2,0	8,o
1985	1985	1987	1987	1987	1985	1986	1984	1985	1985	1988	1986	1986
Dallimi												
6,0	5,8	3,4	3,2	2,8	1,1	4,3	2,8	3,6	2,7	7,0	5,4	0,4

Tabela 4 Temperaturat mesatare mujore maksimale dhe minimale në Brezovicë

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
16,5	13,5	21,5	27,1	27,0	31,1	36,8	32,0	31,2	27,0	22,3	27,6
1988.	1988.	1987.	1985.	1988.	1987.	1987.	1985.	1987.	1984.	1985.	1985.

Tabela 5 Temperaturat maksimale mujore në ºC

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Vlera mesatare												
0,0	0,0	0,0	0,3	7,3	6,2	16,0	18,0	9,0	0,2	0,0	0,0	57,0
Vlera maksimale												
0,0	0,0	0,0	1,0	25,0	11,0	23,0	23,0	18,0	1,0	0,0	0,0	
			1985.	1988.	1987.	1988.	1988.	1987.	1984.			
Vlera minimale												
0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	2,0	4,0	8,0	5,0	0,0	0,0	0,0	
			1988.	1987.	1986.	1986.	1988.	1988.	1988.			

Tabela 6 Numri i ditëve me temperaturën maksimale të ajrit ≤25ºC

I		II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Zona rreth 900 m l.md.	-2,8	-2,5	2,2	8,1	12,3	16,1	18,0	18,1	14,0	6,4	4,0	-0,7	7,9
Zona rreth 1700 m n.v.	-4,6	-2,3	-0,7	3,3	9,0	11,8	14,8	15,3	11,2	6,8	2,2	-2,7	5,4
zona rreth 2000 m l.md.	-5,4	-3,2	-2,2	1,4	7,2	9,9	13,0	13,7	9,6	5,6	1,1	-3,7	3,9
Tr 900/2000	0,24	0,06	0,40	0,01	0,46	0,56	0,45	0,40	0,40	0,25	0,26	0,27	0,36

DRAFT

Tabela 7 Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore të ajrit, periudha 1931-1960

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
6,4	6,3	6,8	5,8	6	5,4	3,3	3,3	3,2	4,8	5,4	5,6	5,2

Tabela 8 Mesatarja e vranësirat mujore në të dhjetat e mbulimit të qiellit në Brezovicë, periudha 1984-1988

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Shtërpca, periudha e viteve 1960-1984.												
71	63	75	75	96	92	92	58	71	68	91	90	922
Jazhinca, periudha e viteve 1960-1984.												
87	73	80	81	111	91	81	65	72	82	97	94	1014

Tabela 9 Vlerat mesatare mujore dhe vjetore të reshjeve në mm, në Shtërpcë dhe Jazhincë

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Viti
Ditët e kthjellëta	3,8	4,3	2,5	4,5	1,5	4,4	11,8	14,6	13,2	8,4	7,4	6	82,4
Ditët e vranëta	11,8	11	13,8	8	8	5	2,6	2,6	2,6	6,8	9,8	10,6	92,6

Tabela 10 Numri mesatar i ditëve të kthjellëta dhe të vranëta në Brezovicë, periudha 1984-1988

	Dimri		Pranvera		Vera		Vjeshta		Totali	
	mm	%	mm	%	mm	%	mm	%	mm	%
Shtërpca	224	24,3	246	26,7	222	24,1	230	24,9	922	10
Jazhinca	254	25	272	26,8	237	23,4	251	24,8	1014	10

Tabela 11 Shpërndarja e sasisë vjetore të reshjeve sipas stinëve të vitit

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Jazhinca												
max.	216	162	238	144	216	270	246	192	217	205	204	172
viti	1963.	1970.	1958.	1975.	1961.	1983.	1973.	1979.	1978.	1952.	1962.	1976.
min.	26	15	21	12	16	23	10	2	10	0	14	2
viti	1982.	1982.	1953.	1952.	1969.	1982.	1954.	52/62	1958.	1969.	1978.	1972.
Shtërpca												
max.	158	118	208	136	189	310	209	168	223	177	209	161
Viti	1963.	1970.	1982.	1966.	1974.	1983.	1970.	1979.	1978.	1975.	1981.	1962.
min.	16	22	17	29	14	23	15	7	16	1	26	1
viti	1964.	1982.	1976.	1980.	1969.	1982.	68/78	1978.	1965.	1969.	1978.	1972.

Tabela 12 Lartësitë maksimale dhe minimale e reshjeve mujore në mm në Jazhincë (periudha 1950-1984) dhe në Shtërpcë (periudha 1960-1984)

	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW	C
Dimri	5	0	175	107	52	135	195	5	420
Pranvera	10	0	197	118	66	166	141	14	288
Vera	7	0	185	132	39	132	107	15	382
Vjeshta	7	0	240	76	28	111	73	3	463
Mesatare vjetore	7	0	199	108	46	136	106	10	388

Tabela 13 Frekuenca mesatare vjetore dhe sezonale e erërave, si dhe qetësia në % në Brezovicë, periudha 1984-1988

DRAFT



Harta 15 Reshjet dhe shtrirja e tyre*

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



*Harta 16 Trëndafili i erërave**

2.1.3.6. Biogjeografia dhe biodiversiteti

Rëndësia dhe kompleksiteti i florës në pjesën veriore të maleve të Sharrit dhe degëve të tij rrjedhin nga disa faktorë të rëndësishëm: kushtet historike të lidhur nga njëra anë me dukuritë glaciale në viset e larta malore, ndërsa në anën tjetër karakteri refugial i masivit, në epokën e akullt, duke marr parasysh pozitën jugore të Sharrit dhe ndikimeve të klimës mesdhetare – sub-mesdhetare: karakteri i klimës së sotme, e cila është në përgjithësi e butë – e karakterit kontinental, por thelbësisht e ndryshuar në aspektin e klimës së modifikuar mesdhetare (kryesisht regjimi i reshjeve, që nuk paraqiten në periudhën e verës) si dhe ndikimit të modifikuar të masivit të lartë malor me pozitë në juglindje të gadishullit Ballkanik: lartësi të mëdha mbidetare dhe relief kompleks; shtresa te ndryshme gjeologjike (gur gëlqeror, seprnetinë). Veçanërisht duhet veçuar ndikimin sub-mesdhetar dhe mesdhetar (ndikimi klimatik, historik, foto-

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

gjeografik), i cili është i shprehur me një grupe të florës mesdhetare dhe sub-mesdhetare të Sharrit, me specifika të vegjetacionit dhe karakterit të kushteve ekologjike.

Duke pasur parasysh pozitën jugore të masivit të Sharrit, dhe me të edhe ndikimin e klimës sub-mesdhetare (rrëzë luginës së lumit Drin dhe nëpër grykën e Kaçanikut), si dh lartësinë e madhe mbidetare të Sharrit, është i shprehur në të një numër i madh i rripave të lartë të vegjetacionit; ky fenomen, i cili gjithnjë e më shumë manifestohet duke shkuar në Ekuador, në malet e Sharrit më së miri reflektohet në prani shumë interesante, komplekse dhe e rëndësishme e vegjetacionit endemik dhe reliktin e pishave ballkanike të rrobullit (Pinus heldreichii) dhe molikës (Pinus peuce), që formojnë një brez të veçantë të lartë dhe ndërtojnë një kufi të epërm primar malor; kompleksiteti i këtij vegjetacioni është i shkaktuar nga diversiteti i substratës gjeologjike: pyjet e rrobullit dhe molikës në silikat, gurë gëlqeror dhe seperntinë.

Vegjetacioni pyjor i pjesës veriore të maleve të Sharrit dhe degëve të tij është shumë i zhvilluar, kompleks dhe i rëndësishëm, i manifestuar me disa breza të larta të vegjetacionit, para së gjithash të ndikuara nga klima dhe karakteri klimatik: brezi kserotermfil i ulët i pyjeve të bungut (Quercus pubescens, Quercus conferta, Quercus cerris, Carpinus orlentalis), brezi kalimtar termomezofil i bungut (Quercus petrea) dhe shkoza e bardhë (Carpinus betulis), brezi mesofil i ahut (pylli i pastër i ahut apo ahishte - Fagus moesiaca, dhe pylli i ahut i përzier me pisha Ables alba, në zonat e larta malore), brezi më i lartë frigofil i rrobullit (Opinus heldreichii) dhe molikës (Pinus peuce), që krijojnë kufirin e epërm malor. Në disa pjesë të këtij masivi, zona kalimtare në mes të brezit të fundit malor dhe vegjetacionit barishtor alpin e përbënë vegjetacioni barishtor alpin i pishave (Pinus mugo).

Mbi kufirin e epërm malor, dhe zonës kalimtare të pishave malore, fillon brezi kompleks, i ndryshëm dhe shume i rëndësishëm (ose më mirë të themi zona) e bashkësisë së barishtoreve të alpin/malore të larta, të tipit (të modifikuar) të livadhe alpine. Megjithatë, nën ndikimin e njeriut ky vegjetacion është shndërruar në kullota malore. Në malet e Sharrit dhe degët e tij zëne hapësirë më madhe, janë të përbërjes komplekse në vartësi të substrateve gjeologjie, kushteve orografike dhe veprimtarisë së njeriut (kryesisht shkalla e kullotjes), në kuadër të vegjetacionit të kullotave dhe vegjetacionit të shkurreve dhe kaçubave alpine.

I tërë mali i Sharrit, së bashku me degët e tij, meriton të trajtohet në formë të veçantë "mbrojtëse". Kjo vlen si për vegjetacionin në përgjithësi, ashtu edhe në eko-sistemet e veçanta (fitocenozat) dhe llojet individuale të bimëve dhe kafshëve. Natyrisht, mbrojta e maleve të Sharrit dhe botës së gjallë bimore dhe shtazore nënkupton raportin aktiv, mënyrën ekologjike të qasjes dhe krijimtarisë, që nënkupton që duhet më së pari të mendohet jo vetëm për mbrojtjen e asaj që ekziston (e asaj me vlerë që ka mbetur), por në mënyrë të barabartë edhe në ripërtëritjen dhe përmirësimin e vendit dhe vegjetacionit të saj.

Malet e Sharrit janë në atë masë të degraduara dhe në mënyrë jo të mirë të ndryshuara, që vihet në pyetje jo vetëm mbrojtja e tij por edhe restaurimi dhe përmirësimi i tij. Kjo nënkupton që në malet e Sharrit duhet të realizohen punime të mëdha në restaurimin dhe përmirësimin, në mënyrë që bota e gjallë e tij (para së gjithash vegjetacioni) të rigjenerohet dhe përmirësohet. Mbrojtja deri më sot, vlen vetëm për ato vlera që ishin, për arsye të ndryshme, deri më tani të mirëmbajtura. Kështu më me rëndësi është që malet e Sharrit të shpallen park nacional me serë rezervash rreptësishtë të mbrojtura, dhe pikërisht me këto mbetje natyrore të rëndësishme, që kishin me qenë kopsht i rëndësishëm (për hapësirat e tjera të Sharrit) i llojeve të rrezikuara, të rralla dhe relikte – endemike.

Prandaj ne mendojmë se duhet mbrojtur së pari ato komplekse të vegjetacionit në të cilat rolin edifaktorial luajnë pikërisht rrobulli dhe molika. Në anën tjetër, duke mbrojtur pyjet e rrobullit dhe molikës mbrojmë një gamë të tërë të llojeve interesante dhe të rëndësishme të bimëve dhe fushave dhe jo vetëm rrobullin dhe molikën (natyrisht, një gamë të tërë të llojeve të kafshëve). Përveç rrobullit dhe molikës, me ligj janë të mbrojtura edhe specie të shumtë të bimëve ndër të cilat me rëndësi të veçantë në kuadër të komunës së Shtërpcës janë:

- Gentiana lutea (lincura);
- Pinus mughus (pisha krivelj);
- Të gjitha speciet e lisave.

Bota shtazore e luginës së Sirinikut dhe anëve të saj periferike dhe majave, karakterizohet me numër të madh të llojeve dhe numër të vogël të ekzemplarëve të specieve të caktuara. Në këtë rajon ekzistojnë kushte të favorshme natyrore për jetën e specieve të shumta të kafshëve, por është gjithnjë ndikimi më i madh i njerëzve, me kohë, shumë negativisht ka ndikuar në zvogëlimin e popullatës së specieve të caktuara. Sipas rezultateve të hulumtimeve të deritanishme në zonën e maleve të Sharrit jetojnë dreri, dhia e egër, derri i egër, ariu, kaprolli, rrëqebulli, pastaj ujku, macja e egër, dhelpra, kunadhja gushëbardhë, kunadhja e artë, lepuri, ketri, baldosa, vidra, gjer etj. Ornitofauma e maleve të Sharrit, është gjithashtu mjaft e pasur. Në këto zona jeton gjeli i egër, sorra galica, parosi i dëborës, lauresha e brigjeve, pipiti i ujit, trishtili i zi, krahdylli, mëllenja qafore, qukapiku i zi, shqiponja e artë (e maleve), huta, skifter i drurëve dhe

DRAFT

shumë specie tjera. Ndërsa prej specieve të kafshëve rëndësi të veçantë kanë të gjitha kafshët që janë në numër të vogël si rrëqebulli (në pyjet rreth Shtërpcës dhe Prevallës), dreri malor (nga Piribregu), gjeli i egër (në Orman dhe livadhet e Cerevi), ariu etj.

Shumica e specieve të kafshëve janë me ligj të mbrojtura qoftë në tërësi (ndalimi i vrasjeve dhe kapja), qoftë pjesërisht (me leje periodike për gjuetinë e numrit të caktuar të specieve të veçanta të kafshëve). Duke pasur parasysh botën shtazore për mbajtjen ekuilibrit ekologjikë në kuadër të luginës së Sirinukut dhe rrëzë maleve të tij në periudhën e planifikuar të gjitha speciet e mbrojtura do të kontrollohen nga organizatat përgjegjëse (shoqata e gjuetarëve) dhe individët. Për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë e specieve të kafshëve, e posaçërisht të atyre të rralla për rritjen e vlerës së përgjithshme turistike të luginës së Sirinikut dhe maleve të Sharrit, Oshlakut, Koxha Ballkanit në njëzet vitet e ardhshme në mënyrë të planifikuar dhe do të rritet numri i specieve të veçanta. Aktivitetet për të rritur numrin e popullsinë të specieve të veçanta të kafshëve janë të nevojshme sepse në zonat e maleve të Sharrit deri vonë, për shembull, nuk ka pas më shumë së 135 drerë, 467dhi të egra, 32 arinj, 10 rrëqebull, 119 derra të egra. Nëse dihet që komuna e Shtërpcës gjenden në më pak së një të katërtën e shpateve veriore dhe degëve të maleve të Sharrit në kuadër të Kosovës, është e qartë se në këto rajon është një numër shumë i vogël (i rrallë) i specieve të vlefshme. Me mbrojtjen e planifikuar dhe mbarështimin e llojeve të caktuara do të ndërpritet procesi i zhdukjes së pakthyeshme të specieve të caktuara siç është ka ndodhur së voni me drerin e egër për të cilin B.S. Naumov (1965) thotë së "ekzistojnë indikacione që në territorin e Kosovës dhe dreri i egër është autokton".

Mbrojtja e florës dhe e faunës do të realizohet në mënyrë të planifikuar në bazë të programeve konkrete të mbrojtjes dhe mbarështimit të specieve të caktuara, të hartuara nga institucionet e specializuara shkencore dhe profesionale. Realizimi dhe përcjellja (kontrolli) e realizimit të këtyre programeve do të jetë nën kompetencat e institucioneve përgjegjëse të republikës si dhe kompanisë publike "Parku Nacional – Malet e Sharrit" me seli në Shtërpcë.

Plani i mbrojtjes së mjedisit në këtë plan hapësinor është projektuar në bazë të studimeve të mëposhtme kërkimore dhe programeve:

- Justifikimi i shpalljes së pjesës së Maleve të Sharrit në Kosovë si Park Kombëtar, Instituti Rajonal për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë,1982.
- Komuna e Shtërpcës – lugina e Sirinikut karakteristika e mjedisit, Botim i veçantë, libri 37 / dhe Instituti Gjeografik ,,Jovan Cvijić,, SANU, Beograd, viti 1990.
- Komuna e Shtërpcës – lugina e Sirinikut, Zhvillimi socio – ekonomik, organizimi dhe shfrytëzimi i hapësirës, Botim i veçantë, libri 37 / dhe Instituti Gjeografik ,,Jovan Cvijić,, SANU, Beograd, viti 1991.
- Programi i zhvillimi të turizmit të komunës së Shtërpcës, Instituti për arkitekturë dhe urbanizëm, Beograd, viti 1991.

Studimet e cekura dhe programi janë pjesë e bazës së dokumentacioneve që janë pjesë përbërëse e këtij Plani Zhvillimor Komunal të Shtërpcës. Përveç kësaj, janë shfrytëzuar dhe hartuar deri më tani dokumentet relevante në lidhje me komunën e Shtërpcës:

- Zgjidhja e menaxhimit të ujit Ibër-Lepenc,
- Baza e ujit në Kosovë,
- Menaxhimi i pyjeve në kuadër të komunës së Shtërpcës.

Së fundi, si baza juridike – ligjore për projektimin e planit për mbrojtjen e mjedisit në këtë Plan hapësinor janë përdorur në mënyrë të veçantë:

- Ligji për Parkun Nacional të Maleve të Sharrit (2013) dhe
- Ligji për mbrojtjen e pjesëve të larta të maleve të Sharrit, Oshljakut, Koxhës Ballkanit dhe Sharrit, si dhe për mbrojtjen e rezervateve natyrore.

DRAFT



*Harta 17 Zoodiversiteti në komunën e Shtërpcës**

Parku nacional dhe rezervatet natyrore

Kur është fjala për pjesën e larta të maleve të cekura me ligj është shpallur "Parku Nacional i Maleve të Sharrit". Me këtë ligj (2013) janë përcaktuar kufijtë e Parkut Nacional si në vijim: kufiri i Parkut Nacional në pjesën jugore dhe juglindore përputhen me kufijtë administrativ në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, dhe

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

kalon nëpër majat më të larta të maleve të Sharrit, duke filluar nga maja e Lubotenit (2.496 m), mbi Kullën (2.314 m), Livadicën (2.735 m), Jezercit (2.604 m) deri në kufi me komunën e Prizrenit. Nga këtu kufiri i Parkut Nacional është në kufi në mes të komunës së Prizrenit dhe Republikës së Maqedonisë dhe rrëzë kodrës së maleve të Sharrit mbi Bistrën (2.640 m), Maja e zezë (2.735 m), Kobilica (2.526 m) deri Kara Nikole (2.106 m). Kufiri vazhdon tutje në drejtim juglindor dhe shtrihet te kufiri në mes republikave dhe pastaj kufiri i Parkut Nacional kthehet në veriperëndim deri te lartësia 1.626 m. Kjo kuotë del në lindje mbi fshatin Manastirica dhe arrin në lartësinë 1.071 m nga ku tutje shkon te lartësia 1.310 m. Kufiri i Parkut pastaj del në veriperëndim deri tek lartësia 1.4365 (Javorovica), dhe prej aty në lindje deri tek lartësia 1.765 m (Mlake) dhe nga aty vazhdon në veriperëndim deri te lartësia 1.271 m, duke u shtrirë mbi Fshatin e Epërm (Gornje Selo), ku kufiri i Parkut në vazhdim përbëhet nga rruga Prizren – Brezovicë deri të kështjella e Mbretit në lartësi prej 1.120 m.

Nga kjo lartësi kufiri shtrihet në perëndim mbi fshatin e Virgjëreshës së Shenjtë me izohipsë prej 1.212 m deri tek lartësia 1.130 m nga ku në perëndim mbi kuotën 931 arrin në kuotën 1.507 m. Nga kjo kuotë del në verilindje deri te kuota 1.656 m duke përshirë Golem Bor nga ana perëndimore dhe arrin në veri në kuotën 1.509 m, e nga aty shtrihet në verilindjen dhe arrin në kuotën 1.598 m (Granizon) dhe vazhdon tutje në veri deri te lartësia 1.931 m dhe deri te lartësia 1.710 m, ku nga aty në veriperëndim deri te lartësia 1.456 m (Rusenica), pastaj, kufiri shtrihet deri te lartësia 841 m, duke përshirë manastirin e Teodorit të shenjtë, kufiri pastaj del në lindje në lartësi 1.498 m mbi fshatin Delovcë, dhe lëshohet në lindje te guri Bolovan, duke përfshirë Carevën dhe Bukoshën në lidhje deri në lartësi prej 1.654m nga kjo lartësi kufiri shtrihet në drejtim të juglindjes ku, përsëri hyn në komunën e Shtërpcës dhe arrin në lartësi 1.441 m mbi fshatin Bitia e Epërme, Popovcë dhe Bitia e Poshtme. Nga këtu kufiri del në jug dhe arrin në lartësi 1.276 m (Çuka), dhe pastaj kufiri lëshohet mbi Orliç deri në lartësi 1.150 m, pastaj në këndin e drejt ngritën në lartësi prej 1.516 m (Borça e Vogël), dhe pastaj del në perëndim deri në lartësi 1.440 m (Livadhet Botërore), dhe pastaj lëshohet në jug ku prenë lumin Lepenc dhe ngritët në kokën e Begut deri te izohipsa 1.600 m. Nga aty kufiri del në lindje mbi fshatin në Sevcë dhe arrin lartësinë prej 1.312 m, nga aty tutje shkon në verilindje dhe arrin lartësinë duke prerë rrugën Brezovic – Prizren 1.232 m (Burli), del në juglindje deri te lartësia 1.453 m, ku vazhdon tutje në veriperëndim deri te lartësia 1.485 m, dhe tutje në drejtim të njëjtë deri te lartësia 1.541m, dhe tutje vazhdon në lindje deri te Maja e Zezë (Crni Vrh) (1.562 m) dhe lartësi 1.712m, duke përfshirë Tupanin, Baçillen dhe del në jugperëndim deri te pika fillestare e përshkrimi të kufirit të Lubotenit ku edhe përfundon.

Kufijtë pra, në kuadër të komunës së Shtërpcës janë përshirë sipërfaqet mbi vendbanimet si Berevca, Vërbeshtica, Sevca, Jazhinca, Brezovica, Shtërpca, Gotovusha, Drajkoci, Firaja dhe Brodi. Asnjë nga vendbanimet e përmendura nuk është i përfshirë me kufirin e Parkut Nacional. Kufiri i përmendur i Parkut Nacional "Malet e Sharrit" është përcaktuar në vitin 2013. Propozimi i tij është tërësisht në përputhje me rezultatet e hulumtimit deri tek të cilat është arritur në kuadër të projektit shkencor për luginën e Sirinikut (komuna e Shtërpcës) gjatë viteve 1989 – 1991, dhe në kuadër të projektit shkencor për Luginën e Mesme (pjesa e komunës së Prizrenit), Opojës (më parë në kuadër të komunës së Dragashit) dhe Gorës (më parë në kufirin e Dragashit), realizimi i të cilit është planifikuar në periudhën e viteve 1991 – 1993. Me projektet e përmendura më parë, janë përfshirë pjesët e maleve të Sharrit. Në bazë të rezultateve të hulumtimeve të deritanishme mund të përfundohet që me Ligjin për parkun nacional Malet e Sharrit nga viti 2013 nuk janë përfshirë objekte mjaft të rëndësishme natyrore dhe lokalitetet në kuadër të komunës së Dragashit (sot Gora dhe Opoja), të cilët do të propozohen për ruajte në bazë të rezultateve të përmendura në hulumtim. Në projektin shkencor të përmendur për luginën e Sirinikut, është konstatuar se:

- Në territorin e komunës së Shtërpcës ka, përveç zonave të mbrojtura, edhe disa lokalitete dhe objekte natyrore që do të ishte e dobishme të mbrohen me ligj;
- Në kuadër të kufirit të Parkut Nacional Malet e Sharrit në luginën e Sirinikut (komuna e Shtërpcës) është e domosdoshme të vërtetohen më detajisht duke pasur parasysh që ky kufi (2013) është përcaktuar në hartë me raportin 1:100.000 (eventualisht 1:50.000) që nënkupton në hartë më pak detaje;
- Që kufiri është përcaktuar përafërsisht (prej lartësisë në lartësi apo sipas izohipsës etj.) pa marr parasysh gjendjen reale në hapësirë;
- Që në brendi të kufijve parkut Nacional nuk ishte përfshirë lokaliteti Qershia e Rexhës, i cili paraprakisht ka qenë i trajtuar me planin urbanistik gjeneral si pjesë e ndërtimit urban në rajon.

Në bazë të konstatimeve paraprake rreth këtij Plani Hapësinor të komunë së Shtërpcës miratohet, me ligj, kufiri i parkut nacional Malet e Sharrit si i përkohshëm duke potencuar nevojën që kufiri të determinohet në bazë të rezultateve të programeve shkencore të cekura si Malet e Sharrit të vitit 1993.

Duke pasur parasysh se me këtë Plani Hapësinor, Komuna e Shtërpcës, po ashtu, përkohësisht aprovon kufijtë e zonën së mbrojtur rreth Parkut Nacional Malet e Sharrit dhe atë: nga kufiri i parkut Nacional në lartësi prej 1.442 m në malin Sharrë në juglindje e deri të lartësia 1.238, në malin e njëjtë, dhe pastaj tutje në lindje të fshatit Çuturin dhe vendbanimit

Berevca dhe Shtërpca në lartësi 1.037m, pastaj lartësi 1.149 m dhe deri në lartësi 1.228 (Koka) dhe lartësi 1.531 m (Kokoshinjë) ku bashkohet me kufirin e Parkut Nacional Malet e Sharrit (paraqitja e hartës është në raport prej 1:25.000). kur është fjala për ndarjen e zonave me shkallë të ndryshme të mbrojtjes së Parkut Nacional Malet e Sharrit, me këtë Plan Hapësinor të komunës së Shtërpcës ka ndër-kritere dhe atë:

- Zona e parë e mbrojtur është zona e fenomeneve themelore natyrore me kufizime të mëdha për përdorim dhe me shkallë më të lartë të mbrojtjes. Kjo zonë përfshinë hapësirën e mjediseve burimore me interes të veçantë për zonën e Parkut Nacional Malet e Sharrit. Brenda kësaj zone janë rezervatet strikte natyrore të cilat deri tash ishin të mbrojtur me ligj (Popovo prase, livadhet e Carevës – Gini vode, liqeni i Jazhincës, liqeni i Livadicës, rezervatet e pyjeve të shtëpia e Stojkut), si dhe rezervatet të cilët me këtë Plan propozohen për mbrojtje (malet e bungut nën Oshlak, mali i ahut te Prevalla, malet e rrobullit mbi Gini vodën, mali i Molikës mbi Gini vodën, Ostrovicë).
- Zona e dyte e mbrojtur është zonë mbrojtëse e drejtuar për pushim aktiv dhe rekreacion të banorëve (pikat për piknikë, shtigjet malore shëtitëse), si dhe për zhvillimin e aktiviteteve dimërore sportive me inkurajim të zhvillimit të aktiviteteve turistike. Konkretisht në kuadër të zonës së dytë mbrojtëse në Parkun Nacional Malet e Sharrit në këtë plan hapësinor të komunës së Shtërpcës miratojmë që hapësira të shfrytëzohet për aktivitete dhe veprimet në vijim:
- Rregullimi i shtigjeve shëtitëse me pika të shënuara për pushim të turistëve;
- Pushimoret e rregulluara;
- Shtigjet skijimore të rregulluara për turistë
- Sistemi i rregulluar për transportin e turistëve (veçanërisht të skitarëve) nga pjesët e ulëta në ato më të larta të maleve të Sharrit, Oshlakut dhe maleve tjera
- Lëvizja e organizuar dhe e kontrolluar e kullotjes së kafshëve, para së gjithash nga vendbanimet që janë në zonën kadastrale në kuadër të parkut Nacional, pastaj nga vendbanimet tjera në përputhje me planin dhe programin e shfrytëzimit dhe mbrojtjes së zonave për kullotje në këtë zonë
- Pyllëzimi i organizuar dhe i kontrolluar me shfrytëzimin e masës drunore në përputhje me planet dhe programet për mbrojtje të miratuara më parë, si dhe shfrytëzimi i pyjeve
- Shfrytëzimi i organizuar dhe i kontrolluar i specieve pyjore dhe atyre bimore të kullotave me interes për ushqimin dhe mjekimin e njerëzve, do të definohet nga planet e caktuara dhe programeve për përdorim dhe mbrojte të këtyre bimëve, në pakon me ligjin për mbrojtjen e tyre
- Mbarështimi i organizuar dhe i kontrolluar i kafshëve të veçanta në përputhje me ligjin për mbrojtjen e tyre dhe me programe dhe plane përkatëse
- Në kuadër të kësaj zonë është i ndaluar ndërtimi i objekteve banesore dhe objekteve tjera për banim të përkohshëm apo përhershëm, ose për banim të turistëve gjatë qëndrimit të tyre në Parkun Nacional, si dhe i objekteve tjera për zhvillimin e veprimtarive afariste, përveç sistemit për transportin e turistëve nga vendet e ulëta në ato më të larta
- Zona e tretë mbrojtëse, apo zona për destinacione të ndryshme të shkallës së tretë mbrojtëse përfshinë hapësirat tjera të Parkut Nacional të Maleve të Sharrit, e kjo nënkupton hapësirat të cilat në kuadër të komunës së Shtërpcës karakterizohen me sipërfaqe malore dhe bimore (kryesisht për këmbësorë).

Në këtë zonë shfrytëzimi, rregullimi dhe mbrojtja janë të ngjashme me shfrytëzimin, rregullimin dhe mbrojtjen e hapësirës në kuadër të zonës tjetër, pasi që në zonën e tretë është lejuar si në vijim:

- Shfrytëzimi i organizuar dhe i kontrolluar i tokës bujqësore në përputhje me nevojat e banorëve të cilët kanë parcela në këtë zonë të mbrojtur, në përputhje me planet dhe programet mbrojtëse për shfrytëzimin e tokës në kuadër të Parkut Nacional
- Pyllëzimi i organizuar dhe i kontrolluar me shfrytëzimin e masës drunore në përputhje me programet për mbrojtje në këtë zonë, si dhe në përputhje me nevojat e arsyeshme të banorëve të komunës së Shtërpcës me masën drunore, si lëndë e parë për përpunim dhe ngrohje
- Gjuetia e organizuar dhe e kontrolluar për specie të veçanta shtazore dhe atë në hapësirat ku nuk është e paraparë lëvizja e turistëve.
- Shfrytëzimi i planifikuar i lokacioneve të veçanta dhe i zonave për ndërtimin e objekteve për nevojat e zhvillimit të turizmit (hotele, apartamente, shtëpi për vikend qe jepen me qira për turistët, restorante, objekte sportive dhe objekte tjera përcjellëse duke përfshirë rrugët e asfaltuara, trafo-stacionet dhe të ngjashme)

Në zonën e tretë mbrojtëse miratojmë zhvillimin intensiv të turizmit dhe rekreacionit në lokacionet: Qershia e Rexhës dhe Shtëpia e Stojkut deri në vitin 2010, si dhe livadhi i Palenskës pas asaj. Për lokalitetet dhe zonat e përmendura me (këtë Plan hapësinor) përcaktohen nevojat për hartimin e planeve urbanistike në detaje duke respektuar Ligjin për Parkun Nacional, Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe Planin hapësinor të komunës së Shtërpcës.

Përfundimisht, në zonën mbrojtëse rreth Parkut Nacional shfrytëzimi, rregullimi dhe mbrojtja e hapësirës në periudhën e planifikuar do të jetë në përputhje me vendimet dhe programet e planit që kanë të bëjnë me sipërfaqen totale të Parkut Nacional- Malet e Sharrit duke pasur parasysh të gjitha nevojat e banorëve për zhvillim, si dhe faktit së në zonën mbrojtëse gjenden vendbanimet Shtërpca, Berevca, Brezovica, Vërbeshtica, Jazhinca dhe Sevca, dhe pjesët e vendbanimeve të Gotovushës, Drajkocit, Firajës dhe Brodit.

Për vendbanimet e përmendura në kuadër të zonës së mbrojtur rreth Parkut Nacional Malet e Sharrit, miratohet nevoja për drejtim të planifikuar të zhvillimit të tyre dhe atë në bazë të:

- Planit të përgjithshëm urbanistik për tërësinë hapësinore të Shtërpcës – Berevcës – Brezovicës – Jazhincë
- Rregullimi urbanistik i bazës së vendbanimit Sevcë
- Rregullimi urbanistik i bazës së vendbanimit Vërbeshticë.

Këto drejtime të planeve janë në pajtim me rekomandimet nga dokumenti i "Justifikimit publik të shpalljes së një pjese të maleve të Sharrit në Kosovë si Park Nacional" nga viti 1982, me të cilin theksohet nevojat që "Planet zhvillimore të Parkut të ardhshëm Nacional- Malet e Sharrit, në drejtim të vendbanimeve brenda kufijve të parkut, me ç'rast duhet të merren parasysh nevojat e zhvillimit të këtyre vendbanimeve, në veçanti nevoja për zgjerimin e tyre, rregullimin si dhe kompletimin me pajisje të përshtatshme urbane"

Kur është fjala për veprimtaritë ekonomikë, në të njëjtin dokument ceket se në kuadër të parkut nacional si dhe në zonën mbrojtëse rreth parkut, mundet /edhe më tutje të zhvillohen (në përputhje me nevojat e banorëve) bujqësia, pylltaria, ekonomia e vogël, turizmi dhe industria, por "kapacitetet industriale, me rregullore nuk duhet të vendosen në kufijtë e Parkut Nacional. Përjashtime bëjnë disa kapacitete më të vogla industriale në kuadër të ekonomive të vogla që nuk e ndotin ambientin, dhe që me praninë e tyre nuk do të ndikojnë në arritjen e qëllimeve themelore të Parkut Nacional Malet e Sharrit".

Me këtë Plan hapësinor komuna e Shtërpcës nuk planifikon ndërtimin e asnjë objekti industrial brenda kufijve të Parkut Nacional. Planifikon vetëm mbajtjen e kapaciteteve më të vogla industriale në vendbanimin e Shtërpcës dhe ndërtimin e objekteve të reja të industrisë e cila nuk emeton ndotjen e ujit, ajrit dhe format tjera të ndotjes. Gjithashtu, në pjesën e Parkut Nacional planifikohet të ndërtohet qendra e re skijimore që është e rëndësisë së madhe jo vetëm për zhvillimin ekonomik të komunës por edhe të rajonit (më në detaje është përshkuar në pjesën e planifikimit të këtij dokumenti).

Kur është fjala për rrugën regjionale Doganaj – Shtërpcë – Prevallë – Prizren, me këtë Plan miratohet edhe ekzistimi i saj si dhe modernizimi në periudhën e planifikuar deri në vitin 2025.

Së fundmi, si përfundim, theksohet që ky Plan Zhvillimor i komunës së Shtërpcës i cili në periudhën e planifikuar do të punojë për nevojat e konstituimit, organizmit dhe funksionimit të Parkut Nacional- Malet e Sharrit. Në këtë aspekt me Planin zhvillimor të komunës së Shtërpcës në mënyrë të planifikuar definohet mbrojtja, rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës vetëm në pjesën lindore të Parkut Nacional, ndërsa në një apo dy vitet e ardhshme, "do të jetë e nevojshme të hartohet plani zhvillimor i Planit hapësinor për tërë territorin e ardhshëm të Parkut Nacional". Në kuadër të hartimit të Planit zhvillimor të komunës së Shtërpcës, si dhe Programit për zhvillimin e turizmit në këtë komunë, pastaj edhe hartimi i Planit të përgjithshëm urbanistik Shtërpcë – Berevcë – Brezovicë – Jazhincë dhe i planeve detajore për lokacionet turistike si Qershia e Rexhës dhe Shtëpia e Stojkut, subjektet e shfrytëzimit të hapësirës dhe veprimtarive natyrore në sipërfaqen e Parkut Nacional dhe zonat e tij të mbrojtura duhet të angazhohen me qëllim të harmonizimit të qëllimeve dhe interesave për shfrytëzimin e ardhshëm, rregullimin dhe mbrojtjen e hapësirës së Parkut Nacional.

Përveç Parkut Nacional me ligj janë të mbrojtura edhe pjesët e komunës së Shtërpcës dhe atë në nivelin strikt të rezervateve natyrore:

- Popovo prase në Oshlak
- Livadhet e Carevës – Gini vodë, nën Jezerc në Sharr dhe atë nga Prevalla deri tek liqeni i Jazhincës
- Pylli Pinus peuce – Rododendron ferrugineum te Shtëpia e Stojkut
- Pylli Pinus peuce – Acer ledreichii te Shtëpia e Stojkut
- Liqeni i Jazhincës
- Liqeni i Livadicës

Karakteristikat themelore të këtyre rezervave natyrore do i përmendim në vijim të tekstit.

Pjesa lindore e Oshlakut – kompleksi "Popovo prase" mbi Prevallën

Në shpatet jugore dhe juglindore (lindore) të Popovo prases (pjesa e fundit lindore e Oshlakut gjenden malet/pyjet e rrobullit që janë të ruajtura mirë dhe mjaftë të shtrira (Pinus – heldelchii), me një përbërje të ndryshme. Në shpatet e ekspozuara në jug janë bashkësitë përbërëse Seslerio – Pinetum heldrelchii M. Janket dhe R. Bog., ndërsa në shpatet e ekspozuara në lindje, pak të lagështa dhe nën hije, përbërjet e bashkësisë Luzulo maximae – Pinetum heldrelchii M. Jank. Prandaj, është e qartë se bëhet fjalë për një kompleks pyjor ekologjik, fitocenologjik (vegjetativ) dhe shumë interesant.

Vendi i zonave të djegura ekzistuese të malit të rrobullit (shpatat në lindje) tregojnë procesin e vazhdimësisë për të ripërtërirë pyjet e rrobullit, kështu që edhe ky vend i zonave të djegura është një vend me interes të veçantë shkencor dhe praktik (në lidhje me procesin natyrorë të ripërtëritjes së komplekseve pyjore të shkatërruara nga zjarri, ku ky është një shembull interesant tokave të djegura në pyjet e rrobullit).

Diverziteti vegjetativ – i florës së këtij kompleksi shihet nga përbërja floristike e një mali të rrobullit të bashkësisë Seslerio – Pinetum heldreishi që gjendet menjëherë mbi Prevallën, në bazë të këtyre regjistrimeve fito-cenologjike:

- Oshlak (malet e Sharrit)
- Lartësia mbidetare 1.700 m
- Ekspozimi jugor
- Baza gjeologjike e gurit gëlqeror.
- Pjerrtësia e terrenit 30%.
- Pylli i rrobullit (Seslerio – Pinetum heldreishii), i dendur, përbërja 80%, gjatësia e lisit deri në 20 m, trashësia mesatare 40 cm – në katin e parë; në katin e dytë përbërja është 60%, lartësia 10 m. Trashësia mesatare 20 cm.
- Kati i lisave
- Pinus heldrelshii 4.4
- Kati i II i lisave
- Pinus heldreishii 3.3
- Kati i III i shkurreve (lartësia deri 3 m, përbërja rreth 40%)
- Pinus heldreishii 2.2
- Juniperus intermedia 1.1
- Kati i IV i bimëve tokësore (mbulesa 90% - shumë e bujshme e pajisur me një florë mjaft të pasur) me rreth katër-dhjetë specie.

Duke pasur parasysh afërsinë e rrugës automobilistike (që kalon nëpër Prevallë, duke shkuar për Prizren), të gjitha pyjet e rrobullit mund të vizitohen lehtë (ekskursione në këmbë, ekskursione profesionale, turistike), në mënyrë që ky rezervat të ketë një vlerë turistike dhe edukative. Shumica e pyjeve të rrobullit në Kosovë (dhe po ashtu të molikës), është vështirë të arrihen, kështu që qasja e lehtë tek pyjet e rrobullit në lokacionin Popovo prase paraqet një kualitet dhe lehtësi të madhe.

Kompleksi i pyjeve në malet e Sharrit në lindje të Prevallës, nga vendi "Gini vodë" dhe livadhet e Mbretit, dhe deri te vargmali kryesor i maleve të Sharrit (duke përfshirë liqenin e Jezercit)

Ky territor për nga bashkësitë e ndryshme pyjore paraqet, nga aspekti ekologjik, vegjetativ dhe fitocenologjik, një nga pjesët më interesante dhe më të rëndësishme të Maleve të Sharrit. Në të njëjtën kohë është një nga rezervatet më interesante në këto male.

Duhet theksuar që kjo është pjesa e vetme e maleve të Sharrit (në kuptim të ngushtë), pa degët e tij, ku vegjetacioni fillestar i malit, edhe pse në brez të ngushtë, është ruajtur deri tek kufiri natyral i pyllit. Po ashtu, është një pjesë unike në të cilën është paraqitur një numër i madh i bashkësive. Përveç kompleksit të pyjeve të ahut, që gjithashtu janë prezentë dhe mjaft mirë të zhvilluara në tërë malet e Sharrit një interes të veçantë përbëjnë edhe pyjet e përziera të pishave. Askund më në malet e Sharrit dhe në degët e tij nuk ka aq shumë pyje të përziera të pishave, në përbërjen e të cilave marrin pjese tri specie alpine/malore të tyre si: Pinus: Pinus helderichii, P. Peuce i P. Silvestris. Është fat që në këtë pjesë përveç silikatit paraqitet edhe guri gëlqeror, që ka mundësuar të formohen përbërjet e rrobullit të llojit kacifil (Pinetum heldreichii calcicolum M. Jank)., të përfaqësuara më bashkësi Seslerio – Pinetum heldreichii M. Jank. Et R. Bog. Në fakt kjo lëvizje fillon me një masiv gëlqeror, diku në nivelin e rrugës nga Prevalla në Brezovicë, dhe atë në masivin, sidomos në shpatet e eksponuara në jug, ku është zhvilluar vegjetacioni i rrobullit të llojit kacifil

(bashkësitë e përmendura). Në gurët gëlqeror, në lartësitë më të mëdha mbidetare, vazhdon silikati; kufiri i gurit gëlqeror është i rrethuar me masën e shkëmbinjve të silikatit. Përroi që rrjedh në drejtim të këtij masivi humbet duke u zhytur në kalimet nga silikati në terrenin e gurëve gëlqeror (nga aty në "Gini vodë").

Prezenca e ujit sipërfaqësor, menjëherë nën kokën e gurit gëlqeror, ka shkaktuar krijimin pak a shumë të terrenit moçalik, mbi të cilin është zhvilluar pylli i rrobullit i bashkësisë Ajugo – Pinetum peucis M. Janket R. Bog. (që në fakt edhe është bashkësia ekstreme hidrofile e pyjeve të rrobullit). Ky variant i pyjeve të lagështa të rrobullit të tipit Ajugo – Pinetum peucis geumetnosum coccinei, meriton vëmendje më të veçantë. Por jo vetëm kaq, këtu në bazë të ekspozimit jugor dhe terrenit i hapur, është i përfaqësuar rrobulli (Pinus heldreichii), dhe atë me numër të madh, i zhvilluar mirë dhe me lisa të gjatë, pa marrë parasysh sipërfaqen e lagësht të silikatit. Kjo ka rëndësi të veçantë ekologjike në lidhje me të kuptuarit e ekologjisë dhe biologjisë së kësaj specie shumë interesante të pishës së lartë endemiko-ballkanike të rrobullit, të moshës terciare.

Megjithatë, duke pasur parasysh terrenin e hapur dhe tokën moçalike, këtu është prezentë edhe pisha e bardhë (Opinus silvestris), e cila së bashku me rrobullin dhe molikën ndërtojnë një bashkësi mjaft interesante të pyjeve të përziera (tipa Pino – Pinetum peucis mixtum M. Jank).

Këto pyje të përziera hidrofile molike – rrobulli dhe pisha e bardhë zënë një sipërfaqe relativisht të vogël. Për dallim nga ato, bashkësia tipike Ajugo – Pinetum piucis shtrihet deri në pjesën e epërme të kufirit malor, në drejtim të liqenit të Jazhincës.

Kështu, përveç brezit të ngushtë, pak a shumë kompakt të pyjeve me pisha (kryesisht rrobullit dhe molikës, dhe pjesërisht pishës së bardhë), me bashkësi të ndryshme dhe nën-bashkësi në gurët gëlqeror dhe silikate, nga koka gëlqerore në afërsi të rrugës dhe deri te kufiri i epërm i pyllit, në këtë rezervat kompleks duhet të përfshihen edhe kompleksi i pyjeve të ahut (në pjesën më të ulët, nën pyjet e rrobullit dhe molikës: dhe ato janë përbërjet e bashkësisë Fagetum montanum silicicolum në disa vende ndoshta kemi edhe mbetje të bashkësisë Abieto – Fagetum).

Dy komplekse të vogla të pyjeve të rrobullit tek shtëpia e Stojkut

Kompleksi më i vogël i pyjeve të rrobullit tek shtëpia e Stojkut, në shpatet veriore të maleve të Sharrit, përballë Brezovicës, paraqet në fakt bashkësinë Rhododendro – Pinetum peucis M. Jank R. Bog. Për shumë çka, kjo bashkësi është e një karakteri të jashtëzakonshëm, sidomos pasi që bëhet fjalë për kombinim fitocenologjik të dy llojeve relikte dhe endemike: Pinus peuce i Rhododendron ferruginea. Lloji i fundit është për nga interesi mjaft i veçantë, për shkak të vargmaleve të kësaj specie në Evropë për shkak të pranisë mjaftë të rrallë të tij ashtu si dhe vetë llojet e Rhododendron ferruginea, në gadishullin Ballkanik.

Liqeni i Jazhincës

Liqeni i Jazhincës gjendet në 2.128 metra të lartësisë absolute dhe atë në rrethin e burimit të Lumit të Thatë (Suva Reka). Në nivelin më të lartë të ujit thellësia e liqenit është 11 metra, gjatësia rreth 150 metra dhe gjerësia rreth 87 metra. Vija e rregullt është e gjatë 500 metra, sipërfaqja deri në 10.620 m². Vëllimi i liqenit është rreth 45.100 m³, ndërsa temperatura e ujit gjatë verës është rreth 1º C. Tejdukshmëria e liqenit është e plotë.

Liqeni i Livadicës

Ky është edhe një objekt hidrologjik, gjeo-morfologjik dhe glacial i formuar në pirgun pas shkrirjes së akullnajës,. I gjatë është 220 metra, ndërsa i gjerë 125 metra. Gjatësia e bregut është 683 metra, ndërsa thellësia më e madhe është 6,7 metra. Sipërfaqja e liqenit është 20.580 m², dhe vëllimi 74.715 m³. Uji është i kthjellët, i pastër dhe me ngjyrë të gjelbër dhe të kaltër. Në kohën e nivelit më të madh të liqenit uji rrjedh mbi sipërfaqe. Liqeni gjendet në 2.173 metra të lartësisë absolute dhe i përket burimit të lumit të Kalugjerës. Përveç vlerave natyrore të cekura dhe me ligj të mbrojtura në malet e Sharrit ekzistojnë edhe disa lokacione tjera të vlefshme me ç'rast mbrojtja e të cilave propozohet edhe me këtë plan. Kështu, në zonën e gjerë të rezervateve natyrore "Popovo prase" dhe "Gini vodë – livadhet e Mbretit" gjenden, gjithashtu, pyje mjaft të vlefshme, të cilat kur të mbrohen, bashkë me ato që janë përmendur më herët do të paraqisnin kompleksin e përgjithshëm natyror në pjesën jugperëndimore të komunës së Shtërpcës. Duhet cekur regjistrimet fito-cenologjike të disa përbërjeve të rëndësishme të pyjeve:

Pylli i ahut (Fegetum montanum silicicolum), te Prevalla

- Lartësia mbidetare 1.500 m.
- Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
- Ekspozimi veriperëndimor
- Pjerrtësia e terrenit 15 shkallë
- Pyll i dendur i ahut
- Kati i I, lisat (përbërja 90%, lartësia e lisit nga 25 deri 30 m, trashësia mesatare 40 deri 50 cm)

- Fagus moesiaca 3.3
- Kati II, lisat (lartësia 10 deri 15 m, trashësia mesatare e lisit 10 deri 20 cm).
- Fagus moesiaca 2.2
- Kati i III, bimët sipërfaqësore (mbulimi i terrenit 50%) me 26 specie.

Pylli i rrobullit (ky variant me Lonicera hxlosteum dhe Carum grecum) vargu gëlqeror – mbi luginën e lokacionit "Gini vode".

- Lartësia mbidetare 1.700 m.
- Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
- Ekspozimi juglindor
- Pjerrtësia e terrenit 45 shkallë.
- Një dendësi relativisht e dendur e pyllit të rrobullit
- Kati i I, lisat (përbërja 80%, lartësia e lisit 20 m, trashësia mesatare e lisit 35 cm).
- Pinus heldrelshii 4.4
- Kati i II, shkurret (përbërja 40%, lartësia deri 3m).
- Pinus heldreichii 2.2
- Juniperus intermedia 1.1
- Kati III , bimët sipërfaqësore (mbulimi i terrenit 60%) me 22 specie.

Pylli i molikës (Ajugo – Pinetum pucis), në vargun mbi lokacionin "Gini vodë" mbi pyllin e mëparshëm të rrobullit

- Lartësia mbidetare 1.800 m.
- Sipërfaqja gjeologjike nga silikati
- Ekspozimi veriperëndimor
- Pjerrtësia e terrenit 25 shkallë.
- Pyll i dendur i molikës
- Kati i I, lisat (përbërja 90%, lartësia deri 20 m, trashësia 30 cm.)
- Kati i II, kaçubet (përbërja rreth 30%, lartësia deri 2 m)
- Juniperus intermedia +
- Pinus peuce +
- Kati i III, bimët sipërfaqësore (përbërja 70%) me 19 specie.

Përveç zonës së Prevallës, edhe Ostrovica ka nevojë për vëmendje, zona e sipërme malore mbi pyjet e ahut deri te majat më të larta.

Masivi i Ostrovicës është veçanërisht interesant sepse bëhet fjalë për sipërfaqe gjeologjike nga serpentina. Për këtë duhet theksuar që sipërfaqja gjeologjike nga terpentina shtrihet deri në majat më të larta duke i ndërtuar, kështu që është ofruar edhe mundësia që në viset e larta malore të zhvillohet vegjetacioni në serpentinë. Me fjalë tjera, në serpentinë është i zhvilluar vegjetacioni i pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii serpentini colum M. Jank.) që i përkasin bashkësisë Ptilotricho – Bruckenthallo – Pinetum heldreichii M. Jank. Pyjet e rrobullit në serpentinë janë një fenomen i rëndësisë së veçantë, pyjet e rrobullit në serpentinë në Ostrovicë janë rast i veçantë i vegjetacionit jo vetëm në komunën e Shtërpcës por edhe në tërë gadishullin Ballkanik. Prandaj, është e qartë se këtu bëhet fjalë për ndarjen e rezervateve të mbrojtura rreptësisht. Mirëpo, këtu nuk është fjala vetëm për pyjet e rrobullit. Në serpentinën e Ostrovicës, në pjesët më të larta të saj deri tek majat e larta gjendet vegjetacioni i viseve të larta malore të pishës krivula (Pinus mugo), e cila i përket Ptilotricho – Bruckenthallo – Pinetum mughi M. Jank, et R. Bog (ose bashkësia e grupit Pinetum mughi serpentinicolum M. Jank.). Sipas hulumtimeve të deritanishme do të ishte e nevojshme të mbrohen këto bashkësi të pishave, që nga aspekti shkencor dhe praktik janë shumë të rëndësishme. Domethënë, edhe pisha e llojit krivula në bashkësinë e serpentinës paraqet një raritet në gadishullin Ballkanik. Që të arrihet efekti i plotë, këtu do të duhet të mbrohet i tërë kompleksi i bashkësisë serpentine të rrobullit, bashkësitë serpentine të krivulave, si dhe sipërfaqet e kullotave në mes tyre. Në këtë mënyrë, do të kishim nën mbrojtje një kompleks të tërë të serpentinës tek vegjetacioni me shumë pak lloje të bashkësive malore dhe të viseve të larta malore (kullotat dhe krivulat), me përbërje të ndryshme dhe të rëndësishme të fitocenolozës. Me mbrojtjen e këtij vegjetacioni kompleks do të mbronin një sërë të llojeve serpentine dhe llojeve tjera të rëndësishme, që është shumë me rëndësi. Përveç rezervateve të propozuara më parë, propozohet që me ligj të mbrohet druri i dushkut Quercus robur në afërsi të vendbanimit Izhancë.

DRAFT

Për tërë sipërfaqen e luginës së Sirinukut është karakteristike se si përgjatë Lepencit , ashtu edhe gjatë degës së Lepencit në luginë shfaqet verri (Alnus glutinosa) dhe shelgu (Salix spp.). Lisi i bungut nuk është hasur në këtë vend. Është një surprizë e madhe që në rrjedhën e poshtme të lumit të Izhancës në lartësi prej 710 metra gjendet lisi i bungut (Quercus robur). Ai gjendet në anën e majtë, i ngritur një metër përmbi ose në nivelin e ulët të ujit. Karakteristikat e vendeve ku ndodhet lisi i mbetur i bungut janë shumë më larg prej atyre që mund të quhen normale për paraqitjen e këtij lloji. Bregu dhe shtrati i lumit është shkëmbor, plot me guralecë me mungesë të materialit të imët. Në bregun e lumit mbështeten anët shkëmbore të pjerrëta të luginës së lumit. Aluviale të rrafshëta nuk ka. Është e dukshme lidhja e drejtpërdrejtë e sistemit të rrënjëve të bungut me bazën gëlqerore. Lisi i bungut është pothuajse i lidhur drejtpërdrejt në hapësirë me bashkësinë e shkozës së zezë dhe bungut, që rritet në anën jugperëndimore të Shtumanit (974 m), vargu i të cilit e përbënë pjesën e pellgut ujëmbledhës në anën e majtë të pellgut të lumit të Izhancës. Nuk është e njohur që deri më sot është vërtetuar pjesëmarrja e lisit të bungut në këtë sipërfaqe të mjedisit termofil. Lisi është i vjetër, i mbështjellë me zgavrën e djegur, me diametër rreth 80 cm, dhe mjaft i frytshëm.

Ne mendojmë se kjo mbetje tregon prezencën e pyjeve të dushkut në luginën e Sirinikut, fillimisht si një vlerë shkencore dhe tregues për karakterin e vegjetacionit të dikurshëm. Prandaj ne jemi të lirë që t'u propozojmë organeve të komunës se Shtërpcës që me bashkëpunim me menaxhmentin e pyjeve të organizojmë mbrojtjen e këtij druri.

Së fundmi, në hulumtimet shkencore të luginës së Sirinikut , u gjet së në luginën lindore të Oshlakut gjendet lokaliteti me hapje të shpellave që mendohet se janë hyrjet për në shpellë, vlera e së cilës do të përcaktohet pas disa detajeve speleologjike, hidrologjike dhe hulumtimeve tjera të ngjashme. Është e rëndësishme që ky objekt natyror të mbrohet sa më parë deri tek tretmani i tij në mënyrë të plotë dhe në mënyrë shkencore.

DRAFT



*Harta 18 Vegjetacioni në komunën e Shtërpcës**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



*Harta 19 Trashëgimia natyrore e komunës së Shtërpcës**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

2.2. DEMOGRAFIA

2.2.1. Zhvillimi Demografik

Popullsia dhe karakteristikat e saj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimet e gjithmbarshme të territorit. Bazuar në dinamikën e popullsisë sipas vendbanimeve dhe strukturave demografike, është e mundur edhe planifikimi hapësinor i territorit. Kosova dhe Komuna e Shtërpcë shikuar në retrospektivë kishin një trend pozitiv të dinamikës së popullsisë mirëpo ky trend pozitiv në këto dy dekadat e fundit ka filluar të ketë ndryshime, të cilat çojnë në zvogëlimin e rritjes së popullsisë.

Popullata në Kosovë dhe posaçërisht në Shtërpcë kanë përjetuar dinamika të larta për vetë zhvillimet historike në të cilat ka kaluar vendi. Pranohet që ritmet e rritjes natyrale të popullatës janë ende më të lartat në rajon. Por, në Komunën e Shtërpcës kemi pasur rritje natyrale të popullsisë prej vitit 1198 deri 1991 sipas të dhënave të ASK-së, por me regjistrimin e popullsisë në vitin 2011 kemi një rënie të lartë të numrit të popullsisë.

Sipas të dhënave nga ASK-ja, Komuna e Shtërpcës ka shënuar një rritje të popullsisë që nga viti 1198 ku kishte 9573 banorë, deri në vitin 1991 ku kishte 12712 banorë. Mirëpo, sipas regjistrimit të vitit 2011, kjo komunë kishte një rënie të konsiderueshme të popullsisë me 6949 banorë, që do të thotë se për 20 vjet ka rënie të numrit të popullsisë për 5763 banorë ose për 45.33%.

Beroc	336
Biti e Epërme	574
Biti e Poshtme	735
Brezovicë	70
Brod	2551
Drekoc	119
Firajë	1677
Gotovushë	504
Izhanc	102
Jazhincë	188
Kashtanjevë	136
Sevcë	202
Sushicë	87
Shtërpcë	2440
Vërbeshticë	615
Viqë	435
SHTËRPCE	10771

Tabela 14 Numri i popullsisë sipas viteve të regjistrimeve

Kjo situatë na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me zvogëlim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Komuna e Shtërpcës renditet në mesin e komunave me numrin më të vogël të popullsisë në Kosovë. Prandaj të dhënat e regjistrimit të fundit në Komunën e Shtërpcës tregojnë se kemi pas një rënie të theksuar të popullsisë duke u bazuar ne të dhënat zyrtare nga ASK-ja. Gjersa rezultatet preliminare të regjistrimit të popullsisë të AKS-së të vitit 2024, Komuna e Shtërpcës ka gjithsejtë 10,771 banorë rezident. Komuna është end e në pritje të rezultateve publike zyrtare kuptuar numrin e saktë të banorëve rezident.

Lindjet: sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK-së, numri i lindjeve të gjalla (të regjistruara) për vitin 2011 ishte gjithsej 68 lindje të gjalla, prej tyre me vendbanim të përhershëm të nënës në Kosovë (rezidentë). Ky numër i lindjeve do të merret si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë.

Lindjet	**Vdekjet**	**Shtimi natyror**
68	19	49

Tabela 15 Lindjet ne periudha të ndryshme sipas (ASK 2021)

Ajo që e bën kompleks diskutimin mbi demografinë është larmia e fenomeneve demografike me të cilat është përballur e gjithë Kosova. Ajo është përballur që në vitet '70 me fenomenin e emigracionit, por duke pasur gjithmonë asetin e një rritjeje të konsiderueshme natyrale të popullsisë.

2.2.2. Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të veçantë për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që

kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate. Në aspektin demografik, kjo strukturë ka rëndësi për riprodhimin biologjik, sepse krijohet kontingjenti fertil, ndërsa në aspektin socio-ekonomik, ndikon në krijimin e kontingjentit të punës. Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës ka rëndësi edhe për strukturat tjera demografike, për faktin se strukturat e popullsisë sipas veçorive të ndryshme socio-ekonomike (sipas aktivitetit, veprimtarisë, profesionit, arsimit etj.) hulumtohen njëkohësisht edhe sipas gjinisë dhe moshës.

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 14 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës edhe ky është një indikator mjaftë i rëndësishëm, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.

	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-55	56-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80-84	85+	Gjithsej
Femra	235	256	289	336	348	306	315	344	348	345	349	354	317	353	313	178	102	53	5141
Meshkuj	311	303	351	384	401	362	397	407	365	412	357	351	339	347	260	146	97	40	5630
Gjithsej	546	559	640	720	749	668	712	751	713	757	706	705	656	700	573	324	199	93	10771

Tabela 16 Popullsia në Komunën e Shtërpcës sipas grup – moshës dhe gjinisë, 2024

Në bazë të shënimeve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 vërehet se kontingjentin më të madh të popullsisë e përbëjnë grup mosha 0 deri 14 vjeçare (25.48%). Grup mosha e re, deri 15-64 vjeçare përbën rreth 64.61% të popullsisë, derisa grup mosha mbi 65 vjeçare përbën 9.90% të popullsisë së Shtërpcës.



Grafiku 6 Grup-moshat e popullsisë (ASK-2024)

Nga grafiku i sipërm mund të konstatojmë se grup mosha 0-29 vjet e përbën popullsinë e Komunës së Shtërpcës me 36%, grup mosha 30-64 vjet me 22% dhe 65+ me 9%. Struktura gjinore e popullsisë në Komunën e Shtërpcës ka karakteristikat e veta me dominim të lehtë të gjinisë mashkullore.

Edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja, konkludohet se Komuna e Shtërpcës ka popullsi kryesisht të re.



Grafiku; 3 Popullsisë ne Komunën e Shtërpcës sipas gjinisë (ASK-2024)

Nga grafiku, shihet se ekziston një rebalanc i vogël gjinor në popullsinë e Komunës së Shtërpcës, ku popullsia mashkullore dominon me 52% në krahasim me popullsinë femërore që ka 48% të popullsisë së gjithmbarshme. Struktura e krijuar e moshës dhe gjinisë dhe ndryshimet e tyre gjatë kohës krijojnë efekte të reja socio-ekonomike dhe demografike. Këto dy struktura vazhdimisht ndikojnë në krijimin e kontingjenteve të rëndësishme, siç janë: kontingjenti i punës, fertil, shkollor, i moshuar etj.

2.2.3. Dendësia e popullsisë

Agjencia e Statistikave të Kosovës në vjetarin statistikor të vitit 2021 ka bërë një vlerësim edhe të shpërndarjes së popullsisë në territor. Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë, dhe e kundërta, në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël. Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe, siç janë: Brod (1680 b/km2), Biti e Poshtme (383b/km2), Drekoc (106 b/km²) etj. Dendësia mesatare e popullsisë bazuar në sipërfaqen ekzistuese të vendbanimeve rurale dhe zonës urbane është 4.04 banorë për hektarë, ku në zonën urbane është 4.34 banorë për hektarë, gjersa në zonën rurale është 4 banorë për hektarë.



Harta 1 Dendësia e popullsi

2.2.4. Niveli i arsimimit

Në Komunën e Shtërpcës pjesa më e madhe e popullsisë e kanë të përfunduar shkollën e mesme të lartë. iveli i popullsisë të cilët nuk dinë shkrim e lexim është i vogël, po ashtu edhe niveli i të diplomuarve pasuniversitar është në nivel të ulët.

	Para - shkollor	Shkolla fillore (klasa 1-5)	E mesme e ulët (klasa 6 - 9)	E mesme e lartë (klasa 10-13)	Niveli Bachelor	Niveli Master	Doktora-tura/ Dr	Gjithsej
Gjithsej	19	497	572	438	207	97	3	1 833
Meshkuj	17	263	313	225	85	37	2	70
Femra	2	234	259	213	122	60	1	891

Tabela 17 Numri i banorëve sipas nivelit të edukimit (ASK-2024)

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024)

2.3. EKONOMIA

2.3.1. Ekonomitë familjare

Komuna e Shtërpcës ka 1,485 ekonomi familjare; 341 në zonën urbane dhe 1,144 në atë rurale. Këto të dhëna i gjejmë në statistikat nga regjistrimi i fundit i popullsisë së Kosovës, i bërë në vitin 2011, dhe ky numër është shumë i vogël, krahasuar me numrin e banorëve, ndonëse Komuna ka numër të vogël të tyre, i cili është 6,503.

Familjet kryesisht janë të tipit të ngushtë të familjes bërthamë; çiftit bashkëshortor me fëmijë, me ndryshime të vogla në qytet dhe në fshatra. Mesatarja e numrit të personave për ekonomi familjare në total është 4.7.

Vendbanimi	Nr. i ekonomive familjare	Mesatarja e numrit të personave për ekonomi familjare
Urban	314	3.7
Rural	1,144	5
Totali	**1,485**	**4.7**

Tabela 18 Numri i ekonomive familjare në Komunën e Shtërpcës, ASK, 2011

2.3.2. Bizneset, ndërmarrjet dhe ambienti i biznesit

Ekonomia e komunës së Shtërpcës bazohet kryesisht në turizëm, ndërtimtari dhe bujqësi (kryesisht prodhim i mjedrës), e që janë biznese të vogla tregtare.

Në vitin 2023 numri i ndërmarrjeve aktive në Shtërpcë ishte 733, ku numrin më të madh e kishte sektori i ndërtimtarisë dhe akomodimit.

Sektori	Nr. i ndërmarrjeve	%
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	56	7%
B - Industria nxjerrëse	-	-
C - Industria përpunuese	66	9%
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-	-
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	-	-
F - Ndërtimtaria	86	11%
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	61	8%
H - Transporti dhe magazinimi	27	8%
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	80	11%
J - Informimi dhe komunikimi	40	5%
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-	-
L - Aktivitetet e patundshmërisë	40	5%
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	54	7%
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	51	7%
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	4	1%
P - Arsimi	21	2%
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	20	2%
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	16	2%
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	40	5%
T - Person Fizik	8	1%
U – Mungon aktiviteti	63	9%
Total	**733**	**100%**

Tabela 19 Numri i ndërmarrjeve në Shtërpcë, 2023

Për numrin e ndërmarrjeve sipas vendbanimeve në Komunën e Shtërpcës nuk ka të dhëna. Ndërsa sipas llojit të pronësisë, nga të dhënat e ATK-së shihet se numri i më i madh i bizneseve sipas llojit janë sh.p.k., biznese individuale, etj.

Lloji i biznesit	2023	%
Biznes individual	281	38%
Kompani e huaj	44	6%
Ndërmarrje nën menaxhimin e AKP-së	1	0%
Ndërmarrje shoqërore	26	4%
OJQ	40	6%
Organizata buxhetore	5	0%
Person fizik	8	1%

Sh.p.k.	308	42%
Tjetër	20	3%
Gjithsej	**733**	**100%**

Tabela 20 Ndërmarrjet sipas pronësisë në Shtërpcë, 2023

2.3.3. Punësimi dhe Papunësia

Papunësia- shkalla e papunësisë në nivel vendi sipas ASK-së është 11.8%. Papunësia më e lartë është tek femrat me 19.4% se sa tek meshkujt që është 8.9%. Të dhëna për shkallën e papunësisë në Komunën e Shtërpcës nuk ekzistojnë, por sipas të dhënave të fundit në dispozicion, në vitin 2021 si të papunë ishin regjistruar 292 persona, ndërsa totali i punëkërkuesve ishte 1,442.

Mashkull	Mashkull (%)	Femër	Femër (%)	Totali	Punëkërkuesit total
135	46.2%	157	53.7%	292	1,442

Tabela 21 Të papunët e regjistruar në Shtërpcë

Të papunë të regjistruar në Komunën e Shtërpcës në vitin 2021 ishin 4,461; prej tyre 49.0% meshkuj dhe 50.0% femra. Në dy vitet e fundit ka rritje të punëkërkuesve femra, duke tejkaluar numrin e gjinisë mashkullore. Kjo ka ndodhur si rezultat i një sërë faktorëve, siç janë arsimi, madhësia e familjeve, të ardhurat, si dhe mundësive më të mëdha të femrave në qasje në mikrofinanca.

Niveli edukimit	Mashkull	Mashkull (%)	Femër	Femër (%)	Totali	Punëkërkuesit total
Arsim i mesëm profesional	580	63.1%	338	36.8%	918	469
Bačelor	110	40.4%	162	59.5%	272	200
Klasët I –IX (Shkolla fillore)	253	35.7%	455	64.2%	708	230
Master	13	43.3%	17	56.6%	30	14
Pa shkollë	305	42.5%	412	57.4%	717	598
Shkollë e mesme gjimnaz	326	48.6%	344	51.3%	670	166
Totali	2,287	50%	2,285	49.9%	4,572	6,270

Tabela 22 Të papunët e regjistruar sipas nivelit të edukimit dhe gjinisë në komunën e Shtërpcës, 2020[9]

Sipas edukimit, numri më i madh i të punësuarve është me arsim të mesëm profesional, pa shkollë, dhe me gjimnaz, ndërsa sipas gjinisë papunësia më e madhe është tek femrat 52.0%, se sa tek meshkujt 47.9%.

Sa i përket nivelit të shkollimit të punëkërkuesve, pjesa më e madhe e tyre janë pa edukim, personat me arsim të mesëm profesional, nxënësit e shkollave fillore, individët me nivel studimi bačelor, etj.

Niveli më i lartë i papunësisë qëndron tek kategoria e profesioneve elementare, me 46% tek meshkujt dhe me 53.90% tek femrat. Profesionistët janë kategoria e dytë me papunësinë më të madhe që ndajnë përqindjen 44.5% meshkujt dhe 55.40% femrat.

Profesionet	Mashkull	%	Femër	%	Totali	Punëkërkuesit
Profesionet e forcave të armatosura	1	100%	0	0.00%	1	1
Menaxherët	23	67.6%	11	32.30%	34	27
Profesionistët	115	44.5%	143	55.40%	258	228
Teknikët dhe Bashkëpunëtorët profesional	90	59.6%	61	40.30%	151	151
Punëtorë zyre dhe asistent	3	50%	3	50.00%	6	14
Punëtorët për shërbime dhe shitje	11	61.1%	7	38.80%	18	30
Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	1	50%	1	50%	2	5
Punonjësit e zejes dhe profesioneve të ngjashme	69	69%	31	31%	100	46
Operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina	9	69.2%	4	30.7%	13	23
Profesionet elementare	429	46%	502	53.9%	931	903
Totali	751	69.7%	763	38.2%	1514	1428

Tabela 23 Të papunët e regjistruar sipas profesionit dhe gjinisë në komunën e Shtërpcës

Popullsia në moshë pune në vitin 2020 në komunë ishte 3,311; 48.0% nga të cilët ishin meshkuj dhe 48.9% femra. Grup mosha që kishte numrin më të madh të popullsisë ishte mosha 25-39,kurse ajo me më së paku popullsi në moshë pune ishte grup mosha 55-64.

[9] Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Grupmosha	Mashkull	Femër	Totali	Punëkërkues total
15-24	308	285	593	159
25-39	838	791	1,629	847
40-54	288	404	188	509
55-64	156	241	397	168
Totali	**1,590**	**1,721**	**3,311**	**1,683**

Tabela 24 Popullsia në moshë pune në Komunën e Shtërpcës, 2020[10]

Punësimi- Shkalla e punësimit sipas ASK-së në nivel vendi për vitin 2022 është 34.0%. Punësimi më i lartë është te meshkujt 50.8%, ndërsa punësimi te femrat është 17.1%.

Në vitin 2023, sipas ATK-së, në komunë janë të punësuar 4, 565 punëtorë dhe sektori me numrin më të madh të tyre është akomodimi dhe shërbimi ushqimor me 2,170 punëtorë. Më pas është sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, përderisa sektori me numrin më të vogël të punëtorëve në sektorin privat është sektori i arsimit me 13 punëtorë.

Sipas të të njëjtit burim, numri i të punësuarve burra është 3,152 apo 69.0%, ndërsa numri i grave të punësuara është 1,413 apo 30.9%.

Sektori	Nr. i punëtorëve	%
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	124	8%
B - Industria nxjerrëse	-	-
C - Industria përpunuese	306	6%
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-	-
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	-	-
F - Ndërtimtaria	574	8%
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	757	16%
H - Transporti dhe magazinimi	72	1%
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	2170	48%
J - Informimi dhe komunikimi	256	5%
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-	-
L - Aktivitetet e patundshmërisë	16	0%
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	162	3%
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	58	1%
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	-	-
P - Arsimi	13	0%
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	30	0%
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	-	-
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	67	1%
T - Person Fizik	-	-
U – Mungon aktiviteti	149	3%
Total	**4,565**	**100%**

Tabela 25 Punësimi sipas sektorëve ekonomik në Komunën e Shtërpcës, 2023

Numri më i madh i punëtorëve sipas llojit të biznesit është në ndërmarrjet e llojit sh.p.k. me 3,343 punëtorë apo 73.2%, bizneset individuale me 20.2% etj.

Lloji i biznesit	Nr .i punëtorëve	%
Biznes individual	924	20%
Kompani e huaj	10	0%
Ndërmarrje nën menaxhimin e AKP-së	-	-
Ndërmarrje shoqërore	175	4%
OJQ	52	1%
Organizata buxhetore	-	-

[10] Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

Person fizik	-	-
Sh.p.k.	3,343	73%
Tjetër	61	2%
Gjithsej	4,565	100%

Tabela 26 Punësimi sipas llojit të biznesit në Komunën e Shtërpcës, 2023

2.3.4. Tregtia

Në Komunën e Shtërpcës tregtia me shumicë dhe pakicë është e organizuar kryesisht në biznese të vogla familjare; pra, ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Ekzistojnë vetëm dy biznese të sektorit publik. Megjithatë, sektori i tregtisë është ende në zhvillim e sipër, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Shumica e dyqaneve janë të vendosura në qendër të qytetit, ku ka edhe dyqane të specializuara në kategori të ndryshme si: për këpucë, tekstil, produkte metalike, etj. Në Komunën e Shtërpcës ekziston një treg i rregulluar, përveç tregut të gjelbër dhe atij të bagëtisë të cilat nuk kanë lokacione të rregulluara, po spontanisht formohen në rrugë apo në afërsi të rrugëve.

Tregtia fokusohet kryesisht në tregjet lokale me pakicë, bujqësi, dhe përpunim të ushqimit. Në përgjithësi, tregtia është e zhvilluar, pavarësisht nga vështirësitë e mjedisit të bizneseve. Por, përparimi i mëtejmë pengohet nga faktorë si orientimi i brendshëm, statuti ligjor dhe investimet e huaja direkte.

2.3.5. Industria

Situata në fushën e industrisë në komunën e Shtërpcës vazhdon të jetë e pafavorshme. Si kompleksi më i rëndësishëm industrial më herët ishte një fabrikë e pjesëve mekanike e cila prodhonte makina për përpunimin e metalit. Krahas kësaj në këtë fabrikë janë prodhuar edhe lidhëset për piano, si dhe trupat ndriçues. Ekzistojnë edhe fabrika për përpunimin e drurit dhe produkteve të tij. Deri vonë kanë ekzistuar kapacitetet për prodhimin e medikamenteve, por viteve të fundit nuk ka prodhim për shkak të teknologjisë së vjetërsuar.

Industria në Komunë mund të klasifikohet në publike dhe private. Në sektorin privat ekzistojnë fabrika të cilat merren me nxjerrjen dhe përpunimin e ujit mineral dhe lëngjeve të gazuara. Në Komunë ekzistojnë edhe 3 ndërmarrje sociale të cilat prodhojnë tekstil, lëngje mjedrash dhe xhem, dhe produkte tjera ushqimore.

2.3.5.1. Industria e drurit

Në komunë industria e drurit është e zhvilluar mesatarisht. Këtu aktivitetin e tyre e zhvillojnë rreth 5 mikro ndërmarrje familjare, me dy deri tre të punësuar. Për produktet e tyre ata përdorin kryesisht drurin e thatë dhe prodhimet përfshijnë mobilje, kuzhina, orendi të tjera dhe produkte zbukuruese, dhe tregu i tyre shtrihet në nivel lokal.

DRAFT



*Harta 20 Shtrirja hapësinore e bizneseve**

2.3.6. Ndërtimtaria

Sektori i ndërtimtarisë është sektor premtues në komunë duke ditur që komuna është një destinacion i njohur turistik për shkak të Brezovicës dhe bjeshkëve të Sharrit, që do të thotë se në një të ardhme jo shumë të largët do të vazhdojnë të ndërtohen objekte të ndryshme për pushime dhe rekreacion, si dhe për banim e që do të rrisin punësimin dhe turizmin dhe numrin e popullsisë.

Ndërtimtaria ka një vend të rëndësishëm në ekonominë e Shtërpcës. Planifikohet që të forcohet në aspektin e një numri të punësuarve në profile të ndryshme. Ndërtimtaria funksionale vazhdon të jetë e lidhur ngushtë me zhvillimin e të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe jo ekonomike. Zhvillimi intensiv i ndërtimtarisë vazhdon të jetë i kushtëzuar në përputhje me kapacitetin e investimeve për zhvillimin ekonomik dhe aktivitete sociale. Aktivitet ndërtimore janë

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

të përqendruara kryesisht në kompanitë e ndërtimit privat që merr pjesë me përqindje të lartë në punësimin total të komunës.

Kompanitë e ndërtimit janë përdorues relativisht të mëdhenj të hapësirës. Pra, po analizohen dhe planifikohen hapësira që mund të përdoren për deponim, ndarjen e zhavorrit dhe të materialeve tjera për të prodhuar një masë betoni dhe produkte nga gjysmë-betoni, për instalimin dhe funksionimin e bazës së makinës dhe punëtorive për riparime, për pune të reparteve të ndryshme, (muratorët, punëtorët me armaturë, mekanikë, elektricistë, zdrukthëtarë, punët finale etj.), për parkimin e makinave, depove, objekteve tjera dhe shërbimeve.

2.3.7. Zonat ekonomike dhe industriale

Ndërmarrjet ekonomike të Komunës së Shtërpcës janë të shpërndara në zonën urbane dhe vendbanimet rurale, megjithatë komuna nuk ka zona të shpallura ekonomike apo industriale.

Në zonën urbane bizneset kryesisht janë të përqendruar në rrugën rajonale R115 Prizren-Doganaj, dhe kryesisht janë ndërmarrje shërbyese, si restorante dhe kafene, dyqane të tregtisë me shumicë dhe pakicë, autoservise, parukeri, etj. Në zonat rurale duhet të theksohet Brezovica si zonë turistike, ku dominojnë bizneset e akomodimit dhe shërbimeve të ushqimit.

2.3.8. Bujqësia

Viset malore janë shfrytëzuar tradicionalisht, para së gjithash, për blegtori, dhe në masë më të vogël për prodhimin e kulturave bujqësore. Ky konstatim vlen edhe për Komunën e Shtërpcës duke marr parasysh se territori i saj gjendet në lartësi prej 640 deri 2.597 m, dhe që në të ka kullota dhe livadhe si dhe sipërfaqe të pemishteve.

Në Komunën e Shtërpcës për prodhime bujqësore (sipas të dhënave të drejtorisë së Gjeodezisë) shfrytëzohen gjithsej 13.649,70 ha. Pjesa e këtyre sipërfaqeve pjellore është rreth 56,90%, në kuadër të komunës 55,20%. Nga këto sipërfaqe sektori publik shfrytëzon 7.019,0 ha (51,40%), ndërsa privat 6.633,7 ha (48,60%). Sektori publik ka 7.012,4 ha sipërfaqes blegtorale (63,80%), ndërsa privat 3.972,8 ha (36,20%). Sipërfaqet tjera bujqësore janë mjaft të vogla dhe të papërfillshme (6,50 ha ose 0,20%), derisa në sektorin privat 2.667,50 ha të këtyre sipërfaqeve janë (99,80%).

Në tabelën në vazhdim janë paraqitur tokat bujqësore sipas shfrytëzimit.

Qëllime	Totali		Privat		Publik	
	Ha	%	ha	%	ha	%
Arat	2.463,20	9,94	2.460,70	32,58	2,50	0,01
Kopshtet	0,80	0,00	0,80	0,01	0,00	0,00
Pemishtet	203,20	0,82	199,20	2,64	4,00	0,02
Vreshtat	0,30	0,00	0,30	0,00	0,00	0,00
Livadhet	3.340,70	13,49	3.316,10	43,91	24,60	0,14
Kullotat	7.644,50	30,87	656,60	8,69	6.987,90	40,60
Pyjet	10.331,40	41,72	801,10	10,61	9.530,30	55,40
Pjellore	23.984,10	96,85	7.434,80	98,44	16.549,30	96,20
Jopjellore	778,00	3,15	117,60	1,56	660,40	3,80
TOTALI	24.762,10	100,00	7.552,40	100,00	17.209,70	100,00

Tabela 27 Toka bujqësore, sipas kategorive te shfrytëzimit dhe shtrirjes hapësinore

Në bazë të këtyre informatave mund të thuhet se në Komunën e Shtërpcës eksitojnë kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë. Deri në masën e caktuar ky konkludim është logjik dhe atë kur është fjala për kushtet e zhvillimit të prodhimtarisë ekstensive bujqësore. Këtu mendojmë për prodhimin me pjesëmarrje, së pari, të familjeve bujqësore rurale të cilat merren me këtë veprimtari për qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre, dhe eventualisht, me qëllim të prodhimit të tepricave bujqësore të destinuara për tregun lokal. Për këtë mënyrë të prodhimeve bujqësore banorët kanë shfrytëzuar këto sipërfaqe:

- Për prodhim blegtoral janë shfrytëzuar 10.985,200 ha (45,80% nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 44,4 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e kulturave janë shfrytëzuar 2.464,0 ha (10,30% nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 10,00 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e frutave/pemëtarisë (dhe vreshta) janë shfrytëzuar 203,50 ha (0,80 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht diçka më pak se 0,80 % nga totali i sipërfaqes së komunës).

Ndryshimet në trajtimin e bujqësisë nga ana e shtetit në periudhën e pasluftës kanë çuar në një reduktim drastik të intensitetit dhe përfshirjes së hapësirës për tokat punuese bujqësore, kështu që sot mund të flitet për (këto) sipërfaqe si sipërfaqe në të cilat është e mundur të organizohet prodhimtaria bujqësore, dhe jo për sipërfaqe që në të vërtetë shfrytëzohen për qëllime të tilla.

Kadastra i komunës	Totali		Privat		Publik	
	ha	%	ha	%	ha	%
Sevda	3.995,8	16,7	936,6	12,6	3.059,2	18,5
Jazhinca	1.507,3	6,3	305,5	4,1	1.201,8	7,3
Vërbeshtica	4.058,5	16,9	1.140,3	15,3	2.918,2	17,6
Shtërpca	3.377,7	14,1	1.267,1	17,0	2.110,6	12,8
Berevca I	1.157,2	4,8	499,0	6,7	658,2	4,0
Berevca II	207,7	1,1	-	-	270,7	1,6
Sushica	1.054,5	4,4	407,5	5,5	647,0	3,9
Bitia e E.	893,4	3,7	353,0	4,8	540,2	3,3
Bitia e P.	624,7	2,6	260,0	3,5	364,7	2,2
Gotovusha	1.571,9	6,6	735,1	6,6	1.080,6	6,5
Drajkoci	1.086,8	4,3	290,1	3,9	733,7	4,4
Viça	693,2	2,9	357,3	4,8	335,9	2,0
Kashtanjeva	1.804,7	7,5	598,7	8,1	1.206,0	7,3
Izhanca	364,4	1,5	171,8	2,3	192,6	1,2
Brod	1.586,3	6,6	356,8	4,8	1.229,9	7,4
TOTALI	23.984,1	100,0	7.434,8	100,0	16.549,3	100,0

Tabela 28 Sipërfaqe pjellore dhe jo pjellore nëpër vendbanime në komunën e Shtërpcës – private, publike dhe totali[11]

Burimi: Pasqyra e sipërfaqeve për kultura, klasa dhe tokë jo pjellore, drejtoria e Gjeodezisë, Shtërpcë

Shfrytëzimi i hapësirës	Totali		Privat		Publik	
	Ha	%	Ha	%	Ha	%
Bujqësia	2.464,0	10,3	2.461,5	33,1	2,5	0,0
Pemëtaria dhe vreshtaria	203,5	0,8	199,5	2,7	4,0	0,0
Blegtoria	10.985,2	45,8	3.972,7	53,4	7.012,5	42,4
Pylltaria	10.331,4	43,1	801,1	10,8	9.530,3	57,6
TOTALI	23.984,1	100	7.434,8	100,0	16.594,3	100,0
Bujqësia	13.649,1	56,9	6.633,7	89,2	7.019,0	42,4
Pylltaria	10.331,4	43,1	801,1	10,8	9.530,3	57,6
TOTALI	23.984,1	100	7.434,8	100	16.549,3	100

Tabela 29 Sipërfaqet pjellore sipas shfrytëzimit – totali dhe sipas pronësisë

Në Komunën e Shtërpcës pjesa më e madhe e tokës është në pronësi publike, ku 69.50 % e sipërfaqes i takon sektorit publik dhe 30.50% sektorit privat.

Tokat bujqësore sipas pronësisë			
Private ha	**%**	**Publike ha**	**%**
7,552.40	30.50	17,209.70	69.50

Tabela 30 Tokat bujqësore sipas pronësisë, Burimi: Drejtoria për kadastër dhe Gjeodezi

Ndryshimet në trajtimin e bujqësisë në zhvillimin ekonomik të shoqërisë që kanë ndikuar në zvogëlimin e intensitetit dhe përfshirjen hapësinore të shfrytëzimit të sipërfaqeve për prodhimtari bujqësore kryesisht kanë të bëjnë me:

- Dekurajimin sistematik të zhvillimit të bujqësisë në përgjithësi në lidhje me aktivitetet tjera ekonomike (kryesisht për të mirën e industrisë),
- Bartjen e tepricave të pjesës së akumulimit nga bujqësia për aktivitete tjera,
- Obligimin e fshatarëve për të ndryshuar përbërjen rasore të sfondit të kafshëve të tyre,
- Lidhjet e dobëta të sektorit publik dhe privat të prodhimtarisë bujqësore,

[11] Drejtoria e Gjeodezisë, Shtërpcë

- Ndalimin e posedimit të më shumë se 10 ha të sipërfaqeve bujqësore të një familje rurale,
- Mbajtjen e pronësisë publike të 2/3 së sipërfaqeve blegtorale edhe pse sektori publik ka më pak sfond të bagëtive sesa ai privat.

Pasojat e trajtimit të këtillë të bujqësisë në zhvillimin e përgjithshëm socio – ekonomik edhe në Komunën e Shtërpcës janë manifestuar, kryesisht, në kuptim negativ. Intensiteti i shfrytëzimit të hapësirave bujqësore në mënyrë të vazhdueshme është zvogëluar, prodhimi i masës bujqësore me kalimin e kohës ka qenë gjithnjë e më i vogël, ndërsa numri i deleve dhe kafshëve tjera është reduktuar në minimumin e nevojshëm për jetën e përditshme të familjeve rurale.

Ndryshimet e cekura në Komunën e Shtërpcës janë sidomos të "nxitura" edhe nga ana e strukturave qeverisëse të shoqërisë së gjerë socio – politike. Emigrimi i banorëve rural për shkak të arsyeve ekonomike, por edhe arsyeve teknike ka ndikuar (dhe ndikon) në rënie të vazhdueshme demografike të fshatit, dhe kjo më tutje ka ndikuar edhe në zvogëlimin e intensitetit të shfrytëzimit të hapësirave bujqësore. Me kalimin e kohës, popullsia rurale është gjithnjë duke u orientuar në përdorimin e hapësirave për kultura bujqësore dhe pemëtari, e gjithnjë e më pak në përdorimin e hapësirave për blegtori.

Sipas të dhënave në dispozicion në periudhën prej viteve 1964 deri 1988, sipërfaqet e arave/tokave të punuara janë zvogëluar nga 3.454 ne 2.457 ha, dhe në të njëjtën kohë sipërfaqet e pyjeve, kullotave dhe livadheve janë rritur nga 19.434 në 21.316 ha. Proceset e përmendura kanë quar në atë se dendësia e deleve në kullota dhe në hapësira të livadheve të reduktohet në një dele në 1,6 ha, që konsiderohet të jetë shumë e pafavorshme për zhvillim ekzistues (si dhe të ardhshëm) të blegtorisë. Mesatarisht një familje rurale kishte (1998) vetëm 2-3 dele.

Shfrytëzimi i zonave blegtorale nga ana e sektorit publik është edhe më e vogël për shkak se Kooperativa Bujqësore „Milan Zečar", e cila organizon prodhimin blegtoral, kultivon vetëm 3.000 dele të vendosura në fermë në lokacionin e quajtur Raki jashtë kufijve të bashkësisë. Duhet theksuar që para 25-30 vjetëve kjo kooperativë ka organizuar kultivimin e 18.000 deleve dhe 4.300 krerë të bagëtive tjera.

Se çfarë rëndësie negative kanë ndryshimet në intensitetin e shfrytëzimit të hapësirave në Komunën e Shtërpcës tregojnë të dhënat e Drejtorisë së Gjeodezisë së pjesës në sipërfaqen e përgjithshme të hapësirave bujqësore; madje 10.985,2 ha ose 85,5 % të të gjithë sipërfaqeve bujqësore të livadheve dhe kullotave. Po ashtu duhet të theksojmë se në periudhën e viteve prej 1964 deri 1988 sipërfaqet e livadheve dhe kullotave janë rritur më shumë për 1.677 ha ose për 20,2% në krahasim më gjendjen e vitit 1964.

Me kalimin e kohës, pra, popullsia bujqësore gjithnjë e më shumë është orientuar në sipërfaqe të kulturave bujqësore dhe të pemëtarisë, që në komunë janë rreth 2,667.5 ha, që do të thotë 19,5% e sipërfaqes së përgjithshme bujqësore ose (vetëm) 10% të sipërfaqes së përgjithshme të komunës. Përkatësisht, dendësia e popullsisë së Komunës së Shtërpcës në krahasim me sipërfaqet e kulturave bujqësore dhe të pemëtarisë është rritur për rreth 460 për 1 km^2. Procesi i rritjes së dendësisë do të vazhdohet edhe më tutje që tregon në nevojën për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve nga shfrytëzimi irracional. Kushtet për zhvillim ekonomik të bujqësisë dhe fshatrave në Komunën e Shtërpcës, d.m.th., janë zvogëluar edhe atë më shpejt se që sektori publik ka mundur (apo ka dashur) të përcjell këtë trend. Tepricat e fuqisë punëtore nga fshatrat është dashur të largohen në qytetet përreth; largimi është realizuar në numër të vogël deri në Ferizaj dhe Prizren (për shkak të politikës së caktuar kombëtare dhe për shkak të zhvillimit të pamjaftueshëm industrial të qyteteve të përmendura), si dhe jashtë vendit. Shtrohet pyetja, a ishte e mundshme që këto proceset negative të specifikuara të ngadalësohen me intensifikimin e prodhimit bujqësor? Kjo ishte e mundur të arrihet vetëm në masë të vogël sepse tokat e kulturave bujqësore dhe të pemëtarisë në Komunën e Shtërpcës kanë vlerë të vogël të bonitetit. Deri te ky përfundim, tërthorazi, vihet në bazë të të dhënave të sipërfaqeve të kulturave bujqësore dhe të pemishteve nëpër klasat kadastrale të caktuara. Kështu, në komunë tokat prej klasës së dytë deri tek klasa e katërt kadastrale janë 317,2 ha, ose 12,9% të gjithë sipërfaqes së kulturave bujqësore, përkatësisht vetëm 1,3% nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës. Në kuadër të kësaj, sipërfaqja e pemishteve (vreshtave) është 113,2 ha, ose 1,7% të sipërfaqes totale të komunës, që mund t'i trajtojmë si sipërfaqe që mund të përdoren për ndonjë prodhim të intensifikuar të bujqësisë. Kështu, është e nevojshme që të mbajmë në mend se tokat e klasës së dytë deri te klasa e katërt kadastrale në komunën e Shtërpcës sipas vlerës prodhuese i përkasin klasave më të dobët të tokës pjellore në pjesët e ulëta të rrafshit të Kosovës. Me hulumtimin e bonitetit të tokës në Komunën e Shtërpcës janë fituar të dhënat për vlerësim relativ të përshtatshmërisë së kësaj zone për zhvillimin e intensifikuar të prodhimtarisë bujqësore. Sipas këtyre të dhënave, është e qartë që në Komunën e Shtërpcës nuk ka hapësira të mëdha të tokës me kapacitet të madh të prodhimtarisë, sepse toka të klasës së bonitetit I dhe II ka vetëm me rreth 462,3 ha (1,8% nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës), ndërsa tokë të klasës së bonitetit III dhe IV ka 1,137.7 ha (4,6 % nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës). Pra, në Komunën e Shtërpcës ka 1.600,0 ha (6,4% të tokës produktive).



*Harta 21 Klasat e bonitetit të tokave bujqësore**

2.3.8.1. Ekonomitë bujqësore dhe ndërmarrjet bujqësore

Numri i ekonomive dhe ndërmarrjeve bujqësore në komunën e Shtërpcës sipas ASK në nivel të Komunal janë 1357 ekonomi bujqësore dhe 16 ndërmarrje apo subjekte juridike.

Lloji i ekonomive/ndërmarrjeve	Lloji i shfrytëzimit	Numri
Ekonomitë bujqësore - Gjithsej	Numri i ekonomive bujqësore	1357

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	4227.35
	Njësitë blegtorale	2032
Ekonomitë familjare bujqësore dhe bizneset individuale	Numri i ekonomive bujqësore	1341
	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	4222.81
	Njësitë blegtorale	2029
Subjektet juridike	Numri i ekonomive bujqësore	16
	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)	4.54
	Njësitë blegtorale	3

Tabela 31 Ekonomitë dhe ndërmarrjet bujqësore

2.3.8.2. Drithërat

Kjo lëmi e bujqësisë është mjaftë e përhapur dhe e preferuar në Komunën e Shtërpcës, ku si kulturë kryesore është misri, gruri, fasulja kokërr etj., ku të gjitha këto përbëjnë një sipërfaqe prej 245 ha dhe 3,185 ekonomi bujqësore.

Gruri		Misri		Bishtajoret kokërr		Fasulet kokërr		Drithërat kokërr - Gjithsej	
Nr i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Nr i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Nr i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Nr i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Nr i ekonomive bujqësore	Sipërfaqja (ha)
237	55.71	992	98.52	978	45.88	978	45.52	3,185	245.63

Tabela 32 Prodhimtaria vjetore i drithërave (ASK)

2.3.8.3. Perimekultura

Viteve të fundit ka marr hov kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur (serra), është bërë një shtim i dukshëm i sipërfaqeve me kultura perimtarie që kultivohen në serra. Deri më sot ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i serave të ndërtimeve të ndryshme, nga ai më i thjeshtë i drurit e deri te ato të modernizuara. Po ashtu, perimtaria kultivohet edhe në fushë të hapur, ku si kultura kryesore janë speci, domatja dhe trangulli.

Speca		**Domate**		**Tranguj**	
Nr i ekonomive bujqësore	**Sipërfaqja (ha)**	**Nr i ekonomive bujqësore**	**Sipërfaqja (ha)**	**Nr i ekonomive bujqësore**	**Sipërfaqja (ha)**
118	1	113	1	16	0.2

Tabela 33 Prodhimtaria vjetore i perimeve (ASK)

2.3.8.4. Pemëtaria

Komuna e Shtërpcës ka kushte të volitshme klimatike—tokësore shumë të favorshme për kultivimin e pemëve. Më së shumti kultivohen mollët, dardhat, kumbullat, kajsitë, arrat dhe lajthia. Kjo veprimtari ka filluar të ringjallet. Momentalisht me pemë janë të mbjella sipërfaqe e konsiderueshme. Por viteve të fundit vërehet një interesim për kultivimin e pemëve të imëta, si mjedra, manaferra, aronia etj.

Lloji pemëve	**Numri i fermerëve dhe bimëve të kultivuara**	**Numër**
Mollë	Numri i fermave bujqësore	780
	Numri i pemëve	9357
Dardhë	Numri i fermave bujqësore	601
	Numri i pemëve	2936
Ftua	Numri i fermave bujqësore	331
	Numri i pemëve	556
Mushmollë	Numri i fermave bujqësore	304
	Numri i pemëve	555
Kumbull	Numri i fermave bujqësore	640
	Numri i pemëve	6621
Qershi	Numri i fermave bujqësore	456
	Numri i pemëve	1701
Vishnje	Numri i fermave bujqësore	319
	Numri i pemëve	887
Pjeshkë	Numri i fermave bujqësore	213

	Numri i pemëve	376
Kajsi	Numri i fermave bujqësore	209
	Numri i pemëve	625
Arrë	Numri i fermave bujqësore	576
	Numri i pemëve	2519
Lajthi	Numri i fermave bujqësore	77
	Numri i pemëve	230

Tabela 34 Prodhimtaria pemëtarë në komunën e Shtërpcës (ASK)

2.3.8.5. Blegtoria

Momentalisht fondi i bagëtisë mbahet kryesisht për qumësht, për majmëri (mish) dhe produkte të tjera. Ekzistojnë më se 1,278 familje të cilat kultivojnë kafshë për nevoja familjare me një fond prej 4,472 krerë. Gjithashtu ekzistojnë ferma të mesme dhe ato komerciale. Nuk ekziston ndonjë kapacitet, i cili do të kishte funksionuar për përpunimin e produkteve blegtorale. Por, ekziston vetëm forma e thjeshtë e përpunimit.

Lloji i kafshëve	**Ekonomit dhe krerët**	**Nr. Ekonomive dhe krerëve**
Gjedhe gjithsej	Numri i ekonomive bujqësore	600
	Numri krerëve	1560
Dele	Numri i ekonomive bujqësore	59
	Numri krerëve	1555
Dhi	Numri i ekonomive bujqësore	69
	Numri krerëve	459
Derra	Numri i ekonomive bujqësore	427
	Numri krerëve	764
Kuaj, gomarë dhe mushka	Numri i ekonomive bujqësore	123
	Numri krerëve	134
Shpeze	Numri i ekonomive bujqësore	644
	Numri shpendëve	13132
Koshere bletësh	Numri i ekonomive bujqësore	95
	Numri i koshereve	1625

Tabela 35 Fondi blegtoral (ASK)

2.3.10. Pylltaria

Pyjet paraqesin një burim të rëndësishëm natyror të ripërtërishëm me potencial për të furnizuar produkte drusore dhe jodrusore. Komuna e Shtërpcës është e njohur për pasuritë natyrore, sidomos për pyjet e bukura dhe malet e larta. Sipërfaqja pyjore në Komunën e Shtërpcës shtrihet në hapësirë prej 10.331,4 ha, apo 42.7% të territorit të komunës. Sipërfaqe pyjore private është 801,10 ha (7,75%), dhe pjesa tjetër prej 9.530,30 ha (92,25 %) është nën pronësi publike.

Pyjet shtrihen në lartësi prej 640 m në brigjet e Lepencit, ndërsa në regjionin e Brezovicës deri në 2500m lartësi. Përveç ahut që dominon, janë shumë të përfaqësuara edhe shkoza e bardhë, bungu, panja, hiri i zi, bliri i argjendtë, bliri i zakonshëm, panja malore, panja fushore, etj. Brezi më i madh i pyjeve të ahut krijon bashkësi të përzier gjethore – halore në të cilat janë të shoqëruara nga hiri malor, rrobulli, molika, bredhi dhe pisha.

Pylltaria si veprimtari ekonomike në vendbanimet e komunës është prezentë në masë të vogël. Në numrin e bizneseve të regjistruara ajo merr pjesë vetëm me 7%, së bashku me peshkimin dhe bujqësinë. Nga ana tjetër, dukuria e prerja e pyjeve është një dukuri që bëhet shpesh dhe ilegalisht prej vetë banorëve të Komunës, veçanërisht në Parkun Nacional të Brezovicës dhe prerja bëhet kryesisht për nevoja vetanake, shtëpiake, pra, për ngrohje.

Shfrytëzimi i hapësirës	**Totali**		**Privat**		**Publik**	
	Ha	**%**	**Ha**	**%**	**Ha**	**%**
Pylltaria	10.331,4	100	801,1	7.75	9.530,3	92.25

Tabela 36. Tokat pyjore sipas pronësisë

2.3.11. Zejtaria

Zejtaria është fushë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik të Komunës së Shtërpcës. Veprimtaria e zejtarisë ushtrohet në fushën e përpunimit dhe prodhimit të produkteve në treg, kryesisht në seri të vogla që nuk kanë karakteristika të industrisë prodhuese (instrumentet muzikore, veglat bujqësore dhe tjerat).

Në Komunën e Shtërpcës janë të njohur edhe zejtarët që merren me zejtarinë e shërbimit në fushën e mirëmbajtjes dhe rregullimit të produkteve, pajisjeve, objekteve si dhe shërbimeve tjera. Janë të njohur zejtarët që merren me punët vendore, ose me përpunimin dhe rafinimin e objekteve dhe veglave artistike si dhe formimi i cilësisë së tyre që varet nga aftësitë personale të prodhuesit. Po ashtu ekzistojnë artizanët të angazhuar me përpunimin e punëve të dorës me produkteve të veçanta të cilat janë prodhuar nga vet zejtari ose me anëtarët e familjes.

Me gjithë ekzistimin e zejtarëve dhe punës së tyre, kjo veprimtari rrezikon të zvogëlohet, për të mos thënë të shuhet. Arsyet janë se çdo ditë e më pak kërkesa për këto produkte bie, e rrjedhimisht edhe interesi nga të rinjtë për ta mësuar dhe për ta zhvilluar këtë veprimtari. Mosha e të gjithë zejtarëve është mbi 55 vjeç, që tregon se ata e punojnë këtë veprimtari si trashëgimi që e kanë mësuar nga të parët e tyre, dhe vazhdojnë ta bëjnë më shumë si dëshirë dhe jo aq shumë nga kërkesa që ekziston në treg sepse ajo është e vogël.

2.3.12. Turizmi

Komuna e Shtërpcës karakterizohet me pasuri të mëdha të resurseve turistike. Megjithatë, këto potenciale nuk shfrytëzohen akoma mjaftueshëm, si shkak të mungesës së përfundimit të aktiviteteve të privatizimit, ashtu edhe mungesës së donacioneve, subvencioneve, dhe investimeve të huaja.

Zona turistike në Komunën e Shtërpcës kryesisht shtrihen në vendbanimin e Brezovicës me një sipërfaqe prej rreth 112.00 ha apo 0.45% të tërë territorit të komunës. Vetëm Parku Nacional "Malet e Sharrit" në territorin e Komunës së Shtërpcës shtrihet në sipërfaqe hapësinore prej 107.00 ha, apo 47% të të gjithë territorit të Parkut. Zonat turistike nga turistët dhe vizitorët vendor dhe të huaj shfrytëzohen më së shumti për qëllime rekreacioni, pushime, gara sportive dimërore, vizita hulumtuese-studiuese, etj.

Nga burimet natyrore të Komunës së Shtërpcës veçohen malet e Sharrit që janë të pasura me ujëra (lumenj dhe liqene malore), tokë pjellore bujqësore të klasës III dhe IV, kullosa, pyje, florë dhe faunë. Malet kanë lartësi mbidetare deri në 2.600 m dhe në pjesën veriore kanë shpate të favorshme për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror. Shpatet e buta të thepisura dhe shpatet e gjelbra të përshtatshme për rekreacion gjatë verës me vlerë turistike gjeo-morfologjike dhe hidrologjike si dukuri hyjnë në lokacionet më të rëndësishme turistike në Kosovë.

Parku Kombëtar "Malet e Sharrit", qendra e skitarisë Brezovica me shtigjet FIS me gjatësi prej mbi 3.000 m dhe 5 teleferikë, mjedisi i ruajtur, trashëgimia kulturore dhe historike mesjetare e monumenteve unike ortodokse nga shekulli XVI, janë atraksione turistike që paraqesin pasuri ndërkombëtare. Megjithatë, për nevojat turistike shfrytëzohet vetëm 0.12% e sipërfaqes së komunës.

Pyjet shumëvjeçare, livadhet dhe kullosat janë të pasura me lule malore, bimë mjekuese, specie të rralla të kafshëve të egra, sasi relativisht të larta të reshjeve dhe rrjet lumor të dendur si dhe me pasuri në burime dhe ujëra sipërfaqësore. Një numër i madh i burimeve dhe rrjedhave me ujë të ftohtë dhe të pastër janë kolorit i veçantë i kësaj zone.

Qendra e skijimit Brezovica është qendër turistike në anën veriperëndimore të malit Sharr dhe është një qendër unike rekreativo-sportive me një lartësi mbidetare prej 900m deri 2500m. Ajo është larg nga Prishtina 60km dhe po ashtu edhe nga Shkupi. Qendra e skijimit ka 11 ski-lift me kapacitet 10.000 skijatorë në orë.

Në Komunën e Shtërpcës ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare që janë edhe objekte turistike. Është Kalaja e Brezovicës në Gradishtë, ku në të gjitha anët e fortifikatës gjenden miniera dhe të mihura në kodrat përreth. Kompleksi "Treshnja" (Qershia), "Shtëpia e Stojkut" si dhe "Livadhet e Mbretit" renditen ndër resurset tjera turistike si potenciale për zhvillimin ekonomik të komunës.

Vizitorët

Në Brezovicë ka disa hotele për sezonin e dimrit që mund të akomodojnë rreth 700 persona, por ekzistojnë edhe një numër i hoteleve që janë jashtë funksionit.

Numri i vizitorëve vendor dhe të huaj në vitin 2023 ishte 44,441 në Ferizaj dhe rrethinë, dhe numri i net qëndrimeve ishte 57,857. Edhe pse mungojnë statistika të detajuara për komunën e Shtërpcës në këtë fushë, duke e ditur fluksin e madh të vizitorëve në Brezovicë, shumica e numrit të dhënë të turistëve konsiderohet se kanë vizituar dhe qëndruar atje.

DRAFT



Grafiku 5. Numri i vizitorëve në regjionin e Ferizajit, 2022



Grafiku 6. Numri i net qëndrimeve të vizitorëve në regjionin e Ferizajit, 2022

2.3.12. Resurset nëntokësore dhe sipërfaqësore

Përbërja gjeologjike e tokës është prej mineraleve të ndryshme. Besohet se territori i Komunës së Shtërpcës është mjaft i hulumtuar nga aspekti gjeologjik dhe se janë caktuar rezervat themelore të burimeve të mineraleve. Sa i përket eksploatimit të xeheve të kromit në minierën e Brezovicës, me një numër të llojeve të veçanta të mineraleve nëntokësore, kjo minierë është ndër më të vjetrat në vend. Rezervat ekonomikisht të pagueshme vetëm se janë shterur, dhe miniera është mbyllur në mesin e viteve të pesëdhjeta.

Gjithashtu, është konstatuar se në territorin komunës nuk ka rezerva rentabile ekonomike të materialeve metalike. Nga materialet jo-metalike duhet përmendur gurëthyesin e Shtërpcës nga i cili është nxjerr materiali për prodhimin e gëlqeres, por ndërkohë është mbyllur.

Eksploatimi i argjilës është bërë në vendbanimin Biti e Epërme për punime të qeramikës, por është braktisur me shuarjen e këtij lloji të tregtisë. Eksploatimi sporadik dhe i pa organizuar i zhavorrit dhe rërës nga shtrati i Lepencit kryesisht i është lënë sektorit privat. Sipas hulumtimeve ekzistojnë kushtet e favorshme për hapjen minierës mbi Gotovushë në shpatin e sipërm në Zmijanjë ose në afërsi të lokalitetit Belevode (Uji i Bardhë), si dhe në vendbanimet Viçë, Izhancë dhe Brod.



*Harta 22 Zhvillimi ekonomik**

2.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE*

2.4.1. Ujësjellësi

Në Komunën e Shtërpcës **75** % e vendbanimit është e mbuluar më rrjetin publik të ujësjellësit, **18,75** % pjesërisht dhe **6,25** % ka rrjet të ujësjellësit por me probleme në furnizim. Në nivelin urban **95** % të banorëve janë të përfshirë me rrjetin e ujësjellësit. Në territorin e Komunës së Shtërpcës nuk ekziston një rrjet i menaxhuar i ujësjellësit apo rrjeti kryesor i ujësjellësit, por secili vendbanim ka ujësjellësin e veçantë, kështu që Komuna nuk ka qasje në informata të

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

* Sa i përket infrastrukturës teknike, Komuna nuk menaxhon me to dhe rrjedhimisht nuk ekzistojnë të dhëna të sistemuara për të përfshirë në këtë dokument, përpos atyre që janë paraqitura në të.

integruara apo të sistemuara. Duhet theksuar që disa vendbanime, edhe pse janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, kanë probleme me furnizim me ujë. Në periudhën e verës janë të mundura reduktimet me furnizim me ujë për shkak të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore.



Harta 23 Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit i ndërtuar që menaxhohet*

Rrjeti i ujësjellësit shtrihet në 15 vendbanime me gjatësi totale prej 107,418.52 metra

Vendbanimet	**Gjatësia totale për secilin vendbanim (m)**
Berevcë	2,578.77
Bitinja e Epërme	4,868.04
Bitinja Poshtme	5,404.04

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Brezovica	2,309.96
Brod	22,387.14
Drajkovcë	1,209.49
Firaja	8,526.71
Gotovusha	5,016.64
Jazhince	12,135.85
Kashtanjeve	2,384.27
Sevcë	4,453.90
Shtërpce	9,923.82
Sushiqë	1,616.16
Verbështicë	20,394.77
Viça	4,208.96
Gjatësia totale e gypave për të gjitha vendbanimet	**107,418.52**

Tabela 37 Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit sipas vendbanimeve

2.4.2. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza)

Në Komunën e Shtërpcës **12,5**% e vendbanimit është i mbuluar me rrjetin publik të kanalizimit, **25**% është në procesin e ndërtimit, **6,25**% është pjesërisht i mbuluar dhe **25**% nuk është i mbuluar me rrjetin e kanalizimit. Në territorin e Komunës së Shtërpcës nuk ekziston një rrjet kryesor i kanalizimit.

Rrjeti i kanalizimit shtrihet në 4 vendbanime me gjatësi totale prej 17,189.86 metra.

Vendbanimet	**Gjatësia totale për secilin vendbanim (m)**
Bitija e Poshtme	2,587.04
Brezovica	2,111.86
Shtërpce	7,342.73
Verbeshice	5,148.23
Gjatësia totale e gypave për të gjitha vendbanimet	**17,189.86**

Tabela 38 Gjatësia e rrjetit të kanalizimit sipas vendbanimeve

2.4.3. Gjendja e ndotjes së rrjedhave të ujit

Duke vështruar në mënyrë komplekse problematikën e ndotjes së rrjedhave të ujit në Komunën e Shtërpcës, mund të supozohet se dëmet bazë në rrjedhat e ujit janë nga erozioni, ose lumenjtë e dhunshëm, si dhe sasitë e ujërave të zeza të cilat pa kanalizim dhe pa pastrimin e përmbajtjes së kanaleve derdhen në rrjedhat e ujërave. Përveç ndotjes natyrore që shkaktohet nga erozioni i tokës duke sjellë sedimente në rrjedha të ujërave, ndotje të konsiderueshme shkaktojnë edhe popullsia rurale e vendosur në të gjitha luginat e degëve në Sharr. Të gjitha ujërat e zeza të familjeve, shumë rrallë përmes gropave septike, pa ndonjë pastrim derdhen në ujëra. Pasi që vendbanimet e mëdha janë të vendosura në degët më të bukura të degëve të Sharrit, ekziston mundësia që aktiviteti shkatërrues i njeriut të ndikojë në mjedisin e rrjedhave të ujit.

Analizat mikrobiologjike dhe fiziko – kimike të rrjedhave të ujërave në zonën e Komunës se Shtërpcës që janë realizuar në vitin 1978, kanë treguar që karakteristikat e ujit i përkasin klasës së I-rë dhe kanë veti të ujit të pastër të quajtur "oligasprob". Megjithatë, në kohët e sotme, si mbledhës së ujërave të përdorura, shumë pak mund t'i ruajnë veçoritë e veta natyrore. Ata gjithnjë e më shumë maten me materie organike dhe joorganike që vijnë nga vendbanimet, materialet e depozituara dhe mbeturinat e shumta. Duhet theksuar së industria në Komunën e Shtërpcës nuk është e zhvilluar dhe se nuk ekzistojnë ujëra industriale që do të ndikonin në ndotjen e ujit. Sasitë e mëdha të ujërave të ndotur që drejtpërdrejtë derdhen në lumenj me përmbajtjen e tyre fizike dhe kimike në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në ndryshimin e cilësisë së ujit, dhe ashtu ndikojnë në bilancin natyral të lumit. Falë sasive të mëdha të ujërave që kanë mbledhësit e përmbajtjeve të kanaleve, ato mund t'i pranojnë këto përmbajtje pa ndonjë rrezik të madh. Sasitë e mëdha të ujërave nga mbledhësit duke kaluar me shpejtësi të madhe mbi gurët e shumtë në rrugë mjaft të shkurta të rrjedhës me vetë-pastrim ruajnë dhe mirëmbajnë përmbajtjet e tyre themelore.

DRAFT



Harta 24 Rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura (zeza) *

2.4.4. Trajtimi i ujërave të ndotura (zeza)

Si në shumë komuna të Republikës së Kosovës edhe Komuna e Shtërpcës ende nuk e ka të ndërtuar Impiantin për Trajtimin e Ujërave të Zeza dhe ujërat e zeza pothuajse nga të gjitha zonat në të cilën ka të ndërtuar sisteme të kanalizimit këto ujëra i derdhin në lumenj më të afërt duke i ndotur ata edhe më shumë. Në disa fshatra nuk funksionojnë këto sisteme.

2.4.5. Drenazhimi-kanalizimi i ujërave atmosferike

Rrjeti i kanalizimit të ujërave atmosferike, edhe pse ekziston në disa pjesë të qytetit aktualisht, është në gjendje mesatare. Vetëm disa rrugë kryesore janë nën sistemin e kanalizimit atmosferik kurse tjerat janë me sistem të hapur të kanalizimeve ose pa sistem fare.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Një problem tjetër është se në shumicën e rasteve kemi përzierje të ujërave atmosferike dhe derdhje te tyre ne kanalizim të ujërave të zeza. Gjithashtu, duke u bazuar në raportet sektoriale, për vendbanimet rurale (fshatrat), shumica e tyre e kanë kanalizimin e përbashkët.

2.4.6. Infrastruktura e energjisë elektrike

Komuna e Shtërpcës furnizimin me energji elektrike e siguron nga nënstacioni energjetik NS 35/10 kV Shtërpce. Ky nënstacion furnizohet nga NS 110/35/10(20) kV Ferizaji 1(Bibaj) nëpërmjet një linjën 35 kV e cila është e gjatë rreth 21.5 km, nënstacioni Ferizaj 1 është i lokalizuar në fshatin Bibaj në periferi të qytetit të Ferizajt.

Në hartën nr.19 është paraqitur rrjeti energjetik i Komunës së Shtërpcës, skema gjeografike e rrjetit 10 dhe 35 kV.

Në qytetin e Shtërpcës është i ndërtuar nënstacioni shpërndarës i energjisë elektrike

35 /10 kV me një fuqi të instaluar prej 2x8 MVA, ndërsa linja që furnizon këtë nënstacion është e ndërtuar nga shtyllat metalike, ndërsa përcjellësit e saj janë 3 x 185 mm² Al/Çe në shtyllat e kapriate. Nga ky trafo stacion shpërndahen 7 daljet 10 kV deri NS 10(20)/0,4 kV që janë të instaluar nëpër lokalitetet përreth si dhe në Shtërpcë.

Rrjeti 10 kV në qytet kryesisht është i ndërtuar si rrjete kabllore me kabllo, ato më të vjetrat me vaj , ndërsa kabllot e reja janë nga materiali XLP, ndërsa për ndërlidhjen e NS-ve më të largëta në fshatrat përreth rrjeti është ekskluzivisht me rrjetin ajror me përçues nga Al/Çe.

Nga të dhënat e e KEDS-it rezulton se shumica e NS janë në pronësi të KEDS-it, përveç: nënstacioneve në fabrikën I.L Ribar, hotel Narcisi, Pilana dhe Laza.

Vendbanimi Brezovica furnizohet me dy largpërçues ajror 10 kV nga të cilët njëri është i ndërtuar në shtyllat druri dhe i cili vazhdon në drejtim të fshatit Sevcë i cili rrjet nuk është në gjendje te mirë, ndërsa i dyti në shtylla betoni, ndërsa që daljet që janë të lidhura me këtë largpërçues janë si dalje kabllore.

Rrjeti shpërndarës 10 kV në drejtim të Brodit dhe Firajës të seksionit 3 x 50 mm² Al Çe në shtyllat druri është në gjendje të keqe, si edhe rrjeti brenda vendbanimeve të fshatrave, i cili gjithashtu nuk është ne gjendje më të mirë.

Në vet qendrën e Brezovicës në afërsi të hotelit "Breza" gjendet objekti i ndërtuar shpërndarës që paraqet degëzimin energjetik prej kabllove 10 kV për këtë pjese. Qendra skijimore ka një rrjet të besueshëm dhe të njëanshëm të furnizimit përmes rrjetit të përmendur në shtyllat e kapriate, ndërsa hoteli "Molika" është i furnizuar dyfish përmes unazës lokale. Në tërë qendrën skijimore ekzistojnë 4 NS prej 10/0,4 kV, prej të cilëve tri janë në pronësi të „Ineks Sharra", njëra është e dedikuar për shkollën skijimit dhe një kullë e TS është për konsumin e gjerë për vikend zonën rreth "Shtëpisë së Stojkut". Ekzistojnë TS 10/0,4 kV të kallajit tek transmetuesi mbi qafën e Luanit që është largpërçues i çmontuar prej 10 kV dhe se për shkak të nevojave të transmetuesit furnizohet me rrjetin sekondar përmes ski liftit „Berevačke rupe". Sa i përket fuqisë së angazhuar në këtë rast konsumatori dominues është "Ineks – Sharra" me 2.000 kVA të fuqisë së instaluar në hotelin "Narcis" dhe me 3.030 KVA të fuqisë së instaluar në qendrën skijimore "Brezovica". Konsumatori kryesor në qendrën skijimore është hotel "Molika" me fuqi të instaluar prej 2 x 1.000 kVA ndërsa konsumatorë tjerë të mëdhenj janë ski liftet (ashensorët):

Në përgjithësi nga NS 35/10(20) kV Shtërpca në të gjitha drejtimet nga te cilet furnizohen konsumatorët jane 7 dalje me gjithsejtë 77 nënstacione me një fuqi totale te instaluar prej 25080 kVA dhe e cila është paraqitur nëpërmjet tabelës vijuese:

Drejtimet NS 35/10 kV Shtërpca	Numri i nënstacioneve	1260	1000	630	400	250	160	100	50
J02. Shari - Molika	5		1	2				2	
J03.Pillana - Berevci	3		1			1	1		
J04.Fabrika -I.L.Ribar	1	1							
J07.Breza	28		2	6	2	9	5	4	
J07.Narcisi	2			1				1	
J08. Gotovusha - Brodi	30				3	10	9	6	2
J09.Shtërpca 1	5			2	1	1	1		
J10.Shtërpca 2	3			1	1	1			
Fuqia e Instaluar (kVA)	25080	1260	4000	7560	2800	5500	2560	1300	100

Tabela 39 Pasqyra e trafo-stacioneve në komunën e Shtërpcës sipas fuqive emërtimeve dhe daljeve

Drejtimi "Narcisi "	Hotel NARCISI	630	P	**R**
	TS Llaza	100	P	**R**
Drejtimi "Pillana - Berevci "	Fabrika	630	P	**U**
	Berevci 2 (Glok)	250	KEDS	**R**
	Berevci 1 (Farma)	160	KEDS	**R**
Drejtimi "Shari " - " Molika"	Hotel MOLIKA	1000	P	**U**
	Shkolla e Skijimit	630	P	**U**
	Kulla, sharr	630	KEDS	**R**
	Repititori	100	P	**U**
Drejtimi "Shtërpca 1 "	Komuna, Shterpc	630	KEDS	**U**
	Ambulanta, Shterpc	630	KEDS	**U**
	Qendra , Shtërpc	630	KEDS	**U**
	Shtëpia e mallrave (robna kuca)	400	KEDS	**U**
	Kulla , Shtërpc	400	KEDS	**U**
	Shkolla , Shterpca	250	KEDS	**U**
	Rada , Elektricisti	250	KEDS	**U**
	OSBE	160	KEDS	**U**
Trafo shtepiake	TS Trafo shtepiake Shterpc 35/10kV	50	KEDS	**U**
HIDROENERGJI SH.P.K	HIDROENERGJI SH.P.K -Ylber Shamolli	12020	P	**R**
HC Sharri-MATKOS GRUP	HC Sharri-MATKOS GRUP	8970	P	**U**
		6900	P	**U**
HC VIÇË-MATKOS GRUP	HC VIÇË-MATKOS GRUP	5400	P	**R**
HC BREZOVICË-MATKOS GRUP	HC BREZOVICË-MATKOS GRUP	2530	P	**U**

DRAFT

Emri i daljes 10(20)kV	Emërtimi i TS 10/0.4 kV	Fuqia instaluese (kVA)	Pronësia e TS KEDS/Private	TS Regjioni Urban/Rural
Drejtimi "Breza"	Vikendica 4 (Kulla)	1000	KEDS	**U**
	Ts Blerim Ymeri	1000	P	**U**
	Vikendica 1 (baton Bejta)	630	KEDS	**U**
	Vikendica Elektrokosova	630	KEDS	**U**
	Hotel Breza	630	P	**U**
	TS Lahor	630	P	**U**
	Ts Kuvendi Komunal(Banesat)-Brezovicë	630	P	**U**
	Ts Villat -Brezovicë	630	KEDS	**U**
	Hotel , Junior-geneks	400	P	**U**
	Sevce 1 (Kisha)	400	KEDS	**R**
	Vikendica 3 (Nexhat Daci)	250	KEDS	**U**
	Jazhinca 1(dom kulture)-shtepia e kultures	250	KEDS	**R**
	Jazhinca 2 (kod reke) te lumi	250	KEDS	**R**
	Sevce 3 (reka) lumi	250	KEDS	**R**
	Sevce 4 (Palić)	250	KEDS	**R**
	Verbeshtica 1(Groble) vorrezaqt	250	KEDS	**R**
	Verbeshtica 3 (Bazen)	250	KEDS	**R**
	TS NIC Holding	250	P	**U**
	Ts Veton Surroi "STELLA CONSULTING" SH.P.K	250	P	**U**
	Vikendica 2 (Bajrush Hashani)	160	KEDS	**U**
	Brezovica (permendorja)	160	KEDS	**U**
	Brezovica Kulla	160	KEDS	**U**
	Gjykata Themelore e Kosoves	160	P	**U**
	Ts Tahir Maloku "FITORJA" Sh.P,K	160	P	**U**
	Ndërtimtari	100	P	**U**
	Jazhinca 3 (Bara)	100	KEDS	**R**
	Sevce 2 (Kulla)	100	KEDS	**R**
	TS Tahir Maloku	100	KEDS	**U**
Drejtimi "Fabrika -I.L.Ribar"	Fabrika Ivo llola (2x630KVA)	1260	P	**U**
Drejtimi "Gotovusha - Brodi "	Gotovusha 1 (ulica)	400	KEDS	**R**
	Brodi 1 (shehler)	400	KEDS	**R**
	NTP-"ADI"	400	P	**R**
	Biti I Ulte , Serbet	250	KEDS	**R**
	Biti e eperm (popovct)	250	KEDS	**R**
	Biti e eperm te Shqiptaret	250	KEDS	**R**
	Gotovusha 3 (ekfa) - kisha	250	KEDS	**R**
	Firaja 1(Kulla)	250	KEDS	**R**
	Firaja 2 (Shkolla)	250	KEDS	**R**
	Firaja 3 (Lagje Req)	250	KEDS	**R**
	TS Elezaj (me heret TS Xhonaj kulla)	250	KEDS	**R**
	Brodi 2 (Rudaj)	250	KEDS	**R**
	TS Isuf berisha "BURIMI COMERC"SH.P.K	250	P	**R**
	Biti I Ulte , Shqiptaret	160	KEDS	**R**
	Gotovusha 2 (Shkolla)	160	KEDS	**R**
	Drajkovci 2 (vukashin)	160	KEDS	**R**
	Viqa	160	KEDS	**R**
	TS Bucko	160	KEDS	**R**
	TS-Brod-lagja Emërllahët	160	KEDS	**R**
	TS-Firajë-lagja Dragoshët	160	KEDS	**R**
	TS Ylber Shamolli "HIDROENERGJI" fsh Brodë	160	P	**R**
	TS Ylber Shamolli "HIDROENERGJI" fsh Viqë e Ulët	160	P	**R**
	Biti (te ura)	100	KEDS	**R**
	Shushiq	100	KEDS	**R**
	Drajkovci 1 (ambullanta)	100	KEDS	**R**
	Gredovica	100	KEDS	**R**
	Brodi privat (Haki Imeri)	100	KEDS	**R**
	TS Islam Mjekiqi "BREZOVICA CORPORATION"Sh	100	P	**R**
	Paloj	50	KEDS	**R**
	TS-Aleksander Milosavleviç	50	P	**R**

Tabela 40 Pasqyra e trafo-stacioneve në komunën e Shtërpcës sipas fuqive emërtimeve dhe daljeve



*Harta 25 Shtrirja e rrjetit të energjisë elektrike**

Në regjionin e Shtërpcës rreth 70% të linjave prej 10 kV janë të ndërtuara nga seksionit të vogël të tërthortë (Al/Çe – 25 mm2 dhe 35 mm2) dhe ky seksion është i pa mjaftueshëm për t'i furnizuar kërkesat e konsumatorëve në lokalitete të caktuara.

	Klientë të amvisërisë		Klientë publik		Klientë komercial	
Vendbanimi	Klientë aktiv	Klientë pasiv	Klientë aktiv	Klientë pasiv	Klientë aktiv	Klientë pasiv
Beroc	270	9	2	0	17	4
Biti i Epërm	173	10	3	0	8	1

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Biti i Poshtëm	220	10	1	0	26	6
Brezovicë	963	16	9	0	65	15
Brod	356	19	3	0	29	3
Drajkoc	76	8	1	0	18	2
Firajë	270	6	2	0	8	3
Gotovushë	352	6	2	0	26	4
Izhanc	23	2	0	0	2	0
Jazhincë	460	22	3	0	53	11
Kashtanjevë	53	1	0	0	2	0
Sevcë	408	29	3	0	18	3
Sushicë	52	0	2	0	3	0
Shtërpcë	1013	45	7	2	222	28
Vërbeshticë	322	24	3	0	44	9
Viqë	97	9	1	0	3	2
Gjithsej	5108	216	42	2	544	91

Tabela 41 Infrastruktura për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, numri i klientëve sipas kategorive

2.4.7. Telekomunikacioni

Shërbimet telefonike fikse të Telekomit të Kosovës (PTK), në Komunën e Shtërpcës, janë të mbuluara me rrjetin e telefonisë fikse, ndërsa nëpër disa vendbanime rurale, nuk ekziston. Në Komunën e Shtërpcës ekziston centrali i PTK-së me kapacitetit prej 1.500 numrave. Nga ky central bëhet shtrirja në linjat kryesore magjistrale që shkojnë në drejtim të Brezovicës dhe qendrës skijimore në Sharr, por ekziston edhe linja kabllore e pavarur e ashtuquajtur Vendpushimet e SPB-së në vikend zonë tek vendbanimi Qershia e Rexhës. Linja magjistrale e përmendur është me 150 linja deri të kutia e kabllove në afërsi të lokacionit "Brvnara". Nga kjo pjesë e linjës së magjistrales ndahet rrjeti kabllor me 50 linja deri tek hotel "Narcis", ndërsa për në drejtim të qendrës skijimore shtrihet kablloja me 100 linja deri të degëzimi tjetër në vikend zonë të Qershisë. Nga ky degëzim i qendrës skijimore, përkatësisht hotelit "Molika" është një kabllo e shtrirë prej 50 linjave, ndërsa në degëzimin e përmendur në zonën e Qershisë është lënë porti për lidhjen edhe të 50 linjave tjera. Përveç këtyre rrjeteve kabllore ekzistojnë dy rrjete ajrore përmbi vendbanimin e Shtërpcës me 180 palë dhe drejt fshatit Berevcë me 40 palë. Telefonia fikse shtrihet në 11 vendbanime me gjithsej 1.500 numra të telefonit. Vendet e banuara ku është i shtrirë rrjeti i telefonisë janë : Shtërpca, Sevca, Jazhinca Vërbeshtica, Brezovica, Bereci, Bitia e E., Bitia e P., Gotovusha, Drajkoci dhe Viça.

DRAFT



*Harta 26 Rrjeti i infrastrukturës së telekomunikimit**

2.4.7.1. Telefonia mobile

Territori i Komunës së Shtërpcës është mjaftë mirë i mbuluar me rrjetin e telefonisë mobile. Të dy operatorët mbulojnë teritorin e Shtërpcës me shërbime të telefonisë mobile me zë "voice" dhe me të dhëna "data".

Mbulueshmëria me shërbimet e zërit "voice" në Komunën e Shtërpcës është e kënaqshme, përfshirë edhe zonat rurale në përjashtim të zonave malore të pa banuara ku vërehet mungesë e sinjalit 3G dhe LTE.

Shërbimet "data" që ofrohen janë një përfshirje e gjerë e teknologjive nga EDGE/GPRS, 3G/WCDMA dhe 4G/LTE. Mbulueshmëria me këto shërbime është e koncentruar në zonat më të banuara, ndërsa duhet të bëhen përmirësime në zonat rurale dhe ne zonat turistike dhe rritje e kapaciteteve në zonat urbane.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Sipas të dhënave nga Atlasi Elektronik, numri i BTS në Territorin e Komunës së Shtërpcës është i mjaftueshëm në zonën urbane, ndërsa në zonat rurale dhe ato malore duhet të rritet i BTS-ve. Mënyrë me e përshtatshme për ta bërë këtë rekomandohet që të ndërtohen BTS të përbashkët nga dy operatorët, gjë që do të ulë edhe kostot e tyre të operimit. Njëkohësisht do të përmirësonte edhe mbulueshmërinë me shërbime për qytetarët dhe turistët.

2.4.7.2. Shërbimet e internetit

Bazuar në të dhënat e dërguara nga operatorët, vërehet se Komuna e Shtërpcës qëndron mirë në ofrimin e shërbimeve të internetit dhe DTV.

Operatorët e licencuar ofrojnë shërbime kryesisht në zonat urbane dhe në disa zona rurale, ku përqendrimi i qytetarëve/banesave është më i madh. Ndërsa në zonat e largëta dhe më pak të banueshme këta operatorë nuk ofrojnë shërbime. Në këto zona shërbimet ofrohen nga operatorë lokal, shpeshherë të pa licencuar dhe me kualitet jo të kënaqshëm të shërbimit. Ofrimi i shërbimeve bëhet përmes sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) në mbi 80% të rasteve dhe në 20% të rasteve përmes GPON (Fiber).

Gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Shtërpcës është relativisht e mirë. Ekzistojnë disa kompani (operatorë ekonomikë) që bëjnë shpërndarjen e rrjetit të internetit.

Operatorët e licencuar që operojnë në Komunën e Shtërpcës ofrojnë shërbimet e internetit, TV digjital dhe disa prej tyre edhe telefonitë FIX-e e që janë Telekomi i Kosovës dhe Rrjeti i Kompanisë IPKO.

Shpërndarja e teknologjive dhe e rrjetave të avancuara në Komunën e Shtërpcës është zhvilluar me një ritëm jo të rregullt dhe në mënyrë të pakoordinuar. Infrastruktura e rrjetit të telefonisë fikse nuk është e shtrirë në të gjithë territorin e komunës, kryesisht fshatrat malore nuk posedojnë rrjet të kabllovikut nga asnjë operator që vepron në nivel komunal.

2.4.8. Infrastruktura e ngrohjes qendrore

Zona urbane por edhe fshatrat nuk kanë sistem të ngrohjes qendrore, kështu që gjithë banorët, bizneset, industritë dhe afarizmi për ngrohje përdorin ngrohjet individuale, ku si lëndë djegëse kryesisht përdorin drurin, rrymën elektrike, gazin, karburantet, thëngjillin. Kohëve të fundit përdorin edhe peletin.

2.4.9. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Aktualisht, shërbimi i menaxhimit të mbeturinave në komunë ofrohet nga "NJKP' (Novo Javno Komunalno Preduzeće/Kompani Publike Komunale), e cila kryen grumbullimin e mbeturinave nga amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe transportimin e tyre në deponinë sanitare regjionale në Velekincë-Gjilan. Në bazë të të dhënave nga "Draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027", mbulimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për vitin 2021 për tri kategoritë e konsumatorëve vijon:

- 90% mbulim për konsumatorët e amvisërisë;
- 85% për konsumatorët biznese; dhe
- 88% për konsumatorët publik - institucionet.

Rrjeti i shërbimit është i shtrirë në rreth 80% të territorit të komunës, ku nga 16 vendbanime në Komunën e Shtërpcës, vetëm 3 fshatra nuk janë të mbuluara me shërbimet komunale (Sushica, Izhanca dhe Kashtanjeva), për shkak të infrastrukturës së pakalueshme. Pajisjet komunale janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në 13 fshatra. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave ofrohet në 3 zona:

- Urbane – konsumatorët janë të pajisur me kontejnerë të përbashkët, grumbullimi kryhet çdo ditë
- Periferike dhe Rurale – konsumatorët e pranojnë shërbimin derë më derë, grumbullimi kryhet një herë në javë.

Sa i përket infrastrukturës për bartjen dhe transportimin e mbeturinave, kompania ka në dispozicion 3 kamionë kompaktorë dy prej të cilëve me kapacitet bartës 6 ton dhe njëri 10 ton, të cilët kryejnë funksionin e transportimit deri në stacionin transfer në Gërlicë. Kamionët janë të vjetër dhe në gjendje të keqe, njëri prej tyre tashmë komplet jashtë funksionit.

Për grumbullimin e mbeturinave janë në dispozicion kontejnerët metalik prej 1,1m³, dhe të tjerë 120l dhe 240l. Kontejnerët 1.1 m3 janë të shpërndarë pranë shesheve dhe rrugëve publike, ku në disa raste problematikë përbën edhe hedhja e mbeturinave inerte dhe hirit. Në vendbanimet të cilat nuk janë të mbuluara me shërbime komunale, deponimi i mbeturinave bëhet në deponi të egra.

DRAFT

Komuna e Shtërpcës është në proces të hartimit të Planin Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh, sipas Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.

2.4.9.1. Numri i klientëve sipas kategorive, sasia e gjenerimit dhe mbulueshmëria me shërbime të menaxhimit të mbeturinave për secilin vendbanim

Baza e të dhënave të operatorit për klientët e shërbyer nuk është e azhurnuar dhe, si shembull, edhe pse të gjitha familjet shërbehen në një vendbanim, faturohet vetëm një përqindje e caktuar e tyre. Shkalla e arkëtimit në Komunën e Shtërpcës shfaqet e ulët rreth 49%, çka do të se thotë kemi një sistem jo efikas të arkëtimit[12], shërbimet në njëfarë forme nuk kushtëzohen, gjë që ndikon në cilësinë e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.

Emri i operatorit	Numri i familjeve	Numri i familjeve të shërbyera	Numri i bizneseve aktive	Numri i bizneseve të shërbyera	Numri i institucioneve	Numri i institucioneve të shërbyera
NJKP	2750	2284	111	79	23	23

Tabela 42 Mbulimi i shërbimit në territorin e komunës

Nga të dhënat në dispozicion, prej gjithsej 2,884 konsumatorëve në territorin e komunës, **2,386** prej tyre janë në sistem dhe shërbehen me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, ku specifikisht **83.0%** e konsumatorëve të amvisërisë janë në sistem, **71.2% e** bizneseve dhe **100.0%** e konsumatorëve publik.

2.4.9.2. Gjatësia e rrjetit, numri, vëllimi dhe distanca në mes kontejnerëve sipas vendbanimeve

Komuna	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i kontejnerëve (nr.)	Vëllimi i kontejnerëve	Dist. mes. ndërmjet kont. (m)
Shtërpcë		2300	120 l	
		40	240 l	
		45	1.1 m^3 (kont. metalik)	

Tabela 43 Menaxhimi me mbeturina, rrjeti i shërbimit

Kontejnerë funksionalë (në gjendje pune):

- 70% e kontejnerëve 120l;
- 60% e kontejnerëve 240l; dhe
- 80% e kontejnerëve 1.1m^3.

2.4.9.3. Numri dhe gjenerimi i mbeturinave i klientëve sipas kategorive

Kodi referues#	Sipërfaqja (ha)
Njësia deponuese – Velekincë (Gjilan)	24

Tabela 44 Menaxhimi me mbeturina, deponitë – shtrirja hapësinore e deponive

Komuna e Shtërpcës si komunitet i vogël nuk posedon stacionin transfer për grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave, prandaj këto dërgohen direkt për deponim përfundimtar në deponinë sanitare regjionale në Velekincë-Gjilan, e cila menaxhohet nga KMDK sh.a. Deponitë nën menaxhimin e KMDK sh.a. janë deponi sanitare për trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme komunale dhe të amvisërisë sipas katalogut të mbeturinave të përcaktuar në Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina.

Kjo deponi u shërben komunave të Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Kaçanikut, Shtimes, Ferizajt, Hanit të Elezit, Kllokotit, Parteshit, Ranillugut dhe Shtërpcës. Gjendja e deponisë nuk është e kënaqshme. Sistemi i pompimit është jashtë funksionit dhe rrjedhimisht uji sipërfaqësor dhe ai i mbeturinave të deponisë përzihen.[13]

Në komunën e Shtërpcës funksionojnë disa grumbullues joformal të mbeturinave, që kryesisht bëjnë mbledhjen e materialeve prej metalit, plastikës dhe letrës. Këto mbeturina dërgohen tek operatorët e brendshëm që merren me riciklimin e tyre, p.sh. në Ferizaj, ose eksportohen jashtë vendit.

Gjendja me deponitë ilegale

[12] Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë, 2018
[13] Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë, 2018

Të dhënat e fundit nga komuna, 2019, tregojnë për 18 deponi ilegale të identifikuara në territorin e komunës. Komuna është angazhuar për eliminimin e deponive ilegale dhe si rezultat kanë arritur t'i mbyllin 50% të tyre, mirëpo prapë se prapë ekziston një numër i deponive ilegale të cilat po ndikojnë në ndotjen e mjedisit.[14] Në mungesë të të dhënave mbi sasinë e mbeturinave që hedhen ilegalisht, shkalla e hedhjes ilegale nuk mund të përcaktohet.

Madhësia e deponisë	Deponitë ilegale	
	Sasia	Përqindja (%)
Deponi e vogël: 1-5 qese mbeturinash (200l)/vellim deri 1 m^3	0	0
Deponi e mesme: 6-20 qese mbeturinash (200l)/vellim 1.2-2 m^3	4	22.2
Deponi e madhe: >20 qese mbeturinash (200l)/vellim >2 m^3	14	77.7
Totali	**18**	100%

Tabela 45 Menaxhimi i mbeturinave, deponitë – shpërndarja hapësinore e deponive

Mbeturinat e ngurta

Në Komunën e Shtërpcës ende nuk ofrohet asnjë shërbim (i organizuar) për këto lloj mbeturinash (mobilje, elektroshtëpiake, etj.) që depozitohen nga qytetarët dhe bizneset. Si rezultat, këto mbeturinat ose hidhen pranë vendpushimeve publike ose hidhen në vende të papërshtatshme duke krijuar deponi të egra.

Mbeturinat nga ndërtimi/demolimi

Komuna e Shtërpcës ka përcaktuar lokacionin për deponimin e mbeturinave nga ndërtimi/demolimi. Megjithatë, meqenëse ky lokacion ende nuk është funksionalizuar, kjo kategori e mbeturinave deponohet në lokacione të ndryshme pa asnjë kriter. Zakonisht, depozitimi i këtyre mbeturinave çon në depozitimin gradual të mbetjeve të tjera në atë vend, duke krijuar kështu deponi të egra. Prandaj, në të ardhmen kjo situatë duhet të trajtohet si prioritet dhe të sillet një zgjidhje adekuate për këtë kategori mbeturinave.

Mbeturinat shtazore

Menaxhimi i mbetjeve shtazore paraqet një sfidë jo të lehtë për komunën. Edhe pse sipas legjislacionit aktual, komuna nuk është drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e kësaj kategorie, megjithatë keq menaxhimi i kësaj kategorie të mbeturinave (duke pasur parasysh specifikat e saj) shkakton probleme serioze për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Aktualisht nuk ekzistojnë praktika të menaxhimit të kësaj kategorie. Praktikat e përpunimit teknologjik të tyre ende nuk janë të aplikueshme në Kosovë. Si pasojë, një pjesë e tyre përfundojnë në kontejnerë me mbeturinat tjera dhe hidhen në deponi ose hidhen në mënyrë të paligjshme.

Mbeturinat medicinale

Mbeturinat medicinale si: mbetjet anatomike, materialet nga intervenimet kirurgjike, gjaku, shiringat, mbetjet nga kulturat biologjike, grumbullohen nga operatori i autorizuar për përpunim të mëtutjeshëm. Një pjesë e tyre dërgohet në sterilizatorin në Spitalin Rajonal të Ferizajt, një pjesë dërgohet për t'u djegur dhe pjesa tjetër dërgohet në deponinë rajonale për deponim përfundimtar. Për mbeturinat e krijuara nga punëtorë shëndetësor, nuk ka të dhëna të sakta se si menaxhohen. Në përputhje me ligjet në fuqi, këto institucione janë të obliguara që të lidhin kontratë me operatorët e licencuar për menaxhimin me mbeturina medicinale.

Mbeturina të tjera

Për kategoritë tjera të mbeturinave të krijuara në Komunën e Shtërpcës, si: bateritë, mbeturinat e vajrave, mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, nuk ka informacion për gjendjen e tyre. Në përgjithësi, ndarja e mbeturinave, trajtimi dhe deponimi pasqyrohen të pafavorshme, si pasojë e mungesës së infrastrukturës, zbatimit të nismave dhe shkaqe vetëdijesimi.

Të dhëna nga raportet komunale tregojnë për një prodhim mesatar të mbeturinave për kokë banori prej 289.3 kg/banorë/vit, 1,827.3 ton mbeturina të grumbulluara nga operatori më 2021 dhe 6,317 banorë të shërbyer.

[14] Mbrojtja e Mjedisit në 16 Komuna – Mundësitë për Bashkëpunim Ndër-Komunal, 2016

Shifra mbi gjenerimin e mbetjeve për vit është marrë për të tri kategoritë e klientëve, duke qenë se operatori nuk aplikon gjenerimin ndaras sipas kategorive.

2.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI PUBLIK

Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe për vet zhvillimin e Komunës së Shtërpcës. Është faktor i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, atë social dhe hapësinor por edhe si pasojë e këtyre rrjedhave luan rol të rëndësishëm në relacionet hapësinore në mes të hapësirave dhe destinacioneve të tyre. Transporti në Shtërpcë është kryesisht trafik rrugor.

2.5.1. Transporti rrugor

Në territorin e Komunës së Shtërpcës, rrjeti i rrugëve të kategorizuara, regjionale dhe rrugore që lidhin qendrën e vendbanimeve me rrugën regjionale, shtrihet në gjerësi totale prej 70 km. Nga këto, 54 km ose 77% janë rrjet bashkëkohor. Nëpër territorin e Komunës së Shtërpcës nuk kalojnë rrugë të karakterit nacional.

Vendbanime	Kategoria e Rrugëve	Gjatësia m
Berofci	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	20211.65
Brezovica	Rrugë Rajonale	761.5
	Rrugë Lokale	5035.81
Brod	Rrugë Rajonale	2992.1
	Rrugë Lokale	28450.22
Bitija e Poshtme	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	8352.88
Drajkovcë	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	22376.94
Bitija e Epërme	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	11467.81
Gotovusha	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	21527.34
Izhanci	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	8108.29
Jazhinca	Rrugë Rajonale	7808.8
	Rrugë Lokale	24222.69
Kashtanjeva	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	24312.94
Sevcë	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	30180.36
Shtërpca	Rrugë Rajonale	6066.59
	Rrugë Lokale	49021.81
Sushiqi	Rrugë Rajonale	
	Rrugë Lokale	7837.17
Viçë	Rrugë Rajonale	298.8
	Rrugë Lokale	17013.71
Vërbeshticë	Rrugë Rajonale	9097.48
	Rrugë Lokale	33537.64

Tabela 46 Mbulueshmëria me rrugë në vendbanime

DRAFT



*Harta 27 Infrastruktura rrugore në komunën e Shtërpcës**

2.5.1.1. Rrugët Rajonale

Komuna e Shtërpcës ka një mbulueshmëri dhe lidhshmëri të mirë me rrugë rajonale.

Nr.	Emërtimi i rrugëve	Gjatësia
1	Rruga Shtërpcë – Prizren	22.5 km
2	Rruga Shtërpcë – Brezovicë	9.6 km
3	Rruga Brezovicë – Verbeshticë	4.3 km
	TOTALI	**36.4 km**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Tabela 47 Mbulueshmëria me rrugë rajonale

2.5.1.2. Rrugët lokale

Komuna e Shtërpcës ka një mbulueshmëri dhe lidhshmëri të mirë me rrugë lokale.

	Gjatësia
Totali i rrugëve lokale-komunale në km	**227.42 Km**

Tabela 48 Mbulueshmëria me rrugë lokale

2.5.2. Transporti hekurudhor

Në territorin e Komunës së Shtërpcës nuk ekziston transporti hekurudhor. Stacioni më i afër hekurudhor është në Kaçanikun e Vjetër rreth 20 km larg vendbanimit të Shtërpcës, linja hekurudhore Fushë Kosovë – Shkup. Mungesa e stacioneve hekurudhore dhe largësia e stacione ekzistuese këtë komunë e vendos në një pozitë mjaft të pafavorshme sa i përket transportit, që reflektohet në transportin masiv të mallrave dhe produkteve.

2.5.3. Transporti ajror

Komuna e Shtërpcës nuk ka aeroport. Aeroporti më i afërt është aeroporti i Prishtinës – 61 km larg Shtërpcës.
Në të ardhëm nuk parashikohet ndërtimi i aeroportit, kështu që kjo komunë do t'i drejtohet aeroportit të Prishtinës dhe të Shkupit.

2.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

2.6.1. Shëndetësia

Në Komunë të Shtërpcës ka:

- 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- 2 Qendra të Mjekësisë Familjare;
- 7 Ambulanta të Mjekësisë Familjare.

Numri i të punësuarve në institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor është:

- 13 mjekë të përgjithshëm;
- 15 mjekë të specializuar;
- 1 farmacist.

Vendbanimet	Institucioni	Lagja/ zona gravituese	Mjek te përgjithshëm (nr.)	Mjek ne specializim (nr.)	Mjek te specializuar (nr.)	Farmacist (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)
Shtërpcë	QKMF	Tërë Komuna	3		14	1	0.2	0.13	0.07	1524.1	P+1
Drejkoc	QMF	Drejkoc, Gotovushë, Viqë	2	-	-	-	0.12	0.026	0.117	179.5	P
Brod	QMF	Brod, Firajë	1	-	1	-	0.06	0.025	0.058	200	P
Vërbëshicë	AMF	Vërbëshicë	1				0.08	0.03	0.05	52.7	P
Sushicë	AMF	Sushicë	1				0.9	0.03	0.87	48.5	P
Sevcë	AMF	Sevcë	1				0.08	0.03	0.05	43.8	P
Jazhincë	AMF	Jazhincë, Brezovicë, Sushicë, Sevcë	1				0.2	0.04	0.16	95.3	P
Gotovushë	AMF	Gotovushë	1				0.04	0.03	0.01	180.2	P
Bitija e Epërme	AMF	Bitija e Epërme	1				0.02	0.01	0.01	26	P
Bitija e Ulët	AMF	Bitija e Ulët	1				0.02	0.01	0.01	16	P

Tabela 49 Veçoritë e institucioneve shëndetësore te nivelit parësor

Në Komunë të Shtërpcës ekziston edhe ndërtesa e Spitalit të Përgjithshëm, mirëpo ky institucion asnjëherë nuk është funksionalizuar dhe nuk ofron asnjë shërbim.

DRAFT

2.6.2. Institucionet arsimore

Në Komunë ekziston një çerdhe/kopsht publik për fëmijë.

Në institucionet publike të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët:

- 2,045 nxënës vijojnë mësimet;
- punojnë 250 mësimdhënës; dhe
- shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme të parcelave prej 3.245 ha me sipërfaqe të lirë prej 2.517 ha.

		Nxënës të regjistruar (nr.)						**Ndërtesa kryesore**		**Klasat**		**Vendparkingjet (nr.)**	
Vendbanimet	**Emri I institucionit**	**Meshkuj**	**Femra**	**Mësimdhënës (nr.)**	**Sipërfaqja e parcelës (ha)**	**Sipërfaqja e ndërtuar (ha)**	**Sipërfaqja e lire (ha)**	**Sipërfaqja (m^2)**	**Etazhiteti (P)**	**Sipërfaqja (m^2)**	**Numri (nr.)**	**Për vizitor**	**Për zyrtar**
Shtërpcë	"STAJA MARKOVIC"	213	206	37	0.3	0.2	0.1	/	P	/	/	/	/
Popaj	"STAJA MARKOVIC	63	55	/	/	/	/	/	P	/	/	/	/
Sushiqë	"STAJA MARKOVIC"	13	7	/	/	/	/	/	P	/	/	/	/
Sevcë	"SHARSKI ODRED"	41	47	25	0.17	0.2	0.12	0.17	P	1200	/	3	2
Jazhincë	"SHARSKI ODRED"	64	58	26	0.045	0.19	0.007	0.045	P	70	/	3	4
Vërbeshticë	"SHARSKI ODRED"	17	16	27	0.02	0.19	0.15	0.022	P	1500	/	2	1
Gotovushë	"RAJKO UROSHEVIC"	59	61	11	0.6	0.1	0.5	/	P	/	/	/	/
Viçë	"RAJKO UROSHEVIC"	4	2		0.11	0.02	0.09	/	P	/	/	/	/
Firajë	"OSMAN MANI"	61	82	22	0.39	0.14	0.25	1344	1	944	15	0	0
Viçë	"OSMAN MANI"	13	13		0.08	0.03	0.05	144	P	126	4	0	0
Brod	"RAZIM COKLI"	56	75	34	0.6	0.2	0.4	909	1	755	10	0	0
Brod	"RAZIM COKLI"	58	53		0.25	0.05	0.2	641	P	561	11	0	0
Izhanc	"RAZIM COKLI"	2	2		0.2	0.05	0.15	388	P	323	5	0	0
Bitijë e Epërme	"ANTON SANTORI"	10	10	8	0.11	0.04	0.07	388	P	323	5	0	0

Tabela 50 Institucionet arsimore fillore dhe të mesme të ultë, regjistri sipas vendbanimeve

Në institucionet publike të arsimit të mesëm të lartë:

- 693 nxënës vijojnë mësimet;
- 74 mësimdhënës punojnë;
- shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme të parcelave prej 0.71 ha me sipërfaqe të lirë prej 0.53 ha;

	Nxënës te regjistruar (nr.)					**Ndërtesa kryesore**	**Klasat**	**Vendparkingjet (nr.)**

Vendbanimet	Emri i institucionit	Meshkuj	Femra	Mësimdhënës (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja (m^2)	Numri (nr.)	Për vizitor	Për zyrtar
Shtërpcë	"JOVAN CVIJIQ"	275	285	60	0.55	0.12	0.43	/	P	/	/	/	/
Firajë	"KONGRESI I MANA."	68	65	14	0.16	0.06	0.1	1306	1	1100	14	0	0

Tabela 51 Institucionet arsimore të mesme të lartë, regjistri sipas vendbanimeve



*Harta 28 Shtrirja e institucioneve publike të arsimit paraunversitar**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

2.6.3. Institucionet administrative

Në komunë shtrihet ndërtesa kryesore e Kuvendit Komunal në një sipërfaqe të përgjithshme kadastrale prej 0.15 ha dhe dy Zyra të Gjendjes Civile që shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme kadastrale prej 0.14 ha.

Vendbanimet	Institucioni	Lagja/ zona gravituese	Numri I zyrtareve (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)
Shtërpcë	Kuvendi Komunal	Tere Komuna		0.15	0.05	0.1
Brod	Objekt Administrativ	Brod	2	0.1	0.03	0.07
Drajkoc	Objekt Administrativ	Drajkoc, Firaj	3	0.04	0.02	0.02
Shtërpcë	Gjykata	Tere Komuna		0.04	0.02	0.02
Shtërpcë	Stacioni Policorë	Tere Komuna		0.13	0.03	0.1
Shtërpcë	Posta	Tere Komuna	3	0.02	0.01	0.01
Shtërpcë	KEDS	Tere Komuna	5	0.12	0.02	0.1
Drajkoc	Zjarrfikësit	Drajkoc, Firaj		0.05	0.03	0.02
Shtërpcë	Ndërmarrja publike NJKP	Tere Komuna	4	0.03	0.02	0.01
Shtërpcë	Objekt social	Tere Komuna		0.03	0.01	0.02
Shtërpcë	Zyra për punësim	Tere Komuna	2	0.02	0.01	0.01
Shtërpcë	Zjarrfikësit	Tere Komuna	5	0.08	0.03	0.05

Tabela 52 Institucionet e administratës publike

2.6.4. Kultura

Oferta kulturore e Komunës së Shtërpcës duhet të jetë në përputhje me mundësitë, kërkesat dhe rekomandimet të cilat kanë qenë rezultat i procesit të pjesëmarrjes në planifikim.

Shtëpia e Kulturës "Shën Sava" në Shtërpcë është një nga institucionet ku mbahen një sërë aktivitetesh kulturore. Në territorin e Komunës e Shtërpcës është planifikuar ndërtimi i objekteve kulturore në vendbanimet: Firaja, Brod, Viçë dhe Brezovicë, ndërsa në vendbanimet Sevcë, Jazhincë dhe Vërbeshticë, rindërtimi i nevojshëm dhe zgjerimi i objekteve ekzistuese.

Në Komunë të Shtërpcës ka 5 Shtëpi të Kulturës, të cilat shtrihen në parcela kadastrale me sipërfaqe prej 0.48 hektarë.

Vendbanimet	Institucioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)
Shtërpcë	Shtëpi e Kulturës	0.1	0.05	0.05
Vërbashticë	Shtëpi e Kulturës	0.05	0.03	0.02
Jazhincë	Shtëpi e Kulturës	0.08	0.03	0.05
Drajkoc	Shtëpi e Kulturës	0.19	0.05	0.14
Sevcë	Shtëpi e Kulturës	0.06	0.05	0.01

Tabela 53 Veçoritë e institucioneve kulturore

Bibliotekat në vendbanime: Në Komunën e Shtërpcës në të gjitha fshatrat ku është i planifikuar ndërtimi i objekteve kulturore, në kuadër të tyre është paraparë edhe rregullimi i hapësirës për bibliotekë dhe sallë të leximit, ku përveç huazimit të librave do të mundësohet edhe leximi. Në objektet ekzistuese kulturore që nuk kanë biblioteka po ashtu do të parashihet ofrimi i hapësirës për rregullimin e bibliotekave dhe sallave për lexim. Për arsimin fillor dhe për shkollat e mesme në Shtërpcë duhet të sigurohet nga një sallë që do të përdoret për lloje të ndryshme të aktiviteteve kulturore.

Ansambletë aktuale dhe shoqatat kulturore artistike në Komunën e Shtërpcës janë: "Cvetko Grbiç" Shtërpcë, "Rinia" Gotovushë, "Lepenci" Sevcë dhe "Sh. Petar" Vrëbeshticë. Për veprimtaritë e tyre kulturore mund të përdoren objektet e mësipërme kulturore tashmë ekzistuese ose të cilat do të ndërtohen. Ky lloj i kulturës ka nevojë për t'u mbështetur dhe për të krijuar kushtet për funksionimin e tij. Duhet të punohet në organizimin e Panairit Vjetor të Librit në Komunë, për hapjen e shkollës se ulët të muzikës, themelimi i korit të qytetit, themelimi i një klubi të artistëve, piktorëve, dhe aktivizimi i kinemasë urbane në Shtërpcë. Me qëllim të hulumtimit, konservimit, mbledhjes, raportimit, si dhe prezantimit të trashëgimisë së luajtshme për qëllime të studimit, edukimit dhe perceptimit të saj për qytetarët e komunës dhe më gjerë, është e nevojshme për të krijuar një **Muze në Komunën e Shtërpcës.**



*Harta 29 Shtrirja e institucioneve publike kulturore dhe administrative**

2.6.5. Hapësirat sportive dhe rekreative

Në Komunë shtrihen 11 hapësira sportive dhe rekreative që shtrihen në sipërfaqe të përgjithshme të parcelave kadastrale prej 1.76 ha.

Vendbanimet	Institucioni	Lagja/ zona graviteuese	Numri I zyrtareve (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)
Verbeshice	Fushë Sportive	Verbeshice	1	0.07	0.05	0.02
Verbeshice	Fushë Sportive	Verbeshice	0	0.11	0.1	0.01
Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	1	0.05	0.04	0.01

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	0	0.05	0.03	0.02
Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	1	0.04	0.04	0.00
Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	0	0.17	0.1	0.07
Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	0	0.07	0.05	0.02
Shtërpce	Fushë Sportive	Shtërpce	1	0.04	0.03	0.01
Jazhincë	Fushë Sportive	Jazhincë	0	0.12	0.08	0.04
Gotovushë	Fushë Sportive	Gotovushë	0	0.15	0.12	0.03
Biti e Poshtme	Fushë Sportive	Biti e Poshtme		0.03	0.03	0.00

Tabela 54 Hapësirat rekreative dhe sportive

2.6.6. Hapësirat publike dhe të gjelbra

Në Komunë shtrihen 11 parqe publike që shtrihen në sipërfaqe të përgjithshme të parcelave kadastrale prej 1.70 ha, si dhe një shesh publik që shtrihet në sipërfaqe të përgjithshme të parcelave kadastrale prej 0.16 ha.

Vendbanimet	**Hapësira**	**Lagja/ zona gravituese**	**Sipërfaqja e parcelës (ha)**
Jazhincë	Park	Jazhincë	0.04
Berofc	Park	Berofc	0.03
Shtërpcë	Park	Shtërpcë	0.07
Shtërpcë	Park	Shtërpcë	0.04
Shtërpcë	Shesh	Shtërpcë	0.16
Viçë	Park	Viçë	0.03
Berofc	Park	Berofc	0.02
Berofc	Park	Berofc	0.02
Berofc	Park	Berofc	1.37
Jazhincë	Park	Jazhincë	0.03
Biti e Poshtme	Park	Biti e Poshtme	0.03
Shtërpcë	Park	Shtërpcë	0.02
Gotovushë	Park	Gotovushë	0.03

Tabela 55 Hapësirat publike dhe të gjelbra

2.6.7. Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

Në Komunë të Shtërpces ka një Qendër të Punës Sociale që shtrihet në parcelë kadastrale me sipërfaqe prej 500m^2 ku punojnë 8 zyrtarë.

Vendbanimet	**Institucioni**	**Viti I themelimit**	**Lagja/zona gravituese**	**Zyrtar të përgjithshëm (nr.)**	**Zyrtar të specializuar (nr.)**	**Sipërfaqja e parcelës (ha)**	**Sipërfaqja e ndërtuar (ha)**	**Sipërfaqja e lire (ha)**
Shtërpce	QPS	2008	Komuna	5	3	0.05	0.03	0.02

Tabela 56 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit

Në Komunë të Shtërpces janë gjithsejtë 1,395 persona që pranojnë ndihmë sociale, prej të cilëve 1370 janë persona te moshës se shtyrë.

Personat ne nevoje- kategoritë	**Numri i banorëve**
Fëmijë pa përkujdesje prindore	/
Fëmijë me sjellje asociale	/
Delikuent te mitur	/
Persona me marrëdhënie te çrregulluara ne familje	4
Persona te moshës se shtyrë	1370
Persona me sëmundje trupore ose aftësi te kufizuara fizike	18
Persona me të aftësive të kufizuara mendore	/
Persona me sëmundje mendore	/
Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi	/
Viktima te dhunës ne familje	3

Viktima te trafikut te qenieve njerëzore	/
Persona me varësi nga alkooli ose drogat	/
Viktima të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu	/
Kategori te tjera	/

Tabela 57 Institucionet e mirëqenies sociale dhe komunitetit, personat ne nevojë

2.6.8. Objektet e religjionit dhe varrezat publike

Sa i përket objekteve fetare në Komunën e Shtërpcës gjinden përafërsisht 16 Kisha dhe 5 Xhami, të shtrira në pjesën me të madhe të vendbanimeve.

Vendbanimi	Objektet fetare	Sipërfaqja ha
Viçë	Kishë Ortodokse	0.06
2 Vërbashticë	Kishë Ortodokse	0.28
3 Shtërpce	Kishë Ortodokse	0.30
2 Sevcë	Kishë Ortodokse	0.10
Jazhincë	Kishë Ortodokse	0.06
2 Gotovushë	Kishë Ortodokse	0.20
Drajkoc	Kishë Ortodokse	0.07
Brod	Kishë Ortodokse	0.03
Bitijë e Poshtme	Kishë Ortodokse	0.01
Bitija e Epërme	Kishë Ortodokse	0.12
Berofcë	Kishë Ortodokse	0.02
Kushtanjevë	Xhami	0.02
Drajkoc	Xhami	0.13
2 Brod	Xhami	0.25
Bitija e Epërme	Xhami	0.1

Tabela 58 Objektet religjioze

Varrezat ekzistojnë pothuajse në çdo fshat, dhe në disa vendbanime ka edhe më shumë se një parë varreza. Janë të parregulluara dhe pa infrastrukturë minimale nga ana komunale. Në bazë të analizave në terren, grupi të cilin e kanë përfaqësuar përfaqësuesit e komuniteteve fetare ka identifikuar lokacione të varrezave në tërë territorin e komunës, ku është konstatuar se një pjesë e tyre i përmbushë nevojat edhe për 10-të vitet e ardhshme. Është e nevojshme të merren masat për infrastrukturë shtesë që duhet për mirëmbajtje, menaxhim dhe rregullim. Në të gjitha vendbanimet mungon hapësira për varrim dhe qëndrim, mungojnë rrethoja, si dhe shtigjet, gjelbërimi dhe veprimtaritë e tjera të nevojshme. Janë të planifikuara edhe vendet për varre që janë të paraqitura në hartën e infrastrukturës së varrezave.

Në Komunë të Shtërpcës ka 23 varreza publike, nga të cilat:

- 13 janë varreza publike për besimtarë ortodoks; dhe
- 8 janë varreza publike për besimtarë mysliman.

Varrezat publike shtrihen në parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 26.27 hektarë.

Vendbanimet	Institucioni	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)
Bitija e Epërme	Varreza Myslimane	0.08	0.008	0.072
Brod	Varreza Myslimane	1.7	0.34	1.36
Drajkoc	Varreza Myslimane	0.08	0.016	0.064
Kushtanjevë	Varreza Myslimane	0.06	0.012	0.048
Viçë	Varreza Myslimane	0.3	0.03	0.27
Drajkoc	Varreza Myslimane	0.5	0.1	0.4
Drajkoc	Varreza Myslimane	0.1	0.07	0.03
Bitija e Epërme	Varreza Myslimane	0.06	0.006	0.054
Bitija e Epërme	Varreza Ortodokse	0.8	0.24	0.56
Berofcë	Varreza Ortodokse	0.4	0.24	0.16
Drajkoc	Varreza Ortodokse	0.8	0.16	0.64
Jazhincë	Varreza Ortodokse	1.25	0.375	0.875
Gotovushë	Varreza Ortodokse	0.5	0.1	0.4

Gotovushë	Varreza Ortodokse	16	14.4	1.6
Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.7	0.63	0.07
Sevcë	Varreza Ortodokse	0.75	0.075	0.675
Viçë	Varreza Ortodokse	0.65	0.13	0.52
Bitijë e Poshtme	Varreza Ortodokse	0.22	0.044	0.176
Vërbashicë	Varreza Ortodokse	0.15	0.06	0.09
Vërbashicë	Varreza Ortodokse	0.2	0.1	0.1
Vërbashicë	Varreza Ortodokse	0.1	0.02	0.08
Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.07	0.021	0.049
Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.8	0.48	0.32

Tabela 59 Veçoritë e institucioneve kulturore

2.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

2.7.1. Mjedisi

Ndotja në gjithë territorin e Kosovës dhe në gjitha komponentët mjedisor është mjaftë prezente duke kontaminuar mjedisin ku jetojmë dhe ku veprojmë. Si probleme kryesore lidhur me mjedisin në Komunën e Shtërpcës listohen situata me deponitë ilegale, përfshirja e ulët në rrjetin e kanalizimit dhe derdhja e ujërave të zeza në lumenj pa trajtim paraprak. Niveli i ulët i vetëdijesimit gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, ku si rezultat kemi numër të konsiderueshëm të deponive ilegale, hedhjen e tyre në lumenj dhe hapësira publike.

2.7.2. Ndotja e ajrit

Në kuadër të monitorimit të gjendjes së mjedisit AMMK, përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës, mirëmban rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe bën përcjelljen sistematike të cilësisë së ajrit dhe nxjerr konstatime mbi nivelin e ndotjes së ajrit në 2 zona monitorimi:

- Aglomerati - AKS1 (që përfshin Prishtinën dhe Obiliqin)
- Zona monitoruese ZKS1 (Brezovica, Drenasi, Gjilani, Hani i Elezit, Mitrovica, Peja, Prizreni)

Stacioni i monitorimit Brezovicë-KS0507A është i vetmi stacion në kuadër të Komunës së Shtërpcës, pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit.

Komuna e Shtërpcës nuk ka ndonjë zhvillim të madh industrial në tërësi që mund të ndikojë në ndotjen e ajrit. Kapacitetet industriale aktuale janë të vogla, kryesisht ndërmarrjet shtrijnë tregun në nivelin lokal. Duke qenë se stacioni i monitorimit është i llojit malor/mjedis rural, në zonën urbane të Shtërpcës nuk ka stacion monitorimi, edhe pse ndotja është evidente, kryesisht nivelet e pluhurit si pasojë e djegies së lëndëve djegëse për ngrohje edhe disa tymtarë nga hotelieritë dhe bizneset e vogla. Kjo mund të bëhet edhe më e vështirë gjatë periudhës së dimrit ku edhe faktorët klimatik janë ata që ndikojnë në ajrin e kësaj zone.

Cilësia e ajrit

Në mungesë të të dhënave të monitorimit për pika të caktuara potencialisht të ndotura brenda territorit të komunës do të bëhet një vlerësim i parametrave në dispozicion (PM10, PM2.5, NO_2, SO_2, CO, O_3), nga stacioni i monitorimit Brezovicë – IHMK (lloji i zonës – rurale), si pjesë e Rrjetit Shtetëror për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit të Kosovës. Pragjet alarmuese për dyoksidin e squfurit dhe dyoksidin e azotit, si dhe informacioni dhe alarmi për ozonin dhe PM10, sipas UA 02/2011 "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe Ligji Nr. 08/L-025 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Ndotës	Pragu alarmues	Periudha mesatare
Dyoksid sulfuri	500 µg/m3	Nuk aplikohet
Dyoksid azoti	400 µg/m3	Nuk aplikohet
Ozoni - informacion	180 µg/m3	1 orë
Ozoni - alarm	240 µg/m3	1 orë
PM10 - informacion	100 µg/m3	24 orë
PM10 - alarm	100 µg/m3 për 3 ditë rresht	24 orë

Tabela 60 Pragjet e alarmit për ndotësit kryesorë të ajrit sipas legjislacionit të Kosovës

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite µg/m3	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO2	Vlerat limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	200	18
	Vlerat limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	40	Nuk parashikohet
	Vlerat limite vjetore, për mbrojtjen e vegjetacionit	µg/m3	30	Nuk parashikohet
SO2	Vlerat limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	350	24
	Vlerat limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore të maksimales 8 orëshe, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	10	Nuk parashikohet
PM10	Vlerat limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	50	35
	Vlerat limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	40	Nuk parashikohet
PM2.5	Vlerat limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	25	Nuk parashikohet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit	µg/m3	120	Nuk parashikohet

Tabela 61 Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011

Parametrat e cilësisë së ajrit në stacionin monitorues Prishtinë - IHMK, për periudhën Janar 2019 – Nëntor 2022

Në grafikun më poshtë interpretohen vlerat e secilit ndotës për periudhën 2019-2022:



Grafiku 7 Mesatarja vjetore e ndotësve të ajrit 2019-2022

2.7.3. Ndotja e ujit

Vendbanimet pa qasje në sistemin e ujësjellësit, sigurojnë ujin e pijes nga puset individuale apo kolektive, të cilat shpesh nuk mirëmbahen si duhet. Këto puse nuk janë të ndërtuara si duhet dhe ndodh të ndoten nga ujërat sipërfaqësor (si ujëra të zeza apo të kulluara) gjë që përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin e popullatës.

Dihet se Komuna e Shtërpcës nuk posedon as një impiant për trajtimin e ujërave të zeza dhe në këtë mënyrë gjitha ujërat e zeza derdhen në lumenj dhe përroska të Shtërpcës, ndërkohë që pjesa më e madhe e këtyre shkarkimeve të këtyre ujërave të pa trajtuara derdhen në pjesën ku ndjeshmëria e ujërave nëntokësore dhe mbi tokësore është e nivelit më të lartë (shih hartën). Sasitë e mëdha të ujërave të ndotur që drejtpërdrejtë derdhen në lumenj me përmbajtjen e tyre fizike dhe kimike në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në ndryshimin e cilësisë së ujit, dhe ashtu ndikojnë në bilancin natyral të lumit.
Në këtë fazë nuk janë siguruar të dhëna mbi parametrat fiziko-kimik të ujërave për përcaktimin e shkallës së ndotjes së ujërave sipërfaqësore.

Më 1978 ishin realizuar disa analiza mikrobiologjike dhe fiziko-kimike të rrjedhave ujore në komunën e Shtërpcës, dhe tregonin për një mjedis ujor shumë të oksigjenuar dhe nivele të ulëta materie organike. Megjithatë, sot, sasitë e mëdha të ujëra të ndotur që derdhen në këto rrjedha, përmbajtja e materies organike dhe joorganike kanë ndikuar në cilësinë e ujit dhe humbjen e vetive.

Përveç ujërave të zeza, erozioni dhe si pasojë transportimi i sedimenteve në ujërat e zonës, janë një problematikë tjetër bazë i ndotjes së rrjedhave ujore.

DRAFT



*Harta 30 Ndjeshmëria mjedisore e ujërave**

2.7.4. Ndotja e tokës

Kjo komponent mjedisore po ashtu është nën ndikim të ndotjes në radhë të parë nga ndërtimet ilegale dhe në formë të pa planifikuar, kështu duke nxënë hapësira të konsiderueshme të tokave bujqësore dhe tokave me vlera të larta të bonitetit. Ngjashëm, toka është e ndotur edhe nga hedhja dhe ekspozimi i mbeturinave jashtë deponive sanitare dhe vendeve adekuate.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



*Harta 31 Ndjeshmëria mjedisore e tokës**

2.7.5. Ndotja nga zhurma

Ekzistojnë disa lloje faktorësh që ndikojnë mirë apo keq në nivelet e zhurmës në komunë. Varësisht karakterit të zonave të caktuara, sipërfaqeve të gjelbra dhe frekuencës së qarkullimit të automjeteve, deri më sot nuk është arritur të vlerësohen nivelet e zhurmës, përmes matjeve, të cilat marrin parasysh përmbajtjen e zhurmave, nivelet e presionit akustik dhe ndryshimin e këtyre niveleve me kalimin e periudhave të caktuara.

Trafiku rrugor është burimi kryesor i emetimit të niveleve të papranueshme (më shumë se 55 dB) të zhurmës në Komunën e Shtërpcës, ashtu si edhe në qytetet tjera të vendit. Për kufijtë e caktuar të zhurmës mjedisore, 55 dB referohet si kufiri standard për mungesën e shqetësimit njerëzor në mjedisin e jashtëm gjatë ditës, dhe 50 dB për orët e mbrëmjes. Aktivitetet ekonomike cilësohen burime kyçe të emetimit të nivele të papranueshme të zhurmës,

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

megjithatë në mungesë të sistemeve matëse është shumë e vështirë të bëhet një vlerësim me bazë në të dhëna ekzistuese (qoftë edhe nga aktivitete ekonomike), apo burime tjera potenciale të emetimit të zhurmave.

2.7.6. Erozioni

Erozioni është një proces natyror, dhe mendohet se aktiviteti njerëzor ka ndikuar në ngritjen e erozionit në mënyrë dramatike. Shfrytëzimi i tokës në Komunën e Shtërpcës, shpyllëzimi dhe shtrirja urbane kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së erozionit. Nisur nga ajo që erozioni si dukuri prek më së shumti terrenet e pjerrëta, karakteristikë e rëndësishme morfometrike e komunës është pjerrtësia prej 25% e cila përfshin 94,77% të sipërfaqes së përgjithshme.

Territori i komunës së Shtërpcës me intensitete të ndryshme të erozionit është përfshirë 246,30 km² ose 99,47%, deri sa akumulimi është i theksuar në 32 km² ose 0,43% të sipërfaqes. Në bazë të koeficientit të erozionit (0,29), kjo sipërfaqe i përket kategorisë së IV të erozionit. Me kategoritë më të forta të erozionit (I-III) janë prekur 26,33 km² ose 10,63% të territorit të Shtërpcës.
Totali i prodhimit vjetor të sedimenteve në Komunën e Shtërpcës është 102.874,35 m³. Prodhimi specifik i sedimenteve, përkatësisht sasia e sedimenteve që prodhohen në 1 km² për tërë sipërfaqen e komunës është 417,68 m³/km²/vit. Nëse masa e përmendur e sedimenteve, e cila çdo vit prodhon dhe në etapa nis procese të ndryshme të erozionit, shndërrohet në shtresa më të trasha se 20 cm, atëherë në Komunën e Shtërpcës në vit lëvizin dhe zhvendosen 51,44 hektar, duke pezulluar shumicën e pjesës kualitative të dheut. Faktorët të cilët ndikojnë në erozionet ujor të sipërfaqeve ose të linjës janë: përbërja gjeologjike, reliefi, klima dhe mënyra e shfrytëzimit të tokës.

Territori i Komunës së Shtërpcës karakterizohet me sipërfaqe erozive sipas kategorive në vijim:

- Sipërfaqe që i janë ekspozuar erozionit shumë të dobët përfshinë rreth 2.379,82 ha, ose rreth 5% të territorit;
- Sipërfaqet e ekspozuara ndaj erozionit të dobët përfshijnë rreth 19.971,54 ha, ose rreth 41% të territorit;
- Sipërfaqet e ekspozuara ndaj erozioni mesatar përfshijnë rreth 13.294,83 ha, ose 27% të territorit të komunës;
- Sipërfaqet me erozion të fortë mbulojnë 11.631,96 ha ose 24% të territorit të komunës, dhe
- Erozioni shumë i fortë shtrihet në sipërfaqe prej 1.399,4 ha ose 3% të territorit të komunës.

Përmirësimi i praktikave të shfrytëzimit të tokës mund të kufizojë erozionin duke rekomanduar sistemet ndërtimore, pyllëzimin dhe shtrirjen e kontrolluar të zgjerimit të vendbanimeve. Komuna e Shtërpcës karakterizohet me shkallë të lartë të erozionit.

DRAFT



*Harta 32 Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit**

2.7.7. Rrëshqitja e tokës

Ky rajon karakterizohet me një llojllojshmëri shumë të theksuar litostratigrafike dhe ka një përbërje të ndërlikuar tektonike të terrenit. Këtu janë të shprehura proceset e theksuara bashkëvepruese gjeologjike, të sjelljes së materialeve nga shpatina me formimin e sipërfaqeve të shpëlarjes së shpejtuar dhe të gërryerjeve, rrëkeve dhe me dukuri të shumta të rrëshqitjeve dhe të shembjeve të dheut, të bartjes së materialeve sterile etj.

2.7.8. Tërmetet

Nga aspekti sizmologjik, territori i Komunës së Shtërpcës paraqet tërë aktivitetin sizmik, ku është e mundur shfaqja e tërmeteve katastrofike. Vet zona me gjasë nuk është e kërcënuar nga paraqitja e tërmeteve më të forta autoktone, por është e ekspozuar ndaj efekteve të forta sizmike të tërmeteve, vatra e të cilëve gjenden në largësi të mëdha apo të

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

vogla. Të dhënat mbi tërmetet, të cilat janë sot në dispozicion, tregojnë se shfaqja e tërmeteve katastrofike është regjistruar qysh në vitin 1457, kur në rrethin e Prizrenit ka ndodhur tërmeti prej 9º MS. Në kohën e re është evidentuar tërmeti që ka ndodhur në gusht të vitit 1921 në zonën në mes të Ferizajt dhe Vitisë, dhe i cili në Komunën e Shtërpcës është regjistruar me intensitet prej 8º MS. Dy lokacionet e cekura kanë ndikimin më të rëndësishëm në karakteristikat sizmike të tërmetit të komunës, sepse paraqesin dy burime sizmike më të afërta dhe më të forta. Shfaqje të tërmeteve autoktone janë të regjistruara në territorin e Komunës së Shtërpcës në zonën e Ostrovicës, Shtërpcës dhe në juglindje të Brodit, por megjithatë, magnitudat e tyre (3-4) tregojnë që janë shumë larg nga për nga rëndësia e definimit të zonës së burimeve sizmike, jashtë rretheve të komunës. Ekzistenca e tërmeteve lokale, qoftë edhe të dobëta, duhet të tregojë në rrezikun që vjen nga veprimet e tyre.



Harta 33 Stabiliteti i terrenit*

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



*Harta 34 Tërmetet**

2.7.9. Rrokullisjet e masave shkëmbore dhe ortekët e dëborës

Bora është një dukuri e rregullt dimërore në Komunën e Shtërpcës. Numri i ditëve me reshje bore, gjatësia dhe trashësia e shtresës së borës rritet me rritjen e lartësisë mbidetare. Numri mesatar vjetor i ditëve me borë që varion për periudhën e viteve 1931-1960 shkon prej 40 në luginën e Lepencit deri në 100 ditë në pjesët më të larta të maleve të Sharrit. Në Shtërpcë numri i ditëve të regjistruara me reshje bore, për periudhën e viteve 1960-1984 është mesatarisht 39, ndërsa në Jazhincë për periudhën e viteve 1959-1985 është 42 ditë. Me shtresën e borës, me të cilën nënkuptohet shtresa e borës me trashësi më së paku 1 cm, disa pjesë janë të mbuluara prej 60 deri në 210 ditë. Shtresa e borës, për shkak të temperaturave të ulëta të ajrit, përherë ka qëndrueshmëri më të gjatë në krahasim me ditët e reshjeve të borës, d.m.th, ditët kur bie borë. Sipas matjeve konkrete për periudhën e viteve 1960-1984 kohëzgjatja mesatare e shtresës së

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

borës në Shtërpcë është 66,5 ditë, në Jazhincë 71,2 ditë. Prandaj, kohëzgjatja e shtresës së borës e shtrirë nga Shtërpca – Jazhincë rritet në 100 për 5 ditë. Në pjesët më të larta të maleve të Sharrit nën shtresën e borës janë pjesët prej 180 deri 210 ditë, që nënkupton 6 deri në 7 muaj. Përndryshe, trashësia mesatare dhe maksimale e shtresës së borës në lartësi mbi 1.700 m, është duke filluar nga 150 deri 200 cm, derisa në rajonet më të ulët është 70 cm.

2.7.10. Erërat

Në Komunën e Shtërpcës më të shpeshtat janë erërat lindore dhe perëndimore, dhe është e qartë që në drejtimin e erërave në mënyrë dominante ndikojnë format e reliefit, që nënkupton drejtimi i luginës së Lepencit dhe malet përreth. Era perëndimore, në mesin e stinës së dimrit sjell reshje të shumta bore. Ajo në muajt e verës, në orët e pasdites, zëvendësohet me erërat juglindore, të cilat depërtojnë në komunën e Shtërpcës nga gryka e Kaçanikut dhe mbi degëzimet më të ulëta të maleve të Sharrit, në lindje të Lubotenit. Megjithatë, në terrenet skijimore të Brezovicës gjatë dimrit dominojnë erërat nga kuadrati verior. Ato fryjnë nga mali i Jezercit, janë të forta, të ftohta me ç'rast sjellin stuhi dëbore dhe borë të imët. Por, ato ndjehen vetëm në pjesët e larta, me mbi 1.200 m lartësi mbidetare, derisa nën të lajmërohen si erëra të dobëta. Kur analizojmë shpeshtësinë e erërave dhe qetësinë nëpër stinët e vitit, qetësia më e madhe është gjatë vjeshtës dhe dimrit, deri sa një frekuencë më të mëdha të reshjeve kanë pranvera dhe vera.

2.7.11. Diellosja

Diellosja (insolacioni) është e rëndësishme për botën e gjallë (bimët, kafshët, njerëzit), për bujqësi, turizëm, shëndetësi etj. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), relievi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat. Në gjerësitë tona gjeografike (42-43 shkallë) diellosja vjetore do të duhej të zgjaste 4450-4460 orë në vit ose 12,2 orë në ditë 9 mesatarisht. Në të vërtetë, diellosja në Kosovë zgjatë 2079 orë ose 5,7 orë në ditë, që është 47% nga diellorja e mundshme.

2.7.12. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Territori i Komunës së Shtërpcës kryesisht ka reliev kodrinoro-malor. Gati 70% e territorit të Shtërpcës është i mbuluar me pyje dhe shkurre, e cila vlerësohet si e cenueshme nga zjarret sidomos gjatë stinës së verës, respektivisht gjatë kohës së thatë dhe temperaturave të larta. Sipas raporteve të komunës, gjatë viteve të fundit ka pasur disa raste të zjarreve të shkaktuara kryesisht nga temperaturat e larta, zjarr vëniet dhe veprimtaritë e pakujdesshme njerëzore.

2.7.13. Vërshimet

Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që kërkojnë vëmendje të veçantë. Vërshimet konsiderohen dukuri që shfaqen në zonat e caktuara që janë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe shkaktojnë dëme të dukshme. Vërshimet nuk mund të parandalohen, por, dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose nga shkrirja e borës duhet të gjejë rrugën e lëvizjes së tij.

Shfaqja e ujërave të mëdha është vështirë të përcaktohet. Vërshimet e mëdha në pellgun e Lepencit janë vërejtur në vitin 1897, 1925, 1933, 1191, 1196, 1953, 1965, 1979 i 1981. Efekt veçanërisht shkatërrues kanë pasur shfaqjet e vërshimeve që janë paraqitur ne vitin 1897, 1953 i 1979. Ato flukse të ujit kanë ngjarë me ujërat e mijëra-vjetëve më parë. Fluksi i ujit në vitin 1953 dhe 1979 ka shkaktuar vërshime katastrofike në luginat e degëve të lumit të Lepencit. Atëherë valët përmbysëse të flukseve rrebeshe të ujit kanë shkatërruar sfondin e pasur të kafshëve të egra dhe peshkun fisnik të Sharrit, me ç'rast kanë mbuluar dhe marrë me vete pjesët e zonave të trafikut dhe shtëpitë. Lumenjtë kanë rrokullisur gurët e mëdhenj, kanë sjellë dhe larguar materialin e papërpunuar, kanë rrafshuar pjesët e bregut dhe kanë ndryshuar regjimin biologjik dhe ujor.

DRAFT

2.8. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE, NATYRORE DHE TURISTIKE

2.8.1. Asetet e Trashëgimisë Kulturore

Komuna e Shtërpcës është mjaftë e pasur me elemente të trashëgimisë kulturore të cilat në të ardhmen duhet të ruhen dhe mbrohen për pos aseteve kulturore të cilat janë të shumta në komunë duhet përmendur edhe disa memoriale modeste të përkushtuara ushtarëve dhe viktimave të luftës së sytë Botërore: monumenti mbi varrezën e përbashkët të luftëtarëve nga këto anë, i lokalizuar pranë obeliskut të përmendur në afërsi të kishës Shën Jovani në Shtërpcë, monument i ngjashëm mbi varrezën e katërmbëdhjetë të rënëve nga fshati Vërbeshticë, i vendosur në rrugë, e nën kishës Shën. Ilija në Vërbeshtice, si dhe memoriali – burimi në rrugën në mes të Shtërpcës dhe Brezovicës, si dhe përmendorja e dëshmorëve të luftës se UÇK- se e vendosur përskaj rrugës kryesore në fshatin Brod.

Veprat e rëndësishme të arkitektëve bashkëkohorë, të krijuara në territorin e komunës së Shtërpcës (hotel „Narcis“, objekti i komunës së Shtërpcës, Shtëpia e modernizuar e kulturës, si dhe objektet publike në Shtërpcë, objekti i postës, bankat etj.) nuk tregojnë ndonjë lidhje me kulturën e trashëguar arkitektonike e cila gjatë disa shekujve ka arritur të mbijetoj edhe të rezistojë ndikimeve të huaja.

Lista e objekteve kulturore të mbrojtura dhe të evidentuara:

- Trashëgimia kulturore e rëndësisë së veçantë:
  - Kalaja mbi Brezovicën - Çajlia, Brezovicë
  - Kisha e Shën Nikollës e shekullit XVI, Gotovushë
  - Kisha e Shën Nikollës e shekullit, Shtërpcë
- Trashëgimia kulturore me rëndësi të madhe:
  - Pllaka e gurit me varrin tek Kisha e Shën Gjergjit, Bitia e Epërme
  - Kisha e Teodorit të Shenjtë nga shekulli XVI, Bitia e Poshtme
- Trashëgimia kulturore e evidentuar
  - Varreza e fshatit „Crkvishta“,Vërbeshticë
  - Kisha e Shën Ilijës, Vërbeshticë
  - Kisha e Shën Arangjelit nga shekulli XVI dhe XVII, Sevcë
  - Kisha e Shën Nikollës nga shekulli XVI, Sevcë
  - Kisha e Shën Premtit nga shekulli XVI, Jazhincë
  - Xhamia e fshatit, Bitia e Epërme
  - Kisha e Shën Premtit, Berevcë
  - Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë, Gotovushë
  - Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë
  - Kisha e Shën Mladenci, Drajkoc
  - Kulla e Ibrahim Mulës nga shekulli XIX, Firajë
  - Xhamia e fshatit Kashtanjeve
  - Xhamia e fshatit Biti e Epërme

DRAFT



Harta 35 Trashëgimia kulturore e komunës së Shtërpcës*

Më poshtë janë edhe Zonat e Veçanta të Mbrojtura (ZVM):

- Kisha e Teodorit të Shenjtë, Bitia e Poshtme,
- Kisha e Shën Nikollës, Shtërpcë,
- Kisha e Shën Gjergjit, Bitia e Epërme,
- Kisha e Shën Nikollës, Gotovushë,
- Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë,

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

Harta 36 ZVM - Kisha e Teodorit të Shenjtë, Biti e Poshtme

Harta 37 ZVM - Kisha e Shën Nikollës, Shtërpcë.



Harta 38 ZVM - Kisha e Shën Gjergjit, Biti e Epërme

Harta 39 ZVM - Kisha e Shën Nikollës, Gotovushë

Harta 40 ZVM - Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë

2.8.2. Asetet e Trashëgimisë Natyrore

Kjo komunë është mjaft e pasur me trashëgimi natyrore:

- Parku Kombëtar i Sharrit
- Kompleksi/Qendra e Brezovicës,

• Liqeni i Livadicës dhe Jazhincës



*Harta 41 Trashëgimia natyrore**

2.8.3. Asetet Turistike

Komuna e Shtërpcës karakterizohet me kushte mjaft të volitshme natyrore për zhvillimin e turizmit. Malet e Sharrit me lartësi deri në 2.600 m dhe me shpate jashtëzakonisht të favorshme në pjesën veriore për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror, janë vlera të cilat deri më sot janë shfrytëzuar shumë pak. Shpatet e buta të thepisura në dimër dhe shpatet e gjelbra të përshtatshme për rekreacion gjatë verës me vlerë turistike gjeo-morfologjike (majat e larta të Sharrit, shpatet e thepisura, luginat me origjinë glaciale/akullnajore) dhe hidrologjike (burime të shumta dhe përroska që janë aktive gjatë verës) si dukuri hyjnë në lokacionet më të rëndësishme turistike në Kosovë. Nga pikëpamja e

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

nevojave të Komunës së Shtërpcës për zhvillim social – ekonomik sigurisht që në të ardhmen duhet të aktivizohet hapësira më e madhe për qëllime turistike.

Sot për nevojat e turizmit në Komunën e Shtërpcës shfrytëzohen hapësirat e vogla: hotelet, restorantet, vendpushimet dhe objektet tjera përcjellëse turistike, duke përfshirë edhe dhjetëra kilometra të rrugës së asfaltuar nga Brezovica deri te hoteli "Molika "të cilat nuk zënë më shumë së rreth 15 ha. Përveç këtyre, në mënyrë periodike për nevojat rekreative në verë, e veçanërisht gjatë dimrit shfrytëzohen shtigjet skijimore dhe ato për shëtitje me jo më shumë se 10 – 15 ha. Në sipërfaqen e përgjithshme të Komunës së Shtërpcës, pjesa e këtyre hapësirave, pra, është vetëm rreth 0,12 %. Këto zona të cekura, pra, në të ardhmen mund të zgjerohen edhe për 10 apo më shumë herë (sepse këso lloj terrene ka mjaftë) dhe atë pa rrezik për pengimin e zhvillimit të veprimtarive tjera ekonomike – afariste, duke përfshirë edhe pylltarinë dhe bujqësinë (blegtorinë).

Shtatë ashensor aktual mbi hotelin "Molika" nuk paraqesin "ngarkesë" në hapësirë për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave; pjesërisht trasat e tyre kalojnë edhe nëpër shkëmbinjtë shterpë, kanale dhe gurina, të cilat janë plotësisht jo pjellore dhe në këtë mënyrë shfrytëzohen për qëllime të "prodhimit". Analizat e deritanishme të kushteve gjeo-morfologjike dhe biogjeografike për zhvillimin e turizmit në Sharr tregojnë për ekzistencën e kushteve të favorshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie në jugperëndim të hotelit "Molika" deri te livadhet e Bistrës dhe Carevës, në një anë, dhe deri në verilindje dhe në lindje të hotelit në drejtim të Lubotenit, Shtërpcës dhe Gotovushës, në anën tjetër. Këtu, para së gjithash, mendojmë për potencialet natyrore për nevojat e turizmit dimëror. Mirëpo, përveç këtyre terreneve, për zhvillimin e turizmit janë të favorshme edhe pjesët e tjera të komunës, sidomos në pjesën e burimit të Lepencit (mbi Sevcë). Në skicën në aneks është paraqitur shpërndarja hapësinore e objekteve të planifikuara turistike të akomodimit, ashensori dhe pika që do të trajtohen si komplekse turistike me të gjitha kapacitetet e nevojshme për qëllime akomodimi, siç ishte cekur më parë, për qëndrimin e turistëve me mundësi më të mira ekonomike. Paraqitja e shpërndarjes së pikave kryesore turistike në malet e Sharrit (nga Shtërpca prej rreth 850 m dhe Brezovica në rreth 910 m deri te 2.580 (kreshta e këtij mali) në lidhje me Shtërpcën, si qendër e komunës, dhe në rrugën regjionale Prizren – Prevallë – Shtërpcë – Ferizaj, qartë tregojnë për rëndësinë turistike të kompleksit "Treshnja" (Qershia) si dhe për zhvillimin e përgjithshëm të turizmit në Komunën e Shtërpcës. Pozita qendrore e këtij kompleksi turistik në krahasim me komplekset tjera turistike "Brezovica" dhe "Shtëpia e Stojkut" si dhe "Livadhet e Mbretit" dhe "Shtërpca" theksojnë rëndësinë e jashtëzakonshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të turizmit (veror dhe dimëror) në Komunën e Shtërpcës dhe në Kosovë. Lokacioni „Treshnja" (Qershia), si dhe të gjitha lokacionet e planifikuara të ndërtohen dhe të organizohen si komplekse të qendrës turistike të lidhura njëra me tjetrin dhe të cilët me atraktivitetin e tyre mund të afrojnë (verës dhe dimrit) numrin më të madh të turistëve nga jashtë.

2.9. VENDBANIMET

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Pikërisht nga kjo arsye, vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë popullative dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Numri i vendbanimeve në Kosovë numëron 1457, nga të cilat 30 janë të nivelit urban dhe të tjerat për nga përmbajtja dhe veprimtaritë që zhvillohen dhe ofrohen në to janë të statusit të fshatit. Shprehur në përqindje del se qytetet përbëjnë 2.06% të vendbanimeve kosovare. Ato paraqesin qendrat në të cilat zhvillohen aktivitetet sociale, kulturore, ekonomike, ndaj edhe koncentrimi i popullatës është më i madh në këto qendra. Madhësia e 30 qendrave urbane, varësisht në raport me numrin e banorëve, është si vijon:

Deri 15.000 banorë	Malisheva, Z. Potoku, **Shtërpca**, Novo Bërda.
15.000 – 75.000 banorë	Suhareka dhe të gjitha komunat tjera
75.000 – 120.000 banorë	Gjilani, Gjakova, Peja, Mitrovica, Vushtrria, Podujeva
120.000- 220.000 banorë	Prizreni
> 220 000 banorë	Prishtina

Tabela 62 Komunat sipas numrit të banorëve

Sipas të dhënave statistikore, Komuna e Shtërpcës përbëhet nga 16 vendbanime, të cilat shtrihen në një territor prej 247.60 km2. Në përgjithësi, 10,771 banorë të Komunës së Shtërpcës jetojnë, bëjnë biznes, zhvillojnë aktivitete dytësore dhe terciare në 16 vendbanime dhe përdorin rrjetin rrugor për komunikim të ndërsjellë dhe transport të mallrave. Sipërfaqja e përgjithshme e vendbanimeve, rrugëve dhe infrastrukturës tjetër nuk është më shumë se 423.0 ha. Kjo sipërfaqe, e cila zë gjithsej 36.4% të sipërfaqes djerrë të vendit, ndërsa në komunën e Shtërpcës jo më shumë se 1.70%.

DRAFT

2.9.1. Karakteri Urban Rural dhe funksionaliteti ndërlidhës

Sipas regjistrimit të fundit zyrtar të Agjencisë Statistikore të Kosovës, në Komunë të Shtërpcës shtrihen 16 vendbanime me sipërfaqe të përgjithshme prej 247.60 km2 ku jetojnë rreth 10,771 banorë, në një dendësi mesatare prej 56,13 b/ km².

Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (km²)	Dendësia(b/ha)	Klasifikimi i vendbanimit
Beroc	336	11,84	49,2	Qendër e rendit të ulët
Biti e Epërme	574	93,43	4,1	Qendër e rendit të mesëm
Biti e Poshtme	735	65,21	7,5	Qendër e rendit të mesëm
Brezovicë	70	27,25	27,2	Qendër bazike
Brod	2551	16,64	82,6	Qendër e rendit të ulët
Drejkoc	119	10,94	17,7	Qendër e rendit të ulët
Firajë	1677	10,94	76,6	Qendër e rendit të ulët
Gotovushë	504	16,12	55,3	Qendër e rendit të mesëm
Izhanc	102	37,71	0,2	Qendër e rendit të ulët
Jazhincë	188	15,46	44,9	Qendër e rendit të ulët
Kashtanjevë	136	18,28	0	Qendër e rendit të ulët
Sevcë	202	40,97	29,1	Qendër e rendit të ulët
Sushicë	87	10,72	13,7	Qendër e rendit të ulët
Shtërpcë	2,440	35,30	68,8	Qendër e rendit të mesëm
Vërbeshticë	615	41,82	7,6	Qendër e rendit të ulët
Viqë	435	71,48	3,9	Qendër e rendit të ulët

Tabela 63 Numri i banorëve sipas vendbanimeve

Fshatrat në Komunën e Shtërpcës në aspektin tipologjik, konform reliefit dhe shtrirjes së tyre, karakterizohen kryesisht me veti të fshatit malor, po edhe të rrafshit.

Në aspektin hapësinor, Shtërpca si vendbanim i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 247.60 km² dhe gravitimin e popullsisë prej 10,771 banorë, të shpërndarë në 16 vendbanime Në zonat rurale, vendbanimet karakterizohen me objekte të banimit individual, objekte ekonomike-bujqësore, shkollë, objekte fetare, ambulancë, dyqane dhe varreza në periferi. Në shumicën e rasteve, këto përmbajtje përfaqësojnë elementet e siluetës dominante në arkitekturë. Zona urbane, përpos vendbanimeve të ngjeshura, karakterizohet me një dendësi më të lartë të vendbanimeve, me karakteristikë kryesisht të frekuentimit të objekteve administrative. Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve, ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

DRAFT



*Harta 42 Shtrirja e vendbanimeve**

2.9.2. Vendbanimet sipas madhësisë dhe numrit të banorëve

Komuna e Shtërpcës është ndarë për efekt administrimi në 15 zona kadastrale dhe 16 vendbanime me sipërfaqe prej 247.60 km², me dendësi prej 28 b/km², me 10,771 banorë sipas regjistrimeve të fundit ët popullësisë, të vitit 2024

Nga pikëpamja e trendeve demografike vetëm Sevca, Shtërpca, Firaja dhe Brodi kanë shënuar trende pozitive viteve të fundit dhe dendësia e popullatës është edhe në këto vendbanime mesatare, vlen të ceket edhe një shpërndarje jo e balancuar e popullsisë në Komunën e Shtërpcës.

Trajtimi i vendbanimeve të banuara në planet zhvillimore komunale është i nevojshëm dhe kyç, sepse e tërë veprimtaria dhe organizimi i jetës së shoqërisë së njerëzve kanë qenë dhe do të jenë të ndërlidhura me ta. Tipologjia e vendeve të banuara sipas madhësisë është një nga metodat më të rëndësishme për shfaqjen e karakteristikave të

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

sistemit të popullsisë në hapësirat e caktuara siç është mënyra e kualitetit te jetës në vendet e banuara në këtë hapësirë, sepse, vendbanimi më i banuar nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte, ndërsa vendbanimi me më së paku banorë nënkupton të kundërtën e të mëparshmes. Pikërisht për shkak të kësaj arsye, vendbanimet e banuara karakterizohen për nga madhësia e banorëve dhe në bazë të shumë analizave këto problematika përcaktojnë pikat strategjike për zhvillim të mëtutjeshëm të komunës por edhe më gjerë.

Vendbanimet e banuara, sipas madhësisë demografike dhe kushteve tjera në komunën e Shtërpcës sipas normave teknike të planifikimit mund t'i kategorizojmë në:

- Vendbanim rural i madh 2,500-5,000 banorë
- Vendbanim i mesëm i madh rural 1,000-2,500 banorë
- Vendbanim i mesëm i vogël rural 500-1,000 banorë
- Vendbanim i vogël rural 200-500 banorë

Vendbanimi	Nr. i banorëve	Klasifikimi i vendbanimit	Sipërfaqja (km²)
Beroc	336	Vendbanim i vogël rural	11,84
Biti e Epërme	574	Vendbanim i mesëm vogël rural	93,43
Biti e Poshtme	735	Vendbanim i mesëm vogël rural	65,21
Brezovicë	70	Vendbanim shumë i vogël rural	27,25
Brod	2,551	Vendbanim i mesëm i madh rural	16,64
Drejkoc	119	Vendbanim shumë i vogël rural	10,94
Firajë	1,677	Vendbanim i mesëm i madh rural	10,94
Gotovushë	504	Vendbanim i mesëm vogël rural	16,12
Izhanc	102	Vendbanim shumë i vogël rural	37,71
Jazhincë	188	Vendbanim shumë i vogël rural	15,46
Kashtanjevë	136	Vendbanim shumë i vogël rural	18,28
Sevcë	202	Vendbanim shumë i vogël rural	40,97
Sushicë	87	Vendbanim shumë i vogël rural	10,72
Shtërpcë	2,440	Vendbanim i mesëm i madh rural	35,30
Vërbeshticë	615	Vendbanim i mesëm vogël rural	41,82
Viqë	435	Vendbanim i vogël rural	71,48

Tabela 64 Vendbanimet sipas madhësisë dhe numrit të banorëve

Në kategorinë e parë të vendbanimeve të banuara **(Vendbanim i vogël rural)** të madhësisë prej 200 – 500 banorë përbëjnë 4 vendbanime të banuara nga gjithsej 16 sa edhe janë në territorin e Komunës së Shtërpcës, dhe ato janë: Biti e Epërme, Biti e Poshtme, Vërbeshticë, Viqë

Në kategorinë e dytë të vendbanimeve të banuara **(Vendbanim i mesëm rural)** të madhësisë prej 501 - 1000 banorë e përbëjnë 4 vendbanime: Brezovica, Jazince, Berevce, Firaja.

Në kategorinë e tretë të vendbanimeve të banuara **(Vendbanim i mesëm i madh rural)** të madhësisë prej 1001-2500 banorë e përbëjnë 3 vendbanime: Brod, Shtërpcë, Sevce,., prej të cilave Shtërpca është zonë qendrore.

Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit	Klasifikimi i vendbanimit	Vendbanimet	Numri i vendbanimeve
5,000-10,000 banorë	Vendbanim shumë i vogël urban		-
2,500–5,000 banorë	Vendbanim rural i madh		
1,000-2,500 banorë	Vendbanim i mesëm i madh rural	Brod, , Shtërpcë, Sevce,	3
500-1,000 banorë	Vendbanim i mesëm rural	Brezovica, Jazhince, Berevce, Firaja	4
200-500 banorë	Vendbanim i vogël rural	Biti e Epërme, Biti e Poshtme, Vërbeshticë, Viqë	4
<200 banorë	Vendbanim shumë i vogël rural	Drajkoc, Izhanc, Kashtanjevë, Sushicë,	4

Tabela 65 Vendbanimet sipas kategorive të madhësisë

2.9.3. Vendbanimet sipas llojit dhe lartësisë mbidetare

Pjesa më e madhe e vendbanimeve shtrihen në zonat e rrafshëta në lartësinë mbidetare nga 650m deri në 1100 m, ku në këtë lartësi ndodhet edhe zona urbane apo qyteti i Shtërpcës.

Vendbanimet në terrenet më të ulëta, ose vendbanimet e rrafshit, shtrihen në lartësinë mbidetare deri në 650-750 m. Këto vendbanime kryesisht kanë tokë më pjellore dhe merren me prodhimtari bujqësore. Disa nga vendbanimet, të cilat shtrihen deri në 750-1100 metra lartësi mbidetare në viset rrëzë viseve malore, shfrytëzojnë hapësirat malore dhe fushore. Vendbanimet e viseve kodrinore-malore dallohen me lartësi më të madhe mbidetare, prej 750-1100 metra dhe janë të pasura me pyje dhe me kullosa dhe më të varfra me toka pjellore për mbjelljen e drithërave. Populllsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

Vendbanimet	Zona Kadastrale	Lartësitë mbidetare
Berevca	Berevca	1033-1400
Brezovica	Brezovica	2100-2350
Brod	Brod	780-1950
Viça	Viça	749-950
Vërbeshtica	Vërbeshtica	1900-2350
Bitia e E.	Bitia e E.	830-1340
Gotovusha	Gotovusha	850-2232
Bitia e P	Bitia e P	610-1200
Drajkoci	Drajkoci	833-2230
Izhanca	Izhanca	600-1069
Jazhinca	Jazhinca	2000-2350
Kashtanjeva	Kashtanjeva	1131-1530
Sevca	Sevca	1250-2000
Sushica	Sushica	1125-1350
Firaja	Drajkoci	833-2230
Shtërpca	Shtërpca	1107-1955

Tabela 66 Lartësia mbidetare e shtrirjes së vendbanimeve

2.9.4. Vendbanimet Urbane

Zona urbane apo zona qendrore e Shtërpcës është një qytezë e vogël me karakter urban në një lartësi mbidetare nga 850m deri më 1050m. Shtërpca luan një rol me rëndësi në zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. Pozita e saj gjeo-morfologjike dhe vet struktura fizike e qytezës ofron një mundësi të mirë për të jetuar dhe vepruar.

2.9.5. Vendbanimet rurale

Rrjeti i vendbanimeve rurale në Komunën e Shtërpcës paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore të vendbanimeve rurale. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në Komunën e Shtërpcës, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Komuna e Shtërpcës i ka 15 vendbanime të karakterit rural.

2.9.6. Vendbanimet joformale[15]

Janë vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

Çështje shumë me rëndësi për Shtërpcën, si edhe në çdo qytet në Kosovë, janë vendbanimet joformale (VBJ) dhe zhvillimi i tyre. Në Shtërpcë nga KK, e sipas Udhëzuesit për Planifikim Hapësinorë për Vendbanime Joformale të Ministrisë për Planifikim Hapësinor, janë identifikuar 3 vendbanime joformale.

Që të tri këto vendbanime joformale nuk janë trajtuar me plane rregulluese.

Nr.	Emërtimi i Vendbanimit joformal	Sipërfaqet ha.
1	Shtërpce	1,80
2	Berevce	1,60
3	Gotovusha	2,70

Tabela 67 Sipërfaqet e Vendbanimeve Joformale

[15] DUMM

Vendbanimet joformale	Sipërfaqja	Nr. i banorëve	Nr. i njësive të banimit	Infras. Fizike	Infras. Sociale	Prona	Gjendja e VBJ	Prioriteti për intervenim
Shtërpce	1,80	720	35	Formale	Mungon Shëndetësia	Publike & Private	Mesatare	Pronësia
Berevcë	1,60	650	22	Formale	Mungon Shëndetësia Çerdhe	Publike & Private	Mesatare	Pronësia & Infrastruktura Teknike
Gotovusha	2,70	30	32	Formale	Mungon Shëndetësia	Publike & Private	Mesatare	Pronësia & Infrastruktura Teknike

Tabela 68 Veçoritë e Vendbanimeve Joformale

Ndonëse shumica e vendbanime joformale në Kosovë nuk karakterizohen me jo sigurinë e pronës, në vendbanimet e hulumtuara në Shtërpce, ekzistojnë raste të papërcaktuara të pronësisë, ku shfrytëzuesit nuk janë në posedim të pronës, si dhe numër i vogël i uzurpimeve të cilat janë në proces të zgjidhjes.
Ajo që i karakterizon vendbanimet joformale në Shtërpce janë:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëria deri në diskriminim

Mungesa e shërbimeve elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale është treguar të jetë arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuate.

Nr. i VJF	Sipërfaqja e përgjithshme në ha e zonave	Numri i shtëpive	Numri i banorëve	Dendësia (b/ha)
3	6.10	89	400	65,5

Vendbanimi VJF	Sipërfaqja e përgjithshme në ha e zonave	Numri i shtëpive	Numri i banorëve	Dendësia (b/ha)
Shtërpce	1,80	35	157	87,2
Berevce	1,60	22	99	61,8
Gotovusha	2,70	32	144	53,3

		Prioriteti për intervenim			Plani që e rregullon			Madhësia			Konteksti urban/rural		
Nr.	Vendbanimi / emërtimi	ASH / AM / AGJ			PZHK /PZHU / PRRU			V / M/ M			U / UR / R		
1	Shtërpce	X			X			X			X		
2	Berevce	X			X			X					X
3	Gotovusha	X			X					X			X

Tabela 69 Veçoritë e Vendbanimeve Joformale

ASH - Afat shkurtë PZHK - Plani Zhvillimor Komunal v - I vogël U – Urban
AM - Afat mesëm PZHU - Plani Zhvillimor Urban m - I mesëm UR - Urban Rural
AGJ - Afat gjatë PRRU - Plani Rregullues Urban M - I madh R – Rural



Figure 1. Pozita e 3 vendbanimeve joformale në Komunë të Shtërpcës

2.9.9. Ndërtimet pa Leje[16]

Në Regjistrin e ndërtimeve pa leje të Komunës së Shtërpcë janë të regjistruara mbi 530[17] raste, si ndërtesa të kategorisë I-rë dhe të II-të, sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i identifikuar i ndërtimeve pa leje pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi Ligji Nr. 06/L-024.

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Autoriteti zyrtar përkatës, do t'i trajtojë dhe legalizojë shumicën e ndërtimeve të kategorisë I-rë dhe II-të, mirëpo, përsëri do të mbetet një numër i konsiderueshëm i objekteve/ndërtesave të cilat

[16] DUMM

[17] Numri i ndërtimeve pa leje në Komunë të Shtërpcës, nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje të MMPH, për Shtërpcë

janë ndërtuar pas 30 gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, e të cilat tutje do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim.

Duke qenë se për ndërtimet pa leje kemi çështje të pronësisë së pa zgjidhur, respektivisht pronësi me titullar të ndryshëm, atëherë për ndërtimet pa leje, të identifikuara në pronat me pronësi komunale, Komuna e Shtërpcës, gjatë trajtimit të VBJ, duhet të bashkëpunojë me Kuvendin Komunal Shtërpcë (nëse eventualisht ekzistojnë), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi komunale, si dhe t'i bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Për ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore (nëse eventualisht ekzistojnë), Komuna e Shtërpcës, gjatë trajtimit të VBJ duhet të bashkëpunojë me AKP-në (në nivel regjional dhe qendror), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi shoqërore, si dhe t'i bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, menaxhohen dhe trajtohen nën mandatin e AKP-së.

2.10. BANIMI

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për stabilitet social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi.

Duke qenë shfrytëzuesi më i madh i hapësirës si aktiviteti themelor i vendbanimeve, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponent i rëndësishëm i zhvillimit ekonomiko-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi. Zona urbane e Shtërpcës karakterizohet me një dendësi më të madhe se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 56.13 b/km². Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale, por e ulët për zonat urbane.

Inventari i Banimit

Sipas informatave ekzistuese, informacioni bazë për banim është në tabelën e dhënë:

Shtëpi individuale	Banesa me shumë apartamente (pjesë e ndërtesave kolektive)	Gjithsej
4,688	69	4,757

Tabela 70 Numri total i njësive të banimit pjesëtuar me numrin e njësive të banimit, 2022

Tabela në vijim tregon numrin e objekteve të banimit të ndarë sipas disa kategorive në të gjitha vendbanimet e komunës së Shtërpcës.

VENDBANIMET	SHTËPI	BANESË	SIPËRFAQE (m²)	MESATARJA (m²)
BEREVC/BEREVCE	251	10	28,747	110.14
BROD	401	0	50,992	127.16
BITI E POSHTME/DONJA BITINJA	160	1	19,718	122.47
DREKOC/DRAJKOVCE	375	0	50,600	134.93
BITI E EPËRME/GORNJA BITINJA	120	0	12,257	102.14
GOTOVUSHË/GOTOVUŠA	312	0	35,616	114.15
IZHANCË /IZHANCE	17	0	1,462	86.00
JAZHINCË /JAZHINCE	205	0	20,518	100.09
KASHTANJEVË/KAŠTANJEVO	70	0	4,600	65.71
SEVCË /SEVCE	206	0	17,857	86.68
SHTËRPCË/ŠTRPCE	941	37	122,370	125.12
SUSHICË/SUŠIĆE	43	0	3,437	79.93
VIÇË/VIČA	69	1	7,749	110.70
VËRBESHTICË/VRBEŠTICE	822	10	114,696	137.86
FIRAJË/FIRAJA	261	0	29,300	112.26

BREZOVICË/BREZOVICA	435	10	51,200	115.06
Gjithsej	**4,688**	**69**	**571,119**	**108,15**

Tabela 71 Numri i shtëpive dhe banesave sipas vendbanimeve

Sipas të dhënave nga lista e tatimit në pronë nga viti 2022, në Komunën e Shtërpcës janë rreth 4,757 objekte banesore (të marra parasysh shtëpitë dhe banesat) në formë të shtëpive individuale dhe njësive të banimit. Komuna e Shtërpcës ka 14 fshatra dhe të gjitha fshatrat janë të banuara. Në qytetin e Shtërpcës ka 978 objekte banimi, prej të cilave më shumë se 95% janë shtëpi familjare.

Analiza e gjendjes aktuale të zonave të banuara tregon se mesatarisht një familje në Komunën e Shtërpcës jeton në rreth 108 m2. Nëse marrim parasysh se familja mesatare në Shtërpcë ka rreth 4 deri në 5 anëtarë, atëherë kriteret për hapësirë të përshtatshme banimi të llogaritura si mesatare janë plotësuar.

Fshatrat në Komunën e Shtërpcës janë mjaft të populluara. Fshati me më së shumti banorë është fshati Vërbeshticë me rreth 832 objekte banimi (shtëpi dhe banesa), i cili është pothuajse sa vetë qyteti i Shtërpcës.

Nga 14 fshatrat e Shtërpcës, 50% e fshatrave, pra 7 fshatra, kanë mbi 200 shtëpi, që konsiderohet numër i konsiderueshëm i shtëpive për një fshat. Në këto 14 fshatra janë gjithsej 2,562 objekte banimi.

Më poshtë është një tabelë me informacione për të gjitha objektet që ndodhen në komunë:

Zona Kadastrale	Shtëpi	Banesë	Objekti i dytë i banimit	Dyqan	Restorant	Punëtori	Garazhe	Objekti dytë komercial	Objekti i dytë bujqësor
BEREVC/BEREVCE	251	10	2	13	6	4	0	6	2
BROD	401	0	0	12	0	4	1	0	6
BITI E POSHTME/DONJA BITINJA	160	1	0	6	0	1	0	1	2
DREKOC/DRAJKOVCE	375	0	1	13	4	1	0	1	0
BITI E EPËRME/GORNJA BITINJA	120	0	0	4	0	0	0	2	0
GOTOVUSHË/GOTOVUŠA	312	0	0	17	0	0	0	2	0
IZHANCË /IZHANCE	17	0	0	0	0	0	0	0	1
JAZHINCË /JAZHINCE	205	0	1	9	0	0	0	4	0
KASHTANJEVË/KAŠTANJEVO	70	0	0	0	0	0	0	0	0
SEVCË /SEVCE	206	0	0	14	0	0	0	1	0
SHTËRPCË/ŠTRPCE	941	37	0	104	12	5	1	8	0
SUSHICË/SUŠIĆE	43	0	0	2	0	0	0	0	0
VIÇË/VIČA	69	1	0	1	0	0	0	0	0
VËRBESHTICË/VRBEŠTICE	822	10	1	31	7	2	0	6	1
FIRAJË/FIRAJA	261	0	0	0	0	0	0	0	0
BREZOVICË/BREZOVICA	435	10	0	0	0	0	0	0	0
Total	**3,992**	**69**	**5**	**226**	**29**	**17**	**2**	**31**	**12**

Tabela 72 Objektet e ndërtuara në komunën e Shtërpcës (pjesa e parë)

Zona kadastrale	Bazen	Fabrikë	Hotel	Zyre	Garazhe	Depo	Objekt bujqësor	Stallë
BEREVC/BEREVCE	0	3	0	2	0	1	0	0
BROD	0	5	0	5	0	0	0	6
BITI E POSHTME/DONJA BITINJA	0	3	0	1	0	5	0	0
DREKOC/DRAJKOVCE	1	0	0	0	0	2	0	1
BITI E EPËRME/GORNJA BITINJA	0	0	0	0	0	0	0	0
GOTOVUSHË/GOTOVUŠA	0	0	0	0	0	0	0	0
IZHANCË /IZHANCE	0	0	0	0	0	0	0	0
JAZHINCË /JAZHINCE	0	0	0	0	0	0	0	0
KASHTANJEVË/ KAŠTANJEVO	0	0	0	0	0	0	0	0
SEVCË /SEVCE	0	0	0	0	0	1	0	0
SHTËRPCE/ŠTRPCE	0	3	0	26	1	8	0	0

SUSHICË/SUŠIĆE	0	0	0	0	0	0	0	0
VIÇË/VIČA	0	1	6	5	0	0	2	0
VËRBESHTICË/ VRBEŠTICE	0	0	0	0	0	0	0	0
FIRAJË/FIRAJA	0	0	0	0	0	0	0	0
BREZOVICË/BREZOVICA	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	**1**	**15**	**6**	**39**	**1**	**17**	**2**	**8**

Tabela 73 Objektet e ndërtuara në komunën e Shtërpcës (pjesa e dytë)

Bazuar në regjistrimin zyrtar të popullsisë nga viti 2011, njësitë e banimit janë të vendosura në zonat urbane dhe rurale:

Lloji i banimit	Gjithsej			Urban			Rural		
	Banim	Ekon. famil.	Banorë	Banim	Ekonomi familjare	Banorë	Banim	Ekon. famil.	Banorë
Shtërpce	1,480	1,485	10,771	341	341	2,440	1,139	1,144	8,331
Banesa të thjeshta	1,456	1,461	10,700	339	339	2,430	1,117	1,122	8,267
Tjetër lloj i banimit	24	24	71	2	2	7	22	22	64

Tabela 74 Banesat sipas llojit, statusit të popullsisë dhe llojit të vendbanimit në një zonë urbane

Tipologjia e banimit në komunë është relativisht e ngjashme në nivel shtetëror. Më së shpeshti këto janë shtëpi familjare, ndërsa shtëpitë me rreshta të dyfishtë dhe të poshtëm duken më pak të përshtatshme për banim.

	Gjithsej	Shtëpi individuale	Shtëpi dyshe	Rreshti i shtëpive (me të paktën tre njësi banimi të bashkangjitura ose ngjitur, secila me dalje të veçanta)	Ndërtesa ose blloqe apartamentesh	Tjera
Shtërpce	1,355	1,292	47	9	5	2
Urbane	291	252	29	6	4	-
Rurale	1,064	1,040	18	3	1	2

Tabela 75 Shtrirja hapësinore (ha) dhe numri i ndërtesave të banimit (nr.) për njësi

Kushtet e Banimit

Më poshtë është një analizë e situatës së shërbimeve publike në disa sektorë

	Gjithsej	Furnizimi nga shërbimi publik	Furnizimi nga burime tjera	Sistemi i furnizimit brenda ndërtesës	Sistemi i furnizimit jashtë ndërtesës	Nuk ka sistem furnizimi me ujë
Objektet e banimit	1,480	830	625	3	10	2
Numri i banorëve	10,771	3,139	3,706	7	17	9

Tabela 76 Sistemi i furnizimit me ujë

	Gjithsej	Kanalizim i lidhur me rrjetin publik	Kanalizim i lidhur me rrjet privat	Metoda të tjera të lidhjes së ujërave të zeza (gropë septike, lumë)	Nuk ka sistem të kanalizimit
Objektet e banimit	1,480	599	458	404	19
Popullatë	10,771	2,212	2,770	1,885	82

Tabela 77 Sistemi i kanalizimit

	Gjithsej	Dru	Qymyr	Naftë/mazut	Energji elektrike	Nxehje tjera
Objekte banimi	1,480	1,447	4	16	13	0
Numri banoreve	10,771	6,832	13	74	30	0

Tabela 78 Sistemi i nxehjes

2.10.1. Banimi Social

Në Shtërpcë janë ndërtuar 4 objekte banesore kolektive, të cilat janë të destinuara për banim social. Këto objekte janë ndërtuar në vitin 2012 dhe janë të vendosura në fshatin Bitinja e Madhe afër Shtërpcës. Ndërtesat e banimit janë ndërtuar në një sipërfaqe prej 31.7 ari. Në secilën nga këto 4 ndërtesa banimi kolektive, ka 20 njësi banimi, që përfaqëson gjithsej 80 njësi banimi në 4 ndërtesa banimi. Sipërfaqja e çdo njësie banimi është 75.00 m2. Çdo njësi banimi ka një korridor, një kuzhinë me trapezari dhe sallon, dy dhoma gjumi dhe një banjo. Gjithashtu, çdo njësi banimi ka një hapësirë bodrumi, si dhe një vend parkimi.



*Harta 43 Rastet sociale në komunën e Shtërpcës**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

2.11. SHFRYTËZIMIT AKTUAL I TOKËS

Në Komunën e Shtërpcës vlerësohet se 67.50% e sipërfaqes është tokë Pyjore dhe 30.10% është tokë bujqësore, sipërfaqe këto më të mëdha sa i përket territorit.

Në vazhdim janë të paraqitura të gjitha shfrytëzimet ekzistuese të territorit të Komunës së Shtërpcës në sipërfaqe për hektar si dhe në përqindje sipas HILUCS:

Shfrytëzimi i tokës sipas HILUCS	**Sipërfaqja (ha)**	%
Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit	17.91	0.07%
Prodhim Parësor / Bujqësi	7452.43	30.10%
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative	1.10	0.004%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	16713.77	67.50%
Banim / Banim i përhershëm	576.48	2.33%

Tabela 79 Sipërfaqja dhe përqindja e sipërfaqeve të ndërtuara sipas kategorive të HILUCS

Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Shtërpcës është 24762,2 ha. Shfrytëzimi i hapësirës për vendbanime të përhershme të banorëve dhe për zhvillimin e veprimtarive dytësore dhe terciare (përveç, turizmit pjesërisht) realizohen, në pjesën më të madhe, brenda 16 vendbanimeve (duke përfshirë vendbanimin/fshatin turistik Brezovica).

Viset malore janë tradicionalisht, para së gjithash, të shfrytëzuara për prodhimtari blegtorale, dhe në masë më të vogël për prodhimtari bujqësore. Ky konstatim vlen edhe për Komunën e Shtërpcës, duke pasur parasysh atë se territori i saj gjendet në lartësi prej rreth 640 deri 2.597 m, dhe që në të ka kullosa dhe livadhe, sipërfaqe të frutave dhe kulturave, si dhe tokës së punueshme.

Në bazë të këtyre informatave mund të vihet në përfundim së në Komunën e Shtërpcës ekzistojnë kushte të favorshme natyrore për zhvillimin e bujqësisë. Deri në një masë të caktuar ky përfundim është logjik, dhe atë vetëm kur është fjala për kushtet për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore. Këtu po i referohemi prodhimit me pjesëmarrjen, para së gjithash, të familjeve bujqësore rurale që merren me këto aktivitete me qëllim të përmbushjes së nevojave të veta, dhe eventualisht me qëllim të prodhimit të tepricave bujqësore të destinuara për tregun lokal. Për këtë mënyrë të prodhimtarisë bujqësore, banorët kanë shfrytëzuar këto sipërfaqe:

- Për prodhim blegtoral janë shfrytëzuar 10.985,2 ha (45,8 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 44,4 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e kulturave janë shfrytëzuar 2.464,0 ha (10,3 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht 10,0 % nga totali i sipërfaqes së komunës).
- Për prodhimin e frutave/pemëtari (dhe vreshta) janë shfrytëzuar203,5 ha (0,8 % nga totali i tokës pjellore, përkatësisht diçka më pak se 0,8 % nga totali i sipërfaqes së komunës).

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore është 13.652,7 ha, që paraqet 55,15% nga sipërfaqja e përgjithshme.



Kur është fjala për sipërfaqet e pyjeve, prodhimin e masës drunore, në aspektin biologjik, realizohet në një sipërfaqe totale prej 10.574,4 ha, apo në 42,7 % të territorit të Komunës së Shtërpcës. Nga ajo një pjesë e vogël e sipërfaqeve pyjore është private (842,1 ha apo 7,96 %), ndërsa pjesa më e madhe është nën pronësi publike (9.732,3 ha, ose 92,04 %).

Tabela 80 Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës	**Sip. *ha***
Vendbanimet	456.48
Kultura	0.42

Arsimi	3.09
Shërbimet	0.96
Objektet sportive	1.85
Shëndetësia	0.71
Administrata	0.24
Zonat Ekonomike	14.27
Varrezat	10.71
Trashëgimia kulturore	3.61
Hapësirat turistike	272
Pyjet	10057.64
Bujqësia	10178.82
Rrugët	3759.51

Sipërfaqet e pyjeve gjenden pothuajse tërësisht në viset që nuk janë të përshtatshme për prodhimtari bimore dhe blegtorale, që nënkupton anët e luginave të pjerrëta, zakonisht të ekspozuara në veri dhe në bazën gjeologjike më pak të përshtatshme për formimin e tokës më cilësore. Pyjet shtrihen në lartësi prej 640 m në brigjet e Lepencit deri në rreth 2.200 m në Oshlak. Megjithatë, shumica e pyjeve në lartësi prej 1.000 – 1.700 m ndodhen në shpatet e Sharrit, Oshlakut dhe malit të Jezercit. Terreni mbi 2.000 (2.000 m) është pa mbulesë të pyjeve. Kohëve të fundit (në tridhjetë vitet e fundit), pyjet gradualisht janë duke u zgjeruar edhe në viset të cilat janë të përshtatshme për prodhimtarinë bujqësore dhe atë në rrethin e Komunës së Shtërpcës dhe për këtë arsye këto sipërfaqe më pak përdoren për bujqësi. Sepse, gjithnjë e me pak ka popullsi bujqësore në komunë dhe gjithnjë e më pak ka kafshë (sidomos dele) në kullosa që ndikon " pozitivisht " në "lirimin" e hapësirës për zgjerimin natyror të pyjeve.

Sa i përket në përgjithësi, e para se gjithash për aktivitetet ndërtimore, renditja e vlerës së terrenit është si një bazë për ndërtim. Përveç kësaj, stabiliteti i terrenit mundëson të gjitha format e ndërtimit, të cilat duhet edhe të shfrytëzohen. Shikuar në përgjithësi, 10,771 banorë të Komunës së Shtërpcës banojnë, veprojnë, dhe zhvillojnë veprimtaritë sekondare dhe terciare brenda 16 vendbanimeve si dhe shfrytëzojnë rrjetin e rrugëve për komunikim dhe transport të mallrave në mes vete. Sipërfaqja e përgjithshme nën vendbanime, rrugë dhe infrastrukturë tjetër nuk është më e madhe se 423,0 ha. Kjo sipërfaqe në total në sipërfaqen jo pjellore të tokës merr pjesë prej 36,4%, ndërsa në komunën e Shtërpcës jo më shumë se 1,70 %.

Në bazë të këtyre informatave mund të supozojmë:

- Që për nevojat e banimit dhe zhvillimit të veprimtarive sekondare dhe terciare, duke përfshirë dhe rrjetin e rrugëve, është e angazhuar një sipërfaqe mjaftë e vogël;
- Që përdorimi i sipërfaqes në Komunën e Shtërpcës është më intensiv vetëm në 1/90 e sipërfaqes totale të komunës;
- Që dendësia e banorëve në sipërfaqet e cekura është 44 banorë në një hektar.

Këtu do të mund të konstatojmë se në Komunën e Shtërpcës ka mjaftë sipërfaqe për zgjerimin e vendbanimeve, por me kusht që kjo të mos bëhet në tokën e vlefshme dhe të punueshme përreth vendbanimeve. Megjithatë, nëse lind nevoja për ndërtimin e numrit më të madh të objekteve banesore, infrastrukturore, ekonomike dhe objekteve të standardeve shoqërore, atëherë duhet llogaritur përfshirjen e rreth 2,5 ha në çdo 100 banorë të rinj, që, duke marr parasysh dinamikën e ndryshimeve demografike, nuk do të paraqit një ngarkesë të madhe për zhvillimin e vazhdueshëm dhe të shpejtë të socio-ekonomisë në Komunën e Shtërpcës.

Toka e territorit të Komunës së Shtërpcës karakterizohet me kushte natyrore te vlefshme për zhvillimin e turizmit. Malet e Sharrit me lartësi deri 2.600 m dhe me shtigje jashtëzakonisht të favorshme në veri për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror janë një vlerë që deri më sot është shfrytëzuar shumë pak. Shtigjet e lehta dhe tërheqëse skijimore gjatë dimrit dhe shtigjet e gjelbëruara të përshtatshme për rekreacion gjatë verës me vlera të mëdha turistike, me dukuri gjeo-morfologjike (majat e larta të Sharrit, seksionet e pjerrëta, luginat e origjinave glaciale/akullnajore etj.) dhe hidrologjike (burimet dhe përrenjtë e shumtë që janë aktivë gjatë verës) që hyjnë në radhët e lokaliteteve më të vlefshme të rajonit.

Sot për nevojat e turizmit në Komunën e Shtërpcës shfrytëzohen pjesët e pakta të tokësn si disa hotele, restorantet, vendpushimet dhe objektet tjera përcjellëse turistike, duke përfshirë dhjetëra kilometra të rrugës së asfaltuar nga Brezovica deri te "Molika" që nuk zënë më shume së rreth 15 ha. Përveç këtyre, në mënyrë periodike, për nevoja të rekreacionit në verë, e sidomos dimri,t shfrytëzohen shtigjet për shëtitje dhe skijim në sipërfaqe totale prej rreth 97,0 ha. Në sipërfaqen e përgjithshme të pjesës së komunës, pjesa e kësaj sipërfaqe ndryshon me vetëm rreth 0,45%. Sipërfaqet e cekura, pra, në të ardhmen mund të zgjerohen edhe për 10 herë e më shumë (sepse këso lloje të terreneve

ka mjaftë) dhe atë pa rrezik për të zhvilluar e zhvillimin aktiviteteve ekonomike, duke përfshirë pyjet dhe bujqësinë (bagëti).

DRAFT

3. VLERËSIMI I GJENDJES

3.1. KONSTATIME GJEOGRAFIKE DHE MJEDISORE

Vlerësimi i gjendjes: Është i bazuar në të dhënat e Profilit Komunal dhe ka rezultuar në paraqitje të trendëve, nevojave, projeksioneve, prognozave dhe supozimeve për të ardhmen, relevante për komunën.

Gjithashtu, vlerësimin i gjendjes e kemi kryer duke shqyrtuar dhe vlerësuar përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për Komunën e Shtërpcës, të cilat do t'i keni në vazhdimësi sipas fushave tematik. Ky vlerësim na ka shërbyer për të përkufizuar nevojat dhe kërkesat e fushave zhvillimore sektoriale.

Në kuadër të vlerësimit të gjendjes janë trajtuar dhjetë fusha tematike dhe analiza është fokusuar në disa fusha relevante për komunën. Po ashtu, janë analizuar komunat fqinje, qëllimet dhe objektivat e nivelit qendror, dhe kërkesat e normave teknike të planifikimit hapësinor, si dhe në identifikimin e sfidave me implikimet e tyre hapësinore.

Metodologjia për vlerësimin e gjendjes ka qenë pranimi dhe shqyrtimi i gjetjeve kyçe, dhe supozime të pranuara nga të gjithë pjesëmarrësit lidhur me: konstatimet e ndryshme gjeografike dhe mjedisore; trendët dhe prognozat demografike; gjendjen e secilës fushë sektoriale dhe nevojave përkatëse; kërkesave dhe mundësive për zhvillim; identifikimin e implikimeve hapësinore për komunën; identifikimin e nevojave që duhen adresuar dhe plotësuar në mënyrë që të tejkalohen sfidat kryesore të zhvillimit hapësinor. Gjetje kyçe, përfundimet koncize dhe supozime të pranuara nga të gjithë akterët janë përdorur për të krijuar bazën për hartimin e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve të Zhvillimit Strategjik.

Të dhënat për fushat tematike dhe trendët të cilat i kemi prezantuar në vlerësimin e gjendjes do merren parasysh në të gjitha pjesët tjera të PZHK-së. Gjetjet dhe vlerësimet janë strukturuar sipas fushave tematike:

- Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson të dhënat për projeksionet e popullsisë, prognozat e gjendjes ekonomike, nevojat për banim në të ardhmen, si dhe lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve përgjatë rrugëve specifike të komunikimit.
- Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për komunën që përkufizojnë nevojat dhe kërkesat e fushave zhvillimore sektoriale.
- Vlerësimi i gjendjes përfshin shqyrtimin e fushave tematike specifike relevante për komunën, si dhe me komunat fqinje, nivelin qendror dhe normat teknike të planifikimit hapësinor.
- Vlerësimi i gjendjes përqendrohet në identifikimin e sfidave të lidhura me fushat tematike me vëmendje të posaçme lidhur me implikimet e tyre hapësinore.

Në vijim janë radhitur sfidat kryesore të gjendjes ekzistuese në Komunë:

Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunësisë

- I tërë zhvillimi në komunë është bërë pa planifikim institucional, është bërë dyfishimi i kapaciteteve dhe nuk janë shfrytëzuar resurset lokale dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë.
- Përcaktimi i mënyrave për institucionalizim (vënia nën kontroll) e këtij zhvillimi dhe planifikimi i zhvillimit të ardhshëm duke u bazuar në potencialet lokale.

Shfrytëzimi joracional i hapësirës

- Humbja e pakthyeshme e tokës bujqësore (edhe pse ka pak tokë bujqësore shumica e ndërtimeve janë ndërtuar në tokë bujqësore).
- Cilësia e dobët e mjedisit jetësor (mungesa e ngrohjeve qendrore dhe shfrytëzimi i burimeve alternative, mungesë në shërbime publike, si mbledhja e mbeturinave, mostrajtim i ujërave të zeza, etj.).
- Përcaktimi i mënyrave se si të përparojnë shërbimet publike në mënyrë që të rritet cilësia e mjedisit jetësor.

Infrastruktura e dobët teknike

- Niveli i dobët i kualitetit të infrastrukturës teknike në zonën urbane dhe rurale;
- Mungesë e trajtimit të ujërave të zeza dhe përzierje e ujërave të zeza me ato atmosferike;
- Mungesë e rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore;
- Cilësia e dobët e kaptazheve të ujit dhe akumuluesve të tjerë.

Rrezikshmëri të shkatërrimit të trashëgimisë natyrore

- Rrezik nga shkatërrimi i trashëgimisë natyrore (duke pas parasysh vlerat e larta të malit Sharr)
- Planifikimi i shfrytëzimit të vlerave dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore për brezat e ardhshëm.

DRAFT

Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe sociale

- Niveli i ulët (jo i kënaqshëm, edhe pse këtu kemi edhe shërbimin sekondar shëndetësor) i shërbimeve shëndetësore dhe sociale në zonën urbane, e sidomos në atë rurale.
- Mundësitë e përmirësimit të shërbimeve në përgjithësi, me prioritet të shërbimeve më afër vendbanimeve.

Standardet, normat dhe parimet

- Pjesa dërmuese e zhvillimeve hapësinore janë zbatuar jashtë standardeve, andaj zbatimi i normave dhe parimeve të obligueshme vështirë plotësohet.
- Ndërtimet jashtë standardit dhe pa kritere për zonën e Brezovicës janë problem në vete dhe vështirë i zgjidhshëm.

3.2. TRENDËT DHE PROGNOZAT DEMOGRAFIKE

3.2.1. Dinamika e popullsisë

Në procesin e përgatitjes së Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të Komunës së Shtërpcës, është thelbësore të kuptohen trendët, nevojat, projeksionet, prognozat dhe supozimet për të ardhmen e komunës. Duke analizuar dhe vlerësuar të dhënat e Profilit Komunal, kemi krijuar një pasqyrë të qartë të gjendjes aktuale dhe kemi identifikuar sfidat kryesore që kërkojnë zgjidhje në kuadër të këtij plani.

Një aspekt i rëndësishëm në vlerësimin e gjendjes ka qenë përfshirja e të gjithë akterëve relevantë në procesin e përgatitjes së PZHK-së. Duke realizuar një analizë gjithëpërfshirëse dhe duke marrë parasysh të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe burime alternative zyrtare, kemi siguruar që plani zhvillimor do të reflektojë nevojat dhe pritshmëritë e të gjithë pjesëmarrësve.

Për më tepër, analiza jonë ka përfshirë një vlerësim të përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve për Komunën e Shtërpcës. Ky vlerësim na ka mundësuar të përkufizojmë prioritetet dhe kërkesat e zhvillimit sektorial, të cilat do të adresohen sipas fushave tematike në vijim të planit.

Një element kyç në procesin e planifikimit ka qenë analiza e numrit të popullsisë, që kryesisht mbështetet në të dhënat e regjistrimeve. Në Kosovë, dhe veçanërisht në Komunën e Shtërpcës, mungesa e regjistrimeve të plota të popullsisë gjatë periudhës 1991–2011 ka krijuar vështirësi për planifikimin hapësinor dhe zhvillimor. Në këtë drejtim, të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare të vitit 2011 përbëjnë një burim të besueshëm për pasqyrimin e gjendjes reale në terren.

Në dy dekadat e fundit, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel komunal, nuk është regjistruar rritje e popullsisë krahasuar me trendët e tri dekadave më parë. Kjo situatë sugjeron një tendencë të stagnimit ose zvogëlimit të numrit të popullsisë, e cila duhet të merret parasysh në të gjitha aspektet e planifikimit të ardhshëm zhvillimor. PZHK-ja e Komunës së Shtërpcës synon të adresojë këto sfida dhe të krijojë një platformë të qëndrueshme për zhvillimin social, ekonomik dhe hapësinor të komunës, duke reflektuar nevojat e qytetarëve dhe duke garantuar një qasje të integruar ndaj të ardhmes..



Grafiku 8. Popullsia (ndryshimet) e Komunës së Shtërpcës sipas viteve, Burimi: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2023.

Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë dhe si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror. Komuna e Shtërpcës ka gjithsej 16 vendbanime, prej tyre 15 janë fshatra dhe vetë qyteti i Shtërpcës. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë.

Edhe Komuna e Shtërpcës, si shumë komuna tjera në Kosovë, ndër vite ka përjetuar de popullim të zonave rurale dhe dyndje drejt zonës urbane. Përqindje e konsiderueshme e depopullimit të zonave rurale ka ndodhur dhe besohet do vazhdojë të ndodhë si shkak i proceseve urbanizuese dhe migrimeve të jashtme. Urbanizimi në qytet ka rezultuar në favor të rritjes së pjesës urbane kryesore dhe zonave përreth.

Viti Vendbanimet	1981	1991	2011	2024
Beroc	876	792	287	336
Biti e Epërme	568	602	329	574
Biti e Poshtme	669	741	383	735
Brezovicë	328	445	68	70
Brod	1350	1608	1680	2551
Drekoc	182	193	106	119
Firajë	926	980	1103	1677
Gotovushë	985	986	445	504
Izhanc	222	277	89	102
Jazhincë	731	644	162	188
Kashtanjevë	448	451	123	136
Sevcë	1222	1283	176	202
Sushicë	280	268	74	87
Shtërpcë U	1966	2200	1265	2440
Vërbeshticë	925	790	450	615
Viqë	437	452	209	435
TOTAL	12115	12712	6949	10771

Tabela 81 Numri i popullsisë sipas vendbanimeve ndër vite 1981, 1991,2011 dhe 2024 regjistrimi i fundit.

Nga të dhënat e prezantuara më lartë kemi pasur një lëvizje të popullsisë drejt zonës urbane edhe vazhdon të ketë një lëvizje të tillë duke mundësuar kushte më të mira sociale. Për të analizuar gjendjen ekzistuese të zhvillimeve popullative mbështetemi në regjistrime, analiza dhe vlerësime mbi numrin e popullsisë ndër vite. Kur bazohemi në indeksin bazik dhe vargor të rritjes së popullsisë në Komunën e Shtërpcës mund të vërejmë periudhat kohore kur ka pasur rritje më të theksuar.

Vitet e regjistrimeve të popullsisë	**Nr. i popullsisë**	**Indeksi bazik**	**Indeksi Vargor**
1961	9573	100	100
1971	11664	122	122
1981	12115	127	104
1991	12712	133	105
2011	6949	73	55
2021	6503	68	94
2024	10771	112	165

Tabela 82 Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor në Komunën e Shtërpcës

Bazuar nga të dhënat në ASK vërehet se rritje më të madhe të popullsisë në Komunën e Shtërpcës kishte në vitet e '81–'91 – ta, pastaj ka vazhduar me një rënie të dukshme të numrit të popullsisë së përgjithshme. Ndërsa, nga viti 1991 – 2011, popullsia e Shtërpcës ka pasur zvogëlim të numrit të përgjithshëm. Pas vitit 1991 shënohet stagnim i shtimit të popullsisë. Në bazë të shënimeve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, numri i popullsisë në Komunën e Shtërpcës është zvogëluar për afërsisht 45.33%, apo 5763 banorë, krahasuar me vlerësimin e vitit 1991.

3.2.2. Struktura e popullsisë sipas grup moshave

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë përfaqëson një komponent të rëndësishëm në zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, duke ndikuar në të tashmen dhe në të ardhmen. Nga kjo strukturë burojnë kontingjentet kryesore të popullsisë, të cilat luajnë një rol vendimtar në proceset demografike dhe socio-ekonomike. Në aspektin

demografik, kjo strukturë ka një rëndësi të veçantë për riprodhimin biologjik, duke përcaktuar kontingjentin fertil që siguron vijimësinë e popullsisë. Ndërsa në aspektin socio-ekonomik, ajo ndikon në krijimin e kontingjentit të fuqisë punëtore, që përbën shtyllën kryesore të zhvillimit ekonomik të një shoqërie. Struktura e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës është gjithashtu e rëndësishme për analizimin e veçorive të tjera demografike dhe socio-ekonomike, si aktiviteti, profesioni, arsimi dhe veprimtaritë ekonomike, duke mundësuar një pasqyrë të plotë të dinamikave të popullsisë. Grup-moshat e reja (0-14 vjeç) dominojnë dukshëm në përbërjen e përgjithshme të popullsisë në komunë. Ky fakt është një indikator i rëndësishëm, pasi këto grup-mosha përfaqësojnë bazën e ardhshme të popullsisë fertile, duke siguruar një burim të qëndrueshëm për nivelet e lindshmërisë.Struktura e mirëkuptuar e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë është themelore për hartimin e politikave të qëndrueshme demografike dhe ekonomike, duke siguruar zhvillimin dhe mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.

	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-55	56-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80-84	85+	Gjithsej
Femra	235	256	289	336	348	306	315	344	348	345	349	354	317	353	313	178	102	53	5141
Meshkuj	311	303	351	384	401	362	397	407	365	412	357	351	339	347	260	146	97	40	5630
Gjithsej	546	559	640	720	749	668	712	751	713	757	706	705	656	700	573	324	199	93	10771

Tabela 83 Struktura e popullsisë sipas grup moshave

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social, nga rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik.

Rreth 22.88% e popullsisë në komunë janë në moshë të re, gjegjësisht i takojnë grup moshës 0- 19 vjeç. Derisa grup-mosha 20–39 vjeç e përbën mbi 26.73% të popullsisë, grup mosha 40–65 vjeç përfshin rreth 32.83% të popullsisë. Analizat strukturore të grup moshave tregojnë se Shtërpca ka një popullsi me rreth 49.61% nën moshën 39 vjeçare.

3.2.3. Lëvizjet natyrore të popullsisë

Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës dhe Komunës së Shtërpcës paraqet një komponentë mjaft karakteristike. Ato janë rezultat i rrethanave politike dhe kushteve shoqërore - ekonomike nëpër të cilat ka kaluar Kosova dhe Shtërpca, ku shtimi natyror i popullsisë ka shkuar drejt zvogëlimit. Megjithatë, trendi aktual i shtimit natyror të popullsisë në Kosovë është pozitiv krahasuar me vendet e rajonit dhe vendet e BE-së. Kosova, sikurse edhe Komuna e Shtërpcës, ende ka trend pozitiv të shtimit natyror, mirëpo, me tendencë të zvogëlimit. Shtimi natyror i popullsisë ne Komunën e Shtërpcës deri në vitet '90 të shekullit XX-të, pavarësisht disa oscilimeve, ka qenë e lartë. Pas vitit 2000 ka filluar të bjerë në mënyrë shumë të shpejtë, si pasojë e emigrimit, shtyrjes së martesave, dhe faktorëve të tjerë, pasoja këto që po ndihen edhe tani. Popullsia e Komunës së Shtërpcës në vitin 2018 kishte shtim natyror rreth 1.002%, ose në numra absolutë (187 banorë) gjë që është pak më e ulët se mesatarja e Kosovës (1.02%), e që tregon për një shtim të thjeshtë të popullsisë, dhe krahasuar me vitet paraprake, ka tendencë të uljes së shtimit natyror të popullsisë edhe në vitet në vazhdim. Faktorët kryesor që kanë ndikuar në uljen e shtimit natyror të popullsisë janë migrimet e brendshme dhe të jashtme, vdekshmëria e lartë, gjendja socio-ekonomike, arsimimi etj. Ulja e shtimit natyror të popullsisë ka për pasojë de-balancimin e strukturave demografike, efektet në rritjen e grup-moshës së tretë, humbjen e fuqisë punëtore, zvogëlimin e numrit të nxënësve, etj.

Tabela 84 Lëvizja natyrore e popullsisë ASK

Vitet	*Lindjet*	*Vdekjet*	*Shtimi natyror*
2017	90	137	-47
2018	135	115	20
2019	85	138	-53
2020	132	172	-40
2021	129	170	-41

Burimi: Regjistrimet e Popullsisë në Kosovë, 2011 ndërsa të dhënat për vitin 2017-2021 nga Vlerësimi i Popullsisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Nga tabela shihet se shtimin natyror të popullsisë e kemi me bilanc negativ nga viti 2017, ku kjo ka ndodhur si rezultat i migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, vdekshmëria e lartë, gjendja socio-ekonomike, arsimimi etj. Në bazë të vlerësimeve të popullsisë për vitin 2021 të publikuara nga ASK, Komuna e Shtërpcës ka gjithsej 6,503 banorë, që është për 446 banorë banorë më pak krahasuar me regjistrimin e vitit 2011.

3.2.4. Lëvizjet mekanike të popullsisë

Në bazë të shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (të publikuara në vitin 2020), Shtërpca ka shënuar bilanc negativ të migrimit kombëtar prej 11% dhe migrimit ndërkombëtar 2%.

Bazuar në të dhënat e ASK-së të vitit 2014, jashtë vendit jetojnë gjithsej 609 banorë të Komunës së Shtërpcës, që paraqet një përqindje të ulët prej 8.76%, prej të cilëve 247 banorë janë të gjinisë femërore dhe 362 banorë janë të gjinisë mashkullore.



Grafiku 9 Migrimi i popullsisë sipas moshës

Komuna e Shtërpcës është ndër komunat e Kosovës me shkallën më të ulët të migracionit. Vendet ku më së shumti kanë emigruar qytetarët nga Shtërpca janë: Gjermani, Zvicra, Francë, Italia etj. Gjithnjë sipas të njëjtit burim (ASK, 2014), migrimi ndërkombëtar më së shumti, sikurse në nivel të Kosovë ashtu edhe në komunën e Shtërpcës, ka ndodhur në vitet e '90 – ta dhe pas vitit 2000.

Shtërpcës	*Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor)*	*Migrimi ndërkombëtar - Imigrimi*	*Migrimi ndërkombëtar – Emigrimi*	*Migrimi ndërkombëtar - Bilanci i migrimit*	*Migrimi kombëtar - Imigrimi*	*Migrimi kombëtar - Emigrimi*	*Migrimi kombëtar - Bilanci i migrimit kombëtar*	*Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të*	*Gjithsej popullsia dhe migrimi (31.12)*
2017[18]	6773	18	14	4	41	65	-24	-20	6820
2018[19]	6763	21	35	-14	39	55	-16	-30	6743
2019[20]	6670	19	43	-24	40	56	-16	-40	6723
2020[21]	6621	14	12	2	27	38	-11	-9	6661
2021[22]	6580	13	77	-64	32	45	-13	-77	6544

Tabela 85 Migrimi ndërkombëtar sipas viteve

[18] Vlerësimi i Popullsia e Kosovës 2017
[19] Vlerësimi i Popullsia e Kosovës 2018
[20] Vlerësimi i Popullsia e Kosovës 2019
[21] Vlerësimi i Popullsia e Kosovës 2020
[22] Vlerësimi i Popullsia e Kosovës 2021

Bilanci i migrimit ndërkombëtar në Komunën e Shtërpcës është -1.8% (ASK, 2014), që është shumë më i ulët se komunat tjera. Sa i përket migrimit kombëtar, Komuna e Shtërpcës përsëri renditen ndër komunat me shkallë të ulët të migrimit. Bilanci i migrimit kombëtar në Komunën e Shtërpcës është – 6.8% (ASK-2014).

Pavarësisht migrimit ndërkombëtar dhe atij kombëtar, qytetarët që kanë migruar kanë pasuri të paluajtshme dhe vizitojnë Shtërpcën gjatë vitit dhe natyrisht se planifikimet në infrastrukturë dhe shërbime publike komuna duhet të planifikojë edhe për këtë kategori të qytetarëve.

Përveç kësaj, Komuna e Shtërpcës njihet si regjion turistik i Kosovës, sidomos Brezovica, zonë e cila nuk ka banorë të përhershëm shumë, mirëpo ka një numër të konsiderueshëm të lëvizjeve brenda vitit për rekreacion. Gjithë këto zhvillime duhet të merren parasysh në planifikime të infrastrukturës.

3.2.5. Numri i ekonomive familjare

Nga të dhënat e prezantuara më poshtë mund të kuptojmë dhe konstatojmë se një numër i konsideruar i vendbanimeve rurale, posaçërisht vendbanimet e thella kodrinore – malore, kanë pasur një ulje të lehtë të ekonomive familjare. Regjistrimi i fundit i ekonomive familjare i vitit 2011 tregon një rënie të numrit të ekonomive familjare.

Viti	1991	2011	2024
Vendbanimet	**Ekonomitë Familjare**	**Ekonomitë Familjare**	**Ekonomitë Familjare**
Beroc	172	81	88
Biti e Epërme	95	74	151
Biti e Poshtme	104	81	193
Brezovicë	187	11	18
Brod	199	263	671
Drekoc	37	29	31
Firajë	120	179	441
Gotovushë	212	123	133
Izhanc	33	15	27
Jazhincë	144	45	49
Kashtanjevë	64	18	36
Sevcë	255	56	53
Sushicë	39	15	23
Shtërpcë	537	341	642
Vërbeshticë	157	115	162
Viqë	72	39	114
SHTËRPCE	2427	1485	2834

Tabela 86 Numri i ekonomive familjare sipas vendbanimeve dhe numrit te popullsisë ndër vite 1991, 2011 dhe 2024, ASK 2024

3.2.6. Trendët dhe prognozat demografike

3.2.7. Parashikimet (projeksionet) e popullsisë 2032

Zhvillimi demografik i komunës së Shtërpcë, si një proces kompleks është shtjelluar sipas disa elementeve kryesore siç janë: numri i popullsisë, dendësia, shtimi natyror, strukturat dhe migrimet. Në procesin e planifikimit rol të veçantë luan edhe parashikimi i popullsisë për të ardhmen. Për nevoja të planifikimit hapësinor të territorit të Shtërpcës, parashikimet e popullsisë mëtojnë të bëhen për periudhën afatmesme. Merren në konsideratë barrierat statistikore sa i përket numrit faktik të popullsisë së Komunës së Shtërpcës. Nisemi me analiza të disa indikatorëve, të cilët na ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes faktike. pra, na mundësojnë të vijmë në përfundime me disa supozime mbi numrin aktual dhe trendët apo parashikimet e popullsisë së Komunës së Shtërpcës për periudhën afatmesme.

Pn = Po + Numri i Lindjeve (B) – Numri i Vdekjeve (D) + Net Migrimet (Nm)

$$r = \frac{1}{n}\frac{[Pn - P_o]}{[P_o]} x100$$

R = [(Pn / Po) 1/n - 1] x 100; Përmes formulës: $Pn = Po\ (1+R/100)^n$

Në vlerësimit e fundit, (ASK-2021) të popullsisë e komuna e Shtërpcë ka numrin e popullsisë 6,503 banorë. Agjencia e Statistikave të Kosovës ka ndërtuar 3 skenarë të projeksionit të popullsisë për 40 vitet e ardhshme, ku popullsia e Kosovës ulet në 1.6 milionë në skenarin e ulët, arrin nivelin prej 1.8 milionë në skenarin e mesëm dhe shkon deri në 2.1 milionë banorë në skenarin e lartë. Në vlerësimin e saj për vitin 2017-2021, ASK-ja e vlerëson rritjen natyrore të

popullsisë në nivel vendi në 1.14%, ndërsa emigrimin e vlerëson vetëm -0.3%, duke bërë që popullsia e Kosovës të vlerësohet me një rritje prej 0.84%. Sikur Kosova, edhe zhvillimi demografik i komunës së Shtërpcë si një proces kompleks është shtjelluar sipas disa elementeve kryesore, siç janë: numri i popullsisë, dendësia, shtimi natyror, strukturat dhe migrimet. Trajtimi i këtyre temave është me rëndësi edhe për parashikimin demografik. Në procesin e planifikimit rol të veçantë luan edhe parashikimi i popullsisë për të ardhmen.

Skenari 1 - Parashikimet e popullsisë së përgjithshme 2032

Parashikimet e popullsisë janë përpjekje për të parashikuar numrin e njerëzve që do të jetojnë në Shtërpcë në të ardhmen, duke u bazuar në të dhënat nga Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Këto parashikime zakonisht bazohen në supozimet rreth tendencave të ardhshme në lindshmëri, vdekshmëri dhe migrim dhe mund të përdoren për të ndihmuar politik bërësit dhe planifikuesit të parashikojnë dhe përgatiten për nevojat dhe sfidat e ardhshme të një popullsie. Gjithashtu, parashikimet e popullsisë mund të ndihmojnë në planifikimin e shërbimeve publike si arsimi, shëndetësia dhe transporti. Në tabelën me poshtë jemi ndalur me një parashikim të popullsisë për vitin 2032 duke u bazuar në të dhënat zyrtare.

Shtërpcë	1991	2011	2024	2032
Popullsia rezidente	12712	6949	10771	12472
Popullsia jo rezidente	2542	1390	2154	2494

Tabela 87 Prognoza e numrit të banorëve për vitin 2032

Nga analiza dhe parashikimet e popullsisë, në Komunës së Shtërpcës do të ketë 12472 banorë rezidentë në vitin 2032 duke u bazuar në vlerësimit e fundit të ASK-ës, duke mos përfshirë popullatën e cila nuk banon/jeton në Shtërpcë. Bazuar në këtë trend të zhvillimeve demografike në Komunën e Shtërpcës, deri në vitin 2032, ka tendencë të ketë një bilanc pozitiv të popullsisë.

Skenari 2 – Parashikimet e popullsisë rezidente 2032

Vlerësimi i ASK-së për popullsinë rezultoi se në Komunën e Shtërpcës, në vitin 2021 kishte 6,503 banorë. Ndërsa, sipas projeksioneve demografike të popullsisë, të bazuara në rritjen e popullsisë sipas regjistrimeve të popullsisë të viteve 1198 deri në 2011, rezulton se në Shtërpcë deri në vitin 2032 mund të arrihet një popullsi prej 12472 banorë. Projeksionet demografike deri në vitin 2032 parashohin rritje të popullsisë, kurse vlerësimi i popullsisë të vitit 2021, sipas ASK-së, paraqet ulje të numrit të popullsisë në Komunën e Shtërpcës. Ritmet e shtimit të popullsisë kanë ndikuar edhe në lëvizjen e numrit të popullsisë nëpër vendbanime, gjatë gjithë periudhave. Duhet theksuar se vetë qendra urbane e Shtërpcës kishte shënuar ritme të shpejta të shtimit të popullsisë gjatë gjithë periudhave të fundit 1981- 2011.

Vendbanimet	***1991***	***2011***	***2024***	***2032***
	Popullsia			
Beroc	***792***	***287***	***336***	***316***
Biti e Epërme	***602***	***329***	***574***	***597***
Biti e Poshtme	***741***	***383***	***735***	***807***
Brezovicë	***445***	***68***	***70***	***78***
Brod	***1608***	***1680***	***2551***	***3207***
Drekoc	***193***	***106***	***119***	***118***
Firajë	***980***	***1103***	***1677***	***2119***
Gotovushë	***986***	***445***	***504***	***520***
Izhanc	***277***	***89***	***102***	***99***
Jazhincë	***644***	***162***	***188***	***163***
Kashtanjevë	***451***	***123***	***136***	***111***
Sevcë	***1283***	***176***	***202***	***160***
Sushicë	***268***	***74***	***87***	***68***
Shtërpcë	***2200***	***1265***	***2440***	***3188***

Vërbeshticë	*790*	*450*	*615*	*537*
Viqë	*452*	*209*	*435*	*383*
SHTËRPC	*12712*	*6949*	*10771*	*12472*

Tabela 88 Prognoza e numrit të banorëve për secilin vendbanim për vitin 2032

Duke u bazuar nga të dhënat alternative zyrtare nga burimet e ndryshme parashikimet demografike për vitin 2024 numri i banorëve rezidentë është 10,771 banorë. Bazuar në trendët e numrit të banorëve përgjatë 68 viteve të kaluara si dhe rezymimeve tjera, të dhënave plotësuese, vlerësohet se në vitin 2032 në komunë do të jetojnë gjithsejtë 12,472 banorë, ku 3,188 banorë parashihen të jetojnë në zonën urbane, gjersa 9,284 në zonën rurale.

3.2.8. Parashikimet e popullsisë rezidente sipas grup moshës, 2032

Analiza dhe parashikimet e popullsisë, bazuar në strukturat demografike dhe veçanërisht strukturën sipas grup-moshës, ka një rëndësi të veçantë në sferën e planifikimit hapësinor të territorit, jo vetëm për faktin që na mundëson me njohjen e gjendjes ekzistuese, mirëpo mundëson edhe planifikimin e territorit te komunës, si p.sh. është e rëndësishme për përcaktimin e politikave të qeverisë, zhvillimit ekonomik, si dhe për planifikimin e burimeve të nevojshme, si shëndetësia, arsimi, transporti dhe infrastruktura.

Parashikimi i popullsisë sipas grup moshës mund të bëhet duke u bazuar në disa faktorë, siç janë rritja natyrale, migrimi dhe ndryshimet në strukturën e popullsisë. Në vazhdim, do të shpjegojmë se si këta

faktorë ndikojnë në rritjen ose zvogëlimin e popullsisë sipas grup moshës.

Shtërpcë	0-9	10-19	20-29	30-39	40-49	50-59	60-69	70-79	80+	Gjithsej
2011	1237	1305	1126	930	725	502	337	178	56	6396
2024	2,083	2,199	1,897	1,567	1,220	845	567	300	95	10,771
2032	2412	2546	2196	1814	1413	979	656	348	110	12472

Tabela 89. Prognoza e numrit të banorëve sipas grupmoshave për vitin 2032.

Për të bërë një parashikim të saktë të popullsisë sipas grup moshës, duhet të marrim parasysh të gjithë këta faktorë dhe të analizojmë trendët historikë në popullsinë sipas grup moshës. Kjo mund të ndihmojë në kuptimin e zhvillimit të mundshëm të popullsisë sipas grup moshës në të ardhmen dhe në planifikimin e politikave dhe strategjive në fushën e shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe pensionimit.

3.2.9. Parashikimi i numrit të ekonomive familjare 2032

Në bazë të analizave të trendëve të ekonomive familjare në vitin 2032, pritet të ketë rreth 2149 ekonomi familjare në Komunën e Shtërpcës sipas projeksioneve demografike. Nga kjo shifrë, pritet që 445 ekonomi familjare të vendosen në zonën urbane. Parashikimet tona për periudhën 2024-2032 bazuar në të dhënat zyrtare për numri e ekonomive familjare në të ardhmen pritet të jetë 2149.

Vendbanim et	1981	*1991*	2011	2021	2032
Beroc	165	172	81	55	165
Biti e Epërme	92	95	74	69	60
Biti e Poshtme	103	104	81	74	63
Shtërpcë	69	187	11	31	69
Brezovicë	151	199	263	316	372
Brod	36	37	29	27	24
Drekoc	110	120	179	205	240
Firajë	180	212	123	115	86
Gotovushë	23	33	15	16	12
Izhanc	144	144	45	53.5	127
Jazhincë	60	64	18	91	85
Kashtanjevë	237	255	56	237	255
Sevcë	45	39	15	3	48
Sushicë	445	537	341	337	445
Vërbeshticë	156	157	115	102	81
Viqë	67	72	39	31	17
GJITHSEJ	2083	2427	1485	1763	2149

Tabela 90 Prognoza e numrit të ekonomive familjare për vitin 2032

Për nevoja të planifikimit hapësinor-urban të territorit, rëndësi të veçantë ka bërja e analizave dhe projeksioneve për numrin e ekonomive familjare. Duke marrë për bazë zhvillimet shoqërore, familja kosovare në përgjithësi po shkon drejt një dekompozimi, e cila tregon se do të ketë rritje të numrit të ekonomive familjare dhe zvogëlim të numrit të anëtarëve për një ekonomi familjare.

Bazuar në trendët demografikë, deri në vitin 2032 Komuna e Shtërpcës vlerësohet se do të ketë rreth 2149 ekonomi familjare.

Gjetjet kryesore

Në bazë të indikatorëve të trajtuar mund të konstatohet se për periudhë për të ardhmen, të dhënat zyrtare te Agjencinë te Statistikave te Kosovës sipas regjistrimit te fundit për vitin **2024** numri i:

- Popullsisë rezidente është **10,771;**
- Ekonomive familjare rezidente është **2,149;**
- Popullsia jo rezidente është **2,494;**
- Ekonomive familjare jo rezident është **656**;

Bazuar në grafikun e prezantuar në vijim, vërehet se në vitin 2011, komuna e Shtërpcës kishte në total 6949 banorë. Nga kjo shihet, 3148 ishin banorë serbë, ndërsa 3757 ishin banorë shqiptarë, me 44 banorë janë te përkatësive tjerë. Numri relativisht i ulët i banorëve serbë nënkuptohet për shkak të mos-pjesëmarrjes së një pjese të popullsisë në regjistrimin e atëhershëm të popullsisë në Komunën e Shtërpcës. Kjo çon në një numër më të ulët të deklarimeve sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për këtë komunë.



Në komunën e Shtërpcës, sipas të dhënave nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, banojnë rreth 13,600 banor. Ndër ta, 9,100 janë Serbë, 4,500 janë Shqiptarë dhe vetëm 30 janë Romë. Këto të dhëna shënojnë një strukturë demografike shumë të përzier dhe një rritje të qetë në numrin total të banorëve[23]

3.3. FUSHA EKONOMIKE

3.3.1. Ekonomitë familjare

Deri në vitin 2032 numri i ekonomive familjare rezidente pritet të jetë 2,149. Projeksionet janë të atilla që në zonën urbane ekonomitë familjare të rriten për 2.8% në vit, ndërsa në zonat rurale numri i tyre të rritet për 1.8% në vit deri në vitin 2032, gjithmonë bazuar në të dhënat e ASK-së për vlerësimin e popullsisë për vitin 2021.

Vendbanimi	2023	2025	2028	2032
Urban	356	376	409	445
Rural	1,478	1,531	1,616	1,704
Total	**1,834**	**1,908**	**2,025**	**2,149**

[23] https://kk.rks-gov.net/Shtërpce/qyteti/numri-i-banoreve

Tabela 91 Projeksionet e ekonomive familjare në Komunën e Shtërpcës, 2023-2032

Këto prognoza vijnë nga rritja e zhvillimit ekonomik përmes projekteve zhvillimore që planifikohet të realizohen, përveç në fushën e bujqësisë, edhe në atë të turizmit, industrisë dhe në veprimtaritë e tjera shërbyese dhe arsyeve të tjera demografike.

3.3.2. Punësimi dhe Papunësia

Punësimi - Në Komunën e Shtërpcës trendet e punësimit tregojnë për një rritje pozitive.

Sektori	2020	2021	2022	2023
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	177	149	163	124
B - Industria nxjerrëse	-	-	-	-
C - Industria përpunuese	435	506	470	306
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-	-	-	-
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	-	-	-	-
F - Ndërtimtaria	314	651	530	574
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	543	630	745	757
H - Transporti dhe magazinimi	89	79	62	72
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	810	1,082	2,047	2,170
J - Informimi dhe komunikimi	187	221	224	256
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit		2	23	
L - Aktivitetet e patundshmërisë	12	11	12	16
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	184	216	189	162
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	24	31	49	58
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	13	8	-	-
P - Arsimi			5	13
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	-	1	52	30
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	-	-	-	-
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	35	119	87	67
T - Person Fizik	56	-	5	-
U – Mungon aktiviteti	94	190	166	149
Total	**2,973**	**3,896**	**4,829**	**4,565**

Tabela 92 Trendet e punësimit sipas sektorëve ekonomik 2020-2023

Supozohet se deri në fund të vitit 2023 të dhënat e ATK-së do të ndryshojnë, ku pritet të ketë rritje të numrit të të punësuarve, ndërsa deri në vitin 2032 prognozat janë që punësimi do të ketë rritje mesatare prej 3.5%.

Sektori	2023[30]	2025	2028	2032
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	180	193	214	237
B - Industria nxjerrëse	-	-	-	-
C - Industria përpunuese	510	546	606	672
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-	-	-	-
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	3	3	4	4
F - Ndërtimtaria	643	689	764	847
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	768	823	912	1,011

[30] Verësim

H - Transporti dhe magazinimi	92	99	109	121
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	2,205	2,362	2,619	2,904
J - Informimi dhe komunikimi	265	284	315	349
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	32	34	38	42
L - Aktivitetet e patundshmërisë	20	21	24	26
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	220	236	261	290
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	67	72	80	88
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	25	27	30	33
P - Arsimi	14	15	17	18
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	61	65	72	80
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	5	5	6	7
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	129	138	153	170
T - Person Fizik	60	64	71	79
U – Mungon aktiviteti	203	217	241	267
Total	**5,502**	**5,894**	**6,535**	**7,245**

Tabela 93 Prognozat e punësimit sipas sektorëve ekonomik deri në vitin 2032

Në mungesë të të dhënave për numrin e punëtorëve sipas vendbanimeve në Komunën e Shtërpcës, trendet dhe prognozat në këtë kategori nuk kanë mundur të paraqiten.

Trendet e punësimit sipas pronësisë së bizneseve tregojnë për rritje të vazhdueshme të të njëjtat llojeve të pronësisë së bizneseve.

Lloji i biznesit	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Biznes individual	966	1,055	1,014	924
Kompani e huaj	10	4	47	10
Ndërmarrje nën menaxhim të AKP-së	0	14	0	0
Ndërmarrje shoqërore	148	226	210	175
OJQ	31	124	93	52
Organizata buxhetore	13	8	0	0
Person fizik	56	0	5	0
Sh.p.k.	1,667	2,370	3,374	3,343
Tjetër	82	95	86	61
Total	**2,973**	**3,896**	**4,829**	**4,565**

Tabela 94 Trendet e punësimit sipas pronësisë së bizneseve 2020-2023

Ngjashëm pritet që të mos ketë ndryshime në llojet e pronësisë së bizneseve krahasuar me gjendjen momentale. Pra, rritjen më të madhe do ta kenë bizneset e pronësisë sh.p.k. dhe bizneset individuale.

Lloji i biznesit	**2023**	**2025**	**2028**	**2032**
Biznes individual	2,430	1,348	1,494	1,657
Kompani e huaj	67	72	80	88
Ndërmarrje nën menaxhim të AKP	34	36	40	45
Ndërmarrje shoqërore	289	310	343	381
OJQ	203	217	241	267
Organizata buxhetore	25	27	30	33
Person fizik	71	76	84	93
Sh.p.k.	3,452	3,698	4,100	4,546
Tjetër	103	110	122	136
Total	5,502	5,894	6,535	7,245

Tabela 95 Prognozat e punësimit sipas pronësisë së bizneseve deri në vitin 2023

Papunësia

Në Komunën e Shtërpcës papunësia është e lartë. Nga trendet e të papunëve të regjistruar në entin e punësimit në komunë vërehet se numri i të papunëve meshkuj ka shkuar duke rënë përderisa i atyre femrave duke u rritur.

Viti	Mashkull	Mashkull (%)	Femër	Femër (%)	Totali
2018	231	58.3%	165	41.6%	396
2019	233	50.7%	22	49.2%	459
2020	1,590	48.0%	1,724	51.9%	3,311
2021	136	46.5%	156	53.4%	292
Totali	**2,190**	**49.1%**	**2,268**	**50.8%**	**4,458**

Tabela 96 Të papunët e regjistruar sipas viteve dhe gjinisë në komunën e Shtërpcës, 2018-2021

Sfidat e tregut të punës në Komunën e Shtërpcës që njëkohësisht tregojnë edhe nevojat e ndërhyrjes së institucioneve publike për përmirësimin e këtij tregu janë:

- Numri i lartë i të papunëve
- Mungesa e programeve për zhvillimin e aftësive të të papunëve (përfshirë edhe programet virtuale)
- Mungesa e programeve trajnuese për avansimin e aftësive të të punësuarve (përfshirë edhe programet virtuale)
- Mungesë e bashkëpunimit më të madh të partneriteteve publiko- private që përfshijnë institucionet komunë-arsim-sektor privat i biznesit
- Mungesë e kanaleve informuese për vendet e lira të punës dhe mundësitë e trajnimeve profesionale ekzistuese
- Përmirësimi i rrjetit të transportit i cili do të ndikonte në rritjen e numrit të fuqisë punëtore

3.3.3. Bizneset, ndërmarrjet dhe ambienti i biznesit

Në Komunën e Shtërpcës deri ekzistojnë rreth 733 biznese, ku dominon sektori i akomodimit, ndërtimtarisë, industrisë, e kështu me radhë. Megjithatë mendohet se ky numër është më i madh dhe deri në fund të vitit fiskal 2023 do të jetë më i lartë për 8% krahasuar me vitin 2022

Nga të gjithë sektorët, në Komunën e Shtërpcës sektori më premtues që mund të ndikojë në zhvillimin ekonomik është sektori i turizmit dhe industrisë. Megjithatë, gjendja aktuale financiare e akterëve të ndryshëm, si të investitorëve privat, komunal apo edhe të donatorëve të ndryshëm është mjaftë e vogël për të investuar/financuar bizneset që ato t'i ngritin kapacitetet prodhuese dhe të ngritin nivelin e ofrimit të shërbimeve.

Sektori	2020	2021	2022	2023
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	103	110	110	56
B - Industria nxjerrëse	8	5	2	
C - Industria përpunuese	128	132	132	66
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	-	-	-	-
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave	-	-	-	-
F - Ndërtimtaria	154	167	193	86
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	114	114	114	61
H - Transporti dhe magazinimi	65	45	45	27
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	163	163	163	80
J - Informimi dhe komunikimi	81	53	75	40
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	8	44	36	
L - Aktivitetet e patundshmërisë	37	37	40	40
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	110	110	110	54
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	90	91	102	51
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	22	27	12	4
P - Arsimi	-	-	37	21
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	5	29	58	20
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	32	32	32	16
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	57	77	81	40
T - Person Fizik	57	49	43	8

DRAFT

U – Mungon aktiviteti	151	139	125	63
Total	**1,574**	**1,424**	**1,510**	**733**

Tabela 97 Trendet e ndërmarrjeve ekonomike sipas sektorëve ekonomik në komunën e Shtërpcës, 2020- 2023

Prognozat e sektorëve ekonomik parashohin një rritje të vazhdueshme stabile të bizneseve deri në vitin 2030.

Sektori	**2023**	**2025**	**2028**	**2032**
A – Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	112	119	131	144
B - Industria nxjerrëse	5	5	6	6
C - Industria përpunuese	132	141	155	170
D - Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar		0	0	0
E - Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave		0	0	0
F - Ndërtimtaria	201	214	235	259
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	114	121	133	147
H - Transporti dhe magazinimi	65	69	76	84
I - Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	164	175	192	211
J - Informimi dhe komunikimi	87	93	102	112
K - Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	41	44	48	53
L - Aktivitetet e patundshmërisë	45	48	53	58
M - Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	111	118	130	143
N - Shërbimet administrative dhe mbështetëse	105	112	123	135
O - Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	31	33	36	40
P - Arsimi	37	39	43	48
Q - Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	59	63	69	76
R - Artet, Argëtimi dhe rekreacioni	34	36	40	44
S - Aktivitetet e tjera shërbyese	81	86	95	104
T - Person Fizik	58	62	68	75
U – Mungon aktiviteti	153	163	179	197
Total	**1,635**	**1,741**	**1,914**	**2,104**

Tabela 98 Projeksionet e ndërmarrjeve të reja sipas sektorëve deri në vitin 2032

Sipas pronësisë së bizneseve, trendet tregojnë se numri më i madh i bizneseve në 4 vitet e fundit i takon llojit sh.p.k., ndërsa më së paku ndërmarrje janë të menaxhuara nga AKP-ja.

Lloji i biznesit	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Biznes individual	508	541	566	281
Kompani e huaj	49	62	89	44
Ndërmarrje nën menaxhim të AKP	41	18	4	1
Ndërmarrje shoqërore	44	48	50	26
OJQ	78	83	96	40
Organizata buxhetore	22	27	12	5
Person fizik	57	49	43	8
Sh.p.k.	538	548	602	308
Tjetër	48	48	48	20
Total	**1,574**	**1,424**	**1,510**	**733**

Tabela 99 Trendet e ndërmarrjeve sipas pronësisë 2020-2023

Projeksionet tregojnë se rritjen më të madhe në numër deri në vitin 2032 do të vazhdojnë ta kenë sh.p.k.-të dhe bizneset individuale.

Lloji i biznesit	**2023**	**2025**	**2028**	**2032**
Biznes individual	562	599	658	723
Kompani e huaj	98	104	115	126
Ndërmarrje nën menaxhim të AKP	52	55	61	67
Ndërmarrje shoqërore	62	66	73	80
OJQ	80	85	94	103

DRAFT

Organizata buxhetore	37	39	43	48
Person fizik	64	68	75	82
Sh.p.k.	632	673	740	813
Tjetër	48	51	56	62
Total	**1,635**	**1,741**	**1,914**	**2,104**

Tabela 100 Projeksionet e ndërmarrjeve sipas pronësisë deri në vitin 2032

Numri i vogël i bizneseve është një indikator për një klimë jo të favorshme ekonomike. Komuna e Shtërpcës, duke pasur territor mesatar të sipërfaqes komunale me të gjitha potencialet ekzistuese ekonomike, është një mundësi më e madhe për inovatorët që të zhvillohen dhe të depërtojnë më shpejtë në rrjetet sociale të biznesit. Përmes krijimit të qendrave biznesore, siç është janë inkubatorët e biznesit dhe qendrat për kërkim dhe zhvillim, inovatorët e kanë më lehtë të jenë më të dukshëm dhe të stimulohen për punën e tyre.

Një fushë tjetër në të cilën duhet të fokusohet komuna është ofrimi i shërbimeve të ndryshme online. Kjo duhet të ketë parasysh edhe ndërlidhjen e sektorëve të ndryshëm në mes veti në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më lehtë në shërbimet e tyre përmes qasjes virtuale.

"Agromarketks" është një treg i gjelbër virtual i cili ndërlidh fermerët e komunës së Shtërpcës, Suharekës, Gjakovës dhe Parteshit dhe të tjerë me blerësit në mbarë Kosovën. Përmes këtij tregu blerësit mund të ndërtojnë kontakte tregtare, të bashkëpunojnë më lehtë dhe më shpejtë si dhe të arrijnë marrëveshje agrokulturore.

Tregje të tilla duhet të stimulohen nga ana e komunës, sepse sot ekziston mundësia më e madhe që bizneset të rriten më shpejtë nëse kanë prezencë në tregtinë elektronike. Bashkëpunimi midis sektorëve të caktuar dhe krijimi i sinergjive ndërsektoriale është një domosdoshmëri tjetër për zhvillimin ekonomik të komunës.

Sfidat me të cilat përballet sektori i bizneseve në Komunën e Shtërpcës janë:

- konkurrenca jo lojale nga ekonomia e hirtë,
- furnizimi jo i rregullt dhe jo stabil me energji elektrike
- kostoja e energjisë elektrike
- kamatat e larta dhe kostot tjera për transaksione bankare
- profitabiliteti shumë i ulët
- mungesë e përkrahjes komunale qoftë përmes granteve apo edhe përmes lëhtësimit të proceduarave administrative

Prandaj paraqiten këto nevoja:

- krijimi i një fushate marketingu për komunën
- krijimi i një klime më të madhe bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve dhe bashkëpunimit ndërsektorial
- mbështetje institucionale në trajnime dhe konsulencë dhe mbështetje infrastrukturore
- stimulimi i krijimit të partneriteteve publiko - private

Komuna e Shtërpcës ka potencial të madh për rritje ekonomike, e cila do të ndihmojë edhe në rritjen e ekonomisë së vendit duke i kapërcyer boshllëqet ekonomike të saj. Performanca më e lartë ekonomike ekziston në potencialet e industrisë së turizmit, përfshirë këtu udhëtimet apo vizitat e turistëve dhe rekreacionin. Prandaj, duhet që bizneset t'i ngritin cilësinë e shërbimeve, në rend të parë përmes trajnimeve të fuqisë punëtore dhe pasurimit të ofertës së shërbimeve.

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
▪ Zona e veçantë malore për blegtori , pylltari, pemëtari (mbjellja e manaferrave) dhe bletari; ▪ Traditë të gjatë bujqësore; ▪ Ekologjikisht një mjedis i pastër për prodhimin e ushqimit organik; ▪ Llojllojshmëria e bimëve shëruese	▪ Copëtimi i parcelave; ▪ Mungesë e mekanizmave bashkëkohorë; ▪ Mungesë e infrastrukturës lidhëse për parcela bujqësore; ▪ Mungesë e sistemit të ujitjes; ▪ Shkallë e ulët e integrimit të prodhuesit bujqësor me tregun; ▪ Mosinteresimi i rinisë për t'u marrë me bujqësi.
MUNDËSITË	**RREZIQET**

DRAFT

▪ Mundësi e mirë për llojllojshmërinë e prodhimtarisë bujqësore dhe përpunimin e produkteve; ▪ Zhvillimi i blegtorisë dhe pylltarisë; ▪ Ekzistenca e bankave për kredi si dhe prodhimi dhe fondet e investimeve; ▪ Stimulimi i bujqësisë si dhe regjistrimi i kamatës në kredi për prodhimtarinë bujqësore; ▪ Mundësia e ndërtimit të sistemit të ujitjes dhe shfrytëzimi i ujit nga lumenjtë për ujitje.	▪ Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore; ▪ Qasja e kufizuar në mjete financiare, çmimet e ulëta të produkteve bujqësore si dhe kufizimi i tregut; ▪ Mosinteresimi i bujqve për rritjen e prodhimtarisë bujqësore; ▪ Ligji joadekuat për tokën bujqësore si dhe mungesa e shqyrtimit të politikës së tokës.

Tabela 101 SWOT analiza e sektorit të bizneseve

3.3.4. Ndërtimtaria

Ndërtimtaria ka një vend të rëndësishëm në ekonominë e Shtërpcës. Planifikohet që të forcohet në aspektin e një numrit të të punësuarve në profile të ndryshme. Ndërtimtaria funksionale do të vazhdojë të jetë e lidhur ngushtë me zhvillimin e të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe jo ekonomike. Zhvillimi intensiv i ndërtimtarisë do të vazhdojë të jetë i kushtëzuar në përputhje me kapacitetin e investimeve për zhvillimin ekonomik dhe aktivitete sociale. Aktivitetet ndërtimore do të vazhdojnë të jenë të përqendruara kryesisht në kompanitë e ndërtimit privat që do të punësojnë shumicën e punëtorëve të punësimit total në komunë.

Kompanitë e ndërtimit janë përdorues relativisht të mëdhenj të hapësirës. Pra, po analizohen dhe planifikohen hapësira që mund të përdoren për deponim, ndarjen e zhavorrit dhe të materialeve tjera për të prodhuar një masë betoni dhe produkte nga gjysmë-betoni, për instalimin dhe funksionimin e bazës së makinës dhe punëtorive për riparime, për punë të reparteve të ndryshme (muratorët, punëtorët me armaturë, mekanikë, elektricistë, zdrukthëtarë, punët finale etj.), për parkimin e makinave, depove, objekteve tjera dhe shërbimeve.

3.3.5. Turizmi

Resursi strategjik i turizmit kosovar duhet të mbetet hapësira me shumë vlera, deri tani e ruajtur, që në afat të gjatë gjithnjë e më shumë do të ketë rëndësi. Vlera turistike kanë pothuajse të gjitha trevat e Kosovës në forma dhe dimensione të veta, varësisht nga resurset dhe shkalla e zhvillimit. Fizionomia e elementeve tërheqëse të Kosovës udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimet e transitit turistik, qytetet e mëdha, banjat, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat.

Në Komunën e Shtërpcës, vlera më e rëndësishme e Parkut Kombëtar Sharri është fakti që ai ngërthen një sekuencë të tërë ekosistemesh në gjendje të mirë, në substrakte të ndryshme, nga malet e deri tek kodrinat. Të ndërlidhura me to janë flora dhe fauna pothuajse e paprekur, që përfshinë edhe shumë specie të rralla dhe endemike. Ndikimet njerëzore ekzistojnë dhe janë në rritje, megjithëse ato ende janë të lokalizuara dhe sipërfaqja e parkut ende nuk ka pësuar degradim apo fragmentim të theksuar apo të përhapur.

Në qendrën e skijimit në Brezovicë gjenden stabilimentet dhe objektet turistike, ku ekzistojnë rreth 500 shtëpi. Qendra e skijimit Brezovicë ka 2 hotele, 1 restorant, 2 shtëpi malore, 7 ski-lift bazik, ndërsa fshati turistik i Brezovicës ka 2 motel-restorante dhe 150 ndërtesa private (shtëpi vikendi). Në qendër të skijimit, për turizëm fundjave dhe pikniku gjatë muajve dhjetor – shkurt, numri maksimal i vizitorëve arrin 3000.

Komuna e Shtërpcës më së shumti njihet për turizmin e saj, me pozitën e favorshme gjeografike të Brezovicës, e cila shtrihet në Parkun Kombëtar të Sharrit dhe me shpatet e përshtatshme për sportet dimërore, e që në të njëjtën kohë i ka mundësuar asaj të bëhet një nga qendrat më të mëdha turistike në Kosovë. Një shumëllojshmëri e bimëve endemike në malet e Sharrit që gjendet edhe në këtë pjesë njihet edhe si një burim i rëndësishëm për zhvillim.

Qendra e skijimit më herët ka organizuar dy kampionate evropiane të skijimit alpin dhe nëntë kampionate kombëtare. Deri në vitin 1999 çdo vit janë realizuar më shumë se 103.000 fjetje në të gjitha objektet e qendrës së skijimit dhe mesatarisht 13.000 fjetje janë realizuar në objektet e tjera me qira.

Kategoria	Emri i shtegut	Gjatësia e shtegut	Gjatësia e teleferikut	Kuota	Ndryshimi i lartësisë mbidetare	Statuti
KUQE	Karaula	2600m	1186m	1731-2190	459m	Aktive
ZEZË	Piriberg	3500m	521+1186m	1718-2522	804m	Joaktive
KALTËRT	Gropat Berevaqe	800m	731m	2099-2285	168m	Aktive
KUQE	Qafa e Ortekut	2500m	1428m	1718-2147	429m	Aktive

KALTËRT	Baqilla	301m	301m	1729-1803	73m	Aktive
KALTËRT	Munika	454m	454m	1734-1830	94m	Aktive
KALTËRT	Livadhet e Grekut	500m	429m	1772-1885	113m	Aktive
KUQE	Karpa e Kuqe	3000m	1269m	1891-2264	735m	Joaktive
KUQE	Livadhi i Madh	2000m	1280m	1718-2202	484m	Aktive

Tabela 102 Shtigjet e skijimit në Brezovicë dhe karakteristikat e tyre

Shtigjet e ecjes në Komunë janë të rregulluara për të gjitha disiplinat alpine, dhe shpatet anësore të qendrës së skijimit e bëjnë resortin një sistem prej 5 teleferikësh dhe 5 ski-lifteve, të ndërlidhur me 16km gjatësi të shtigjeve të skijimit dhe gjatësi mesatare prej 3.000m. Shtigjet kanë certifikatë të akredituar nga FIS duke i bërë ata të përshtatshëm për organizimin e garave ndërkombëtare së sllallom, sllallom të madh, super G dhe lëshim.

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
▪ Kushtet e mira për zhvillimin e transportit; ▪ Pasuritë e resurseve ujore; ▪ Pasuritë e resurseve natyrore dhe viseve tërheqëse; ▪ Llojllojshmëria e florës dhe faunës; ▪ Mjedis ekologjikisht i pastër; ▪ Objekte ekzistuese; ▪ Qytetarë mikpritës; ▪ Manifestimet tradicionale; ▪ Trashëgimia shpirtërore dhe kulturore.	▪ Mungesa e liderit; ▪ Qëllimet dhe strategjitë zhvillimore të paqarta; ▪ Mungesa e infrastrukturës së duhur; ▪ Rrjedha e pamjaftueshme e investimeve; ▪ Marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore private
MUNDËSITË	**RREZIQET**
▪ Zhvillimi i turizmit gjatë gjithë vitit (veror dhe dimëror); ▪ Ndërtimi i shtegut ▪ Hapja e rrugëve të reja për komunikim më efikas (Prizren); ▪ Zhvillimi i veprimtarive vendore.	▪ Situata jo e favorshme politiko – ekonomike; ▪ Ndryshimi i nevojave të njerëzve për turizmin malor; ▪ Mungesa e investitorëve të interesuar; ▪ Fatkeqësitë natyrore.

Tabela 103 SWOT analiza e sektorit të turizmit

3.3.6. Tregtia

Gjendja ekonomike e Kosovës, përfshirë edhe sektorin e tregtisë si sektorin më prezent në vend, karakterizohet nga pengesa dhe shqetësime të vazhdueshme. Niveli i lartë i papunësisë, për shembull, mbizotëron prej vitesh tashmë. Një numër i madh i vendeve të punës në sektorin privat ofron punë për punëtorë me kualifikime të ulëta, që me siguri nuk kontribuojnë në uljen e kësaj përqindjeje të lartë të punëtorëve të pakualifikuar.

Tregtia është ndër degët parësore në ekonominë e Shtërpcës.

Dyqanet tregtare në përgjithësi janë të tipit të përzier, edhe pse ka dyqane të specializuara për: këpucë, tekstil, veshje dhe produkte metalike.

Tregtia e komunës është e kufizuar kryesisht në tregun lokal, me shumë pak tendenca për t'u zgjeruar në tregun jashtë komunës. Niveli i bashkëpunimit ndërmjet dy komuniteteve kryesore në Komunë nuk është i kënaqshëm. Megjithatë, bizneset e konsiderojnë rritjen ekonomike në Kosovë si faktorin kryesor që do të ndikojë në bashkëpunimin mes dy komuniteteve të ndryshme në komunë. Kjo do të vijë si rrjedhojë e potencialit për rritje që mund të ekzistojë përmes bashkëpunimit dhe krijimit të rrjeteve rajonale dhe qendrore mes të gjitha komuniteteve të biznesit ndër komunal.

Zbatimi i politikave dhe projekteve që ndihmojnë në rimëkëmbjen dhe fuqizimin për hapat e parë të ndërmarrjeve ekzistuese dhe krijimit të start-up-ëve është gjëja për të cilën Komuna e Shtërpcës ka shumë nevojë. Strategjitë e suksesshme të zhvillimit shihen në mbështetjen tek pasuritë pozitive të qendrave të qytetit, qendrën e skijimit në Brezovicë, dhe sektorin e bujqësisë.

Sfidat e të bërit biznes në Komunën e Shtërpcës adresojnë këto çështje kryesore:

- nevoja për marketing e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla;
- gjetja e hapësirës për zgjerim në qendër të qytetit;
- marrja e mbështetjes me financim;
- teknologjia bashkëkohore;
- gjetja e punëtorëve të aftësuar dhe të besueshëm

Ndërsa, si nevoja zhvillimore në komunë paraqiten të jenë:

- Nxitja dhe zbatimi i programeve aktive për punësim
- Krijimi i inkubatorëve të vegjël me qëllim të stimulimit të krijimit të start-up bizneseve të vogla dhe mbështetjes së tyre intelektuale në fazat fillestare të themelimit
- Fokusimi në zhvillimin e infrastrukturës qytetare (aftësitë, kapacitetet, dhe asetet që iu mundësojnë njerëzve të bëhen bashkë për t'i zgjidhur problemet dhe që të punojnë bashkë) përmes angazhimit të qytetarëve në aktivitete të përbashkëta edukative/vullnetare të ndryshme (shpërndarje të informatave, kanaleve të komunitetit, mbledhjeve/dialogut civil, qeverisjes së hapur, qasje e lehtë dhe falas në disa shërbime të komuniteteve të caktuara, thirrje përmes rrjeteve sociale për aktivitetet e cekura më lartë, organizimin e aktiviteteve sportive përfshirë edhe garimin)
- Zhvillimi i fuqisë punëtore

Programet stimuluese të komunës për sektorin e tregtisë duhet të përfshijnë uljen e kostos së vendndodhjes së bizneseve, ndihma në uljen e rreziqeve të investimeve për të stimuluar vendosjen e bizneseve në qendër të qytetit. Nxitje të tjera përfshijnë financimin e rritjes së taksave, programet e granteve të fasadimeve, përmirësimin e qarqeve të biznesit, lehtësimin e tarifave dhe programet e ndihmës për qira për bizneset.

Përveç adresimit të kostove të financimit dhe vendndodhjes, gjithashtu ekziston edhe nevoja shumë e madhe e zhvillimit të nevojave profesionale dhe biznesore të bizneseve të komunës. Mungesa e punëtorëve të duhur dhe të kualifikuar si dhe mungesa e hapësirave të përshtatshme për të bërë biznes janë sfida të komunitetit të biznesit të cilave sfida i shtohet edhe mungesa e vendparkingjeve dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve. Bizneset kërkojnë punëtorë që kanë aftësi të buta relevante dhe janë të kualifikuar, ndërsa sfidat e tyre më të mëdha janë marketingu dhe vetëdijesimi i konsumatorëve, posedimi i teknologjisë bashkëkohore, mbijetesa në periudha të vështira ekonomike, siç ishte pandemia COVID, si dhe vështirësitë për t'u zgjeruar si biznes.

Prandaj, duke ditur se nga hulumtimet e bëra në komunën e Shtërpcës ekziston numër i konsiderueshëm i banorëve dhe sidomos i të rinjve të komuniteteve pakicë që ka ndërprerë edukimin. Programet mentoruese dhe programet trajnuese për biznes janë mjaftë të domosdoshme si për një pjesë të komunitetit të biznesit, ashtu edhe si trajnime profesionale për të rinjtë, sepse është vërtetuar se bizneset e vogla që ndjekin këto lloj trajnimesh rrisin shitjet dhe zgjerojnë biznesin.

Përmes zbatimit të këtyre strategjive si dhe strategjisë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, rezultatet e komunës në periudhë afatgjatë do të jenë:

- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Shtimi dhe rritja e të ardhurave familjare
- Efikasitet ekonomik
- Integrim shoqëroro-ekonomik
- Rregullim i mjedisit
- Vendimmarrje më e fuqishme

Përveç kësaj, përmes zbatimit të duhur të këtyre strategjive mund të përdoren edhe potencialet për të zhvilluar industrinë e prodhimit si industrinë e drurit, industrinë e materialeve ndërtimore, përpunimi i metalit, kultivimi dhe përpunimi i bimëve mjekësore, industria ushqimore, tekstilit, riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve të ngurta. Gjithashtu burimet në dispozicion të tilla si biomasa, energjia diellore, era dhe uji mund të përdoren për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes.

Ndër prioritetet e para të komunës sugjerohet vendosja e pajisjeve për rigjenerimin e burimeve alternative të energjisë efiçiente. Ky realizim mund të ketë rezultate pozitive edhe në aspektin afatgjatë në infrastrukturën e mençur urbane.

Një gjë tjetër e rëndësisë së madhe paraqet nevoja e promovimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve për riciklim të produkteve. Një fushatë e bërë në media dhe përmes vënies së motos në formë të shtypur për ndarje të produkteve të ricikluara në vende të caktuara (p.sh. afër kontejnerëve të mbetjeve) ngrit efektshëm vetëdijesimin dhe

ndërgjegjësimin e qytetarëve për riciklim. Përpunimi dhe riciklimi i këtyre mbetjeve mund të organizohet përmes angazhimit të përbashkët të bashkëpunimit komunë-sektor privat.

PËRPARËSITË	DOBËSITË
▪ Ekzistenca e objekteve tregtare; ▪ Shumëllojshmëria e shërbimeve; ▪ Aftësia e të punësuarve dhe komunikimi i mirë me konsumatorët; ▪ Lojaliteti i konsumatorëve;	▪ Ndërtimi i ngadalshëm i infrastrukturës moderne të tregut dhe tregtisë në nivel lokal; ▪ Nuk ekzistojnë strategji të qarta të dhe të përcaktuara të tregut dhe politikës tregtare; ▪ Çmimet e papërshtatshme; ▪ Nuk ekziston rregullorja ligjore për mbrojtjen e konsumatorit.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
▪ Investimet në zhvillimin e tregtisë; ▪ Hapja e objekteve të reja tregtare që do të kushtëzojnë konkurrencën më të mirë në treg; ▪ Rritja e numrit të të punësuarve.	▪ Importi i pakontrolluar i mallrave me prejardhje e dyshimtë; ▪ Organizimi dhe transformimi afarist i ngadalshëm; ▪ Konkurrenca tregtare jo korrekte; ▪ Zvogëlimi i fuqisë blerëse të konsumatorëve.

Tabela 104 SWOT analiza e sektorit të tregtisë

3.3.7. Bujqësia

Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë dhe si e tillë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e një regjioni apo komune. Komuna e Shtërpcës gjendet në pjesën jug-lindore të Kosovës. Territori i Komunës së Shtërpcës ka një sipërfaqe prej 247.00 km2 (24,700 hektarë). Rreth 30.10% e territorit të komunës është tokë bujqësore.

Edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë së Komunës së Shtërpcës, vërehet një rënie e interesimit për t'u angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël i prodhuesve janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Përkundër potencialit, sektori i bujqësisë përballet me sfida dhe pengesa zhvillimore, një pjesë e të cilave janë potencuar në vazhdim. Barrierat mund të grupohen në produktivitetin e ulët, çmimet e ulëta dhe kosto të larta. Trendi i humbjes së tokës bujqësore, madhësia e kufizuar e parcelave të tokës se punueshme, papunësia e lartë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, si dhe mungesa e shkathtësive profesionale në shfrytëzimin e makinerisë dhe teknologjisë bujqësore paraqet një pengesë kryesore në zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, edhe blegtoria ballafaqohet me kufizime zhvillimore për t'u përballur me kushtet dhe konkurrencën e tregut, për shkak të ekzistimit të fermave të vogla. Me madhësinë e fermës ndërlidhet shumë edhe mundësia e shfrytëzimit të teknologjive të reja, implementimi i teknikave dhe të arriturave të reja shkencore, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos dhe në shtimin e prodhimit bujqësor.

Aspekt tejet kufizues i bujqësisë është mungesa e shkathtësive profesionale në përgatitjen dhe zbatimin e politikave dhe projekteve në sektor. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë ka hartuar strategjinë për këshillime, që koordinon ofrimin e këshillave me institucione dhe akterë në nivel vendi. Strategjia këshilluese ka synuar rritjen e numrit të fermerëve dhe palëve tjera me interes që marrin këshilla për bujqësi dhe zhvillim rural. Nevoja për këshillime dhe përkrahje teknike është e vazhdueshme.

Kjo gjendje e përgjithshme për pasojë ka produktivitetin e ulët meqë nuk ka parakushte për aplikimin e teknologjive të avancuara në sektor:

- Mungesa e sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Qasja e dobët e fermerëve në tregje;
- Mungesa e magazinimit dhe ftohjes shtynë prodhuesit vendorë të shesin prodhimet e tyre gjatë, apo menjëherë pas vjeljes me çmime të ulëta;
- Mungesa e zinxhirit industrial prodhues i produkteve blegtorale;
- Përveç inputeve të shtrenjta, shkalla e vogël e operacioneve shkakton kosto të larta prodhimi;
- Sektori i bujqësisë nuk është rentabil sa duhet në mënyrë që të financojë rritjen e ardhshme përbrenda dhe ka qasje të kufizuar në fonde të jashtme.
- Kamata të larta - kreditë komerciale dhe mikrofinanciare nuk mund të përballohen financiarisht;

- Struktura dhe infrastruktura e dobët e fermës, që si pasojë karakterizohet me humbje të tregjeve për prodhime dhe pamjaftueshmëri të resurseve financiare të ndara për përkrahjen e bujqësisë;
- Shfrytëzimi jo adekuat i tokës dhe mungesa e konsolidimit;
- Numri i kufizuar i shoqatave të prodhuesve dhe mungesa e rregulloreve;
- Cilësia e ulët e prodhimeve bujqësore;
- Të hyrave të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake;
- Niveli i ulët i edukimit të fermerëve ndërmjet moshës madhore të fermerëve dhe popullatës që jetojnë në viset rurale.

Fuqia punëtore në sektorin e bujqësisë

Fuqia punëtore në bujqësi është e rëndësishme për të vlerësuar se deri në çfarë mase bujqësia mund të absorbojë fuqinë punëtore rurale dhe shkallën deri në cilën punët jobujqësore kërkohen në viset rurale. Kjo e fundit tregon që politikat përtej bujqësisë, të cilat synojnë zhvillimin rural janë të domosdoshme. Gjatë analizës janë grumbulluar informata rreth punësimit të anëtarëve të familjeve në bujqësi, rreth përkushtimit të tyre në bujqësi, me orar të plotë apo të kohëpaskohshëm (sezonal).

Në sektorin e bujqësisë janë të angazhuar një numër i lartë i të punësuarve. Sipas ASK-së numri i të punësuarve në këtë sektor është mbi 3,275 punëtor të rregullt si dhe një numër i madh i atyre sezonal nga e cila kuptojmë se bujqësia është një sektor shumë i rëndësishëm në sigurimin e jetesës të një numri të madh të ekonomive familjare.

	Numri i të punësuarve
Shtërpcë	3,275

Tabela 105 Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (ASK)

Struktura e fermës

Struktura e përdorimit të tokës dëshmon të jetë pengesa kryesore kur bëhet fjalë për përdorimin e tokës përkundrejt politikave për zhvillim bujqësor në vend. Më pas, ekziston një sektor i polarizuar bujqësor me disa prona të mëdha dhe një sektor i madh të pronave të vogla. Struktura e shpërndarjes së madhësisë ilustrohet me rreth 60% të numrit të fermave që janë më pak se 5 ha dhe të fragmentuara.

Vetëm 9.5% e fermave janë më shumë se 20 ha. Për këtë mund të shtohet se procesi i nënndarjes në trashëgimi po vazhdon. Madhësia mesatare e një ferme për një ekonomi familjare është 2-3 ha tokë bujqësore e punueshme, zakonisht e fragmentuar në 6-8 parcela kadastrale. Madhësia mesatare e parcelës kadastrale është 0.3 ha.[31]

Bazuar në madhësinë e sipërfaqes së tokës së punueshme struktura e fermave klasifikohet në katër kategori kryesore:

- Fermat që kishin madhësi shumë të vogël, më pak se 1 ha përbëjnë 9.9% të fermave dhe kishin sipërfaqe prej 18,519 ha.
- Fermat me madhësi nga 1 deri në më pak se 5 ha kishin pjesëmarrjen prej 50.90%, dhe përfaqësojnë rreth 95,138 ha.
- Fermat me madhësi prej 5 deri në më pak se 20 ha, kishin një përfaqësim prej 29.70% që përfshijnë sipërfaqe prej 55,432ha, dhe

[31] ASK (Agjencioni i Statistikave të Kosovës)

- Fermat me madhësi prej 20 e më shumë hektarë merrnin pjesë me 9.5% që përfshinë sipërfaqen prej 17,918 ha.



Grafiku 10 Numri i ekonomive bujqësore sipas sipërfaqes së tokës së punueshme, 2018, ASK

Sa i përket numrit të ekonomive bujqësore rreth 31,648 prej tyre, që paraqesin 30.30%, prej gjithsej ekonomive bujqësore, posedojnë ferma me madhësi prej 0 deri më pak se 0.5 ha sipërfaqe të tokës së punueshme. Grupim tjetër më i madh i ekonomive bujqësore paraqitet me madhësi të fermës nga 0.5 deri më pak se 1 dhe 1 deri më pak se 2 që përfshin 44,030. Sa i përket numrit të ekonomive bujqësore rreth 31,648 prej tyre, që paraqesin 30.3%, prej gjithsej ekonomive bujqësore, posedojnë ferma me madhësi prej 0 deri më pak se 0.5 ha sipërfaqe të tokës së punueshme. Grupim tjetër më i madh i ekonomive bujqësore paraqitet me madhësi të fermës nga 0.5 deri më pak se 1 dhe 1 deri më pak se 2 që përfshin 44,030.

Prodhimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore

Drithërat – Drithërat një ndër veprimtaritë kryesore të bujqësisë në Komunën Shtërpcës. Rreth 245.63 ha të tokës së punueshme janë të mbjella me drithëra, grurë 55.71 ha (22.68%), misri me 98.52 ha (40.11%), bishtajore kokërr 45.88 ha (18.68%) dhe fasule kokërr 45.52 (18.53%).[32] Prodhimtaria në përgjithësi është e kënaqshme por nuk ka pasur rritje të dukshme të rendimentit ndër vite. Prodhimtarinë më të madhe në vitin 2019 e ka pasur misri me 5.0 t/ha, dhe pas tij gruri me 3.5 t /ha.



Grafiku 11. Trendët e kultivimit të drithërave sipas sipërfaqes së kultivuar

[32] ASK, regjistrimi i bujqësisë 2014

Edhe pse në nivel të vendit statistikat tregojnë një trend pozitiv sa i përket sipërfaqeve të kultivuara me drithëra, rendimenti mesatar për hektar mbetet ende i ulët në krahasim me shtetet e BE-së. Si faktor i rëndësishëm i shtimit të sipërfaqeve me këtë kulturë mund të jenë politikat mbështetëse përmes pagesave direkte për sipërfaqe të kultivuar me këtë kulturë (150 EUR/ha në 2019). Rendimentet e ulëta mund të jenë kryesisht për shkak të mungesës së njohurive mbi teknikat moderne të prodhimit dhe trajtimit të sëmundjeve, për shkak të shërbimeve joadekuate të këshillimit dhe trajnimit si dhe për shkak të qasjes jo të mirë në inpute me cilësisë të mirë.

Ndryshueshmëria e çmimeve të tregut, sidomos për grurin dhe misrin gjatë viteve të fundit ka bërë që këto kultura të jenë të paqëndrueshme, prandaj fermerët nuk mund të planifikojnë investime të mëdha në to për shkak të ndryshimeve të çmimeve. Përveç faktorëve të sipër cekur, madhësia e fermave që kultivojnë grurë dhe misër është dukshëm më e vogël dhe shumë e fragmentuar në krahasim me vendet e BE-së, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm në ekonominë e shkallës së efikasitetit të këtyre fermave. Prodhimit të drithërave duhet t'i jepet rëndësi më e madhe për shkak të kërkesave ekzistuese, zvogëlimit të importit (36.3 milion EUR për vitin 2016), sigurimit të ushqimit për kafshë, si dhe sigurimit të lëndës së parë për industrinë e ushqimit, etj. (MBPZHR, Green Report 2018, 2019).

Prodhimi dhe përpunimi i pemëve dhe perimeve

Prodhimi vendas i pemëve dhe perimeve është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite. Me fillimin e rimëkëmbjes ekonomike në përgjithësi edhe sektori i pemëve dhe perimeve ka filluar një rritje graduale ndër vite ku sipas të dhënave të ASK-s momentalisht në Shtërpce ekzistojnë një numër i madh i trupave të pemëve dhe perimeve.



Grafiku 12. Trendët e prodhimit të pemëve

Prodhimi i arrorëve dhe pemëve të imëta është rritur gjithashtu ndjeshëm dhe pritet të rritet ende si rezultat i mbjelljeve së fundmi, të nxitura nga skema e mbështetjes nga qeveria dhe donatorë të ndryshëm.

Shumica e prodhimeve të freskëta mblidhen nga grumbullues/shitës shumicë dhe shiten në tregjet e pemëve-perimeve dhe dyqanet tradicionale të pakicës. Krijimi i një rrjeti tregjesh shumicë ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e prodhuesve që ndodhen larg zonave kryesore urbane për të tregtuar produktet e tyre. Qarkullimi i produkteve të freskëta të vendit në zinxhirët e super-marketeve është relativisht i vogël.



Grafiku 13 Trendët e kultivimit të perimeve sipas sipërfaqes së kultivuar

Infrastruktura dhe shërbimet përkatëse të pasvjeljes (ambientet e dhomave frigoriferike, linjat e ambalazhimit/paketimit etj.), janë të kufizuara, por megjithatë ka pasur rritje të numrit të tyre si rrjedhojë e mbështetjes së ministrisë së bujqësisë dhe donator të ndryshëm. Ndërsa ambientet e kufizuara të dhomave frigoriferike dhe humbjet e mëdha të produkteve si rrjedhojë e mungesës së tyre kanë qenë për vite me radhë shkaku kryesor i deficitit të lartë në tregtinë e produkteve pemëtarë dhe perimtarie, kapacitetet e ruajtjes në dhoma frigoriferike janë rritur në vitet e fundit. Skemat e subvencionit të qeverisë dhe forcimi i konsoliduesve, një kategori tregtarësh më afër fermerëve (e përfshirë si në shitjen e inputeve bujqësore fermerëve, ashtu edhe në grumbullimin e produkteve nga fermerët), po kontribuon ngadalë në përmirësimin e situatës. Aktualisht, grumbulluesit janë akterët më aktivë në zinxhirin e vlerës.

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve përbëhet nga disa ndërmarrje formale dhe disa punishte informale gjysmë industriale që ofrojnë një gamë të gjerë frutash dhe perimesh të përpunuara.

Sektori ka një fokus të qartë të plotësimit të kërkesës së brendshme dhe të zëvendësimit të importeve. Megjithatë, nisur nga mundësitë që ekzistojnë, prioritet duhet të marrë gjithashtu promovimi i eksporteve.

Sektori i pemëve dhe perimeve karakterizohet nga kushte të përshtatshme klimatike që mundësojnë prodhimin e hershëm të disa lloje frutash dhe perimesh, të cilat përbëjnë gjithashtu një **potencial** të rëndësishëm për sa i përket mundësive të eksportit. Ky është sot një realitet i prekshëm i provuar me eksporte në rritje te pemëve dhe perimeve.

Prodhimi i pemëve dhe perimeve përballet ende me **sfida** të ndryshme, përfshirë informalitetin e sektorit të materialit mbjellës, kostot e larta të inputeve të blera dhe lëndës djegëse (që prekin veçanërisht serrat me ngrohje), produktivitetin e ulët dhe humbjet e mëdha të pasvjeljes, sidomos në rastin e pemëve. Standardet e sigurisë ushqimore të pemëve dhe perimeve janë gjithashtu një sfidë për t'u adresuar që të rriten eksportet drejt tregjeve të shteteve anëtare të BE-së.

Prodhimit dhe përpunimit të mishit

Prodhimtaria e mishit të gjedhit tradicionalisht është konsideruar si nënprodukt i sektorit të qumështit. Të gjithë viçat vijnë nga fermat prodhuese të qumështit, d.m.th. nuk ekziston një zinxhir i mirëfilltë i furnizimit me mish, i kompletuar dhe i specializuar. Fermat për majmëri janë kryesisht objekte të konvertuara nga objektet për prodhimin e qumështit ose objekte të ndërtuara nga vetë fermerët e vegjël. Për të shtuar profesionalizmin në mbarështimin e gjedheve për mish, është e nevojshme që të përmirësohen njohuritë teknike të prodhuesve, sidomos të fillestarëve, rreth praktikave të mbarështimit të gjedheve dhe kafshëve tjera për mish dhe prodhimit të ushqimit për kafshë, duke i përshtatur trajnimet dhe shërbimin këshillues. Mbarështuesit e gjedheve dhe kafshëve tjera për mish gjithashtu kanë më shumë nevojë për investime në stalla dhe objekte ndërtimore. Investimet në makineri të fermës për prodhim të ushqimit për kafshë dhe investimet në menaxhimin e mbetjeve dhe plehut gjithashtu kanë prioritet të lartë. Ka nevojë për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe objekteve të fermave për mbarështim të kafshëve për mish në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedis.

Megjithatë, zhvillimi i sektorit të mishit ka disa **sfida,** përmasa e vogël e fermës rezulton në efiçencë të ulët, kostot e foragjereve janë të larta dhe mbeten një pengesë kryesore për njësitë e mbarështimit dhe majmërisë, ndërkohë që prodhuesit shpesh nuk kanë njohuritë praktike për ushqimin optimal të kafshëve për trashje, çmimi i lartë i blerjes së ushqimeve të blegtorisë ka një ndikim të rëndësishëm në çmimin e lartë të mishit, mospërdorimi i mjaftueshëm i racave cilësore për prodhimin e mishit në një pjesë të fermave, mungesa e fermave të gjedhit të specializuara për prodhimin e mishit dhe kushtet e shëndetit të kafshëve përbëjnë kufizime të rëndësishme për zhvillimin e sektorit, siguria e produkteve të freskëta që shiten në dyqane pakice nuk është gjithmonë e garantuar për shkak të moszbatimit të plotë të ligjit dhe mangësive në infrastrukturë, duke përfshirë mungesën e thertoreve që përmbushin standardet minimale kombëtare. Me gjithë përmirësimet e kohëve të fundit, thertoret kanë ende mangësi në infrastrukturë, çka mbetet një sfidë për integrim të mëtejshëm në zinxhirin e vlerës së prodhimit vendas. Thertoret nevojitet të përmirësohen dhe të plotësojnë standardet e sigurisë ushqimore, mungesë e koordinimit të mirëfilltë i zinxhirit prodhues përpunues numër i vogël i ndërmarrjeve përpunuese të mishit të cilat përdorin teknologji të avancuar të përpunimit të mishit.

Sektori i qumështit

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral. Vitet e fundit janë themeluar disa ndërmarrje tregtare të cilat veprojnë në grumbullimin dhe përpunimin e qumështit, të cilat kanë gjetur shtrirje të mirë të produkteve të tyre në nivel lokal por edhe me gjerë. Këto ndërmarrje në bashkëpunim me fermerët janë duke bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për konsum familjar në prodhim për treg, që të përmirësohen kushtet e mbarështimit, të zbatohen praktikat e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit dhe të rritet kapaciteti i bujqve për prodhimin e qumështit me cilësi të lartë.

Prodhimi i qumështit nga ripërtypësit e vegjël (dele, dhi) është kryesisht një cikël i mbyllur, nga prodhimi i qumështit, te përpunimi i djathit dhe shitja (marketingu) në fermë. Vetëm disa ferma janë komerciale, ndërsa shumica e prodhuesve që mbajnë ripërtypës të vegjël janë ferma të vogla me praktika kryesisht tradicionale të mbarështimit të kafshëve. Ka nevojë të madhe për investime në modernizimin e stallave, objekteve përcjellëse infrastrukturore, për përdorimin e sistemeve të mjeljes, etj.

Shumica e qumështit prodhohet nga prodhues shumë të vegjël gjysmë të specializuar që kanë më pak se 50 dele apo dhi dhe ferma gjedhi me më pak se 10 lopë qumështore. Shumica e fermave të gjedhëve kanë 3-9 krerë gjedhë dhe rreth 48% e tyre. Sidoqoftë, vihet re një prirje drejt konsolidimit: numri i fermave me më shumë se 5 lopë është trefishuar në krahasim me vitin paraprake, ndërkohë që numri i fermave me mbi 10 gjedhë është 38%.[33]



Grafiku 14 Madhësia e fermës sipas numrit të krerëve në Shtërpcë

Industria e përpunimit të qumështit kohët e fundit është përmirësuar dhe pasuruar me disa fabrika moderne, por megjithatë një pjesë e saj mbetet akoma e fragmentuar, përkundër disave të cilat kanë filluar të përdorin teknologji të avancuar në përpunim të qumështit.

Këto kompani po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë importin dhe po fitojnë tregun vendas. Veçori tjetër e tyre janë kapacitet optimale të prodhimit dhe shumëllojshmëria e artikujve.

Aktorët e zinxhirit të vlerës (veçanërisht fermat dhe përpunuesit e vegjël) duhet të bëjnë më shumë për të arritur standardet mjedisore dhe ato të sigurisë ushqimore. Mbledhja dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Mbledhja e qumështit të papërpunuar kryhet më së shumti direkt nga përpunues qumështi dhe nga grumbullues qumështi privatë të pavarur. Shpesh qumështi nuk ruhet në tank ftohës në fermë dhe as gjatë transportit për në fabrikën e përpunimit.

Fabrikat e përpunimit të qumështit kanë investuar për teknologji moderne dhe kanë përmirësuar ndërtesat dhe ambientet për të shmangur ndotjen. Për sa i përket kërkesës, produktet e qumështit janë pjesë e rëndësishme e shportës ushqimore për konsumatorët dhe ka një preferencë të përgjithshme për produktet e qumështit të vendit.

Sektori përballet me sfida të ndryshme. Në bazë të analizave, sfidat kryesore në kuadër të sektorit të industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore është decentralizimi i ndërmarrjeve përpunuese zgjidhja më e mirë në aspektin e funksionimit të këtyre veprimtarive është centralizimi përmes krijimit të politikave dhe strategjive zhvillimore duke krijuar hapësira dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive, standardet e sigurisë ushqimore dhe të mjedisit duhet që të përmirësohen dhe të respektohen. Cilësia e qumështit të papërpunuar dhe gjendja mikrobiologjike është problematike, ndërkohë që kushtet e transportit janë të papërshtatshme, shpesh pa përdorur tanke ftohës. Në shumicën e rasteve nuk ka trajtim të ujërave të përdorura dhe të mbetjeve të përpunimit të qumështit (p.sh. laktozës). Mungesa e specialistëve të kualifikuar (teknologjia e përpunimit të qumështit, laboratori etj.) në zonat rurale është një nga faktorët që ka penguar dhe do të vazhdojë të pengojë, përveç zbatimit të dobët të ligjit, zbatimin e standardeve të sigurisë dhe të mjedisit.

Të gjeturat kyçe në kuadër të fushës së bujqësisë janë radhitur në vazhdim:

- Humbja e tokës bujqësore e kualitetit të lartë;
- Fragmentim i ekonomive bujqësore;

[33] ASK (Agjencioni i statistikave të Kosovës)

- Vërshime të shpeshta të tokave bujqësore dhe humbje të mëdha të produkteve bujqësore nga ky faktor;
- Sipërfaqe të vogla të kultivuara me pemë;
- Sipërfaqe të vogla të kultivuara me perime (fushë të hapur dhe serra);
- Numër i vogël i pikave për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- Fond i vogël blegtoral përkundër potencialeve që posedon Komuna e Shtërpcës
- Numër i vogël i qumështoreve dhe përpunuesve të qumështit dhe mishit;
- Sipërfaqe të vogla të kultivuara me vreshta përkundër potencialit dhe traditës së fermerëve të kësaj ane;
- Jo funksionim i duhur i sektorit të shpeztarisë;
- Potenciale të mira për zhvillim të bletarisë.

SWOT Analiza

Përparësitë	**Dobësitë**
▪ Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike të favorshme për zhvillimin të agrobiznesit; ▪ Resurset natyrore: rreth 30.10% tokë bujqësore, mbi 67.50% tokë pyjore, dhe resurse ujore të bollshme; ▪ Ndërmarrje për grumbullim të produkteve bujqësorë. ▪ Potenciale të mjaftueshme njerëzore me përgatitje profesionale dhe me moshë të re; ▪ Kapacitetet të konsiderueshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale; ▪ Traditë në prodhimin e pemëve konkretisht atyre të imëta; ▪ Kapacitetet e prodhimit të fidanëve të pemëve, analizimi dhe kontrolli i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale; ▪ Potencial për zhvillim të agroturizmit; ▪ Qasja në rrugë nacionale dhe regjionale;	▪ Humbje e tokë bujqësore çdo vit; ▪ Ndotje e tokave bujqësore; ▪ Mungesa e organizimit të fermerëve (kooperativa bujqësore); ▪ Prodhimtaria e ulët dhe cilësia jo e kënaqshme e produkteve bujqësore; ▪ Edukimi i pamjaftueshëm i fermerëve në përputhje me trendët dhe mënyrat e reja të prodhimit; ▪ Aplikimi i teknologjisë së vjetruar në prodhimin e produkteve bujqësore; ▪ Pamjaftueshmëria e përkrahjes teknike për fermerë; ▪ Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore - fragmentimi i tokave bujqësore; ▪ Mungesë e sistemeve të ujitjes dhe drenazhimit; ▪ Mungesa e qasjes në tregje – mos funksionimi i pikave grumbulluese në tërë territorin e komunës; ▪ Pamjaftueshmëria e shërbimeve këshillimore profesionale; ▪ Mungesë e politikave dhe përkrahjes në zhvillimin e agroturizmit; ▪ Mungesa e kompetencave në menaxhim të resurseve pyjore;
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ Mundësi të shumta për prodhime finale; ▪ Futja e teknologjive të reja; ▪ Hapja e tregjeve të reja; ▪ Konsolidimi i tokës bujqësore; ▪ Mundësi qasje në programe e projekte për përfitim nga fondet dhe skemat mbështetëse të qeverise dhe donatorëve; ▪ Mundësi e plasimit të mallrave në tregun e jashtëm; ▪ Organizimi i fermerëve (bashkërendimi, koordinimi); ▪ Bashkëpunimi me nivelin qendror në ripyllëzim; ▪ Mbrojtja e ekosistemit dhe biodiversitetit;	▪ Ndotja e tokës dhe resurseve të ujit; ▪ Braktisja e fshatrave, interesimi i ulët i rinisë për veprimtari bujqësore; ▪ Mungesa e kredive të favorshme afatgjata; ▪ Fuqia blerëse e popullsisë është e ulët; ▪ Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore; ▪ Qasja e kufizuar në mjete financiare për investime në agrobiznes; ▪ Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në bujqësi; ▪ Konkurrenca e tregut nga importi; ▪ Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

Tabela 106 SWOT analiza e sektorit të bujqësisë

3.3.8. Pylltaria

Pylltaria është degë me rëndësi në Komunën e Shtërpcës, kjo për faktin se ajo zë një sipërfaqe të madhe të komunës. Në aspektin ekonomik kjo fushë sjellë shumë përfitime, veçanërisht përmes sektorit të turizmit por edhe duke u shfrytëzuar resurset e saj nga industritë prodhuese dhe përpunuese.

Për Komunën e Shtërpcës pyjet paraqesin një resurs të rëndësishëm, por për shkak të prerjes ilegale të tyre nga ana e banorëve rrezikohet degradimi i tyre, nëse nuk ndërhyhet me një menaxhim të kujdesshëm nga organet kompetente.

Gjetjet:

- Ekzistenca gjithnjë e më pak e popullsisë bujqësore
- Ndikimi i kafshëve në kullota (sidomos dele) ndikon në zgjerimin natyror të pyjeve
- Mbrojtja e zonave dhe e specieve të mbrojtura
- Shtimi dhe mbrojtja e biodiversitetit, me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit
- Humbja e vlerave ekologjike të pyjeve dhe sipërfaqeve të tyre si dhe degradimi ekologjik
- Menaxhimi joadekuat ekonomik i zonave në menaxhim të pyjeve (Koritnik (Dragash), Kaçanik (Sharr) dhe Shtërpcë).
- Prerje e përhapur ilegale e prerjes së druve për dru zjarri, posaçërisht rreth fshatrave, kundër prerësve ilegalë të drunjëve gjatë 10 viteve të fundit. Drejtoria e PK ka raportuar se ky problem është më në kontroll tani se që ishte më parë

Nevojat zhvillimore:

- Bërja e përpjekjeve për t'i rikthyer pyjet në situatën e dëshiruar, veçanërisht trajtimit të silvikulturës
- Rregullimi i strukturave pyjore me qëllim të shtimit të llojllojshmërisë së kafshëve, zogjve dhe bimëve
- Shtimi i masave të organeve kompetente komunale për parandalimin ilegal të pyjeve

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
▪ Resurset ekzistuese pyjore; ▪ Ekzistimi i administrimit të pyjeve dhe parkut nacional; ▪ Pasuri me lloje endemike të florës dhe faunës	▪ Organizimi joadekuat në pylltari; ▪ Mungesa e investimeve; ▪ Bashkëpunimi joadekuat i sektorit privat dhe publik; ▪ Bashkëpunim i pamjaftueshëm dhe koordinimi me institucione shtetërore
MUNDËSITË	**RREZIQET**
▪ Menaxhimi i resurseve natyrore dhe shfrytëzimi adekuat i pyjeve; ▪ Mundësitë e shfrytëzimit të mjeteve investuese; ▪ Zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit	▪ Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve; ▪ Degradimi i sipërfaqeve pyjore; ▪ Vizion jo i qartë për zhvillimin e ardhshëm të pyjeve; ▪ Fatkeqësitë natyrore

Tabela 107 SWOT analiza e sektorit të pylltarisë

3.3.9. Industria

Industria në Komunën e Shtërpcës nuk është shumë e zhvilluar. Numri ndërmarrjeve prodhuese është shumë i vogël. Industrinë në bazë të sektorëve në komunë ndahet në publike dhe private. Në komunë ekzistojnë edhe 3 ndërmarrje sociale të cilat merren me prodhimin e tekstilit, lëngje mjedrash dhe xhem dhe produkte tjera ushqimore. Në tremujorin e parë të vitit 2021 janë regjistruar edhe tri ndërmarrje të reja prodhuese por për të cilat nuk ka të dhëna se cilës industri i përkasin.

Si industri premtuese që me përkrahje të komunës mund të lulëzojnë janë industria e prodhimit të bukës dhe ëmbëlsirave, shtimi fabrikave të përpunimit të frutave të malit, etj. Nëse komuna i ulë kriteret për subvencionim, atëherë edhe këto ndërmarrje të vogla do të përfitonin asistencë ekonomike si dhe do të krijoheshin edhe ndërmarrje të tjera.

Komuna e Shtërpcës, me një histori të gjatë, ka një trashëgimi në fushën industriale, e cila mund të shfrytëzohet si një aset zhvillimor. Në komunë, historia e gjatë industriale ka krijuar një mjedis të veçantë kulturor të përbërë nga asete të caktuara jo materiale, siç janë aftësitë, tradita, monumentet dhe artefaktet.

Brenda procesit të zhvillimit të integruar urban, në komunë mund të zbatohen masa të caktuara të politikave urbane, pasi që ato lidhen me zhvillimin lokal. Këto masa përfshijnë iniciativat për rritjen e llojllojshmërisë së punëve, siç mund të jenë: promovimi i ndërmarrësisë, punësimi lokal dhe i komunitetit. Gjithashtu është e domosdoshme krijimi i politikave industriale që shpiejnë në inovacion, digjitalizim dhe dekarbonizim, dhe që e bëjnë industrinë e fuqishme dhe konkurruese.

Ashtu siç rekomandon edhe politika industriale e Bashkimit Evropian për industrinë prodhuese në Evropë, ashtu edhe zhvillimi industrial i komunës duhet të investojë në fushën e inovacionit industrial, duke e përfshirë njëkohësisht

teknologjinë me emetim të ulët të karbonit për t'u përballur me sfidat e ndryshimeve klimatike, zhvillimin e projekteve të përbashkëta evropiane dhe ri fuqizimin e industrisë përmes politikave komerciale evropiane. Zhvillimi industrial gjithashtu ka nevojë të bazohet në teknologji të re, në aktivitete të bazuara një njohuri dhe aktivitete të lidhura me shërbime, së bashku me promovimin e profesioneve të reja dhe plotësimin e nevojave të konsumatorëve.

Zhvillimi i suksesshëm i bizneseve të vogla kërkon tejkalimin e shumë pengesave aktuale në komunë. Pengesat specifike që janë më kritike janë:

- Mungesa e mbështetjes institucionale
- Mungesa e burimeve financiare
- Ndërprerja e zinxhirit furnizues ndërmjet procesit të prodhimit dhe fuqisë punëtore
- Prezencë e madhe e produkteve të importuara

Nevojat zhvillimore:

- Asistencë teknike dhe trajnim që rrisin aftësitë menaxheriale të menaxherëve dhe fuqisë punëtore
- Programet që krijojnë qasje në tregje me fokus në zhvillimin e lidhjeve ndërmjet bizneseve të vogla dhe tregjeve kryesore
- Krijimi i lidhjeve me rrjete të ndryshme sociale
- Mundësitë afatgjata të financimit nga burime të ndryshme financiare, si komuna, banka, dhe fonde të tjera zhvillimore

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
▪ Objektet ekzistuese industriale; ▪ Resurset njerëzore; ▪ Infrastruktura ekzistuese dhe qasja në objektet industriale.	▪ Teknologjia e vjetruar; ▪ Kuadri profesional jo adekuat; ▪ Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i kapaciteteve të industrisë; ▪ Ngecja e privatizimit.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
▪ Zhvillimi i bizneseve të vogla dhe të mesme me ideja të reja biznesi; ▪ Tërheqja e investimeve; ▪ Zhvillimi i industrisë drunore	▪ Rregulloret ligjore të papërshtatshme; ▪ Qasje e pamjaftueshme në mjetet investuese.

Tabela 108 SWOT analiza e sektorit të industrisë

3.3.10. Zejtaria

Zejtaria në Kosovë zë fill qysh nga periudha Ilire e deri në ditët e sotme si element kryesor në zhvillimet ekonomiko-shoqërore dhe kulturore në vend. E gjithë kjo ilustrohet edhe me gjetjet antike të eksponateve të ndryshme të cilat janë të prezantuara në muzetë etnografikë nëpër secilin qytet në tërë vendin. Gjatë zhvillimit të periudhave të ndryshme kohore edhe zejtaria ka filluar të evoluojë dhe të bëhet një sektor i cili ndikon në zhvillimin ekonomik e këtë më së miri e tregon fakti i zhvillimit të shtigjeve të karavaneve tregtare që bënin tregti nga Venediku – Raguza (Dubrovniku i sotëm) – Shkodra – Peja – Gjakova, për të vazhduar në pjesët tjera të Evropës. Kulminacionin e zhvillimit në Kosovë zejtaria e arriti sidomos në shekujt XV dhe XIX ku nëpër disa qytete në Kosovë u zhvilluan "Çarshitë", si zona të veçanta tregtare me dyqane, në të cilat edhe zhvilloheshin artizanatet ku ofronin shërbimet dhe shiteshin produktet.

Sipas regjistrimit kadastral të vitit 1582 në pjesën perëndimore të vendit ushtroheshin mbi 56 zeje të ndryshme e që përfshinte rreth 43% të popullatës të angazhuar në këto zeje. Prodhimi me vlerë artistike në këtë kohë kanë dhënë veçanërisht: argjendarët, saraqët, terzinjtë, qeleshepunuesit etj. Duke e parë këtë zhvillim u krijuan edhe grupet e zejtarëve (esnafët) të cilat merreshin me organizimin dhe rregullimin e zejtarisë si sektor i veçantë në ekonomi si dhe promovimin e punës artistike të mjeshtërve të artizanateve. Sipas shënimeve të vitit 1986, në Kosovë kanë qenë aktive 113 veprimtari zejtare. Më tepër se gjysma e zejtarisë së pavarur të ushtruar në Kosovë është përqendruar kryesisht në 15 zeje ku mungojnë veprimtaritë zejtare prodhuese bashkëkohore. Pra, zejtaria si sektor ekonomik paraqet një segment të veçantë të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Kryesisht zejtaria është përcjell në brezat familjar. Me zhvillimin e kohës, zhvillimet sociale, zhvillimet në industri dhe tregti ndikuan që shumë nga këto zeje të pësojnë dhe të shuhen duke mos pasur më përfitime si dhe gjetja e tregut

ishte shumë e vështirë. Tani kemi vetëm disa nga zejet të cilat plotësojnë nevojat e popullatës të cilët edhe pse me vështirësi, po mundohen të mbijetojnë dhe të ofrojnë produktet dhe shërbimet e tyre profesionale.

Në fushën e zejtarisë në komunën e Shtërpcës kërkohet krijimi i kushteve të duhura për krijimin e vendeve të punës dhe dhënia e kontributit në rritjen e mirëqenies sociale. Pra, është i nevojshëm përpilimi i programeve për shkollim dhe kualifikim profesional si dhe i kushteve për zbatim praktik të mësimit.

Synim të jetë edhe bashkëpunimi me organizata të tjera ndër komunale për të arritur qëllimin në përfaqësimin e interesave të biznesit përmes rrjetëzimit në këshillim, ofrimin e shërbimeve, organizimi i punëtorive, në mënyrë që bizneset të informohen për mundësitë B2B dhe të krijojnë bashkëpunime me përfitime të ndryshme.

3.3.11. Resurset nëntokësore dhe sipërfaqësore

Formacionet mesozoike, kretanet dhe dolomitët në zonën e Shtërpcës shfaqen në lindje të majës së Lubotenit. Në afërsi të Brezovicës janë akumuluar materiale morene nga proceset glaciale, që përbëhen nga shkëmbinjtë magmatik, shkëmbinjtë metamorfik, gurët rërorë, kuarcitet dhe gurët gëlqerorë. Rajoni i Shtërpcës është shumë i njohur për burimet e tij minerare. Në disa lokacione në të kaluarën ka pasur eksploatim intensiv të plumbit, zinkut, arit, bakrit, kromit dhe hekurit.

Në territorin e komunës nuk ka minerale metalike përveç kromit, i cili si lëndë e parë është shfrytëzuar për prodhimin e kromit deri në vitin 1953. Por, mbetet çështje e hapur a duhet që në këtë territor të bëhet eksploatimi i xeheve dhe me çfarë sistemi, duke ditur që lindin konfliktet në aspektin e zhvillimit të aktiviteteve tjera ekonomike, që kanë vlera më të theksuara konkurruese. Kjo para së gjithash i referohet aktiviteteve të turizmit, e cila ndër të tjera kërkon mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit.

Në këtë drejtim, xehetaria ka disa dukuri dhe procese përcjellëse që në thelb kontribuojnë në dëmtimin e mjedisit, e që ai të mbrohet është e nevojshme të investohen fondet shtesë që për nga aspekti ekonomik e bëjnë eksploatimin më të shtrenjtë. Por, edhe më tepër eksploatimi nuk mund të mënjanohet në përgjithësi për disa minerale, e sidomos për jo metalet.

Sa i përket pasurive minerare natyrore, të cilat gjenden në territorin e komunës, këto janë shfrytëzuar që nga koha e mesjetës. Ndër pasuritë minerare të cilat gjenden, vlen të përmendet shfrytëzimi i kaliumit, magnezitit si dhe të burimeve të ujit mineral dhe të atij termal.

3.3.12. Energjia

Rrjeti energjetik luan rol thelbësor në zhvillimin e qytetit, sidomos në kohët e sotme të teknologjisë dhe inovacionit. Në Komunën e Shtërpcës ky rrjet akoma vazhdon të mos jetë në gjendjen e duhur, gjë që paraqet nevojë urgjente të përmirësimit të tij në mënyrë që komuna të arrijë zhvillim dhe rritje më të shpejtë ekonomike. Numri i konsumatorëve privat është shumëfish më i madh se i atyre publik. Nga të dhënat më të fundit në dispozicion, në tabelën e mëposhtme paraqitet konsumi mujor i energjisë elektrike në Komunën e Shtërpcës në vitet 2018-2020.

Muaji/Viti	2018	2019	2020
Janar	2735.0883	2483.0127	2773.6044
Shkurt	2198.6186	2061.8829	2141.2409
Mars	2260.5093	2118.5346	2057.3406
Prill	1955.4980	1800.9621	1870.3639
Maj	1771.9033	1866.7477	1781.5581
Qershor	1451.9789	1682.0034	1614.9682
Korrik	1451.9789	1729.1810	1682.1504
Gusht	612.9649	1719.4506	1675.5522
Shtator	1669.0821	1725.0492	1660.1088
Tetor	1881.2593	1916.7005	1871.1525
Nëntor	2028.3994	1988.0448	2016.2268
Dhjetor	2366.8512	2459.3289	2361.6411
Total MW/h	**23.1401**	**23.5509**	**23.5059**

Tabela 109 Konsumi mujor sipas viteve në Komunën e Shtërpcës

Konsumi i përmendur pothuajse tërësisht i referohet amvisërive dhe qendrës së skijimit në Brezovicë gjatë muajve të dimrit.

Për shkak të pozitës gjeografike dhe territorit që ka komuna, ajo ka potenciale edhe për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme përmes resurseve të ndryshme natyrore.

Energjia e ripërtëritshme

Hidroenergjia - Komuna e Shtërpcës vlerësohet se ka potencial hidroenergjetik në 20 MW. Kushtet natyrore për shfrytëzimin e burimeve ujore të lumit Lepenc ekzistojnë po ashtu edhe nga degët dhe pellgjet e tij. Rrjeti hidrografik i Parkut Kombëtar karakterizohet nga pasuri të shumta hidrologjike si burime, dalje nëntokësore dhe pellgje malore, liqene akullnajore dhe lumenj që i përkasin pellgjeve të lumenjve Lepenc dhe Bistricës së Prizrenit**.**

Në Komunën e Shtërpcës, bazuar ne listën e burimeve te listuara nga zyra e rregullatorit te energjise ZrrE janë te listuara dy hidrocentrale qe janë investuar nga kompania Matkos Grup dhe atë

- MATKOS me fuqi 2.1 MW ne operim nga viti 2017 sipas autorizimit AEU_03/13

Në fshatin Biti e Poshtme është duke u ndërtuar hidrocentrali H3 Viça. Kapaciteti i tij i instaluar është 5.4 MW. Megjithatë, ndërtimi i këtij hidrocentrali vlerësohet se do të krijojë disa implikime në rendimentin bujqësor. Në këtë territor janë rreth 200 hektarë të cilët punohen në mënyrë të vazhdueshme, nga të cilat rreth 100 janë të mbjella me mjedër dhe pjesa tjetër ishin të mbjella me misër dhe grurë, dhe me krijimin e këtij hidrocentrali këto toka bujqësore do të jetë e vështirë të ujiten. Gjatë vitit 2019, rendimenti nga mjedrat ishte rreth 500 ton, të shitura me një çmim mesatar prej 1.3€ për kilogram. Arkëtimet nga këto shitje përllogariten rreth 650,000.00€ bruto, e që është e një rëndësie të veçantë për këtë fshat malor.

Energjia solare - Komuna Shtërpcës ka ndër mundësitë më të mira për krijimin e energjisë solare. Në komunë kohëzgjatja mesatare vjetore me diell është me mbi 1938 orë.

Energjia e erës – Komuna ka kushte edhe për prodhimin e energjisë së erës. Shpejtësia mesatare mujore e erës në Komunës e Shtërpcës është midis 4.4 m/s në zonat më të ulëta, deri në 7.8 m/s në zonat më të larta.

Energjia e biomasës - Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve të Shtërpcës është rreth 10.500 ha, me një rritje vjetore prej rreth 32.000 m3, ndërsa sipërfaqja e tokës bujqësore është rreth 13.600 ha që mund të jetë një burim i rëndësishëm i biomasës. Sipas vlerësimit të ekspertëve, sasitë e treguara janë të mjaftueshme për 11.200 t copëza druri, që mjafton për zhvillimin e një impianti 1 MW.

Sfidat e Komunës së Shtërpcës në fushën e energjisë:

- Rrjeti energjetik i dobët
- Ndërprerjet e shpeshta
- Mungesë e linjave unazore për furnizimit me energji elektrike
- Terreni i papërshtatshëm i mirëmbajtjes së instalimit elektrik

Nevojat për përmirësimin dhe zhvillimin e situatës energjetike:

- Ndërtimi/Shndërrimi i NS 35/10 kV Shtërpca ne NS 110/10(20) kV.
- .Shtimi i linjave të furnizimit me energji
- Rregullimi i terrenit për mirëmbajtje të instalimeve
- Subvencionimi i prodhimit të energjisë së ripërtëritshme
- Krijimi i partneriteteve Publiko-Private për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme
- Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për ruajtjen e energjisë së prodhuar

Energjia e ripërtëritshme - Komuna e Shtërpcës mund të stimulojë prodhimin e energjisë së ripërtëritshme përmes subvencionimeve të pajisjeve fotovoltaike dhe pajisjeve tjera si dhe të krijojë pika të ruajtjes së energjisë së prodhuar. Për efiçiencë të energjisë stimulimi mund të bëhet në ndërtimin e shtëpive të reja dhe renovimin e shtëpive të vjetra.

Duke qenë vend transiti mes Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe vend turistik që posedon qendrën e Skijimit Brezovizën, komuna duhet të investojë edhe në e-mobilitet, duke subvencionuar përdorimin e makinave elektrike, si në blerje ashtu edhe në dhënie me qira.

3.3.13. Infrastruktura rrugore

Komuna e Shtërpcës ka infrastrukturë rrugore në gjendje të mirë. Rruga rajonale Prizren – Doganaj që kalon përmes Komunës ka dhe mund të këtë rol të rëndësishëm edhe në të ardhmen në zhvillimin e saj ekonomik përmes aspektit komercial si dhe atë të turizmit. Komuna nuk ka qasje direkte në transportin e rrjetit hekurudhor.

Gjendja e mirë e rrugëve mund të ndikojë pozitivisht në ngritjen e nivelit të ndërmarrësisë. Mund të rris po ashtu krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve. Infrastruktura e mirë rrugore që ekziston në zonën urbane dhe rurale, me një investim të vogël në përmirësimin e saj mund të përmirësojë edhe më tutje investimet në sektorin e biznesit, në tregje dhe shërbime, dhe gjithashtu të ndikojë pozitivisht në nivelet e të ardhurave për shkak të kostove më të ulëta të transportit.

DRAFT

3.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në territorin e komunës së Shtërpcës, infrastruktura teknike e rrjedhimisht edhe shërbimet publike që lidhen me të nuk është në nivelin më të mirë të mundshëm por viteve të fundit është duke u investuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore. Kjo çështje është problem sidomos sa i përket nivelit të zhvillimit të infrastrukturës ujore dhe për këtë arsye ka nevojë për përpjekje më të mëdha të shoqërisë që ky problem të zgjidhet apo të zbutet. Problem është po ashtu edhe me infrastrukturën e ujërave të zeza të cilat nuk menaxhohen në mënyrën më të mirë gjithashtu furnizimi jo i mirë me energji elektrike ku rrjeti elektrik në disa pjesë është shumë i amortizuar, tensioni i dobët dhe ka reduktime të furnizimit. Nuk është në gjendje të mirë as rrjeti rrugor në këtë komunë.

3.4.1. Infrastruktura e ujësjellësi

3.4.1.1. Rrjeti i ujësjellësit, mbulueshmëria

Aspekti i furnizimit me ujë i qytetarëve të Komunës së Shtërpcës është relativisht i mirë. Pjesa më e madhe e vendbanimeve apo 75% është e mbuluar me rrjet, 18.75% është e mbuluar pjesërisht, ndërsa 6.25% nuk kanë furnizim me ujë të pijes.



Grafiku 15. Shkalla e furnizimit me ujë të pijes

Komuna e Shtërpcës furnizimin dhe menaxhimin e sistemit të ujësjellësit e realizon me kapacitete vetanake, pra, ky sistem nuk përfshihet në ndonjë nga kompanitë e menaxhimit të ujit të pijes (KRU).

KRU Prishtina	**KRU** Hidroregjioni Jugor	**KRU** Hidrodrini	**KRU** Mitrovica	**KRU** Gjakova	**KRU** Bifurkacioni	**KRU** Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga **KRU**-të
Prishtina Podujeva Fushë Kosova Obiliçi Lipjani Drenasi Shtime Graçanica	Prizreni Suhareka Malisheva Dragashi Mamusha	Peja Istogu Klina Juniku Deçani	Mitrovica Skenderaj Vushtrria	Gjakova Rahoveci Prizren (disa fshatra)	Ferizaj Kaçaniku	Gjilani Kamenica Vitia	Novobërda Zubin Potoku Leposaviçi Zveçani Shtërpce, Hani i Elezit, Partesh, Rani Ilug, Mitrovica e Veriut, Kllokot

3.4.1.2. Cilësia dhe furnizimi me ujë

Përkundër resurseve të saj të kufizuara, qendra e ujit e IKSHPK-së aktualisht e përmbush rolin e saj parësor të pavarur për monitorimin e përputhshmërisë së cilësisë së ujit të pijshëm nga kompanitë publike rajonale të ujësjellësit në

Kosovë në pajtim me standardet e mëhershme të BE-së dhe OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm me qëllimin parësor të mbrojtjes së shëndetit publik.

Këto tema të propozuara si më kryesoret nuk do të shikohen si përfundimtare, por ato do vazhdojmë t'i zhvillojmë deri në arritjen e qëllimit.

Sipas Raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë së Kosovës për vitin 2017, rezulton se gjatë analizave të bëra, uji është i standardit të lartë dhe i plotëson kriteret 100% me cilësi të mirë.

Bazuar në rezultatet e monitorimit të kryer nga Qendra e Ujit e Instituti Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK) konform përgjegjësive që ka kjo Qendër për monitorim të jashtëm sipas UA Nr. 16/2012, cilësia e përgjithshme e ujit të pijshëm në Kosovë që u ofrohet konsumatorëve ne 44 zona te furnizimit (ZFU), është 99.20% në përputhshmëri me vlerat parametrike mikrobiologjike, ndërkaq 98.00% në përputhshmëri me vlerat parametrike kimike, duke rezultuar në një nivel të përgjithshëm të përputhshmërisë prej 98.3%. Kjo shkallë e përputhshmërisë është rezultat i 50,289 testeve të kryera gjatë vitit 2016 nga gjashtë laboratorët rajonalë të Qendrave Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) dhe Qendra e Laboratorëve Testues në IKSHPK.

Parametrat	Numri i testeve të kryera	Përputhshmëria me vlerat parametrike	Tejkalimi i vlerave parametrike	
		%	Nr.	Nr. i ZFU-ve
Koliformet totale	5,525	**98.9**	61	21
E coli	5,525	**99.6**	24	9
Klori rezidual	5,485	**89.6**	569	25
Turbullira	5,518	**99.1**	50	11
Era	2,026	**100**	0	0.0
Shija	2,026	**100**	0	0.0
pH	2,027	**100**	0	0.0
Nitratet	1,740	**99.9**	2	1
Nitritet	1,779	**100**	0	0.0
Hekuri	1,855	**99.9**	2	1
Mangan	1,726	**99.9**	2	1
Alumini	1,025	**99.7**	3	2
Parametrat tjerë	14,032	**99.7**	37	15
Totali:	**50,289**	**98.5**	**750**	**35**

Tabela 110 Cilësia e ujit të pijshëm sipas parametrave bazik ne zonat e furnizimit për vitin 2016-2017

3.4.1.3. Kërkesat për ujë/ Vlerësimi i nevojave në të ardhmen

Sipas udhëzimit Administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor janë përcaktuar kërkesat për ujë për kokë banori, ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri janë radhitur sipas kategorisë:

- për vendbanime ≥ 100001 banor: ≥ 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001- 100000 banor: ≥ 250- 300 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 20001- 100000 banor: ≥ 200- 250 litra/banor;
- për vendbanime ≥ 5001- 20000 banor: ≥ 150- 200 litra/banor;
- për vendbanime < 5000 banor: ≥ 100 - 150 litra/banor.

Sipas prognozave të **skenarit realist** të demografisë deri në vitin 2030, Komuna e Shtërpcës ka një numër të banorëve prej **6,853** duke përfshirë zonën urbane dhe rurale, dhe sipas këtij numri të banorëve, dhe kalkulimeve hidraulike të shpenzimeve ditore për banor, institucionet përkatëse duhet të sigurojnë një sasi të ujit prej

Q= 57.0 l/s .

Bazuar në kapacitetet ekzistuese të burimeve të ujit, kapaciteteve të konservimit të rezervuarëve, kapacitetet e stacioneve të pompimit, numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2030 të **Skenarit realist,** përfshirë edhe banorët jo rezidentë, analizës së shpenzimeve sipas normave teknike të planifikimit për banor (norma e përdorimit **q=150 l/për banor)**. Komuna ka nevojë për rritje të kapaciteteve të konservimit të ujit prej së paku 8-10 vitet e ardhshme prej 25.0 l/s.

3.4.1.4. Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re në rrjetin e ujësjellësit

Sipas **Skenarit realist** parashihet që shkalla e mbulimit me shërbime gjatë 10 viteve të ardhshme të rritet për 25.0 l/s të mbuluar 6,853 banorë, në veçanti në zonat rurale ku nuk ka mbulueshmëri, dhe nënkupton që duhet që, përpos në burimet e reja të ujit të ketë investime, të parashihen investime edhe për zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit që nevojitet për furnizim me ujë të këtyre banorëve.

Humbjet e ujit kanë efekt negativ ekologjik, ekonomik dhe social dhe janë pjesë përbërëse e pashmangshme e çdo sistemi të ujësjellësit. Shkalla e ujit të humbur është një indikator i mirë i jo efiçiencës së sistemit dhe në korrelacion me indikatorët tjerë, siç janë efiçienca financiare dhe efiçienca operative. Reduktimi dhe kontrollimi i qëndrueshëm i UPF në një sistem të ujësjellësit është një problem kompleks i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Kjo për faktin se humbjet e ujit kanë tendencë natyrale të ngritjes nëse nuk ndërmerren masa adekuate për ndaljen/zvogëlimin e tyre: rrjedhjet nga gypat shtohen vazhdimisht, numri i ujëmatësve që nuk matin saktë rritet, të dhënat për konsumatorët vjetrohen etj.

Është e qartë se nuk mund t'i eliminojë në tërësi humbjet e ujit, megjithatë, mund dhe është e vendosur që t'i reduktojë substancialisht ato.

Rëndësia ekonomike e humbjeve të ujit dhe nevoja për një strategji të reduktimit të UPF.

Me qëllim të eliminimit të konfuzionit eventual lidhur me terminologjinë e cila përdoret kur bëhet fjalë për humbjet e ujit (përdorimi jo konsistent i termave si: humbjet teknike, humbjet fizike, humbjet administrative, humbjet komerciale etj), në këtë dokument është përdorur terminologjia standarde e adaptuar në metodologjinë për llogaritjen e bilancit ujor të Asociacionit Botëror të Ujërave (IWA), ku humbjet e ujit ndahen në:

- Humbjet aparente (komerciale), dhe
- Humbjet reale (fizike).

Megjithatë, tri janë identifikuar të jenë shkaqet kryesore për shkallën e lartë të humbjeve të ujit:

• **Mos menaxhimi i duhur** - Edhe pse humbjet e ujit janë identifikuar si prioritet, deri tani nuk ka pasur strategji të zhvilluar për menaxhimin e tyre.
• **Problemet kulturore dhe sociale** - Problemet me sundimin e ligjit janë reflektuar edhe në rritjen e humbjeve të ujit në formën e kyçjeve ilegale, dëmtimin e rrjetit të ujësjellësit, manipulimin me ujëmatës, etj.
• **Problemet teknike** - Për shkak të resurseve të limituara financiare, investimet në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit kanë qenë minimale, dhe ato kryesisht të financuara nga donatorët. Për më tepër, rrjeti i shpërndarjes nuk i ka të përcaktuara zonat hidraulike gjë që e vështirëson tej mase menaxhimin efektiv të humbjeve të ujit.

Për arritjen e caqeve të përcaktuara, komuna do të përqendrojë aktivitetet e veta në katër shtylla kryesore:
(i) Matja e plotë dhe e saktë e ujit të konsumuar;
(ii) Eliminimi i të gjitha parregullsive të lidhura me faturimin e saktë në bazë të konsumit real të konsumatorëve;
(iii) Identifikimi dhe legalizimi/shkyçja e të gjitha kyçjeve të paligjshme;
(iv) Detektimi dhe riparimi sistematik i të gjitha rrjedhjeve si dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).
Reduktimi i këtyre humbjeve nuk kërkon investime financiare të larta por para se gjithash përkushtim maksimal të menaxhmentit, prandaj mund të arrihen rezultate të konsiderueshme përmes ndërmarrjes së masave, si:

- inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit,
- shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht ose që vjedhin ujin,
- instalimi i ujëmatësve aty ku mungojnë,
- kalibrimi i ujëmatësve të dyshimtë,

- inspektimi i rregullt dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional,
- ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve,
- kontrollimi i leximeve nga kontrolla, etj.

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e ujit:

- Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme me ujë të pijes për gjithë qytetarët e komunës, në veçanti zonat urbane.
- Mbajtja e qëndrueshmërisë dhe përmirësimi permanent i furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës;
- Krijimi i DMA dhe menaxhimi i humbjeve teknike e komerciale duke rivitalizuar rrjetet ekzistuese, duke përdorur praktikat më të mira;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen për furnizim me ujë:

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese te ujit të pijshëm;
- Hapja e puseve të reja në disa vendbanime rurale;
- Ndërtimi i stacioneve të pompave
- Rritja e vëllimit të rezervuarëve dhe ndërtimi i rezervuarëve të ri;
- Mbrojtja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në të gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit;
- Krijimi i zonave dhe nënzonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit.

3.4.2. Kanalizimi i ujërave të ndotura (zeza) dhe atmosferike

Shërbimi aktual ofron shërbime të kanalizimit rreth 25% të popullsisë (zona e përgjithshme e furnizimit). Ujërat e ndotura nga qyteti i Shtërpcës rrjedhin pa u trajtuar në rrjedhat ujore përreth.

Vlen të theksohet se përafërsisht 80% e banorëve ujërat fekale i derdhin në rrjetin lumor apo në hapësira të hapura. Një përqindje e vogël këto ujëra i derdhin në rrjete të kanalizimeve të menaxhueshme.

Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve në të kaluarën kryesisht u mbajt nga operatorët e sistemit, shumica e të cilëve nuk janë më në dispozicion për të ndihmuar me detajet e vendndodhjes së sistemit apo funksionimit të tij. Prandaj, informacioni është jo i plotë dhe duhet bërë shumë punë për të rimarrë atë njohuri. Sistemi i kolektorëve lokal sekondar dhe kyçjeve të konsumatorëve nuk është planifikuar të rehabilitohet ose zëvendësohet në asnjë prej nismave të financuara nga donatorët.

Sasia e ujërave të zeza do të rritet me shpejtësi ne te ardhmen, e njëjtë sikur nevoja për ujë të pijes. Rritja e nevojës për ujë për pastrim, gjendja e pjesërisht e vjetruar e rrjetit të kanalizimit, dhe nga vet fakti se Shtërpca nuk ka pajisje të punës për trajtimin ujërave të zeza, është domosdoshmëri që sistemi për menaxhimin e ujërave të zeza duhet të riparohet.

Me zgjerimin e sistemit te kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim me gjithëpërfshirës i ujit. Elementi kryesor i menaxhimit modern të ujit është ndarja e grumbullimit të ujërave nga reshjet dhe ujërat e zeza. Përderisa ujërat e zeza duhet të grumbullohen dhe trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat e reshjeve duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse cikli i ujërave natyrore. Kjo përfshinë ruajtjen dhe infiltrimin e ujërave nga reshjet brenda zonave banuese dhe komerciale. Ruajtja dhe infiltrimi i ujërave nga reshjet e redukton shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohëve të rënies dhe ndihmon në reduktimin e investimeve të nevojshme.

Masa me urgjente është impiant për ujëra të zeza pasi që këto ujëra nuk menaxhohen dhe si rrjedhojë derdhe një shtretër të lumenjve apo hapësira tjera.

Vlerësimi i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë të tillë-Kanalizimi i ujërave të ndotura

Bazuar në gjendjen ekzistuese të rrjeteve të kanalizimit të ujërave të ndotura dhe atmosferike dhe numrit të prognozuar të banorëve, në pjesë të qytetit dhe vendbanimeve (fshatrave) të cilat kanë nevojë për rrjete të reja të ujërave të ndotura si dhe Kolektorët kryesor të cilat dërgojnë ujin deri te FTUZ.

-Ndërtimi i kanalizimeve të reja në zonën urbane për të unifikuar rrjetet e fragmentuara ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në një pikë të vetme.

Kapacitetet e nevojshme të infrastrukturës së zgjeruar apo të re në Rrjetin e Kanalizimit

Bazuar në numrin e banorëve për secilin vendbanim gjeri në vitin 2028, përfshirë edhe banorët jo rezidentë komuna ka nevojë në:

- Zgjerimin dhe rehabilitimin i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimin e shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferike;

Sfidat kryesore në menaxhimin kanalizimit:

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetarët e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Ndërtimi i impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferike;

3.4.3. Ujitja dhe drenazhimi i tokave bujqësore

Komuna e Shtërpcës nuk ka sistem të ujitjes së tokave bujqësore në formë të organizuar. Duke ditur sipërfaqen e konsiderueshme të tokave bujqësore me kualitet të lartë dhe të përshtatshme për ujitje, është i domosdoshëm investimi në sisteme të ujitjes për toka bujqësore për arsye të rritjes së kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore.

Komuna e Shtërpcës ka burime të konsiderueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore andaj mund të përdorë disa lloje të sistemeve të ujitjes për të cilat duhet të bëhet një plan fizibiliteti për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi llojin e sistemit më të përshtatshëm të ujitjes për toka bujqësore.

Llojet e sistemeve të ujitjes që mund të përdoren për toka bujqësore është si në vijim:

1. Tokë bujqësore me sistem të ujitjes në sipërfaqe- brazda;
2. Tokë bujqësore me sistem të ujitjes me spërkatje;
3. Tokë bujqësore me sistem të ujitjes me pika;
4. Tokë bujqësore me sistem të ujitjes nëntokësore;
5. Tokë bujqësore me sistem të ujitjes së kombinuar

3.4.4. Energjia Elektrike

Furnizimi me energji elektrike i konsumatorëve në nivelin e shpërndarjes bëhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) që ne e njohim si KEDS. Është detyrë e këtij operatori të sigurojë energji për konsumatorët, por që pa dyshim që sasinë më të madhe të energjisë ky operator e siguron nga termocentralet e Kosova A dhe Kosova B të cilat janë të lokalizuara në Obiliq.

Furnizimi me energji elektrike është relativisht i mirë por ka raste edhe të ndërprerjes së rrymës elektrike, për disa arsye. Arsyet për këtë janë: kompania KEDS arsyetohet në vjetërsinë e rrjetit i cili shkakton probleme, pastaj rrjeti i kabllove në qytet si ai i tensionit të mesëm dhe të ulët të cilët të shumtën e rasteve janë në gjendje të keqe dhe burim rreziku për qytetarë si dhe mbingarkesa e rrjetit që furnizon nga NS Ferizaji, e posaçërisht në sezonin dimëror kur edhe paraqiten këto mbingarkesa.

Sa i përket problemeve dhe sfidave në aspektin e energjisë elektrike si në nivelin nacional ashtu edhe atë komunal, problem është rrjeti elektrik i cili është i vjetër. Pra, infrastruktura është vjetërsuar duke filluar nga telat shpërndarës të cilët janë të shtrirë po thuaj në të gjithë qytetin dhe gjendja se si janë momentalisht është shumë e rrezikshme për qytetarin. Po ashtu, shtyllat në të cilat mbështetet rrjeti, një pjesë ende përbëhen nga druri dhe në gjendje jo të mirë fizike, dhe si rezultat i infrastrukturës së dobët kemi humbje të jetës së njerëzve nga energjia elektrike.

Problem tjetër i cili duhet të theksohet është **rrjeti i tensionit 35 kV** i cili kalon në Komunën e Shtërpcës. Gjendja fizike e këtij rrjeti nuk është në nivelin e kënaqshëm. Po ashtu, ky rrjet kalon mbi vendbanime, përkatësisht mbi shtëpi banimi, pra, nuk ka një tampon zonë mbrojtëse dhe si rezultat i saj është rrezik i lartë për jetën e qytetarëve.

Problemet mjedisore nga energjia elektrike

Mund të themi se problematika mjedisore në sistemet e transmetimit ndahet në:

- Problemet mjedisore që shkaktohen nga linjat, dhe
- Problemet mjedisore që shkaktohen nga nënstacionet

Problemet mjedisore që shkaktohen nga linjat

Sot kur paraqitet nevoja e domosdoshme për zhvillimin energjetik të vendit tonë, paraqitur edhe në këtë Plan Zhvillimor, ne duhet të përshtatim prioritetin e kërkesave duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e tyre në mjedis. Prandaj, mund të themi se prioriteti anon kah një zhvillim i nevojshëm i transmetimit të energjisë elektrike të tensionit të lartë, duke mos mënjanuar nevojën për minimizimin e ndikimeve të mundshme në mjedis.

Pjesa më e madhe e linjave kalon nëpër sipërfaqet e punuara dhe të ndërtuara, ndërsa diç më pak në ato të ekosistemeve malore ku ndikimi i tyre nuk është aq i shprehur. Nga aspekti i rrezatimit elektromagnetik, ndikim më të madh kanë fushat elektromagnetike të frekuencës industriale.

Problemet mjedisore që shkaktohen nga nënstacionet

Përveç zënies së sipërfaqeve, nënstacionet bartin edhe ndryshime më të mëdha vizuale në rrethinë, mirëpo në aspektin estetik nuk ndikojnë dukshëm, meqë sipas rregullave duhet të ndërtohen jashtë zonave të banimit. Zhurma që shkaktohet në vazhdimësi (puna e transformatorëve) ose ajo në jo-vazhdimësi (pajisjet e shkyçjes-e ndërprerësit), më së shumti ndikon në rrethin e drejtpërdrejtë të nënstacioneve, ndërsa për shkak të reliefit ose vegjetacionit rrallëherë bartet tek pjesët e banuara, por ajo në lokacionin e nënstacioneve ka mundësi të ketë vlera më të mëdha se ato të lejuara.

Masat në përkujdesjen ndaj ndikimeve mjedisore

Në kohën kur nevoja për energji gjithnjë e më shumë po rritet, ndikimet reale në mjedis dhe synimet për një kualitet të mbrojtjes nga ky segment zhvillimor përfshijnë disa masa:

- Zvogëlimin e emisioneve në ujë, ajër dhe tokë;
- Rritjen e efektivitetit energjetik;
- Vënien e masave preventive me qëllim të zvogëlimit të numrit të aksidenteve;
- Përkujdesja për mbetje, posaçërisht atyre të natyrës së rrezikshme;
- Mundësia e riciklimit në shumë forma funksionale, qofshin ato edhe mënyra indirekte;
- Zhvillimin e sistemeve për mbledhjen e të dhënave dhe baza e të dhënave (forma elektronike);
- Reduktimin e pjesëve dhe pajisjeve të vjetruara që janë të montuara;
- Përpilimi i dokumentacionit për këtë segment transmetues;
- Ndërtimi i linjave dyfishe aty ku ka mundësi të racionalizohet shfrytëzimi i sipërfaqeve dhe korridoreve;
- Në përgjithësi përmirësimi i okupimeve të korridoreve për Transmision aty ku ka mundësi të realizohet;

Të gjitha këto të realizohen në etapa kohore të planifikuara paraprakisht, si:

- Zvogëlimi i dëmeve të bëra në të kaluarën;
- Reduktimi i ndikimeve nga aktiviteti në vijim në sektorin përkatës, dhe
- Parandalimi i ndotjes nga aktivitetet në të ardhmen (p.sh. VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis real dhe masat preventive në zvogëlimin e duhur).

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e energjisë

- Furnizimi i pa ndërprerë me energji elektrike;
- Eliminimi i linjave ajrore të tensionit të lartë në kuadër të vendbanimeve të mëdha me potencial të rrezikut për qytetarët;
- Menaxhimi i ndërtimeve në afërsi të linjave ajrore me tension të lartë në koordinim me komunën;
- Mundësia e shfrytëzimit të potencialeve hapësinore për krijimin e energjisë alternative;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Nderimi i NS110/10(20) kV
- Transformimi i rrjetit shpërndarës 10kV në 20 kV;
- Zhvendosja e rrjetit ajror në rrjete kabllore nëntokësore përkrah infrastrukturës tjetër
- Ndërtimi i nënstacioneve të reja për ofrim të shërbimeve më cilësore;
- Zëvendësimi i TS 10/0.4 kV me ato 20/0.4kV.

DRAFT

3.4.5. Energjia termike (Ngrohja)

Në Komunën e Shtërpcës nuk ekziston një sistem qendror i ngrohjes, andaj banorët shfrytëzojnë material me bazë natyrore për ngrohje, si p.sh. djegie të drurit dhe thëngjillit. Djegia e këtij lloji materiali për ngrohje gjatë dimrit nga shtëpitë individuale në përmasa komunale sigurisht që ka një ndikim të lartë negativ në ndotje të ajrit dhe mjedisit, si shkatërrimi i pyjeve nga prerja e pakontrolluar e drunjëve.

Andaj, shfrytëzimi i gjenerimit të energjisë termike për zhvillim të ndonjë lloj sistemi të ngrohjes qendrore në komunë është më se i rëndësishëm. Rrjedhimisht, hulumtimi i mundësive për gazifikim dhe përdorimi i gazit natyror për ngrohje është pjesë e rëndësishme e konceptit hapësinor.

3.4.6. Telekomunikimi

Shërbimet Telekomunikuese Mobile

Të dy operatorët mbulojnë territorin e Shtërpcës me shërbime të telefonisë mobile me zë (voice) dhe me të dhëna (data). Mbulueshmëria me shërbimet e zërit (voice) në Komunën e Shtërpcës është e kënaqshme, përfshirë edhe zonat rurale, në përjashtim të zonave malore të pa banuara ku vërehet mungesë e sinjalit 3G dhe LTE.



Harta 44 Shërbimet Telekomunikuese Mobile

Nga figurat e lartë vendosura konkludojmë se mbulueshmëria me rrjetin GSM ,3G dhe LTE në qytetin e Shtërpcës është e kënaqshme, ndërsa në zonat rurale dhe viset malore të pabanuara ose rrallë të banuara mbulueshmëria me rrjetin e 3G dhe LTE nuk është e kënaqshme.

Numri i BTS në zonën urbane të Shtërpcës është i mjaftueshëm, ndërsa në zonat rurale dhe malore është e nevojshme rritja e numrit të BTS-ve në mënyrë që të kemi mbulueshmëri optimale, në veçanti në zonat turistike.

Nga hulumtimet në terren vërejmë se ndërtimi i BTS është bërë pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese. Ekzistojnë raste kur dy BTS të operatorëve të ndryshëm janë në distancë shumë të vogël nga njëri-tjetri.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve telekomunikuese mobile:

Duke parë që mbulueshmëria me shërbime *voice* është e kënaqshme, përmirësimet duhet të orientohen kryesisht në shërbimet *data* dhe rritja e numrit të BTS–ve. Nevoja për kapacitete më të mëdha nga shfrytëzuesit është gjithnjë në

rritje. Kjo tregon që edhe për zonat me mbulueshmëri të mirë në ditët e sotme, në një të ardhme jo të largët nuk do të jetë e mjaftueshme. Për këtë nevojitet përmirësim në infrastrukturë dhe teknologji.

Për të përmbushur kërkesat e qytetarëve për kapacitete të mjaftueshme operatorët duhet që të:

- Rrisin numrin e BTS-ve në zonat me koncentrim më të madh të qytetarëve dhe në zonat turistike. Mënyra më e përshtatshme për ta bërë këtë, rekomandohet që të ndërtohet BTS e përbashkët nga të dy operatorët.
- Rrisin kapacitetet duke zëvendësuar transportin me wireless, me atë me fije optike. Edhe në këtë rast mund të përdorin infrastrukturë të përbashkët nëntokësore që mund te jetë pronë e operatorëve, pronë publike komunale, apo edhe ndonjë operatori të shërbimeve FIX-e, të cilët do ta ndajnë të njëjtën infrastrukturë gjithashtu.

Shërbimet telekomunikuese fikse, internet dhe DTV

Sa i përket rrjetit fiks të ofrimit të shërbimeve të qasjes në internet në Komunën e Shtërpcës, bazuar në të dhënat e dërguara nga operatorët, vërehet se Komuna e Shtërpcës qëndron mirë në ofrimin e shërbimeve të internetit, të cilat ofrojnë shpejtësi shumë të larta dhe nivele të garantuara të kualitetit të shërbimeve të internetit, në krahasim me rrjetin mobil.

Edhe pse shërbimet me internet në Komunën e Shtërpcës janë të mira, problemi qëndron në infrastrukturën ekzistuese, e cila është ndërtuar pa ndonjë koordinim në mes të operatorëve të kompanive telekomunikuese dhe nuk është e unifikuar.

Gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në Komunën e Shtërpcës është relativisht e mirë; ekzistojnë disa kompani (operatorë ekonomikë) që bëjnë shpërndarjen e rrjetit të internetit.

Shpërndarja e teknologjive dhe e rrjeteve të avancuara në Komunën e Shtërpcës është zhvilluar me një ritëm jo të rregullt dhe në mënyrë të pakoordinuar.

Operatorët e licencuar ofrojnë këto shërbime kryesisht në zonat urbane dhe në disa zona rurale, ku përqendrimi i qytetarëve-banesave është më i madh, ndërsa në zonat e largëta dhe më pak të banueshme, këta operatorë nuk ofrojnë shërbime. Në këto zona, shërbimet ofrohen nga operatorët lokalë, shpeshherë të pa licensuar dhe me kualitet jo të kënaqshëm të shërbimit. Ofrimi i shërbimeve bëhet përmes sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) në mbi 80% të rasteve dhe në 20% të rasteve përmes GPON (Fiber).

Sfida më e madhe për përmirësimin e shërbimeve është infrastruktura. Për momentin shumica e operatorëve shfrytëzojnë shtyllat e distribucionit për shtrirjen e kabllove, qoftë të rrjetit primar, apo të atij sekondar që i jep shërbim edhe qytetarit. Të pakta janë rastet, kryesisht në zonat urbane, ku operatorët kanë shfrytëzuar infrastrukturën nëntokësore për shtrirjen e kabllove të tyre.

Përmirësimet duhet të bëhen në:

- Infrastrukturë – Duhet të ndërtohet infrastruktura e përbashkët nëntokësore për të gjithë operatorët. Infrastruktura të përdoret edhe për operatorët që ofrojnë shërbime telekomunikuese mobile. Zgjidhja ideale do të ishte që infrastruktura primare të jetë pronë komunale apo e një operatori dhe të mirëmbahet nga vetëm një ekip, i cili pastaj jepet në shfrytëzim për operatorët.
- 100% e infrastrukturës në zonat urbane duhet të kalojë në infrastrukturë nëntokësore, ashtu sikurse edhe rrjetet primare, furnizimet në zonat rurale të bëhen me infrastrukturë nëntokësore, ndërsa në zonat me banim më të ulët, të lejohet edhe infrastruktura ajrore, por me shtylla të sigurta nga betoni.
- Të sigurohet që së paku dy operatorë që ofron shërbime kualitative dhe kontent të licencuar, të ofrojnë shërbime për secilin qytetar të Shtërpcës. Kjo për shkak se konkurrenca rrit cilësinë dhe jep lehtësime financiare për qytetarët.
- Të bëhen lehtësime për operatorët që kalojnë nga HFC në GPON, pasi që me këtë veprim ju mundësojnë shërbime shumë më të mira dhe kualitative qytetarëve.

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e rrjetit të telekomunikimit

- Shpërndarja e rrjetit kabllor në tërë komunën, përfshirë edhe pjesët me të thella rurale;
- Shpërndarja e kabllove optike në të mirën e menaxhimit më të lehtë dhe shërbim cilësor;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Shpërndarja e rrjeteve optike;
- Eliminimi i kabllove ajrore dhe vendosja e tyre në gypa nëntokësor;
- Ri-organizimi i antenave shpërndarëse të rrjetit sipas standardeve;
- Mundësi qasjeje çdo qytetari në internet dhe DTV .

3.4.7. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës rregullohet përmes Kornizës Ligjore e cila është e harmonizuar me legjislacionin evropian, respektivisht direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat rregullojnë sektorin e mbeturinave. Qëllimi kryesor i kornizës ligjore për menaxhimin e mbeturinave është evitimi dhe reduktimi në masë sa më të madhe të mundshme të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton dhe rregullon pronësinë e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen koorporative të tyre në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Neni 6 i Ligji Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike mundëson krijimin e ndërmarrjeve publike lokale nga komunat. Ndërsa me nenet 4, 5, dhe 6 të Rregullores Nr.02/2013 përcaktohen kriteret dhe procedurat për krijimin e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave. Në bazë të nenit 5.2 të këtij ligji të drejtën e komunës si aksionar e ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga: një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Sistemi aktual i menaxhimit të mbeturinave komunale është i paqëndrueshëm në aspektin mjedisor. Mbledhja, transportimi dhe asgjësimi i mbeturinave nuk ofrohet për të gjithë, prandaj mbeturinat e pa mbledhura hidhen ose digjen dhe kjo ndikon negativisht në shëndetin e njeriut si dhe në ujë, ajër, tokë dhe biodiversitet. Ngjashëm, mbeturinat e rrezikshme (në rrjedhën e mbeturinave komunale) nuk mblidhen, nuk trajtohen ndaras, përfundojnë të deponuara bashkë me mbeturinat komunale dhe paraqesin rrezik për mjedisin.

Komuna e Shtërpcës do të shfuqizojë sistemin aktual të grumbullimit të mbeturinave, duke bërë një planifikim që kompanitë/operatorët të bëjnë kontraktimin në bazë të zonave, në mënyrë që i gjithë territori i Komunës të mbulohet me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave duke përfshirë edhe pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit.

Përmes investimeve kapitale private, Komuna e Shtërpcës duhet të planifikojë që hapësirën e stacionit transit të mbeturinave ta shndërrojë në qendër për ndarje të materialeve me qëllim riciklimi. Sektori i menaxhimit të mbeturinave karakterizohet me nivele të ulëta të efikasitetit, investime private të kufizuara dhe përvojë joadekuate në përdorimin e teknologjisë moderne.

Pa marrë parasysh shkallës relativisht të lartë të mbulimit me shërbim të grumbullimit të mbeturinave (80%), infrastruktura e grumbullimit të mbeturinave është e dobët dhe karakterizohet me një numër të pamjaftueshëm të kontejnerëve/shportave (kryesisht të dëmtuara) që shpesh nuk përputhen me sistemin e transportit. Janë tre fshatra në komunë ku shërbimet e grumbullimit nuk janë të disponueshme për shkak të infrastrukturës së pakalueshme.

Pajisjet e transportimit të mbeturinave shpesh amortizohen, nuk funksionojnë mirë dhe janë kryesisht të pamjaftueshme për mbulim të plotë me shërbim. Mirëmbajtja e pajisjeve është po aq e pamjaftueshme, ndërsa autoparqet janë në gjendje të keqe.

Në përgjithësi, vlerësimi nënvizon disa nga sfidat dhe kufizimet e infrastrukturës aktuale të menaxhimit të mbeturinave në komunë, duke përfshirë kamionët e vjetër dhe joadekuat dhe problemet me deponimin e mbeturinave në zona të caktuara.

Baza e të dhënave nga operatori për klientët e shërbyer nuk është e përditësuar dhe shumë evidenca mungojnë, duke rezultuar në praktika joefikase të grumbullimit dhe faturimit të mbeturinave në Komunën e Shtërpcës. Edhe pse të gjitha familjet marrin shërbime të grumbullimit të mbetjeve, vetëm një përqindje e caktuar e tyre faturohen, gjë që tregon se ka një mospërputhje midis numrit të klientëve të shërbyer dhe numrit të klientëve që paguajnë për shërbimin.

Megjithatë, përpjekjet e komunës për të hartuar një plan për menaxhimin e mbetjeve tregojnë një angazhim për përmirësimin e situatës.

3.4.7.1. Mbledhja, transferimi dhe deponimi i mbeturinave komunale

Në mungesë të një stacioni transferimi për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve, mbeturinat dërgohen direkt në deponinë sanitare rajonale në Velekincë-Gjilan, e cila menaxhohet nga KMDK SH.A. Deponia është një vendgrumbullim sanitar që trajton mbetjet komunale dhe shtëpiake jo të rrezikshme, siç përcaktohet në ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina. Gjendja aktuale tregon se kjo deponi aktualisht nuk funksionon siç duhet dhe mund të ketë rreziqe mjedisore dhe shëndetësore që lidhen me funksionimin e tij.

Në komunën e Shtërpcës operojnë grumbulluesit joformalë të mbeturinave, kryesisht duke grumbulluar materiale metalike, plastike dhe letre, të cilët luajnë një rol në menaxhimin e mbetjeve në komunë dhe aktivitetet e tyre kontribuojnë në riciklimin dhe reduktimin e depozitimit të mbetjeve në deponi.

Në përgjithësi, situata nxjerr në pah disa dobësi në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Shtërpcës. Mungesa e një stacioni transferimi për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve mund të rezultojë në transportimin e drejtpërdrejtë (pa ndarje) të mbetjeve në deponi, i cili mund të mos funksionojë siç duhet. Megjithatë, mbledhësit informal të mbetjeve luajnë një rol në menaxhimin e mbetjeve, duke kontribuar në riciklimin dhe reduktimin e depozitimit të mbetjeve në deponi.

Deponitë ilegale: Komuna e Shtërpcës përballet me disa sfida sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Një nga problemet kryesore është prezenca e deponive ilegale, të cilat ndikojnë negativisht në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Kategorizimi i madhësive të deponive ilegale është shumë e rëndësishme. Rreth 78% e këtyre deponive hyjnë në kategorinë e deponive të mëdha, që tregon se ka një sasi të konsiderueshme mbeturinash që gjenerohen dhe nuk depozitohen siç duhet, ku në secilën ka përmbajtje të mbeturinave kryesisht **komunale, mbeturina nga ndërtimi/demolimi** dhe **mbeturina të tjera**.

Është gjithashtu thelbësore të përcaktohet sasia e mbetjeve që hidhen ilegalisht në mënyrë që të merren masat e duhura për të reduktuar këtë praktikë.

Mbeturinat e vëllimshme: Mbeturinat e ngurta, si mobiljet dhe elektro-shtëpiaket, aktualisht nuk menaxhohen nga komuna. Qytetarët dhe bizneset vazhdojnë t'i depozitojnë këto mbetje në vende të papërshtatshme. Kjo situatë jo vetëm që krijon deponi ilegale, por përbën edhe rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin. Prandaj, komuna duhet të zhvillojë një strategji për të adresuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe për të ofruar shërbime të përshtatshme për qytetarët dhe bizneset e saj.

Mbeturinat e demolimit/inerte: Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2015, menaxhimi i këtij lloji të mbeturinave është obligim i komunës. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, komuna në bashkëpunim me komunat përreth, mund të ndërtojnë një deponi për mbeturinat nga ndërtimi/demolimi me qëllim që të mos degradohet edhe më tej mjedisi. Ky UA gjithashtu përcakton kriteret për përzgjedhjen e vendeve të përshtatshme për këtë lloj të mbeturinave, ku ndër më të rëndësishmet janë: vendet që më parë janë shfrytëzuar për eksploatim me qëllim të mbushjes së gropave, kanaleve të ndryshme të formuara në mënyrë të natyrshme, vende të degraduara si rezultat i erozionit ose rrëshqitjeve të dheut, apo vende tjera të ngjashme.

Megjithatë, siç është përmendur edhe më lartë, është përgjegjësi e komunës t'i trajtojë mbetjet e demolimit/inerte. Mund të thuhet se të gjitha komunat në Kosovë kanë mangësi në krijimin e deponive/vendeve të përshtatshme për depozitimin e kësaj kategorie.

Komuna e Shtërpcës ka problem në aspektin e grumbullimit të mbeturinave inerte pasi që nuk ka ndonjë deponi legale në aspektin e grumbullimit dhe trajtimin e këtyre mbeturinave dhe si rezultat i kësaj, shumica e deponive ilegale në komuna përbëhen nga mbeturina të demolimit/inerte.

Andaj komuna e Shtërpcës duhet të caktoj një hapësirë të përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave inerte.

Mbeturinat shtazore: Mungesa e aktiviteteve të duhura të menaxhimit të mbetjeve shtazore përbën një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin publik dhe mjedisin, dhe sfidë jo të lehtë për komunën. Mbetjet e kafshëve mund të përmbajnë patogjenë të dëmshëm dhe kimikate që mund të kontaminojnë tokën dhe burimet e ujit, duke çuar në përhapjen e sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera shëndetësore. Mungesa e impiantit për trajtim dhe përpunim teknologjik të tyre, e vështirëson menaxhimin efektiv të kësaj kategorie mbetjesh. Për më tepër, fakti që subjektet që merren me tregtimin e mishit dhe produkteve të tij, si dhe me prodhimin, përpunimin dhe ruajtjen e mishit, asgjësojnë këto kategori në mënyrë të paligjshme e përkeqëson më tej situatën.

Përveç subjekteve tregtare, në këtë problem kontribuojnë edhe amvisëritë, duke depozituar në mënyrë jo të duhur mbetjet shtazore. Për më tepër, mungesa e një sistemi menaxhimi për kafshët e ngordhura paraqet gjithashtu një problem të madh. Hedhja e mbetjeve të kafshëve nga familjet dhe ngordhja e kafshëve, nëse nuk menaxhohet siç duhet, mund të përbëjë një rrezik të konsiderueshëm.

3.4.7.2. Mbeturinat medicinale:

Prodhohen nga shume subjekte mjekësore, të cilat prodhojnë një sasi të konsiderueshme mbetjesh të rrezikshme. Trajtimi i këtyre mbetjeve në respektimin e mjedisit është detyrë profesionale dhe etike e të gjithë operatorëve mjekësorë. Ky trajtim duhet të eliminojë potencialin patogjen që këto mbetje përmbajnë, në mënyrë që të reduktohet ndotja e ambientit, toksiciteti kimik dhe radioaktiv.

Mbetjet medicinale mund të shkaktojnë infeksione nëse vijnë në kontakt me lëkurën, sytë, ajrin, gojën ose nëse ato në forma të ndryshme depërtojnë në trupin e njeriut. Këto mbetje duhet të trajtohen vetëm në vendet e lejuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe operatorët duhet të janë të pajisur me leje përkatëse.

Trajtimi i mbeturinave medicinale rregullohet përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale.

Mbeturina të tjera: Mungesa e informacionit dhe kushtet e pafavorshme në lidhje me menaxhimin e kategorive të caktuara të mbeturinave, siç janë bateritë, mbeturinat e naftës dhe mbeturinat e pajisjeve elektronike në Komunën e Shtërpcës bën që ato të përfundojnë në deponitë ilegale brenda territorit**.** Vërehet se mungesa e infrastrukturës, iniciativave dhe ndërgjegjësimit janë faktorë që kontribuojnë në këtë situatë.

3.4.7.3. Riciklimi

Riciklimi si proces ka një indikacion të qartë dhe të vetëdijshëm për dobitë ekonomike dhe potencialet e kursimeve për buxhetin nga zhvillimi i sektorit të riciklimit. Megjithatë, investimet e deritanishme në industrinë e riciklimit nga sektori privat apo publik kryesisht mbeten ashtu siç janë planifikuar, por nuk zbatohen dhe nuk janë funksionale.

Sektori joformal është shumë aktiv në mbledhjen e fraksioneve të ricikluara. Edhe pse përmes këtij aktiviteti ata e sigurojnë jetesën e tyre, kjo paraqet rreziqe të mëdha shëndetësore për komunitetin dhe fëmijët në veçanti.

Mbeturinat e mbledhura të ricikluara pastaj ngrihen në zinxhirin e vlerave tek bizneset që i përpunojnë këto materiale dhe po ashtu i eksportojnë ato. Janë disa shembuj (kompostimi i mbeturinave organike, ripërdorimi i gomave, ripërdorimi dhe ruajtja e naftës dhe derivateve të saj etj.) të bizneseve që janë renditur në listë dhe që i ripërdorin apo riciklojnë mbeturinat e mbledhura.

Analiza SWOT – Infrastruktura teknike	
Përparësitë	**Dobësitë**
Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi ▪ **Burime të ujit të pijes;** ▪ **Cilësia e mirë e ujit;** ▪ **Vazhdimësia e ndërtimit të kanaleve të reja;** ▪ **75% e vendbanimeve me rrjet të ujësjellësit;** ▪ **Ofrimi i ujitjes optimale përkundër kushteve minimale;** ▪ **Ujëra sipërfaqësorë të mjaftueshëm për ujitje të tokave bujqësore.** Energjia elektrike ▪ **Kapacitete transmetuese interkonektive të mjaftueshme që mundësojnë tregti ndërkufitare** ▪ **Resurset humane të mjaftueshme për të rekrutuar dhe zhvilluar staf me shkathtësi që mund t'i përgjigjen kërkesave të sektorit;** ▪ **Baza ligjore në harmoni me direktivat e BE-së;** ▪ **Republika e Kosovës është anëtare e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë të EJL** Telekomunikimi ▪ **Disa operatore të licensuar;** ▪ **Potencial i mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore;** Menaxhimi i mbeturinave ▪ **Traditë dhe përvojë në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave;**	**Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi** ▪ Mos shfrytëzimi i kapaciteteve të ujit për nevoja të pijes; ▪ 6.25% vendbanime nuk kanë rrjet të ujësjellësit; ▪ Rrjeti pjesërisht i vjetër i ujësjellësit dhe gypa nga materiali AC në disa zona; ▪ Mungesa e ujëmatëseve zonale në zona të caktuara të rrjetit ujësjellësit; ▪ Dimensione joadekuate të gypave ekzistues; ▪ Mungesa e sistemit të akumulimit të ujërave; ▪ Domosdoshmëria e shfrytëzimit të pompave në disa pjesë të qytetit (lagjet në zonat e larta); ▪ Mungesa e kyçjes së disa fshatrave në rrjetin kryesor; ▪ Shfrytëzimi jo i duhur i ujit (abuzimet); ▪ Mungesa e impianti për trajtimin e ujërave të zeza; ▪ Rrjeti i vjetruar i kanalizimit; ▪ Përzierje e rrjetit te kanalizimit me atë atmosferik; ▪ Mungesa e rrjetit atmosferik të ri; ▪ Mënyra primitive e ujitjes; ▪ **Energjia elektrike** ▪ Rrjet i vjetërsuar si dhe shtylla nga druri; ▪ Kabllot e tensionit të lartë kalojnë mbi shtëpi banimi;

▪ **Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave;** ▪ **Konsumatorët nga tri kategoritë të kënaqur me shërbimet;** ▪ **Personeli/stafi ka përvojë në organizimin e punëve operative dhe mbulimin cilësor të terrenit;** ▪ **Staf profesional për përgatitjen e projekteve për kërkim të donacioneve;**	▪ Kapacitete gjeneruese aktuale të vjetruara që nuk sigurojnë prodhim të qëndrueshëm të energjisë elektrike; ▪ Nivel i lartë i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes; ▪ Mundësi të kufizuara për vetë financim të investimeve; ▪ Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve prodhuese; **Telekomunikimi** ▪ Mënyra e shpërndarjes së rrjetit e pa organizuar; ▪ Mos bashkëpunim i operatoreve si dhe organeve tjera; ▪ Mos aplikim i standardeve për vendosjen e antenave përçuese të valëve; ▪ Mbulueshmëri jo adekuate e territorit të komunës; **Menaxhimi i mbeturinave** ▪ Infrastrukturë e kufizuar për menaxhimin e mbeturinave, trajtimin dhe riciklimin; ▪ Mungesa e një baze të dhënash për t'i shërbyer një menaxhimi më efikas të mbeturinave, inventarizim i lokacioneve problematike; ▪ Mungesë e deponisë për mbeturina nga ndërtim/demolimi; ▪ Kapacitetet e kufizuara në mekanizëm dhe automjete për ofrimin e shërbimeve; ▪ Mos ndarje e mbeturinave në burim; ▪ Komuna nuk ka një stacion transfer për grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave komunale; ▪ Prezenca e deponive ilegale; ▪ Mungesa e trajtimit të mbeturinave industriale dhe sanitare; ▪ Mungesë e hapësirave dhe praktikave për trajtim të mbeturinave shtazore;
Mundësitë	**Rreziqet**
Ujësjellësi, Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi ▪ **Shfrytëzimi i investimeve të jashtme;** ▪ **Garantët qeveritarë;** ▪ **Aplikimi i arritjeve teknologjike;** ▪ **Trajnimi i stafit;** ▪ **Ekzistenca e Legjislacionit përkatës;**	**Ujësjellësi dhe Kanalizimi dhe ujitja/drenazhimi** ▪ Mos ndërrimi i gypave të vjetër të ujësjellësit; ▪ Cenimi i kualitetit/sigurisë së ujit si pasojë e rrjetit të vjetërsuar; ▪ Humbjet e mëdha të ujit në rrjet; ▪ Keqpërdorimi i ujit;

DRAFT

▪ **Instalimi ujëmatësve digjital në tërë zonën e shërbimit, ashtu që do të kishte avantazhe të ndjeshme sa i përket rënies së humbjeve të ujit si dhe rritjes së faturimit në [m3] të ujit të shpenzuar;** ▪ **Investime nga WB në sistemin e ujitjes të tokave bujqësore** Ngrohja ▪ **Ndërtimi i impianteve të ngrohjes me djegie të mbeturinave dhe BRE-ve tjera;** ▪ **Ndërtimi i impianteve të reja bashkë gjeneruese** ▪ **Menaxhimi i mbeturinave** ▪ **Fushata vetëdijsuese;** ▪ **Krijimi i Eko-taksës** ▪ **Angazhimi i OJQ-ve mjedisore;** ▪ **Rritjen e inkasimit dhe marrëdhënieve me konsumatorë;** ▪ **Rritjen e mundësive për investime të reja kapitale dhe pajisjeve;** ▪ **Inicimin e procesit të riciklimit dhe ndërtimin e vijave ricikluese;** ▪ **Forcimin e partneriteti dhe kooperimit me rrjetin PAMKOS dhe ndërmarrjet simotra për mbeturina në Kosovë.** **Menaxhimi i mbeturinave** ▪ **Ndërtimi i infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim;** ▪ **Ofrimi i infrastrukturës adekuate për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave;** ▪ **Krijimi i një baze të dhënash, mbajtja e evidencave mbi situatën me mbeturinat, për menaxhim më efikas në të ardhmen;** ▪ **Promovimi i konceptit 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim);** ▪ **Investime në ndërtimin e stacionit transfer për deponimin e përkohshëm të grumbullimit me mundësi të ndarjes së mbeturinave;** ▪ **Planifikimi i deponisë rajonale për mbetjet nga ndërtim/demolimi** ▪ **Përmirësimi i infrastrukturës dhe mekanizmave të menaxhimit të mbetjeve si integrimi i teknologjive dhe pajisjeve të reja;** ▪ **Zbatim i rregulloreve dhe ndëshkime të rrepta për hedhjen ilegale;** ▪ **Menaxhimi i qëndrueshëm i kategorive të mbeturinave që mbeten pa trajtim dhe deponim adekuat;**	▪ Mospjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje në procesin e ndërtimit të impiantit (çështja e ekspropriimit); ▪ Politika joadekuate; ▪ Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore ▪ Mbrojtja e rezervuarëve dhe Stacioneve te pompave me rrethoj dhe siguri fizike ▪ Dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit **Ngrohja** ▪ Mungesa e investitorëve në sektorin e ngrohjes ▪ Menaxhimi i mbeturinave ▪ Rritja e ndotjes; ▪ Shfaqja e sëmundjeve infektive; ▪ Ndotje e tokave bujqësore; ▪ Mos mirëmbajtje adekuate e rrjetit energjetik; **Menaxhimi i mbeturinave** ▪ Rritja e problematikave lidhur me gjenerimin dhe depozitimin e mbeturinave; ▪ Menaxhimi joadekuat i mbetjeve mund të çojë në probleme mjedisore dhe shëndetësore, të cilat mund të ndikojnë negativisht në mirëqenien e popullatës lokale dhe mjedisin; ▪ Mungesa e menaxhimit ndikon gjithashtu në zhvillimin turistik dhe ekonomik të zonës; ▪ Hedhja jo e duhur e mbetjeve shtazore, mbetjeve të ndërtimit/rrënimit dhe mbetjeve industriale mund të çojë në përhapjen e sëmundjeve dhe rreziqeve të tjera shëndetësore; ▪ Mungesa e informacionit për menaxhimin e mbetjeve mjekësore nga sektori privat mund të çoj në asgjësim jo të duhur;

DRAFT

▪ **Eliminimi i deponive ilegale;**	

Tabela 111 SWOT Analiza për infrastrukturë teknike

3.5. INFRASTRUKTURA TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

3.5.1. Rrjeti rrugor

3.5.1.1. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Referuar ligjit mbi rrugët, rrugët publike kategorizohen në:

- Autoudhë;
- Rrugë nacionale
- Rrugë rajonale dhe
- Rrugë lokale

Nëpër territorin e Komunës së Shtërpcës nuk kalojnë autoudhë. Lidhja më e afërt e Shtërpcës është në autoudhën "Arbër Xhaferi" përmes rrugës rajonale R115.

Përveç autoudhëve të cila nuk përfshihet në kuadër të rrjetit rrugor të Komunës së Shtërpcës, në territorin e Komunës së Shtërpcës nuk kalojnë as rrugët nacionale.

Analiza e gjendjes ekzistuese tregon një prapambetje të infrastrukturë së transportit në krahasim me treguesit e shumtë që janë evidentë në Kosovë. Në bazë të kësaj, në periudhën e ardhshme është i rëndësishëm zhvillimi intensiv i sistemit të transportit, i cili do të duhet të paraqes një nga parakushtet themelore të zhvillimit të tërë komunës.

Në territorin e Komunës së Shtërpcës, rrjeti i rrugëve të kategorizuara, rajonale dhe rrugëve tjera që lidhin qendrën e vendbanimeve me rrugën rajonale, shtrihet në gjerësi totale prej 70 km. Nga këto, 54 km ose 77% janë rrjet bashkëkohor.

Rrugët rajonale

Tri rrugë rajonale e lidhin Shtërpcën me qytetet dhe fshatrat tjera brenda komunës dhe rrjetin tjetër rrugor të Kosovës dhe më gjerë. Një ndër rrugët më të rëndësishme rajonale është rruga rajonale R-115 e cila kalon nëpër territorin e komunës në drejtim të jugperëndimit – verilindjes është me një shtrirje bashkëkohore dhe lidhë Shtërpcën me Komunën e Prizrenit në jugperëndim, si dhe me rrugën nacionale Prishtinë – Ferizaj – Shkup në lindje. Në territorin e komunës rruga regjionale është e gjatë 25 km, me gjerësi prej 6-7 m.

Rruga tjetër rajonale R118, aktualisht ndërpritet në fshatin Vërbeshticë. Kjo rrugë mjaftë e rëndësishme ka mundësi të lidhet në fshatin Delloc dhe të mundësoj lidhjen në rrugën nacionale N25 dhe me Komunën e Suharekës. Gjitahshtu, edhe rruga tjetër rajonale lidhë Shtërpcen me Brezovicen.

Përgjithësisht rrugët rajonale ofrojnë kushte të mira për qarkullim të automjeteve motorike. Pjesa më e madhe e tyre janë të asfaltuara, por kanë nevojë për mirëmbajte, rehabilitim dhe përmirësim të sipërfaqes qarkulluese më qëllim të përmirësimit të kualitetit të lëvizjes dhe rritjes së nivelit të sigurisë gjatë lëvizjes. Plotësimi i kërkesave për lëvizje të pa motorizuara në këto pjesë të rrjetit rrugor po ashtu kërkon trajtim dhe masa konkrete.

Rrugët lokale-urbane

Rrugët lokale lidhin vendbanimet me rrugën rajonale apo qendrën turistike me rrugën rajonale. Këto rrugë janë rrugë me ose pa shtresa bashkëkohore. Gjerësia e rrugëve lokale me shtresë bashkëkohore është 3-5 m.

Në disa vitet e fundit janë rikonstruktuar dhe asfaltuar një numër i rrugëve në brendi të vendbanimeve të Komunës së Shtërpcës. Përmasat e këtyre rrugëve janë shumë të ngushta (gjerësia 3-4m). Rrugët tjera të pa asfaltuara janë po ashtu me përmasa të ngushta të rrethuara me objekte të ndërtuara që pamundësojnë zgjerimin e tyre. Përmasat e ngushta pengojnë ndarjen e trafikut për këmbësor dhe vetura, që sigurinë e këmbësorëve e redukton në minimum. Terreni malor në të cilin gjendet lokacioni ka shkaktuar probleme në pjerrtësinë gjatësore të këtyre rrugëve me ç`rast në muajt e dimrit e vështirësojnë mjaftë qarkullimin normal të trafikut.

Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda Shtërpcës kanë karakter të ndryshëm. Rrugët e karakterit më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të karakterit më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklistë shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklistë.

Në Shtërpcë, kërkesave për lëvizje të këmbësorëve dhe çiklistëve, nuk u ofrohet hapësirë e sigurt dhe komode. Gjithashtu, edhe në kuadër të rrjetit rrugor periferik, këmbësorët dhe çiklistët nuk kanë qasje të lehtë dhe kushte të mira për lëvizje të sigurt.

DRAFT

3.5.2. Cilësia e infrastrukturës (elementeve strukturore të rrugëve)

3.5.2.1. Ndërlidhja e vendbanimeve me zonën urbane dhe ndërmjet

Trafiku për në Shtërpcë vjen nga dy drejtime kryesore: Prizreni, Ferizaj dhe Kaçaniku.

Qytetet dhe fshatrat në komunën e Shtërpcës janë të lidhura me rrjetin rrugor rajonal. Njëra nga më të rëndësishmet është rruga R115 që lidhë Prizrenin dhe Ferizajn përmes Shtërpcës. Shumica e rrugëve rajonale janë të asfaltuara, por për shkak konfiguracionit të terrenit në disa pjesë të këtyre rrugëve paraqiten vështirësi të shtrirjes gjatësore dhe elementeve gjeometrike të tyre.

Rrugët e nivelit më të lartë janë plotësuar nga një rrjet i rrugëve lokale. Kualiteti i këtyre rrugëve në shumicën e rasteve është i dobët, dhe një pjesë e tyre nuk mund të përdoren gjatë kushteve të vështirësuara klimatike.

Në Komunën e Shtërpcës, të gjitha rrugët e viseve rurale kanë lidhshmëri me zonat urbane, edhe pse jo të gjitha rrugët janë të asfaltuara por të gjitha janë të kalueshme.

3.5.2.2. Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror

Nga niveli qendror, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është planifikuar ndërtimi i rrugës rajonale R118 e cila lidhë Komunën e Shtërpcës me Komunën e Suharekës.

3.5.2.3. Vlerësimi e intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore

Kapaciteti është definuar si madhësia maksimale e qarkullimit të automjeteve të cilat mund të kalojnë nëpër pjesën e vëzhguar të shiritit qarkullues të rrugës në periudhën e caktuar kohore, nën ndikimin e kushteve të komunikacionit në rrugë.

Kapaciteti i rrugëve rajonale R 115, R118 dhe R 210

Rruga rajonale R115 që kalon nëpër territorin e komunës në drejtim të jugperëndimit – verilindjes është me një shtrirje bashkëkohore dhe lidh Komunën e Prizrenit në jugperëndim si dhe me rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj – Shkup, në lindje. Në territorin e Komunës së Shtërpcës rruga rajonale R115 është e gjatë 25 km, me gjerësi prej 6-7 m. Bazuar në gjerësinë dhe numrin e korsive (nga një korsi për secilin kah), kapaciteti potencial për rrugët rajonale për kahe sillet rreth 1100 - 1300 aut/h.

Kapaciteti i rrugëve lokale

Rrugët lokale lidhin vendbanimet me rrugët rajonale, apo qendrën turistike me rrugën rajonale. Pjesa më e madhe e rrjetit rrugor në Komunën e Shtërpcës është e përbërë nga rrugë lokale. Gjendja dhe elementet gjeometrike të këtyre rrugëve janë të ndryshme, duke filluar nga 3.0 – 6.0 m. Bazuar në gjerësitë dhe gjendjen e rrugëve (përfshirë faktorët reduktues nga ndikimet e lëvizshmërisë urbane), kapaciteti i rrugëve lokale sillet nga 500 – 800 aut/h/kah.

3.5.2.4. Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit

Pas analizës së të dhënave, është vlerësuar se nga modalitetet e mundura, transporti rrugor është dominues. Nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për akomodimin e të gjithë pjesëmarrësve në trafik është e nevojshme.

Sa i përket zhvillimit të një rrjeti të ri të trotuareve për këmbësorë në Komunës së Shtërpcës, vëmendja duhet përqendruar në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës për lëvizje të këmbësorëve si dhe për të promovuar një kulturë të re për trafik të pa motorizuar, paraprakisht duhet të krijohen kushtet për lëvizje të lirë dhe të sigurt.

Rrjeti i shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta, dhe hapësirat publike do të plotësojnë në plotni konceptin e transportit të qëndrueshëm. Boshti i butë i hapësirave publike dhe transportit të pa motorizuar do të ndërlidhet me nyjën qendrore dhe ato sekondare në qytet.

3.5.2.5. Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim

Në Shtërpcë ka një parkim publik në qendër, i cili menaxhohet nga komuna. Por, është me rëndësi të ndërtohet një sistem i menaxhimit të parkingjeve në qytet dhe të planifikohen parkingje shtesë për të ofruar hapësirë të mjaftueshme parkimi për veturat që kanë për destinim qendrën e qytetit.

Për momentin, parkingjet publike në qytetin e Shtërpcës janë në shërbim:

- me pagesë; dhe
- pa kufizime kohore gjatë qëndrimit në parkingje.

Është e rëndësishme të futen masa të kufizimit të kërkesave dhe të hulumtohen/iniciohen opsione të mëtejshme për zhvillim të ardhshëm, duke përfshirë rritjen e tarifave për parkim të automjeteve në rrugë dhe jashtë rrugës (parkingje), si dhe kufizimeve për qëndrim të gjatë në qendër të qytetit. Menaxhimi efektiv i kërkesave luan një rol kyç në këtë qasje për të ndihmuar menaxhimin e rritjes së vazhdueshme në nivelet e trafikut dhe për të inkurajuar njerëzit të marrin parasysh alternativa tjera dhe në këtë mënyrë të mbështesin opsione më të qëndrueshme të udhëtimit.

3.5.3. Rrjeti hekurudhor

Në territorin e Komunës së Shtërpcës nuk ekziston transporti hekurudhor. Stacioni më i afër hekurudhor është në Kaçanikun e Vjetër, rreth 20 km larg vendbanimit të Shtërpcës, linja hekurudhore Fushë Kosovë – Shkup. Mungesa e stacioneve hekurudhore dhe largësia e stacione ekzistuese këtë komunë e vendos në një pozitë mjaft të pafavorshme sa i përket transportit, që reflektohet në transportin masiv të mallrave dhe produkteve. Në kuadër të PZHK-së së Shtërpcës është paraparë një studim i fizibilitetit për restaurimin e sistemit hekurudhor në linjën Brod-Shtërpcë- Sevce.

3.5.4. Transporti ajror

Komuna e Shtërpcës nuk ka aeroport. Aeroporti më i afërt është aeroporti i Prishtinës – 61 km larg Shtërpcës.

3.5.4.1. Linjat transportuese ndër komunale e brenda komunës urbane dhe rurale

Komuna e Shtërpcës nuk ofron shërbime për transport publik urban. Transporti publik urban- periferik është pjesërisht funksional në komunën e Shtërpcës, duke ofruar lidhje të qendrës urbane me vendbanimet tjera. Organizimi i transportit publik në komunë bëhet nëpërmes minibusëve dhe taksive, kryesisht nga operatorët privat. Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim sidomos në drejtim të nën-qendrave dhe vendbanimeve përreth, me theks të veçantë në mbulimin e zonës perëndimore të komunës me transport publik.

Në kuadër të PZHK-së propozohet përmirësimi i transportit publik urbano- rural dhe sigurimi i transportit urban deri në zonat turistike Brezovicë dhe qendrën e re të skijimit.

Për rrugët të cilat janë kompetencë e nivelit komunal, Komuna e Shtërpcës duhet të caktojë pikat e ndaljes së transportit publik, kryesisht në vendet më të frekuentuara duke pasur parasysh kriteret e vendosjes së stacioneve dhe të sigurojë për to infrastrukturën e nevojshme.

3.5.5. Vlerësim i nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese

3.5.5.1. Vlerësimi i nevojave infrastrukturore për rrugët rajonale

Nga niveli qendror, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, është planifikuar lidhja e Komunës së Shtërpcës me Komunën e Suharekës përmes rrugës rajonale R118 me gjatësi 8 km.

3.5.5.2. Vlerësimi i nevojave infrastrukturore për rrugët lokale - urbane

Në zona të caktuara në brendi të lagjeve të Shtërpcës paraqiten vështirësi në operimin e trafikut për shkak të parametrave teknik të rrugëve të cilët rezultojnë të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesat për qarkullim të automjeteve.

Plani Zhvillimor Komunal nuk kufizon planifikimin, zgjerimin apo hapjen e rrugëve të reja, të cilat kanë për qëllim përmirësimin, funksionalizimin dhe sigurinë e rrjedhës së trafikut. Gjithashtu, për përzgjedhjen e tipit të udhëkryqit, paraprakisht duhet të bëhet analiza e lokacionit dhe fluksit të qarkullimit në hyrje. Në varësi të këtyre kushteve, duhet të caktohet tipi adekuat i udhëkryqit të trafikut (udhëkryq i rregulluar me rregulla të trafikut, udhëkryq i rregulluar me shenja të trafikut, udhëkryq i rregulluar me semafor, rrethrrotullim i trafikut apo udhëkryq me disnivel).

Përparësitë	Dobësitë
• **Lidhjet relativisht të mira me komunat përreth (Prizren, Ferizaj, Kaçanik);** • **Infrastruktura e re rrugore në segmente të veçanta të komunës (Gotovusha, Brodi, Firaja, Sevca, Brezovica);** • **Afërsia dhe mundësia e shfrytëzimit të rrjetit kryesor hekurudhor dhe dalje në Korridorin e X pan- evropian;** • **Lidhja relativisht e mirë dhe afërsia për qasje në autoudhën "Arbër Xhaferi" në pjesën lindore dhe**	• Rrugët rajonale komunale (R210 dhe R118) janë me akses të ngushtë dhe segmente të papërshtatshme, si dhe nuk krijojnë lidhje funksionale me rrugë të karakterit nacional; • Transport joadekuat dhe i pamjaftueshëm publik; • Mungesa e shtigjeve për biçikleta • Cilësia e pjesës më të madhe të infrastrukturës rrugore nuk përmbush kushtet e parapara. • Mungesa e infrastrukturës përcjellëse si: trotuaret, ndriçimi, sinjalizimi trafikut etj.

në autoudhën "Ibrahim Rugova" në pjesën jug perëndimore.	• Mungesa e hekurudhës.
Mundësitë	**Rreziqet**
• **Avancimi i sistemit të transportit publik** • **Projektet e reja të infrastrukturës siç janë: Ndërtimi i rrugës rajonale R118 dhe lidhja me Komunën e Suharekës;** • **Lidhja në rrjetin hekurudhor të Kosovës dhe korridore panevropiane përmes rrjetit hekurudhor (korridori i X-të);** • **Shfrytëzimi i fondeve për plotësim, rregullim dhe modernizim të infrastrukturës së transportit;** • **Rrugët alternative dhe lidhja funksionale e të gjitha vendbanimeve.**	• Investimet në infrastrukturën e transportit nuk janë integruar siç duhet në projektet e zhvillimit. Mungesa e ose pamjaftueshmëria e buxhetit komunal dhe granteve për realizimin e projekteve të parapara. • Shkallë e ulët e sigurisë në trafik si rezultat i mungesës së infrastrukturës adekuate të transportit.

Tabela 112 Analiza SWOT për Infrastrukturën e transportit dhe transporti

3.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

3.6.1. Shëndetësia

3.6.1.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 3,500 m² dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor, komuna nuk ka mungesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor.

	Numri aktual i banorëve	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	2,440	2,000	0.20	488	1,512
Zone Rurale	8,331	1,500	0.20	1,666	-166
Gjithsejtë	10,771	3,500	0.20	2,154	1,346

Tabela 113 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor për numrin aktual të banorëve

3.6.1.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas rrezeve të mbulueshmërisë

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale të rrezeve të mbulueshmërisë prej:

- 3km për AMF; dhe
- 1km për QMF.

Duke marrë parasysh shtrirjen ekzistuese të kujdesit parësor shëndetësor, territori është mirë i mbuluar me këto institucione dhe komuna nuk nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor.



*Harta 45 Mbulushmëria e territorit me institucione të nivelit parësor shëndetësor**

3.6.1.3. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 3,500 m² dhe normën minimale prej 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor, komuna ka nuk nevojë për të caktuar parcelave kadastrale shtesë për ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor.

	Numri i banorëve 2033	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	3,180	2,000	0.20	636	1,364
Zone Rurale	9,284	1,500	0.20	1,857	-357
Gjithsejtë	12,464	3,500	0.20	2,493	1,007

Tabela 114 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike shëndetësore të nivelit parësor për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.1.4. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe ato tre vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Shëndetësisë për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 238,607 nga granti qeveritar dhe € 4,030 nga të hyrat vetanake.

	2018-2020	**2021-2023**	**2024-2026**	**2027 -2029**

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

	Subvencione t dhe transferet	Investime kapitale	Subvencione t dhe transferet	Investime kapitale	Subvencione t dhe transferet	Investime kapitale	Subvencione t dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	877	61,257	1,000	56,257	1,050	59,070	1,103	62,023
Grantet qeveritare	-	61,257	-	56,257	-	59,070	-	62,023
Të hyrat vetanake	877	-	1,000	-	1,050	-	1,103	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 115 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Shëndetësisë

3.6.2. Arsimi

3.6.2.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.30 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike parashkollore. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, prej 1.30 m²/banor dhe sipërfaqen ekzistuese prej 1,500 m², komuna ka mungesë të parcelave kadastrale prej së paku 1,672 m² në zonë urbane dhe 10,830 m² në zonë rurale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike parashkollore.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	1,500	1.30	3,172	-1,672
Zone Rurale	8,331	0	1.30	10,830	-10,830
Gjithsejtë	10,771	1,500	1.30	14,002	-12,502

Tabela 116 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike parashkollore për numrin aktual të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.80 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulët. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen ekzistuese prej 43,228 m² për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, komuna ka mungesë të parcelave kadastrale prej së paku 3,832 m² për ofrimin e institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta në zonën urbane.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	3,000	2.80	6,832	-3,832
Zone Rurale	8,331	40,228	2.80	23,327	16,901
Gjithsejtë	10,771	43,228	2.80	30,159	13,069

Tabela 117 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta për numrin aktual të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave të mesme të larta. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen ekzistuese prej 7,100 m² për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave të mesme të larta, komuna ka mungesë të parcelave kadastrale prej së paku 6,731 m² për ofrimin e institucioneve publike të shkollave të mesme të larta në zonë rurale.

	Numri i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	5,500	1.00	2,440	3,060
Zone Rurale	8,331	1,600	1.00	8,331	-6,731
Gjithsejtë	10,771	7,100	1.00	10,771	-3,671

DRAFT

Tabela 118 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve të shkollave të mesme të larta për numrin aktual të banorëve

3.6.2.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas rrezeve të mbulueshmërisë

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale të rrezeve të mbulueshmërisë prej:

- 300m për çerdhe të fëmijëve; dhe
- 500 për kopshte të fëmijëve.

Duke marrë parasysh që aktualisht nuk ka asnjë institucion publik parashkollor, bazuar në shtrirjen e vendbanimeve të mëdha, komuna duhet të ndërtoj së paku:

- 3 institucione publike parashkollore në Shtërpcë;
- 1 institucion publik parashkollor në Brod; dhe
- 1 institucion publik parashkollor në Firajë;



*Harta 46 Nevojat për mbulueshmërinë e territorit me institucione publike parashkollore**

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale të rrezeve të mbulueshmërisë së institucioneve publike të shkollave fillore të mesme të ulëta prej:

- 600m për shkolla fillore të mesme të ulëta në zonë urbane; dhe
- 1,500m për shkolla fillore të mesme të ulëta në zonë rurale.

Duke marrë parasysh shtrirjen e institucioneve publike të shkollave publike fillore të mesme të ulëta, komuna nuk ka nevojë për të ndërtuar institucione të tilla shtesë.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



Harta 47 Mbulueshmëria e territorit me institucione publike të shkollave fillore të mesme të ulëta*

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale të rrezeve të mbulueshmërisë për institucione të shkollave të mesme të larta prej:

- 1,900m për shkolla të mesme të larta në zonë urbane; dhe
- 4,700m për shkolla të mesme të larta në zonë rurale.

Duke marrë parasysh shtrirjen e institucioneve publike të shkollave publike të mesme të larta, komuna nuk ka nevojë për ndërtuar institucione të tilla shtesë.

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit



*Harta 48 Mbulueshmëria e territorit me institucione publike të shkollave të mesme të larta**

3.6.2.3. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.30 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike parashkollore. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, dhe normën minimale prej 1.30 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike parashkollore, komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale prej së paku 2,634 m² në zonë urbane dhe 8,434 m² në zonë rurale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike parashkollore.

	Numri i banorëve 2033	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	3,180	1,500	1.30	4,134	-2,634
Zone Rurale	9,284	0	1.30	12,069	-12,069
Gjithsejtë	12,464	1,500	1.30	16,203	-14,703

Tabela 119 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike parashkollore për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.80 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore të mesme të ulëta. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 do të banojnë 12,464banorë rezidentë, shtrirjen e institucioneve ekzistuese publike të shkollave fillore të mesme të ulëta prej 43,228 m² dhe normën minimale prej 2.80 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore të mesme të ulëta,

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale prej 5,904 m² për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike të shkollave fillore të mesme të ulëta.

	Numri banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	3,180	3,000	2.80	8,904	-5,904
Zone Rurale	9,284	40,228	2.80	25,995	14,233
Gjithsejtë	12,464	43,228	2.80	34,899	8,329

Tabela 120 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave fillore të mesme të ultë për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të mesme të larta. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, shtrirjes së institucioneve ekzistuese publike të shkollave të mesme të larta prej 7,100 m² dhe normën minimale prej 1.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave mesme të larta, komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale prej 7,684 m² për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike të shkollave të mesme të larta në zonë rurale.

	Numri i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	3,180	5,500	1.00	3,180	2,320
Zone Rurale	9,284	1,600	1.00	9,284	-7,684
Gjithsejtë	12,464	7,100	1.00	12,464	-5,364

Tabela 121 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike të shkollave të mesme të larta për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.2.4. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe ato tre vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Arsimit për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është €1,060,055 nga granti qeveritar dhe € 4,476 nga financimi nga huamarrja.

	2018-2020		2021-2023		2024-2026		2027 -2029	
	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	-	130,909	-	296,153	-	310,961	-	326,509
Grantet qeveritare	-	126,433	-	296,153	-	310,961	-	326,509
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	4,476	-	-	-	-	-	-

Tabela 122 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Arsimit

3.6.3. Administrata

3.6.3.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 2,900 m² dhe normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative, komuna ka mungesë të parcelave kadastrale prej 3,765 m² në zonë rurale për ofrimin e shërbimeve administrative.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	1,500	0.62	1,513	-13
Zone Rurale	8,331	1,400	0.62	5,165	-3,765
Gjithsejtë	10,771	2,900	0.62	6,678	-3,778

Tabela 123 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative për numrin aktual të banorëve

3.6.3.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 2,900 m² dhe normën minimale prej 0.62 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative, komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale prej 4,356 m² për ofrimin e shërbimeve administrative në zonë rurale.

	Numri i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	3,180	1,500	0.62	1,972	-472
Zone Rurale	9,284	1,400	0.62	5,756	-4,356
Gjithsejtë	12,464	2,900	0.62	7,728	-4,828

Tabela 124 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike administrative për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.3.3. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe tre ato vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Administratës dhe Mirëqenies Sociale për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 619,809 nga granti qeveritar.

	2018-2020		2021-2023		2024-2026		2027 -2029	
	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	-	265,913	-	112,259	-	117,872	-	123,766
Grantet qeveritare	-	265,913	-	112,259	-	117,872	-	123,766
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 125 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës dhe Mirëqenies So

3.6.4. Infrastruktura e institucioneve kulturore

3.6.4.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej:

- 0.25 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së bibliotekave; dhe
- 0.20 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së teatrove

Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 4,800 m² dhe normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike kulturore, komuna nuk mungesë të sipërfaqes të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve kulturore.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	1,000	0.45	1,098	-98
Zone Rurale	8,331	3,800	0.45	3,749	51
Gjithsejtë	10,771	4,800	0.45	4,847	-47

Tabela 126 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike . për numrin aktual të banorëve

3.6.4.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike kulturore. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 2,900 m² dhe normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike kulturore, komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale prej për ofrimin e shërbimeve kulturore.

	Numri banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	3,180	1,000	0.45	1,431	-431
Zone Rurale	9,284	3,800	0.45	4,178	-378
Gjithsejtë	12,464	4,800	0.45	5,609	-809

Tabela 127 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike kulturore për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.4.3. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe ato tre vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë së Kulturës për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 0.

	2018-2020		2021-2023		2024-2026		2027 -2029	
	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale	Subvencionet dhe transferet	Investime kapitale
Gjithsej	-	0	-	0	-	0	-	0
Grantet qeveritare	-	0	-	0	-	0	-	0
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 128 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë së Kulturës

3.6.5. Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative

3.6.5.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale për infrastrukturë të institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative prej:

- 2.50 m²/banor për vendbanime me ≤ 5000 banorë;
- 4.50 m²/banor për vendbanime me 5001- 20000 banorë; dhe
- 5.00 m²/banor për vendbanime me > 20001 banorë.

Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, dhe që nuk ka asnjë vendbanim me mbi 5,000 banorë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 12,400 m² dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe

hapësirave rekreative komuna ka mungesë të së paku 8,062 m² në zonë rurale për ofrimin e infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative në zona rurale.

	Numri aktual i banorëve	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	2,440	3,800	2	4,880	-1,080
Zone Rurale	8,331	8,600	2	16,662	-8,062
Gjithsejtë	10,771	12,400	2	21,542	-9,142

Tabela 129 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative për numrin aktual të banorëve

3.6.5.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 12,400 m² dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe së infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative, komuna ka nevojë për të caktuar së paku 2,560 m² në zonë urbane dhe 9,968 m² në zonë rurale për ofrimin e infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative në zona rurale.

	Numri i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)	Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)
Zone Urbane	3,180	3,800	2	6,360	-2,560
Zone Rurale	9,284	8,600	2	18,568	-9,968
Gjithsejtë	12,464	12,400	2	24,928	-12,528

Tabela 130 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.5.3. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas rrezeve të mbulueshmërisë

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale të rrezeve të mbulueshmërisë prej 800m për fushat sportive dhe rekreative.

Duke marrë parasysh që aktualisht nuk ka asnjë fushë sportive dhe rekreative në vendbanime të mesme, bazuar në shtrirjen e vendbanimeve të mëdha, komuna duhet të ndërtojë së paku:

- 1 fushë sportive dhe rekreative në Brod; dhe
- 1 fushë sportive dhe rekreative në Firajë;

DRAFT



*Harta 49 Shtrirja e institucioneve publike infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative**

3.6.5.4. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe ato tre vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë përgjegjëse për Sport për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 0.

	2018-2020		2021-2023		2024-2026		2027 -2029	
	Subvencionet dhe transferet	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**
Gjithsej	-	0	-	0	-	0	-	0
Grantet qeveritare	-	0	-	0	-	0	-	0
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 131 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë përgjegjëse për Sport

* Për lexueshmëri të qartë të hartës, hapni hartën digjitale të dorëzuar në aneksin – Pjesa Hartografike/Hartat e Profilit

3.6.6. Infrastruktura e hapësirave të hapura publike

3.6.6.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale për infrastrukturë të hapësirave të hapura publike prej:

- 1.00 m²/banor parqet publike në kuadër të lagjes;
- 2.00 m²/banor për parqet publike në kuadër të vendbanimit;
- 1.00 m²/banor brezat e gjelbër përgjatë rrugëve; dhe
- 2.00 m²/brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore.

Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 3,300 m² dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike, komuna ka mungesë të së paku 15,362 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale në zonë rurale për ofrimin e infrastrukturës së hapësirave të hapura publike.

	Numri aktual i banorëve	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	2,440	2,000	2	4,880	-2,880
Zone Rurale	8,331	1,300	2	16,662	-15,362
Gjithsejtë	10,771	3,300	2	21,542	-18,242

Tabela 132 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin aktual të banorëve

3.6.6.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 2,900 m² dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike, komuna ka nevojë për të caktuar së paku 4,360 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale në zonë urbane dhe 17,268 m² në zonë rurale për ofrimin e infrastrukturës së hapësirave të hapura publike në zona rurale.

	Numri aktual i 2033	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	3,180	2,000	2	6,360	-4,360
Zone Rurale	9,284	1,300	2	18,568	-17,268
Gjithsejtë	12,464	3,300	2	24,928	-21,628

Tabela 133 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së hapësirave të hapura publike për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.6.3. Vlerësimi i kapacitetit financiar dhe teknik

Bazuar në trendin e fondeve të alokuara nga buxheti qendror apo komunal për tre vjetët paraprakë dhe ato tre vijueset, në rast se nuk ka ndryshime të theksuara në vija buxhetore, rezulton që kapaciteti i përgjithshëm financiar i Drejtorisë përgjegjëse për Hapësira Publike për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2021-2029 është € 619,809 nga grantet qeveritare.

	2018-2020		**2021-2023**		**2024-2026**		**2027 -2029**	
	Subvencionet dhe transferet	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**	**Subvencionet dhe transferet**	**Investime kapitale**
Gjithsej	-	265,913	-	112,259	-	117,872	-	123,766
Grantet qeveritare	-	265,913	-	112,259	-	117,872	-	123,766
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-	-
Financim i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 134 Vlerësimi i kapaciteteve financiare (€) për investime kapitale të Drejtorisë përgjegjëse për Hapësira Publike

3.6.7. Infrastruktura e varrezave publike

3.6.7.1. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të banorëve

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale për infrastrukturë të varrezave publike prej 1.50 m²/banor. Duke marrë parasysh supozimin që aktualisht numri i banorëve rezidentë në Komunë të Shtërpcës është 10,771, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 34,170 m² dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave publike, komuna nuk ka mungesë të sipërfaqeve shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së varrezave publike.

	Numri aktual i banorëve	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	2,440	8,700	1.5	3,660	5,040
Zone Rurale	8,331	25,470	1.5	12,497	12,974
Gjithsejtë	10,771	34,170	1.5	16,157	18,014

Tabela 135 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave publike për numrin aktual të banorëve

3.6.7.2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese sipas numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2033

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave publike. Duke marrë parasysh supozimin që në Komunë të Shtërpcës vlerësohet se në vitin 2033 se do të banojnë 12,464 banorë rezidentë, sipërfaqen aktuale të parcelave kadastrale prej 34,170 m² dhe normën minimale prej 1.50 m²/banor për sipërfaqe së infrastrukturës së varrezave publike, komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së varrezave publike.

	Numri i banorëve 2033	**Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)**	**Sipërfaqja e kërkuar për kokë banori (m²)**	**Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet (m²)**	**Bilanci i sipërfaqes së nevojshme (m²)**
Zone Urbane	3,180	8,700	1.5	4,770	3,930
Zone Rurale	9,284	25,470	1.5	13,926	11,544
Gjithsejtë	12,464	34,170	1.5	18,696	15,474

Tabela 136 Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së varrezave publike për numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033

3.6.7.3. Vlerësimi i kapaciteteve aktuale

Bazuar në përqindjen e hapësirave të lira për varreza publike, rezulton që Komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë për varreza publike.

Vendbanimet #	**Lokacioni**	**Siperfaqja e parceles (ha)**	**Siperfaqja e ndertuar (ha)**	**Siperfaqja e lire (ha)**	**Përqindja e sipërfaqes së lirë**
Bitija e Epërme	Varreza Muslimane	0.08	0.008	0.072	90%
Brod	Varreza Muslimane	1.7	0.34	1.36	80%
Drajkoc	Varreza Muslimane	0.08	0.016	0.064	80%
Kushtanjevë	Varreza Muslimane	0.06	0.012	0.048	80%
Viçë	Varreza Muslimane	0.3	0.03	0.27	90%
Drajkoc	Varreza Muslimane	0.5	0.1	0.4	80%
Drajkoc	Varreza Muslimane	0.1	0.07	0.03	30%
Bitija e Epërme	Varreza Muslimane	0.06	0.006	0.054	90%
Bitija e Epërme	Varreza Ortodokse	0.8	0.24	0.56	70%
Berofcë	Varreza Ortodokse	0.4	0.24	0.16	40%
Drajkoc	Varreza Ortodokse	0.8	0.16	0.64	80%
Jazhincë	Varreza Ortodokse	1.25	0.375	0.875	70%
Gotovushë	Varreza Ortodokse	0.5	0.1	0.4	80%
Gotovushë	Varreza Ortodokse	16	14.4	1.6	10%

Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.7	0.63	0.07	10%
Sevcë	Varreza Ortodokse	0.75	0.075	0.675	90%
Viçë	Varreza Ortodokse	0.65	0.13	0.52	80%
Bitijë e Poshtme	Varreza Ortodokse	0.22	0.044	0.176	80%
Vërbashicë	Varreza Ortodokse	0.15	0.06	0.09	60%
Vërbashicë	Varreza Ortodokse	0.2	0.1	0.1	50%
Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.07	0.021	0.049	80%
Shtërpcë	Varreza Ortodokse	0.8	0.48	0.32	70%

Tabela 137 Vlerësimi i hapësirave të lira brenda varrezave ekzistuese publike

3.6.8. Sfidat kryesore të infrastrukturës publike dhe sociale

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të infrastrukturës sociale janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e tokës në pronësi komunale në zonën urbane;
- Mungesa e buxhetit komunal për shpronësimin e tokave me çmim të lartë në zonë urbane;
- Ndërlidhje jo e volitshme e Arsimit për Aftësimin Profesional me kërkesat e tregut të punës;
- Mungesa e kushteve për kryerjen e punës praktike nëpër shkolla (punëtoritë, laboratorët, rrjeti i teknologjisë informative);
- Buxheti i kufizuar për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore;
- Sigurimi i hapësirave-kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale;
- Grumbullimi i objekteve administrative në një vend;
- Akomodimi i kërkesave për strehim për persona të riatdhesuar;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për asistencë sociale;
- Ofrimi i politikave lokale për programe të banimit social të integruar;
- Zbutja e varfërisë dhe papunësisë;
- Ndërtimi i objekteve të reja të kulturës, artit, sportit e rekreacionit dhe përmirësimi i qasjes në këto objekte për të gjithë banorët e Komunës së Shtërpcës;
- Mirëmbajtja adekuate e objekteve të artit, sportit, kulturës, rekreacionit, komunitetit në nënqendra;
- Sigurimi i hapësirave të reja publike për nënqendrat dhe për zonën urbane, si dhe standardizimi i mirëmbajtjes;
- Mirëmbajtja e objekteve fetare dhe objekteve përcjellëse;

3.6.9. Gjetje kyçe dhe supozime të pranuara

Në vijim është paraqitur vlerësimi i nevojave për të ardhmen, për institucione publike dhe sociale, bazuar në numrin e prognozuar të banorëve rezidentë, kërkesën minimale të NTPH dhe rrezeve të mbulueshmërisë, infrastrukturën ekzistuese dhe të planifikuar dhe numrin e prognozuar të banorëve:

- komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor;
- komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike parashkollore.
- komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.
- komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike të shkollave të mesme të larta.
- komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve administrative.
- komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve kulturore.
- komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative në zona rurale.
- komuna ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së hapësirave të hapura publike në zona rurale.
- komuna nuk ka nevojë për të caktuar sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së varrezave publike.

3.6.10. Identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore

Duke marrë parasysh infrastrukturën ekzistuese, komuna ka nevojë të përcaktojë:

- 8,434 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve të institucioneve publike parashkollore, 1 në Brod dhe 1 në Firajë.
- 2,900 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e shërbimeve administrative në zonë ruale.
- 4,376 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së institucioneve publike sportive dhe hapësirave rekreative në zona rurale.
- 11,676 m² sipërfaqe shtesë të parcelave kadastrale për ofrimin e infrastrukturës së hapësirave të hapura publike në zonë rurale.

Përparësitë	**Dobësitë**
▪ Mbulueshmëri e mirë me infrastrukturë të institucioneve publike të kujdesit parësor shëndetësor; ▪ Mbulueshmëri e mirë me infrastrukturë të institucioneve publike të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta; ▪ Mbulueshmëri e mirë me infrastrukturë të institucioneve publike të shkollave të mesme të larta; ▪ Mbulueshmëri e mirë me infrastrukturë të institucioneve kulturore; ▪ Mbulueshmëri e mirë me infrastrukturë të varrezave publike.	▪ Numri i pamjaftueshëm dhe shkalla e ulët e përfshirjes së fëmijëve në institucione parashkollore; ▪ Hapësira e pamjaftueshme në disa prej shkollave të mesme të larta; ▪ Numri i vogël i studentëve të orientuar në drejtimet me rëndësi për zhvillimin e komunës, si turizëm, hotelieri, agrobiznes; ▪ Siguria e pamjaftueshme e nxënësve në shkolla; ▪ Mungesa e Spitalit Rajonal; ▪ Mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në disa fshatra; ▪ Degradimi i objekteve jofunksionale të disa AMF-ve; ▪ Degradimi i objekteve jofunksionale të AMF-ve; ▪ Mungesa e shtëpisë për të moshuar që plotëson nevojat aktuale; ▪ Hapësira e pamjaftueshme e QPS për shërbimet e kërkuara; ▪ Numri i madh i kërkesave në raport me numrin e përfituesve të asistencës; ▪ Mungesa e kodit të veçantë buxhetor për rastet sociale; ▪ Mungesa e objekteve kulturore sidomos nëpër fshatra; ▪ Mungesa e objekteve dhe terreneve sportive nëpër fshatra; ▪ Mungesa e hapësirave të mjaftueshme për varreza në qytet dhe në disa fshatra; ▪ Mungesa e hapësirave për Zyrat e Gjendjes Civile.
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ Ndërtimi i 1 institucioni parashkollor publik në zonë urbane; ▪ Ndërtimi i 1 institucioni parashkollor publik në zonë rurale; ▪ Ndërtimi i 10 fushave sportive rekreative në zonë rurale; ▪ Ndërtimi i 2 zyrave të gjendjes civile në zonë rurale;	▪ Mos përfshirja e të gjithë nxënësve nëpër shkolla, ▪ Prezenca e dukurive negative nëpër shkolla; ▪ Zvogëlimi i nxënësve në zonat rurale dhe rritja e numrit të nxënësve në zonën urbane; ▪ Rritja e trendit të braktisjes së shkollimit; ▪ Ndërlidhja e pamjaftueshme e kurrikulave mësimore me kërkesat e tregut të punës;

DRAFT

▪ Ndërtimi i 6 hapësirave të hapura publike. ▪ Ndërtimi i 3 librarive publike; ▪ Sigurimi i hapësirave plotësuese në shkolla fillore; ▪ Funksionalizimi i ekipeve për parandalimin e braktisjes së shkollës (EPRMB); ▪ Granti specifik nga MASHT për sigurimin e asistentëve profesionalë për fëmijët me nevoja të veçanta; ▪ Zhvillimi profesional i mëtejmë i mësimdhënësve; ▪ Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore; ▪ Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe rehabilitimi i objekteve ekzistuese; ▪ Ndërtimi i kapaciteteve të reja për strehim social (Programi i banimit social); ▪ Krijimi i më shumë hapësirave të hapura publike; ▪ Shfrytëzimi i fushave sportive në kuadër të shkollave për përdorim nga komuniteti; ▪ Krijimi i hapësirave të reja për varreza; ▪ Implementimi i komponentës SMART.	▪ Mungesa e të rinjve të interesuar për t'u regjistruar në programet e përpunimit të metaleve dhe përpunimit të drurit; ▪ Buxheti i kufizuar për zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale; ▪ Largimi i kuadrit profesional nga institucionet dhe komuna; ▪ Kërcënimet ekonomike (kriza globale financiare) kostot në rritje të kujdesit shëndetësor; ▪ Rritja e numrit të shfrytëzuesve të asistencës sociale për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik dhe rritjes së papunësisë; ▪ Rritja e shkallës së varfërisë; ▪ Rritja e numrit të moshuarve në kategorinë e rasteve sociale; ▪ Mungesa e fondeve të nivelit qendror për të paguar punëtorë shtesë në institucionet publike dhe sociale; ▪ Mungesa e partneriteteve publiko private si alternative e qëndrueshme për aktivitete dhe infrastrukturë sportive, kulturë, por edhe shkencë në komunë; ▪ Mungesa e një qendre rinore, hapësirë e funksionalizuar për zhvillimin e veprimit të të rinjve, e licencuar nga drejtoria komunale përgjegjëse për rini; ▪ Rritja e delikuencës dhe ekstremizmit tek të rinjtë si pasojë e mungesë e hapësirave të pamjaftueshme kulturore dhe rekreative; ▪ Shtimi i dukuritë devijante, me theks tek popullata e re, sidomos në zonën urbane; ▪ Dalja jashtë kontrollit e rasteve në gjendje sociale dhe varfëri të skajshme për shkak të thellimit të mëtejmë i krizës ekonomike; ▪ Ndërrimi i strukturës së popullsisë, për shkak të ikjes së popullatës së re jashtë vendit; ▪ Ikja e popullsisë së aftë për punë dhe ekspertëve jashtë vendit.

Tabela 138 SWOT Analiza - Infrastruktura Publike dhe Sociale

3.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Gjendja e përgjithshme mjedisore e Shtërpcës nuk dallon shumë nga gjendja e përgjithshme e mjedisit në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo afër zonave industriale. Qasja ende jo e plotë në furnizim me ujë të pijshëm dhe shërbime sanitare, mostrajtimi i ujërave sanitare urbane apo industriale, problemet me menaxhimin e mbeturinave, ndotja e ajrit, zhurma, prezenca e antenave të telefonisë mobile, gjelbërimi i pamjaftueshëm në qytet dhe e vende të limituara për pushim e rekreacion, janë disa indikatorë që tregojnë cilësinë e mjedisit dhe që kërkojnë veprime konkrete për përmirësimin e tyre.

3.7.1. Ndotja e ajrit

Qytetin e Shtërpcës e karakterizon një trafik mjaftë i dendur, me numër të madh makinash brenda ditës që qarkullojnë nëpër qytet. Mungesa e vendeve të mjaftueshme për parkim, makina të vjetra dhe dendësia e qarkullimit drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen e madhe të ajrit dhe ndikim në shëndetin e popullatës.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave individuale gjatë sezonit të dimrit të cilat nuk janë të lidhura me ngrohjen e qytetit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Mos mbulueshmëria me ngrohje qendrore të qytetit ka shtuar përdorimin e rrymës elektrike dhe lëndëve tjera për ngrohje që rëndojnë situatën mjedisore në qytet. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është ende i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësim të izolimeve të objekteve ekzistuese apo objektet e reja të banimit pritet të japin efektet pozitive në zvogëlimin e përdorimit të energjisë për ngrohje.

Në zonën urbane të Komunës së Shtërpcës nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika në qytet. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plot i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

Burimet kryesore të ndotjes janë:

- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO_2 dhe NOx, si rezultat i trafikut dhe ngrohjes sezonale ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit në qytet por edhe në gjithë hapësirën e Komunës së Shtërpcës;
- Lirimi i gazrave serë (CO_2, SO_2, NOx) nga djegia e mbeturinave nëpër kontejner apo jashtë tyre dhe aktivitete të operatorëve ekonomik brenda dhe jashtë qytetit;[35]
- Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshme të tyre dhe të parkingjeve që kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet.
- Për stacionin në Brezovicë, gjatë periudhës 2019-2022 nuk paraqiten tejkalime të vlerave kufi për ndotësit e ajrit, kjo duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me stacion matës në mjedis rural. Ozoni paraqitet me vlera më të larta, të cilat edhe pse nuk përbëjnë rrezik në nivelet që paraqiten, prapë vlerat shtrihen kryesisht në të njëjtat vlera ndër vite, me shumë pak ndryshime. Vlerësojmë se me përqendrimet nën vlerat limite, cilësia e ajrit konsiderohet të jetë brenda intervaleve të pranueshme.

3.7.2. Ndotja e ujit

Bazuar në analizën e cilësisë, resurseve dhe burimeve të ujit në qytetin e Shtërpcës, u konstatua se preokupimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë së tyre. Parashikohet zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve ujore për përmbushjen e nevojave të sotme dhe të ardhshme. Prandaj është paraparë si në vijim:

- Të gjitha burimet e ujit natyral, termal dhe termal-mineral dhe ujërat e tjerë nëntokësor dhe sipërfaqësor të mbrohen siç mund të shihet në hartën hidrologjike të Shtërpcës, me përcaktimin e zonës së mbrojtjes së detyrueshme rreth burimeve, ujëmbledhësve, rrjedhave të ujit dhe akumulimi, nën një regjim të mbrojtjes së caktuar, në varësi të përdorimit të objektit. Në këto zona nuk duhet të ndërtohen objekte dhe të kryhen punë të tjera, ose të shfrytëzohet toka në një mënyrë që rrezikon sasinë dhe cilësinë e ujit;
- Ndërmarrja e masave për ndalimin e ndotjes së ujit, ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor nga ujërat e zeza, me rekomandim të trajtimit te dalja me gropa septike dhe forma tjera, me instalimin e aparateve për pastrim;
- Në të ardhmen është e nevojshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjata në mënyre që ujërat e zeza (urbane, industriale) para se të shkarkohen, të pastrohen në aspektin fizik, biologjik dhe kimik.
- Për këtë qëllim është e nevojshme siç vijon: - Dokumentacioni teknik i investimit për industri të reja duhet të përmbajnë vendimin për pastrimin e të gjitha ujërave të zeza; - Puna e objekteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa instalim paraprak të pajisjeve që do të sigurojnë pastrimin e ujit te ndotur në mënyrë adekuate. Nevojat e popullsisë për ujë janë në rritje të vazhdueshme. Në të ardhmen, sigurimi i ujit te pijshme e të shëndetshëm për banorët e këtij qyteti do të jetë një problem serioz. Me këtë dokument janë paraparë disa zgjidhje. Për sigurimin e sasisë së parashikuar të ujit dhe sasisë shtesë rezervë, është e nevojshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave te lumit dhe akumulimi. Përveç kësaj, përdorimi racional i ujit në këtë qytet është një detyrë e rëndësishme për të gjithë faktorët e planifikimit dhe përdorimin e ujit dhe hapësirës si në vijim:
- Parashihet mbrojtja e veçantë e burimeve (Dy lumenjtë);
- Masat e veçanta të mbrojtjes duhet të përfshijnë edhe përdorimin e pakontrolluar të plehrave artificial për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfori dhe nitrientet tjera);

[35] PLVM, PLVM

- Mbrojtja tjetër parashihet edhe nga llojet e mbeturinave, duke planifikuar deponi të cilat janë të organizuara dhe që marrin parasysh këtë faktor deri të planifikimi i vendeve për grupim.

Megjithatë, në kohët e sotme, si mbledhës të ujërave të përdorura, shumë pak mund të ruajnë veçoritë e veta natyrore. Ata gjithnjë e më shumë maten me materie organike dhe joorganike që vijnë nga vendbanimet, materialet e depozituara dhe mbeturinat e shumta. Duhet theksuar së industria nuk është e zhvilluar dhe se nuk ekzistojnë ujëra industrial që do të ndikonin në ndotjen e ujit. Sasitë e mëdha të ujërave të ndotur që drejtpërdrejtë derdhen në lumenj me përmbajtjen e tyre fizike dhe kimike në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në ndryshimin e cilësisë së ujit, dhe ashtu ndikojnë në ekuilibrin natyral të lumit. Falë sasive të mëdha të ujërave që kanë mbledhësit e përmbajtjeve të kanaleve, ato mund t'i pranojnë këto përmbajtje pa ndonjë rrezik të madh. Sasitë e mëdha të ujërave nga mbledhësit duke kaluar me shpejtësi të madhe mbi gurët e shumtë në rrugë mjaft të shkurta të rrjedhës me vetë-pastrim ruajnë dhe mirëmbajnë përmbajtjet e tyre themelore.

Kushtet natyrore për përdorimin e fuqisë së ujit të lumit Lepenc dhe degëve të tij në rrethin e qytetit të Shtërpcës mund të klasifikohen në pellgjet më produktive. Duke u nisur nga këto fakte, ne mund të shqyrtojmë ndërtimin e hidrocentralit të vogël. Ndërtimi i digës dhe hidrocentralit do të ishte alternativë e energjisë së qëndrueshme në të ardhmen. Për të iu qasur projektimit dhe ndërtimit të hidrocentralit duhet harmonizuar hulumtimet studimore, në mënyrë që të analizohen parametrat hidrologjik, urban, ekologjik dhe tekno-ekonomik e cilësisë së ujit, dhe ashtu ndikojnë në ekuilibrin natyral të lumit. Falë sasive të mëdha të ujërave që kanë mbledhësit e përmbajtjeve të kanaleve, ato mund t'i pranojnë këto përmbajtje pa ndonjë rrezik të madh. Sasitë e mëdha të ujërave nga mbledhësit duke kaluar me shpejtësi të madhe mbi gurët e shumtë në rrugë mjaft të shkurta të rrjedhës me vetë-pastrim ruajnë dhe mirëmbajnë përmbajtjet e tyre themelore.

Kushtet natyrore për përdorimin e fuqisë së ujit të lumit Lepenc dhe degëve të tij në rrethin e qytetit të Shtërpcës mund të klasifikohen në pellgjet më produktive. Duke u nisur nga këto fakte, ne mund të shqyrtojmë ndërtimin e hidrocentralit të vogël. Ndërtimi i digës dhe hidrocentralit do të ishte alternativë e energjisë së qëndrueshme në të ardhmen. Për të iu qasur projektimit dhe ndërtimit të hidrocentralit duhet harmonizuar hulumtimet studimore, në mënyrë që të analizohen parametrat hidrologjik, urban, ekologjik dhe tekno-ekonomik.

3.7.3. Ndotja e tokës

Administrimi efikas i tokës, rritja e madhësisë se fermës përmes rregullimit të tokës, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi i mëtejshëm, mbrojtja e mjedisit dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm është një sfidë e madhe jo vetëm për Shtërpcën. Gjatë viteve të fundit, është arritur një përparim i madh, megjithatë degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane si rrjedhojë e zgjerimit të pa kontrolluar urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimet në burimet natyrore janë vetëm disa nga problemet qe duhet trajtuar për një menaxhim të mirë të këtij resursi jetik të ardhmen. Si çdo resurs tjetër natyror edhe toka duhet trajtuar seriozisht dhe në mënyrë të integruar për një zhvillim të qëndrueshëm. Trajtimi i integruar kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore ne një mënyrë të përforcuar reciprokisht.

Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, dhe qojnë në një rritje te madhe të kostos se përgjithshme te zhvillimit ekonomik.

Për shkak të këtij spektri të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenti i tokës nuk është konsideruar si i izoluar, prandaj në fazën e analizës i është dhëëe vëmendje e veçantë, dhe për shkak të kësaj parashikohet:

- Mbrojtjen e fizike dhe cilësore e tokës;
- Përveç mbrojtjes së ajrit dhe të ujit – ne parashikojmë futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për sigurimin e "lidhjeve të humbura" për mbrojtjen e mjedisit;
- Parashikohet mbrojtja në drejtim të sipërfaqes së tokës dhe burimeve të tokës nga tjetërsimi për qëllime jo-bujqësore me kufizimin e përhapjes së ndërtimit e ndërtimit brenda grandit te planifikuar ndërtimor (harta: "konceptet e zhvillimit të vendbanimit");
- Të sigurohet prodhimi i rregullt dhe i sigurt me qëllim të mbrojtjes së popullit, bimëve, faunës dhe mjedisit, parashikohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja, përmes mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndotja, me kufizimin dhe parandalimin e ndotjes prej transportit të drejtpërdrejtë, transportin e substancave te dëmshme përmes ujit dhe ajrit dhe ndërmarrjen e masave për ruajtjen dhe përmirësimin e pjellshmërisë;

- Planifikohet ndalimi i shkarkimeve të substancave të dëmshme dhe të rrezikshme që dobësojnë dhe ndryshojnë aftësitë produktive të tokës bujqësore dhe cilësinë e të mbjellave dhe përdorimit të gabueshëm të mineraleve, plehrave organike dhe pesticideve për ruajtjen e bimëve;
- Planifikohen monitorimet në mënyrë të përhershme dhe kontrolli i pjellshmërisë të tokës bujqësore;
- Me plan parashihet realizimi i fazës së dytë dhe të tretë të rregullimit të tokës bujqësore (masa të komasacionit: rregullimi i territorit të tokës për të krijuar parcela të mëdha dhe të rregullta në mënyrë që të sigurohet përpunim ekonomik i tokës dhe të krijohen kushtet e favorshme për zhvillimin e vendbanimeve me karakter bujqësor, rregullimi i kufijve në mënyrë që të krijohen parcela të reja me forma të reja dhe për t'u përfshirë në sistemin e hidromeliorimit deri te të dhënat kadastrale dhe ridefinimi i pronës së parcelave me përdorimin e mjeteve ligjore të burimeve ligjore – komasacioni.
- Parashihet ujitja e tokës bujqësore dhe masave tjera për rritjen e shkallës së bonitetit të tokës që ka shkallë më të ulët të bonitetit;
- Parashihet mbrojtja nga vërshimet me rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe përrenjve (shih hartën vërshimet dhe erozioni) te toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për ruajtjen dhe rritjen e shkallës së bonitetit;
- Parashihet që në zonat që janë me destinime tjera (përveç banimit dhe ndërtimit të përkohshëm) të zbatohen projekte për rikultivimin e tokës bujqësore;
- Parashihet që mbrojtja nga erozioni dhe kullimi i elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimi dhe përmirësimit të zonave të degraduara;
- Parashihet mbrojtja nga degradimi fizik dhe nga ndikimet e njeriut;
- Parashihet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, nëpërmjet lëvizjes së bimëve në tokat bujqësore dhe kthimin e materieve organike (mos djegia e kashtës ose mbetjet bimore);
- Parashikohet zhvillimi i sërishëm i tokës në zona të mbuluara me deponi te egra.

3.7.4. Ndotja nga zhurma

Në Planin Zhvillimor të Komunës janë planifikuar zonat e mbrojtura nga zhurma. Në këto zona nuk do të lejohet ndërtimi dhe lejimi i aktiviteteve të subjekteve afariste që shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara me ligj.

- Nevojat e zhvillimit:
- Kompletimi i kuadrit ligjor dhe harmonizimi i tij me normat ndërkombëtare,
- Rehabilitim i zonave ekzistuese nga zhurma,
- Zvogëlimi i zhurmës në zonat urbane
- Zvogëlimi i zhurmës nga automjetet dhe gjeneratorët
- Zhvillimi i sistemeve për monitorimin, ndërtimi i hartave te zhurmës zhvillimi i normave efikase dhe ekologjikisht normale.

3.7.5. Biodiversiteti

Zona urbane e Shtërpcës nuk është e mbuluar me gjelbërim; kryesisht këto janë sheshet, derisa zonën kadastrave e krijojnë një numër i kërkesave të komunitetit të bimëve të ndryshme, pamjes dhe kërkesave mjedisore. Lartësia e madhe e këtij masivi ka ndikuar në shfaqjen e rripave të caktuar të vegjetacionit. Rripin më të ulët të masivit e krijojnë pyjet termofile, shkurret dhe kaçubat, ndërsa rripin më të lartë e mbulojnë shkurret dhe bimët barishtore frigorifile të maleve të larta që dendëson majat dhe vargjet e maleve. Në ultësira dhe rrëzë kodrave nga pjesa e dukagjinit e deri tek pjesa e Kaçanikut të masivit të Sharrit, si dhe në grykat e shkëmbinjve gëlqeror ku depërtojnë ndikimet nga Mesdheu i ngrohtë, sipërfaqen më të madhe e zënë pyjet termofile gjetherënëse, shkurret dhe kaçubet, shkoza e zezë, hiri i zi, murrizi, dardha e egër, trëndafilat e egër, lajthia turke, lajthit e zakonshme, frutat e maleve, qarri, bungu dhe jargavani.

- Pasi që Shtërpca është e pasur me lloje të ndryshme bimore dhe shtazore, duhet një kontroll i shfrytëzimit të bimëve dhe gjuetisë, sidomos llojeve endemike dhe specieve të rrezikuara për të parandaluar shkatërrimin e tyre.
- Në mënyrë që të ruhen disa lloje të kafshëve në lumenjtë që rrjedhin në Shtërpcë, nevojitet një pastrim nga mbeturinat dhe ujërat e zeza. Në pyje ka nevojë për të kryer mbikëqyrjen e vendeve ku ka specie të rralla të kafshëve.

- Për të mbrojtur speciet bimore kërkohet identifikimi i zonave të ndjeshme, bashkë me ruajtjen e disa llojeve mjekësore që kërcënohen me shkatërrim. Është gjithashtu e nevojshme të bëhet deklarimi i zonave të mbrojtura, peizazheve dhe pemëve që kanë rendësi shkencore, mjedisore, kulturore, historike dhe të tjera.

Pas hulumtimeve të kryera të fitodiversitetit të Shtërpcës, parashihet që disa lloje të ruhen dhe konservohen pasi është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë shumë të pasura dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor. Sa i përket shumëllojshmërisë së kafshëve, sipas të dhënave të IKMN4 , dhe analizave të ekipeve punuese, territori i qytetit të Shtërpcës është i pasur me shtazë të egra ndër të cilat ka shumë lloje që konsiderohen si lloje të rrezikuara dhe në këtë drejtim parashikohet një zonë mbrojtëse ku këto kafshë jetojnë dhe veprojnë, por dhe mbrojtjen e tyre si lloje të veçanta. Në fushën e biodiversitetit janë parashikuar projekte të përbashkëta me komunat tjera dhe shtetin fqinj të Maqedonisë, për mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut kombëtar Malet e Sharrit. Parashikohet një listë e florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës me treguesit se çfarë duhet të mbrohet dhe çfarë mund të përdoret. Brenda parkut kombëtar janë të parashikuara rezervatet natyrore; parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për të parandaluar shkatërrimin e habitatit të bimëve dhe shumë lloje të kafshëve në territorin e Shtërpcës. Duke konsideruar si të rëndësishme ruajtjen e habitatit të fluturave, shpezëve dhe shpezëve mishngrënës etj. paraqitur në hartën e biodiversitetit

Analiza SWOT për Mjedisin

Përparësitë	**Dobësitë**
• Pozita e favorshme gjeografike-kufitare që mund të nxisë projekte të donatorëve të huaj në fushën e mjedisit • Peizazh atraktiv rural • Tokë pjellore dhe kushte të mira për bujqësi • Trashëgimia e pasur (kulturore historike dhe natyrore); • Male të pasura me pasuri natyrore dhe nëntokësore • Mungesa e industrive ndotëse në zonat rurale • Parku Kombëtar dhe zonat tjera të mbrojtura me ligj • Resurse të mjaftueshme të ujit • Territori i komunës së Shtërpcës me diversitet të pasur biologjik; • Hapësirat e lira përgjatë lumenjve • Zonat e mëdha të pyllëzuara të komunës; • Kushtet e mira klimatike të shfrytëzohen për oferta turistike • Reshjet e rregullta si shiu ashtu edhe bora, kështu edhe niveli i ujit konstant.	• Mbeturinat dhe kanalizimi derdhen direkt në lumenj • Ndotje e lartë e mjedisit; • Uzurpimi i tokës pjellore për ndërtim • Toka bujqësore është e papunuar • Shfrytëzimi jo racional i burimeve natyrore; • Pyjet të rrezikuara nga shpyllëzimi; • Ndotja e lumenjve, ajrit, ujërave; • Gjuetia e pakontrolluar e kafshëve të egra; • Peshkimi ilegal; • Prerjet e drunjëve edhe në Zonat e Mbrojtura me ligj; • Pajisje të amortizuara dhe të pafavorshme të grumbullimit të Mbeturinave • Mungesa e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza; • Nuk ka senzor për matjen e cilësisë së ajrit • Përdorimi i thëngjillit për ngrohje nga shtëpitë private • Varësi e vazhduar ndaj pushtetit qendror • Ndotja e vazhdueshme e mjedisit, shfrytëzimit të egër dhe të pakontrolluar të resurseve natyrore; • Mungesa e përpunimit të ujërave të zeza dhe pjesërisht largimi i pakoordinuar i mbeturinave, paraqesin rrezik për shëndetin dhe ambientin
Mundësitë	**Rreziqet**
• Peizazhi atraktiv, bazë për zhvillimin e industrisë së turizmit; • Politika kombëtare të favorshme për zhvillimin e turizmit rural rekreativ; • Projektet ndërkufitare janë prioritet i donatorëve • Shfrytëzimi më i madh i tokës bujqësore; • Organizimi i fushatave për vetëdijesimin e popullatës për mjedisin; • Rritja e buxhetit nga komuna për fushën e mjedisit;	• Përhapja e sëmundjeve të ndryshme si rezultat i ndotjes së mjedisit; • Zvogëlimi i faunës në lumenj si rezultat i ndotjes së lumenjve nga derdhja e kanalizimeve; • Degradim i pa kthyeshëm i tokës; • Nëse vazhdohet trend i tillë i trajtimit të lumenjve dhe shtratit të tyre rrezikohet që të degradohen në mënyra të thellë lumenjtë;

• Përmirësimi i gjendjes në mjedis dhe mbrojtja e shëndetit të popullatës përmes rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara; • Fillimi i aksioneve për largimin e deponive të mbeturinave; • Vendosja e pikës së matësit të ndotjes së ajrit të NO_2 NO CO SO_2 O_3 PM_{10} $PM_{2.5}$; • Largimi i deponive industriale; • Fabrika për riciklimin e mbeturinave.	• Vazhdimi i prerjeve të pyjeve natyrore rrezikon humbjen e habitateve pyjore si ekosisteme natyrore; • Humbja e pa kthyeshme e peizazheve natyrore; • Humbja e llojeve bimore dhe shtazore në mënyrë të pa kthyeshme në ekosistemet e rajonit të Shtërpcës

Tabela 139 Analiza SWOT për Mjedisin

3.7.6. Erozion dhe sendimentimi

Në territorin e Komunës së Shtërpcës erozionet si dukuri natyrore, në kuptimin e tyre klasik, nuk prezantojnë ndonjë rrezik që do të reflektohej negativisht në funksionimin normal të komunitetit. Disa trajta më të buta të erozionit shfaqen si pasojë e ndikimit negativ të faktorit njeri, sidomos në degradimin e shtretërve të lumenjve si pasojë e eksploatimit ilegal dhe të pakontrolluar të zhavorrit.

Territori i zonës urbane nuk është nën ndikimin e erozionit. Zona kadastrale karakterizohet me pjesëmarrjen e sipërfaqeve erozive sipas kategorive në vijim: sipërfaqet që janë të ekspozuara ndaj erozionit shumë të dobët, të dobët, erozionit mesatar dhe sipërfaqet me erozion shumë të fortë.

Duke përdorur metodën e analizës me GIS dhe duke u bazuar nga të dhënat dhe shtresat me atribute nga programi EULUP dhe vlerësimi analitik i bërë për nga shkalla e erozionit, është analizuar harta e ndjeshmërisë se tokës ndaj erozionit.

Rajonet në të cilat erozioni është i intensitetit të lartë në rrjedha të ujit, toka, pyje dhe objekte të palëvizshme, është e nevojshme që të shpallen si zona erozive, të cilat sipas ligjit të Kosovës për ujëra i shpall komuna. Me qëllim të parandalimit te aktivitetit të erozionit parashihen hapat konkret dhe urgjent të tillë si:

- ndalimi i prerjeve dhe degradimit të pyjeve;
- ndalimi i kullotjes;
- ndalimi i përdorimit të të mirave materiale që shkaktojnë erozion;
- ndalimi i përdorimit të tokës, rërës, etj.

3.7.7. Rrëshqitjet e dheut dhe ortekët e dëborës

Këto janë karakteristike për shkëmbinjtë e fortë dhe relativisht të fortë. Ato karakterizohen nga rënie copash dhe blloqesh me rrokullisje në rrëzë të shpatit duke formuar një konsus të materialit. Ato lindin kryesisht si rezultat i procesit të tjetërsimit në shpate me pjerrtësi të madhe ose nën ndikimin e shpërthimeve të ndryshme sidomos në shkëmbinjtë me çarje.

Rrëshqitjet e tokës

Ky fenomen natyror në pjesën urbane reflektohet në rrëshqitjen e bregut të lumenjve që kalojnë në territorin e Komunës së Shtërpcës, por rrëshqitjet ndodhin edhe si rezultat nga dëmtimet që i shkakton njeriu me veprimet e tij.

Ortekët

Orteku është një dukuri e rregullt dimërore. Numri i ditëve me reshje bore, gjatësia dhe trashësia e shtresës së borës rritet me rritjen e lartësisë mbidetare. Numri mesatar vjetor i ditëve me borë shkon për periudhën e viteve 1931-1960 prej 40 ditë në luginën e Lepencit deri në 100 ditë në pjesët më të larta të maleve të Sharrit. Në Shtërpcë, numri i ditëve të regjistruara me reshje bore për periudhën e viteve 1960-1984 është mesatarisht 39, ndërsa në Jazhincë për periudhën e viteve 1959-1985 është 42 ditë. Me shtresën e borës, me të cilën nënkuptohet shtresa e borës me trashësi më së paku 1 cm, disa pjesë janë të mbuluara prej 60 deri në 210 ditë. Shtresa e borës, për shkak të temperaturave të ulëta të ajrit, përherë ka qëndrueshmëri më të gjatë në krahasim me ditët e reshjeve të borës, d.m.th, ditët kur bie borë. Sipas matjeve konkrete për periudhën e viteve 1960-1984 kohëzgjatja mesatare e shtresës së borës në Shtërpcë është 66,5 ditë. Në pjesët më të larta të maleve të Sharrit nën shtresën e borës janë pjesët prej 180 deri 210 ditë, që nënkupton 6 deri në 7 muaj. Përndryshe, trashësia mesatare maksimale e shtresës së borës në lartësi mbi 1.700 m, është duke filluar nga 150 deri 200 cm, derisa në rajonet më të ulët është 70 cm.

DRAFT

Diellosja

Djellosja ose insolacioni i është e rëndësishëm për botën e gjallë (bimët, kafshët, njerëzit), për bujqësi, turizëm, shëndetësi etj. Në diellosje ndikon gjerësia gjeografike (këndi i rënies së rrezeve të diellit), relievi (lartësia, ekspozicioni), vranësia, erërat. Në gjerësitë tona gjeografike (42-43 shkallë) diellosja vjetore do të duhej të zgjaste 4450-4460 orë në vit ose 12,2 orë në ditë 9 mesatarisht.

Në të vërtetë diellosja në Kosovë zgjatë 2079 orë ose 5,7 orë në ditë, që është 47% nga diellorja e mundshme. Diellosja më e vogël është në viset malore dhe afër tyre dhe gjatë muajve të dimrit. Diellosja në muajin dhjetor është mesatarisht 54 orë gjithsej ose 1,7 orë në ditë, kurse gjatë muajve të verës (mbi 250 orë në muaj ose 8,3 orë në ditë). Diellosja është diçka më e lartë në Rrafshin e Kosovës se të Dukagjinit, sepse malet në Rrafshin e Kosovës janë më të ulëta se në Rrafshin e Dukagjinit.

Të mbuluarit e qiellit me re në Kosovë sillet në mes 52-58 % dhe është diçka më e vogël në rrafshin e Kosovës se në Rrafshin e Dukagjinit. Të mbuluarit e qiellit me re ndryshon sipas muajve. Më e lartë është në muajt e dimrit, kah fundi i vjeshtës dhe fillimin e pranverës, kur ka më shumë reshje dhe mjegulla. Më shumë ditë të vrenjtura ka në viset pranë maleve të larta (në alpet shqiptare dhe malet e Sharrit e më pak në Rrafshin e Kosovës, Anamoravë dhe Drenicë).

3.7.8. Erërat

Në Shtërpcë më të shpeshtat janë erërat lindore dhe perëndimore, dhe është e qartë që në drejtimin e erërave në mënyrë dominonte ndikojnë format e reliefit, që nënkupton drejtimi i luginës së Lepencit dhe malet përreth. Era perëndimore, në mesin e stinës së dimrit sjell reshje të shumta bore. Breshëri në Shtërpcë shpesh mund të konsiderohet si i rrezikshëm për ekonominë duke pasur parasysh në vitet e kaluara ka pasur stuhi të breshrit.

3.7.9. Tërmetet

Nga aspekti sizmologjik, zona urbane e Shtërpcës paraqet terrenin sizmik aktiv ku është e mundur shfaqja e tërmeteve katastrofike. Vet zona me gjasë nuk është e kërcënuar nga paraqitja e tërmeteve më të forta autoktone, por është e ekspozuar ndaj efekteve të forta sizmike të tërmeteve, vatra e të cilëve gjenden në largësi të mëdha apo të vogla. Të dhënat mbi tërmetet, të cilat janë sot në dispozicion, tregojnë se shfaqja e tërmeteve katastrofike është regjistruar qysh në vitin 1457, kur në rrethin e Prizrenit ka ndodhur tërmeti prej MS 9º MS. Në kohën e re është evidentuar tërmeti që ka ndodhur në gusht të vitit 1921 në zonën Ferizajt-Viti, dhe i cili në Shtërpcë është regjistruar me intensitet prej 8º MS. Dy lokacionet e cekura kanë ndikimin më të rëndësishëm në karakteristikat sizmike të tërmetit të Shtërpcës, sepse paraqesin dy burime sizmike më të afërta dhe më të forta. Nga shfaqja e tërmeteve autoktone janë regjistruar magnitudat e tyre (3-4)të cilat tregojnë që janë shumë larg nga për nga rëndësia e përcaktimit të zonës seizmike. Ekzistenca e tërmeteve lokale, qoftë edhe të dobëta, duhet të tregojë rrezikun nga veprimet e tyre.

DRAFT



Harta 50 Epiqendrat e tërmeteve në Kosovë

3.7.10. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Me rastin e dimensionimit të rrjetit të ujësjellësit në qytet, një nga kriteret për dimenzionimin e tij duhet të jetë edhe nevoja e mundshme për fikje të zjarrit. Në kushtet e ndërtimit duhet të përcaktohen objektet që do të kanë shkallë më të madhe rezistuese ndaj zjarrit. Kur është fjala për pjesët e qytetit që mund të preken nga zjarri, duhet siguruar qasje maksimale të pjesëve të caktuara të vendbanimeve, veçanërisht ato që janë më të rrezikuar nga zjarri, të tilla si zonat industriale dhe të magazinimit, etj. Zona pyjore, duhet të ndërpriten nga rripat kundër zjarrit, në mënyre që dëmet e mundshme nga zjarret në pyje të reduktohen në minimum. Për sa i përket shpërndarjes së objekteve industriale dhe objekteve tjera prodhuese, duhet të përcaktohemi për një ndërtim të shpërndare, dhe me sistemin pavijon të ndërtimit, i cili siguron përfitime të caktuara në drejtim të mbrojtjes nga zjarri Depot e karburanteve, substancave eksplozive dhe të ndezshme, duhet të vendosen në përputhje me rregullat teknike, kryesisht larg nga qyteti dhe sistemet e mëdha të infrastrukturës.

3.7.11. Vërshimet

Vërshimet janë fatkeqësi natyrore që kërkojnë vëmendje të veçantë. Vërshimet konsiderohen dukuri që shfaqen në zonat e caktuara që janë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe shkaktojnë dëme të dukshme materiale. Vërshimet nuk mund të parandalohen por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose nga shkrirja e borës duhet të gjejë rrugën e lëvizjes së tij. Plani Zhvillimor Urban i Shtërpcës 47 Shfaqja e ujërave të mëdha është vështirë të determinohet. Vërshimet e mëdha në pellgun e Miloshticës janë vërejtur në vitin 1897, 1925, 1933, 1191, 1196, 1953, 1965, 1979 i 1981. Efekt veçanërisht shkatërrues kanë pasur shfaqjet e vërshimeve që janë paraqitur ne vitin 1897, 1953 i 1979.

Përparësitë	**Dobësitë**
• Vetëm disa zona të caktuara kanë erozion të fortë; • Deri tash në komunë nuk ka pasur ndonjë fatkeqësi e shkaktuar nga fuqitë natyrore, e cila do të shkatërronte në masa katastrofike jetën dhe shëndetin e njeriut, shtazëve dhe pasurive, ose duke shkaktuar dëme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore; • Nuk ka pasur fatkeqësi natyrore, siç janë: tërmetet e forta, ortekë apo pirgje bore, borë të madhe, akull, thatësi, shfaqje masive e sëmundjeve ngjitëse tek njerëzit, kafshët, bimët dhe fatkeqësi tjera me përmasa të madha; • Nuk ka pasur fatkeqësi natyrore të përmasave në transportin rrugore, ajror, zjarreve dhe aksidenteve tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe sjellje; • Ekzistojnë mekanizma që merret me planifikimin e situatave urgjente së bashku me nivelin qendror; • Procesi i hartimit të Planit zhvillimor komunal dhe planit urbanistik (PHZK dhe PZHU) është në proces dhe i cili duhet t'i trajtoj këto tema.	• Sasia e madhe e mbeturinave dhe deponive të egra ekziston gati në çdo vendbanim, sidomos përgjatë brigjeve të shtratit të lumit; • Menaxhimi joefikas i mbledhjes së mbeturinave, mungesa e ndarjes dhe riciklimit • Degradimi i shtretërve të lumenjve; • Prerja e pakontrolluar e pyjeve dhe dëmtimi i pyjeve nga zjarri; • Ka pasur vërshime të mëdha; • Nuk ekziston sistem për mbrojte nga vërshimet; • Nuk ekziston standard arkitektonik për ndërtime anti-sizmike; • Nuk ekziston qendra dhe as një sistem kundër breshrit; • Nuk ka sistem të planifikuar për ndërhyrje urgjente ose plan konkret; • Nuk ka vende të planifikuara të shkatërrimit në rast të sëmundjes së kafshëve, ku kërkohet shkatërrimi për shkak të rrezikut për njerëzit.
Mundësitë	**Rreziqet**
• Planifikimi i riciklimit të mbeturinave; • Planifikimi dhe hartimi i projekteve konkrete për mbrojtjen nga degradimi i mëtutjeshëm i shtretërve të lumenjve (planifikimi i deponive dhe masave tjera për pastrim dhe mirëmbajtje nga rregullimi i tokë deri te rregullimi i shtretërve të lumenjve nga përmbajta e betonit dhe shkëmbeve); • Planifikimi dhe hartimi i projekteve për ndërprerjen e prerjes së pakontrolluar të pyjeve dhe masat për mbrojtjen nga zjarri; • Miratimi i rregullores për prezantimin e masave për arkitekturë dhe standarde sizmike të ndërtimit; • Ndërtimi i qendrës kundër breshrit; • Përgatitja e planit për evakuim dhe veprimtari në gjenden emergjente për zvogëlimin e numrit të viktimave si dhe pasojave tjera; • Planifikimi i së paku një vendi për shkatërrim në rast të sëmundjes së kafshëve pasi që shkatërrimi apo asgjësimi është mundësia e vetme për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve.	• Paraqitja e tërmeteve të shkallës së lartë që mund të rrezikoj komunën sepse ajo gjendet në zonën sizmike: • Paraqitja e vërshimeve të mëdha është e mundshme; • Paraqitja e zjarreve të mëdha; • Paraqitja e fatkeqësive tjera natyrore dhe fatkeqësive tjera; • Humbja dhe çrregullimi i ekosistemit dhe llojeve organike që jetojnë në to, që shkakton dëmtimin e pyjeve nga zjarret; • Nga pjesa më e madhe e fatkeqësive rrezikohet jeta ose shëndeti i njeriut, kafshëve si dhe pronës, trashëgimia kulturore dhe natyrore.

Tabela 140 Analiza SWOT për sipërfaqet me rrezikshmëri

DRAFT

3.7.12. IDENTIFIKIMI I SFIDAVE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar disa sfida të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit. Sfidat e identifikuara në gjitha komponentët mjedisore janë:

- Sigurimi i fondeve për projektet mjedisore;
- Menaxhimi i mbeturinave është ndër sfidat më të mëdha mjedisore në Shtërpcës
- Edukimi mjedisor;
- Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore nga ndërtimet dhe nga ndotja, deponitë e mbeturinave te egra dhe deponitë e mbeturinave inerte;
- Trajtimi i ujërave të zeza;
- Ruajtja e cilësisë së ujit në Lumenjë:
- Parandalimi nga degradimi i tokave nga ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave;
- Parandalimi i ndotjes nga zhurma;
- Parandalimi Erozionit;
- Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen pyjeve nga zjarret;

3.7.12.1. GJETJET KYÇE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar Gjetjet kyçe të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit

- Ndotje e Ajrit, Ujit dhe Tokës
- Humbja e tokës bujqësore nga Erozioni nga ndërtimet
- Nuk ka senzor për matjen e ajrit

3.7.12.2. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar Problemet të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit

Ndotja e Ajrit

- Ndotja e ajrit
- Nuk ka sensor për matjen e cilësisë së ajrit
- Menaxhim i kufizuar i mbeturinave
- Ndotja e ajrit, zhurma e lartë, antena të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Shtërpcës.
- Një trafik shumë i dendur, me numër të madh makinash, vende të pakta për parkim dhe cilësi Jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës.

Ndotja Ujit

- Shkarkimi i ujërave të zeza në lumenjë
- Mungesa e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Deponitë e mbeturinave përgjatë shtratit të lumenjve
- Shkarkimi i ujërave industriale në lumenjë pa trajtim adekuat

Ndotja e Tokës

- Humbja tokës bujqësore nga mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, deponitë e automjeteve, procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve, etj.
- Humbja e Tokës Bujqësore me bonitet të Lartë nga ndërtimet
- Mos Mbulesa e gjithë hapësirës ku ka tokë bujqësore me kanale të ujitjes

DRAFT

Ndotja nga zhurma

- Niveli i lartë i zhurmës nga automjetet, gurthyesit dhe veprimtarin industriale;
- Mungesa e dokumenteve për parandalimin e ndotjes nga zhurma.

Biodiverziteti

- Humbja e sipërfaqeve Pyjore;
- Rrezikimi i specieve të rralla nga zhdukja;
- Gjuetia e pa kontrolluar në zonën kufitare me Maqedoninë

Erozioni

- Humbja e tokës bujqësore
- Shtretër të ngushte të lumenjve bregut të lumit "Miloshticë, Bollovanka, Kalluxherka
- Rrezikimi infrastrukturës, ura në fsh Rakovinë, Rogovës dhe në fsh. Shishman
- Zonat e rrezikuara nga vërshimet kryesisht pranë lumenjve Miloshticë, Bollovanka, Kalluxherka dhe Lepenc.

Rrëshqitja e Tokës

- Shpyllëzimi i hapësirave;
- Nxirrja e rërës dhe zhavorrit;
- Rrëshqitjet e dheut në fshatin Jazhincë ,Brod, Brezovicë;
- Ndërtimet pa kriter dhe ne shpërputhje me planet e Komunës.

Tërmetet

- Mungesa e Analizave Mikro-Sizmike për Komunën e Shtërpces;
- Cilësi jo e duhur e ndërtimeve.

Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

- Mungesa e mureve mbrojtëse në vendet ku ka orteqe të dëborës ne zonat Malore
- Erërat
- Mungesa e një plani për gjelbërim mbrojtës dhe plan për peizazhe natyrore brenda qytetit
- Mos shfrytëzimi i erës për përfitimin e energjisë elektrike

Sipërfaqet me ndotej të lartë (HOT-SPOTET)

- Mungesa e lokacionit për mbeturinat e ngurta
- Mos riciklimi i mbeturinave

Sipërfaqet e Rrezikuara nga zjarri

- Zona e majës së lartë, e cila përfshinë zonat malore te Komunës së Shtërpcës
- Rrugët e ngushta në zonën urbane (kryesisht pjesa e vjetër e qytetit) po ashtu edhe ne zonat e thella malore, si ajo e Jazhinces dhe disa fshatra të zonës të rrezikuara nga zjarri
- Zjarrvënjet e shkaktuara nga faktori njeri (të qëllimshme apo nga pakujdesi)
- Rrjeti dhe instalimet e vjetruara elektrike

Përmbytjet

- Shtretërit e ngushtë të Lumenjve;
- Mungesa e rehabilitimit të brigjeve të Miloshticë, Bollovanka, Kalluxherka dhe Lepenc.
- dhe ngritjes së argjinaturave mbrojtëse.

3.7.12.3. KONSTATIMET DHE MASAT KRYESORE

Ndotja e Ajrit Konstatimet

- Menaxhimi i rrjetit rrugor;
- Promovimi I teknologjive te pastërta ;
- Rritja e sipërfaqeve te gjelbra;

- Bizneset të cilat përdorin lënde djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të pajisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilësisë së lëndës djegëse).
- Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore të Shtërpcës dhe për rrethe deponive te mbetjeve kimike dhe deponive të Mbeturinave
- Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si te lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve
- Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave që e Ndotin Ajrin.
- Përcaktimin e kritereve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Shtërpcës dhe nën – qendrat.
- Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve.
- Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale)
- Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në Këmbë.

Ndotja e Ujit Konstatimet

- Ndërtimi i Kolektorëve dhe impiantit për Trajtimin e ujërave të zeza;
- Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor sidomos ne pjesën e Maleve të Sharrit të mbrohen, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike.
- Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.)
- Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh ketë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

Ndotja e Tokës Konstatimet

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikua
- Planifikohet të bëhen në mënyra të vazhdueshme monitorimi dhe kontrolla e plleshmërisë së tokës bujqësore.
- Parashikohen ujitje e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit te toka e cila ka bonitet më të ulët.
- Parashikohet në zonat të cilat janë destinime (për pos banimit) tjera dhe ndërtime të përkohshme të hartohen projekte ri kultivimi të tokës bujqësore;
- Parashikohet mbrojtja nga degradimi dhe ndikimi i njeriut.
- Parashikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes qarkullimit bimorë në tokat bujqësore dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen sërrishtat ose mbetjet bimore)
- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.

Ndotja nga Zhurma Konstatimet

Andaj për zvogëlimin e zhurmës në Shtërpcës Parashikohet.

- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, në qendër etj.).
- Të Hartohet Harta Strategjike e zhurmës dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga zhurma.

Biodiverziteti Konstatimet

- Zhvillimi ekonomik i një vendi mund të sigurohet përmes ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive natyrore e biologjike.
- Dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversitetit- shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.
- Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet .
- Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e komunës Shtërpcës , duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj.

Erozioni

- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja.
- Parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpëlarja e elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimit dhe melorimit të zonave të degraduara përkatësisht në Fshatrat Brod, Firaja, Izhance, Sevce dhe Vërbeshtica.

Rrëshqitja e Tokës

- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në disa segmente të rrugëve locale që përshkojnë rrugët locale të fshatrave Jazhincë,Brod,Firaj Izhance, Sevce dhe Vërbeshtica. dhe ne fshatrat tjerë ku janë te rrezikuara nga kjo dukuri .

Tërmetet

- Analizat Mikrozonike për qytetin e Shtërpcës
- Kujdes të veçantë duhet kushtuar ndërtimeve të larta >P+4, objekteve industriale dhe infrastrukturës rrugore, e sidomos urave.

Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në vendet ku ka orteqe të Dëborës P.sh. në zonën Brezovicës

Erërat

- Komuna duhet pasur në konsideratë në procedurat e dhënies së kushteve të ndërtimit për objektet të etazhitetit të lartë si dhe objekteve të infrastrukturës teknike, të transportit dhe objekteve energjetike.
- Hartimi i Planit për gjelbërim Mbrojtës

Sipërfaqet me ndotje të lartë (HOT-SPOTET)

- Caktimi i lokacionit për mbeturina të ngurta;
- Riciklimin e mbeturinave;
- Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave;
- Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimin i vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj.).
- Masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdorën, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar

Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

- Zgjerimi i Rrugëve në qytet dhe fshatrat ku janë të rrezikuara nga zjarri
- Ndërtimi i rezervarëve të ujit ne zonat rurale për zjarrfikësit;
- Edukimi dhe sensibilizimi i faktorit njeri për rendësin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret

Përmbytjet

- Parashikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave te toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit;
- Rregullimi dhe rehabilitimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave;

- Mirëmbajtja cilësore e rrjetit të kanalizimit dhe rrjetit të ujërave atmosferik në përballimin me qëllim të përballimit të reshjeve intensive dhe shmangies së përmbytjeve dhe dëmtimeve në zonat e urbanizuara;
- Ndërtimi i argjinaturave mbrojtëse në pikat potenciale për vërshime.

3.7.12.4. PERFUNDIME DHE REKOMANDIMET e VSM-s

Shtërpca është komuna e cila ndodhët në territorin me vlera të larta natyrore për shkak të bjeshkëve të Sharrit dhe parkut nacional "Mali Sharr" po ashtu kjo komunë posedon begati të mëdha natyrore për shkak të relievit të saj dhe kushteve tjera klimatike, orografike, biodiversitetit, ekosistemeve të veçanta, shtrirjeve e mbulesave vegjetative nga nivelet me të ulta deri te zona subalpike dhe alpike. Andaj projektet e parapara me PZHK dhe zbatimi rigoroz i tyre dhe sugjerimeve të cilat u dhan në VSM në përgjithësi do të ketë ndikime pozitive në mjedis. PZHK do të orientojë rritjen e mundshme dhe të parashikuar të popullsisë në disa vendbanime të komunës së Shtërpcës me qëllim dendësimin në zonat që janë të pastabilizuara ende dhe të zhvillojë zona të reja banimi dhe shërbimesh të qëndrueshme rreth këtyre vendbanimeve aktuale në komunën e Shtërpcës.

PZHK gjithashtu do të ruajë trashëgiminë e ndërtimit, krahas nxitjes së një peizazhi me pamje më të këndshme duke eliminuar pamjet e vrazhda sidomos në vikendzonën në Brezovicë. PZHK ja do të sjellë përmirësime në mjedis, do të kontribuojë në mbrojtjen e zonave me vlera natyrore dhe ekosistemet me vlera të larta si dhe zhvillimin e pyjeve në të gjitha zonat pyjore dhe parqeve brenda dhe rreth vendbanimeve, krahas aspektit të rëndësishëm të parandalimit të depërtimit (shtrirjes) në tokat e pëlleshme bujqësore përreth lumit Lepenc.

Përfitimet kryesore të këtij plani lidhen kryesisht me përdorimin në mënyrë me efikase të tokës. Komuna duhet të kujdeset për ruajtjen e vlerave natyrore dhe peisazhore të lumenjve sidomos lumit Lepencë i cili kohëve të fundit "vuan" nga ndotja e lartë nga kanalizimet dhe nga ndërhyrjet në devijimin e rrjedhës së tij. Plani Zhvillimor Komunal ka përfshirë edhe planin e PN "Malit Sharr" dhe Master Planin e qendrës se re të skijimit si dhe mundësin e ndërlidhjes së zonave turistike të kësaj komune me zonën turistike të Përvallës, kështu duke i harmonizuar zhvillimet e reja në raport me këto dy plane dhe zhvillimet dhe planet tjera. Ai gjithashtu shoqerohet me pjesëmarrje të gjere publike në nivelin teknik dhe strategjik, me VSM, me disa strategji e plane të më hershme, me GIS, Vlerësim të Kapaciteteve Investive, si dhe mundësinë e publikut të gjere të konsultohet dhe te shprehet për projekt-Planin. PZHK lejon mundesinë e qartësimit dhe detajimit më të hollësishëm gjatë hartimit të Planeve dhe projekteve tjera lokale (planeve rregulluese). Si e tillë, alternativa e paraparë me PZHK vlerësohet e mirë dhe adekuate në kuptimin mjedisor dhe aspektet tjera . Janë pasur parasysh parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor të bazuar mbi eksperiencat ndërkombëtare, si nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror, ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, pejsazhere, zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, informimi dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, etj. Zbatimi praktik i parimeve të përgjithshme në rastin e PZHK-së nxjerr disa përparësive si p.sh. Zhvillimi kompakt dhe policentrik i vendbanimeve, densifikim përpara shtrirjes për ngadalësimin e shpërndarjes përtej vijave cilat kufizojnë ndërtimin, strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent, krijimi i rrugëve të reja brenda vendbanimeve ekzistuese, rehabilitimi i lagjeve ekzistuese, ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe historike, ruajta e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve në vendbanime, dhe zgjerimi i zonës së ndërtimit atje ku kushtet janë të favorshme.

Plani përpiqet të përmbushë disa objektiva strategjike të pranuara gjerësisht përfshirë:

- Komuna e Shtërpcës komunë e cila përballon nevojat për banim të banorëve të saj dhe turist nga jasht vendit;
- Komuna e Shtërpcës komunë e shëndetshëm me peizazhe dhe ekosisteme interesante;
- Komuna e Shtërpcës komunë policentrike sipas konceptit përfundimtar;
- Shtimi i sipërfaqeve te gjelbra duke synuar rritjen e potencialit ekologjik dhe zhvillimin, krijimin e pyjeve, korridoreve ekologjike dhe tampon zonave në Shtërpcës;
- Zgjerim të rrugeve por dhe nxitjes se ecjes këmbësorë dhe me bicikleta;
- Permiresim transportit publik (përmiresim i shërbimit të autobusëve);
- Zgjerim i vendbanimeve me trende pozitive në drejtimin të tokave me plleshmëri më të dobët.

Objektivat strategjike të mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në Shtërpcës, rritjen e sigurisë, shtim të mundësive për mënyrë aktive të jeteses, shtim i sipërfaqeve të gjelbra, përmiresim i cilësisë së ajrit, etj. dhe duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit. VSM sugjeron disa veprime operacionale konkrete për ruajtjen e vlerave mjedisore dhe vlerave tjera te trashëgimisë Veprime operacionale në Shtërpc: Krijimi i projekteve për zbatim në zonat e mbrojtura të rekognozuara në komunën e Shtërpcës siç janë:

- Zonat e mbrojtura në PN "Mali Sharr",
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të parapara me PZHK, krijimi i parqeve të reja nëpër dhe përreth vendbanimeve; zgjatimi dhe përmirësimi i kushteve ekologjike në koridorin përgjatë lumenjve;
- Krijimi i lulishteve dhe kopshteve në qytetin e Shtërpcës; kthimi i zonave te ndotura ne sipërfaqe te gjelbra;
- Gjelbërimi me peme dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuareve; ngritja e barrierave të dendura me gjelbërim si perde që ndajnë rrugët nga zonat e banimit dhe zonat tjera, përgjatë rrugëve me trafik të dendur me qellim te shumëfishte (rritje gjelbërimi, permiresim cilësisë se ajrit përmes filtrimit te pluhurave, si edhe rritje e sigurisë rrugore);
- Trajnim i grupeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtje dhe sensibilizim të vlerave mjedisore.
- Veprimet në infrastrukturë: ndërtimi i një rrjeti rrugor që lidhin Shtërpcës me rajonin; përmirësim i gjendjes së rrugëve ekzistuese dhe zgjerim sipas mundësisë;
- Krijim i rrjetit të plote rrugor në vendbanimet e mëdha me përmbajtje edhe për biciklistet dhe këmbësorët; përmirësim i sistemit, orareve dhe cilësisë se autobuzeve; përmiresimi i projektimit te rrugëve me parashikimin e trotuareve te plota dhe shiritave/korsive për bicikletat sipas standarteve europiane te rrugeve;

Plani do të jete një dokument që që ofron vizion, qëllime dhe objektiva per zhvillimin hapësinor të komunës së Shtërpcës. PZHK-ja duhet te fuqizoje komunën të luaje rol me aktiv mes paleve për të ofruar mundesi për të mos mbetur peng i mosmarrveshjeve mes paleve. VSM gjithashtu i vendos disa kufizime zhvillimit që parashikohet nga PZHK-ja. Kriteret mjedisore qe kufizojne zhvillimin komunal janë:

(1) kriteret e forta mjedisore shëndetsore,

(2) kritere të trashegimisë kulturore,

(3) kritere peisazhike dhe

(4) kritere inxhinierike dhe te infrastrukturës.

Parashikohen një seri masash zbutëse ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore gjatë zbatitmit të PZHK-së. Masat zbutëse synojnë që të përmirësojnë gjendjen ekzistuese aty ku 144 standardet mjedisore janë të cënuara dhe të sigurojnë që zhvillimet komunale në zonat e tjera dhe ato që do të integrohen rishtazi në Planin Zhvillimor Komunal të bëhen në përputhje me standardet mjedisore. Monitorim i zbatimit të PZHK-së dhe parametrave mjedisore te tij do jetë kyç i suksesit për garantimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të planit. Parashikohet të monitorohen treguesit e mbrojtjes së mjedisit me qëllim që realizimi i objektivave të bëhet i matshëm për çdo element mjedisor.

3.8. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

Komuna e Shtërpcës është mjaft e pasur me elemente të trashëgimisë kulturore të cilat në të ardhmen duhet të ruhen dhe mbrohen për pos aseteve kulturore të cilat janë të shumta në komunë duhet përmendur edhe disa memoriale modeste të përkushtuara ushtarëve dhe viktimave të luftës së sytë Botërore: monumenti mbi varrezën e përbashkët të luftëtarëve nga këto anë, i lokalizuar pranë obeliskut të përmendur në afërsi të kishës Shën Jovani në Shtërpcë, monument i ngjashëm mbi varrezën e katërmbëdhjetë të rënëve nga fshati Vërbeshticë, i vendosur në rrugë, e nën kishës Shën. Ilija në Vërbeshtice, si dhe memoriali – burimi në rrugën në mes të Shtërpcës dhe Brezovicës, si dhe përmendorja e dëshmorëve të luftës se UÇK- se e vendosur përskaj rrugës kryesore në fshatin Brod.

Në procesin e planifikimit, procesi i urbanizmit i cili duhet të përfshijë këtë zonë të pazhvilluar, është e rëndësishme që fizikisht të ruhen dhe të ngritën në nivel të duhur të dëshmive materiale të fuqisë shpirtërore të popullit të Shtërpcës në kohët e vështira të historisë së tij, në kohën e sundimeve të ndryshme dhe luftërave botërore dhe ballkanike duke i përfshirë në jetën bashkëkohore dhe peizazhin e formuar modern.

Lista e objekteve kulturore të mbrojtura dhe të evidentuara:

Trashëgimia kulturore të rëndësisë së veçantë:

- Kalaja mbi Brezovicën - Çajlia, Brezovicë;
- Kisha e Shën Nikollës e shekullit XVI, Gotovushë;
- Kisha e Shën Nikollës e shekullit, Shtërpcë.

Trashëgimia kulturore me rëndësi të madhe:

- Pllaka e gurit me varrin tek Kisha e Shën Gjergjit, Bitia e Epërme;
- Kisha e Teodorit të Shenjtë nga shekulli XVI, Bitia e Poshtme.

Trashëgimia kulturore e evidentuar

DRAFT

- Varreza e fshatit „Crkvishta“,Vërbeshticë
- Kisha e Shën Ilijës, Vërbeshticë
- Kisha e Shën Arhangjelit nga shekulli XVI dhe XVII, Sevcë
- Kisha e Shën Nikollës nga shekulli XVI, Sevcë
- Kisha e Shën Premtit nga shekulli XVI, Jazhincë
- Xhamia e fshatit, Bitia e Epërme
- Kisha e Shën Premtit, Berevcë
- Kisha e Shpëtimtarit të Shenjtë, Gotovushë
- Kisha e Virgjëreshës së Shenjtë, Gotovushë
- Kisha e Shën Mladenci, Drajkoc
- Kulla e Ibrahim Mulës nga shekulli XIX, Firajë
- Xhamia e fshatit Kashtanjeve
- Xhamia e fshatit Biti e Epërme

Kurse trashëgimi a natyrore është mjaft e pasur si:

- Parku Kombëtar i Sharrit;
- Kompleksi/ Qendra e Brezovicës;
- Liqeni i Livadicës dhe Jazhincës.

SWOT analiza e trashëgimisë

Trashëgimia natyrore	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
• Komuna me një llojllojshmëri të faunës dhe florës, ka pasuri të konsiderueshme • Komuna ka një florë dhe faunë të ndryshme, ka pasuri të rëndësishme tokësore dhe nëntokësore; • Komuna ka zona dhe peizazhe të pasur me biodiverzitet si trashëgimi të mbrojtur natyrore (parku nacional); • Ekziston dëshira profesionale dhe politike për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave të pasura me florë dhe faunë; • Ekziston një bazë e mirë ligjore; • Ekziston interesi për ngjarjet turistike dhe sportive – rekreative në këto zona;	• Resurset natyrore nuk janë mirë të studiuar dhe hulumtuar; • Mungon efikasiteti në menaxhimin e zonave dhe trashëgimisë së mbrojtur; • Mungojnë plane hapësinore për zonat e mbrojtura dhe peizazhe; • Mungesa e investimeve për popullarizimin e maleve, mbrojtjen dhe rregullimin e zonave të mbrojtura; • Mungon vetëdija për ruajtjen e resurseve natyrore; • Shkatërrimi i madh i pyjeve ka si pasojë humbjen e biodiverzitetit.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Planifikimi dhe zhvillimi i projekteve që sigurojnë ekosisteme të plota pa ndërprerjen e rrjedhave dhe cikleve të mbyllura; • Hartimi i planeve dhe projekteve për vendosjen në zonat e mbrojtura të pasura me florë dhe faunë (rezervatet natyrore) me theks tek peizazhet dhe trashëgimia natyrore; • Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për zonat e ndryshme në funksion të mbrojtjes dhe zhvillimit të florës dhe faunës që paraqet një tipar të komunës; • Planifikimi dhe përgatitja e projekteve për kohezionin ekologjik (zonave të mëdha me vlera natyrore të lidhura me korridore);	• Degradimi dhe shkatërrimi i zonave me trashëgimi natyrore; • Zhdukja e realeve dhe vendeve të llojeve të ndryshme bujqësore-bimore dhe shtazore, si dhe zhdukja e tyre; • Shfaqja e gjuetisë së pakontrolluar.

DRAFT

• Planifikimi dhe përgatitja e projektit për zonat e ndryshme në funksion të mbrojtjes dhe zhvillimit të peizazheve që janë të pasura me biodiverzitet si dhe me trashëgimi natyrore të mbrojtur (sigurimi i bodiverzitetit maksimal); • Planifikimi dhe përgatitja e projekteve të përbashkëta (zonat e mbrojtura, peizazhet dhe objektet tjera natyrore) me komuna tjera dhe me shteti fqinjë Maqedoninë; • Shfrytëzimi i programeve të ndryshme ndërkombëtare për menaxhimin, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore; • Planifikimi i forcimit të mekanizmave për mbrojtjen dhe zhvillimin në përputhje me bazën ligjore të këtyre vlerave; • Programet e animimit të vlerave natyrore me qëllim të njohjes, si dhe mbrojtje së tyre.	
Trashëgimia kulturore – historike	
PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
• Zonat e pasura me vlera të trashëgimisë arkeologjike; • Zonat e pasura me vlera të trashëgimisë arkitektonike; • Ekzistenca e zonave me vlera historike (monumente dhe komplekse memoriale); • Përkushtimi institucional për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre vendeve; • Ekzistenca e infrastrukturës ligjore.	• Degradimi i zonave për vlerat kulturore – historike, me ndërtimet pa leje; • Mungesa e politikave për mbrojtjen e zonave me trashëgimi kulturore – historike në bazë të koncepteve bashkëkohore; • Mungesa e regjistrimit të zonave me vlera kulturore – historike, si dhe monitorimi; • Mungesa e digjitalizimit të zonave dhe projekteve për mbrojtje dhe zhvillim; • Numër i pamjaftueshëm i ekspertëve dhe mekanizmave për implementim në këtë fushë; • Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional; • Mungesa e vetëdijes dhe respektimit të subjekteve zyrtare dhe popullsisë për mbrojtjen e zonave me trashëgimi kulturore; • Mungesa e infrastrukturës ligjore, në fakt mosfunksionimi i mekanizmave për zbatimin e ligjit në këtë fushë
MUNDËSITË	**RREZIQET**
• Digjitalizimi i zonave dhe futja e masave mbrojtëse për të gjitha zonat; • Njohja e mëtutjeshme e zonave dhe regjistrimi i tyre (duke përfshirë regjistrimin gjeo-fizik në disa zona të caktuara); • Digjitalizimi, planifikimi dhe përgatitja e projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave me vlera arkeologjike; • Digjitalizimi, planifikimi dhe përgatitja e projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave me vlera arkitektonike;	• Degradimi deri të shkatërrimi i këtyre vlerave; • Humbja e identitetit, trashëgimisë dhe lashtësisë; • Në aspektin social (varfërimi në aspektin e mundësive për krijimin e vendeve të reja të punës dhe në aspektin e frymës); • Shkatërrimi i potencialeve zhvillimore në aspektin ekonomik; • Ballafaqimi i gjeneratave të ardhshme me problemin e mbrojtjes.

DRAFT

• Digjitalizimi, planifikimi dhe përgatitja e projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e zonave me vlera historike;
• Hartimi i politikave bashkëkohore dhe koncepteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore – historike;
• Ndërmarrja e masave për menaxhim adekuat të këtyre zonave, bashkëpunim ndërinstitucional dhe stimulim të mbrojtjes së zonës së trashëgimisë;
  • Organizimi i grupeve punese dhe ngritja e kapaciteteve profesionale për trajtimin e këtyre zonave;
  • Koordinimi i aktiviteteve në mes të nivelit për funksionalizimin e mekanizmave për zbatimin e ligjit nga kjo fushë;
  • Trajnime dhe kampanja informative për ngritjen e vetëdijes dhe respektimit nga ana e subjekteve zyrtare dhe popullsisë për mbrojtjen e zonave me trashëgimi.	

Tabela 138 SWOT analiza e trashëgimisë

3.9. VENDBANIMET

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Pikërisht nga kjo arsye, vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë popullative dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Numri i vendbanimeve në Kosovë , numëron 1457 nga të cilat 30, janë të nivelit urban dhe të tjerat për nga përmbajtja dhe veprimtaritë që zhvillohen dhe ofrohen në to janë të statusit të fshatit. Shprehur në përqindje del se qytetet përbëjnë 2.06 % të vendbanimeve kosovare. Ato paraqesin qendrat në të cilat zhvillohen aktivitetet sociale, kulturore, ekonomike ndaj edhe koncentrimi i popullatës është më i madh në këto qendra. Madhësia e 30 qendrave urbane varësisht në raport me numrin e banorëve është si vijon:

Deri 15.000 banorë	Malisheva, Z.Potoku, **Shtërpca**, Novo Bërda.
15.000—75.000 banorë	Suhareka dhe të gjitha komunat tjera
75.000 – 120.000 banorë	Gjilani, Gjakova, Peja, Mitrovica, Vushtrria, Podujeva
120.000- 220.000 banorë	Prizreni
> 220 000 banorë	Prishtina

Tabela 139Komunat sipas numrit të banorëve

Vendbanimet sipas madhësisë demografike dhe kushteve tjera në komunën e Shtërpcës sipas normave teknike të planifikimit mund të klasifikohen në:

1. Vendbanime të mëdha rurale prej 2.500 deri në 5.000 banorë

2. Vendbanime të mëdha rurale të mesme prej 1.000 deri në 2.500 banorë

3. Vendbanim i vogël rural me 200-500 banorë

Sipas të dhënave statistikore, Komuna e Shtërpcës përbëhet prej 16 vendbanimeve, të cilat shtrihen në nje territor prej 247.60 km². Shikuar në përgjithësi, 10,771 banor të komunës së Shtërpcës banojnë, veprojnë, zhvillojnë veprimtaritë sekondare dhe terciare brenda 16 vendbanimeve si dhe shfrytëzojnë rrjetin e rrugëve për komunikim dhe transport të mallrave në mes vete. Sipërfaqja e përgjithshme nën vendbanime, rrugë dhe infrastrukturë tjetër nuk është më e madhe se 423,0 ha. Kjo sipërfaqe e cila në total në sipërfaqen infertile të tokës merr pjesë prej 36,4%, ndërsa në komunën e Shtërpcës jo më shumë se 1,70 %.

Në bazë të të dhënave të fundit të grupeve punuese për përgatitjen e planit zhvillimor komunal (grupi për çështje demografike dhe sociale) në komunën e Shtërpcës për vitin 2010-2011, ata i klasifikuan vendbanimet si vijon: Në

kategorinë e parë të vendbanimeve të banuara (vendbanime të vogla rurale) me madhësi prej 200 - 500 banorë përbëhet nga 5 vendbanime nga gjithsej 16 që gjenden në territorin e komunës së Shtërpcës, përkatësisht: tele, Drajkovc, Izhance, Kaštanjeva dhe Sushicë.

Në kategorinë e dytë të vendbanimeve të populluara (vendbanime të mesme rurale) me madhësi prej 501 deri në 1000 banorë, janë 7 vendbanime: Berevcë, Brezovicë, Verbeshticë, Gornja Bitinja, Gotovusha, Bitinja e Madhe dhe Jazhinac. Kategoria e tretë e vendbanimeve të populluara (vendbanime të mëdha të mesme dhe rurale) me 1001-2500 banorë përbëhet nga 3 vendbanime: Brod, Sevce dhe Firaja.

Kategoria e katërt e vendbanimeve të populluara (vendbanimi i madh rural) me më shumë se 2500 deri në 5000 banorë hynë në Shtërpcë, e cila njihet si zona qendrore.

3.9.1. Vendbanimet sipas madhësisë dhe numri i banorëve

Komuna e Shtërpcës bën pjesë në radhën e komunave të vogla në territorin e Kosovës dhe shtrihet në 248 km2 që përbën 2.3% të territorit të Kosovës. Kjo është një zonë kodrinore-malore e ndarë për efekt administrimi në 15 zona kadastrale dhe 16 Vendbanime, me sipërfaqe pre 248 km², me dendësi prej 28 b/km², me gjithsejtë 10771 banorë.

Nga pikëpamja e trendeve demografike vetëm Sevca, Shtërpca, Firaja dhe Brodi kanë shënuar trende pozitive viteve të fundit dhe dendësia e popullatës është edhe në këto vendbanime mesatare, vlen të ceket edhe një shpërndarje jo e balancuar e popullsisë në Komunën e Shtërpcës.

Vendbanimi	Nr. i banorëve	Kategorizimi i vendbanimit	Sipërfaqja (km²)	Klasifikimi i vendbanimit
Beroc	336	Vendbanim i vogël rural	11,84	Qendër e rendit të ulët
Biti e Epërme	574	Vendbanim i vogël rural	93,43	Qendër e rendit të mesëm
Biti e Poshtme	735	Vendbanim i vogël rural	65,21	Qendër e rendit të mesëm
Brezovicë	70	Vendbanim shumë i vogël rural	27,25	Qendër bazike
Brod	2551	Vendbanim i mesëm i madh rural	16,64	Qendër e rendit të ulët
Drejkoc	119	Vendbanim shumë i vogël rural	10,94	Qendër e rendit të ulët
Firajë	1677	Vendbanim i mesëm i madh rural	10,94	Qendër e rendit të ulët
Gotovushë	504	Vendbanim i vogël rural	16,12	Qendër e rendit të mesëm
Izhanc	102	Vendbanim shumë i vogël rural	37,71	Qendër e rendit të ulët
Jazhincë	188	Vendbanim shumë i vogël rural	15,46	Qendër e rendit të ulët
Kashtanjevë	136	Vendbanim shumë i vogël rural	18,28	Qendër e rendit të ulët
Sevcë	202	Vendbanim shumë i vogël rural	40,97	Qendër e rendit të ulët
Sushicë	87	Vendbanim shumë i vogël rural	10,72	Qendër e rendit të ulët
Shtërpcë	2,440	Vendbanim i shumë i vogël urban	35,30	Qendër e rendit të mesëm
Vërbeshticë	615	Vendbanim i vogël rural	41,82	Qendër e rendit të ulët
Viqë	435	Vendbanim i vogël rural	71,48	Qendër e rendit të ulët
TOTALI	10,771			

Tabela 141 Vendbanimet sipas madhësisë dhe numri i banorëve

Trajtimi i vendbanimeve të banuara në planet zhvillimore komunale është i nevojshëm dhe kyç, sepse e tërë veprimtaria dhe organizimi i jetës së shoqërisë së njerëzve kanë qenë dhe do të jenë të ndërlidhura me ta. Tipologjia e vendeve të banuara sipas madhësisë është një nga metodat më të rëndësishme për shfaqjen e karakteristikave të sistemit të popullsisë në hapësirat e caktuara siç është mënyra e kualitetit te jetës në vendet e banuara në këtë hapësirë, sepse, vendbanimi më i banuar nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte, ndërsa vendbanimi me më së paku banorë nënkupton të kundërtën e të mëparshmes. Pikërisht për shkak të kësaj arsye, vendbanimet e banuara karakterizohen për nga madhësia e banorëve dhe në bazë të shumë analizave këto problematika përcaktojnë pikat strategjike për zhvillim të mëtutjeshëm të komunës por edhe më gjerë.

Vendbanimet e banuara, sipas madhësisë demografike dhe kushteve tjera në komunën e Shtërpcës sipas normave teknike të planifikimit mund t'i kategorizojmë në:

- Vendbanim rural i madh 2,500-5,000 banorë;
- Vendbanim i mesëm i madh rural 1,000-2,500 banorë;
- Vendbanim i mesëm rural 500-1,000 banorë; dhe
- Vendbanim i vogël rural 200-500 banorë.

Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit	Klasifikimi i vendbanimit	Vendbanimet	Numri i vendbanimeve
5,000-10,000 banorë	Vendbanim shumë i vogël urban		-
2,500–5,000 banorë	Vendbanim rural i madh		
1,000-2,500 banorë	Vendbanim i mesëm i madh rural	Brod, , Shtërpcë, Sevce,	3
500-1,000 banorë	Vendbanim i mesëm rural	Brezovica, Jazince, Berevce, Firaja	4
200-500 banorë	Vendbanim i vogël rural	Biti e Epërme, Biti e Poshtme, Vërbeshticë, Viqë	4
<200 banorë	Vendbanim shumë i vogël rural	Drajkoc,Izhanc, Kashtanjevë, Sushicë,	4

Tabela 142 Klasifikimi i vendbanimeve sipas normave të planifikimit

3.9.2. Vendbanimet sipas funksionalitetit dhe rrjetit ndërlidhës

Në territorin e komunës së Shtërpcës, rrjeti i rrugëve të kategorizuara, regjionale dhe rrugore që lidhin qendrën e vendbanimeve me rrugën regjionale, shtrihet në gjetësi totale prej 70 km. Nga këto, 54 km ose 77% janë rrjet bashkëkohor. Komuna është pa rrugë magjistrale. Rruga regjionale që kalon nëpër territorin e komunës në drejtim të jugperëndimit – verilindjes është me një shtrirje bashkëkohore dhe lidh Komunën e Prizrenit, në jugperëndim dhe me rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj – Shkup, në lindje. Në territorin e Komunës së Shtërpcës, rruga regjionale është e gjatë 25 km, me gjerësi prej 6-7 m. Rrugët lokale lidhin vendbanimet me rrugën regjionale, apo qendrën turistike me rrugën regjionale. Këto rrugë janë rrugë me ose pa shtresë bashkëkohore. Gjerësia e rrugëve lokale me shtresë bashkëkohore është 3-5 m. 36

Sistemi i qarkullimit dhe transportit në Shtërpcë vuan disa problematika: Qarkullimi vuan mungesën e rrjedhshmërisë kryesisht për shkak të një rrjeti rrugor që nuk është projektuar për të akomoduar një presion qarkullues të këtij niveli. Kuptohet që mungesa e hierarkisë së rrjetit rrugor dhe niveli i lartë i rrugëve me fund janë një pjesë e shkaqeve që krijojnë trafik në Shtërpce. Mungesa e disiplinimit të qarkullimit vjen për shkak të mungesës së planifikimit të rregullave të qarta në qarkullim. Rrjeti qarkullues nuk është i larmishëm. Parkimi është një temë që influencon tepër qarkullimin në Shtërpcës. Problem shtesë janë vështirësitë e fshatrave malore në zona më të thella, posaçërisht gjatë sezonit të dimrit, kur edhe bllokohen rrugët si rezultat i motit të keq dhe reshjeve të shumta të borës.

Ndërmarrja regjionale e Ujësjellësit është përgjegjëse për furnizimin me ujë për Shtërpce dhe fshatrave të Shtërpcës. Në këto fshatra, vetëm një pjesë e banoreve kanë kontratë me Ndërmarrjen, kurse disa të tjerë shfrytëzojnë burime individuale. Kjo ndodh kryesisht për arsye se:

- rrjeti nuk e furnizon të gjitha vendbanimet, shumë shtëpi kanë sistem privat të furnizimit me ujë me puse private, ose u mungon furnizimi me ujë;
- përdoruesit furnizohen, por me lidhje ilegale, shpesh ngaqë ndërtimi i shtëpisë është bërë në mënyrë informale;
- sistemi i furnizimit me ujë është i vjetër.

Për sa kohë furnizimi me ujë i Shtërpcës vazhdon të jetë me ndërprerje, do te vazhdoje te jete prezent rreziku për shëndetin për shkak te ndotjes kryesisht bakteriale te ujit. Klorifikimi kryhet në impiantin e trajtimit te ujit ose depozitat e ujit te pijshëm dhe ne përgjithësi uji karakterizohet nga teprice klori si mase preventive për te parandaluar ndotjen bakteriale. Ka pas raste, sidomos ne stinën e nxehtë, të sëmundjeve gastro-enterike, por mungojnë evidencat që të mund të përcaktojnë lidhjen ndërmjet ujit të ndotur dhe sëmundjes. Në vendbanimet e mëdha të Shtërpcës, në përgjithësi është rritur konsumi i ujit të konfeksionuar si masë për të shmangur mundësinë e kontaminimit edhe nga uji i depozitave nëpërmjet të cilave furnizohen shumica e objekteve. Komuna e Shtërpcës ka burime të mjaftueshme ujore për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe në perspektive. Komuna furnizohet, nga disa burime uji. Një pjesë e sistemit të furnizimit me ujë është i vjetër dhe punon nën kapacitetin e projektuar, ndërkohë që ka dhe shumë humbje në rrjet, nuk disponohet informacion i plotë i lidhjeve ilegale për përdorim shtëpiak dhe ujitje. Ka të dhëna që në disa puse të ceket, uji nëntokësor është i ndotur. Gjithsesi shifra e humbjeve mendohet të jetë e lartë.

Në Komunën e Shtërpcës 12,5 % e vendbanimit është i mbuluar më rrjetin publik të kanalizimit, 25 % është në procesin e ndërtimit, 6,25 % është pjesërisht i mbuluar dhe 5,25 % nuk është i mbuluar me rrjetin e kanalizimit. Në territorin e Komunës së Shtërpcës, nuk ekziston rrjeti kryesor i kanalizimit.

Shumë nga vendbanimet në Komunës së Shtërpcës nuk kanë menaxhim efektiv të kanalizimit/ujërave të ndotura. Janë ndërtime të paligjshme që derdhen drejt e në lumenj, të cilët shpesh janë standardit dhe rrjedhin, duke shkaktuar

[36] Shënimet nga VSM i Planit Zhvillimor Komunal, Komuna Shtërpce, 2020

ndotjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësore. Mungesa e trajtimit të ujërave te ndotura përbën ndoshta rrezikun të madh mjedisor për Shtërpcën dhe sigurisht shkakton ndotje të madhe. Duhet vënë në dukje se MMPH ka parapa impiant regjional për trajtimin e ujërave të zeza konfiguracioni i terrenit të Shtërpcës nuk paraqet ndonjë përparësi në ketë funksion përpos në segmente të caktuara.

Menaxhimi i mbeturinave në komunë bëhet nga "NJKP' (Novo Javno Komunalno Preduzeće/Kompania e Re Publike Komunale). Në bazë të të dhënave të fituara "NJKP" 80 % të vendbanimeve janë të mbuluar me shërbime komunale. Nga 16 vendbanime në komunën e Shtërpcës, vetëm 3 fshatra nuk janë të mbuluar me shërbime komunale (Sushica, Izhanca dhe Kashtanjeva), për shkak të terrenit të pakalueshëm. Pajisjet komunale janë të shpërndarë në mënyrë të barabartë në 13 fshatra. Për grumbullimin e mbeturinave janë në dispozicion kontejnerët 1,1 m³, të cilët janë të shpërndarë pranë institucioneve publike dhe shportat të cilat i posedon gati çdo shtëpi. Në vendbanimet të cilat nuk janë të mbuluar me shërbime komunale, deponimi i mbeturinave bëhet ne deponi të egra. Komuna jonë nuk posedon deponi në të cilat do të mund të deponoj mbeturinat, por mbeturinat i transporton në Gërlicë dhe Gjilan[37].

3.9.3. Vendbanimet sipas lloji dhe lartësia mbidetare e vendbanimeve

Komuna e Shtërpcës paraqet zonë malore me tërësi specifike të dhëmbëzuar dhe me shtrirje të lartësisë mbidetare e cila sillet nga 900 m në luginën e Lepencit deri në 2.500 m në majën më të lartë, Luboten. Përderisa pjesa më e madhe e vendbanimeve shtrihen në zonat e rrafshëta në lartësinë mbidetare nga 764m deri në 1276 m, ku në këtë lartësi ndodhet edhe zona urbane apo qyteti i Shtërpcës.

Vendbanimi	Sipërfaqja (km²)	Lartësia mbidetare	Vendbanimi	Sipërfaqja (km²)	Lartësia mbidetare
Beroc	11,84	1033	Izhanc	37,71	793
Biti e Epërme	93,43	1087	Jazhincë	15,46	1044
Biti e Poshtme	65,21	849	Kashtanjevë	18,28	1085
Brezovicë	27,25	1020	Sevcë	40,97	1276
Brod	16,64	836	Sushicë	10,72	1276
Drekoc	10,94	1020	Shtërpcë	35,30	1020
Firajë		1059	Vërbeshticë	41,82	1020
Gotovushë	16,12	1064	Viqë	71,48	764

Tabela 143 Vendbanimet dhe lartësitë mbidetare

Vendbanimet në terrenet më të ulëta, ose vendbanimet e rrafshit, shtrihen në lartësinë mbidetare deri në 760 - 850 m. Këto vendbanime, kryesisht kanë tokë më pjellore dhe merren me prodhimtari bujqësore. Disa nga vendbanimet, të cilat shtrihen deri në 850-1280 metra lartësi mbidetare në viset rrëzë viseve malore, shfrytëzojnë hapësirat malore dhe fushore. Vendbanimet e viseve kodrinore-malore dallohen me lartësi më të madhe mbidetare, prej 850-1280 metra dhe janë të pasura me pyje dhe me kullosa dhe më të varfra me toka pjellore për mbjelljen e drithërave. Populllsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

3.9.4. Raporti në mes të sipërfaqeve të ndërtuara dhe të pandërtuara

Sa i përket numrit të strukturave të ndërtuara, në Komunë pjesa më e madhe e ndërtimeve janë ndërtesa banimi me një njësi, pastaj banimi me shumë njësi dhe të fundit për nga numri i strukturave renditen ndërtesat dyqanet dhe zyret. Sa përket sipërfaqeve të strukturave të ndërtuara, në Komunë pjesa më e madhe e ndërtimeve janë ndërtesa banimi me një njësi, pastaj ndërtesa banimi me shumë njësi, komerciale , administrative e kështu më radhë.

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për stabilitet social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie njerëzore në përgjithësi.
Zona urbane e qytetit të Shtërpcës karakterizohet me dendësi më të lartë se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 56.13 b/ km². Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane.
Bazuar në regjistrimin zyrtar të banimit të vitit 2011, njësitë e banimit janë kryesisht në zonën urbane.
Tipologjia e banimit në komunë është relativisht e ngjashme në nivel vendi. Më të zakonshme janë shtëpitë familjare të veçuara, ndërsa shtëpitë dyshe apo ato në varg duken të jenë më pak të favorizuara për banim.

Zonat Kadastrale	**Vendbanimi**	**Populllsia**	**Sipërfaqja ZK (ha)**	**Kufiri ndërtimor (ha)**	**Sipërfaqja e ndërtuar (ha)**	**Lartësia mbidetare**
Kashtanjeva	Kashtanjeva	0	1828	113.78	1.06	1131-1530
Sevcë	Sevcë	1192	4097	52.88	6.01	1250-2000
Brod	Brod	2,551	1664	174.67	6.48	780-1950

[37] Shënimet nga VSM i Planit Zhvillimor Komunal, Komuna Shtërpce, 2020

Bitija e Posh.	Bitija e Poshtme	735	652.1	37.62	3.14	610-1200
Viça	Viça	280	714.8	34.97	1.65	749-950
Brezovica	Brezovica	70	272.5		1.01	2100-2350
Vërbeshtica	Vërbeshtica	320	4182	216.26	9.7	1900-2350
Sushiqi	Sushiqi	147	1072	17	0.95	1125-1350
Jazhinca	Jazhinca	188	1546	53.49	4	2000-2350
Shtërpca	Shtërpca	2431	3530	169.81	18.55	1107-1955
Bitija e Epërme	Bitija e Epërme	574	934.3	45.21	2.8	830-1340
Berofci	Berofci	336	1184	26.81	4.02	1033-1400
Gotovusha	Gotovusha	504	1612	39.95	5.46	850-2232
Drajkoc	Drajkoc	119	1094	118.92	5.48	833-2230
Izhanci	Izhanci	8	377.1	45.07	0.46	600-1069
Total		10,771	24759.8	1146.44	70.77	

Tabela 144 Vendbanimet – kufiri ndërtimor dhe sipërfaqet e ndërtuara

3.9.5. Vendbanimet Urbane

Zona urbane apo zona qendrore e Shtërpcës është një qytezë e vogël me karakter urban në një lartësi mbidetare nga 850m deri më 1050m. Shtërpca luan një rol me rëndësi në zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. Pozita e saj gjeo-morfologjike dhe vet struktura fizike e qytezës ofron një mundësi të mirë për të jetuar dhe vepruar.

3.9.6. Vendbanimet rurale

Rrjeti i vendbanimeve rurale në Komunën e Shtërpcës paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore të vendbanimeve rurale. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në Komunën e Shtërpcës, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Komuna e Shtërpcës i ka 15 vendbanime të karakterit rural me 10,771 banorë..

3.9.7. Trendët, nevojat, projeksionet dhe prognozat

Trendi i zhvillimeve dëshmon se një pjesë e komunës së Shtërpcës, është zhvilluar në mënyrë relativisht të pa kontrolluar. Zona urbane ka pasur koncentrim më të madh të ndërtimeve, ndërkohë që në zonat rurale zhvillimi ka qenë i shpërndarë në të gjithë territorin dhe rrjedhimisht i pa balancuar. Intensitet më të madh zhvillimi dhe më të shpërqendruar ka pësuar pjesa qendrore e komunës, në veçanti vendbanimet përreth zonës urbane.

Zhvillimi i shpërqendruar ka ndodhë për shkak të presionit të madh për ndërtim në qytetin e Shtërpcës, gjë që ka ndikuar që ndërtimet të kalojnë përtej kufirit aktual të zonës urbane në vendbanimet përreth. Në këtë mënyrë, vendbanimet rurale pothuajse janë bashkëngjitur me zonë urbane duke marr parasysh shkallën e zhvillimit. Zhvillimet me intensitet më të lartë vërehen sidomos në jug-perëndim të zonës urbane. Si të tilla, këto vendbanime sot funksionojnë si qendra sub-urbane si rezultat i afërsisë së tyre me qytetin dhe kërkesës së lartë për zhvillim dhe shërbime. E njëjta nuk mund të thuhet për fshatrat malore më të largëta të Komunës së Shtërpcës.

Me rastin e hulumtimit të gjendjes ekzistuese gjatë hartimit të Profilit komunal janë evidentuar vendbanimet me potencial të zgjerimin dhe në hartimin e vizionit për zhvillimin e komunës është trajtuar edhe tema e zgjerimit të vendbanimeve. Vendbanimet ku nuk parashihet zgjerim të hapësirës banuese në shtrirjen e tyre territoriale, sugjerohet që zhvillimet eventuale të orientohen drejt densifikimit, kompaktësimit të strukturës fizike.

Zgjerimi i vendbanimeve para së gjithash duhet të bazohet mbi parimet e densifikimit, shfrytëzimit racional të tokës dhe mbrojtjes së tokës bujqësore.

Vendbanimi	**Kategori e rendit hapësinor**[38]	**Morfologjia hapësinore** [39]	**Dendësia ndërtimore** [40]	**Reliefi**[41]	**Identiteti ekonomik** [42]	**Klasifikimi i vendbanimit**

[38]Hapësirë rurale, qendër e zhvillimit rural, hapësirë urbane dhe hapësirë e zgjeruar urbane, sipas 6.1.4. Kategori e rendit hapësinor nga Kodi Hierarkik i Rregullimit Plotësues.
[39]Linear, i koncentruar, i shpërndarë.
[40] E lartë, mesatare, e ulët (0-7%, 7-10%, >10%).
[41] Malor, i rrafshit, i përzier.
[42] Bujqësor, shërbime, përzier, tjera.

Berevca	Hapësirë Urbane	I shpërndarë	E ulët	Malor - 1033-1400	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Brezovica	Hapësirë Rurale/ Hapësirë e zgjeruar urbane	Linear	E lartë	Malor- 2100-2350	I përzier	Qendër bazike
Brod	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor- 780-1950	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Viça	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I përzier- 749-950	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Vërbeshtica	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	Malor- 1900-2350	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Bitia e Epërme	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	I përzier - 830-1340	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Gotovusha	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	I përzier- 850-2232	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Bitia e Poshtme	Hapësirë Rurale	I koncentruar	Mesatare	I përzier - 610-1200	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Drajkoci	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor- 833-2230	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Izhanca	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I përzier - 600-1069	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Jazhinca	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	Malor- 2000-2350	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Kashtanjeva	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I përzier- 1131-1530	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Sevca	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	Malor- 1250-2000	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Sushica	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	E ulët	I përzier- 1125-1350	Bujqësor	Qendër e rendit të ulët
Firaja	Hapësirë Rurale	I shpërndarë	Mesatare	Malor - 833-2230	Bujqësor	Qendër e rendit të mesëm
Shtërpca	Hapësirë Urbane	Linear	E lartë	I përzier- 1107-1955	I përzier	Qendër bazike

Tabela 145 Kategorizimet e vendbanimeve

3.9.8. Depopullimi i vendbanimeve

Depopullimi është proces kompleks që po vazhdon në territorin e Kosovës, kryesisht në zonat kodrinore malore me lartësi të madhe mbidetare etj. Kjo dukuri është prezente edhe në komunën e Shtërpcës, e më e theksuar është në vendbanimet të cilat janë më larg nga qendra e qytetit. Kjo ndodh për shkak të kushteve të vështira që mbretërojnë në këto vendbanime, kushte që krijohen nga faktorët natyror, ekonomik, social, infrastruktura e pazhvilluar, niveli i ulët i shërbimeve, etj.

Depopullimi më i madh ka ndodhur në qytetin e Shtërpcës, pas vitit 1999. Arsye kryesore për depopullim është shpërngulja e popullsisë jo shqiptare posaçërisht popullsisë serbe pas vitit '99. Ndërsa sa i përket vetëm popullsisë shqiptare, depopullimi është shfaqur më shumë në këto vendbanime : Brod, Firajë. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, Koshtanjeva pa pësuar depopullim total she sot nuk e ka asnjë banorë (0), Izance i ka 8 banorë etj.

Përshkak të koncentrimit më të madh të veprimtarive ekonomike, si atyre industriale dhe shumë veprimtarive tjera në Shtërpce, të cilat janë më atraktive për numrin e madh të të papunësuarve në fshatra që në rrethanat e futjes së mekanizimit në bujqësi mbesin pa punë. Rrjedhimisht, rrethanat ekonomiko- sociale ndikuan në lëvizjen e popullsisë drejt qendrave urbane, duke u shndërruar nga migrues ditor e javor, në migrues të përhershëm.

3.9.9. Zgjerimi i vendbanimeve

Me rastin e hulumtimit të gjendjes ekzistuese gjatë hartimit të Profilit komunal janë evidentuar vendbanimet me potencial të zgjerimit dhe në hartimin e vizionit për zhvillimin e komunës është trajtuar edhe tema e zgjerimit të

vendbanimeve. Zgjerimi i vendbanimeve është përkufizuar në hartë. Vendbanimet ku nuk parashihet zgjerim të hapësirës banuese në shtrirjen e tyre territoriale, sugjerohet që zhvillimet eventuale të orientohen drejt densifikimit, kompaktësimit të strukturës fizike.

Zgjerimi i vendbanimeve para së gjithash duhet të bazohet mbi parimet e densifikimit, shfrytëzimit racional të tokës dhe mbrojtjes së tokës bujqësore.

Komuna e Shtërpcës është ndarë për efekt administrimi në 15 zona kadastrale dhe 16 Venbanime me sipërfaqe pre 247.60 km2. Nga pikëpamja e trendeve demografike, vetëm Sevca, Shtërpca, Firaja dhe Brodi kanë shënuar trende pozitive viteve të fundit dhe dendësia e popullatës është edhe në këto vendbanime mesatare, vlen të ceket edhe një shpërndarje jo balancuar e popullsisë në komunën e Shtërpcës. PZHK-ja ka paraqitur shpërndarjen sipas numrit të popullsisë për secilin vendbanim duke u kujdesur që në të ardhmen të krijohet një „linje" e shpërndarjes së popullatës në konceptin policentrik. Duke marr parasysh disa parametra edhe demografik edhe fizik, ekonomik por edhe mjedisor janë propozuar kufijtë e rij ndërtimor për të gjitha vendbanimet.

Komuna e Shtërpcës ka një sipërfaqe prej 24.770 ha. Numri i banorëve i Komunës së Shtërpcës është rreth 6.949 banorë59 dhe është në kategorinë e Vendbanimit shumë të vogël urban60 (Qendër sekondare)

Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Shtërpcës

- Në vitin 2000 ZU e Shtërpcës ka pas një sipërfaqe prej 73 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Shtërpcës ka rreth 78 ha ose afërsisht për 7 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Shtërpcës ka një sipërfaqe prej 79 ha, ose 1.2 % më e madhe nga matja paraprake;
-Në vitin 2024 ZU e Shtërpcës ka një sipërfaqe prej 81 Ha ose 2,5 % me e madhe se matja e fundit.
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është shumë e vogël duke e krahasuar me vitin 2000, ZU e Shtërpcës është e bashkuar me VB Berofcë;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta me tokë bujqësore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi me etazhitet të ulët.

DRAFT

Emri i Vendbanimit	Kufijtë ekzistues ndërtimor (Ha)	Kufijtë e planifikuar ndërtimor (Ha)
Brod	58.18	97.1
Viça	15.28	25.85
Drajkoc	63.11	121.11
Berefce	23.3	27.12
Gotovusha	29.03	28.79
Vërbeshtica	89.41	108.97
Shtërpca	93.94	101.88
Sevce	56.17	66.19
Kashtanjeva	18.26	14.51
Izhanci	15.01	5.15
Sushiqi	6.15	10.34
Biti e Epërme	44.01	32.96
Biti e Poshtme	23.59	20.56
Jazhinca	35.18	41.88
Totali	570.62	702.41

Tabela 146 Kufijtë ekzistues dhe të planifikuar të vendbanimeve

Nga shënimet e lartë shkruara, shihet qartë se në kuptimin e zgjerimit të zonës ndërtimore për 10+ vite, janë paraparë 702.41 ha që do të thotë, një tregues për zënien e tokës prej 131.79 ha dhe shtrirja është e planifikuar me PZHK drejtë tokës me plleshmëri më të dobët.

Në tabelën e bashkangjitur më poshtë, prezantohen shënimet se në cilat vendbanime nevojitet zgjerimi dhe në cilat kompaktësimi. Shënimet janë si më poshtë:

Vendbanimet ku nevojitet zgjerimi	Vendbanimi ku nevojitet kompaktësimi
Qyteti	Qyteti
Brod	Gotovushë
Viça	Sevce
Drajkoc	Kashtanjevë
Vrbeshticë	Sushicë
Shtrpce	Biti e Epërme dhe e Poshtme

Tabela 147 Vendbanimet që parashihet të zgjerohen dhe ato që parashihet të kompaktësohen

Vendbanimet e përcaktuara për zgjerim janë vendbanime të cilat ky koncept I parasheh si vendbanime me potencial zhvillimi. Këtu hyn zona urbane, Qyteti, vendbanim I cili ka potencialin me të madh për rritje. Gjithashtu, të gjitha këto vendbanime tregojnë rritje të trendit të popullsisë në projeksionet e demografisë, çka çon në kërkesë për rritje edhe të kufijve ndërtimor. Për më shumë, këto vendbanime do të pranojnë banorët e zhvendosur nga zonat e mihjeve, që rritë kërkesën për banim dhe zhvillim të tyre.

Vendbanimet e përcaktuara për kompaktësim janë vendbanime të cilat ky koncept I parasheh si vendbanime që duhet të dendësohen dhe plotësohen edhe brenda kufijve të tyre ndërtimor në mënyrë që të arrihet kompaktësimi i tyre. Këto janë parë si vendbanime të shpërndara dhe me hapësira që kanë mundësi të plotësohen.

Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore
Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e lidhjes së mire mes zonës urbane me vendbanimet rurale malore;
- Qasja e dobët nga vendbanimet sub- urbane në zonë urbane;
- Shuarja e vendbanimeve malore dhe dyndja e tyre ne zonë urbane;
- Mungesa e qasjes në infrastrukturë teknike-ujësjellës e kanalizim për disa nga vendbanimet;
- Mungesa e infrastrukturës përkatëse si dhe shpërndarja jo e balancuar e infrastrukturës publike dhe sociale;
- Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban;

- Numër i lartë I ndërtimeve pa leje, që duhet integruar dhe urbanizuar;
- Zhvillime të paplanifikuara me mungesën konsekuente të shërbimeve dhe hapësirave të gjelbër publike ;
- Morfologji dhe strukturë urbane jo konsistente në pjesët sub- urbane të qytetit;
- Mungesë e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në lagjet sub- urbane;
- Zgjerime të mëdha me densitet të ulët të cilat konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar;

Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara

- Qyteti i Shtërpcës paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për gjithë territorin e komunës.
- Qyteti i Shtërpcës i takon tipit të koncentruar të vendbanimeve. Nëse e analizojmë madhësinë e parcelave në zonën urbane, atëherë del se kemi të bëjmë më një territor mjaft të fragmentuar.
- Shumica e vendbanimeve janë të tipit të shpërndarë - me karakter malor, me dendësi të ulët të banimit, dhe mungesë të infrastrukturës, pastaj ato të tipit të koncentruara , e që tregon drejtë për drejtë mungesën e një planifikimi të mirëfilltë para zhvillimit të vendbanimeve, dhe në fund në një numër shumë të vogël vendbanimet lineare, që janë vendbanime të zhvilluara për-rreth rrugëve kryesore te komunës.
- Kjo shpërndarje e banimit brenda vendbanimeve ka rezultuar edhe me një dendësi të ulët apo mesatare tek shumica e vendbanimeve, me përjashtim të zonës urbane dhe vendbanimeve rreth saj, që vjen si rezultat i kërkesave të shumta për banim për shkak të zbrazjeve të vendbanimeve rurale/malore, drejt zonës urbane.
- Shtërpca karakterizohet me tri lloje të relievit, pjesa qendrore e saj si zonë e rrafshët, unaza rreth saj duke shkuar kah veriu si zonë e përzier dhe pjesa jug-perëndimore zonë e thellë malore.
- Edhe karakteri ekonomik në Komunë mund të themi se në një masë dirigjohet nga relievi dhe afërsia me qendër. Zona qendrore që përfshinë zonën urbane me vendbanimet për rreth, zhvillojnë aktivitete të ndryshme ekonomike; zona jug-lindore relativisht zhvillon bujqësi.
  Duke parë trendet e numrit të popullsisë sipas regjistrimeve të ASK-së deri na vitin 2011, por edhe projeksione të popullsisë, del se popullsia e Shtërpcës është kryesisht në rënie me përjashtim të disa vendbanimeve ku ka rritje

Përparësitë	**Dobësitë**
▪ Qasja e mirë e vendbanimeve në shërbime komunale; ▪ Zonat për zhvillim në lokacione atraktive turistike. ▪ Zona shumë atraktive të turizmit malor, të pasura me shtigje të skijimit.	▪ Mungesa e informative për thellim të analizave për zhvillimet e planifikuara me PZHK ▪ Ndërtimet informale edhe në vikend zona; ▪ Përqindje e lartë e papunësisë; ▪ Zona me dendesi tëulëtnë numrin më të madh të vendbanimeve. ▪ Vendbanime të thella malore; ▪ Gjatë stinës së dimrit, lidhje e vështërësuar e vendbanimeve me qendrën e Shtërpcës ▪ Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore
Mundësitë	**Rreziqet**
▪ Hartimi Ligjit për Rregullim të tokës urbane (ku lehtëson miratimin dhe zhvillimin e planifikimit urban në kadastër). ▪ Dendësimi i planifikuar i vendbanimeve ekzistuese në bazë të planeve hapësinore-veçanërisht në fshatra dhe në zonat sub-urbane; ▪ Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave urbane dhe për ndërtim të reja në sipërfaqe të përshtatshme për urbanizim	▪ Migrimi i popullsisë fshat – qytet. ▪ Mungesa e dokumentacionit kadastral. ▪ Pronësia e paqartë mund të pengojë zhvillimin e duhur. ▪ Ndërtimet pa leje përgjatë rrugës mund ta bllokojnë zhvillimin e ardhshëm ▪ Konflikte në lidhje me çështjet e pronësisë;

Tabela 148 Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet - Analiza SWOT

3.10. VENDBANIMET JO FORMALE DHE NDËRTIMET PA LEJE43

Janë vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

Çështje shumë me rëndësi për Shtërpcën , si edhe në çdo qytet në Kosovë, janë vendbanimet Joformale (VJ) dhe zhvillimi i tyre. Në Shtërpcë nga KK, e sipas Udhëzuesit për Planifikim Hapësinorë për Vendbanime Joformale të Ministrisë për Planifikim Hapësinorë, janë identifikuar 3 vendbanime joformale.

Sipas të dhënave të fundit nga Komuna e Shtërpcës, nuk ka vendbanime joformale të regjistruara në kuadër të Komunës së Shtërpcës. Megjithatë, sipas raportit të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, në Strpac janë identifikuar 3 vendbanime joformale.

Vendbanimet joformale janë çështje që prekin të gjitha komunitetet në Kosovë. Bazuar në definicionin që jep Ligji Nr. _04_L-174_Ligjit për Planifikim Hapësinor, "Vendbanimet joformale" janë vendbanime të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, e në veçanti banim të përshtatshëm.

Janë vendbanime ku banorët nuk i gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

Ndonëse shumica e vendbanime joformale në Kosovë nuk karakterizohen me jo sigurinë e pronës, në vendbanimet e hulumtuara në Shtërpce, ekzistojnë raste të papërcaktuara të pronësisë, ku shfrytëzuesit nuk janë në posedim të pronës, si dhe numër i vogël i uzurpimeve të cilat janë në proces të zgjidhjes. Ajo që i karakterizon vendbanimet joformale në Shtërpcë janë:

- Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet elementare
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje
- Rrezikshmëria deri në diskriminim

Mungesa e shërbimeve elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale është treguar të jetë arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuate. Infrastruktura fizike në këto tri lagje edhe pse ekziston (uji, rryma, kanalizimi dhe grumbullimi i mbeturinave), ajo është joadekuate.

Nr. i Vendbanimit VJF	Sipërfaqja e përgjithshme në ha e zonave	Numri i shtëpive	Numri i banorëve	Dendësia (b/ha)
3	6.10	89	400	65,5

Tabela 149 Veçoritë e përgjithshme të Vendbanimeve Joformale

3.10.1. Karakteristikat dhe numri i banorëve

Komuna e Shtërpcës i ka të identifikuara 3 Vendbanime Joformale, me karakteristikat e prezantuara si më poshtë: Në total ka rreth 89 objekte dhe 400 banorë.[44]

Vendbanimi VJF	Sipërfaqja e përgjithshme në ha e zonave	Numri i shtëpive	Numri i banorëve	Dendësia (b/ha)
Shtërpcë	1,80	35	157	87,2
Berevce	1,60	22	99	61,8
Gotovusha	2,70	32	144	53,3

Tabela 150 Veçoritë e secilit Vendbanimit Joformal

[43] DUMM

[44] Numri i shtëpive është identifikuar sipas incizimeve ajrore të Gjeoportalit Shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net/search). Numri i banorëve është rezultat i shumëzimit të shtëpive të identifikuara, me numrin mesatar të banorëve për njësi familjare (4.5 b)



Grafiku 16 Grafiku me numër të vendbanimeve joformale sipas Komunave në Kosovë (2010)

3.10.2. Gjendja ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendbanimeve joformale të identifikuara

Sipas dokumentit të hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor 'Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Rregullimin e Vendbanimeve Joformale në Kosovë 2011-2015', përcaktohet kategorizimi i VBJ-ve dhe atë si vijon:

1. Vendbanimi Joformal në kuadër të zonës urbane apo zonës rurale;
2. Vendbanimi Joformal në afërsi të ambienteve të rrezikshme për banorët;
3. Vendbanimi Joformal në tokën me pronësi të parregulluar;
4. Vendbanimi Joformal në afërsi të zonave të mbrojtura me rëndësi për shtetin;
5. Vendbanimi Joformal me mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale, ndikim negativ në mjedis.

Konform kategorizimit si më lartë, vendbanim joformal i përket kategorisë së parë, të zotërimit joformal ose jo i sigurt i pronësisë, gjersa të gjithë banorët e këtij vendbanimi gëzojnë qasja adekuate në shërbime elementare, pjesëmarrje adekuate në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi. Sa i përket gjendjes ekonomike ky vendbanim cilësohet të ketë gjendje jo të kënaqshme ekonomike, duke pasur parasysh se shumica e ekonomive familjare i takojnë listës së familjeve me asistencë sociale.

Për të rregulluar çështjen pronësore të këtyre vendbanimeve joformale nevojitet koordinim në mes banorëve të VJF-së, autoriteteve dhe përfaqësuesve të pronës, bazuar në ligjet në fuqi deri në trajtimin përfundimtar dhe njohjen e pronësisë për banorët e VJF-së.

Sfidat, gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore.
Sfidat, identifikimi i problemeve dhe konstatimet kryesore të vendbanimeve

- Kostoja dhe kohëzgjatja e formalizimit dhe rregullimit të vendbanimeve joformale që do të duhej të jetë komponentë e obligueshme e strategjisë afatmesme dhe afatgjate të rregullimit të vendbanimeve joformale.
- Mungesa e detyrimeve ligjore për institucionet përgjegjëse të niveleve të ndryshme
- Mungesa e legjislacionit që do të i obligonte banorët e vendbanimeve joformale që të iniciojnë rregullimin e statusit pronësorë të tyre.
- Mungesa e legjislacionit, pjesa e cila do ti që do të i obligonte banorët e vendbanimeve joformale, që ta iniciojnë dhe vazhdojnë deri në përfundim rregullimin e statusit të tyre pronësorë.

Gjetjet kyçe dhe supozime të pranuara

- Drejtoria e Urbanizmit në Shtërpcë, konfirmon se nuk ka Vendbanime Joformale, përderisa Raporti i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, ka të identifikuara 3 vendbanime joformale, të cilat i kemi prezantuar si më lartë.

- Vendbanimet Joformale përfshijnë një sipërfaqe prej 6.10 ha, një numër të shtëpive prej 89 si dhe numër të banorëve 400.[45]
- Gjendja e ndërtesave të banimit nuk është shumë e mirë dhe kjo tregohet nga gjendja ekzistuese e objekteve që janë marrë sa i përket kësaj çështje;
- Destinimi i sipërfaqeve në këtë lagje, është kryesisht banim me një njësi, duke shfrytëzuar hapësira për afarizëm dhe hapësirat dhe sipërfaqet e dedikuara për rrugë.
- Mungojnë hapësirat për rekreacion.
- Vendbanimet joformale, janë pa plane rregullues, më tutje do të trajtohen me Plane respektive Rregulluese.

Pronësia mbi tokën - Dokumentacioni kadastral ekziston në Drejtorinë për Kadastër në Shtërpce dhe disa prej pronarëve i kanë fletat poseduese, duke rezultuar me pronësi të kombinuar.

Vlerësimi i përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve – Analiza SWOT

Analiza SWOT për vendbanimet joformale

Përparësitë	**Dobësitë**
- Identifikimi i VBJ - Ekziston dokumentacion kadastral për VBJ; - Sipërfaqja e territorit të identifikuar, 6.10 ha, rreth 89 shtëpi dhe 400 banorë, - Teren i përshtatshëm për ndërtim - Infrastruktura teknike bazike relativisht e mirë e vendbanimeve në përgjithësi; - Qasja e mirë e vendbanimit në shërbime komunale	- Çështja pronësore e pa zgjidhur, për të gjitha rastet e identifikuara; - Jo të gjithë banorët, kanë tituj të regjistruar të pronës; - Mungesë e menaxhimit efektiv të planifikimit hapësinor dhe kontrollit të zhvillimeve urbane; - Mosrespektimi i planeve ekzistuese urbane, si dhe mungesa e planit rregullativ, ka bërë që shërbimet themelore të mos jenë në nivelin e kënaqshëm;
Mundësitë	**Kërcënimet**
- Prona komunale, mundësi kthimi në vendbanim formal - Ofrimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore. - Zgjidhja e transportit publik - Krijimi i këshillave nga pjestarët e komuniteteve në kuadër të VBJ-ve; - Fuqizimi i rolit të përfaqësuesve, të komuniteteve në vendimmarrje duke përfshirë edhe rolin e gruas; - Inkurajimi i komuniteteve të VBJ, në kryerjen e punëve në përmirësimin e kushteve në VBJ; - Avancimit të kontrollit inspektim të VBJ - Mundësia e zhvendosjes eventuale e VBJ, në një lokacion më adekuat dhe më të përshtatshëm;	- Implikime pronësore - Implikime buxhetore - Tej zgjatja e procedurave ligjore në raport të ndërtimeve pa leje - Mungesa e një zgjidhjeje adekuate konkrete; - Mosdefinim i qartë i kompetencave institucionale;

3.10.3. Ndërtimet Pa leje

Në Regjistrin e ndërtimeve pa leje të Komunës së Shtërpcë, janë të regjistruara mbi 530[46] raste, si ndërtesa të kategorisë I-rë dhe të II-të, sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i identifikuar i ndërtimeve pa leje, pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi Ligji Nr. 06/L-024.

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Autoriteti zyrtar përkatës do ti trajtoj dhe legalizoj shumicën e ndërtimeve të kategorisë I-rë dhe II-të, mirëpo, përsëri do të mbetet një numër i konsiderueshëm i objekteve/ndërtesave, të cilat janë ndërtuar pas 30 Gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, e të cilat tutje do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim.

[45] *Numri i shtëpive individuale, është përcaktuar, përmes inqizimeve nga Gjeoportali-http://geoportal.rks-gov.net/search*

[46] Numri I ndërtimeve pa leje në Komunë të Shtrpcës, nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje të MMPH, për Shtrpce

Duke qenë se për ndërtimet pa leje kemi çështje të pronësisë së pazgjidhur, respektivisht pronësi me titullar të ndryshëm, atëherë për ndërtimet pa leje, të identifikuara në pronat me pronësi komunale, Komuna e Shtërpcës, gjatë trajtimit të VBJ, duhet të bashkëpunojnë me Kuvendin Komunal Shtërpcë (nëse eventualisht ekzistojnë), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi komunale, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Për ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore (nëse eventualisht ekzistojnë), Komuna e Shtërpcës, gjatë trajtimit të VBJ duhet të bashkëpunojnë me AKP-në (në nivel regjional dhe qendror), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi shoqërore, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, menaxhohen dhe trajtohen nën mandatin e AKP-së.

3.11. BANIMI

Për zgjidhjen e çështjes së banimit, komuna e Shtërpcës duhet të ofrojë zgjidhje të përshtatshme banesore që do t'i përshtaten nevojave të banorëve të saj aktual dhe të ardhshëm. Qasja në banim adekuat dhe të përballueshëm është një komponent themelor i cilësisë së jetës në komunë. Faktorët që ndikojnë në qasjen në banim përfshijnë kryesisht çmimin, d.m.th. ofertën dhe kërkesën për lloje të ndryshme banesash (shtëpi ose njësi banimi në ndërtesa kolektive). Tregu i lirë i banesave dhe pushteti vendor luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e zgjedhjes së përshtatshme të banesave për kategori të ndryshme familjesh me nivele të ndryshme të ardhurash.

Zona urbane e Shtërpcës karakterizohet me një dendësi më të madhe se zonat rurale dhe kjo dendësi është rreth 56.13 b/km². Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale, por e ulët për zonat urbane.

3.11.1. Trendet dhe projeksionet e banimit

Sipas projeksionit, numri i banorëve deri në vitin 2032 pritet të rritet me rreth 32%. Sipas këtyre përllogaritjeve, parashikimet e banesave deri në vitin 2032 duken kështu:

VENDBANIME	SHTËPI/ APARTAMENT Situata e objekteve në vitin 2023	SHTËPI/ APARTAMENT Projektimi i objekteve në vitin 2032
BEREVC/BEREVCE	261	345
BROD	401	529
BITI E POSHTME/DONJA BITINJA	161	213
DREKOC/DRAJKOVCE	375	495
BITI E EPERME/GORNJA BITINJA	120	158
GOTOVUSHË/GOTOVUŠA	312	412
IZHANCË /IZHANCE	17	22
JAZHINCË /JAZHINCE	205	271
KASHTANJEVË/KAŠTANJEVO	70	92
SEVCË /SEVCE	206	272
SHTËRPCE/ŠTRPCE	978	1,291
SUSHICE/SUŠIĆE	43	57
VIÇË/VIČA	70	92
VËRBESHTICË/VRBEŠTICE	832	1,098
FIRAJA/FIRAJË	261	345
BREZOVICA/BREZOVICË	445	587
Gjithsej:	4,757	6,279

Tabela 151 Numri i ndërtesave të banimit

VENDBANIMET	SHTEPI/BANESE Situata aktuale sipërfaqe (m²) 2023	SHTEPI/BANESE Projeksioni I sipërfaqeve (m²) 2023
BEREVC/BEREVCE	28,747	37,946
BROD	50,992	67,309
BITI E POSHTME/DONJA BITINJA	19,718	26,028
DREKOC/DRAJKOVCE	50,600	66,792
BITI E EPERME/GORNJA BITINJA	12,257	16,179
GOTOVUSHË/GOTOVUŠA	35,616	47,013
IZHANCË /IZHANCE	1,462	1,930

JAZHINCË /JAZHINCE	20,518	27,084
KASHTANJEVË/KAŠTANJEVO	4,600	6,072
SEVCË /SEVCE	17,857	23,571
SHTËRPCE/ŠTRPCE	122,370	161,528
SUSHICE/SUŠIĆE	3,437	4,537
VIÇË/VIČA	7,749	10,229
VËRBESHTICË/VRBEŠTICE	114,696	151,399
FIRAJA/FIRAJË	29,300	38,676
BREZOVICA/BREZOVICË	51,200	67,584
Gjithsej	**571,119**	**753,877**

Tabela 152 Sipërfaqet e objekteve të banimit

3.11.2. Çmimet mesatare të ndërtesave

Në vitet e fundit jemi dëshmitarë të një rritje të çmimeve të pasurive të paluajtshme në të gjithë botën. Kjo u ndikua kryesisht nga Pandemia Covid-19 si dhe nga lufta në Ukrainë, e cila ka filluar në fillim të vitit 2022, për shkak të së cilës u rritën çmimet e karburanteve, e cila më pas rriti çmimet totale në mënyrë zinxhirore. Edhe tregu i ndërtimit nuk mund të mbetet imun ndaj zhvillimeve të tilla, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve të ndërtimit. Për shembull, gjatë 2019-22. çmimi i hekurit është dyfishuar.

Për shkak të këtyre zhvillimeve, çmimet e patundshmërive në mbarë Kosovën janë rritur. Çmimet e banesave për metër katror në Shtërpcë variojnë kryesisht në varësi të vendndodhjes, por mesatarisht janë nga 600 deri në 900 euro/m2.

Çmimet mesatare të qirave të ndërtesave ndryshojnë dhe varen nga zona, vendndodhja dhe cilësia e ndërtimit. Ndërsa mesatarisht çmimi për marrjen me qira të një apartamenti me 2 dhoma është 150-300 euro.

Edhe çmimet e ndërtimit janë rritur ndjeshëm. Sipas disa kompanive të kontaktuara, kostoja e ndërtimit në gjithë Kosovën është rritur me rreth 20-30% dhe në gjysmën e parë të vitit 2023, ndërtimi për një metër katror të një objekti (shtëpi apo njësi banimi) kushton 350-450 euro.

3.11.3. Nevojat për banim për të ardhmen

Politika e banimit në komunën e Shtërpcës duhet të jetë në përputhje me nevojat e popullatës, por edhe sipas normave teknike në mënyrë që banorëve të Shtërpcës t'u mundësohet një jetë e lehtë dhe cilësore.

Fakti që kjo komunë është qendër turistike dhe ka potencial të madh për përmirësimin e turizmit duhet të merret parasysh edhe në planifikimin e banimit.

Banorëve të Shtërpcës duhet t'u sigurohet një zgjedhje e akomodimit në të gjithë qytetin përmes një përzierje të llojeve të banimit për të përmbushur një sërë nevojash banimi për të gjitha komunitetet;

Më poshtë është një përshkrim se si duhet të zhvillohet banimi në komunën e Shtërpcës:

Kriteret për ndërtimin e ndërtesave të reja kolektive:

Shtërpca do të inkurajojë zgjerimin afatgjatë të banesave që të bëhet në një mënyrë logjike dhe të qëndrueshme që maksimizon përdorimin efikas të tokës dhe infrastrukturës në dispozicion.

Përbërja e banesës:

Shtërpca do të inkurajojë një shumëllojshmëri të llojeve, formave, përballueshmërisë dhe dendësisë së banesave kolektive në zonat e banuara të mbështetura nga dizajni cilësor, aksesi në lehtësitë dhe shërbimet lokale dhe kapaciteti infrastrukturor. Ruajtja e sipërfaqeve të gjelbra do të konsiderohet me kujdes në përputhje me planet komunale për mbrojtjen e mjedisit.

Integrimi i llojit të banesave:

Shtërpca do të mbështesë dizajnin e banesave që përqafon dhe integron me kujdes dendësi të ndryshme banimi brenda një lagjeje ose në një bllok apo rrugë të vetme për të krijuar tranzicion të qetë vizual midis llojeve të ndryshme të banesave.

Parkingje:

Shtërpca do të sigurojë që projektet e banimit me njësi të shumta të ofrojnë parking nëntokësor, si dhe afër vendbanimeve apo objekteve afariste në mënyrë që të mundësohet qarkullimi më i lehtë i këmbësorëve dhe automjeteve.

Siguria në rrugë/lagje:

Siguria e lagjes, qoftë nga grabitësit apo shkelësit e rregullave të komunikacionit në lagje, është shumë e rëndësishme për komunën e Shtërpcës. Për këtë qëllim, në projektet e ardhshme duhet të inkorporohet një pjesë e sigurisë dhe nuk mund të merret leja për përdorimin e saj pa marrë parasysh temën e sigurisë në lagje. Gjithashtu, duhet të bëhet një studim fizibiliteti për vendbanimet emocionuese, ku duhet të ndërtohet siguria për banorët e Shtërpcës.

Performanca e energjisë

Kursimi i energjisë në ndërtesat e banimit, veçanërisht në ndërtesat kolektive, duhet të trajtohet me shumë seriozitet dhe në përputhje me ligjet aktuale. Në këtë drejtim duhet të bëhet një studim fizibiliteti dhe të aplikohen fonde qeveritare dhe ndërkombëtare për të reduktuar nevojën për energji elektrike qoftë nëpërmjet termoizolimit, instalimit të paneleve apo formave të tjera moderne.

Strehimi inovativ

Shtërpca duhet të mbështesë partneritete inovative dhe të eksplorojë modele kreative financimi, rregullore, standarde dhe procese miratimi, si dhe stimuj për sektorin privat për të ofruar projekte banimi ku mund të demonstrohet se produkti do të jetë mjaft tërheqës dhe funksional në dizajn dhe pamje për të justifikuar ndryshimet në Standardet ekzistuese.

Shtërpca do të inkurajojë kompanitë e ndërtimit që të përdorin metoda efikase dhe më të lira të ndërtimit në lidhje me elementet e parafabrikuara, materialet e ndërtimit dhe format e ndërtuara që rezultojnë në strehim estetikisht tërheqës dhe të përballueshëm.

Si përfundim, Komuna e Shtërpcës do të shqyrtojë me kujdes kriteret për ndërtimin dhe qëndrimin e familjeve në objektet kolektive në përputhje me ligjet në fuqi që trajtojnë këtë çështje. Disa nga kriteret bazë janë si më poshtë:

1. Të ketë lloje të ndryshme banimi për të plotësuar nevojat për strehim dhe nevojat sociale;

2. Të ketë dizajn adekuat urban (p.sh. parqe, kënde lojërash, pika qendrore dhe hapësira të hapura të shfrytëzueshme) që mundësojnë funksionimin adekuat të të gjitha vendbanimeve përreth;

3. Sigurimi i lidhjeve për këmbësorët, çiklistët si dhe qarkullimi i automjeteve në të gjithë vendbanimin;

4. Sa herë që është e mundur, të trajtohet siguria dhe parandalimi i krimit nëpërmjet instalimit të kamerave ose oficerëve të policisë në zonë;

5. Konsideroni me kujdes mbrojtjen e mjedisit;

6. Inkurajimi i objekteve të banimit për turizëm;

Kriteret për ndërtimin e shtëpive individuale dhe shtëpive me tarraca.

Disa nga kriteret bazë për ndërtimin e shtëpive individuale dhe shtëpive me tarracë në vendbanimin e Shtërpcës janë:

1. Ndërtimi i shtëpive të qytetit duhet të theksojë lidhjen me zonat/lagjet përreth për sa i përket gjelbërimit adekuat;

2. Duhet të inkurajohet ndërtimi i shtëpive në zona të zbrazëta/bosh për të mbushur boshllëqet;

3. Të dekurajohet grupimi i banesave të qytetit/shtëpive me radhë në sipërfaqe të mëdha, si dhe ndërtimi i tyre në qendër të qytetit;

4. Ndërtimi i shtëpive duhet të veprojë si një tampon midis ndërtesave kolektive dhe shtëpive ekzistuese, duke siguruar një kalim gradual të lartësive të ndërtesave;

Një sfidë e rëndësishme për planifikimin real në fushën e banimit është mungesa e statistikave dhe të dhënave në fushën e banesave. Ky problem nuk ekziston vetëm për komunën e Shtërpcës, por në përgjithësi për tërë Kosovën dhe paraqet pengesë për planifikimin e duhur. Komuna e Shtërpcës duhet t'i përditësojë të dhënat në lidhje me banimin në periudha trevjeçare në mënyrë që të korrespondojnë me programet trevjeçare të banimit. Informacioni bazë që kërkohet është:

- Numri dhe llojet e banesave kolektive;
- Numri dhe llojet e shtëpive;
- Numri i objekteve ilegale;
- Numri i objekteve për nevoja të tjera, jashtë banimit (shkolla, objekte administrative, klinika, etj.);
- Numri i objekteve për banesa sociale;

Hapësirat për rekreacion:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e parqeve, këndeve të lojërave, hapësirave të hapura dhe vendkalimeve brenda zonave të banuara duhet të jetë pjesë përbërëse e zhvillimit të zonës. Kriteret dhe standardet e lokacionit për rregullimin e

hapësirave të tilla duhet të përfshihen në Hartat Zonale të Komunës së Shtërpcës ose në planet e detajuara urbanistike. Planifikimi i tokës për këto hapësira duhet të trajtohet edhe në këto plane.

Problemet kryesore të identifikuara

Disa nga problemet kryesore që kanë të bëjnë me banimin në komunën e Shtërpcës janë:

1. Mungesa e stafit të mjaftueshëm komunal për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në sektorin e banimit;
2. Mungesa e politikave dhe strategjive të banimit në nivel shtetëror;
3. Vështirësi në harmonizimin e nevojave për banim në raport me kërkesën e banorëve;
4. Numri i pamjaftueshëm i objekteve sociale dhe menaxhimi dhe mirëmbajtja e dobët e objekteve ekzistuese sociale;
5. Mungesa e sektorit komunal të banimit;
6. Mundësi të limituara për sigurimin e banesave të përshtatshme (sociale dhe të përballueshme) për familjet me të ardhura të ulëta dhe familje të tjera;
7. Mungesa e fondeve për banim në nivel lokal dhe qendror;
8. Probleme me trajtimin e vendbanimeve informale, brenda dhe jashtë zonave urbane;
9. Rritja e banimit përgjatë rrugëve; përdorimi joracional i hapësirës; lidhja midis banesave individuale dhe kolektive në zonat urbane;

Potenciali:

1. Hartimi i një projektligji të ri për strehimin;
2. Përmirësimi i politikës së banimit dhe urbanistikës;
3. Rritja e banesave për të plotësuar kërkesën për banesa;
4. Interesi për sektorin privat për të investuar në sektorin e banesave;

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
▪ Ndërtimi i objekteve të reja të banimit; ▪ Cilësi relativisht e mirë e banimit; ▪ Një numër i konsiderueshëm objektesh për banim u ndërtuan për të zbutur mungesën e vendbanimeve menjëherë pas luftës, të shkaktuar nga shkatërrimi apo dëmtimi, si dhe për të zhvendosurit që kërkonin strehim; ▪ Përkushtimi i administratës për zgjidhjen e çështjeve të banimit; ▪ Ligji për programet sociale të banimit; ▪ Iniciativa për investime në banesa nëpërmjet PPP, një fond i rëndësishëm njësi banimi, i mundësuar/ofruar nga sektori privat; ▪ Stok banesash relativisht të reja dhe të ndërtuara duke përdorur materiale cilësore; ▪ Mundësia e rritjes së potencialit për turizëm;	▪ Mungesa e statistikave për banim; ▪ Një numër njësish banimi janë të lira në pjesën më të madhe të vitit; ▪ Numri i pamjaftueshëm i njësive bashkiake të banimit; ▪ Buxheti i pamjaftueshëm për banim; ▪ Administrimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave nuk është në gjendjen më të mirë; ▪ Mungesa e politikave dhe strategjive të banimit; ▪ Nuk ka iniciativa të drejtpërdrejta për zhvillimin e banesave për familjet me të ardhura të ulëta (strehim të përballueshëm); ▪ Mungesa e truallit për ndërtim me infrastrukturë të përshtatshme banesore sociale; ▪ Koordinim i dobët ndërmjet institucioneve; ▪ Vëllimi i madh i ndërtimeve pa leje; ▪ Mospërputhje e konsiderueshme e llojeve të pronësisë; ▪ Niveli i ulët i regjistrimit të pronës; ▪ Mungesa e izolimit të mirë dhe niveli i ulët i efikasitetit të energjisë; ▪ Niveli i lartë i papunësisë; ▪ Familjet janë të ngarkuara nga kostot e jetesës, normat e larta të hipotekës që janë financiarisht të papërballueshme për shumicën e popullsisë; ▪ Sektori i pazhvilluar i apartamenteve me qira;
MUNDËSITË	**RREZIQET**

▪ Formimi i sektorit komunal për banim; ▪ Planifikimi kompakt i zonave të banuara; ▪ Mundësi për të rritur dendësinë e banesave; ▪ Fushata e lejeve të ndërtimit të bashkisë; ▪ Fushata bashkiake dhe menaxhimi i procesit të legalizimit; ▪ Disa zona gërmimi janë me interes kombëtar dhe madje mund të tërheqin vizitorë nga jashtë nëse ofrohet një ekspozitë profesionale e objekteve dhe ekzistojnë udhëzime; ▪ Mundësia e investimeve nga investitorë të huaj;	▪ Çmimet e larta të ndërtesave të banimit; ▪ Buxheti i pamjaftueshëm për banim; ▪ Supozohet se modelet tradicionale të banimit, me shumë gjenerata të familjeve të shumta, do të reduktohen, duke rritur kështu kërkesën shtesë për strehim individual; ▪ Tendenca për të ndërtuar objekte banimi pa planifikim të duhur dhe pa leje ndërtimi; ▪ Rritja e kërkesës për strehim, duke përfshirë një numër në rritje të familjeve të riatdhesuara dhe shumë anëtarësh; ▪ Kërkesa e lartë për depozita dhe norma të larta interesi nga bankat për kredi për banesa; ▪ Paqëndrueshmëria politik;

Tabela 153 SWOT Analiza për Banim

3.11.4. Banimi Social

Komuna e Shtërpcës do të angazhohet në ofrimin e zgjidhjeve të përkohshme për qytetarët e saj të cilët nuk mund ta zgjidhin vetë çështjen e banimit. Kjo do të bëhet për familjet që aplikojnë për ndihmë dhe plotësojnë kriteret në përputhje me Ligjet në fuqi. Familjet që nuk mund të sigurojnë vetë banimin adekuat e duhur do të ndihmohen kryesisht nëpërmjet Ndërtesave të Banesave Sociale si dhe nëpërmjet pagesës së një pjese të qirasë (Bonusi i Banimit) të përshkruar në ligj. Planifikimi i detajuar për këto kategori personash që kanë nevojë për banim të përkohshëm duhet të bëhet përmes programeve trevjeçare të banimit, që është edhe një detyrim ligjor.

Një nga pengesat kryesore për kujdesin për banim në komunën e Shtërpcës është mungesa e njësive adekuate brenda institucionit komunal. Komuna e Shtërpcës duhet të analizojë mundësinë e krijimit të një njësie përgjegjëse për çështjet e banimit, e cila mund të organizohet në kuadër të drejtorisë për planifikim urban ose ndonjë drejtori tjetër përkatëse.

Shtërpca duhet të sigurojë që korniza e planifikimit të banimit të mbështesë ofrimin e asistencës për strehim në mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ardhshme, duke marrë parasysh mundësitë financiare të komunës. Me përcaktimin e politikës së shfrytëzimit të tokës publike, komuna e Shtërpcës duhet të ndikojë se si dhe ku do të sigurohet banimi për familjet që plotësojnë kriteret për banim social.

Banimi social në Kosovë trajtohet sipas Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta për Banim (Ligji Nr. 03L-164). Sipas këtij ligji, komunat e Kosovës janë të obliguara që të ofrojnë strehim të përkohshëm për kategoritë e ndryshme të familjeve që nuk mund të sigurojnë strehim të vetëm.

Sipas këtij ligji, ekzistojnë tre forma ndihme: nëpërmjet banesave sociale, nëpërmjet pagesës së një pjese të qirasë dhe nëpërmjet përshtatjes së banesave komunale duke e kthyer atë në godina për banim social.

Komuna e Shtërpcës e ka të miratuar Programin Trevjeçar të Banimit. Me këtë program të përkujdesjes për banim e ka të planifikuar përkujdesjen për banim për ata qytetarë të cilët nuk kanë mundësi t'i sigurojnë vetes dhe familjeve të tyre kulm mbi kokë.

3.12. SHFRYTËZIM AKTUAL I TOKËS

Territori i Komunës së Shtërpcës është i dominuar me pjesë kodrinore - malore që mundëson zhvillimin turizmit dimëror dhe turizmit veror, ekonomisë pyjore dhe blegtorisë, ndërsa sipërfaqet e rrafshëta shfrytëzohen për aktivitete tjera bujqësore dhe për ngritjen e vendbanimeve. Në vazhdim është paraqitur një tabelë, në të cilën janë të rreshtuara shfrytëzimet dhe sipërfaqet e tyre sipas shfrytëzimit aktual të tokës të vitit 2020, dhe sipas shfrytëzimit të tokës të PZHK – 2012 (PZHK aktual), në tabelë janë nxjerrë edhe diferencat në hektar dhe në përqindje.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ 11/2015 MBI ELEMENTET DHE KËRKESAT THEMELORE PËR HARTIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL, janë bërë krahasimet në mes të këtyre shfrytëzimeve të Tokës në mënyrë që te kemi më të lehtë krahasimin e projeksioneve të PZHK 2012 deri në gjendjen aktuale.

Kategoria e shfrytëzimit	Shfrytëzimi i tokës bazuar në të dhënat nga Plani Zhvillimor Komunal 2012	Shfrytëzimi Aktual 2021 sip/ha	Diferenca në ha	Diferenca në %
Prodhim Parësor / Bujqësi	8084	7452.43	-631.57	-7.81%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	15900	16713.77	813.77	5.12%
Banim / Banim i përhershëm	570.43	576.48	6.05	1.06%
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative	1.10	1.10	0	0.00%
Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit	17.91	17.91	0	0.00%

Tabela 154 Tabela krahasuese në mes të projeksioneve të shfrytëzim të planifikuar të tokës PZHK 2012 si dhe shfrytëzimit aktual të tokës 2021.

Gjetjet kyçe

Gjatë analizës së profilit për komunën e Shtërpcës kemi disa gjetje kyçe në disa fusha të shfrytëzimit të Tokës. Në tabelën më poshtë kemi të përshkruara gjetjet kyçe të shfrytëzimit të tokës.

Nr	Përshkrimi
1	Shfrytëzimi i Tokës për Banim/Banim i përhershëm: Duke analizuar trendin e rritjes së sipërfaqeve të banimit nga viti 2012 deri 2020, për tetë vite kemi 6.05 ha rritje.
2	Shfrytëzimi i Tokës si Prodhim Parësor / Bujqësi: Në komunën e Shtërpcës kemi një humbje të konsiderueshme të tokës bujqësore, ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi -631.57ha të humbura.
3	Shfrytëzimi i Tokës si Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë: Në komunën e Shtërpcës kemi një rritje të tokës pyjore ku nga viti 2012 e deri në vitin 2020 kemi 813.77 ha.
4	Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative : Në komunën e Shtërpcës kemi një gjendje të njejtë të zhvillimit të zonave turistike nga viti 2012 e deri në vitin 2020 me sipërfaqe prej 1.10ha.
5	Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit : Në komunën e Shtërpcës kemi një gjendje të njëjtë të zhvillimit të zonave të shërbimeve nga viti 2012 e deri në vitin 2020 me sipërfaqe prej 17.91ha.

Tabela 155 Gjetjet kyçe gjatë vlerësimit të profilit të shfrytëzimit të tokës

Pjesën më të madhe të territorit të Shtërpcës e zënë toka pyjore duke përfshi edhe kullosat dhe livadhet alpike, pastaj pyjet, vendbanimet dhe shfrytëzime tjera. Sa i përket shfrytëzimit të tokës në disa vendbanime kemi shfrytëzim jo racional dhe jo i ndarë çartë.

Kategoritë e shfrytëzimit	Sip. *ha*
Vendbanimet	456.48
Kultura	0.42
Arsimi	3.09
Shërbimet	0.96
Objektet sportive	1.85
Shëndetësia	0.71
Administrata	0.24
Zonat Ekonomike	14.27
Varrezat	10.71
Trashgëgimi kulturore	3.61
Hapësirat turistike	272
Pyjet	10057.64
Bujqësia	10178.82
Rrugët publike	3759.51

DRAFT

Tabela 156 Analiza e shfrytëzimit aktual të tokës

Përparësitë	**Dobësitë**
▪ Zonat për zhvillim në lokacione atraktive ▪ Kufij ndërtimor të përcaktuar me PZHK të kaluar ▪ Parku nacional "Mali Sharr" ▪ Përcaktimi i zonave urbane të reja ▪ Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave për ndërtim të pendëve dhe akumulim të ujit ▪ Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave ndërtimore ▪ Përcaktimi i zonave turistike verore dhe dimërore	▪ Objekte industriale pranë zonave të banimit – konflikti i shfrytëzimit të tokës, ▪ Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi joefikas në periferi ▪ Buxheti i ulët për shpronësime, duke marrë parasysh rritjen e vlerës së tokës. ▪ Inventarizimi i kulturave dhe klasave të kualitetit të tokës- nuk përkon gjendja faktike me të dhënat kadastrale. ▪ Parcelimi pa ndonjë planeve rregullative, ku pas një kohe të shkurtër ato ndryshojnë dhe pala përballët me ndryshim kadastral, ku dëmtohet në aspektin financiar. ▪ Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore dhe pyjore ▪ Fragmentimi i tokës bujqësore në parcela të vogla ▪ Mungesa e konsolidimit të tokës. ▪ Vendbanime me shtrirje të shpërndarë ▪ Krijimi i korridoreve të zonave ekonomike në mënyrë të pa kontrolluar ▪ Mungesa e sistemit të ujitjes dhe infrastrukturës rrugore për tokën bujqësore ▪ Ndarja fizike e tokës bujqësore i shkaktuar nga ndërtimi i autostradës ▪ Mungesa e sipërfaqeve ujore (akumulimeve) ▪ Dëmtim i zonave pyjore
Mundësitë	**Kërcënimet**
▪ Zonat në fushat bregore në vendet atraktive mund të rizhvillohen në zona të reja banuese dhe nga kjo lirohet shtypja e zhvillimit në tokat bujqësore. ▪ Hartimi Ligjit për Rregullim të tokës urbane (ku lehtëson miratimin dhe zhvillimin e planifikimit urban në kadastër). ▪ Miratimi i Ligjit për Pronën Publike. ▪ Kthimi sa më i shpejtë i dokumentacionit kadastral nga Serbia. ▪ Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave urbane dhe për ndërtim të reja në sipërfaqe të përshtatshme për urbanizim ▪ Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore Përcaktimi i zonave për ndërtim të pendëve dhe akumulim të ujit ▪ Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore ▪ Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore ▪ Caktimi i zonës ekonomike përgjatë nacionales në të dyja anët e nacionales duke e kufizuar zhvillimin e mëtutjeshëm në favor të tokës bujqësore.	▪ Pronësia e paqartë mund të pengojë zhvillimin e duhur. ▪ Ndërtimet pa leje përgjatë rrugës dhe miniera në pjesën veriore të qytetit mund ta bllokojnë zhvillimin e ardhshëm ▪ Kufizimet financiare për rrugët lidhëse. ▪ Mungesa e dokumentacionit kadastral. ▪ Humbja e tokës bujqësore ▪ Krijimi i vendbanimeve të shpërndara ▪ Ndërtimet mbi zonat arkeologjike dhe dëmtimi i zonave arkeologjike ▪ Vështirësim deri në pamundësim të aplikimit të masave komasative në tokën bujqësore ▪ Rritje e pakënaqësisë qytetare

Tabela 157 SWOT analiza e shfrytëzimit aktual të tokës

DRAFT

3.13. KAPACITETET NJERËZORE DHE FINANCIARE TË KOMUNËS

Procesi i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore dhe financiare të komunës në projektet investuese kërkon analizën e buxhetit kapital dhe vlerësimin e çdo projekti investues si dhe identifikimin e burimeve potenciale të financimit për projekte. Kështu, vlerësimi i nivelit të mjeteve të disponueshëme është faktor kritik tek prioritizimi i atyre projekteve investuese dhe inicimi i projekteve të reja. Në këtë mënyrë, mjetet në dispozicion për investime kapitale gjatë viteve nga të gjitha burimet e identifikuara të financimit janë treguesit e drejtpërdrejtë të kapaciteteve investuese të komunës. Pra, pjesa tjetër e raportimit ka për qëllim të vlerëson vlerën e mjeteve të disponueshme për investime kapitale për periudhën e ardhshme 8 vjeçare përmes identifikimit të gjithë burimeve të mundshme të financimit te veprimeve të planifikuara në këtë dokument.

Kjo ndarje identifikon opsionet e mundshme për komunën që të rrit financimin për investime kapitale dhe të paraqet projektimet e të hyrave të veta të destinuara për investime kapitale me të cilin vlerësohen mjetet në dispozicion për investime kapitale në periudhën e dhjetë viteve të ardhshme.

Identifikimi i burimeve të mundshme financiare të komunës është bazuar së pari në legjislacionin në fuqi lidhur me burimet e financimit të komunës[47] dhe për burimet tjera potenciale të identifikuara si burime të disponueshme të financimit për projekte kapitale investuese. Burimet kryesore për shumicën e komunave janë burimet vetanake dhe grande nga buxheti qendror. Në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me financimin e qeverisë lokale në Kosovë, të gjitha komunat mund të menaxhojnë me burime financiare që vijnë nga burimet e veta dhe nga Grandi gjeneral apo i përgjithshëm. Më tutje, rishikimi i secilit burim të identifikuar të financimit që potencialisht kontribuon në investime kapitale është paraqitur dhe përshkruar si në vazhdim:

1. Të hyrat vetanake – përfshijnë tatimet komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit dhe pagesat e tjera për shërbime publike të ofruara nga ana e komunës, detyrimet rregullatore dhe gjobat, qiratë për pasuri të patundshme, të hyrat nga shitja e pronës së komunës, të hyrat nga marrja e pjesshme apo e tërësishme e pronësisë së komunës, participimet e përdoruesve të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore, kamatat nga pronat e komunës si dhe donacionet nga qeveritë e huaja. Burimet që mund direkt të rrisin gjenerimin e të hyrave vetanake e që janë të drejtuar kah investimet kapitale janë:
    a. Grandet dhe Donacionet – komunat mund të kenë përfitim nga grandet dhe donacionet e organizatave private dhe publike, sidomos për investime kapitale. Këto organizata duke përfshirë Komisionin Evropian, agjencitë ndërkombëtare të shteteve për ofrimin e ndihmës siç janë USAID, GIZ etj, përfaqësitë diplomatike të shteteve të huaja, OJQ-të ndërkombëtare etj.
    b. Pjesëmarrja e qytetarëve në investime kapitale – pjesëmarrja e qytetarëve në investime kapitale është komponentë e të hyrave vetanake për investime kapitale dhe pritet që të vazhdoj edhe në të ardhmen.
    c. Partneriteti privat – publik dhe Koncesionet – komunat mund tu japin infrastrukturën e tyre publike partnerëve privat që të forcojnë shërbimet që ofrohen për qytetarët e vet dhe ashtu të rrisin pjesëmarrjen e sektorit privat në burimet e financimit të komunës. Kohëzgjatja e këtyre kontratave mund të jetë deri në 40 vite.
2. Grandet operative nga buxheti qendror – përfshijnë grandin gjeneral, grandin e veçantë për arsim dhe grandin e veçantë për shëndetësi. Grandi përgjithshëm është 10% e të hyrave të buxhetuara të qeverisë qendrore dhe iu ndahet komunave në bazë të numrit të variablave, ku variabla më e rëndësishme është popullsia e komunës. Grandi special për arsim dhe shëndetësi ka për qëllim të financoj shpenzimet e ofrimit të standardit minimal të nivelit të arsimit parashkollorë, fillor dhe të mesëm dhe të shëndetit publik, si dhe alkimi dhe shpërndarja është bazuar kryesisht në numrin e nxënësve dhe stafit për arsim dhe në numrin e kontrolleve/vizitave të individëve në shëndetësi.
3. Grandet tjera dhe transferet – përfshijnë grandet për forcimin e kompetencave, transferet për bartjen e kompetencës, grandet e jashtëzakonshme që përfshijnë transferet nga ana e ministrive relevante që mund të realizohen për një numër të arsyeve që përfshijnë projektet e investimeve kapitale me ndikim të përgjithshëm në mirëqenien e cila zgjerohet edhe jashtë kufijve të komunës.
4. Të hyrat nga huazimet komunale – Ligji për huazimin publik iu siguron komunave të Republikës së Kosovës autorizimin të marrin mjete hua, të garantojnë për kredi, paguajnë shpenzime për lëshimin e kredive dhe pagesat e kamatave për huazime. Sipas ligjit, komuna mund të ketë një hua afatgjate për investime kapitale që do të

[47] Ligji për financimin e qeverisë lokale (LFQL), Ligji për qeverisje lokale (LQL), Ligji për kufijtë komunal, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMFPP), Ligji për buxhetin vjetor, Korniza afatmesme e shpenzimeve (KASH) dhe Qarkoret e buxhetit komunal

shfrytëzohet dhe që është pronë e komunës, që ka qëndrueshmëri më së paku tre vite, dhe i cili është i përfshirë në planin e miratuar për investime kapitale, KASH dhe BKK dhe i cili ka të bëjë më arsim dhe mbrojte të shëndetit. Huaja nuk mund të jetë më e madhe se 40% i THV-ve dhe Grandit gjeneral dhe përfshinë vlerën e servisimit të huas gjatë vitit e cila nuk mund të tejkaloj 10% e totalit të të hyrave të gjeneruar. Rregull tjetër e rëndësishme është që komuna të ketë raportet të pakualifikuara të revizionit në dy vitet e mëparshme.

Mjetet në dispozicion për investime kapitale

Mjetet në dispozicion për shpenzime kapitale në periudhën e ardhshme bazohen në të dhënat e 3 viteve të fundit të cilat shërbejnë për të përcaktuar kapacitetet komunale për investime kapitale gjatë 8 viteve të ardhme. Burimet e identifikuara të financimit mundësojnë që të ofrohen kapacitetet. Pra, ky vlerësim fokusohet në projektimin e të hyrave nga burimet e të hyrave vetanake dhe grandet operative të cilat do të jenë të dedikuara për investime kapitale. Pjesa tjetër e këtij raporti paraqet procedurën për vlerësimin e mjeteve në dispozicion për investime kapitale për periudhën 2021 – 2029 në komunën e Shtërpcës.

Planifikimi i buxhetit

Vlerësimi i buxhetit të projektuara janë bazuar në të dhënat historike dhe në rritjen e mundshme të të hyrave nga numri i kategorive për 4 vitet e kaluara. Bazuar në buxhetin e 4 viteve paraprake, vërehet një rritje prej 17.67%, apo 5.89% në të hyrat vetanake.

	Buxheti i planifikuar- viti:				**Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:**			
Kategoria ekonomike:	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2017- 2018**	**2018- 2019**	**2019- 2020**	**2017- 2020**
Rroga dhe paga:	1,928,586	1,968,980	2,114,723	2,178,905	2.05%	6.89%	2.95%	11.49%
Mallra dhe shërbime:	334,437	349,118	419,197	436,881	4.21%	16.72%	4.05%	23.45%
Shpenzime komunale:	81,625	81,625	81,625	83,625	0.00%	0.00%	2.39%	2.39%
Subvencione dhe transfere:	2,877	2,877	2,877	45,000	0.00%	0.00%	93.61%	93.61%
Shpenzime kapitale:	775,881	1,175,009	1,127,797	1,049,760	33.97%	-4.19%	-7.43%	26.09%
Gjithsej:	3,125,422	3,579,626	3,748,237	3,796,190	12.69%	4.50%	1.26%	17.67%

Tabela 158 Pasqyra dhe trendet e planifikimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2017-2020

Vlerësimi i buxhetit të projektuara në krahasim me mjetet e shpenzuara, bazuar në buxhetin e 3 viteve paraprake, vërehet se shpenzimet e Komunës ishin 3.93% më ulëta se sa buxheti i planifikuar.

	Buxheti i planifikuar- viti:				**Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:**			
Kategoria ekonomike:	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2017- 2018**	**2018- 2019**	**2019- 2020**	**2017- 2020**
Rroga dhe paga:	1,981,127	2,007,448	2,015,779		1.31%	0.41%		1.72%
Mallra dhe shërbime:	305,423	339,677	408,445		10.08%	16.84%		25.22%
Shpenzime komunale:	81,554	68,718	81,278		-18.68%	15.45%		-0.34%
Subvencione dhe transfere:	3,837	1,315	0		-191.78%			
Shpenzime kapitale:	658,162	951,581	1,064,068		30.83%	10.57%		38.15%
Gjithsej:	3,030,104	3,368,739	3,659,570		10.05%	7.95%		17.20%

Tabela 159 Pasqyra dhe trendet e shpenzimit te buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2017-2020

Bazuar në vlerësimin e buxheteve të kaluara parashikohet që nga 2021 deri në vitin 2029, buxheti i përgjithshëm i Komunës pritet të gjenerojë gjithsejtë €45,794,243.

Kategoria ekonomike:	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**
Rroga dhe paga:	2,178,982	2,262,425	2,349,063	2,439,019	2,532,419	2,629,397	2,730,087	2,834,634	2,943,185
Mallra dhe shërbime:	607,197	654,658	705,828	760,997	820,479	884,611	953,755	1,028,303	1,108,679
Shpenzime komunale:	88,466	89,171	89,882	90,598	91,321	92,049	92,782	93,522	94,268
Subvencione dhe transfere:	72,603	95,257	124,979	163,976	215,140	282,268	370,342	485,897	637,508
Shpenzime kapitale:	1,056,074	1,147,916	1,247,745	1,356,256	1,474,204	1,602,409	1,741,763	1,893,237	2,057,883
Gjithsej:	4,003,322	4,239,111	4,488,788	4,753,170	5,033,124	5,329,567	5,643,470	5,975,861	6,327,829

Tabela 160 Projeksion i buxhetit të Komunës për 8 vitet e ardhme

Të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake të projektuara janë bazuar në të dhënat historike dhe në rritjen e mundshme të të hyrave nga numri i kategorive për vitet 2017– 2018. Bazuar në buxhetin e viteve paraprake, vërehet një rritje prej 20.13%, apo 10.06% në të hyrat vetanake.

Kategoria e te hyrave vetanake:	**Te hyrat- viti:**	**Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:**

	2017	2018	2019	2020	2017- 2018	2018- 2019	2019- 2020	2017- 2020
Tatimi ne prone:	124,710	104,312	137,670		-19.56%	24.23%		9.41%
Regjistrimi i automjeteve:	19,530	19,410	20,530		-0.62%	5.46%		4.87%
Lejet e ndërtimit:	36,764	45,902	91,783		19.91%	49.99%		59.94%
Regjistrimi i trashëgimisë:	42,595	32,949	36,366		-29.28%	9.40%		-17.13%
Ndërrim i destinimit te tokës:								
Dokumentet e gjendjes civile:	9,153	9,270	7,798		1.26%	-18.88%		-17.38%
Veprimtaritë afariste:	850	100			-750.00%			
Shfrytëzimi i pronës publike:								
Participimet ne Arsim dhe Shëndetësi:	597	517	915		-15.35%	43.47%		34.79%
Tjera:	2,631	16,219	1,450		83.78%	-1018.66%		-81.47%
Gjithsej:	236,829	228,679	296,511		-3.56%	22.88%		20.13%

Tabela 161 Pasqyra dhe trendet e te hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2017-2020

Në vijim janë paraqitur të hyrat vetanake direkte dhe indirekte.

Kategoria e te hyrave vetanake:	Te hyrat- viti:				Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2017	2018	2019	2020	2017- 2018	2018- 2019	2019- 2020	2017- 2020
Direkte:	236,829	228,679	296,511		-3.56%	22.88%		20.13%
Indirekte:	23,573	18,771	36,254		-25.58%	48.22%		34.98%
Gjithsej:	260,402	247,450	332,765		-5.23%	25.64%		21.75%

Tabela 162 Pasqyra dhe trendet e hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2017-2020

Bazuar në vlerësimin e të hyrave vetanake të kaluara parashikohet që nga 2021 deri në vitin 2029, shuma e përgjithshme e të hyrave vetanake pritet jetë € 3,833,638.

Kategoria e te hyrave vetanake:	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Tatimi ne prone:	144,150	150,936	158,040	165,479	173,268	181,424	189,964	198,905	208,268
Regjistrimi i automjeteve:	21,030	21,542	22,067	22,604	23,155	23,719	24,296	24,888	25,494
Lejet e ndërtimit:	105,550	121,383	139,590	160,528	184,608	212,299	244,144	280,765	322,880
Regjistrimi i trashëgimisë:	33,252	30,404	27,800	25,419	23,242	21,252	19,431	17,767	16,246
Ndërrim i destinimit te tokës:									
Dokumentet e gjendjes civile:	7,121	6,502	5,937	5,421	4,950	4,520	4,127	3,769	3,441
Veprimtaritë afariste:									
Shfrytëzimi i pronës publike:									
Participimet ne Arsim dhe Shëndetësi:	1,074	1,261	1,480	1,737	2,040	2,394	2,811	3,300	3,874
Tjera:	859	509	302	179	106	63	37	22	13
Gjithsej:	313,036	332,536	355,216	381,368	411,369	445,670	484,811	529,417	580,216

Tabela 163 Projeksioni të hyrave vetanake për 8 vitet e ardhme

Transferët e buxhetit qendror

Transferet e buxhetit qendror vijnë në tri mënyra, përmes grandit të përgjithshëm, grandit të veçantë për arsim dhe grandit të veçantë për shëndetësi. Së pari, 10% e grandit gjeneral nga të hyrat totale të përgjithshme alokohet në/me buxhetet e komunave. Përqindja e buxhetit komunal të alokuar në Shtërpcë është llogaritur mesataren për vitet 2019 – 2020 dhe mendohet që do të vazhdohet në të ardhmen. Të dhënat për periudhën 2019 – 2020 janë marrë nga tabela e buxhetit të ministrisë së financave. Në anën tjetër, ndarja e grandit për shëndetësi dhe grandit për arsim bëhet sipër vlerësimit të grandit të përgjithshëm sepse nuk ekziston formulë e drejtpërdrejte për llogarinë e tyre. Periudha për vitin 2019 – 2020 mendohet që do të vazhdojë edhe në të ardhmen në mënyrë të njëjtë.

	2019	2020	2019- 2020
Grante qeveritare	3,672,789	3,794,170	3.20%

Tabela 164 Pasqyra dhe grandeve qeveritare, 2019-2020

Bazuar në vlerësimin e granteve qeveritare të kaluara parashikohet që nga 2021 deri në vitin 2029, të shuma e përgjithshme e granteve qeveritare pritet jetë € 35,814,788.

	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Grante qeveritare	3,731,538	3,791,227	3,851,870	3,913,483	3,976,082	4,039,683	4,104,300	4,169,952	4,236,653

Tabela 165 Projeksioni të Granteve Qeveritare për 8 vitet e ardhme

Investimet kapitale

Investimet kapitale gjatë vitit 2017, 2018, dhe 2019 janë të karakterizuara me investimet kapitale të financuara nga ana e THV-ve dhe grandit gjeneral si dhe investimet kapitale të financuara përmes grandeve speciale. Përqindja mesatare e investimeve kapitale nga THV-të dhe grandet e përgjithshme nga të hyrat e gjeneruara nga këto burime supozohet që do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Njëjtë mendohet për investimet kapitale të financuara nga fondet speciale. Tabela në vijim paraqet investimet historike kapitale në Shtërpcës.

Mesatarja e rritjes së investimeve kapitale shënon një rritje prej 38.15%, me përqendrim të madh në infrastrukturë të transportit dhe teknike.

	Trendet e rritjes/ zvogëlimit- viti:						
Sektori:	**2017**	**2018**	**2019**	**2017- 2018**	**2018- 2019**	**2019- 2020**	**2017- 2020**
Infrastrukture sociale dhe publike:	404,1,677	183,654	121,151	-120.44%	-51.59%		-9.80%
Infrastrukture transportuese:	217,423	421,397	545,870	48.40%	22.80%		13.77%
Infrastrukture teknike:	35,900	346,531	397,048	89.64%	12.72%		18.37%
Gjithsej:	658,162	951,582	1,064,069	30.83%	10.57%		38.15%

Tabela 166 Pasqyra dhe investimeve kapitale, 2017-2020

Bazuar në vlerësimin e granteve qeveritare të kaluara parashikohet që nga 2021 deri në vitin 2029, të shuma e përgjitshme e investimeve kapitale parashihet të jetë € 13,499,371.

	2021	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**	**2028**	**2029**
Infrastrukture sociale dhe publike	115,215	109,569	104,200	99,094	94,239	89,621	85,230	81,053	77,082
Infrastrukture transportuese	336,453	623,624	666,560	712,453	761,505	813,935	869,975	929,872	993,894
Infrastrukture teknike	433,517	473,335	516,811	564,280	616,109	672,699	734,487	801,949	875,608
Gjithsej:	1,132,185	1,206,528	1,287,572	1,375,828	1,471,854	1,576,255	1,689,691	1,812,875	1,946,584

Tabela 167 Projeksioni i investimeve për 8 vitet e ardhme

DRAFT

4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e zhvillimit hapësinor është pjesa kryesore të PZhK-së. Korniza e zhvillimit hapësinor paraqet zhvillimin hapësinor për tërë territorin e Komunës së Shtërpcës për periudhën së paku 8 vjeçare, gjegjësisht formulon strukturën dhe organizimin hapësinor për zhvillim të ardhshëm.

Gjatë hartimit të PZhK-së është bërë një mobilizim i të gjitha resurseve njerëzore dhe intelektuale nga komuna dhe jashtë komunës, si konsultime me ekipin bazë dhe ekipin komunal të planifikimit për hartim të PZhK-së dhe duke organizuar aktiviteteve të pandërprera të grupeve punuese, institucioneve, sektorëve dhe të gjithë qytetarëve të Shtërpcës me qëllim të hulumtimit, analizimit dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Korniza e zhvillimit hapësinor bazohet në "Planin Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 - 2020+".

4.1. VIZIONI

Duke vlerësuar rëndësinë e planit zhvillimor komunal si një dokument që planifikon dhe rregullon përdorimin e zonave komunale në periudhën 8 vjeçare, mori një pjesë të madhe të numrit të personelit profesional dhe njerëzit lokal të punësuar në institucione të ndryshme, struktura politike, sipërmarrësit, punëtorët e arsimit dhe kujdesit shëndetësor, pa ndihmën e të cilëve në dhënien e informacionit, grumbullimit dhe përpunimit të dhënave burimore, sugjerimeve të dhëna dhe madje edhe kritikave, kjo punë nuk do të ishte kaq kuptimplotë.

"Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 -2020+" ka paraparë Vizionin vijues për Komunën e Shtërpcës:

Bazuar në vizionin dhe planifikimin hapësinorë të Kosovës, regjioni i cili në të ardhmen shihet si: **Ura e Kosovës (zona e verdhë)**, ura që lidh Kosovën me rajonin, një rrjet të fortë funksional i qyteteve dhe fshatrave atraktive për jetë dhe punë në to, me ekonomi, tregti, industri dhe turizëm tërheqës ,tërheqës për investime dhe sipërmarrjen në prodhim, agrobiznes, turizëm, turizëm mjekësor dhe rekreativ për përmbushjen e kritereve për mbrojtjen e mjedisit.

Ky dokument është projektuar të përmbajë të gjitha analizat përkatëse deri tani, dhe koncepte të orientuara drejt së ardhmes dhe zhvillimit, duke ofruar një kornizë për marrjen e nevojshme hapësinore dhe dokumentet e tjera të planifikimit dhe programet e zhvillimit.

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti u konstatua se: Shtërpca ka nevojë për të promovuar zhvillimin, me ç'rast dëshira jonë, dëshira dhe obligimi jonë në të ardhmen është që ky **zhvillim të jetë i qëndrueshëm.**

Ky plan duhet të mundësojë zhvillimin e shpejtë dhe valorizimi i burimeve të përbëra nga zonat rezidenciale, industriale, zonat rekreative turistike dhe të gjitha rrjedhat duhet të projektohen dhe ndërtohen në një mënyrë që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe kombin - tani dhe në të ardhmen. Është e nevojshme për tu siguruar që ngjarjet e tilla të mos bien në konflikt (me efekte negative) me interesat e tjera sociale të tilla si ambienti, shëndeti dhe siguria e popullatës. Gjatë planifikimit të rrjedhave të reja duhet pasur kujdes për rrjedhat e mëparshme.

Komuna e Shtërpcës në rolin e një lideri rajonal me turizëm të zhvilluar, me të gjitha pasuritë natyrore, bujqësi të zhvilluar dhe me tendenca të traditës dhe rrjedhave moderne, me cilësi dhe mjedis të qëndrueshëm për të gjitha komunitetet.

4.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

Në vitin 2015 është miratuar Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshin 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ). Duke u bazuar në parimin e "lënë askush prapa", Agjenda e re thekson një qasje holistike për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë. Më poshtë, gjeni grafikën ku janë listuar të gjithë 16 QZHQ- të, të cilat janë përvetësuar si qëllime të përgjithshme të zhvillimit të Shtërpcës nëpërmjet PZHK-së do të zbatohen sipas mundësive si një hap drejt krijimit të mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar dhe koordinim të donacioneve.

1. Jo Varfërisë	•Elimino varfërinë në të gjitha format e tij kudo.
2. Elimino Urinë	•Eliminim i urisë, ngritja e cilësisë së ushqyerit dhe promovim i bujqësisë së qëndrueshme.
3. Shëndet i mirë	•Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe mirëqenies së njerëzve të gjitha moshave.
4. Arsim cilësor	•Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe plotësim i drejtës për mësim gjatë gjithë jetës.
5. Barazi Gjinore	•Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave.
6. Ujë i pastër	•Sigurimi i pajisjeve dhe administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve për të gjithë.
7. Energji e përballueshme	•Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne dhe me çmim të përballueshëm.
8. Zhvillim ekonomik	•Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme përmes punësimit në kushte humane dhe të denja, për të gjithë.
9. Industrisë, Inovacionit dhe Infrastrukturës	•Ndërtimi i infrastrukturës rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe e inovacionit.
10. Redukto pabarazitë	•Zvogëlimi i pabarazisë ndërmjet të Qytetit dhe zonave rurale, si dhe në mes të zonave rurale.
11. Qytete të qëndrueshme	•Shtërpce, qytezë/ vendbanim gjithëpërfshirës, i parrezikshëm, rezistues dhe i qëndrueshëm;
12. Konsumim i përgjegjshëm	•Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.
13. Ndryshimi klimatik	•Lufta kundër ndryshimeve klimatike dhe efekteve të tij, me aktiviteteve të planifikuara dhe me efekte lokale.
14. Jeta në Tokë	•Shfrytëzim i qëndrueshëm i pyjeve dhe ndalimi i degradimit të tokës dhe humbja e biodiversitetit.
15. Institucione efektive	•Zhvillim gjithëpërfshirës, qasje në drejtësi për të gjithë dhe institucione efektive dhe të përgjegjshme.
16. Partneritet për Qëllimet	•Forcimi i zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit për zhvillim të qëndrueshëm.

Tabela 168 Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm që përfshin 17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm

4.3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTA

Qëllimet e veçanta të cilat do prezantohen në fushat tematike të PZhK-së, të mbështetur në hulumtimin e gjerë dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese, dhe paraqesin sintetizim të qëllimeve të prezantuara nga drejtoritë komunale, institucionet tjera publike lokale dhe qendrore, shoqërisë civile, si dhe "16 Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030".

Objektivat e propozuara janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe të lidhura për afatet kohore që synohet për tu arritur brenda një periudhë kohore specifike.



Figura 1. Zbërthimi i Objektivave sipas konceptit SMART

4.4. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT TEMATIKE

1. ZHVILLIMI EKONOMIK			
Qëllimi 1: Zhvillimi i zonave industriale, ekonomike të biznesit, korridoreve zhvillimore ekonomike.			
Objektiva 1.1: Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonës ekonomike te Shtërpcës dhe Gotovushës		Objektiva 1.2: Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës të zonave ekonomike në korridorin e rrugës rajonale.	
Qëllimi 2: Modernizimi i bujqësisë dhe procesimi i produkteve bujqësore			
Objektiva 2.1: Menaxhimi adekuat i tokave bujqësore dhe pyjeve përmes përcaktimit të kufijve të zonave bujqësore dhe pyjore	Objektiva 2.1: Zhvillimi I blegtorisë, pemëtarisë dhe perimekulturave në etapat 2026-2031	Objektiva 2.2: Ngritja e kapaciteteve të prodhuesve për kultivimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, në veçanti grave në bujqësi, 2026-2031	Objektiva 2.3: Sigurimi I infrastrukturës për grumbullimin, ruajtjes dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore në etapat , 2026-2031

2. INFRASTRUKTURA TEKNIKE			
Qëllimi 1: Administrimi i qëndrueshëm i ujësjellësve dhe kanalizimeve			
Objektiva 1.1: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të ujësjellësit të fshatrave deri në vitin 2030	Objektiva 1.2: Përmirësimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit në qytet – zvogëlimi i humbjeve deri në 100 % deri në vitin 2032	Objektiva 1.3: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet të kanalizimit të fshatrave deri në vitin 2028	Objektiva 1.4: Shkyçjet e lidhjeve ilegale në ujësjellës deri në vitin 2026
Objektiva 1.5: Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza 2026		Objektiva 1.6: Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe funksionalizimit të rrjetit ekzistues atmosferik në qytezë ndarja e ujërave të zeza dhe atmosferike deri në vitin 2026	
Qëllimi 2: Sigurimi i energjisë së qëndrueshme e moderne			

Objektiva 2.1: Shtrirja nëntokësore e rrjetit elektrik dhe të TI –së në 70% të zonave urbane deri në vitin 2026	Objektiva 2.2: Ndërrimi i pajisjeve të vjetra elektro-energjetike deri në vitin 2026	Objektiva 2.3: Përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe furnizimi cilësor me energji elektrike në gjithë territorin e komunës me theks të veçantë zonën turistike.	Objektiva 2.4: Përmirësimi dhe rritja e efiçencës energjetike në objektet publike 90% deri në vitin 2026 dhe 70% deri në vitin 2030 ndërsa për objektet private 60% deri në vitin 2026
Objektiva 2.5: Hulumtimi i mundësive për ndërtimin e sistemit të ngrohjes të bazuar në energjinë solare deri në vitin 2026			
Qëllimi 3: Ofrimi i shërbimeve moderne të telekomunikimit			
Objektiva 3.1: Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit 4G dhe 5G LTE deri në vitin 2026	Objektiva 3.2: Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore deri në vitin 2026	Objektiva 3.3: Zhvillimi i një infrastrukturë për një rrejt të përbashkët për shërbime të telekomunikimit deri në vitin 2026	
Qëllimi 4: Krijimi i një mjedisi të pastër pa mbeturina			
Objektiva 4.1: Përfshirja e fshatrave/vendbanimeve të mbetura në sistemin e menaxhimit të mbeturinave deri në fund të 2026 (mbulimi 100% me shërbim)	Objektiva 4.2: Ndërtimi i stacionit transfer të mbeturinave deri në 2026	Objektiva 4.3: Eleminimi i të gjitha deponive të egra 2026	
Objektiva 4.4: Përcaktimi dhe funksionalizimi i hapësirës për menaxhimin e mbetjeve nga ndërtim/demolimi dhe atyre shtazore deri më 2026	Objektiva 4.5: Ndërtimi i deponisë dhe impiantit për dekompostim të mbeturinave të biomasës deri në vitin 2030		

3. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI		
Qëllimi 1: Zhvillimi I infrastrukturës dhe transportit të qëndrueshëm		
Objektiva 1.1: Modernizimi i rrugëve ndërlidhëse deri në vitin 2028	Objektiva 1.2: Ndërtimi i rrugëve të qytetit për zonat e reja të banimit sipas PRRH-ve të cilat do të hartohen deri në vitin 2027	Objektiva 1.3: Optimalizimi i rrugëve unazore (tranzitore) ekzistuese deri në vitin 2026
Qëllimi 2: Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe sigurimi i transportit publik		
Objektiva 2.1: Përmirësimi i transportit publik urbano-rural dhe sigurimi i transportit urban dhe deri në zonat turistike Brezovicë dhe qendrën e re te skijimit deri në vitin 2026	Objektiva 2.2: Zhvillimi dhe zgjerimi i rrjetit të transportit të rregullt publik për të gjitha vendbanimet me mbi 450 banorë deri në vitin 2026	Objektiva 2.3: Ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe sigurimi lokacioneve për venndalesa të autobusëve deri në vitin 2026
Qëllimi 3: Promovimi i lëvizshmërisë rekreative		
Objektiva 3.1: Në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me nivelin qendror ndërtimi i teleferikut Përvall - Brezovicë deri në vitin 2026	Objektiva 3.2: Ndërlidhja e zonave turistike përmes shtigjeve për çiklistë dhe kalërim gjatë verës deri në vitin 2027	

4. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE			
Qëllimi 1: Sigurimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe mirëqenies sociale			
Objektiva 1.1: Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja për shërbim social deri në vitin 2026	Objektiva 1.2: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore për 30% deri ne vitin 2026	Objektiva 1.3: Përmirësimi i infrastrukturës dhe sigurimi i hapësirave dhe ndërtesave të reja shëndetësore deri në vitin 2026	Objektiva 1.4: Përmbushja e kërkesave për banim social (në vazhdimësi)
Qëllimi 2: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor			
Objektiva 2.1:			

DRAFT

Ndërtimi i çerdheve dhe kopshteve të fëmijëve për disa vendbanimet rurale me mbi 2000 banorë deri në vitin 2026
Qëllimi 3: Sigurimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve
Objektiva 3.1: Rinovimi i ndërtesës komunale deri në vitin 2026 — Objektiva 3.2: Ndërtimi i zyrave të gjendjes civile në nënqendrat e planifikuara deri në vitin 2026
Qëllimi 4: Sigurimi i infrastrukturës sociale adekuate dhe mirëmbajtja e saj
Objektiva 4.2: Krijimi i kushteve dhe sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës (në vazhdimësi) — Objektiva 4.3: Përmirësimi i hapësirave ekzistuese dhe sigurimi i hapësirave të reja për sport dhe rekreacion nëpër shkolla deri në vitin 2028 — Objektiva 4.4: Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës (në vazhdimësi)
Objektiva 5.5: Sigurimi i hapësirës për zgjerim të varrezave sipas asaj që është paraparë në hartë deri në vitin 2026 dhe planifikimi/ lejimi i hapësirave për objekte të reja të religjionit (në vazhdimësi)

5. MBROJTJA E MJEDISIT DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI		
Qëllimi 1: Parandalimi i ndotjes së ujërave		
Objektiva 1.1: Ndarja e rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferik në qytet në të gjitha vendbanimet me mbi 1500 banorë deri në vitin 2029	Objektiva 1.2: Hapja dhe rregullimin e shtretërve të Moravës, Mirushës, Stanishorkës deri në vitin 2028	Objektiva 1.3: Eliminimi i deponivë ilegale deri në vitin 2026
Qëllimi 2: Parandalimi i ndotjes së ajrit		
Objektiva 2.1: Planifikimi i hapësirave të gjelbra të reja në qytet deri në vitin 2026 dhe zhvillimi i hapësirave të gjelbra (në vazhdimësi)	Objektiva 2.2: Hartimi i Planit Lokal të Veprimit të Cilësisë së Ajrit deri në vitin 2026	Objektiva 2.3: Kufizimi i emetimit të substancave ajrore të dëmshme ose toksike nga veprimtaritë industriale deri në vitin 2027

Qëllimi 3: Parandalimi i rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera			
Objektiva 3.1: Ndërtimin e pendave për mbrojtje nga erozioni në shtretërit e përroskave dhe përrenjve dhe përmirësimin e argjinaturave mbrojtëse deri në vitin 2028	Objektiva 3.2: Ripyllëzim të 140ha për sipërfaqet pyjore përgjatë zonave erozive dhe shpatijet e diellosura, mbjellja e drunjtëve shtatlartë gjethembajtëse përgjatë perimetrit të zonave industriale deri në vitin 2026	Objektiva 3.3: Pastrimin e kanaleve të ujitjes dhe të kanalizimit atmosferik ekzistues deri në vitin 2026	Objektiva 3.4: Sigurim i qasjes së automjeteve të zjarrfikësve deri të zonë banimi dhe vendosja e hidrantëve në qytet dhe vendbanime në komunë deri në vitin 2030

6. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE		
Qëllimi 1: Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë kulturore		
Objektiva 1.1: Restaurimi i tërësishëm i objekteve të trashëgimisë 2028	Objektiva 1.2: Ndërtimi i një objektit të Muzeut të Qytetit deri në vitin 2026	
Objektiva 1.5: Hartimi i Planit 25-vjeçar të Konservimit të Trashëgimisë Arkitekturale deri në vitin 2021		
Qëllimi 2: Zhvillim i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore		
Objektiva 2.1: Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave turistik në trekëndëshin në Brezovicë.	Objektiva 2.2: Zhvillimi i infrastrukturës dhe përmbajtjeve të zonave për turizëm rural duke shfrytëzuar potencialet si kombinim i tokave pjellore rreth Lepencit dhe pjesëve kodrinore malore/ kombinim edhe me produktet	Objektiva 2.3: Projekte për kampanja informuese deri në vitin 2026.

	blegtorale dhe përmbajtjet tjera deri në vitin 2026	

7. VENDBANIMET		
Qëllimi 1: Zhvillimi i vendbanimeve kompakte, të balancuara dhe të qëndrueshme		
Objektiva 1.1: Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar të qytetit jashtë kufirit urban deri në vitin 2026.	Objektiva 1.2: Promovimi i shfrytëzimeve në pajtueshmëri (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të rejat për të plotësuar nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2029.	Objektivi 1.3: Promovimi i përdorimeve të përputhshme (komerciale, rekreative, etj.) në lagjet ekzistuese dhe të reja për të përmbushur nevojat e banorëve ekzistues dhe të ardhshëm deri në vitin 2026
Qëllimi 2: Mbrojtja e karakterit rural hapësinor dhe planifikim për rritje të ekuilibruar të vendbanimeve rurale		
Objektiva 2.1: Promovimi i modelit kompakt të zhvillimit rural duke përcaktuar zonat për zgjerim për të gjithë vendbanimet rurale deri në vitin 2026.	Objektiva 2.2: Parandalimi i fragmentimit të tokave bujqësore dhe pyjore deri në vitin 2026.	Objektiva 2.3: Zvogëlimi i pabarazisë së shpërndarjes së infrastrukturës dhe shërbimeve publike ndërmjet Qytetit dhe vendbanimeve rurale, si dhe në mes të vendbanimeve rurale deri në vitin 2026.
Qëllimi 4: Mbështetja për trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe parandalimi i ndërtimeve të reja pa leje		
Objektiva 4.1: Mbështetje procesit të legalizimi i të gjitha ndërtimeve pa leje dhe integrimi i tyre në zona të urbanizuara, në vazhdimësi, deri në 2029.		

8. BANIMI	
Qëllimi 1: Sigurimi i banimit të qëndrueshëm për të plotësuar nevojat e banorëve të tanishëm dhe të ardhshëm	
Objektiva 1.1: Rritja e fondit banesor dhe dendësimi i ndërtimit në zonën urbane dhe zonën rurale, deri në vitin 2029	Objektiva 1.2: Sigurimi i banimit të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës, në vazhdimësi

9. SHFRYTËZIMI I TOKËS	
Qëllimi 1: Shfrytëzim efikas i tokës dhe resurseve	
Objektiva 1.1: Ruajtja e harmonisë mes shfrytëzimit të Tokës për banim dhe shfrytëzimeve të përziera, industrisë, rekreimit dhe institucioneve deri ne vitin 2032	Objektiva 1.2: Zhvillimi i qëndrueshëm i shfrytëzimit të Tokës deri në vitin 2030
Qëllimi 2: Shfrytëzimi për banim të qëndrueshëm në komunën e Shtërpces	
Objektiva 2.1: Promovimi i ndërtesave efiçiente në sipërfaqet për banim, me shfrytëzim të energjisë së ripërtritshme deri në vitin 2030.	Objektiva 2.2: Zhvillimi i banimit përmes ndërtesave të mençura deri në vitin 2030 dhe në vazhdimësi.
Objektiva 2.3: Zhvillimi i sipërfaqeve të infrastrukturës publike dhe sociale deri në vitn 2032	Objektiva 2.4: Zhvillimi i sipërfaqeve të planifikuara për infrastrukturë në shërbim të arsimit, shëndetësisë, institucioneve të mirëqenies sociale, institucione kulturore, administratë, institucione kulturore, hapësira sportive, ndërtesa fetare dhe varreza deri në vitin 2032 dhe në vazhdimësi.
Qëllimi 3: Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve të Tokës bujqësore	
Objektiva 3.1: Ruajtja dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore në vendbanimet si : Brod, Drajkoc, Gotovushe dhe Bitije e Poshtme, deri në vitin 2030.	Objektiva 3.2: Promovimi dhe zhvillimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore për bujqësi dhe blegtori në fshatrat me lartësi të madhe mbidetare deri në vitin 2030.

Objektiva 3.3: Shfrytëzimi i sipërfaqeve të tokave bujqësore për zhvillim të bletarisë deri në vitin 2030.	

4.5. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i komunës së Shtërpcës është mjaft i bazuar duke filluar nga profili, vlerësimi i gjendjes, analiza, Vizioni, Qëllimet, Objektivat, si dhe ka marr parasysh dhe ka reflektuar dokumente dhe strategji planifikimi të nivelit komunal dhe qendror.

Komuna e Shtërpcës në bashkëpunim me të gjithë aktorët në fushën e planifikimit ka pas për qëllim që ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor të jetë i strukturuar mirë, dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të mund të kuptohet si i vetëm. Në ketë drejtim Ekipi i angazhuar nga komuna e Shtërpcës si dhe kompania "INSI" dhe ekipet tjera të angazhuara jashtë komunës kanë punuar bazuar në kërkesat e parapara me ligj, udhëzime administrative, normave teknike, si dhe struktura e përmbajtjet si nyejt, korridoret dhe përmbajtjet tjera e bëjnë këtë koncept lehtë dhe i kuptueshëm.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor krijon bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe do të shfrytëzohet gjatë hartimit të kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës të Shtërpcës.

Shtërpca duhet të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke planifikuar zhvillim të zonave të banimit, industriale, rekreative turistike (qendrat e Skijimit) që të jenë pozitive për mjedisin, ekonominë dhe mirëqenien e popullsisë, sot dhe në të ardhmen. PZhK duhet të siguroj zhvillim të balancuar ashtu që zhvillimet ekonomike nuk janë në konflikt (kanë efekte negative) me fushat tjera siç janë: mjedisi, shëndeti dhe siguria e popullatës.

Komunës së Shtërpcës i nevojitet rritje dhe zhvillim mirë i planifikuar, duke krijuar kushte për zhvillim të jetë **zhvillim i qëndrueshëm.**

4.6. SKENARËT E PROPOZUAR HAPËSINOR

Përgatitja e skenarëve hapësinor është një metodë e planifikimit strategjik, me qëllim të analizimit të zhvillimeve të mundshme në të ardhmen. Këtu përfshihen situatat e ardhshme alternative dhe drejtimet që mund të ndihmojnë në realizim. Skenarët bazohen në pasojat hipotetike të vendimeve dhe veprimeve të mundshme për vetëdijesimin lidhur me proceset kauzale.

Përveç se paraqiten mundësitë e shfaqjes së një situate hipotetike në të ardhmen, janë paraqitur edhe variacione dhe alternativa.

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Shtërpcës e kanë analizuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor konceptin e PZHK-së së përmes Skenarit, si bazë e mundshme të zhvillimit hapësinor të vendbanimeve.

Në kuadër të skenarëve të propozuar, nën supozimin e një mjedisi me zhvillim jostabil, janë marr parasysh aspektet pozitive dhe negative për zhvillim. Prandaj, duhet të analizohen faktorët relevantë, të cilët kanë ndikim kryesor në zhvillim.

DRAFT

4.6.1. SKENARI I - SKENARI I CILI KA ELEMENTE NGA PZHK E KALUAR

Skenari është analizuar në rrafshin hapësinor, politik dhe social dhe është diskutuar me shoqërinë civile, dhe duke marr parasysh gjendjen faktike në komunë dhe zhvillimet që kanë ndodhur në territorin e komunës së Shtërpcës por dhe të gjitha implikimet hapësinore që reflektojnë gjendjen në aspektin ekonomik, social dhe mjedisor, si:

- Zhvillimi është i ndarë në mes qytetit të Shtërpcës dhe fshatrave më të mëdhenj të komunës
- Fshatrat e mëdha i furnizojnë fshatrat e tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike, publike dhe sociale
- Qendra e re e skijimit.

Ky model është i bazuar në konkluzionet nga analiza faktike në planet hapësinore të veprimit, si dhe i tregon bazat kualitative në lidhje me zhvillimet hapësinore të komunës. Pikat kryesore në vijim nga bazat e modelit të zhvillimit hapësinor:

Qyteza e Shtërpcës është qendër komunale, me funksione të përqendruara në qytet. Shumica e tokës për banim dhe për shfrytëzim komercial, gjithashtu është e përqendruar në qytezë.

Fshatrat të cilat janë identifikuar të zhvillohen si qendra policentrite dytësore janë: Sevca dhe Brodi.

Këto qendrat dytësore janë përzgjedhur me qëllim të furnizimit të fshatrave përreth me infrastrukturë publike dhe private në bazë të këtyre kritereve:

- Partneritetit urbano – rural, numri i popullsisë, institucionet dhe infrastruktura ekzistuese, potencialet zhvillimore, shtrirja gjeografike, dhe trendët e rritjes, etj.

Disa funksione bazike publike shoqërore, si për shembull, shkollat e mesme, qendrat e mjekësisë familjare dhe zyrat komunale janë të vendosura aty. Për ta përforcuar rritjen e qendrave dytësore, gjithashtu atyre iu është ofruar tokë ndërtimore për banim dhe përdorim komercial.

Sjellja e natyrës në qendër të qytetit

Për ta përmirësuar klimën lokale në Shtërpce dhe për ta lidhur pjesën e brendshme të qytetit me fshatrat përreth, janë propozuar korridore të gjelbra përmes qytetit rreth lumit Lepenc. Kjo është e mundur, e zbatueshme, sepse korridoret komunikojnë me lumenjtë që rrjedhin përmes zonës urbane. Në këto raste, këto zgjidhje do të shërbejnë gjithashtu për qëllim të mbrojtjes nga ndotja e ujit të lumenjve.

Mbrojtja e trashëgimisë natyrore

Për shkak të vlerave të mëdha që kanë malet e Shtërpcës pjesa më e madhe e tyre janë pjesë e parkut nacional "Mali Sharr". Këto pjesë të komunës janë zona parësore për mbrojtjen e natyrës dhe për rivitalizim natyror. Lumenjtë që kalojnë përgjatë komunës kanë të definuar zonat mbrojtëse të tyre.

Mundësia e hyrjes në tërë komunën

Rruga rajonale kalojnë përmes zonave më të dendura banuese të komunës dhe formojnë shtyllën kurrizore të sistemit rrugor. Qendrat dytësore, janë të lidhura me këtë sistem kryesor. Rruga lokale që kalon përgjatë luginës së Lepencit, ka përfituar prioritet të lartë. Për ta përmirësuar rrjedhën e trafikut përreth Shtërpcës dhe për ta ndihmuar brendinë e qytetit nga trafiku, janë propozuar disa rrugë alternative.

Një rrjet i zhvilluar i rrugëve dhe i transportit publik do ta rrisë mundësinë e lëvizjes së lirë të banorëve për t'i ndihmuar fshatrat dhe për ta ngritur linjën vepruese për institucione shoqërore, siç janë shkollat dhe kujdesi shëndetësor. Sistemi kryesor rrugor duhet të plotësohet me rrjetin e rrugëve lokale.

DRAFT



Harta 51 Skenari i parë i propozuar

Përparësitë	Mangësitë

▪ Zhvillimi i qytetit, ashtu edhe i fshatrave më të mëdha Brodi, Verbeshtica dhe Sevca. ▪ Qendra e re e skijimit dhe ndërlidhja me qendrën në Brezovicë ▪ Lidhje relativisht e mirë e fshatrave me qendrën urbane ▪ Kosto më e ulët e infrastrukturës teknike ▪ Sigurimi i infrastrukturës bazike për fshatra ▪ Shpërndarja e mirë institucionale dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale ▪ Numër i vogël i qendrave sekondare bëjnë përqendrim të burimeve ▪ Mundësia e lidhjes së qendrave sekondare mes veti me një "Unazë Komunale"	▪ Ofron zhvillimi të pamjaftueshëm të qytetit ▪ Pamundëson shtrirjen e shërbimeve edhe në vendbanimet tjera
Konkluzion	
Përparësi kryesore e këtij skenari është që ishte bazë për zhvillim të planifikuar të komunës dhe si pjesë e PZHK-së, ishte një skenar i analizuar dhe punuar me një proces gjithëpërfshirës, por nuk ofronte një zhvillim të mirë të zonave të banimit në anën veriore.	

Tabela 169 SWOT analiza e Skenarit 1

4.6.2. SKENARI 2 - SKENARI I ZHVILLIMIT MONOCENTRIK HAPËSINOR

Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës duke e krijuar një tërësi urban si zhvillim monocentrik, d.m.th qendra komunale duhet te orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, Në ketë kohë, në nivel global më shumë se gjysma e botës jeton në zonën urbane, është shumë normale zhvillimi i një skenari të tillë edhe për komunën e Shtërpcës.

Ky skenarë përmban edhe përmbajtjet zhvillimore të komunës si zonat për **Rekreacion dhe turizmi** dy zona si qendra të skijimit njëra ekzistuese ajo e Brezovicës, kurse tjetra e propozuar, si dhe Parku Nacional "Mali Sharr" janë me rëndësi të veçantë dhe janë propozuar të zhvillohen qendra për turizëm dhe rekreacion jo vetëm për komunën e Shtërpcës por edhe për Kosovën dhe më gjerë.

Këto qendra trajtohen si përmbajtje të konceptit kryesorë, sidomos për turizëm rekreativ- sportiv dhe malor.

Si përmbajtje tjera që janë pjesë me rëndësi për konceptin janë: Zonat e Mbrojtura, korridori zhvillimor dhe agroturizmi.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky skenar bazohet në zhvillimin monocentrik me vetëm një nyje kryesore e konsideron të rëndësishme, qytetin e Shtërpcës, ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës, duke e krijuar një tërësi urban si zhvillim monocentrik, ndërsa nyejt tjera ekzistues nuk do trajtohen me prioritet por do mbahen në kufijtë aktual.

Për **KORRIDORET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky s**kenar** bazohet aksin që fillon në Shtërpce dhe vazhdon përgjatë rrugës rajonale në drejtim të Brodit, kurse në anën tjetër vazhdon nga Shtërpca në drejtim të qendrës turistike të Përvallës dhe Prizerenit. Është një korridor zhvillimorë mjaft i rëndësishëm gjithashtu, kemi edhe tendenca korridoresh në të gjitha drejtimet të qendrës turistike Brezovicë.

Në lidhje me **PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, Skenari 2 ofron vetëm plotësimin dhe dendësimin vetëm në zonën (monocentrike) urbane, të definuar si më lartë si pjesë kryesore e konceptit, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.

Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 2 synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 2 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

Në lidhje me **ZONAT E RRITJES,** Skenari 2 ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, vetëm në një zonë të rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës pa anashkaluar edhe korridoret në drejtim të Ferizajt dhe Prizrenit.

Përparësitë	**Mangësitë**
▪ Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme zhvillimin e qendrave të skijimit. ▪ Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme mbrojtjen e natyrës Zonave të Mbrojtura në parkun nacional "Mali Sharr"; ▪ Zhvillimi i qytetit orientohet te ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete; ▪ Siguron mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet për një urbanizim të qëndrueshëm; ▪ Mundëson urbanizimin e komunës me vendosjen e shumicës së qytetareve në zonën urbane të zgjeruar (deri 65% të popullatës); ▪ Mundëson ofrim më të lehtë dhe me kosto më të ulët të shërbimeve ndaj qytetarëve; ▪ Promovon zhvillim dhe mbrojtje të tokës bujqësore dhe zhvillimin e blegtorisë në Kashtanjevë; ▪ Mundëson zhvillimin e zonave turistike dhe rekreativo turistike; ▪ Ofron qasje efikase në korridoret e transportit;	▪ Pamundëson plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Shtërpcës; ▪ Kufizon rreth 70 % të popullsisë që jetojnë në zonat rurale, duke kufizuar funksionimin e lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore; ▪ Mundëson shkaktimin e ngarkesa në rrugën rajonale ▪ Pamundëson zhvillimin të vendbanimeve tjera të mëdha të komunës si Brodi, Verbeshtica dhe Bitija e Poshtme; ▪ Ky skenar mund të pengojë edhe aspirata e Komunës për zhvillimin e bujqësisë gjegjësisht blegtorisë, me përqendrim në zonën urbane.
Konkluzion	
Ky skenar nuk do të zhvillohet më tutje pasi si zhvillim do të shkaktonte çrregullime më të mëdha njerëzore me nxitjen e lëvizjeve nga zonat rurale dhe fshatrat e mëdha, dhe do kishte implikime të mëdha financiare. Ndërsa në kuptimin hapësinorë do ta çrregullonte komunën dhe do të shkaktoj ngarkesa tjera të pa nevojshme.	

Tabela 170 SWOT analiza e Skenarit 2

DRAFT



Harta 52 Skenari i dytë i propozuar

4.6.3. SKENARI 3 - SKENARI I ZHVILLIMIT POLICENTRIK HAPËSINOR

Zhvillimi policentrit bazohet në koncentrim të zhvillimit në nyje të paracaktuara. Ky skenar propozon formimin e 4 nyejve kryesore, qytetin e Shtërpcës dhe tri nënqendra, dy qendra të skijimit dhe një qendër e agroturizmit, të cilat i furnizojnë fshatrat tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale.

Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës dhe tri nën-qendrave, duke e krijuar një tërësi urban, e cila duhet te orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm. Në ketë kohë, në nivel global më shumë se gjysma e botës jeton në zonën urbane, edhe në Shtërpce diku rreth 60 % e popullsisë jetojnë në zonën urbane, është shumë normale zhvillimi i një skenari të tillë edhe për komunën e Shtërpcës, por ky skenar ofron edhe zhvillimin e tri nën-qendrave që synon sado pak një qëndrueshmëri hapësinore dhe funksionale, tri nën-qendrat janë Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme.

Ky skenar përmban edhe përmbajtjet zhvillimore të komunës si zonat për rekreacion dhe turizmi Qendra e skijimit Brezovica dhe qendra e re e skijimit e propozuar, edhe Kashtanjeva propozohet si zonë për zhvillim të agroturizmit.

Për **NYJET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky **skenar** bazohet në zhvillimin disa nyejve që konsideron të rëndësishme, qytetin e Shtërpcës. Ky skenar propozon zhvillimin e qendrës urbane të Shtërpcës duke e krijuar një tërësi urban, Nyje tjetër e rëndësishme është Brodi, Bitija e Poshtme dhe Vërbeshtica, ndërsa nyejt tjera ekzistues do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual.

Për **KORRIDORET** si pjesë të kërkesave nga udhëzimi administrativ ky **skenar** bazohet aksin që fillon në Shtërpc si dhe **Korridor i rëndësishëm, Korridori n**ga Shtërpca, në drejtim të Ferizajt deri te zona kadastrale e Brodit, është një korridor zhvillimorë mjaft i rëndësishëm gjithashtu, kemi edhe korridorin nga Shtërpca deri në Përvall, por edhe tendenca e korridorit në drejtim të Brezovicës qendrës së skijimit.

-Në lidhje me **PLOTËSIMIN DHE DENDËSIMIN**, Skenari 3 ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane, Brod, Vërbeshticë dhe Biti e Poshtme të definuar si më lartë si pjesë e konceptit ku synohet zhvillimi kompakt, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.

-Në lidhje me **MBAJTJEN NËN KONTROLL**, Skenari 3 synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.

-Në lidhje me **MBROJTJEN**, Skenari 3 mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.

-Në lidhje me **ZONAT E RRITJES,** Skenari 3 ofron rizhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, në zonën e rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës edhe pjesëve tjera të kësaj komune, duke e krijuar një tërësi urban, por edhe në Kashtanjevë si zonë për zhvillim të agroturizmit.

Përparësitë	**Mangësitë**
• Zhvillimi i qytetit orientohet e ndërtohet fuqishëm me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete; • Siguron mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet për një urbanizim të qëndrueshëm dhe në të njëjtën kohë tri nën-qendrat tjera Brod, Verbeshticë dhe Bitijë e Poshtme do ruajnë një ekuilibër me funksionet plotësuese hapësinore; • Mundëson urbanizimin e komunës me vendosjen e shumicës së qytetareve në zonën urbane të zgjeruar (deri 70% e popullatës); • Mundëson ofrim më të lehtë dhe me kosto më të ulët të shërbimeve ndaj qytetarëve; • Mundëson kushte të mira edhe për nën-qendrat Brod, Verbeshticë dhe Bitijë e Poshtme por edhe zhvillim kompakt për zonat tjera;	• Pamundëson ndërprerjen e plotë të emigrimeve nga zonat rurale; • Përqendrimi i madh i popullsisë në zonën urbane mund të shkaktoj ngarkesa dhe pritje të mëdha në pjesën qendrore të qytetit; • Mund të shkaktohet ndotje.

• Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme mbrojtjen e natyrës dhe tokës bujqësore; • Promovon zhvillim e bujqësisë sidomos blegtorisë; • Mundëson zhvillimin e zonave turistike (qendrat e Skijimit dhe parkun nacional "Mali Sharr"; • Ofron qasje në korridoret e transportit përmes fuqizimit me rrugën rajonale dhe hapje e rrugës me komunën e Suharekës; • Zhvillimi i zonave ekonomike brenda territorit të komunës dhe në bashkëpunim me zonat fqinje; • Qendrës së skijimit dhe ndërtimi i qendrës së re.	
Konkluzion	
Skenari 3 do të zhvillohet më tutje pasi është vlerësuar si skenari më i mirë dhe më real, i cili do siguronte një ekuilibër hapësinor, zhvillim ekonomik, social, qasje në transport dhe mobilitet, rregullim dhe integrim të korridoreve zhvillimore ekzistuese dhe funksionalizimin e tyre.	

Tabela 171 SWOT analiza e Skenarit 3

DRAFT



Harta 53 Skenari i tretë i propozuar

4.7. ELEMENTET E KONCEPTIT KRYESOR

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për komunën e Shtërpcës u zhvillua duke përdor konceptet hapësinore vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore. Në konceptin kryesor të Zhvillimit Hapësinor kemi marr parasysh dhe reflektuar gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara. Në këtë koncept është bërë integrimin e kërkesave të planifikimit hapësinor që rrjedhin prej vizionit të komunës së Shtërpcës, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara, dhe në mënyrë të përgjithshme më poshtë i kemi prezantuar nëpërmjet përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet për zhvillim për komunën.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor është baza kryesore e zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës për hartat tematike të PZHK-së. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara në skenarë dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë Nyejt, korridoret, plotësimi dhe dendësimi, mbajtja nën kontroll, mbrojtja e zonave të ndjeshme, zonat e rritjes të cilat te skenarët janë trajtuar edhe me implikime financiare për pos si përmbajtje dhe elemente hapësinore.

NYJET	
	Përcaktimi i disa **NYJEVE** dhe trajtimi i tyre si pika hapësinore të përqendruara ku promovohet densifikim të banimit, intensifikim i funksioneve dhe aktiviteteve.
Konstatohet se hapësirat **që plotësojnë kriteret të trajtohen si nyje janë Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme** por edhe vendbanime tjera me një densitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe ekzistencës së funksioneve të theksuara. Zona urbane e qytetit të Shtërpcës.	

KORRIDORET	
	Trajtimi i disa lidhjeve/ korridoreve ndërmjet nyejve, përgjatë të cilave, natyrshëm mund të nxitet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit.
Konstatohet se aksi që fillon nga Shtërpca dhe vazhdon drejtim të Ferizajt dhe korridori në drejtim të Prevallës apo Prizrenit, tendencë korridorit në drejtim të Brezovicës ku kemi zhvillime hoteliere dhe banimi.	

PLOTËSIMI/ DENDËSIMI	
	Paraqet mundësi dhe potenciali mbushjes dhe dendësimit të hapësirave me zhvillime të caktuara, për të arritur zhvillim hapësinor kompakt dhe për të rritur pragun e popullsisë.
Konstatohet hapësira brenda kufijve ndërtimor të zonës urbane të qytezës së Shtërpcës kanë mundësi dhe potenciale që të mbushen dhe dendësohen me zhvillime qoftë banim ose përmbajtje tjera. Po ashtu, edhe hapësira brenda kufijve ndërtimor të zonave rurale si në fshatrat Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme, e fshatra tjerë, me trend demografik në rritje kanë mundësi dhe potencial që të mbushen dhe dendësohen me zhvillime qoftë banim ose përmbajtje tjera, dhe mund të konsiderohen si zona me mundësi për plotësim dhe dendësim.	

DRAFT

Gjatë këtij procesi në formulimin e këtij koncepti është trajtuar edhe zhvillimi i mundshëm i tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës e cila është trajtuar edhe te koncepti i plotësimit dhe dendësimit.

MBAJTJA NËN KONTROLL	
	Koncepti i Mbajtjes nën Kontroll i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ultë, përmes përdorimit të kufirin për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore, sidomos në drejtim të zonës me ndjeshmëri të lart siç është PN "Mali Sharr" zona e parë dhe zona e dytë.
Në komunën e Shtërpcës janë identifikuar disa hapësira ku ka zhvillim joefikas me dendësi të ultë (si në afërsi të zonës urbane dhe në disa zona rurale/ fshatra me numër të madh të banorëve). Gjatë analizës është arritur pajtim në parim që të definohet kufiri ndërtimor në çdo fshat dhe zonën urbane duke u bazuar në gjendjen reale në teren dhe duke tentuar të mbrohet sa më shumë tokë bujqësore. Në hapësirat ku konstatohet se ka zhvillim joefikas me dendësi të ultë të kufizohen dhe mos të lejohet zhvillim i mëtejmë, zgjerimi të mbahet nën kontroll, dhe zhvillimet brenda fshatrave gjatë përcaktimit të kufijve ndërtimor të mos marrin për bazë zhvillimet joefikase me dendësi të ultë por të promovohen konceptet e zhvillimeve kompakte. Ky koncept është paraqitur në harta me kufijtë ndërtimor me qëllim të mbajtjes nën kontroll të zhvillimeve, gati në të gjitha drejtimet në periferi të zonës urbane.	

MBROJTJA	
	Koncepti i mbrojtjes paraqet koncept i cili i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë.
Konstatohet së në komunën e Shtërpcës pasuritë nëntokësore, si uji, minerale dhe arkeologjike duhet të ruhen dhe bazuar në interesat publike dhe mundësive të planifikohen të trajtohen dhe zhvillohen në harmoni me kërkesat dhe obligimet ligjore, tokës bujqësore, peizazhet dhe vlerat natyrore.	

ZONAT E RRITJES	
	Koncepti me **Zona të Rritjes** paraqet zhvillim të zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzim efikas i tokës.
Konstatohet se disa vendbanime mund të trajtohen si **Zona të Rritjes,** dhe mënyrë të veçantë zona urbane, dhe në disa vendbanime në këto zona mund të ketë ri-zhvillim të zonave ekzistuese, të cilat do ri-zhvillohen në kuptimin e ofrimit të cilësisë së banimit, por edhe me intensitetet më të larta të ndërtimit, ri-zhvillim mund të ketë edhe në disa zona të zhvillimit ekonomik zonat ku ishte e zhvilluar industria por dhe zona tjera.	

DRAFT

4.8. SKEMA KRAHASUESE E SKENARËVE TË PROPOZUAR

	SKENARI 1	SKENARI 2	SKENARI 3
	 SKENARI KRYESOR NGA PZHK E KALUAR, ME ZHVILLIM POLICENTRIT	 ZHVILLIM I FUQISHËM, VETËM TË ZONËS URBANE DHE ZONAVE PERIFERIKE (MONOCENTRIK)	 SKENARI I ZHVILLIMIT POLICENTRIK HAPËSINOR, ME DISA PËRMBAJTJE ZHVILLIMORE DHE ME THEKS NË POTENCIALET E KOMUNËS
NYJET 	●●●○○	●●○○○	●●●●●
	Koncentrimi i zhvillimit në nyje, bazohet në zhvillim policentrit. Ky skenar propozon formimin e 3 nyejve kryesore, qytetin e Shtërpcës dhe 2 qendra të tjera dytësore, të cilat i furnizojnë fshatrat tjera me shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale.	Përdorimi i nyejve në një skenar monocentrik paraqet formimin e vetëm një nyje/ qendre dhe koncentrim të pjesës më të madhe të zhvillimit në atë nyje/ qendër. Nyja kryesore apo qendra sipas këtij skenari është qyteti i Shtërpcës, ndërsa nyejt tjera ekzistuese nuk do trajtohen me prioritet por do mbahen në kufijtë aktual.	Ky skenar propozon formimin e 6 nyejve kryesore, qytetin e Shtërpcës dhe 3 qendra të tjera dytësore, që furnizojnë fshatrat tjera me shërbime, infrastrukturë teknike, publike dhe sociale dhe dy qendra turistike sportive. Nyejt e rëndësishme janë Vërbeshtica, Brodi dhe Bitija e Poshtme dhe Qendrat e skijimit ne Brezovice dhe qendra e re e skijimit e planifikuar. ndërsa nyejt tjera ekzistues do trajtohen mjaftueshëm brenda kufijve aktual.
KORRIDORET	●●●○○	●●●●○	●●●●●

DRAFT

	Ky skenar bazohet në akset që fillojnë nga Shtërpca dhe vazhdojnë nëpër qendrat sekondare që kanë tendencë për zhvillim. Si Korridor kryesorë konsiderohet aksi nga Shtërpca në drejtim të Prizrenit dhe në drejtim të Ferizajt .	Ky skenar bazohet Si Korridor kryesorë konsiderohet aksi nga Shtërpca në drejtim të Prizrenit dhe në drejtim të Ferizajt. Ne këtë skenar synohet që gjitha vendbanimet të lidhen me korridorin kryesor të kenë akçes në këtë korridor si dhe paraqet një ndërlidhje të veçantë në mes të qendrave të skijimit dhe zonës qendrore të Shtërpcës.	Ky skenar bazohet në aksin që fillon nga Shtërpca në drejtim të Prizrenit dhe në drejtim të Ferizajt, paraqet një tendencë të zhvillimit të një korridori në drejtim të Brezovicës duke i inkorporuar në kuptimin hapësinor edhe elementet të cilat janë ekzistuese në këto zona.
PLOTËSIMI DHE DENDËSIMI	●●●●○	●●○○○	●●●●●
	Ky skenar ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane dhe në qendrat sekondare, me synim të zhvillimit më të madh në këto zona por edhe në pjesët tjera rurale.	Ky skenar ofron vetëm plotësimin dhe dendësimin vetëm në zonën (monocentrike) urbane, si pjesë kryesore e konceptit, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.	Ky skenar ofron plotësimin dhe dendësimin në zonën urbane, Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme të definuar si pjesë e konceptit ku synohet zhvillimi kompakt, por plotësim dhe dendësim do të ketë edhe në zonat tjera rurale.
MBAJTJA NËN KONTROLL	●●●●●	●●●●●	●●●●●
	Ky skenar synon kufizimin e zhvillimeve joefikase dhe mban ne kontroll kufijtë e definuar ndërtimor të zonës urbane dhe asaj rurale.	Ky skenar synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitetit të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtimet.	Ky skenar synon mbajtjen në kontroll të gjithë kufijve të definuar ndërtimor qoftë zonës urbane qoftë vendbanimeve rurale, e sidomos në zonat rurale ku jetojnë një përqindje më e vogël e banorëve, duke mos lejuar shtrirje të reja, dhe intensitet të ndërtimeve jashtë zonave të definuara për ndërtim.
MBROJTJA	●●●●●	●●●●○	●●●●●

DRAFT

	Ky skenar mbron resurset e vlefshme natyrore, kulturore, të trashëgimisë e ekonomike në komunën e Shtërpcës.	Ky skenar mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.	Ky skenar mbron tokë bujqësore, mirëpo në anën tjetër synon edhe mbrojtjen e pasurive tjera qoftë nëntokësore, qoftë sipërfaqësore, për tu shfrytëzuar ose marrë masat e duhura sipas planit në funksion të qëndrueshmërisë afatgjate.
ZONAT E RRITJES	●●●●○	●●●○○	●●●●●
	Ky skenar ofron ri-zhvillimin e zonave ekzistuese me intensitet më të lartë dhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzim efikas i tokës.	Ky skenar ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, vetëm në një zonë të rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës.	Ky skenar ofron ri-zhvillim të zonave ekzistuese në intensitetet më të larta, në zonën e rritjes edhe atë në qytetin e Shtërpcës, por edhe zhvillim të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës edhe nënqendrave si Brodi, Vërbeshtica dhe Bitija e Poshtme.

DRAFT

4.9. KONCEPTI KRYESOR I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti kryesor i zhvillimit hapësinor është bazuar në reflektimin e gjendjes aktuale dhe integrimit të zhvillimeve të planifikuara. Logjika hapësinore dhe integrimi i kërkesave të planifikimit hapësinor rrjedhin drejtpërsëdrejti nga vizioni i komunës së Shtërpcës, qëllimeve dhe objektivave përmes tërësive të zgjidhjeve të planifikuara, të prezantuar në mënyrë të përgjithshme përmes përshkrimit tekstual dhe hartave konceptuale hapësinore për të gjitha strategjitë sektoriale dhe propozimet zhvillimore për komunën e Shtërpcës.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përcakton bazën kryesore të zhvillimit dhe shfrytëzimit të tokës të paraqitur në hartat tematike të PZHK-së. Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara gjatë analizës së skenarëve dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë nyejt; korridoret; plotësimi dhe dendësimi; mbajtja nën kontroll; mbrojtja; zonat e rritjes të cilat përpos aspektit hapësinor gjatë strukturimit të skenarëve është trajtuar implikimi financiar i zbatimit të secilit element.

Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor mbështet policentrizmin, ku nyejt ndërlidhen nëpërmjet korridoreve zhvillimore. Korridoret ekzistuese janë analizuar nga aspekti social, ekonomik dhe financiar, dhe është konstatuar se implikimet sociale dhe financiare të mos integrimit të korridoreve ekzistues janë të mëdha, andaj duhet pranuar dhe integruar korridoret ekzistuese, dhe duhet trajtuar tutje si pjesë të konceptit hapësinor(rregullimi dhe funksionalizimi i tyre). Në kuptimin hapësinor, element përmbajtjesor të konceptit kryesor janë edhe dy qendrat e skijimit dhe parku nacional "Mali Sharr".

Koncepti në nivelin e hapësirave mbështet modelin e zhvillimit **kompakt dhe të baraspeshuar zhvillimor** duke promovuar intensitet të lartë zhvillimor dhe të shfrytëzimit të tokës, duke kontrolluar zgjerimet dhe rritjet e më tutjemë përmes përcaktimit të zgjerimeve të Zonës Urbane dhe kufijve ndërtimor të Zonës Rurale, dhe përcaktimit të Zonave të Mbrojtura në nivel komunal në kuadër të parkut nacional "Mali Sharr".

Më saktësisht, në nivel të zonës urbane mbështet modelin e zhvillimit hapësinor-funksional policentrit dhe modelin hapësinor- zhvillimor kompakt dhe të baraspeshuar, si dhe në nivelin e zonave rurale mbështet modelin hapësinor-zhvillimor kompakt për nën- qendrat dhe vendbanimet tjera, kurse në aspektin funksional nën-qendrat trajtohen si nyje shërbyese të shërbimeve publike dhe sociale ku gravitojnë banorët e vendbanimeve përreth.

Në aspektin e zhvillimit bujqësor, koncepti kryesor trajton edhe ndarjen e territorit të komunës së Shtërpcës në **gjashtë zona zhvillimore bujqësore** duke specifikuar përshtatshmërinë bujqësore dhe projektet zhvillimore për secilën nga gjashtë zonat zhvillimore bujqësore.

Pjesë përbërëse kryesore e definimit të infrastrukturës së transportit rrugor në koncept të përgjithshëm është rruga e cila e lidhë Shtërpcën me Suharekën dhe teleferiku i cili lidhë qendrat e skijimit të Shtërpcës me Përvallën.

DRAFT



Harta 54 Koncepti kryesor për zhvillim të ardhshëm hapësinor të komunës së Shtërpcës

Zhvillimet e planifikuara sipas fushave tematike

Zhvillimi i mëtutjeshëm duhet të sigurojë jetesë të mirë në mbarë komunën e Shtërpcës, duke e trajtuar skenarin e përzgjedhur (skenari i 3-të) për zhvillimin hapësinor. Kushtet e barabarta të jetesës dhe punës duhet të arrihen dhe të ruhen në çdo pjesë të komunës së Shtërpcës. Ruajtja dhe arritja e efikasitetit në gjithë territorin, sigurimi i aktivizimit dhe promovimit të zhvillimit të vazhdueshëm të potencialit ekzistues endogjen është thelbësor. Prandaj një menaxhim efikas i hapësirës është i duhur për vëzhgimin dhe rritjen e sigurisë së hapësirave të ndryshme të strukturuara.

4.9.1. Zhvillimi ekonomik

Funksioni ekonomik

Duke konsideruar potencialet dhe përparësitë për zhvillim ekonomik komuna e Shtërpcës do të fokusohet në zhvillimin e sektorëve konkurrente dhe një infrastrukture ekonomike efikase. Përpos menaxhimit të shfrytëzimit të tokës, Komuna e Shtërpcës duhet të zhvillojë dhe shtojë sektorët tjerë ekonomik të cilët shkojnë në shërbim apo mbështetje të turizmit në qendrat e skijimit, p.sh. ndërtimtarinë, prodhimtarinë, tregtinë, akomodimin dhe sektorin e energjisë. Koncept i zhvillimit hapësinor promovon zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, duke mbështetur ekonominë lokale si ekonomitë familjare dhe punësimin, dhe atë gati në të gjithë sektorët ekonomik:

Industria, bazuar në koncept është ruajtur ose destinuar hapësirë për zhvillim dhe fuqizim të industrisë së prodhimit dhe përpunimit të drurit, plastikës, produkteve të qumështit, mishit, ushqimoreve dhe pijeve. Koncepti hapësinor ka integruar çdo parcelë ku zhvillohet industria brenda PZHK-së, edhe se kanë shtrirje jo të përshtatshme hapësinore. Në aspektin zhvillimor, korridoret zhvillimore edhe pse konceptualisht zhvillim jo-kompakt, promovojnë veprimtari industriale dhe ekonomike në Shtërpcës, andaj me qëllim integrimin e tyre dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese, synohet fuqizimi i strukturave të tyre në këtë PZHK.

Zonat ekonomike. Këto aktivitete duhet të zhvillohen në zonat ekzistuese urbane dhe në hapësirat për zgjerim të vendbanimeve. Zonat e reja ekonomike dhe industriale krijohen përgjatë rrugës Shtërpc-Ferizaj, dhe Shtërpc-Prizeren, duke krijuar korridoret e zhvillimit ekonomik dhe të qëndrueshëm. Për më tepër, planifikohet krijimi i zonës ekonomike në Shtërpcë.

Koncepti promovon krijimin e zonës ekonomike brenda komunës së Shtërpcës, shqyrtimin e mundësive për krijim të zonave të përbashkëta ekonomike me komunat fqinje.

Bizneset. Në komunë të Shtërpcës operojnë një numër i konsiderueshëm i bizneseve për kapacitetet e Komunës, andaj ky koncept mbështet krijimin e kushteve për ruajtjen dhe fuqizimin e bizneseve ekzistuese si dhe destinimin e hapësirave për biznese të reja nga të gjitha sektorët, përfshirë prioritet krijimin e kushteve për investim të bizneseve nga jashtë. Në këtë drejtim në zonën urbane është integruar zona e bizneseve dhe kudo që veprojnë bizneset janë favorizuar në kuptimin e sigurimit të kushteve dhe infrastrukturës përcjellëse. Edhe hapësira në trekëndëshat e zhvillimit ekonomik, ndërtimtari, transport, zonat bujqësore, turistike, etj.

Tregtia. Në Komunën e Shtërpcës janë disa shitore tregtare dhe depo me pakicë e shumicë, të cilat iu ofrojnë konsumatorëve lloje të ndryshme të mallrave, si: mallra ushqimore, të higjienës, tekstilit, galanterisë së lëkurës, aparateve të amvisërisë, mobilierisë dhe mallrave të tjera të konsumit të gjerë.

Planifikimi i kushteve dhe infrastrukturës përcjellëse për zhvillim të tregtisë në komunën e Shtërpcës është pjesë e rëndësishme e konceptit të përzgjedhur zhvillimor hapësinor. Promovohet infrastrukturë rrugore që do të mundësonte import dhe eksport të mallrave në rajon dhe në Kosovë. Me qëllim fuqizimit të punësimit në sektorin e tregtisë, koncepti promovon dhe ofron kushte dhe infrastrukturë për veprimtari tregtare promovohen brenda zonës urbane dhe fshatrave të Komunës së Shtërpcës.

Turizmi

Një pjesë e rëndësishme e konceptit të zhvillimit ekonomik është zhvillimi i turizmit, kështu që koncepti favorizon turizmin dimëror në vendpushimet e skive. Përveç turizmit dimëror, është planifikuar edhe zhvillimi i turizmit rekreativ, malor, shëndetësor, agroturizmit, turizmit kulturor dhe atij rural.

Zhvillimi i turizmit në komunë do të bazohet në pasuritë natyrore që ka Mali Sharr. Qendrat turistike janë vendbanimet që lidhen me shtigje këmbësorësh, teleferik, vende për piknik, peizazhe të jashtëzakonshme dhe trashëgimi kulturore. Ato duhet të ofrojnë akomodim dhe informacione turistike.

Me anë të turizmit rekreativ do të nxitet zhvillimi i aktiviteteve plotësuese (hotelieria, , bizneset e vogla, shërbimet publike, infrastruktura, bujqësia, etj.), duke mbështetur punësimin e popullatës lokale dhe menaxhimin më të mirë të

vlerave natyrore dhe kulturore të komunës si asete themelore për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit, prodhimit të eko-ushqimit etj.

Duke ndjekur konceptin e veprimtarive hoteliere që kryesisht operojnë në Brezovicë dhe në brendi të qytetit dhe pjesërisht në pjesët periferike të qytetit dhe në disa fshatra, promovohet intensifikimi i kapaciteteve turistike sidomos në zonat e parapara për turizëm.

Zhvillimi i vikend shtëpive dhe atraksioneve turistike përfshin planifikim strategjik që përmban aspekte ekonomike, hapësinore, mjedisore dhe kulturore. Qëllimi i këtij planifikimi është krijimi i destinacioneve turistike që ofrojnë për vizitorët përvojë vendore, zhvillim të resurseve natyrore dhe infrastrukturë përkatëse.

Zhvillimi i vikend zonave turistike janë planifikuar në lokacionet e mëposhtme:

- Vikend Zona e Vërbeshticës jashtë Parkut Kombëtar për zhvillimin e restoranteve dhe vikend shtëpive;
- Vikend Zona e Jazhincës jashtë Parkut Kombëtar për zhvillimin e restoranteve dhe vikend shtëpive;;
- Vikend Zona e Kashtanjevës jashtë Parkut Kombëtar për zhvillimin e restoranteve dhe vikend shtëpive;

Vikend Zonat kanë një qëllim kryesisht turistik-rekreativ dhe qëllimi i tyre themelor është qëndrimi i përkohshëm i popullsisë për pushim dhe rekreacion. Në përputhje me këtë, objektet në këto vendbanime nuk mund të përdoren për banim të përhershëm, si dhe nuk lejohet regjistrimi i vendbanimit të përhershëm në to. Në këtë mënyrë mbrohet funksioni i hapësirës, parandalohet urbanizimi i pakontrolluar dhe mundësohet zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.

Përpos hapësirave të Vikend Zonave të cekura më lartë, zhvillimi i turizmit do të zhvillohet në Vikend zonat tjera të parapara në Planin Zhvillimor Komunal.

DRAFT



Harta 55 Harta e Zhvillimit Ekonomik (Gjendja e planifikuar)

Ndërtimtaria. Në Shtërpcë operojnë një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve ndërtimore, kryesisht ndërmarrjet që merren me ndërtim të vilave në zonat turistike dhe ndërtime të ulët dhe ato që prodhojnë materiale ndërtimore (gurëthyesit, prodhimi i betonit dhe elementeve të parafabrikuara të betonit, prodhimi i asfaltit, përpunim të drurit, plastikës, metalit, etj.). Ky koncept përkrah fuqizimin e ndërmarrjeve ndërtimore, duke siguruar destinim të hapësirave për prodhim, duke promovuar zhvillim ndërtimor, veçanërisht atij banesor dhe afarizëm. Zhvillimi i industrisë ndërtimore mbështetet edhe nga ndërtimet për ndërtesa të reja të nevojshme për ndërmarrjet e reja potenciale, dhe ofrim të shërbimeve projektuese nga byro projektuese të cilat iu ofrojnë dhe do të ju ofrojnë qytetarëve shërbime: projekte ideore, projekte kryesore dhe mbikëqyrjen e tyre gjatë realizimin (ndërtimin).

Funksioni bujqësor

Bujqësia, sektori i frutave malore dhe tjerave te kultivuara është një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e Shtërpcës. Kjo komunë ka potenciale shumë të mira për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë e cila mbështetet fuqishëm me ketë koncept duke planifikuar kushte dhe infrastrukturë përcjellëse duke promovuar kontribut të konsiderueshëm në ekonomi dhe stabilitetin social.



Harta 56 Harta e Zhvillimit Bujqësor (Gjendja e planifikuar)

Parashihet ndarje e territorin komunal në 3 zona zhvillimore bujqësore: I. Zona rrafshi përgjatë Lepencit; II. Zona Rurale - Bitija e Epërme dhe e Poshtme, Brodi, Firaja; III. Zona e Verbeshtices Viça, Sevca, ku -në të gjitha këto zona koncepti mbështet mbrojtjen e tokës bujqësore dhe trajtim me prioritet për këto zhvillime: Miniferma për lopë qumështore, Miniferma për brojlerë, punkte të grumbullimit të qumështit, njësi përpunuese të qumështit, bletore të reja, Miniferma për dhenë, Miniferma për dhi, ngritje të kapaciteteve për prodhimin e drithërave ton/ha, ngritja e pemishteve të reja si dhe rritja e prodhimtarisë për hektar, ngritja e serrave në zonën përgjatë Lepencit, zhvillimi i agroturizmit konkretisht në pjesën e Kashtanjevës, Brodit dhe Jazhincës.

Brenda zonave bujqësore parashihet edhe mbrojtja e tokave bujqësore si resurs nacional, dhe si aset ekonomik e mjedisor, planifikohet të mbrohet nga degradimi, nga erozioni, fragmentimi dhe ndërtimet, për çka kemi definuar kufijtë ndërtimor dhe kufijtë e tokave bujqësore që planifikohet të mbrohen dhe zhvillohen.

LAVËRTARIA/PERIMTARIA. Lavërtaria është një ndër degët më të vjetra të bujqësisë dhe komuna e Shtërpcës ka një traditë të vjetër të kultivimit të bujqësisë konkretisht të kulturave lavërtarie si e drithërave (grurit, misrit, elbit dhe tërshërës), perimeve (patates, domates, trangullit, specit, shalqirit e shumë kultura tjera). Komuna e Shtërpcës ka tokë

bujqësore relativisht të mirë për kultivimin e kulturave lavërtarie sidomos pjesa përgjatë Lepencit ka një përshtatshmëri të lartë të tokës bujqësore me potencial të lartë të prodhimit të kulturave lavërtarie.

PEMËTARIA. Rajoni i Shtërpcës ka një traditë edhe në kultivimin e pemëve të ndryshme, sidomos mjedrës, rrushit e cila më pastaj ka mundësi të përpunohet në industrinë përpunuese e cila aktualisht është relativisht e zhvilluar në regjionin e Shtërpcës. Për të zhvilluar tutje pemëtarinë, parashihet që përmes ngritjes së disa kapaciteteve për ujitje të zonës dhe subvencioneve në këtë fushë do të fuqizonte këtë veprimtari bujqësore e cila është shumë e nevojshme për Shtërpcën.

Drejtoria për bujqësi dhe zhvillim rural në kornizën zhvillimore për 8 vitet e ardhshme ka paraparë investime në sektorin e pemëtarisë në formën e përkrahjes së fermerëve duke mbështetur zhvillim të sipërfaqeve me pemë.

PESHKATARIA DHE AKUAKULTURA Shtërpca është një vend i pasur me burime ujore, të cilat përbëhen nga lumi Lepenc dhe rrjedhat e tij të cilat janë të pasura me peshq të llojeve të ndryshme në rrjedhat e sipërme të lumit.

Sektori i peshkimit në Shtërpcë është relativisht i pazhvilluar, por i rëndësishëm nga pikëpamja social- ekonomike, si burim i rëndësishëm i vendeve të punës në zonat dhe periudhat e caktuara kohore gjatë vitit.

AKUAKULTURA ka një potencial të madh për zhvillim në të ardhmen, duke ndërthurur aspektet sociale, ekonomike. Kultivuesit e peshkut përdorin teknika të ndryshme kultivimi, intensive, gjysmë intensive, dhe të gjera për të rritur kryesisht troftë, molusqe dhe krap. Këto specie rriten në rezervuarë, liqene artificiale dhe natyrore. Akuakulturara apo rritja e peshkut në formë të organizuar ka filluar të zhvillohet posaçërisht në restorante në basene artificiale për nevojat e tyre.

Blegtoria si një degë e Bujqësisë në Komunën e Shtërpcës zë një vend të posaçëm kur kemi parasysh produktet dhe nënproduktet që merren nga bagëtitë duke filluar prej mishit, qumështit dhe produkteve të tyre. Komuna e Shtërpcës në aspektin gjeografik është shumë e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë duke pasur parasysh sipërfaqet e mëdha të livadheve dhe kullotave, ku veprojnë disa ekonomi familjare që merren me blegtori. Sektori i shpezërisë në Shtërpcës është pak i zhvilluar dhe kryesisht i orientuar në prodhimtari të vezëve për nevoja familjare. Viteve të fundit prodhimtaria e mishit të pulës apo rritjes së bojlerëve mbisundon shpezërinë me një interesim më të madh.

BLEGTORIA DHE SHPEZËRIA do zhvillohet si ekstensive dhe intensive, ku janë paraparë projekte për zhvillimin dhe rritjen e blegtorisë në nivel komune si: rritjen e numrit të bagëtive në nivel komune, përkrahjen e fermerëve me sigurim të mekanizmave (makina për mjeljen e gjedheve, ngrirjen e qumështit, etj).

AGROBIZNESI. Duke marrë parasysh sipërfaqen e kufizuar të tokës bujqësore për një familje, si dhe shpërndarjen e popullsisë, bujqësia nuk mund të sigurojë zhvillim të suksesshëm rural. Megjithatë, në viset rurale janë duke u zhvilluar disa biznese që kanë perspektivë si: grumbullimi dhe përpunimi i produkteve bujqësore (si pemëtaria), përpunimi i drurit, bizneset për grumbullimin e kërpudhave dhe frutave malore të tjera pyjore, bletaria, bimët mjekuese, prodhimi dhe përpunimi i mishit, dhe me prezencë të ulët turizmi fshatar dhe turizmit malor.

Zhvillimi i sektorit bujqësor në zonat rurale mund të ndikojë dukshëm në ngritjen e nivelit të ardhurave dhe në uljen e papunësisë. Për të nxitur zhvillimin e bizneseve rurale, korniza zhvillimore parasheh mbështetjen bizneseve të vogla dhe të mesme rurale nëpërmjet krijimit të kushteve dhe infrastrukturës përcjellëse për zhvillimin e bizneseve familjare.

Sistemet e ujitjes paraqiten si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore, që ndikon në produktivitetin dhe në profitabilitetin e fermerëve. Investimi në ndërtimin e sistemit të ujitjes së tokave bujqësore, është prioritet dhe domosdoshmëri me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe zhvillim më të qëndrueshëm bujqësor. Ujitja**,** sipas mundësive në Shtërpce planifikohet të zhvillohet si ujitje artificiale nga burimet e ndryshme natyrore si: lumi Lepenc dhe rrjedhat e tije. Zhvillimi i rrjetit të ujitjes, planifikohet të realizohet si ujitje kolektive e organizuar me sisteme të mëdha, duke përfshirë disa ha tokë për ujitje.

Rrjetit i gypave të ujitjes do të jetë nëntokësor, me ujë nën shtypje (me presion), me sprucatorët në formë shiu. Përzgjidhet ky sistem i ujitjes, për arsye se nuk kërkon përkujdesje permanente dhe mundëson shtrirjen e rrjetit në rastet kur ka shumë parcela me madhësi nën 1 ha, siç është rasti në zonat rurale të Shtërpcës.

PYLLTARIA. Objektiv i përgjithshëm është ngritja e sektorit pyjor në ekonominë lokale, nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore, duke marrë parasysh gjithmonë rolin shumë funksional të pyjeve sidomos në këtë komunë ku pjesa më e madhe e tyre janë nën mbrojtje në kuadër të parkut nacional "Mali Sharr". Koncepti promovon që pyjet dhe tokat pyjore të shfrytëzohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri me principet për konsensusin global të menaxhimit dhe mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të gjitha llojeve të pyjeve.

DRAFT

Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se pjesa më e madhe e ekonomive familjare për ngrohje përdorin drurin, dhe përdoret në industrinë përpunuese të drurit rezulton në eksploatim të lartë të pyjeve për çdo vit. Si, kundërpërgjigje, koncepti siguron ripyllëzim të hapësirave të zhveshura nga vegjetacioni si dhe rikthim të shkurreve dhe cungishtave në pyje të larta me theks të veçantë në pjesën e maleve ku erozioni është më i theksuar.

VEPRIMTARITË EKONOMIKE ME KOMUNAT FQINJE. Koncepti parasheh edhe lidhjen e veprimtarive ekonomike me komunat fqinje për zonën e përbashkët ekonomike me Prizrenin duke u lidhur me një teleferik me zonat e qendrave e skijimit, Ky koncept inkurajon edhe hulumtimin e mundësive për zona ekonomike të përbashkëta edhe me komunën e Suharekës përmes hapjes së një rruge e cila do të ndihmonte këto dy komuna në shkëmbimin e mallrave dhe produkteve tjera mes veti.

RESURSET. Koncepti është i bazuar në eksploatim të qëndrueshëm të gjithë resurseve dhe mbështet mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve nëntokësore, sipërfaqësore, kulturore e njerëzore por dhe shfrytëzim të resurseve për shërbime turistike, si akomodim dhe shërbim të ushqimit.

Ndikimi i infrastrukturës së transportit si ndërtimi i **Autoudhës** Prishtinë- Shkup, që lidh Prishtinën me shtetin e Maqedonisë dhe me Korridoret VIII dhe X, dhe kalon nëpër Kaçanik e cila është komunë fqinje dhe shumë afër, duke i ofruar Shtërpcës kyçje dhe lidhje me korridoret e rëndësishëm evropian, është pjesë e rëndësishme e konceptit dhe element përmbajtjesor që do fuqizoj zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, edhe hekurudha Fushë Kosovë- Hani Elezit ofron kyçje dhe lidhje me korridoret e rëndësishëm evropian.

4.9.2. Infrastruktura teknike

Koncepti mbështet plotësimin e nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë teknike cilësore dhe me kapacitetet e planifikuara sipas normave teknike të planifikimit. Infrastruktura e planifikuar do jetë në funksion të plotësimit të nevojave për nivelin qendror, rajonal dhe lokal duke planifikuar shtrirjen, lokacionet dhe kapacitetet e kësaj infrastrukture, dhe identifikimin e hapësirave zhvillimore që kanë nevojë për infrastrukturë të zgjeruar dhe të re.

ENERGJIA ELEKTRIKE DHE TERMIKE. Nga analiza e gjendjes ekzistuese të rrjetit të elektro- energjetik rezulton se rrjeti shpërndarës është i vjetruar dhe se është shkaktari kryesor i problemeve me furnizim me energji elektrike në komunë.

Prandaj e nevojshme të planifikohet përmirësimi i rrjetit ekzistues për të rritur cilësinë dhe sigurinë e furnizimit, si dhe për të reduktuar humbjet teknike në zona të caktuara të komunës, si dhe në fshatrat ku këto humbje janë më të theksuara. Kjo nënkupton kalimin nga rrjeti shpërndarës ajror 10kV në rrjetin shpërndarës kabllovik 20kV si dhe zëvendësimin e linjave ajrore 230/400 me kabllo gërshetë apo edhe kabllo nëntokësore domosdoshmerisht ne qytet por edhe ne lokacionet me numër të konsiderueshëm të konsumatorëve.

Në rrjetin e fshatrave më periferike gjithashtu duhet rrjeti të përmirësohet duke vendosur shtylla nga betoni, si dhe zëvendësimi i përçuesve të stërvjetruar me kabllo bistek.

Në kuadër të ketij plani edhe infrastruktura dhe objektet e rrjetit elektro-energjetik të vjetruara, duhet të zëvendësohet, andaj parashihet eliminimi gradual i trafostacioneve të nivelit 35/10 kV dhe kalimi në ato me tension TS 110/20kV, dhe zëvendësimi i nënstacioneve me kapacitet NS 10/0.4 kV në ato me kapacitet 20/0.4 kV.

Sa i përket, energjisë termike, fatkeqësisht Shtërpca nuk posedon asnjë lloj rrjeti për ngrohje qendrore. Koncepti inkurajon edhe hulumtimin e mundësive për ngrohje për zhvillim të sistemit të ngrohjes qendrore me gaz natyror, dhe përdorim të energjisë diellore, energjinë e erës, nga djegia e mbeturinave për energji termike dhe/apo elektrike.

Në drejtim të përmirësimit të **efiçiencës së energjisë**, parashihen masa për rritjen e efiçiencës së energjisë, së pari në ndërtesat publike, hotele dhe bujtina dhe sistemin e ndriçimit publik, për të vazhduar më tutje në ndërtesat private.

Lumi Lepenc mund të shfrytëzohet si hidrocentral për të prodhuar sasi të vogël të energjisë elektrike por pa e dëmtuar lumin dhe rrjedhën natyrore të lumit dhe rrjedhave të tij.

UJËSJELLËSI. Për të përmirësuar gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Shtërpcës, viteve në vijim duhet të investohet në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shërbimeve teknike për gjithë territorin e komunës, duke i ndërmarrë këto veprime:

- Mbulueshmëri me qasje në rrjet të ujësjellësit të 70% të vendbanimeve rurale ku mungon rrjeti dhe të 30% të zonës urbane ku mungon rrjeti;
- Zëvendësimi i të gjithë gypave kryesor (transportues) dhe sekondar (rrjetave) të ujësjellësit nga materiali i Azbest Cement në PE-100 RC apo HDPE-100;
- Hapje e puseve të reja për rritje të kapaciteti të ujit.

- Përmirësimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit në qytet- zvogëlimi i humbjeve mbulimin e zonës së shërbimit më ujëmatës zonal (për reduktimin dhe gjetjen e humbjeve teknike dhe administrative), instalimin e ujëmatësve shtëpiak me lexim dhe ndalje nga distanca, identifikimin dhe eliminimin e kyçjeve ilegale.
- Renovimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë në qytet – ndërrimi i gypave të vjetër të azbest çimentos në disa segmente dhe rritja e diametrit të gypit në disa segmente;
- Montimi i ujëmatësve zonal në hyrje të fshatrave dhe në lagjet urbane.

KANALIZIMI. Për të përmirësuar gjendjen në shkarkim të ujërave të zeza në Komunën e Shtërpcës, viteve në vijim do të investohet në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe shërbimeve teknike për gjithë territorin e komunës, duke i ndërmarrë këto veprime:

- Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit
- Ndërtimi i Fabrikës për trajtimin e ujërave të ndotura për mbulueshmërinë e zonës urbane dhe disa fshatrave në Brod.
- Ndërtimi i disa impianteve të vogla për zonat ku nuk ka mundësi të kyçen në kolektorin kryesor të komunës.
- Ndarja e ujërave atmosferike nga ato të zeza.

KANALIZIMI ATMOSFERIK. Në fshatra sistemi i kanalizimit atmosferik mungon ndërsa ekziston kanalizimi i hapur i cili është pak i mirëmbajtur. Në shumë raste kanalizimin atmosferik e kemi të përbashkët me kanalizimin e ujërave të zeza. Për të përmirësuar mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit atmosferik në Komunën e Shtërpcës duhet të investohet në rehabilitimin e kanaleve, pastrimin e kanaleve të mbyllura dhe funksionalizimin e tyre, identifikimin e kyçeve ilegale të kanalizimit të ujërave të ndotura në sistemin e kanalizimit atmosferik, dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre duke i trajtuar kanalet e hapura. Ndërmerren këto veprime:

- Ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimit atmosferik të ndarë nga kanalizimi i ujërave të zeza;
- Ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimit atmosferik të ndarë nga kanalizimi i ujërave të zeza në gjitha vendbanimet;

TELEKOMUNIKACIONI. Në rrjetin e telekomunikacionit në komunën e Shtërpcës bëhen investime të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të performancës së tij. Në këtë aspekt është shtrirja e kabllosë optike (KO) në fshatrat. Në zonën urbane, ndërsa planifikohet të shtrihet për gjitha vendbanimet.

Propozimet për zgjerimin e infrastrukturës së telekomunikacionit janë planifikuar si në vijim:

- Propozimet për rrjet optik me qëllim të shtimit të kapacitetit të konsumatorëve të rinj
- Zhvillimi i teknologjisë dhe pajisjeve për shërbime të telekomunikimit (TEL+DATA+VIDEO) dhe 4G dhe 5G LTE
- Mbulueshmëria e 100% i territorit të komunës me rrjet optik kabllore dhe shtrirje e rrjetit të ri GPON
- Ndërtimi i infrastrukturës për një rrjet të përbashkët për shërbime të telekomunikimit

GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE. Shtërpca e ka mbulueshmërinë mesatarisht të mirë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave. Ofrimi i këtij shërbimi do të vazhdojë të realizohet bazuar në planet operative që i ka komuna dhe kompania me synim të mbulimit gjitha vendbanimeve të cilat janë jashtë sistemit të grumbullimit të mbeturinave. Përveç kësaj, planifikohet eliminimi i deponive ilegale dhe trajtim i mbetjeve tjera dhe eliminimit të ndotjeve të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor në dhe përreth deponisë rajonale, nëpërmjet shtrirjes së shtresës mbrojtëse- gjeomembranë adekuate.

Sa i përket mbeturinave ndërtimore, parashihet të zhvillohen deponi transite për grumbullimin e mbeturinave ndërtimore për të gjitha vendbanimet si nën-qendra, projekt që planifikohet të realizohet deri në vitin 2026. Skema e grumbullimit të mbeturinave në komunë do t'i nënshtrohet ri-modelimit gjatë së cilit do të caktohen disa zona me orar përkatës të grumbullimit, dhe do të promovohet seleksionimi dhe riciklimi i mbeturinave.

DRAFT



Harta 57 Harta e Konceptit të infrastrukturës teknike (Gjendja e planifikuar).

4.9.3. Infrastruktura e transportit dhe Transporti

Transporti është mbështetësi i të gjitha zhvillimeve në vendbanimet tona. Pa infrastrukturë të transportit, asnjë aktivitet në komunë i çfarëdo lloji nuk mund të zë vend. Përveç përfitimeve ekonomike nga lëvizja më e shpejtë në hapësirë, transporti është përgjegjës edhe për problemet që shkaktohen nga ngarkesa e madhe në komunikacion, ndotja e ajrit nga transporti dhe varësia në lëndët djegëse fosile. Për këtë arsye, në tri dekadat e fundit, diskursi akademik dhe praktik ka ndërruar fokusin nga planifikimi i rrugëve për automjete, në atë të transportit të pa-motorizuar, këmbësorë dhe biçikleta, si dhe transportit publik.

Ky planifikim i qëndrueshëm i transportit, apo **transport multimodal**, i mbështetet nga korniza zhvillimore, merr për bazë të gjitha llojet e transportit, dhe vendos në rend të parë transportin e pa-motorizuar dhe publik, me qëllim të ndikimit në zvogëlimin e shkallës së ndotjes së ajrit dhe mundësive më të mëdha të zhvillimit ekonomik lokal. Qasja e njëjtë është përcaktuar edhe nga Strategjia e Sektorit të Transportit Multimodal e miratuar nga qeveria e Kosovës.

Rrjedhimisht të gjitha planet në Kosovë duhet të promovoj në këtë qasje, përfshirë edhe PZHK-në e komunës së Shtërpcës.

Rrjeti rrugor. Përmirësimi i mëtutjeshëm i rrjetit rrugor është i nevojshëm për të lidhur qytetin e Shtërpcës në tërësi dhe të fshatrave të tij. Kjo do të përmirësoj jetesën, do të mbështesë ekonominë vendore duke ofruar qasje më të mirë në tregje dhe do të promovojë turizmin dimëror**.** Bazuar në legjislacionin në fuqi rrjeti i rrugëve në tërë komunën e Shtërpcës kategorizohet si në vijim:

- Si rrugë rajonale planifikohet asfaltimi i rrugës rajonale zgjerim i saj.
- Hapje e rrugës me komunën e Suharekës;
- Rrugëve lokale, këto rrugë përveç që lidhin vendbanimet, ato ofrojnë lidhje me rrugë nacionale/rajonale. Rrugë Lokale e planifikuar janë në gjitha vendbanimet;
- Rrugë në vendbanime – mbledhëse, nënkupton rrugë brenda vendbanimeve të cilat ofrojnë lidhje me rrugë lokale;
- Rrugët urbane parashihen si rrugë të planifikuara urbane dhe në qendër të qytetit;
- Ndërtimi i unazës në zonën urbane në pjesën ka Brezovica do të devijonte trafikun e automjeteve që kalojnë nëpër qytet, dhe më këtë do të minimizohej ndotja dhe pritjet e gjata në trafik;
- Rrugët lidhëse, nënkuptojnë rrugë të cilat shërbejnë për bartjen e komunikacionit brenda vendbanimeve dhe ofrojnë lidhje me rrugë urbane. Planifikohen rrugët lidhëse me vendbanimet tjera dhe me komunat tjera fqinej;
- Në komunë të Shtërpcës ekzistojnë një numër i rrugëve bujqësore dhe pyjore, por nuk ofrojnë komunikim efikas për fermerët. Rregullimi i infrastrukturës rrugore për qasje në tokat bujqësore dhe pyjore, gjithashtu është një objektiv që duhet të realizohet, pasi që ju ndihmon fermerëve në qasje më të lehtë në arat e tyre dhe ndikon në arritjen e këtij synimi si dhe ruajtjen më efikase të pyjeve.

DRAFT



Harta 58 Harta e Infrastrukturës së Transportit (Gjendja e planifikuar)

Udhëkryqet. Shumë pjesë të trafikut kanë destinacionin e vetë përbrenda qytetit, e cila e limiton efektin e rrugës anësore edhe më shumë. Me shkallën e madhe të motorizimit në popullsi, vlera e trafikut në qytet pritet që të rritet. Këto probleme mund të zgjidhen pjesërisht me rrugët anësore dhe rrugë tjera alternative jashtë qendrës së qytetit, por në të njëjtën kohë kapaciteti i rrugëve ekzistuese dhe kryqëzimeve duhet të rritet. Me qëllim të zgjidhjes së tërësishme të këtij problemi, planifikohet hartimi i një Plani për ridizajnimin e udhëkryqeve.

Transporti publik. Transporti publik urban- periferik është pjesërisht funksional në komunë, duke ofruar lidhje të qendrës urbane me vendbanimet tjera. Organizimi i transportit publik në komunë bëhet nëpërmes minibusëve dhe taksive, kryesisht nga operatorët privat. Transporti publik do të vazhdojë të ofrojë shërbim sidomos në drejtim të nën-qendrave dhe vendbanimeve përreth, me theks të veçantë në mbulimin e zonës perëndimore të komunës me transport publik.

Komuna nuk ofron shërbime për transport publik urban. Ky shërbim planifikohet të organizohet dhe të ofrohet për qytetarë brenda zonës urbane. Rekomandimet e planit për transport janë bazuar në analiza sipërfaqësore të hulumtimeve të ndryshme. Në mënyrë që të arrihet qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm të transportit, prioritet është hartimi i **Planit të veprimit të shërbimit të mobilitetit,** ku do të paraqitet mënyra e veprimit për të arritur deri te niveli i dëshiruar i trafikut dhe mobilitetit për qytetin e Shtërpcës.

Transporti i pa-motorizuar, këmbësorë dhe biçikleta. Një qendër për transport është e nevojshme për këtë komunë e cila do të shërbej edhe për rrjetin e transportit urban, duke e ndihmuar konceptin për transport të qëndrueshëm. Rrjeti i shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta, dhe hapësirat publike do të plotësojnë në plotni konceptin e transportit të qëndrueshëm. Boshti i butë i hapësirave publike dhe transportit të pa-motorizuar do të ndërlidhet me nyjën qendrore dhe ato sekondare në qytet, ku të njëjtat funksione do të paraqiten hollësisht në kuadër të Hartës Zonale të Komunës.

Sa i përket hapësirave publike, koncepti planifikon ri-gjenerim e hapësirave publike në qendër të qytetit, ku hapësira ekzistuese në qendër të qytetit planifikohet të shendohet në rrugë me regjim lëvizjeje, gjegjësisht hapësirë për këmbësorë, ku ndalohet lëvizja e automjeteve. Element tjetër që duhet ti kushtohet rëndësi është lëvizja e personave me nevoja të veçanta. Të gjitha intervenimet në transport do të marrin parasysh kërkesat për persona me nevoja të veçanta.

Parkimi - Parkimi është problem që paraqitet në zonën urbane edhe pse komuna ka një parking publik në qendër, andaj planifikohet të ndërtohet një sistem të menaxhimit të parkingjeve në qytet. Gjithashtu, në qendër të qytetit me PZHK planifikohet të ofrohen parkingje shtesë për të ofruar hapësirë të mjaftueshme parkimi për veturat që kanë për destinim qendrën e qytetit.

4.9.4. Infrastruktura publike dhe sociale

Zhvillimi i sistemit të infrastrukturës publike i referohet përmirësimit të cilësisë jetës së qytetarëve përmes ngritjes së nivelit të shërbimeve dhe qasjes më të lehtë në objekte. Shpërndarja hapësinore e shërbimeve publike bazohet në rrjetin aktual të ndërtesave dhe hapësirave dhe identifikimin e nevojave të popullatës në të ardhmen. Në këtë aspekt, parimet themelore të zhvillimit të ardhshëm të këtij sektori janë:

- përmirësimi i shërbimeve në të gjitha vendbanimet përmes rehabilitimit të objekteve ekzistuese apo ndërtimit të objekteve të reja.
- shtrirja e balancuar e shërbimeve në tërë territorin e komunës.
- nxitja e përfshirjes së iniciativave private në këtë sektor, në veçanti në fushën e përkujdesjes së fëmijëve dhe të moshuarve.

Bazuar në zhvillimin hapësinor dhe demografik për secilin vendbanim dhe strukturës së moshës së popullatës, dhe në përputhje me këtë dhe funksionet e tyre themelore, do të sigurohen shërbimet e nevojshme publike.

DRAFT



Harta 59 Infrastruktura publike dhe sociale

4.9.4.1. Koncepti i zhvillimit hapësinor për institucionet shëndetësore

4.9.4.1.1. Institucionet publike të Kujdesit Shëndetësor Parësor

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna nuk ka nevojë për institucione shtesë të Kujdesit Parësor Shëndetësor në zonë rurale. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e Kujdesit Shëndetësor Parësor sipas konceptit vijues të zhvillimit hapësinor:

- 1 Qendër të Mjekësisë Familjare me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.20m2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 800m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 10,000 banorë;
- 1 Ambulancë të Mjekësisë Familjare me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.20m2 për kokë banori, që mbulon një territor rural me rreze të mbulushmërisë 3,000m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 6,000 banorë.

4.9.4.1.2. Institucionet publike të Kujdesit Shëndetësor Dytësor

Për të realizuar konceptin zhvillimor hapësinor për institucionet publike të Kujdesit Shëndetësor Parësor, Komuna planifikon funksionalizimin e Spitalit të Përgjithshëm.

4.9.4.1.3. Institucionet publike të shërbimeve publike administrative

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për institucionet e shërbimeve publike administrative shtesë. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e shërbimet Kujdesit Parësor Shëndetësor, si vijon:

- 1 Zyre të Gjendjes Civile me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.62m2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 1,000m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 10,000 banorë.
- 1 Zyre të Gjendjes Civile me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.62m2 për kokë banori, që mbulon një territor rural me rreze të mbulushmërisë 3,000m distancë shërbyese, respektivisht reze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 10,000 banorë.

4.9.4.2. Koncepti i zhvillimit hapësinor për institucionet publike sociale dhe të komunitetit

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për institucione institucionet publike sociale dhe të komunitetit shtesë. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e institucioneve publike sociale dhe të komunitetit, si vijon:

- 1 Qendër të Komunitetit me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.20m^2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 600m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 6,000 banorë;
- 1 Qendër për Shërbime Sociale dhe Familjare me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.25m^2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 2,000m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 45,000 banorë.

4.9.4.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor për institucionet kulturore

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për institucionet kulturore shtesë. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e institucioneve kulturore, që nënkupton *ndërtesat e bibliotekave, ndërtesat e muzeve, ndërtesat e galerive të arteve dhe sallave ekspozuese, ndërtesat e 'shtëpive' të kulturës, ndërtesat e teatrove* dhe *ndërtesat e kinemave*, si vijon:

- 1 bibliotekë publike me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.25m^2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 1,500m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 45,000 banorë;
- 1 shtëpi kulture me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.20m^2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 1,500m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 45,000 banorë;
- 1 teatër publik me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 0.20m^2 për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 4,000m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 90,000 banorë;

DRAFT

4.9.4.4. Koncepti i zhvillimit hapësinor për hapësirat rekreative dhe sportive

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për institucione institucionet publike sociale dhe të komunitetit shtesë. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e hapësirave rekreative dhe sportive, që nënkupton *ndërtesat e stadiumeve, ndërtesat e sallave sportive, ndërtesat sportive shume- funksionale, fushat sportive- rekreative shume- funksionale, shtigjet për gara motorike, shtigjet për kalërim, shtigjet për ngjitje dhe marshim alpin, shtigjet për çiklizëm, shtigjet për skijim apo shkëmbinjtë natyror dhe artificial për ngjitje*, *Fushat e golfit*, si vijon:

- 1 hapësirë rekreative dhe sportive me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 2.50m² për kokë banori, që mbulon një territor rural me rreze të mbulueshmërisë 800m distancë shërbyese, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë më pak se 5,000 banorë.

4.9.4.5. Koncepti i zhvillimit hapësinor për hapësirat e hapura publike

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për hapësirat e hapura publike. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e hapësirave të hapura publike, që nënkupton *parqet publike ose hapësirat e lira për shfrytëzim nga këmbësorët ose çiklistët* apo *Fushat e hapura sportive dhe rekreative* si vijon:

- 1 hapësirë të hapur publike me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 1.00m² për kokë banori, që mbulon një territor urban me rreze të mbulushmërisë 800m distancë shërbyese në kuadër të lagjes urbane, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 8,000 banorë;
- 1 hapësirë të hapur publike me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 1.00m² për kokë banori, që mbulon një territor të banuar rural me rreze të mbulushmërisë 800m distancë shërbyese në kuadër të vendbanimit, respektivisht rreze optimale shërbyese në vijë ajrore në të cilin jetojnë së paku 2,000 banorë.

4.9.4.6. Koncepti i zhvillimit hapësinor për varrezat publike

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese, Komuna ka nevojë për institucione institucionet publike sociale dhe të komunitetit shtesë. Në të ardhmen, Komuna synon zhvillimin hapësinor e varrezave publike me sipërfaqe minimale të parcelës kadastrale prej 1.50m² për kokë banori.

4.9.5. Mbrojtja e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit në komunën e Shtërpcës është mision i veçantë marrë parasysh vlerat e saja natyrore siç janë ato pyjore PN "Mali Sharr" dhe zonat e mbrojtura brenda Parkut Nacional, vlerat ujore dhe tokën bujqësore përgjatë luginës së lumit Lepenc. E gjithë kjo krijon një natyrë që është potencial për zhvillim të turizmit. Për të luajtur rolin që i përshkruhet duhet të mbrohet ajri, uji dhe toka. Territori i komunës së Shtërpcës, vazhdimisht është ballafaquar me fatkeqësi natyrore dhe aksidente të ndryshme, ku në masë të madhe shkaktohen dëme materiale si në pjesën urbane ashtu edhe në atë rurale.

Vlerësimi i gjendjes së mjedisit ka trajtuar mundësitë dhe kapitalin natyror, rreziqet e ndërsjella ekosistem-zhvillim, evidentimin e zonave të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore dhe rreziqet eventuale. Në këtë fazë të konceptit zhvillimor plani ndërthur praktika të trajtimit apo menaxhimit të këtyre rreziqeve eventuale.

Cilësia e ajrit

Cilësia e ajrit në Komunën e Shtërpcës ndikohet nga një sërë faktorësh që përfshijnë aktivitetet ndërtimore të pakontrolluara, rrugët e pashtruara, rritjen e shpejtë të numrit të automjeteve, përdorimin e karburanteve të cilësisë së keqe, gjeneratorët me naftë dhe ngrohjet individuale. Këto faktorë kontribuojnë në uljen e cilësisë së ajrit, megjithëse komuna është mjaft e mbuluar me vegjetacion. Ndikimi negativ i cilësisë së ajrit në shëndetin e banorëve është evident, edhe pse nuk ka të dhëna të detajuara për lidhjen specifike me sëmundje të caktuara. Një nga masat kryesore për përmirësimin e cilësisë së ajrit është pyllëzimi dhe krijimi i zonave të gjelbra. Propozimet për pyllëzim përfshijnë mbjelljen e pemëve dhe bimëve të tjera në zona të caktuara të komunës për të rritur kapacitetin e absorbimit të ndotësve nga ajri. Gjithashtu, vendosja e shirita gjelbërues përgjatë rrugëve kryesore dhe zonave urbane do të ndihmojë në uljen e niveleve të ndotjes. Këto masa kërkojnë vendosjen e kritereve strikte për cilësinë e zonave të gjelbra, përfshirë cilësinë e mbulesës së tokës dhe bimore.

Për të ngadalësuar rritjen e numrit të makinave private dhe për të reduktuar ndotjen e ajrit, është e nevojshme promovimi i transportit publik dhe çiklizmit. Propozimet për transportin publik përfshijnë shtimin e linjave të autobusëve dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese. Futja e korsive të biçikletave dhe përmirësimi i rrugëve do të lehtësojë trafikun dhe do të inkurajojë përdorimin e mjeteve alternative të transportit. Përdorimi i karburanteve më të

pastra, përfshirë reduktimin e përmbajtjes së squfurit në karburante, është gjithashtu një masë e rëndësishme për të ulur emetimet e dëmshme.

Shtrimi i rrugëve dhe përmirësimi i trafikut janë masa kyçe për të reduktuar ndotjen e ajrit të shkaktuar nga pluhuri dhe gazrat e automjeteve. Komuna e Shtërpcës, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, duhet të investojë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, duke përfshirë futjen e korsive të dedikuara për biciklet a dhe këmbësorë. Përmirësimi i teknikave të ndërtimit për të pakësuar pluhurin gjatë aktiviteteve ndërtimore është gjithashtu një hap i rëndësishëm për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

Përmirësimi i furnizimit me energji dhe zbutja e kërkesës për energji nëpërmjet burimeve alternative dhe përdorimit të gjeneratorëve me efiçencë të lartë janë masa të rëndësishme për të reduktuar ndotjen e ajrit. Vendosja e kritereve për ngrohjet individuale, duke promovuar përdorimin e burimeve të energjisë më të pastra dhe më eficiente, do të ndihmojë në uljen e emetimeve nga ngrohjet individuale.

Një studim i detajuar për të përcaktuar ndikimin dhe koston e cilësisë së ulët të ajrit në shëndet dhe ekonomi është i nevojshëm për të krijuar një bazë të dhënash të besueshme dhe për të orientuar politikat e ardhshme. Edukimi i publikut mbi shëndetin dhe cilësinë e ajrit është gjithashtu një masë e rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar praktikat e mira. Organizimi i fushatave të edukimit dhe informimit për banorët e komunës do të ndihmojë në krijimin e një kulture të re për mbrojtjen e mjedisit.

Rehabilitimi i zonave të gjelbra ekzistuese për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe për të krijuar mjedise më të shëndetshme për komunitetin është një hap i rëndësishëm. Kjo përfshin mbjelljen e pemëve të reja, mirëmbajtjen e parqeve dhe zonave të tjera të gjelbra, si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbra në zonat urbane.

Cilësia e ujërave sipërfaqësor

Cilësia e ujërave të lumenjve në Komunën e Shtërpcës ndikohet negativisht nga shkarkimet e ujërave të zeza, mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura dhe infrastruktura e vjetruar e kanalizimeve. Këto faktorë çojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, duke ndikuar negativisht në ekosistemet ujore dhe shëndetin e komunitetit.

Krijimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Shtërpcës është një masë e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së ujit të lumenjve. Këto projekte duhet të përfshijnë ndërtimin e impianteve të trajtimit dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve për të siguruar trajtimin efektiv të ujërave të ndotura përpara shkarkimit në lumenj.

Ndërmarrja e masave për zëvendësimin e tubacioneve të vjetra dhe të vogla do të ndihmojë në minimizimin e rrjedhjeve dhe humbjeve të ujit. Ky proces përfshin edhe rregullimin e lidhjeve të paligjshme dhe maksimizimin e lidhjeve të ligjshme për të siguruar një sistem më efikas dhe të qëndrueshëm të furnizimit me ujë.

Reduktimi i përdorimit të gropave septike dhe lidhja e tyre me sistemin e kanalizimeve për ujërat e ndotura është një masë kritike për përmirësimin e cilësisë së ujit. Kjo përfshin lidhjen me kolektorin kryesor të fshatrave dhe ndërtimin e impiantit të planifikuar për trajtimin e ujërave të ndotura.

Cilësia e ujit të pijshëm

Problemet me cilësinë dhe sasinë e ujit të pijshëm në Komunën e Shtërpcës vijnë nga humbjet e larta në rrjetin e furnizimit me ujë, inter-seksionet me linjat e ujërave të zeza dhe lidhjet e paligjshme. Këto faktorë rrezikojnë sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm dhe cilësinë e ujit që arrin te konsumatorët.

Përgatitja e projekteve sektoriale për furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujërave të pijshëm duhet të jetë një prioritet. Këto projekte duhet të trajtojnë mundësinë e financimit dhe implementimit të masave për të siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe cilësor me ujë të pijshëm.

Masa të ndryshme për zvogëlimin e humbjeve në rrjetin e furnizimit me ujë duhet të ndërmerren për të rritur efiçencën e sistemit, si riparimin dhe zëvendësimin e tubacioneve të dëmtuara, instalimin e sistemeve moderne të monitorimit dhe menaxhimit të rrjedhjeve.

Shmangia e inter-seksioneve të linjave të ujërave të pijshëm me ato të ujërave të zeza është një masë kyçe për të parandaluar ndotjen e ujit të pijshëm. Kjo përfshin ndarjen dhe mirëmbajtjen e linjave të ndryshme për të siguruar që uji i pijshëm të mos kontaminohet.

Rregullimi dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë është një hap i rëndësishëm për të siguruar cilësinë dhe sasinë e ujit të pijshëm. Kjo përfshin identifikimin dhe legalizimin e lidhjeve ekzistuese dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e lidhjeve të ligjshme.

DRAFT

Mbrojtja e burimeve ujore mbi sipërfaqe është thelbësore për të siguruar cilësinë e ujit të pijshëm. Kjo përfshin eliminimin e shfrytëzuesve individual të burimeve ujore dhe krijimin e zonave të mbrojtura rreth burimeve kryesore të ujit për të parandaluar ndotjen dhe mbrojtjen e sasisë së ujit.

Sipërfaqet me ndotje të lartë

Sipërfaqet me ndotje të lartë në përfaqësojnë pika të nxehta, ku ndotja ka arritur nivele alarmante, duke ndikuar negativisht në tokë, ujë, ajër dhe biodiversitet. Këto zona përbëjnë një kërcënim serioz për shëndetin e njerëzve dhe ekosistemet lokale, dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente për të identifikuar, menaxhuar dhe rehabilituar ndotjen.

Për të adresuar problemin e ndotjes në të tilla sipërfaqe, është e domosdoshme mbledhja e informacioneve të thelluara për gjendjen aktuale të ndotjes, vlerësimin e nivelit dhe llojit të ndotjes, ndikimet e saj në tokë, ujë dhe ajër, si dhe ekzistencën e lidhjeve të territoreve të ndotura me kërcënimet për shëndetin. Kryerja e analizave në terren dhe laborator do të sigurojë të dhëna të sakta dhe të besueshme për të orientuar ndërhyrjet e ardhshme.

Bazuar në studimet dhe analizat e kryera, duhet të përgatitet një plan i detajuar për menaxhimin dhe rehabilitimin e këtyre pikave të nxehta. Ky plan duhet të përfshijë masat adekuate për pastrimin dhe rehabilitimin e tokës, mbrojtjen e ujërave dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Vlerësimi i ndikimit në mjedis do të jetë një komponent thelbësor i këtij plani, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të bazuara në prova shkencore dhe të adresojnë në mënyrë efektive ndotjen.

Për të mbrojtur shëndetin e njerëzve nga ndikimet negative të ndotjes, është e nevojshme të merren masa specifike shëndetësore. Këto masa mund të përfshijnë informimin dhe edukimin e publikut për rreziqet e ndotjes, krijimin e programeve të monitorimit të shëndetit për banorët e zonave të ndotura, dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe mbështetëse për ata që janë prekur nga ndotja.

Për konsolidimin e tokës dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave, duhet ndërmarrë hapa për të parandaluar dhe rehabilituar ndotjen e këtyre burimeve. Kjo përfshin përdorimin e teknikave të avancuara të rehabilitimit të tokës, si bioremedimi dhe fitoremedimi, për të hequr ndotësit nga toka dhe uji. Mbjellja e bimëve që kanë aftësi të larta për të thithur ndotësit mund të jetë një metodë efektive për të përmirësuar cilësinë e tokës dhe ujit.

Masa specifike si krijimi i zonave të mbrojtura, mbjellja e bimëve vendase dhe ruajtja e specieve të rrezikuara, janë esenciale për t'u zbatuar me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve në zonat e ndotura. Ndërhyrjet synojnë rigjenerimin e ekosistemeve të dëmtuara dhe sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për florën dhe faunën lokale.

Mbrojtja e pyjeve

Pyjet në Komunën e Shtërpcës janë nën presion nga aktivitetet njerëzore si prerjet e paligjshme, zjarret e pyjeve dhe zhvillimi i infrastrukturës pa masa mbrojtëse të mjaftueshme. Këto faktorë rrezikojnë biodiversitetin, stabilitetin e tokës dhe kontribuojnë në ndryshimet klimatike.

Krijimi dhe zbatimi i projekteve konkrete për pyllëzimin, revitalizimin dhe sanimin e pyjeve në zonat e parapara me Planin Zhvillimor Komunal është një hap kyç për mbrojtjen e pyjeve. Këto projekte duhet të fokusohen në mbjelljen e pemëve të reja, restaurimin e zonave të dëmtuara dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve ekzistuese.

Për të siguruar suksesin e projekteve që adresojnë mbrojtjen e pyjeve, është e nevojshme ngritja e një mekanizmi bashkëpunues në nivel të komunës dhe ministrive përkatëse. Ky mekanizëm duhet të përfshijë partneritetet me organizatat joqeveritare, komunitetet lokale dhe ekspertët e mjedisit për të koordinuar dhe monitoruar zbatimin e projekteve.

Të gjitha projektet e reja të infrastrukturës duhet të kushtëzohen me masa për gjelbërim dhe krijimin e zonave tampon. Kjo përfshin mbjelljen e pemëve dhe bimëve të tjera përgjatë rrugëve, ndërtesave dhe zonave industriale për të siguruar një ambient të gjelbër dhe të qëndrueshëm.

Për të mbrojtur pyjet nga aktivitetet e paligjshme, është thelbësore aktivizimi i gjykatave, policisë dhe inspektorëve në mënyrë cilësore. Kjo përfshin zbatimin e rreptë të ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen e pyjeve, ndëshkimin e atyre që kryejnë veprime të paligjshme dhe rritjen e kontrollit mbi aktivitetet që mund të dëmtojnë pyjet.

Zonat që kanë qenë përdorur më parë si venddepozitime legale dhe ilegale duhet të rehabilitohen dhe të ri-gjelbërohen. Kjo përfshin pastrimin e mbeturinave, restaurimin e tokës dhe mbjelljen e bimëve të përshtatshme për të rikthyer këto zona në një gjendje natyrore dhe të shëndetshme.

Mbrojtja e florës dhe faunës

Komuna duhet të bashkëpunojë me institucione ndërkombëtare, veçanërisht me Bashkimin Evropian, për të zhvilluar projekte që fuqizojnë monitorimin e mjedisit. Këto projekte duhet të përfshijnë teknologji të avancuara dhe metodologji të mira për të mbledhur të dhëna të sakta mbi gjendjen e biodiversitetit.

Është e nevojshme të zhvillohen studime të detajuara mbi situatën aktuale të biodiversitetit në Shtërpcë. Këto studime duhet të identifikojnë specifikisht llojet në rrezik, zonat kritike për ruajtjen e biodiversitetit, dhe faktorët kryesorë që kontribuojnë në humbjen e florës dhe faunës.

Për të adresuar humbjet në biodiversitet dhe për të përmirësuar situatën, është thelbësore të krijohet një studim bazë që identifikon gjendjen aktuale të biodiversitetit. Ky studim duhet të shërbejë si pikë referimi për të matur përparimet dhe për të planifikuar ndërhyrjet e ardhshme.

Ruajtja dhe restaurimi i habitateve natyrore është një masë thelbësore për të mbrojtur biodiversitetin. Kjo përfshin krijimin e zonave të mbrojtura, rehabilitimin e zonave të degraduara dhe kontrollin e aktiviteteve njerëzore që dëmtojnë mjedisin natyror.

Për të siguruar mbrojtjen e florës dhe faunës, është e nevojshme përmirësimi i legjislacionit dhe zbatimit të tij në mënyrë të rreptë. Kjo përfshin forcimin e rregullave për ndërtimet në zonat natyrore, ndalimin e gjuetisë dhe shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore.

Kritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi publik mbi rëndësinë e ruajtjes së biodiversitetit është thelbësor. Fushatat informuese dhe edukative duhet të synojnë të ndryshojnë sjelljen e publikut dhe të promovojnë praktika të qëndrueshme që mbrojnë mjedisin.

4.9.6. Parandalimi dhe mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore

Komuna duhet të sigurojë që të gjitha ndërtesat e reja të ndërtohen sipas standardeve të larta anti-sizmike për të përballuar tërmetet. Kjo përfshin përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe teknologjive të avancuara të ndërtimit për të siguruar qëndrueshmërinë strukturore.

Para ndërtimit të pikave të karburantit apo strukturave të tjera kritike, duhet të kryhet një studim i terreneve për qëndrueshmërinë sizmike. Ky studim duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe raportin e vlerësimit të sigurimit teknik të karburantit, duke siguruar që standardet të jenë shumë të larta për të minimizuar rreziqet.

Është e domosdoshme përcaktimi i rreziqeve për shëndetin nga radoni përmes studimeve dhe monitorimit të rregullt të nivelit të radonit në zonat e banuara dhe në ndërtesa publike. Identifikimi i zonave me rrezatim të lartë nga radoni është një hap i rëndësishëm për të ndërmarrë masa mbrojtëse, ku përfshihet krijimi i hartave të rrezikut dhe informimi i publikut për zonat më të rrezikuara. Krijimi dhe zbatimi i kodeve të ndërtimit që sigurojnë mbrojtje nga radioaktiviteti i tokës përmes përdorimit të materialeve të padepërtueshme dhe ventilimit të mjaftueshëm në ndërtesa. Kjo do të ndihmojë në reduktimin e përqendrimeve të radonit në hapësirat e banuara.

Ndërtesat që përmbajnë azbest duhet të bonifikohen për të hequr dhe trajtuar sigurisht materialin e rrezikshëm. Kjo përfshin inspektimin e rregullt dhe rehabilitimin e ndërtesave të vjetra.

Përcaktimi i rreziqeve për shëndetin nga azbesti përmes studimeve dhe monitorimit të përhershëm të ekspozimit ndaj azbestit në ndërtesa dhe mjedise të tjera publike.

Zbatimi i kodeve të ndërtimit që sigurojnë mbrojtje nga emetimi i fibrave të azbestit. Këto kode duhet të përfshijnë përdorimin e materialeve të sigurta dhe teknika ndërtimi që parandalojnë thithjen e fibrave të azbestit.

DRAFT



Harta 60 Mbrojtja e mjedisit dhe rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Gjendja e planifikuar)

4.9.7. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Në Kosovë, trashëgimia kulturore është një prej elementeve më të rëndësishme dhe përmbajtjesore të mjedisit. Ajo paraqet të vërtetën e identitetit të shoqërisë dhe vendit. Konsiderohet si një potencial për zhvillim dhe integrim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror në vend, regjion dhe më gjerë. Si dhe çdo shoqëri, edhe Kosova ka nevoja për balancim në mes të shoqërisë së re dhe të vjetrës. Humbja e së vjetrës është vlerë e pakthyer në dëm të identitetit të vendit dhe njerëzimit. Në të përfshihet krijimtaria që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme. Këto thesare të trashëguara me karakteristika artistike, estetike, vlera historike dhe tradicionale të pronave ilustrohen me diverzitet të pasur të trashëgimisë si ajo : **arkitektonike, arkeologjike, lëvizëse, arkivore dhe shpirtërore**.

Në subjektet lokale për planifikim dhe menaxhim të mjedisit natyror, kulturor dhe historik duhet të bëhet:

- Promovimi i menaxhimit pozitiv të natyrës, mjedisit të ndërtuar dhe historik, për të mbrojtur nga ngjarjet që shkaktojnë dëme;

- Miratimi i një qasje të integruar që mbron zonat e caktuara duke përmbushur nevojat sociale dhe ekonomike të komuniteteve lokale;
- Mbron të gjitha aspektet e peizazhit, duke përfshirë pamjet dhe vendet e veçanta;
- Mbrojnë dhe avancojnë, ku është e mundshme, karakteristikat dhe llojllojshmërinë e peizazheve dhe duke ripërsëritur vlerësimet për destinimet e peizazheve lokale;
- Integrojnë qasjen e bazuar në lokacionin për planifikim zhvillimor me kujdes më të madh për bio-diverzitetin dhe çështjet tjera hapësinore;
- Kërkohet që të kthehen skenat dhe përparësitë e dëmtuara dhe të humbura nëse është e mundshme;

Planet zhvillimore duhet t'i japin përparësi mbrojtjes dhe zhvillimit të lokacioneve të trashëgimive kulturore të nivelit nacional dhe ndërkombëtar. Zhvillimi, i cili mund të ndikoj në ato lokacione mund të mundësohet vetëm nëse nuk ka alternative tjera të zgjidhjes. Disa skena të cilat mund të kontribuojnë në bukuri, llojllojshmëri dhe karakteristika të regjionit duhet të trajtohen sipas interesit nacional si dhe avancimi dhe mbrojtja e peizazhit/skenës të karakterit lokal duhet të konsiderohen si të rëndësishme.



Harta 61 Koncepti i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Kjo trashëgimi me këtë koncept mbrohet dhe zhvillimet përreth tyre duhet të kufizohen bazuar në U.A. për Normat teknike të planifikimit MMPH Nr.08/2017 (shtojcë kapitulli 6) sipas të cilave zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshin

perimetrin e vend-shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojte dhe zonës mbrojtëse të tij në radius prej 50 m (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 m për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri.

4.9.8. Vendbanimet

Trajtimi i vendbanimeve të banuara në planet zhvillimore komunale është i nevojshëm dhe kyç, sepse e tërë veprimtaria dhe organizimi i jetës së shoqërisë së njerëzve kanë qenë dhe do të jenë të ndërlidhura me ta. Tipologjia e vendeve të banuara sipas madhësisë është një nga metodat më të rëndësishme për shfaqjen e karakteristikave të sistemit të popullsisë në hapësirat e caktuara, siç është mënyra e kualitetit te jetës në vendet e banuara në këtë hapësirë, sepse, vendbanimi më i banuar nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte, ndërsa vendbanimi me më së paku banorë nënkupton të kundërtën e të mëparshmes. Pikërisht për shkak të kësaj arsye, vendbanimet e banuara karakterizohen për nga madhësia e banorëve dhe në bazë të shumë analizave këto problematika përcaktojnë pikat strategjike për zhvillim të mëtutjeshëm të komunës por edhe më gjerë.

Megjithatë, me rritjen e numrit të banorëve në Shtërpcës dhe Brezovicës (nga 1.812 në 3373) që tregon se kanë filluar të ndihen ndryshimet pozitive në zonën e II të brezit të lartë për shkak të numrit më të madh të shfrytëzimit të hapësirës për qëllime turistike. Ndryshimet e përmendura dhe tendencat e ndryshimeve tregojnë, pra, në intensitetin e procesit të shtimit të numrit të banorëve përgjatë rrugës kryesore Ferizaj – Prizren. Kjo është pasoj e ndryshimeve të caktuara në zhvillimin e veprimtarive sekondare dhe terciare në pjesët qendrore të komunës, në një anë, dhe mosekzistimi i kushteve të përshtatshme natyrore dhe për zhvillim intensiv të prodhimtarisë bujqësore në pjesët e sipërme buzë luginës së Sirinikut.

Qyteti **është qendra komunale**: Subjektet lokale komunale për planifikim duhet të marrin në konsideratë qëllimet e ekzistencës së PHK-së për qytete si një nyje të zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL) si një koncept i cili siguron zhvillim ekonomik të Kosovës.

Qytetet duhet të jenë realizuese të qëllimeve të përcaktuara përmes:

Qendrave urbane, për aktivitete shërbyese, shërbyese- tregtare, kulturore, argëtuese dhe rekreative që duhet të jenë zona të gjalla përmes shprehjes së zonës së identitetit urban ku së bashku me parimin e zhvillimeve të kombinuara do të jenë të një përmbajtjeje të kombinuar dhe banimit, si dhe objekteve tjera mbështetëse të jetesës; operacioneve shkencore në qytetet me aktivitete kulturore, argëtuese dhe rekreative.

Zonat ekonomike urbane, zona me përqendrim të veprimtarive ekonomike afariste në afërsi të qyteteve si **grupime** të aktiviteteve industriale, shërbyese, veprimtarive shërbyese – tregtare ,të institucioneve hulumtuese zhvillimore, grupimet e të cilave promovojnë konkurrencën dhe bashkëpunimin në të njëjtën kohë (TZHEL dhe grupimet e tjera nëpër komuna);

- Zona me potencial turistik;
- Afarizmi/ekonomitë rurale
- Zona me veprimtari të industrisë së rëndë metalurgjike për përpunim;
- Ekonomia e transportit
- Ekonomia e turizmit.

Në bazë të gjendjes së tanishme të ekonomisë turistike në Kosovë mund të nxirren përfundime që duhet që në kohën sa më të shkurtë të ofrojnë zgjidhje për çështjet në vijim:

- Mungesa e përcaktimit, vizionit, qëllimeve, strategjisë menaxhuese dhe detyrave në turizëm,
- Mungesa e avancimit të ofertës ekzistuese turistike,
- Mungesa e propagandës turistike,
- Mungesa e vendosjes së qartë në tregun turistik si destinacione të reja turistike me një imazh të ri në përputhje me zhvillimin aktual dhe të ardhshëm të tregut turistik,
- Mungesa e realizimit të investimeve të rëndësishme në sektorin privat dhe publik të turizmit,
- Mungesa e formulimit të sistemit të ri të menaxhimit të turizmit si një garanci për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit,
- Problemet me energji elektrike, ujë, kanalizim të ujërave të zeza dhe mbeturina, degradimi i natyrës dhe qendrave urbane për shkak të ndërtimit të egër,

Interesim i vogël i investitorëve për shkak të vonesave në lidhje me pronën e tokës.



Harta 62 Koncepti i zhvillimit të vendbanimeve

Vendbanimet/ Fshatrat tjerë duhet të ofrojnë kushte të mira të jetesës, të furnizuara nga qendra dhe qendrat sekondare

- Zhvillimi i planeve rregulluese për fshatin e Shtërpcës, pastaj të vendbanimeve të banuara si zona me interes të veçantë për komunën dhe qendra sekondare në kuadër të komunës si Vërbeshticë, Bitij e Poshtme dhe Brod brenda të cilëve mund të rritet çdo vendbanim gravitues si një e tërësi në këto qendra sekondare në mënyrë që të bëhet një zhvillim i qëndrueshëm i këtyre vendbanimeve të dendura.
- Zhvillimi i planeve rregulluese për zonën industriale, sipas këtij plani.
- Trajtimi prioritar i fshatit në afërsi të Shtërpcës dhe atyre të vendosur në fushat e zhvillimit të turizmit turistik në kuadër të vikend zonës, Brezovicës dhe Jazhincës.

- Nxitja e ndërtimit brenda zonës së planifikuar.
- Monitorimi dhe ndalimin e ndërtimeve jashtë kufijve të ndërtimit dhe zonave të ngrira.
- Krijimi i Bordit për prishjen e ndërtesave të ndërtuara jashtë kufijve të caktuar.

4.9.8.1. Vendbanimet joformale

Janë shqyrtuar dhe vlerësuar gjendja ekzistuese, shtrirja hapësinore, karakteristikat, numri i banorëve, gjendja ekonomike, sociale dhe mjedisore e vendbanimeve joformale të identifikuara.

Koncepti ka trajtuar mundësitë e trajtimit të vendbanimeve joformale të identifikuara brenda territorit të Komunës së Shtërpcës, ndërsa dimensioni i infrastrukturës do trajtohet më gjerësisht me PHZK, dhe dimensioni i pronësisë duhet të trajtohet nga një Ekip i Komunës, i cili duhet themelohet nga kuvendi i Komunës, me propozim të kryetarit, dhe do koordinoj të gjitha aktivitetet në mes banorëve të VJF-së, pronarëve të tokës dhe ekipës punuese, bazuar në ligjet në fuqi deri në trajtimin përfundimtar dhe njohjen e pronësisë për banorët e VJF-së.

4.9.8.2. Ndërtimet pa Leje

Ndërtimet pa leje të identifikuar me Regjistrin Kombëtar të Ndërtimeve pa Leje, janë vlerësuar të gjitha në mënyrë që përfshirja e ndërtimeve të legalizuara në dokumentet e planifikimit hapësinor të jetë në harmoni me Ligjin për Ndërtime pa Leje[48]. Nga hyrja në fuqi e Ligjit dhe udhëzimeve administrative për Trajtim të Ndërtimeve pa Leje, Komuna e Shtërpcës vepron konform kësaj baze ligjore drejt legalizimit të ndërtimeve pa leje.

4.9.9. Banimi

Duke e kuptuar rëndësinë e banimit, kësaj fushe i është kushtuar një rëndësi e veçantë brenda PZHK-së dhe konceptit kryesor, si dhe është shqyrtuar dhe vlerësuar gjendja ekzistuese e banimit dhe modeleve të banimit në komunë dhe nevojat në të ardhmen.

PZhK duhet të plotësoj të gjitha nevojat për banim, andaj numri i njësive të banimit të nevojshme për të ardhmen është planifikuar sipas rritjes së parashikuar demografike, strukturës së popullsisë por dhe kërkesave të tregut. Gjithashtu, pas analizës së kushteve të banimit, përfshirë rekomandimet për zhvillimin e banimit planifikohet përmirësimi i kushteve të banimit duke ofruar qasje në infrastrukturë adekuate, hapësira adekuate si dhe standard dhe efiçiencë energjetike.

Duke ofruar njësi të reja banimi sipas kërkesës komuna siguron që është duke e kontrolluar dhe udhëzuar zhvillimin në hapësirë dhe kohë. Kjo nënkupton që komuna do të vendosë në faza për rritje të mëtutjeshme të fondit të banimit duke u bazuar në rritje natyrore, kërkesat, dhe zonat për rritje dhe plotësim.

Cilësia e jetës në komunë gjithashtu ndikohet edhe nga vlerat rekreative të trashëgimisë së tij natyrore. Zhvillimin e objekteve dhe pajisjeve për një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i merr parasysh nevojat e banorëve. Ngritjen e kushteve për banim të shëndetshëm dhe atraktiv në zonat urbane dhe zonat rurale. Promovohet ndërtim i objekteve sipas standardeve në hapësirat jo të ndërtuara dhe masat mbrojtëse për reduktimin e pasojave nga tërmetet, vërshimet, erozionet etj. dhe vënia në zbatim e rregullave të ndërtimit për banim në dobi të rritjes së dendësisë për sipërfaqe në zonat e banimit.

Çdo ndërtim i ri do të respektojë masat për Efiçencë të Energjisë sipas kërkesave nga është rregullorja për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave (MMPH Nr. 04/18). Të gjitha këto veprime do të mundësojnë që komuna të përmirësojë kualitetin e banimit në komunë, dhe në të njëjtën kohë të akomodojë kërkesat për njësi të reja të banimit. Subjektet lokale për planifikim duhet të:

- Planifikojnë kërkesat për banim për të gjithë, filluar prej shtresës më të ulët, të atyre me nevoja për strehim apo banim të përshtatshëm dhe për ata me nevoja të veçanta;
- Ofrojnë mundësi të shumta dhe zgjidhje për banim, me komunikim të mirë sipas madhësisë, llojit të vendit të banimit dhe kërkesës për krijimin e komuniteteve të përziera;

[48] Paragrafi 3, Neni 4 I Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje

- Krijojnë hapësira banesore të mjaftueshme me prioritet për ri-shfrytëzim të tokës brenda zonave urbane duke shfrytëzuar shtëpitë e zbrazëta dhe duke i adaptuar banesat ekzistuese;
- Të krijojnë dhe sigurojnë transportin publik për punë, arsimim dhe institucione shëndetësore si dhe tregti, argëtim dhe shërbime lokale;
- Shfrytëzojnë tokën në mënyrë efikase përmes politikave dhe standardeve të planifikimit;
- Vlerësojnë nevojat e njerëzve për transport publik, të cilët janë si kërkesa për krijimin brenda vendeve të banuara të zonës urbane dhe lidhjeve me qendra tjera;
- Reduktojnë varësinë nga automjetet, duke mundësuar qarkullim të këmbësorëve dhe çiklistëve, me vendosjen e lidhjeve të transportit publik me vendin e banimit, punës, shërbimeve lokale dhe mundësive lokale, si dhe me një planifikim të destinacioneve të kombinuara;
- Duke inkurajuar projektimin në zhvillimet e reja të banimit me qëllim të krijimit të mjediseve atraktive dhe me kualitet të lartë të cilat njerëzit do t'i zgjedhin për të jetuar.

Banimi social

Edhe pse shumë bazike dhe e qartë si parim, zgjidhja e vetme për mungesë të banimit është banimi I përballueshëm. Mirëpo, përpilimi I politikave të mirëfillta për banim e sidomos atij me çmim të përballueshëm dhe banimit për familje me asistencë sociale është një nga problemet kryesore të planifikimit në Kosovë, po edhe më gjerë.

Komuna duket të ofroj banim për të gjitha kategoritë. Në fushën e mirëqenies sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit për rastet sociale, duhet planifikuar sigurimi i hapësirës së nevojshme dhe ndërtimi i objekteve për strehim të këtyre familjeve. Kjo mund të arrihet duke siguruar që çdo 5 – 10% nga numri i përgjithshëm i njësive të reja të banimit për vit të jenë me çmim të përballueshëm. Ky veprim mund të mundësojë që familjet e reja të kenë qasje në njësi banimi me çmim të përballueshëm, duke adresuar kërkesat për banim në mënyrë të kontrolluar. Këtij veprimi duhet t'i paraprijë hartimi i një strategjie lokale për banim të përballueshëm dhe për banim social si dhe rregullore komunale. Rregullorja komunale duhet të përcaktojë kriteret që duhet të përmbushen nga çdo investitor për të arritë kuotën e caktuar vjetore për njësi banimi me çmim të përballueshëm dhe atë social.

4.9.10. Zhvillimi i shfrytëzimit të tokës

Planifikimi i shfrytëzimi të tokës për 10 vitet e ardhshme në komunën e Shtërpcës, për grupet punuese ka qenë një sfidë e veçanta sepse ishte i nevojshëm të bëhet në hapësirë trajtimi, identifikimi i kontesteve dhe integrimi i të gjitha rrjedhave për përcaktimin e asaj se cilat aktivitete të shfrytëzimit të tokës duhet të realizohen dhe ku duhet ato të bëhen, duke shfrytëzuar standardet ndërkombëtare dhe GIS, është lehtësuar procesi i vendimmarrjes në aspektin e destinimit të shfrytëzimit të tokës dhe në atë drejtim grupi punues dhe spektri i ekspertëve të përfshirë në këtë proces. Parashihet që toka në komunën e Shtërpcës në mënyrë të konsiderueshme të jete e përcaktuar dhe ruajtur si tokë bujqësore dhe tokë pyjore. Pjesë të tjera do të përcaktohen për vendbanime ose tokës për ndërtim, zona arkeologjike, varreza, gjelbërsi, rrugë, deponi të mbeturinave, stacione për transferim, rrugë qarkore, industri për të gjitha fushat dhe sektorët.

Shfrytëzimi I planifikuar tokës sipas HILUCS	**Sipërfaqja (ha)**
Prodhim Tretësor / Shërbim i komunitetit	21.84
Prodhim Parësor / Bujqësi	4928.00
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Hapësire e hapur rekreative	152.61
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	5426.64
Banim / Banim i përhershëm	899.64
Prodhim dytësor/ industri e prodhimeve të lehta	0.43
Prodhim Tretësor / Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ / Shërbim kulturor/ Zonë e mbrojtur arkeologjike - historike	2.08
Prodhim Parësor / Minierë dhe Gurore / Minierë e materialeve për prodhimin e energjisë	9.24
Shfrytëzim tjetër/ Tokë natyrore e cila nuk është në ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik/Zonë e mbrojtur	1.06
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe nfrastrukturës publike / Rrjetet e transportit	151.54

5. PRIORITETET E ZHVILLIMIT STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT

Kjo pjesë e dokumentit paraqet njërën ndër pjesët mjaft të rëndësishme , pasi që në ketë pjesë kemi analizuar dhe identifikuar nevojat bazuar në vlerësimin të gjendjes, dhe hartuar zgjidhje në formën e Prioriteteve Zhvillimore Strategjike në përputhje me Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat.

Për dallim nga Vizioni, Qëllimet dhe Objektivat, të cilat mund të jenë afatgjata deri në 30 vitet e ardhme, Prioritete strategjike dhe Plani i Veprimit përcaktojnë çështjet kyçe të cilat janë përzgjedhur për të u trajtuar gjatë 8 viteve të ardhme.

Nëpërmjet zbatimit të Prioriteteve Strategjike, synojmë që të përmirësojë jetën a banorëve të Komunës së Shtërpcës dhe të përmbushim pritjet e tyre për zhvillim të qëndrueshëm në shërbime të cilat na janë deleguar, si pushtetit lokal, nga të gjitha fushat tona të kompetencave duke filluar nga: zhvillimin lokal ekonomik, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale, përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale, ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdes për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëminor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale, banimin publik, shëndetësinë publike, licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë, emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike, turizmit; si dhe, aktivitetet kulturore dhe të lira.

Dhe të gjitha këto fusha janë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Komunal të Shtërpcës dhe si të tilla të gjitha prioritetet e PZHK-së paraqesin prioritetet e qeverisë komunale

Natyrisht, që Komuna jonë ballafaqohet me shumë çështje tjera të cilat po ashtu do duhej të përfshiheshin në Prioritetet Strategjike dhe Planin e Veprimit, mirëpo duke ditur se ligj-vënësi ka kërkuar edhe identifikimin e analizave financiare për trajtim të prioriteteve, për shkaqe të kufizimeve financiare si dhe kapaciteteve ekzistuese, Ekipi Punues në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe komunitetin ka identifikuar disa Prioritete Strategjike, të cilat janë të zbatueshme dhe të matshme.

Zbatimi i projekteve të përzgjedhura në Prioritet Strategjike është përshkruar ë hollësi në Planin e Veprimit, të cilat jo vetëm që shërbejnë të udhëzojnë drejtoritë sektoriale duke përcaktuar masave të nevojshme për të arritur Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat e tyre, por po ashtu edhe për të monitoruar performancën e tyre. Për më tepër, kapitujt dhe shtojca vijues përshkruajnë në hollësi si të do të përdoren treguesit për të monitoruar, zbatimin, matjen e suksesit dhe efektivitetit të këtyre e Prioriteteve Strategjike të përcaktuar në këtë dokument.

Të gjitha projektet infrastrukturore dhe zhvillimet tjera të interesit publik të nivelit qendror dhe lokal, dhe që vijnë si rezultat i agjendave ndërkombëtare urbane, SDG-ve, ndryshimeve klimatike dhe reziliencës urbane mund të zbatohen edhe pse nuk janë paraparë më dokument. Pra ky dokument i karakterit strategjik konsiderohet si zhvillues i interesave publike dhe në këtë format ofron hapësirë për zhvillimin e projekteve të tilla.

Pasi që Plani Zhvillimor Komunal është i karakterit të përgjithshëm, zbatimi i projekteve kapitale do të zhvillohet sipas projekteve kryesore (inxhinierike/teknike), te cilat do të mbizotërojnë mbi zhvillimet e planifikuara konceptual të parapara me këtë dokument.

5.1. Prioritetet e zhvillimit strategjik

Ekipi Punues në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale dhe komunitetin ka identifikuar Prioritetet Strategjike vijuese, të cilat konsiderohen reale dhe të zbatueshme dhe të matshme:

5.1.1. Zhvillimi ekonomik

- Rritja e sipërfaqeve bujqësore dhe punimi i tyre (pastrimi i sipërfaqeve të tokës që janë të mbuluara me shkurre, shpyllëzimi i sipërfaqeve me pyje te ulëta, rrafshinat dhe bregoret e mundshme);

- Furnizimi i prodhuesve te perimeve me sera te zinkuara ;
- Stimulimi për mbjellje e me fidanë arre;
- Furnizimi i me fidanë të pemëve të imëta për të mbuluar;
- Furnizim i bletareve me koshere dhe pajisje për bletë;
- Trajtimi i rrugëve fushore;
- Përkrahja e buqëve me repromaterial për mbjelljet pranverore-farë misri dhe pleh artificial;
- Modernizimi i tregut të gjelbër në Shtërpcë;
- Përkrahja e blegtorëve me ferma me kapacitet prej së paku 25 krerë gjedhi;
- Përkrahja e blegtorëve me ferma me kapacitet prej së paku 50 krerë dele apo dhi;
- Furnizimi i fermave të lopëve qumështore me makina mjelëse;
- Furnizimi i fermerëve me mekanizëm përcjellës në bujqësi;
- Përkrahje për ripyllëzim të me fidanë të rinj Bagrem, Accacia, Bung, Qarrë apo Bredh dhe mbjelljen për sipërfaqet pyjore minimale prej së paku 0.5ha përgjatë zonave erosive;
- Popullimi i vendgjuetive me shtazë të egra;
- Gjelbërimi i hapësirave publike;
- Përkrahje për ripyllëzim me fidanë të rinj të arroreve dhe mbjelljen për sipërfaqet pyjore minimale prej së paku 0.5ha të cilat shtrihen në shpatijet e diellosura;
- Hartimit i Planit Rregullues të Hollësishëm për zonat industrial të planifikuara sin ë hartë;
- Ndërtimi I infrastrukturës teknike përgjatë zonave të bizneseve përgjatë rrugës rajonale;
- Organizimi i një panairit të përbashkët ndërkufitar /NVM;
- Organizimi i një konference të donatorëve për financimin e projekteve ndërkufitare;
- Themelimi i zyrës për shërbime të shpejta biznesore (OSS or One-Stop-Shop);
- Hartimi i Planit Rregullues i Hollësishëm për zonat turistike (hoteliere dhe banuese);

5.1.2. Infrastruktura teknike e planifikuar

Para projektimit të zhvillimit të rrjeteve të energjisë dhe burimeve në komunë, është e nevojshme të rregullohet situata ekzistuese dhe rindërtimi i largpërçuesve dhe trafo-stacioneve 10/0.4 KW e para së gjithash:

- Largpërçuesi 10 KW Brezovicë- Sevcë 1 = 5 km
- Largpërçuesi 10 KW Brezovicë- Trshevinë 1 = 3 km
- Largpërçuesi 10 KW Brezovicë - Brodë 1 = 9 km
- Ndërtim i objekteve (kapaciteteve) të reja;
- STS 10/0.4 KW Shtërpcë 250 KWA - Në qendër të fshatit (pjesa e vjetër) kulla ekzistuese nga 400 KWA, është e pamjaftueshme për të mbuluar konsumatorët e ri, ashtu që planifikohet ndërtimi STS prej 250 KWA në fokus të konsumatorëve të kërcënuar.
- STS 10/0.4 KW Gotovushë 250 KWA - TS ekzistuese 10/0,4 KW "kulla" e vendosur në fillim të fshatit në mënyrë që linjat NN të jenë të gjata deri në 3 km, kështu që pikat e përçuesve janë të rëndësishme, d.m.th. situata është shumë e keqe. STS e re do të ndërtohet në qendër të fshatit në gravitetin e ngarkesës, duke përdorur ende rrjetin.
- STS 10/0.4 KW Brezovicë 0.4 KW 100 KW - Familjet e këtij fshati janë shumë të shpërndara, dhe kështu linjat e gjata dhe gjendja energjetike nuk është e mirë, dhe ndërtimi e STS-së së re do të përmirësojë ndjeshëm situatën pa ndërhyrjen e rrjetit të tensionit të ulët.
- STS 10/0.4 KW Vrëbeshticë - Familjet e këtij fshati janë shumë të shpërndara, dhe kështu linjat janë të gjata dhe gjendja energjetike nuk është e mirë, dhe ndërtimi i STS-së së re do të përmirësoj ndjeshëm situatën pa ndërhyrjen e rrjetit të tensionit të ulët.
- STS 10/0.4 Popoc 0.4 KW 100 KW - Familjet e këtij fshati janë shumë të shpërndara, dhe kështu linjat e gjata dhe gjendja energjetike nuk është e mirë, dhe ndërtimi i STS-së së re do të përmirësoj ndjeshëm situatën pa ndërhyrjen e rrjetit të tensionit të ulët.

- STS 10/0,4 KWA Jazhincë - STS ekzistuese e 100 KWA duhet të çmontohet për shkak të mbingarkesës dhe në vend te saj të vendoset një STS i ri nga 250 KWA.
- Trafo-stacionet tjera (ekzistuese) mbeten në përdorim, sipas nevojës, do të zëvendësohen.
- Instalimin e antenës së re të PTK-VALA në zonën kadastrale të Shtërpcës dhe Sevcës. Në vendbanimet ku rrjeti ekzistues daton që nga vitet e 90-at do të vendoset rrjeti i ri. Ndërtimi i objektit të ri postar në Brod, Sevcë, dhe qendrën e re turistike të planifikuar, do të mbulohet i gjithë territori i Komunës me rrjetin e telefonisë fikse dhe rrjetin kabllor;
- Ndajmë sistemet e fekaleve dhe ujerave atmosferik në të gjitha vendbanimet duke filluar nga qendra administrative e Shtërpcës;
- Trajtimi me prioritet i disa vendbanimeve në sistemin e gjysmë-kanalizimit (Shtërpcë, Berevcë, Brod, Firajë, Gotovushë dhe Biti e Epërme etj.);
- Planifikimi dhe ndërtimi i impiantit kryesor të kanalizimit në nivelin e komunës në drejtim të Kaçanikut në dalje të Komunës;
- Krijimi i infrastrukturës për mënjanimin dhe trajtimin e ujerave të përdorura dhe të ndotura nga industritë dhe vendbanime;
- Mbrojtja e ujërave minerale dhe mbrojtja ujërave nëntokësor si në drejtim të largimit të mundësive të kontaminimit, dhe në aspektin e ndërtimit të pakontrolluar dhe kërcënimit të hapësirës;
- Ndarja e rrjetit të kanalizimi te fekaleve dhe ujërave atmosferik në të gjitha vendbanimet;
- Ndërtimi i objekteve në nivelin e vendbanimeve dhe pastrimi i ujërave të zeza, si një zgjidhje e përkohshme për të parandalimin e ndotjes së ujërave;
- Vazhdimi dhe rritja e monitorimit te nivelit të ndotjes së lumit Lepenc;
- Që ne objektet industriale ekzistuese të përfshihen objekte për pastrimin e ujërave të zeza;
- Dokumentacioni investues teknik të industrive të reja duhet të përfshijë vendimin për pastrimin e ujerave të përdorura dhe të kontaminuara;
- Funksionimi i objekteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa instalim paraprak të objekteve për pastrimin e ujërave të ndotura;
- Masa për parandalimin e ujërave të ndotura nga mbeturinat në rrugë Sevcë – Brod.
- Vazhdimi i përdorimit të infrastrukturës që ofrohet nga deponia rajonale;
- Si një alternativë e mundshme e deponisë rajonale është planifikuar një stacion;
- Transferimi në nivel komunal në vendbanimin e Izhancës;
- Përdorimi i mbetjeve për riciklim dhe aftësive të prodhimit të energjisë;
- Trajtimi në fushë të caktuar të mbeturinave inteligjente me mundësi të depozitimit dhe riciklimit të mbeturinave;
- Caktimin e shërbimeve për blerjen e mbeturinave në zonat rurale;
- Ndryshim në mënyrën e riblerjes dhe të menaxhimit të mbeturinave;
- Janë parashikuara dhe vendet për varrimin e shtazëve dhe mundësitë të shkatërrimit masiv në raste emergjente për shkak të sëmundjeve apo arsyeve tjera tek shtazët dhe shpezët.
- Ndërtimi i impiantit për djegien e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë
- Përgatitja e studimit të fizibilitetit të rrjetit të ngrohjes qendrore përmes gazit
- Ndërtimi i Parkut Solar.

5.1.3. Infrastruktura e Transportit dhe Transporti

- përfshirja e Komunave në rrjetin kryesor rrugor të Kosovës për përmirësimin e qasjes,
- përmirësimi i qasjes të të gjithë fshatrave në qendër të Komunës me arritjen e lidhjeve alternative,
- rritjen e sigurisë së rrjeteve rrugore,
- sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e turizmit të lartë
- ruajtjen e mjedisit.

Për të arritur këto objektiva, janë vendosur detyrat e mëposhtme:

- modernizimi i rrugës rajonale Ferizaj - Prizren, në përputhje me kërkesat e rangut të asaj rruge;
- modernizimi i rrjeteve ekzistuese dhe ndërtimi i aksioneve shtesë të rrjeteve të zonës lokale që lejojnë ndërlidhjen e të gjitha vendbanimeve, zonave aktuale dhe të ardhshme turistike;
- përshtatja e kushteve të rrugës së trafikut sikurse kërkohet me urbanizim (trotuaret, ndalesat e autobusit, shtigjet e këmbësorëve, vend-parkimet);
- sigurimi i kushteve optimale për udhëheqjen e transportit publik me autobus për të rritur sigurinë në seksione të hapura dhe vendbanime;
- harmonizimi i linjës lokale të trafikut të autobusëve me zhvillimin e rrjetit të vendbanimeve;
- organizimi i formave të veçanta të transportit publik lokal duke futur taksitë kolektiv, minibusët dhe format tjera kolektive të transportit publik (para-transitit) në funksion të udhëtimit për në punë dhe shkollë;
- ndërtimi i infrastrukturës së trafikut në funksion të zhvillimit cilësor të turizmit të lartë (sistemi hekurudhor i veçantë, gondola, ashensor, heliodrom dhe avancime të tjera të infrastrukturës ekzistuese);
- sigurimi i lidhjeve të transportit të brendshme të objekteve turistike, që mundëson që të gjitha motivet e udhëtimit të jenë në dispozicion nga çdo lokacion i kapaciteteve të vendosura;
- ndërtimi i rrugës anësore rreth qendrës së vendbanimit të Shtërpcës dhe zbatimi i masave të përshtatshme për të mbrojtur mjedisin.

5.1.4. Infrastruktura publike e planifikuar

- Në komunën e Shtërpcës, përveç ndërtesës ekzistuese, planifikohet edhe ndërtimi i objekteve të çerdheve të reja në vendbanime (nën-qendra) si: Vërbeshtic, Brod dhe Bitij e Poshtme.
- Ndërtimi i objekteve shkollore në kuadër të zonës së mbulimit;
- Sigurimi i transportit publik për në shkollën amë;
- Ndërtimi i shkollave (objekteve shtesë) për nivelin e parë (fëmijët e moshës 6-12 vjet.) dhe sigurimi i transportit publik për nivelin e dytë të shkollës fillore.
- Në territorin e komunën e Shtërpcës është planifikuar ndërtimi i objekteve kulturore në vendbanimet: Firaja, Brod, Viçë dhe Brezovicë;
- Në vendbanimet, Sevcë, Jazhincë dhe Vrëbeshticë, rindërtimi i nevojshëm dhe zgjerimi i objekteve ekzistuese;
- Në komunën e Shtërpcës në të gjitha fshatrat ku është i planifikuar ndërtimi i objekteve kulturore, në kuadër të tyre është paraparë edhe rregullimi i hapësirës për bibliotekë dhe sallë të leximit;
- Ndërtimi i komplekseve sportive në zonën e Shtërpcës (livadhe);
- Ndërtimi i fushave të vogla sportive në të gjitha vendbanimet;
- Rregullimi i fushave ekzistuese;
- Ndërtimi i pishinës brenda kompleksit sportiv ne Shtërpcë;
- Poligonet për ecje dhe rekreacion (shtigje te shkurtra) Shtërpcë - Brezovicë, Shtërpcë - Vërbeshticë dhe në të gjithë malet mbi zonën e ski qendrës;
- Ndërtimi i fushave të tenisit në Shtërpcë.
- Aktivizimi i një numri të madh të organizatave rinore dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet lokale;
- Ngritja e kapaciteteve sportive, kulturë dhe angazhimi më i madh i të rinjve në këto veprimtari;
- Përmirësimi i frymës konkurruese në shumë fusha (sport, art, shkencë në shkollat fillore dhe të mesme);
- Sigurimi i objekteve për sport dhe rekreacion në çdo vend të banuar, të cilat mund të përdorën për aktivitete të tjera rinore;
- Hapja e klubeve rinore, objektet e të cilëve mund të jenë në shkollat fillore.
- Qendra kryesore e mjekësisë familjare (QKMF) – në Shtërpcë, e cila do të vazhdojë të ofrojë shërbime të kujdesit shëndetësor 24 orë në departamentin e emergjencave (ndarja fizike nga QKMF e departamentit emergjent për të mundësuar ofrimin efikas të ndihmës së parë në raste të vështira, dhe pa shqetësim të pacientëve të tjerë),

departamenti i mjekësisë familjare, departamenti i stomatologjisë, departamenti i gjinekologjisë, departamenti i vaksinimit.

- Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) - në Drajkoc duhet të siguroj shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës.
- Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF) – duhet të sigurojnë shërbime shëndetësore gjatë ditëve të punës në Brod, Gotovushë, Jazhincë dhe Sevcë.
- Punktet e Mjekësisë Familjare (PMF) - duhet të sigurojnë shërbime shëndetësore në ditët e caktuara (2-3 herë në javë) në Biti të Epërme dhe të Ulët, Sushicë dhe Vrbeshticë.

5.1.5. Mbrojtja e mjedisit

- Vendosja e brezit të gjelbër dhe shiritit me kapacitet për absorbimin e aerosolit, gazeve azotike, squfurit dhe gazeve të karboni, metaleve të rënda përgjatë rrugëve kryesore siç janë të paraqitura në hartë;
- Rehabilitimi i parqeve ekzistuese dhe krijimin e parqeve të reja në fushat e identifikuara si të lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve;
- Mbrojtja, zhvillimi, mirëmbajtja e pyjeve te reja dhe ekzistuese;
- Përmirësimi i trafikut rrugor për të shmangur automjete të mëdha të transportit në qendrat rezidenciale, ku është përqendrimi më i madh i popullsisë;
- Parandalimi i shkarkimit të ndotësve në ajër nga industria dhe makineritë e lëvizshme me anë të instalimit katalizator dhe pajisjeve tjera në kuptimin teknik;
- Përdorimi i energjisë alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit);
- Minimizimi i përdorimit të makinave të pasagjerëve dhe transportit publik;
- Promovimin e trafikut të jo-motorizuar, duke planifikuar shtigjet çiklistike dhe shtigjet për shëtitje;
- Planifikimi i nivelit tolerant të ndotjes dhe nivelet e zhurmave, veçanërisht në zonat me aktivitet të ndjeshme (ne afërsi të shkollave, spitaleve, etj.).
- Rindërtimi i rrugëve (anashkalime në qendra urbane, kanalizime dhe largimin e deponive te mbeturinave të cilat janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet, oksidimi i mbeturinave, etj.
- Të gjitha burimet e ujit natyral, termik dhe termo-mineral dhe sipërfaqe të tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore të mbrohen siç mund të shihet në hartën hidrologjike të Shtërpcës, përcaktimi i zonës së mbrojtjes së detyrueshme rreth burimeve, trapeve, rrjedhave të ujit dhe akumulimi, nën një regjim të mbrojtjes së caktuar, në varësi të përdorimit të objektit. Në këto zona nuk duhet të ndërtohen objekte dhe të kryhen punë të tjera, ose të shfrytëzohet toka në një mënyrë që rrezikon sasinë dhe cilësinë e ujit;
- Ndermirën masa për ndalimin e ndotjes së lumit, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujerat e zeza, me rekomandim të trajtimit nga gropat septike dhe format tjera, instalimin e aparatit për pastrim;
- Në të ardhmen është e nevojshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjata në mënyre që ujërat e zeza (urbane, industriale) para se të shkarkohen, të pastrohen në kushtet fizike, biologjike dhe kimike. Për këtë qëllim është e nevojshme siç vijon:
- Dokumentacioni teknik i investimit për industri të reja duhet të përmbajnë vendimin për pastrimin e të gjitha ujërave të zeza;
- Puna e objekteve të reja industriale nuk duhet të lejohen pa instalim paraprak të pajisjeve që do të sigurojnë pastrimin e ujit te ndotur në mënyrë adekuate.
- Nevojat e popullatës për ujë janë në rritje të vazhdueshme. Në të ardhmen, sigurimi i ujit te pijshme e të shëndetshëm për banorët e kësaj komune do të jetë një problem serioz. Disa zgjidhje për Qendrën Komunale dhe fshatrat përreth janë të parashikuara me këtë dokument. Për sigurimin e sasisë së parashikuar të ujit dhe sasisë shtesë rezervë, është e nevojshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave te lumit dhe akumulimi. Përveç kësaj, përdorimi racional i ujit në këtë Komunë është një detyrë e rëndësishme për të gjithë faktorët e planifikimit dhe përdorimin e ujit dhe hapësirës;
- Parashihet mbrojtja e veçantë e burimeve –Uji i Bardhë I, Uji i Bardhë II, Studenci i Priftit, Durlo Lumi, Blizumir, Ratnoreka, Bigor, Kërcimi, Kreu i Priftit, Lugina e Heshtur,Shtëpia e Stojkit, Gobeljinci, Lumi i Borovskit, Vlahu, Lumi i Prevadës, Çuka e Berevaçit, Dy lumenj, Vrela, Firaja.

- Masat e veçanta të mbrojtjes duhet të përfshijë edhe përdorimin e pakontrolluar të plehrave artificial për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfori dhe nitrientet tjera);
- Mbrojtjet tjera parashikohen edhe nga te gjithë llojet e mbeturinave, të cilat janë të organizuara dhe të cilat marrin parasysh këtë faktor për të planifikuar një vend për grupim.
- Mbrojtjen e fizike dhe cilësore e tokës;
- Përveç mbrojtjes së ajrit dhe të ujit - ne parashikojmë futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për sigurimin e "lidhjeve të humbura" për mbrojtjen e mjedisit;
- Parashikohet mbrojtja në drejtim të sipërfaqes së tokës dhe burimeve të tokës nga tjetërsimi për qëllime jo-bujqësore me kufizimin e përhapjes së ndërtimit e ndërtimit brenda grantit të planifikuar ndërtimor (harta: "Konceptet e zhvillimit të vendbanimit");
- Të sigurohet prodhimi i rregullt dhe i sigurt me qëllim të mbrojtjes së popullit, bimor, faunës dhe mjedisit, parashikohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja, përmes mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndotja me kufizimin dhe parandalimin e ndotjes prej transportit të drejtpërdrejtë, transportin e substancave te dëmshme përmes ujit dhe ajrit dhe ndërmarrjen e masave për ruajtjen dhe përmirësimin e fertilitetit;
- Planifikohet ndalimi i shkarkimeve të substancave të dëmshme dhe të rrezikshme që dobësojnë dhe ndryshojnë aftësitë produktive të tokës bujqësore dhe cilësinë e të mbjellave dhe përdorimit të papërshtatshëm të mineraleve dhe plehrave organike dhe pesticideve;
- Planifikohen monitorimet në mënyrë të përhershme dhe kontrolli i fertilitetit të tokës bujqësore;
- Plani parashikon implementimin e fazës së dytë dhe të tretë të rregullimit të tokës bujqësore (masa të komasacionit: rregullimi i territorit të tokës për të krijuar parcela të mëdha dhe të rregullta në mënyrë që të sigurohet përpunim ekonomik i tokës dhe për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin e vendbanimeve me karakter bujqësor, rregullimin e kufijve në mënyrë që të krijohen parcela të reja me forma të reja dhe për t'u përfshirë në sistemin e hidromeliorimit deri te të dhënat kadastrale dhe ridefinimin e pronësisë së parcelave me përdorimin e mjeteve ligjore të burimeve ligjore – komasacioni). (Harta. Kufijtë e planifikuara te vendbanimeve);
- Parashikimi i ujitjes së tokës bujqësore dhe masa të tjera për të rritur nivelin e shkallës së bonitetit të tokës, e cila ka shkallë të bonitetit më të ulët;
- Parashihet mbrojtja nga përmbytjet me rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe rrjedhave të ujit (shih hartën e përmbytjes dhe erozionit) të tokës e cila ka një vlerësim të lartë të bonitetit dhe masa të tjera për të mbrojtur dhe për të rritur shkallën e bonitetit;
5.2.7.5. PS - DPRU 5 Zhvillimi i 3 uikend zonave

	Përshkrimi i veprimit	Implikimi financiar	Afati Kohor/intervali i planifikimi	Kostoja e përafërt	Korniza institucionale	Prioriteti
1	Zhvillimi i uikend zonës Vërbeshticë	××	O	N/A	Investitori	×××
2	Zhvillimi i uikend zonës Shtërpce	×××	O O	N/A	Investitori	×××
3	Zhvillimi i uikend zonës Jazhincë	×	O	N/A	Investitori	××

DRAFT

5.2.8. Prioritetet strategjike të Shfrytëzimit të Tokës

5.2.8.1. PS - DPRU 1 Funksionalizimi i vendbanimeve dhe urban-rural bilancit të zhvillimit.

	Përshkrimi i veprimit	Implikimi financiar	Afati Kohor/intervali i planifikimi	Kostoja e përafërt	Korniza institucionale	Prioriteti
1	Hartimi i planeve rregulluese për vendbanimet: Shtërpcë, Sevcë, Drajkovc, Brod dhe Brezovicë	××	O	€505,000	Komuna	××
2	Hartimi i planeve rregulluese për zonën industriale në bazë të këtij plani	××	O	€48,000	Komuna	×××
3	Përgatitja e projektit për plotësimin e zgjidhjes së infrastrukturës urbane	××	O	€150,000	Komuna, Investitori	×××
4	Përgatitja e planeve dhe rregulloreve për ndërtimin brenda kufijve të planifikuara	×	O	€113,000	Komuna	×××
5	Monitorimi dhe ndalimin i ndërtimit jashtë kufijve të ndërtimit dhe zonave të ngrira për ndërtim	×	Në Kontinuitet	N/A	Komuna	××
6	Kushtet për përgatitjen e bazës ligjore për një trajtim adekuat të ndërtimeve të paligjshme	×	O	N/A	Komuna	×××
7	Formimi i komisioneve për prishjen e ndërtesave të ndërtuara jashtë kufijve të përcaktuara	×	O	N/A	Komuna	×××

DRAFT

6. ZBATIMI DHE MONITORIMI

6.1. Dispozitat për zbatim

6.1.1. Dispozitat për Zbatim përmbajnë një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm). Pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunale në Kuvend Komunal dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur për zbatimin e Planit Zhvillimor të Komunës, në këtë drejtim Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se zbatimi i Planit Zhvillimor Komunal varet nga shumë faktorë në mënyrë direkt dhe indirekte dhe përpos punës brenda sektorëve të komunës, në funksion të krijimit të një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm, sistem i cili prezanton edhe një nga kërkesat ligjore, duhet punuar edhe me grupet tjera të interesit, e cila nuk mund të bëhet pa ngritur edhe cilësinë e informimit dhe komunikimit si dhe fuqizimin e faktorëve tjerë.

Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm dhe Ekipi punues në rend të parë zbatimin do e bëjnë në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim të Planit Zhvillimor të Shtërpcës, duke punuar Planet e Zbatimit Sektorialë të secilës Drejtori të Komunës së Shtërpcës.

Gjatë zbatimit të PZHK përpos autoriteteve lokale dhe qendrore është e rëndësishme të jenë akterë dhe të ftuar edhe organizatat e tjera si kompanitë publike , OJQ, përfaqësuesit e fermerëve, përfaqësues të industrive që kanë ndikim në komunë e më gjerë, bizneset dhe të tjerët që janë akter kyç dhe të rëndësishëm për zbatimin e planit , gjithnjë në pajtim me parimet që dalin nga U.A . MMPH Nr.-11/2015 neni 4.paragrafi 1.3.

6.1.1.1. Formimi i ekipit

Një nga faktorët fillestar dhe të rëndësishëm të zbatimit të PZHK-së është krijimi i Ekipit Komunal të Shtërpcës, ky Ekipi komunal do ketë obligimet për përkrahje në zbatim të PZHK-së, por edhe për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në të njëjtën kohë pasi që Komuna e Shtërpcës nuk ka Ekip edhe për zbatim dhe monitorim të PZHK-së, ky Ekip duhet ti kryej edhe ato detyra.

Komuna e Shtërpcës në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të PZHK-së, si pjesë e këtij dokumenti, e parasheh krijimin e këtij Ekipi, që përpos rëndësisë së madhe në zbatim, do shërbej edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Ky Ekip Punues duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili bazuar në kompetencat ligjore që ka ose e themelon vet ose i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e Ekipit Punues për zbatimin e Planit Zhvillimor të Shtërpcës, si dhe për Monitorim dhe Raportim lidhur me zbatimin e Planit, për arsye praktike Ekipi i njëjtë do ketë obligimet e njëjta edhe për HZK-në e Shtërpcës.

Në kuadër të vendimit duhet përshkruhet përbërja e Ekipi, detyrat lidhur me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, periudhat e raportimit, kompensimin nëse aplikohet etj.

Ekipi Punues përbëhet nga përgjegjësit e të gjitha drejtorive, udhëheqësi i Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm) është edhe koordinatori i Ekipit.

Detyrat e Ekipit janë të koordinoj dhe bashkërendoj aktivitetet, lidhur me përgatitjen e Planeve Vjetore, për çdo drejtori brenda komunës së Shtërpcës, Planet vjetore duhet përgatitur për Drejtoritë: Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm, Urbanizëm, Administratë, Shëndetësi, Mirëqenie Sociale, Arsim, Kulturë, Sport, Bujqësi, Financa, Pronë, Kadastri, Inspeksioni, Investime kapitale dhe menaxhim i kontratave, Shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim, Parqe.

Është detyrë e secilit përgjegjës që është pjesë e ekipit, nga secila drejtori të kujdesën për këto Plane Vjetore, dhe e koordinatorit të Ekipit të kujdeset për planin e Drejtorisë për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm, por

në cilësinë e koordinatorit dhe si udhëheqës i Ekipit Punues edhe koordinoj dhe ndihmojë edhe planet vjetore të drejtorive tjera.

Detyrë tjetër është që të verifikoj se Planet Vjetore Sektoriale të jenë të bazuara dhe në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim nga PZHK-ja si dhe të:

- Përcjell, koordinoj dhe bashkërendoj zbatimin praktik të projekteve dhe komponentës hapësinore në baza ditore, javore e mujore të punës.
- Merr edhe shënime për mundësitë, sfidat dhe problemet e zbatimit ashtu që të mundësoj përmirësimin e zbatimit në vitin tjetër të radhës.
- Bashkëpunojnë me anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë sistemin e Zbatimit të Planit si dhe Raportimin.
- Informojë, nëpërmjet Zyrës për Informim, edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planit, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, Mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të Fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që të:

- Kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat;
- Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet;
- Definojnë masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet;
- Zhvillojnë tubimet e rregullta publike;
- Zhvillojnë takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatimit të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane.

Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të planit zhvillimore komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që (së paku) të organizojë dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore.

Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët, dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të Transparencës, dhe në këtë mënyrë komunat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal, dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

6.1.1.2. Informimi dhe komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës

Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës luajnë një rol të jashtë zakonshëm, andaj Komuna e Shtërpcës dhe aktorët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për zbatimin e Planit Zhvillimor .

Fusha e informimit dhe e komunikimit ,në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, do jetë një mbështetje e madhe e drejtuesve të institucioneve, dhe të vet institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatoj kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushte edhe këtë kërkesë, nga kuadri ligjor.

Në vijim, Komuna e Shtërpcës do të respektojnë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës gjatë zbatimit të Planit Zhvillimor. Plani i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të PZHK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë aktorët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzoj të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshëm në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe aktorët e tjerë relevant.

Në ketë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë aktorët, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve, botojeni atë dhe bëjeni le të shihet në gazeta, Postoni atë në Ueb faqen tuaj të Internetit dhe, Referojuni sa më shpesh që të jetë e mundur në mënyra të ndryshme dokumenteve të planifikimit. Këto udhëzime, do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Planin Zhvillimor Komunal aktual dhe me këtë rast nga dhe anëtarët e grupeve të tjera të interesit, mund të kërkohen komente dhe sugjerime lidhur me informimin, me komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes.

Si shumë me interes për zbatim të Planit konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë aktorët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

6.1.1.3. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve

Përkundër që në Komunën e Shtërpcës mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësorë gjatë përgatitjes së PZHK-së në kuptimin e gjithëpërfshirës edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, për kundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës.

Në ketë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Planit, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga PZHK-ja.

Drejtoritë, duhet të komunikojnë dhe t'i koordinojnë veprimet për projektet, objektivat qëllimet dhe përmbajtjet tjera të PZHK-së por edhe aktivitetet tjera që janë rezultat i Planit, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe projektet, objektivat, qëllimet dhe dimensionin hapësinor të dokumentit.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësoj komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj aktorëve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Planit, dhe mundëson informim dhe koordinimin efikas, cilësorë, dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë aktorëve relevant. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi

shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Planit, i projekteve, objektivave, qëllimeve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për tu analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspekcionit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën e inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaftë i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimor në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera.

Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Edhe Drejtoritë tjera komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë, pasi që shumë projekte, zhvillime të parapara me PZHK duhet të jenë pjesë e parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre projekteve, objektivave qëllimeve dhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hapë më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal në këtë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet .

Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planit duhet zgjeruar edhe me gjykatat për disa lëndë potenciale, edhe me byrotë projektuese për tu sqaruar për zonat dhe kufijtë ku lejohen ndërtimet, e në këtë vij edhe projektimet edhe shoqëria civile për rolin, rëndësinë por edhe interesat që mbrojnë.

6.1.1.4. Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror

Pasi që PZHK-ja është dokument multi-sektorial, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushë veprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të PZHK-së.

Në këtë drejtim, aktivitetet dhe masat për zbatim, do jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të PZHK-së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPHI-ja, MBPZHR-ja, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministritë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të PZHK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të PZHK-së. Dihet se ministritë e ndryshme si për shembull MMPHI-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit. Duke i ditur edhe kompetencat për ujin, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPHI-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPHI-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, përpos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MMPHI.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të PZHK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendror. Në këtë

drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspektorati i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të PZHK-së.

Pasi që planifikimi është multisektorial, gati të gjitha ministritë dhe të gjitha agjensionet e tjera publike, kanë një fushë-veprimtari, kompetencë dhe ndikim që prekë edhe zbatimin e PZHK-së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të PZHK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e grantëve që vijnë nga niveli qendror. Lirishtë, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtjesore për zbatim të PZHK-së.

6.1.1.5. Mbështetja administrative

Komuna e Shtërpcës, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të PZHK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj.

Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikimeve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për zbatimin e projekteve, objektivave dhe qëllimeve janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim por, edhe për transparencë në zbatim.

Për tu mundësuar zbatimi i PZHK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e hartimit të Hartës Zonale të Komunës ,më të cilën mund të epen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar edhe me PRRH.

Kështu mbështetja administrative përpos transparencës, përgjegjësisë shkon edhe në kompletimin me dokumentet tjerë të nevojshëm për zbatim të plotë të PZHK-së.

6.1.2. Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së

Brenda kapitullit Dispozitat për Zbatim, ekipet hartuese të Planit Zhvillimor Komunal kanë sqaruar edhe përgjegjësit dhe kompetencat lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikimi strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm) pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal në Kuvend Komunal, dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësit ligjore që ka lidhur edhe me monitorimin e zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës, në ketë drejtim drejtoria e Urbanizmit do filloj me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se monitorimi i zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal është një aktivitet i vazhdueshëm me qëllim të sigurimit të informatave në mënyrë të rregullt dhe sistematike, për mes treguesve kuantitativ dhe kualitativ të cilët do matin progresin e arritur në zbatimin e PZHK-së së Shtërpcës, me qëllim të vlerësimit se a janë arritur rezultateve e planifikuara por edhe identifikuar vështirësitë, sfidat dhe problemet.

Monitorimi trajton në mënyrë sistematike raportin ndërmjet gjendjes së zbatuar dhe asaj që është planifikuar me PZHK por edhe pritjeve bazuar në treguesit e paracaktuar.

Është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve sektoriale për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit.

Monitorimi, është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e Planit Zhvillimor Komunal do të sigurohen që projektet, objektivat, qëllimet janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në PZHK dhe brenda afateve të caktuara.

Është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e PZHK-së me dhe standardet e caktuara për të vlerësuar nëse, po bëhet progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave

korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen, dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën brenda detyrimeve të tyre.

Në ketë drejtim mundemi të konstatojmë se mundet të bëhet edhe Anulimi apo shtyrja e zbatimi të ndonjë aktiviteti të Planit të Veprimit të PZHK-së për arsyet e caktuara objektive por edhe subjektive që janë rezultat i procesit të monitorimit të zbatimit, shtyrja ose anulimi bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Kuvendit të Komunës, dhe nëse behët një vendim për shtyrjen apo anulimin e një aktiviteti, Plani i Veprimit do të përditësohet me vendimin e ri, dhe pas përditësimit drejtoritë komunale përgatisin Planin Sektorial Vjetor për zbatim të vitit vijues bazuar në Planin e Veprimit të përditësuar për Zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit është proces sistematik dhe i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, për një ndërhyrje të caktuar.

Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës Plani: po zbatohet, në përputhje me planin e Veprimit për zbatim të PZHK-së ose edhe përmbajtjeve tjera të PZHK-së.

Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit e sidomos PZHK-së në ketë rast, Komuna e Shtërpcës është e bindur se përpos një planifikim të qëndrueshëm dhe hartimit të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm edhe aplikimi i tij në praktike dhe përkrahja më e madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë është për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim .

Komuna e Shtërpcës e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të monitorimit dhe vlerësimit të planit në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor.

Komuna e Shtërpcës ka edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të monitoruar zbatimin e PZHK-së, dhe njëkohësish të përgatiten raportet e nevojshëm për Kuvendin Komunal, MMPHI-në dhe që i duhen çdo pale të interesuar për zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës bëhet në baza ditore, ndërsa Raportimi i monitorimit kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime praktike më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore, por edhe për çdo vit radhazi, pasi që PZHK-ja është dokument i cili planifikohet për së paku 8 vite, intervalet tjera kohore për raportin e monitorimit mund të caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të PZHK-së përgatitet nga Ekipi Punues i cili udhëhiqet nga koordinatori, e koordinatori raportin përfundimisht e trajton dhe përmbyll brenda Autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm), raport i cili prezanton Monitorim dhe Vlerësim e zbatimit të PZHKsë, edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore për nevoja të brendshme të komunës, dhe vjetore i cili është për nevoja të brendshme të komunës por edhe për raportim në MMPHI.

Monitorimi i Zbatimit të PZHK-së bazohet në: Projektet, aktivitetet, masat dhe përmbajtjet tjera të parapara në Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, plan i cili duhet jetë bazë për përgatitjen e planeve vjetore sektorial për secilën drejtori në lidhje me zbatimin e PZHK-së.

Monitorimi i zbatimit trajton edhe projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të cilat nuk janë paraparë me Planin e Veprimit për Zbatimin e PZHK-së, rrjedhimisht as me plan vjetor sektorial të zbatimit të PZHK-së, dhe të cilat mundë të konsiderohen si zhvillime të momentit, të pa planifikuara.

6.1.2.1. Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit

Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që mund të ndryshon nga drejtoria në drejtori, por edhe nga projektet, masat dhe aktivitetet që do monitorohen (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performancës së Komunës të jetë pjesë e procesit të monitorimit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Komunës në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale të komunës.

Drejtoritë komunale sektoriale brenda komunës së Shtërpcës përgatisin raportin monitorues të zbatimit të planeve zhvillimore sektoriale në baza vjetore si obligim ligjor dhe sipas nevojës bazuar në intervalet e lartpërmendura, Raportet vjetore duhet përgatitur për të gjitha drejtoritë, nga të gjitha këto raporte përgatitet Raporti Monitorues i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës dhe e dorëzon në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, pasi të

jetë integruar nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Planifikim strategjik dhe zhvillimi të qëndrueshëm) dhe pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit nga Kuvendi i Komunës, në baza vjetore dorëzon në Ministri raportin informues për gjendjen e zbatimin të Planit Zhvillimor të Komunës.

Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim (anulim ose shtyrje të ndonjë aktiviteti) dhe prezantohen para Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë me statistika financiare, në baza vjetore, së paku për tetë (8) vite.

Raportet vjetore të monitorimit bazohen në analizat e:

Informatave bazë: gjatë gjithë procesit duhet sigurohen informata, informatat duhet siguruar në të gjitha drejtoritë dhe instancat tjera, këto informata sigurojnë bazë të mirë për analizën dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës.

Raporti vjetore i monitorimit dhe raportet sektoriale bazohen në analizat e këtyre informatave bazë .

Cilët janë treguesit?

Për të pasur një monitorim të zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës duhet siguruar që informatat bazë të pasqyrojnë treguesit adekuat për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ.

Çdo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së përgatit Planin vjetor sektorial për Zbatimin e PZHK-së, dhe brenda këtij plani duhet definuar edhe treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të kushteve, zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara.

Si i përcaktojmë treguesit për zbatim?

Duhet të Sigurohemi që ka një pajtim mbi treguesit para aplikimit të tyre (gjatë përgatitjes së planit sektorial vjetor për zbatim nga të gjithë amtarët e ekipit).

- Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm.
- Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistent.
- Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal.
- Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mund të azhurnohen lehtë.
- Miratoni tregues që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera.
- Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit.
- Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, zonave rurale, fondit të ndërtimeve, etj.
- Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit që, të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

Për ilustrim:

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së së Shtërpcës kemi potencuar se për vitin 2023 synohet të ndërtohet rruga e caktuar, treguesi do jetë normal numër dhe në fund të vitit bazuar në informatat bazë mund të themi se kemi realizuar komplet rrugën prej 7 km, ose 7000 m tregues që paraqet të gjitha përmbajtjet e rrugës, të dakorduar kur e kemi krye planin sektorial të zbatimit .

Caktimi i standardeve të monitorimit

Standardet e monitorimit i përcaktojmë në fazën e planifikimit të monitorimit dhe bëhen me marrëveshje të Ekipit Zbatues.

Cila do jetë metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit në procesin e Zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës?

Duke e trajtuar metodologjinë si tërësinë e metodave që përdoren në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës në përgjithësi për dokumentin por edhe në fusha të caktuara sektoriale.

Lirisht mundet të thuhet se këto metoda bazohen në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së si dhe në Planet Sektoriale për Zbatim ku janë paraparë: projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore, kostot financiare dhe pritjet nga zbatimi i tyre, thjesht duke krahasuar gjendjen e planifikuar dhe gjendjen e realizuar.

Metoda e cila preferohet të shfrytëzohet është metoda e orientuara në rezultate dhe në gjendjen faktike në teren.

Ekipi punues duhet përdorë metodat statistikore dhe mundet të përdorë edhe metodat tjera sipas nevojës dhe përcaktimeve edhe në plan pune për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.

Metodologjia e punës do të ndjek hapat e njëjtë të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale, duke ndjekur këta hapa:

Hapi 1 Identifikimi

Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të PZHK-së dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik.

Hapi 2 Definimi i treguesve

Në varësi të asaj se çka është pjesë e planit të veprimit për zbatim të PZHK-së, dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik duhet përcaktohen tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje)dhe tregues kualitativ për më shumë në materialin e lart përmendur : Cilët janë treguesit dhe materialet tjera.

Hapi 3 Përcakto metodat e grumbullimit të të dhënave dhe afatet kohore

Grumbullimi i të dhënave:

Grumbullimi i të dhënave bëhet bazuar në formularët e përgatitur për monitorim sipas specifikave të zhvillimeve dhe drejtorive.

Treguesit kuantitativ dhe kualitativ mblidhen në baza ditore , dhe hedhja e tyre në databazë bëhet në baza javore;

Në rast se mund të duket e nevojshme mundë organizohen intervista, pyetësorë dhe metoda tjera të grumbullimit të informatave.

Grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare të komunës.

Hapi 4 Identifikoni Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit

Në kuadër të planit të monitorimit përcaktohen edhe Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit për përgjegjësit e drejtorive, stafit brenda secilës drejtori për më shumë shih materialin më lartë :Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe materialet tjera.

Hapi 5 Krijo një Plan Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Duke konsideruar se të dhënat bazë (treguesit dhe të dhënat tjera) duhet vlerësuar për të konstatuar dhe raportuar progresin e zbatimit, duhet hartuar një Plan transparent dhe profesional Vlerësimi dhe Format të Raportimit

Hapi 6 Kompletimi i Raportit dhe raportimi në Kuvend komunale të Shtërpcës dhe në MMPHI

Kompletimi i Raportit përfundimtar duhet bëhet nga autoriteti kompetent komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor duke e integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilës drejtori lidhur me vlerësimin e zbatimit, raport i cili duhet prezantohet në Kuvend komunale të Shtërpcës dhe në MMPHI.

Në bazë të dispozitave ligjoret, Raporti i zbatimit dhe monitorimit të PZHK , pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës dorëzohet në MMPHI, më së largu në kuadratin e parë të vitit pasues.

6.1.3. Vlerësimi i zbatimit të Planit Zhvillimor të Komunës

6.1.4. Kuptimi i vlerësimit

Vlerësimi do të thotë gjetja e vlerës në përqindje (%) të realizimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe cilësisë së zbatimit.

Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të faktit të gjetur, të cilët janë grumbulluar dhe sistemuar gjatë procesit të monitorimit.

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo zhvillimet, masat, aktivitetet, projektet në përputhje me rezultatet e planifikuara në Planin e Veprimit për Zbatim të PZHK-së, Planet sektoriale të Zbatimit dhe me standardet e pranuara përgjithësisht profesionale.

Komuna e Shtërpcës do orientohet kryesisht në Vlerësimin e brendshëm i cili është bërë nga stafi I komunës, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Mirëpo Komuna e Shtërpcës mund të angazhoj edhe vlerësim dhe monitorim të jashtëm, ky vlerësim mund të bëhet nga një trupi jashtë strukturave të komunës.

6.1.5. Autoritetet kompetente për Zbatim dhe Monitorimin e zbatimit të PZHK-së së Shtërpcës

Fillimisht duhet sqaruar se Kuvendi i Komunës së Shtërpcës është përgjegjës për alokimin e fondeve për zbatimin e PZHK-së.

Ekipi punues mundë të angazhohet në përgatitje të Raportit të Monitorimit, ky ekip përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e drejtorive, më tutje do të sqarohen se kush do përgatit raportin e monitorimit nga organet e caktuara duke e kuptuar se ekipi punues do bartë ketë proces.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për zbatimin e PZHK-së së Shtërpcës, Monitorimin e zbatimit të PZHK-së si dhe përgatitjen e Raportit të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas Procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit, Drejtoritë komunale sektoriale zhvillojnë edhe aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre lidhur me përgatitjen e Raportit sektorial të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë raportet sektoriale vjetore për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë Raportet sektoriale vjetore të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të PZHK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna mund të angazhoj kompani konsulente për kapitullin e monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit e cila do të përkrahë Ekipin dhe Autoritetet në ketë proces.

Raportimi nga Ekipi Komunal Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh, dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e PZHK-së.

Ky raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit, dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

DRAFT

7. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

7.1. Hyrja në fuqi

- Ky Plan do të hyn në fuqi 15 ditë pasi që të miratohet nga Kuvendi Komunal.

7.1.1. Validiteti/ vlefshmëria

- Ky Plan do të jetë i vlefshëm së paku për 8 vjet.

7.1.2. Vlerësimi

- PZHK do të vlerësohen rregullisht, p.sh. një herë në vit.

Gjithashtu do të konsiderohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banime dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.

Procedura e rregullt e rishikimit është 4 vite pas ditës së miratimit të këtij dokumenti nga Kuvendi Komunal.

DRAFT